

ISSN: 2078-7111



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË

BULETINI SHKENCOR

SCIENCE BULLETIN

(seria e shkencave shoqërore)
(social science series)

VITI XVIII I BOTIMIT, Nr. 25, 2013

**BULETINI I SHKENCAVE
SHOQERORE**

KËSHILLI BOTUES I “BULETINIT SHKENCOR”

- Msc Valbona Emini (Redaktore letrare)
- Msc Migena Riza (Redaktore letrare)
- Monika Thimo (Personi i Kontaktit, Redaktore e gjuhësAngleze)

KËSHILLI SHKENCOR I “BULETINIT SHKENCOR”

- Prof. As. Dr. Gjergji MERO, Universiteti i Korçës, Shqipëri (Kryetar)
- Prof. Dr. Ion CUCUI, Universiteti i Targovishte, Ruman
- Prof. Dsci. Ivan PETKOV, Universiteti i Sofies,Bullgari
- Prof. Dr. Gjergji PENDAVINJI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Prof.Dr. Ali JASHARI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Prof. Dr. Gabriela TEODORESCU, Universiteti i Targovishte, Ruman
- Prof.Dr. Aleko MINGA, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof.Dr. Yllson MANOKU, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Prof. Dr. Kristaq TENEQEXHI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Ass. Dr. PhD Niko KACIROTI, Universiteti i Michigan, USA
- Prof. As. Dr. Aleksandra PILURI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Ass. Prof. Phd Gentian KOSTANDINI, Universiteti i Georgia, USA
- Prof. Ass. Dr. Irena KALLCO, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Ass. Prof. PhD Elton MYKEREZI, Universiteti i Minnesota, USA
- Prof. As. Dr. Lorenc EKONOMI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Dr. Frederik ÇUÇLLARI, Universiteti i Korçës, Shqipëri

PUBLIKUAR NGA

UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË

SHËTITORJA “RILINDASIT”

KORÇË, SHQIPËRI

EDITORIAL BOARD OF “SCIENCE BULLETIN”

- Msc Valbona Emini (Editor)
- Msc Migena Riza (Editor)
- Monika Thimo (Contact person, English - editor)

SCIENTIFIC BOARD OF “SCIENCE BULLETIN”

- Prof. As. Dr. Gjergji MERO, University of Korça, Albania (Chief)
- Prof. Dr. Ion CUCUI, University of Targovishte, Romania
- Prof. Dsci. Ivan PETKOV, University of Sofia, Bulgaria
- Prof. Dr. Gjergji PENDAVINJI, University of Korça, Albania
- Prof.Dr. Ali JASHARI, University of Korça, Albania
- Prof. Dr. Gabriela TEODORESCU, University of Targovishte, Romania
- Prof.Dr. aleko MINGA, University of Tirana, Albania
- Prof.Dr. Yllson MANOKU, University of Korça, Albania
- Prof. Dr. Kristaq TENEQEXHI, University of Korça, Albania
- Ass. Dr. PhD Niko KACIROTI, University of Michigan, USA
- Prof. As. Dr. Aleksandra PILURI, University of Korça, Albania
- Ass. Prof. Phd Gentian KOSTANDINI, University of Georgia, USA
- Prof. Ass. Dr. Irena KALLCO, University of Korça, Albania
- Ass. Prof. PhD Elton MYKEREZI, University of Minnesota, USA
- Prof. As. Dr. Lorenc EKONOMI, University of Korça, Albania
- Dr. Frederik ÇUÇLLARI, University of Korça, Albania

PUBLISHED BY

UNIVERSITY “FAN S. NOLI” KORÇE

SHETITORJA “RILINDASIT”

KORCA, ALBANIA

PËRMBAJTJA

GJUHËSI

Erjon Agolli

IDENTIFIKIMI I FJALIVE TË VARURA KOHORE NË KONTEKST

Evi Konjari

KUNDRINAT NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS GJERMANE DHE ASAJ SHQIPE

Nikolae Saramandu

KONKORDANCA GJUHËSORE MIDIS RUMANISHTES DHE SHQIPES

Pavlo Cicko, Robert Stratoberdha, Fabiola Kadi

RRETH LIGJËRIMIT TË SHKRUAR KULINAR NË SHQIP

Sejdi M.Gashi

KOHA E ARDHME E FOLJES NË SHQIPEN STANDARD. ASPEKTI KOHË, MËNYRË DHE MODALITET

Suela Mangelli

CËSHTJE TË HOMONIMISË LIDHUR ME MËSIMDHËNIEN E GJUHËS ANGLEZE

Suela Pici

“TOGFJALËSHI I QËNDRUESHËM” NË FJALORË (ANGLISHT DHE ANGLISHT-SHQIP)PËR STUDENTËT SHQIPTARË

LETËRSI

Erinda Papa

ANALIZË E ROMANIT “QYTETI ME KATËR PORTA” I DORIS LESINGUT

Eriola Qafzezi

PARATHËNIA – NJË ELEMENT I RËNDËSISHËM NË PËRKTHIMIN E LETËRSISË PËR FËMIJË

Fabiola Kadi

ANIMUS VS. ANIMA: VËSHTIRËSIA E PAJTIMIT TË ARTIT DHE BESIMIT NË VEPRËN LETRARE TË POETIT FRANCEZ PAUL CLAUDEL

Griselda Danglli (Abazaj)

PARODIA DHE ‘LËVIZJA E KALIT’ TEK “LOLITA” E VLADIMIR NABOKOVIT

Klodiana Kullolli

FIGURACIONI SI SHENJYES I MODERNITETIT NË LIRIKËN SHQIPE TË PERIUdhËS SË MIDIS DY LUFTËRAVE

Marina Prifti

STRUKTURA SIMBOLIKE E SUBJEKTITTE “KUSH E SOLLI DORUNTINËN” E SHKRIMTARIT ISMAIL KADARE

Sidita Hoxhiq Dano

THERRTORJA-PESË, NJË RRËFIM PASMODERN

Shpëtim Madani, Shqiponjë Dautaj

QASJA TRAGJI-KOMIKE NË PROZËN E BERNARD MALAMUDIT

Yzedin Hima

“LETËRSIA E PENGUAR” DHE DESTRUKSIONI I MITEVE”

HISTORI

Benita Stavre

NDËRMARRJET FINANCIARE TË QEVERIVE SHQIPTARE TË VITEVE 1920-1939 SIPAS KËNDVËSHTRIMIT TË AUTOREVE TË HUAJ

FILOZOFI – SOCIOLOGJI

Adelina Nexhipi

DUKURI GJINORE NË TRANZICION (RASTI I SHQIPËRISË)

Ardita Abdul

DALLIMET SOCIO-ETNIKE DHE NXITJA E KONFLIKTEVE TEK GRUPMOSHAT ADOLESHENTE NË RAJONIN E TETOVËS

Denisa Titili

MIGRIMI RURAL-URBAN: DINAMIKAT DHE PERSPEKTIVAT PËR INTEGRIMIN NË RRAFSHIN SUBKULTUROR- RASTI I QYTETIT TË KORÇËS

Doralda Tanellari

"DALLIMET SOCIO-KULTURORE NDËRMJET BREZAVE NË QYTETIN E POGRADECIT"

Genti Kruja

DASHURIA, TOLERANCA DHE DIALOGU NË FILOZOFINË E GYLENIT

Gjergji Pendavinji, Robert Stratoberdha

SIGURIMI I CILËSISË TË ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI DUHET TË MBËSHTETET NË OPTIKËN E PLATFORMES EUROPIANE TË MODERNIZIMIT TË ARSIMIT

Stela Karaj

MARRËDHËNIET MES ETIKETIMIT NEGATIV TË NXËNËSVE NGA MËSUESIT DHE MOSHATARËTDHE SJELLJES DEVIJANTE TË NXËNËSVE NË KLASË

PSIKOLOGJI, PEDAGOGJI

Artemisi Shehu (Dono), Jonida Ucaj

REAGIMET E NENAVE, PAS KOMUNIKIMIT TE DIAGNIZES NGA MJEKU, PER FEMIJET E TYRE ME SYNDROME DAUN (DOWN)

Juliana Cyfeku

INVESTIGATING GENDER ISSUES IN ENGLISH FOREIGN LANGUAGE LEARNING AMONG THE FRESHMAN STUDENTS OF ECONOMIC FACULTY “F.S.NOLI” UNIVERSITY. A – CASE STUDY.

Olsa Pema

VËSHTRIM KRITIK MBI NATYRËN E MËSIMDHËNIES SË GJUHËVE TË HUAJA (MGJH) PËRMES TEKNOLOGJIVE TË INTERNETIT

Pandora Teta

ROLI I RRJETIT SOCIAL FACEBOOK NË PROCESIN E PRODHIMIT TË FEEDBACK-UT FORMUES NË NDIHMË TË FORMIMIT DHE ZHVILLIMIT TË AFTËSIVE PËR TË SHKRUAR NË GJUHËN ANGLEZE

GJUHËSI

IDENTIFIKIMI I FJALIVE TË VARURA KOHORE NË KONTEKST ERJON AGOLLI

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëvetë Huaja
Departamenti i Gjuhës Angleze

Përmbledhje

Fjalitë e varura kohore rregullisht shënjohen nga prania e disa fjalëve lidhëse të cilat, përveç faktit që shërbejnë për të bashkuar fjalinë e varur dhe fjalinë kryesore, kryejnë funksione të ndryshme si ai *gramatikor* - duke bërë të mundur krijimin e lidhjeve nënrenditëse; *semantik* - duke bashkëngjitur marrëdhënie të ndryshme kohore; dhe *funksional* - duke bërë kështu dallimin nga strukturat e tjera të përafërta. Gjithsesi, duke qenë se shumë nga këto lidhëza mund të përdoren edhe për të prezantuar fjali me funksione të tjera sintaksore, është e vështirë të përcaktohet nëse fjalia e varur është kohore apo jo vetëm duke u bazuar tek lidhëza.

Ky punim fokusohet pikërisht tek dallimet kryesore ndërmjet fjalive të varura kohore dhe ndërtimeve të tjera që kanë të njëjtën strukturë por shprehin marrëdhënie të ndryshme semantike e funksionale si fjalitë kundrinore, dhe fjalitë përcaktore.

Fjalët kyçe: Fjali kohore, fjali kundrinore, fjali përcaktore

Abstract

Subordinate clauses of time are regularly marked by the use of some connective words which, in addition to joining the dependent clause and the main clause, have different functions such as: grammatical, enabling the creation of subordination; semantic, attaching different temporal relations; and functional, distinguishing them from similar structures. However, because many of these conjunctions can be used to present subordinate clauses of other syntactic functions, it is difficult to identify if the subordinate clause is a time clause or not, based only on the conjunction.

This paper focuses exactly on the main distinctions between time clauses and other constructions with the same structure, but expressing deferent semantic and functional relations, such as object clauses, and relative clauses.

Key words: Time clause, object clause, relative clause

Hyrje

Identifikimi i funksionit sintaksor të fjalive të varura dhe sidomos ai i fjalive të varura kohore, luan një rol shumë të rëndësishëm në kuptimin e dimensioneve të një teksti. Kjo pasi ndërtimi i sfondit kohor në çfarëdo teksti lehtëson ndjekjen e linjës së përgjithshme të ngjarjeve, proceseve, apo situatave në të, dhe lejon lexuesin të bashkëngjisë informacionin e ri në ngrehinën e vet të njohurive ekzistuese.

Për të prezantuar fjalitë kohore përdoren një grup fjalësh lidhëse që shpesh quhen lidhëza nënrenditëse kohore. Në gjuhën angleze të tilla janë, për shembull, *after, as, as/so long as, as soon as, before, once, since, until/till, when, whenever, while/whilst* etj. Ndërsa në shqip, disa shembuj lidhëzash kohore përfshijnë: *kur, që kur, tek, si, pasi, mbasi, sapo, sa, ndërsa, sa kohë që, para se* etj. Gjithsesi, duke qenë se shumë nga këto lidhëza mund të përdoren edhe për të prezantuar fjali me funksione të tjera sintaksore, është e vështirë të përcaktohet nëse fjalia e varur është kohore apo jo vetëm duke u bazuar tek lidhëza. Për shembull, në fjalitë e mëposhtme lidhëza nënrenditëse *since* prezanton fjali kohore në rastin (1a) dhe fjali shkakore në (1b):

- (1) a. He has worked as a teacher **since** he graduated.
(Ai ka punuar si mësues që kur u diplomua.)
b. He wasn't accepted for the job **since** he didn't have the proper education.
(Ai nuk u pranua në atë punë meqenëse nuk kishte arsimin e duhur.)

Për të identifikuar lehtësisht periudhën me fjali të varur kohore duhet të kemi njohuri të mjaftueshme teorike, të fituara nga studimi i përkufizimeve dhe koncepteve të ndryshme që lidhen me të, si dhe aftësi praktike, të fituara nga analiza dhe krahasime të fjalive kohore me ndërtime të tjera të ngjashme me to nga forma por që ndryshojnë rrënjësisht nga përmbajtja, apo funksioni sintaksor.

Kështu, sipas gramatikanëve tëgjuhës angleze “Një fjali rrethanore kohore lidh kohën e situatës së dhënë në fjalinë e saj me kohën e situatës së dhënë në fjalinë kryesore.” (*Longman*) [8]apo “Fjalitë e varura kohore përdoren për të thënë se kur ndodh diçka duke iu referuar një periudhe kohore apo një ngjarjeje tjetër” (*Collins Cobuild English Grammar*)[2].

- (2) He was detained*after he returned from a business trip overseas.*
(Ai u arrestua *pasi u kthye nga një udhëtim biznesi jashtë shtetit.*)

Tek shembulli (2) janë paraqitur dy ngjarje të cilat kanë lidhje me njëra-tjetrën, arrestimi dhe kthimi nga një udhëtim. Fjalia e varur kohore *after he returned from a business trip overseas* tregon kohën kur ndodhi arrestimi duke iu referuar një ngjarjeje tjetër që është kthimi i tij nga një udhëtim biznesi.

Edhe studiuesit shqiptarë japin përkufizime të ngjashme. Sipas Menella Totonit: “Në frazën kohore fjalia e nënrenditur shërben si orientues kohor për fjalinë kryesore. Situata e dhënë në fjalinë kryesore mund të jetë e njëkohshme ose jo e njëkohshme me situatën e dhënë në fjalinë e nënrenditur.” [10] Megjithëse Ttoni i konsideron njëkohësinë dhe jo-njëkohësinë si përbërësit semantik bazë të marrëdhënieve kohore, ai brenda tyre dallon edhe ngjyrimë më të imta, si: njëkohësi e plotë ose e pjesshme, paskohësi ose parakohësi etj. Ai i ilustron këto marrëdhënie me shembujt e mëposhtëm:

- (3) a. Ti do të shoqërosh mikun, *kur të dalë për gjah.* (njëkohësi e plotë)
b. Dolëm nga qyteti *kur po binte muzgu.* (njëkohësi e pjesshme)

c. Dhentë zbritën nga mali *kur bora kishte mbuluar gjithçka*. (paskohësi)

d. *Kur u zgjua për së dyti*, era i kishte shtyrë retë tutje. (parakohësi)

Vepra më madhore shkencore e gjuhës shqipe deri më sot është pa diskutim *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, e cila në vëllimin e saj të dytë (Sintaksa) jep këtë përkufizim për fjalitë kohore: “Periudha me fjali të varur kohore quhet periudha me nënrenditje ku fjalia e varur tregon kohën kur ndodh veprimi, ngjarja e fjalisë kryesore.”[1] Gjuhëtarët shqiptarë që punuan për hartimin e këtij libri janë të mendimit se lloji i marrëdhënies kohore shprehet nga kuptimi i lidhëzës kohore dhe nga bashkëlidhja e trajtave dhe e kuptimeve kohore të foljeve-kallëzues të fjalive. Në disa raste janë vendimtare të dyja këto elemente, ndërsa në raste të tjera njëri element është vendimtar dhe tjetri ndihmës. Për shembull:

(4) ***Kur i kish dëgjuar për herë të parë këto fjalë, ishte tallur*** një javë të tërë me Teftën.

Pra, në fjalinë e mësipërme raporti kohor realizohet nga kuptimi i lidhëzës kohore ***kur*** dhe nga bashkëlidhja e trajtave kohore të foljeve-kallëzues ***kish dëgjuar*** dhe ***ishte tallur*** të cilat që të dyja janë koha më se e kryer, mënyra dëftore.

Duke u bazuar në përkufizimet dhe trajtimet e punimeve shkencore të mëparshme në lidhje me këtë çështje mund të arrijmë në përfundimin se periudhat me fjali të varur kohore kanë karakteristikat e mëposhtme:

- a Përdoren për të thënë se kur ndodh ngjarja e fjalisë kryesore në raport me ngjarjen e paraqitur në fjalinë e varur
- a Nuk përcaktojnë foljen e fjalisë kryesore por të gjithë fjalinë kryesore
- a Ngërthejnë marrëdhënie kohore të parakohësisë, njëkohësisë dhe paskohësisë
- a Lloji i marrëdhënies kohore shprehet nga kuptimi i lidhëzës kohore dhe nga bashkëlidhja e trajtave dhe e kuptimeve kohore të foljeve-kallëzues të fjalive.

Fjalitë e varura kohore dhe fjalitë kundrinore

Siç e kemi parë deri tani, shumë studiues në fushën e gramatikës i dallojnë fjalitë e varura kohore duke filluar me identifikimin e lidhëzave kohore dhe marrëdhënieve që ato shprehin. Gjithsesi, në literatura të ndryshme gjen pak hulumtime mbi përcaktimin se kur një fjali e varur që prezantohet me këto lidhëza është kohore dhe kur jo.

Ndërsa shprehjet kohore dhe lidhëzat nuk janë një mjet i mjaftueshëm për identifikimin e fjalive të varura kohore, një vështrim në aspektin funksional do të na ndihmonte më shumë për t'i dalluar ato nga fjalitë kundrinore. Ndërkohë që funksioni i fjalisë së varur kohore, siç e kemi shpjeguar gjerësisht më sipër, është të tregojë rrethanën kohore kur ndodh ngjarja/ngjarjet, “fjalia e varur kundrinore

drejtpërdrejt ose tërthorazi kryen një funksion të ngjashëm me atë të një kundrine”[1].

(5) a. A motorist has reported *that the road is blocked by snow at Soutra Hill*.

(Një automobilist ka raportuar *se rruga është bllokuar nga bora në Soutra Hill*.)

b. Rilindësit u rikujtuan shqiptarëve *se ata ishin një popull i zgjuar*.

Shembujt e mësipërm nga gjuha angleze dhe nga gjuha shqipe tregojnë qartë se fjalitë e varura kundrinore janë të lidhura drejtpërdrejt me foljen-kallëzues, në një farë mënyre duke plotësuar përmbajtjen e saj dhe kryejnë funksionin e kundrinës.

Për më tepër, Mehmet Çeliku [3] jep disa këshilla praktike për dallimin e sifjalive kundrinore, siç i quan ai, me anë të pyetjeve drejtuar foljes-kallëzues. Sipas tij, “në qoftë se përgjigja barazohet me togfjalëshat “këtë gjë” dhe “atij që”, atëherë kemi periudhë me sifjali kundrinore: *Ai kërkonte që të specializohej në Francë* (-çfarë kërkonte? = këtë gjë = ***që të specializohej në Francë***).

Sipas Longman [8] fjalitë kundrinore mund të prezantohen edhe nga ndajfolja kohore *when* (kur?). Pra, vetëm nëse merren parasysh faktet e mësipërme dhe nëse shohim me kujdes funksionet sintaksore të fjalive, mund të dallojmë fjalinë e varur kohore nga fjalia kundrinore që fillon me ndajfolje kohore. Le të marrim disa shembuj:

(6) a. Tell me *when you'll be ready*.

(Më thuaj *kur do të jesh gati*.)

b. Tell me *when you are ready*.

(Më thuaj *kur të jesh gati*.)

Fjalia e parë (6a) është periudhë me fjali të varur kundrinore. Ajo mund të interpretohet në këtë mënyrë: Më thuaj kohën në të cilën ti do të jesh gati (pra, -çfarë të të them? -këtë gjë: *kur do të jesh gati*). Ndërsa fjalia e dytë (6b) është periudhë me fjali të varur kohore. Ajo është ekuivalente me: Më thuaj sapo të jesh gati.

Për të qenë sa më të qartë po trajtojmë në vijim edhe disa shembuj nga gjuha shqipe:

(7) a. Nuk e mbante mend *kur e kishte shkruar poezinë e parë*.

b. Ai ishte hedhur nga gëzimi *kur e kishte shkruar poezinë e parë*.

Tek (7a) kemi të bëjmë me fjali të varur kundrinore. Ajo i përgjigjet pyetjes: -Çfarë nuk mbante mend? -Këtë gjë = *kur e kishte shkruar poezinë e parë*. Kurse shembulli (7b) përmban fjali të varur kohore, pasi i përgjigjet pyetjes: -Kur ishte hedhur nga gëzimi? - *Kur e kishte shkruar poezinë e parë*.

Fjalitë e varura kohore dhe fjalitë përcaktore

Fjalitë kohore ofrojnë një spirancë kohore për ngjarjen që përshkruhet në fjalinë nga e cila varen. Ndërsa fjalitë përcaktore kryejnë një funksion të ngjashëm me atë të një gjymtyrë përcaktore. Sipas Mark Njusunit [6], fjali lidhore (përcaktore)

quhet fjalia e varur që përcakton një emër që e paraprin atë. Po kështu edhe sipas *Gramatikës së Gjuhës Shqipe* [1], periudhë me fjali të varur përcaktore quhet ajo periudhë në të cilën fjalia e varur tregon në përgjithësi një karakteristikë të një sendi të shprehur prej një gjymtyre emërore i cili është paraprijës i saj. Për shembull:

(8) Njeriu *që vetëm për vete punon* është si një dru *që pemë s'lëshon*.

(9) The cottage *which Mrs Dashwood accepted* was rather small.

(Vila *që pranoi Znj. Dashud* ishte shumë e vogël.)

Si në shqip ashtu edhe në anglisht, fjalia e varur përcaktore përcakton emrin apo gjymtyrën emërore që i paraprin. Kështu, tek shembulli (8) fjalitë e varura përcaktore *që vetëm për vete punon* dhe *që pemë s'lëshon* përcaktojnë emrat që vijnë para tyre, përkatësisht **Njeriu** dhe **një dru**. Po kështu edhe tek shembulli (9) i marrë nga gjuha angleze, fjalia e varur përcaktore *which Mrs Dashwood accepted* përcakton emrin **The cottage**.

Collins Cobuild English Grammar[2] thekson se ndajfolja lidhore *when* kryen funksionin e një përemri lidhor dhe mund të përdoret në fjalitë lidhore (përcaktore), por vetëm kur paraprihet nga emra me kuptime kohore si “dita”, “viti”, “koha” etj. Megjithëse përshkrimi i përgjithshëm i fjalive të varura kohore dhe fjalive të varura përcaktore na ndihmon shumë në njohjen e të dy ndërtimeve, gjërat vështirësohen pak kur fjalitë përcaktore prezantohen nga ndajfolja lidhore *when* (kur?). Kështu, një sy më pak i stërvitur do ta kishte të vështirë të dallonte se cila nga fjalitë e mëposhtme është fjali e varur kohore:

(10) a. There had been a time *when she thought they were wonderful*.

(Ishte një kohë *kur ajo mendonte se ata ishin të mrekullueshëm*.)

b. Jack were sceptical *when she thought they were wonderful*.

(Xheku ishte skeptik *kur ajo mendonte se ata ishin të mrekullueshëm*.)

Nëse i referohemi përkufizimeve dhe sqarimeve që dhamë më sipër, do të dallonim që shembulli (10a) paraqet një fjali të varur përcaktore pasi fjalia e varur e prezantuar nga ndajfolja lidhore *when* (kur?), këtu në rolin e një përemri lidhor, përcakton gjymtyrën emërore që i paraprin *a time* dhe jo të gjithë fjalinë kryesore. Ndërsa tek (10b) kemi rast të pastër të fjalisë së varur kohore sepse fjalia e varur *when she thought they were wonderful* specifikon kontekstin kohor të fjalisë kryesore Jack were sceptical dhe tregon kohën se kur ndodhi ngjarja e paraqitur në këtë fjali.

Edhe në gjuhën shqipe, sipas Menella Totonit [10], në frazat me fjalë mbështetëse përcaktore mund të përdoren si mjete lidhëze edhe ndajfolja lidhore kohore *kur* në vend të përemrit lidhor *që*, karakteristik për këto ndërtime. Ai thekson se ndajfolja lidhore *kur* përdoret në fjali të varura përcaktore, fjala mbështetëse e të cilave është një emër me kuptim kohe:

(11) a. Më mirë më thirr Agavia si atë ditë *kur më pagëzove për së dyti dhe s'pyete më për mua*.

b. Ai kujtonte me mallëngjim vitet e rinisë, *kur bukuria dhe fuqia nuk e kishin lënë ende.*

Pra, njësoj si në anglisht, karakteristikë e fjalive të varura përcaktore me ndajfoljen lidhore *kur* është fakti që ato vijnë pas fjalës mbështetëse me kuptim kohor dhe e përcaktojnë atë siç mund të shihet tek shembujt (11,a,b).

Jim Miller [7] bën një hap më tej duke paraqitur një sërë rregullash që ndihmojnë në identifikimin e fjalive të varura kohore dhe atyre përcaktore. Ai bazohet tek disa pyetje praktike që mund t'i bëjmë vetes kur na duhet të dallojmë midis këtyre dy ndërtimeve:

A. A specifikon kontekstin e fjalisë kryesore? Nëse po, është fjali e varur rrethanore.

A-1. A paraqet kohën e situatës në fjalinë kryesore? Nëse po, është fjali e varur kohore.

(12) *When we sell the house, we will probably leave most of the furniture.*

(*Kur të shesim shtëpinë, ndoshta do të lemë aty shumicën e mobilieve.*)

Tek shembulli (12) fjalia e varur që jepet me gërma të pjerrëta përcakton të gjithë fjalinë kryesore dhe paraqet kohën për situatën e shprehur në fjalinë kryesore. Prandaj mund të themi se kemi të bëjmë me fjali të varur (rrethanore) kohore.

B. A përcakton një emër? Nëse po, është fjali lidhore (përcaktore)

B-1. A ka emri kuptim kohor? Nëse po, është fjali lidhore(përcaktore) kohore.

(13) *This is the year when the profits should start.*

(Ky është viti *kur duhet të fillojnë fitimet.*)

Tek shembulli (13) fjalia e varur *when the profits should start* përcakton emrin *the year* i cili ka kuptim kohor. Pra, kemi të bëjmë me atë që Miller-i e quan fjali lidhore kohore, që në shqip korrespondon me termin fjali përcaktore.

Përfundime

Mendojmë se një njohje më e thellë e karakteristikave të fjalive të varura kohore në anglisht dhe në shqip është thelbësore për identifikimin dhe dallimin e saktëtë periudhës me fjali të varur kohore nga ndërtime të tjera gjuhësore të ngjashme me të, pasi duke analizuar vetëm formën mund të ngatërrohemi. Për ta vërtetuar këtë le të studiojmë shkurtimisht rastet e mëposhtme:

(14) a. We don't know *when this happened.*

(Nuk e dimë *kur ndodhi kjo.*)

b. Can you really remember the time *when this happened?*

(Vërtet mund ta mbash mend kohën *kur ndodhi kjo?*)

c. We were in Paris *when this happened.*

(Ishim në Paris kur ndodhi kjo.)

Megjithëse tek të tre shembujt forma e fjalisë së varur është e njëjtë *when this happened*, do të nxitoheshim nëse do të thoshim se në të gjitha rastet kemi të bëjmë me fjali të varur kohore. Tek shembulli (14a), fjalia e varur lidhet me foljen-kallëzues dhe shërben si kundrinor. Tek rasti (14b), *when this happened* përcakton emrin *time* dhe është fjali e varur përcaktore. Kurse shembulli i tretë (14c) na jep fjali të varur kohore pasi *when this happened* tregon kohën kur ndodhi veprimi i paraqitur në fjalinë kryesore *We were in Paris*.

BIBLIOGRAFIA

Akademia e shkencave e Shqipërisë (2002) *Gramatika e gjuhës shqipe* (sintaksa), Tiranë.

Collins Cobuild English Grammar(1992), London,HarperCollins Publishers.

Çeliku M (2008) *Tekst Ushtrimesh për Sintaksën e Shqipes Standarde – (Pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura)*, Tiranë,Illar.

Çeliku M, Karapinjalli M, Stringa R(2007) *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Tiranë,Illar.

Declerck R (2005) *When-Clauses and Temporal Structure*, London and New York, Routledge.

Newson M(2006) *Basic English Syntax with Exercises*, Budapest, Bolcsesz Konzorcium HEFOP Iroda.

Miller J (2009)*An Introduction to English Syntax*, Second Edition, Edinburgh,Edinburgh University Press.

Quirk R, GreenbaumS, LeechG, SvartvikJ (1985)*A Comprehensive Grammar of the English Language*, London, Longman.

Huddleston R, Pullum GK (2003)*The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press.

Totoni M (2000)*Fraza me nënrenditje*, Tirana, SHBLU.

KUNDRINAT NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS GJERMANE DHE GJUHËS SHQIPE

Evi Konjari

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Departamenti i Gjuhës Gjermane

Abstrakti

Artikulli synon të vëre përballë njëri-tjetrit trajtimin e kundrinave në metoda të ndryshme të mësimdhënies së gjuhës gjermane dhe asaj shqipe. Pas një vështrimi të shkurtër të përgjithshëm rreth kundrinave në të dy gjuhët si dhe shkollave të ndryshme gramatikore do të merren në shqyrtim disa metoda të përzgjedhura të mësimi të gjuhës gjermane, të cilat gjejnë përdorim të gjerë në Shqipëri si dhe metoda të gjuhës shqipe, gjithashtu të përdorura gjerësisht. Në përfundim do të evidentohen dallimet kryesore mes metodave në të dy gjuhët.

Fjalë kyçe: kundrina, mësimdhënie, gjymtyrë të dyta, gramatika tradicionale, gramatika e dependencës.

Hyrje

Gjatë studimit të mësimdhënies së kundrinës dhe sidomos në përdorimin e saj si nxënës apo mësues i gjuhës gjermane hasen ndryshime dhe rrjedhimisht dhe vështirësi të ndryshme. Për këtë arsye nëpërmjet këtij hulumtimi do përpiqem të jap një vështrim të qartë rreth mësimdhënies së kundrinës në gjuhën gjermane dhe atë shqipe. Për realizimin e këtij hulumtimi janë marrë në shqyrtim disa metoda bashkëkohore të mësimi të gjuhës shqipe dhe asaj gjermane, të cilat gjejnë përdorim të gjerë në vendin tonë.

Në të dyja gjuhët kundrrinat zënë një vend qendror për nga rëndësia në gramatikë përse i përket gjymtyrëve të dyta.

Përgjatë zhvillimit të shkencave gjuhësore në dhjetëvjeçarët e fundit kanë lindur teori, apo shkolla të ndryshme gramatikore, të cilat përpiqen në forma të ndryshme të krijojnë një skemë të kompleksitetit të ndërtimit të një gjuhe. Ato gjithashtu trajtojnë emërtimet, funksionin dhe rendin në fjali të kundrinave sipas këndvështrimeve të ndryshme.

Këto teori gramatikore gjejnë përdorim si në mësimdhënien e gjuhës gjermane ashtu dhe në atë të gjuhës shqipe. Por në ndryshim nga gjermanishtja në orën e gjuhës shqipe bazohemi në gramatikën tradicionale, gjë që përbën dhe ndryshimin kryesor mes metodave në dy gjuhët.

Një vështrim i përgjithshëm rreth kundrinave në të dy gjuhët

Natyrshëm lindin pyetje të tilla si: “Çfarë kuptojmë me termin *kundrinë*? Si përkufizohet ky term në gramatika të ndryshme shkollore ose në fjalorë? Cilat kriteret duhet të kemi parasysh në klasifikimin e kundrinës si në gjermanisht ashtu

edhe në shqip? Si do të trajtohen llojet e ndryshme të kundrinave në mësimdhënien e gjuhës së huaj?

Siç u përmend më parë në shekujt e fundit janë krijuar shumë teori gramatikore, të cilat paraqesin lloje të ndryshme të kundrinave duke i trajtuar ato nga këndvështrime të ndryshme. Në fillim dua të prek shkurtimisht termin kundrinë në gjuhën gjermane dhe atë shqipe.

Sipas fjalorit njëgjuhësh Wahrig kundrina përkufizohet si më poshtë:

“Kundrinë”: gram. pjesë e fjalisë, e cila është një plotës emëror i kallëzuesit (Wahrig 2006: fq. 1086).

Në leksikon e shkencës së gjuhësisë nga Bussmann jepet një tjetër shpjegim për termin:

“Kundrinë” - termi i përmbledhur për shumë funksione sintaksore në gjuhët si gjermanishtja, anglishtja, që në varësi të llojit të gjuhës ndonjëherë dallohet nga ana morfologjike (nëpërmjet rasës obliquus) ose nga pozicioni (nëpërmjet pozicionimit të kryefjalës) dhe sipas rregullit karakterizon vetën ose rrethanën, me të cilën lidhet veprimi (përcaktuar nga folja). (Bußmann. , H “Lexikon der Sprachwissenschaft” Stuttgart 1983, fq. 540-541)

Sipas Griessbach: Kundrinë janë të gjitha funksionet e përmendura gjatë përshkrimit të një rrethane, të cilat nuk janë kryefjalë. Sachverhalt = Geschehen/Sein+Rollen (Kadzadej, B; “Deutsche Syntax”, Tiranë, 2002; fq. 64)

Sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe të Akademisë së Shkencave: “Kundrinë”, gjymtyrë e dytë e fjalisë, mbi të cilën bie veprimi i foljes që shërben si kallëzues (Akademia e Shkencave të Shqipërisë, “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1980)

Sipas *Gramatikës së gjuhës shqipe*: Kundrinat janë gjymtyrë të dyta me të cilat shprehen raporte objektore në mes një veprimi a tipari dhe objektit të tij, zakonisht ndërmjet një emri a një fjale tjetër emërore, të lidhur me drejtim me një folje a mbiemër. Më së shumti ato shënojnë objektin e veprimit që shpreh folja. (Çeliku, M\Dom, M\ Floqi, S\ Mansaku, S\Përnaska, R\ Prifti, S\Totoni, M; “Gramatika e Gjuhës Shqipe II”, Tiranë, 2002 fq. 209)

Klasifikimi i kundrinës si në gjuhën gjermane ashtu dhe në atë shqipe varet nga faktorë morfologjikë dhe semantikë (i drejtë/ i zhdrejtë; direkte/indirekte objekt)

Një fenomen gramatikor karakteristik i gjuhës gjermane është ai i reksionit të foljeve, pra, që folje të caktuara kërkojnë një rasë të caktuar. Pra, foljet në gjuhën gjermane kërkojnë rasën kallëzore, dhanore apo kallëzore dhe dhanore, si dhe një numër shumë të vogël foljesh kërkojnë rasën gjinore.

Në gjuhën gjermane dallohen 4 llojet e mëposhtme të kundrinave: Akkusativobjekt (kundrina e drejtë), Dativobjekt (kundrina e zhdrejtë), Genitivobjekt (kundrina e rasës gjinore) dhe Präpositionalobjekt (kundrina e zhdrejtë me parafjalë).

Ndërsa në gjuhën shqipe dallohen 3 lloje kundrinash: kundrina e drejtë “das direkte Objekt” /Akusativobjekt, kundrina e zhdrejtë “das indirekte Objekt”/Dativobjekt dhe Kundrina e zhdrejtë me parafjalë “das Präpositionalobjekt”.

Sipas valencës së një lekseme foljore një kundrinë si në gjermanisht ashtu edhe në shqip mund të shfaqet në fjali e vetme ose e shoqëruar me lloje të tjera kundrinash.

Ndërmjet kundrinës së drejtë, të zhdrejtë dhe asaj me parafjalë në të dyja gjuhët ka vetëm ca ndryshime të vogla. Dy ndryshimet thelbësore janë kundrina e rasës gjinore (Genitivobjekt) në gjermanisht, e cila në gramatikën e gjuhës shqipe nuk egziston dhe trajta e shkurtër (Objektverdoppelung) në shqip, e cila nuk haset në gramatikën e gjuhës gjermane. Trajta e shkurtër (Objektverdoppelung) është një dukuri sintaksore, e cila nga ana morfologjike shfaqet në vendosjen e një tipari të kundrinës pranë foljes, e cila e kërkon atë. (Buchholz, O; Fiedler, W, “Albanische Grammatik”, Leipzig, 1985).

1. Kundrinat në mësimdhënien e gjuhës gjermane

Duke u bazuar te metodat e mësimi të gjuhës së huaj dhe gramatikat shkollore, do mundohem të pasqyroj sa më qartë të jetë e mundur mënyrën se si transmetohen kundrinat në mësimin e gjuhës gjermane dhe asaj shqipe. Për të përfutur një vështrim të përgjithshëm mbi kundrinat në orën e mësimi të gjermanishtes, do bazohem në metodat mësimore: “Moment mal” (1996) i autorëve M. Müller, P. Rusch, Th. Scherling, R. Schmidt, L. Wertenschlag, H. Wilms, Ch. Lemke; “Schritte international” (2006) i autorëve D. Niebisch, S. P. Himstra, F. Specht, M. Bouvermann, M. Reimann; “Auf neuen Wegen”, (2003) i autorëve E. M. Willkop, C. Wiemer, E. M. Küppers, D. Eggers, I. Zöllner; dhe në gramatikën shkollore “Grammatik und vieles mehr. Linguistische Grundlagen und Lernziele für den Lernunterricht der Sekundarstufen,,(2004) i autorit M. Wachtel.

Kështu kundrinat në metodën e mësimi të gjermanishtes si gjuhë e huaj “Moment mal” 1, 2 dhe 3, një metodë mësimore për fillestarë që mësojnë gjermanishten si gjuhë e huaj, e cila u drejtohet të rriturve dhe të rinjve duke filluar nga mosha 16 vjeç dhe i çon ata në nivelet A1, A2, B1, kundrinat (Ergänzungen) shpjegohen në kuadër të gramatikës së dependencës. Me qenë se folja në gramatikën e dependencës zë vendin qendror në fjali dhe kundrinat janë të përcaktuara në varësi të rasës, kundrina e drejtë, e cila është më pranë me foljen dhe zë përdorim më të gjerë në gjermanisht, paraqitet e para në këtë metodë mësimore. Kundrina e zhdrejtë paraqitet në pjesën e dytë duke qenë se në gjermanisht ka edhe folje të cilat kërkojnë dhanoren. Kundrina me parafjalë, e cila tek nxënësit shkakton një tërësi vështirësish, zë pjesën e tretë, sepse nga një anë ka folje të cilat kërkojnë parafjalë në kallëzore si p. sh. bis, durch, für, gegen, ohne um (deri, përmes, për, kundër, pa, në) ose në dhanore si p. sh. aus, bei, mit, nach, seit, von, zu (nga, gjatë, me, në, prej, tek) dhe nga ana tjetër duhet bërë ndryshimi mes parafjalëve të qëndrueshme(feste Präpositionen) dhe të paqëndrueshme (nicht feste), gjë që çon në dallimin e kundrinave. Me qenë se gjinorja si rasë e kundrinës haset shumë rrallë në gjermanisht, kundrina e rasës gjinore është paraqitur në pjesën e fundit të kësaj metode mësimore. Një arsye tjetër për këtë është fakti se në shumicën e rasteve kundrina e rasës gjinore zëvendësohet me kundrinën me parafjalë. Një kujdes i veçantë në metodën “Moment mal” do t’i kushtohet gjithashtu pozicionit të kundrinave. Të gjitha këto shpjegime teorike në lidhje me kundrinat në gjuhën

gjermane do të konkretizohen në fund me anë të ushtrimeve të ndryshme. Sipas këndvështrimit tim, ky libër i referohet gramatikës së dependencës sepse vendi qendror i foljes tregon rolin e rëndësishëm të kallëzuesit, i cili kushtëzon ekzistencën e gjymtyrëve të tjera të fjalisë dhe në këtë mënyrë analiza e gjymtyrëve të fjalisë do të bëhet më e lehtë për nxënësit.

Ndërsa në metodën “Schritte International” 1 dhe 2, e cila i çon nxënësit në nivelet A1 dhe A2, vihet re se përcaktimi i kundrinave bazohet në gramatikën tradicionale. Këtu madje vihen re ndryshime në përkufizimin e terminologjisë. Ndërsa në gramatikën e dependencës, e cila gjeti pasqyrim në “Moment mal”, bëhej fjalë për Ergänzungen (plotësat), në gramatikën tradicionale shfaqet termi kundrinë. Me qenë se kjo metodë mësimore është menduar për të rritur dhe të rinj pa njohuri paraprake të gjermanishtes, pra për fillestarë, do të vihen re disa thjeshtësime. Kështu p. sh. për arsye të vështirësive të përmendura më sipër, në këtë metodë shtellohen kundrina me parafjalë dhe kundrina e gjinore. Në këtë metodë paraqiten vetëm kundrina e drejtë dhe e zhdrejtë, përdorimi në gjuhën gjermane i të cilave do të qartësohet përmes ushtrimeve. Gjatë shpjegimit të këtyre kundrinave një rol të madh luan rasa e tyre. Ndryshe nga gramatika e dependencës, këtu folja nuk kuptohet si bërthama e fjalisë. Arsyeja pse nuk merret si bazë gramatika e dependencës, sipas mendimit tim, është teoria e valencës, shpjegimi i së cilës shkakton vështirësi tek nxënësit, pasi në këtë rast ata nuk kanë njohuri të paraprake të gjuhës.

Në ndryshim me “Schritte international” 1 dhe 3 dhe “Moment mal”, metoda “Auf neuen Wegen” është një metodë mësimore për persona, të cilët kanë njohuri paraprake të gjuhës dhe duan të merren në mënyrë intensive me gjuhën dhe kulturën gjermane ose dëshirojnë të studiojnë në një universitet gjermanishtfolës. Në këtë metodë mësimore kundrinat trajtohen njësoj si tek “Moment mal” duke marrë si bazë gramatikën e dependencës/ valencës së foljes. Valenca e foljes si pjesë e bërthamës së gramatikës së dependencës merr një rëndësi të veçantë në këtë rast, pasi numri i kundrinave në një fjali përcaktohet me ndihmën e saj. Sipas këndvështrimit tim gramatika e dependencës në këtë metodë të çon edhe në ndryshimin e kundrinave nga plotësat e tjerë, të cilët mund të jenë fakultativ në një fjali. Në dallim nga metodat mësimore që u përmendën më sipër, këtu përmendet një përshkrim i detajuar i kundrinave duke u renditur në varësi të shkallës së vështirësisë. Megjithatë as këtu nuk mungojnë ushtrimet, të cilët qartësojnë shpjegimin teorik.

Në krahasim me tekstet e mëparshme mësimore, kundrinat në gramatikën shkollore “Gramatik und vieles mehr. Linguistische Grundlagen und Lernziele für den Lernunterricht der Sekundarstufen”, e cila bazohet në gramatikën tradicionale, parashtrohen vetëm teorikisht. Në këtë libër u kushtohet më tepër rëndësi pjesëve së ligjëratës dhe kategorive gramatikore, nëpërmjet të cilave shprehen kundrinat në një fjali, duke qenë se ato mund të përmbushin funksione të ndryshme në një fjali. Morfologjia këtu qëndron në plan të parë. Përsa i përket renditjes së kundrinave vihet re se kundrina me parafjalë zë vendin e fundit, megjithëse kundrina në rasën gjinore haset shumë rrallë.

Kjo lidhet me faktin se në rastin e kundrinës me parafjalë, ndryshe nga llojet e tjera të kundrinave, reksioni i rasës nuk realizohet direkt nga folja, por me anën e një parafjale.

2. Kundrinat në mësimdhënien e gjuhës shqipe

Meqenëse se deri tani u trajtuan hollësisht vetëm kundrinat në orën e mësimi të gjuhës gjermane, natyrisht që shtrohet pyetja se si do të transmetohen kundrinat në orën e mësimi të gjuhës shqipe dhe nëse ekzistojnë ndryshime mes tyre. Përpara se të trajtoj shkurtimisht këtë çështje, dua të theksoj se për përgjigjen e saj do i referohem teksteve mësimore dhe gramatikave shkollore si p. sh. “Gjuha Shqipe 8” i M. Gjokutaj dhe A. Ballhysa, “Gramatika e Gjuhës Shqipe” i B. Beci dhe “Gramatika e Gjuhës Shqipe II, Sintaksa” i M. Çeliku, M. Domi, S. Floqi, S. Mansaku, R. Përnaska, S. Prifti, M. Totoni.

Në ndryshim me gjermanishten, mësimi i gjuhës shqipe bazohet më tepër në gramatikën tradicionale. Kjo gjen një përdorim të gjerë si te “Gjuha Shqipe 8”, një gramatikë shkollore, grupi i synuar i së cilës janë nxënësit e shkollës së detyrueshme 9 vjeçare që ndjekin klasën e 8-të, ashtu edhe në “*Gramatika e Gjuhës Shqipe*” B. Beci dhe “*Gramatika e Gjuhës Shqipe II, Sintaksa*” M. Çeliku, M. Domi, S. Floqi, S. Mansaku, R. Përnaska, S. Prifti, M. Totoni, të shkollave të mesme dhe universiteteve. Në të gjitha këto gramatika shkollore dhe tekste mësimore kundrinat renditen në varësi të rasës dhe shkallës së vështirësisë si vijon: kundrina e drejtë, kundrina e zhdrejtë, kundrina me parafjalë.

Si në gjermanisht ashtu dhe në metodat e mësimi të gjuhës kundrina e drejtë shfaqet në vend të parë, më pas ajo ndiqet nga kundrina e zhdrejtë, duke qenë se ato hasen më shpesh në gjuhën shqipe. Kundrina me parafjalë, e cila është më e komplikuar se kundrina e drejtë dhe e zhdrejtë, shfaqet si në gjermanisht në vendin e tretë, përse i përket rendit të shpjegimit të tyre në orën e mësimi. Në ndryshim me mësimin e gjuhës gjermane, në mësimin e gjuhës shqipe nuk shpjegohet kundrina e rasës gjinore, duke qenë se ajo nuk ekziston në shqip.

Shpjegimi teorik i kundrinave, si në gjuhën shqipe, ashtu dhe në atë gjermane, gjen zbatimin praktik në ushtrime të ndryshme. Kështu p. sh. në gramatikën shkollore të klasës së tetë teoria konkretizohet me ushtrime. Megjithatë ka edhe raste në të cilat kundrinat trajtohen vetëm teorikisht, si p. sh. në tekstet mësimore, si: “*Gramatika e Gjuhës Shqipe*” B. Beci dhe “*Gramatika e Gjuhës Shqipe II, Sintaksa*” M. Çeliku, M. Domi, S. Floqi, S. Mansaku, R. Përnaska, S. Prifti, M. Totoni. Në të dyja këto tekste shkollore janë dhënë vetëm përkufizime teorike të ilustruara me shembuj.

3. Përfundime

Së fundi, mund të thuhet sesi në mësimin e gjuhës gjermane ashtu edhe në atë të gjuhës shqipe metoda komunikuese është themelore, pasi stimulon të menduarit produktiv nëpërmjet ushtrimeve në klasë dhe nxit aftësinë njohëse të nxënësve.

Përveç kësaj, në orën e mësimit të gjuhës, jepen teori të ndryshme gramatikore si gramatika tradicionale ose gramatika e dependencës, për të lehtësuar të mësuarit e gjuhëve të reja. Këto teori gramatikore gjejnë përdorim si në mësimdhënien e gjuhës gjermane ashtu dhe në atë të gjuhës shqipe. Por në ndryshim nga gjermanishtja në orën e gjuhës shqipe bazohemi në gramatikën tradicionale. Në orën e gjuhës gjermane gjen përdorim jo vetëm gramatika tradicionale, por edhe gramatika e dependencës. Përmes teorisë së valencës ajo lehtëson analizën e pjesëve të fjalisë dhe vendos numrin e plotësive (kundrinave), të cilët mund të shfaqen në një fjali. Nga ana tjetër, ajo lë shumë çështje të hapura, pasi jo çdo pjesë e fjalisë varet nga folja. Por, gjatë trajtimit të kundrinave, në ndryshim nga gramatika tradicionale, ajo ofron mundësi dallimi në lidhje me plotësat e detyrueshëm dhe fakultativ. Nga ana tjetër, gramatika e dependencës shkakton vështirësi për mësimin e një gjuhe të re, sepse jo çdo nxënës është në gjendje të dallojë kundrinat në një fjali përmes marrëdhënieve të varësisë. Për këtë arsye në orën e mësimit të gjuhës preferohet më tepër gramatika tradicionale. Por përfundimisht nuk mund të thuhet se gramatika tradicionale është gramatika më e mirë, sepse siç u qartësua më lart ka edhe këtu mangësi, të cilat plotësohen nga gramatika e dependencës.

Vlen gjithashtu të theksohet se të gjitha metodat e marra në shqyrtim në të dyja gjuhët ishin të pasura me shembuj, gjë që e bën asimilimin e teorisë mjaft të lehtë e të kuptueshme për nxënësit.

Bibliografia

Bahri, B. Gramatika e Gjuhës Shqipe, Tiranë, 2004.

Buchholz, Oda; Fiedler, Wielfried: Albanische Grammatik, Leipzig, 1987.

Çeliku, M. , Domi, M. , Floqi, S. , Mansaku, S. , Përnaska, R. , Prifti, S. , Totoni, M. , Gramatika e Gjuhës Shqipe II. Sintaksa, Tiranë, 2002

Çabej, Eqerem. Hyrje në historinë e gjuhës shqipe (pjesa e parë), Tiranë, 2008.

Demiraj, Shaban. Gramatikë e historisë së gjuhës shqipe, Tiranë, 1986

Duden 4: Grammatik der deutschen Gegenwartssprache, Mannheim, Leipzig, Wien, Zuerich, 1984.

Dreyer, Hilke; Schmitt, Richard: Lehr- und Übungsbuch der deutschen Grammatik, Ismaning 1998.

Engel, Ulrich: Deutsche Grammatik, Heidelberg, 1996.

Eroms, Hans- Werner: Syntax der deutschen Sprache, Berlin, New York, 2000.

Goetze, Lutz; Hess- Luettich, Ernest: Grammatik der deutschen Sprache, München, 2002.

Gjokutaj, M. , Ballhysa, A. , Gjuha Shqipe 8, Tiranë. , 2007.

Graffi, Giorgio. , Sintaksa, Strukturat e ligjërit, Tiranë. , 2003.

Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim: Leitfaden der deutschen Grammatik, Berlin und München, 2000.

Kadzadej, Brikena: Deutsche Syntax, Tiranë, 2012.

Müller, M. , Rusch, P. , Scherling, Th. , Schmidt, R. , Wertenschlag, L. , Wilms, Heinz. , Lemcke, Ch. , Moment mal 1. , Berlin, München, 1996.

Müller, M. , Rusch, P. , Scherling, Th. , Schmidt, R. , Wertenschlag, L. , Wilms, Heinz; Lemcke, Ch. , Moment mal 2. , Berlin, München, 1996.

Müller, M. , Rusch, P. , Scherling, Th. , Schmidt, R. , Wertenschlag, L. , Wilms, Heinz; Lemcke, Ch: Moment mal 3. , Berlin, München, 1996.

Niebisch, D. , Hiemstra, S, P. , Bovermann, M. , Reimann, M. , Schritte international 1. , Ismaning, 2006.

Niebisch, D. , Hiemstra, S, P. , Bovermann, M. , Reimann, M. , Schritte international 3. , Ismaning, 2006.

Schulz, Dora; Griebach, Heinz: Grammatik der deutschen Sprache, Muenchen, 1996.

Wachtel, M. , Grammatik und vieles mehr. Linguistische Grundlagen und Lernziele für den Deutschunterricht der Sekundarstufen, Frankfurt am Main, 2004.

Willkop, E, M. , Wiemer, C. , Küppers, E, M. , Eggers, D. , Zöllner, I. , Auf neuen Wegen. Deutsch als Fremdsprache für die Mittelstufe und Oberstufe, Ismaning, 2003.

KONKORDANCA GJUHËSORE MIDIS RUMANISHTES DHE SHQIPES

Prof. dr. Nikolae Saramandu

Universiteti i Bukureshtit

Konkordancat gjuhësore në gjuhën rumune dhe në gjuhën shqipe janë studiuar prej shume kohësh, pothuajse dy shekuj e gjysmë, duke tërhequr, që nga fillimi, vëmendjen e shkencëtarëve evropianë. Kam parasysh veprën e gjuhëtarit gjerman Johann Thunman, e cila u botua në vitin 1774 në Lajpcig me titullin *Über die Sprache der Albaner und der Wlachen* [Rreth gjuhës së shqiptarëve dhe gjuhës së rumuneve].

Në vitin 1829 një tjetër studiues, nga Sllovenia, Bartolomeu Kopitar, botoi në Vjenë punimin *Albanische, walachische und bulgarische Sprache* [Gjuhët shqipe, rumune dhe bullgare], punim i cili përfaqeson në të njëjtën kohë edhe pikënisje për studimin e krahasuar të gjuhëve ballkanike. Siç e shohim, gjuha rumune dhe gjuha shqipe kanë qënë nga fillimi në vëmendjen e shkencëtarëve ballkanologë. Duke u bazuar në krahasimin e këtyre dy gjuhëve, u zhvillua *teoria e substratit/nënshtresës* përse i përket gjuhës rumune.

Rumanishtja, një gjuhë neolatine, ka një numër karakteristikash që nuk gjenden në gjuhët neolatine perëndimore dhe që shpjegohen nëpërmjet ndikimit e substratit/nënshtresës autoktone mbi latinishten. Identifikimi i këtij substrati trakodak të gjuhës rumune ishte i mundur nëpërmjet krahasimit me gjuhën shqipe, e cila vazhdon në mënyrë direkte gjuhën ilire, me të cilën gjuha trako-dake ishte e ngjashme.

Studimi i konkordancave gjuhësore midis rumanishtes dhe shqipes ka qënë, që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë, një preokupim i rëndësishëm i gjuhësisë rumune historike. Një kontribut vendimtar ka dhënë gjuhëtari rumun më i rëndësishëm të shekullit nëntëmbëdhjetë, një studiues enciklopedik, Bogdan Petriceicu Hasdeu. Ndër studimet e tij të shumta bëjnë pjesë *Perit-au dacii?* [U zhdukën dakët?] (1860), *Strat și substrat. Genealogia popoarelor balcanice* [Shtresë dhe nënshtresë. Gjenezologjia e popujve të Ballkanit] (1891-1892), *Cine sunt albanezii?* [Kush janë shqiptarët?] (1901). Në studimin e fundit Hasdeu deklaroi se "vetëm nëpërmjet një origjine të përbashkët dhe përmes bashkëpunimit të ngushtë në të njëjtën kohë mund të shpjegohet natyra organike e lidhjeve primordiale midis rumanishtes dhe shqipes" (*Cine sunt albanezii?*, [Kush janë shqiptarët?], 1901, citat nga B.P. Hasdeu, *Studime gjuhësore dhe filologjike* II, Bukuresht: Minerva, 1988, fq. 469). Sipas Hasdeut, kjo "natyrë organike primordiale [...] daton që nga fillimi i/lindja e botës/njerëzimit" (po aty, 470), domëthënë që nga origjina e këtyre dy gjuhëve. Bëhet fjalë për periudhën më të hershme në historinë e gjuhës rumune dhe të asaj shqipe.

Kjo periudhë fillon me hyrjen e latinishtes në Gadishullin Ballkanik. Nga gjuhët ballkanike, shqipja pati ndikimin më të madh nga latinishtja. Ky ndikim filloi në shekullin e II-të A.D. dhe ushtrua për më shumë se shtatë shekuj. Siç pohoi

Eqrem Çabeji, gjuhëtari i madh shqiptar, "latinishtja la gjurmë të thella në gjuhën shqipe" (Çabej 1997: 69). Në shqip, elementi latin është më i rëndësishëm se në greqishten e vjetër, edhe pse kontaktet që patën paraardhësit e shqiptarëve me gjuhën greke kishin qënë më të hershme sesa kontaktet me gjuhën latine. Në gjuhën shqipe ka dhjetra fjalë të lashta greke, ndërkohë që numri i termave latinë të ruajtur në gjuhën aktuale është mbi 600 (616, sipas Mihaeskit 1993: 68). Shqipja ka ruajtur më shumë fjale latine sesa greqishtja moderne, ku numri i tyre është rreth 200.

Një serë huazimesh latine në gjuhën shqipe kanë një fazë paraprirëse zhvillimi, krahas me atë të fjalëve me origjinë latine nga rumanishtja dhe nga gjuhë të tjera neolatine, fakt që nxjerr në pah vjtërsinë e ndikimit e latinishtes mbi shqipen. Do të japim vetëm një shembull nga fusha e bashkëtingëllorëve: qiellëzorja *c*, kur ndiqet nga zanorja e mëparshme (*e*, *i*), nuk ndryshon (në rumanisht ndryshon): lat. *cepa*, *civitatem*, *facies*, *socius* > shqip: *qepë*, *qytet*, *faje*, *shok*; në rumanisht *ceapă* (dialektor *țeapă*), *cetate* (dialektor *țitate*), *față*, *soț* [në rumanisht, lat. *c + e, i > țe, ți*] (> *țe, ți*). Kjo situatë gjendet edhe në greqisht, ku fjalët e huazuara nga latinishtja ruajnë qiellëzoren *c* gjithashtu: lat. *cellarium* > gr. *κελλαρὶ* 'bodrum' (në rumanisht *celar*, në dialekt *țilar*).

Latinishtja ka lënë "gjurmë të thella" edhe në fjalorin e gjuhës shqipe, në fusha shumë të rëndësishme dhe të ndryshme (Çabej 1997: 74-75):

- *pjesët e trupit përftile corpului*: *kokë* (< lat. *capus*), *mendje* (< lat. *mens*), *faje* (< lat. *facies*), *shëndet* (< lat. *sanitas*);
- *shtëpi*: *portë* (< lat. *porta*), *mur* (< lat. *murus*), *furrë* (< lat. *furnus*);
- *kafshë shtëpiake*: *qen* (< lat. *canis*), *lepur* (< lat. *lepus*), *pëllumb* (< lat. *palumbus*);
- *mjete pune*: *furkë* (< lat. *furca*), *qerre* (< lat. *carrus*);
- *fusha ushtarake*: *luftë* (< lat. *lucta*), *armë* (< lat. *arma*), *shpatë* (lat. < *spata*);
- *emra farefisnore*: *prind* (< *parens*), *kunat* (< lat. *cognatus*), *fëmijë* (< lat. *familia*), *krushk* (< lat. *consocer*), *kushëri* (< lat. *consobrinus*);
- *jeta shoqërore*: *mik* (< lat. *amicus*), *shok* (< lat. *socius*), *mbret* (< lat. *imperator*), *qytet* (< lat. *civitatem*);
- *njësitë e kohës*: *verë* (< lat. *aestas*), *pranverë* (< lat. *ver*), *janar* (< lat. *ianuarius*), *mars* (< lat. *martius*), *prill* (< lat. *aprilus*), *maj* (< lat. *maius*), *mërkurë* (< lat. *Mercurii dies*);
- *flora*: *pyll* (< lat. *padulem*), *pemë* (< lat. *pomum*);
- *jeta baritore*: *ftujë* (< lat. *vitulus*), *kullostër* (< lat. *colostra*).

Terminologjia më e vjetër kishtare në gjuhën shqipe është me origjinë latine dhe perdoret nga e gjithë popullsia, jo vetëm katolike: *kishë*, *prift*, *mëkat*, *pagëzoj*, *shpirt*.

Elementet latine ekzistuese në gjuhën shqipe gjenden në përgjithësi edhe në rumanisht dhe përfaqesojnë një nga dy "lidhjet thelbësore organike" midis këtyre dy gjuhëve. "Lidhja tjetër thelbësore organike" përfaqesohet nga elementet autoktone

të gjuhës rumune, substrati i/nënshtresa e gjuhës rumune. Në rumanisht ekzistojnë rreth 90 fjalë indigjene/autoktone të sigurta, plus rreth 40 fjalë të tjera indigjene/autoktone të mundshme (Brancus 1983: 28-151). Siç dihet, identifikimi i fjalëve autoktone, para-romake, në gjuhën rumune është bërë nëpërmjet krahasimit me gjuhën shqipe, ku pikërisht këto fjalë gjenden si elemente të trashëguara nga ilirishtja. Këto fjalë autoktone gjenden në të gjitha dialektet rumune (dakorumanisht, arumanisht, meglenorumanisht, istrorumanisht), në përmasa të pabarabarta. Rëndësia e fjalëve autoktone është dhënë nga fakti që ato mbulojnë fushat themelore të fjalorit, shumë prej tyre duke qënë pjesë e *fondit kryesor leksikor* të gjuhës rumune. Akademiku Grigore Brancush tregoi se, për shkak të pasurisë semantike dhe numrit të madh të fjalëve të formuara nga ato, fjalët që janë ruajtur në substratin autokton kanë të njëjtën rëndësi si fjalet e trashëguara nga latinishtja: "Për fjalorin rumun në tërësi, trashëgimitë e substratit kanë të njëjtën rëndësi si elementet latine. Kjo rezulton nga hulumtimi/kërkimet mbi tiparet semantike të këtyre fjalëve, sa shpesh shfaqen, nga fushat e përgjithshme të qarkullimit e tyre dhe nga kapaciteti i tyre për të formuar fjalë të reja." (Brancus 1983: 188).

Këto janë fushat kryesore ku termat autoktonë shfaqen:

- **njeriu** (pjesët e trupit, veshje, ushqime, vendbanimi): *moş* (shqip *moshë*), *ghiuj* (shqip *gjysh*), *buză* (shqip *buzë*), *ceață* (shqip *qafë*), *grumaz* (shqip *gurmaz*), *gușă* (shqip *gushë*), *brâu* (shqip *brez*), *căciulă* (shqip *kësulë*), *zară* (shqip *dhallë*), *gard* (shqip *gardh*), *vatră* (shqip *vatër*)
- **natyra**: *țap* (shqip *cjap*), *baligă* (shqip *bajgë*), *câlbează* (shqip *këlbazë*), *căpușă* (shqip *këpushë*), *țarc* (shqip *thark*)
- **folja** *bucura*, shih në shqip *bukur*

Konkordanca frazeologjike midis rumanishtes dhe shqipes

Janë të shumta dhe theksojnë edhe një herë lidhjen fillestare midis këtyre dy gjuhëve.

Do të prezantojmë këtu vetëm një shembull. Bëhet fjalë për ndërtime dhe shprehje ku shfaqet folja *ajunge* (në rumanisht) dhe *arrij* në shqip. Folja në rumanisht vjen nga folja latine *adjungere*, folje kalimtare që do të thotë 'bashkoj, lidh', por aktualisht përdoret si folje jokalistare, me kuptimin "arrij në destinacion". Për këtë kuptim ekzistojnë në gjuhët neolatine perëndimore fjale që kanë prejardhjen nga folja latine *arripare*: në frëngjisht *arriver*, në italisht *arrivare*, në spanisht *arribar*. Në lidhje me foljen *arrij* në shqip, Eqrem Çabej pohon se "mund të vijë nga një kombinim të foljes *arrivare* në italisht me një fjalë nga fondi i trashëguar" (Çabej 1976: 442). Supozimi i dijetarit shqiptar është i justifikuar për shkak se folja *arrij* përdoret në shqip jo vetëm si folje jokalistare (si *arrivare* në italisht), por edhe si folje kalimtare, fakt i pashpjegueshëm në qoftë se kufizohemi në një huazim nga italishtja. Zgjidhja etimologjike propozuar nga Eqrem Çabeji është e mbështetur edhe nga konkordancat midis foljes *ajunge* në rumanisht dhe foljes *arrij* në shqip, folje që përdoren në të dyja gjuhët si folje kalimtare dhe jokalistare.

Këtu janë disa shprehje dhe ndërtime në të cilat të dyja foljet, në shqip dhe në rumanisht, janë përdorur si *folje kalimtare*:

1° 'prek, kap (diçka)': në shqip *e arrij me dorë*, në rumanisht: *îl ajung cu mâna*;

2° 'barazoj (dikë në diçka)': në shqip *e arrij në mjeshtëri*, në rumanisht *îl ajung în meșteșug*;

3° 'ndodh, t'i ndodhë diçka dikujt': në shqip *ia arrita ditës*, në rumanisht *a-l ajunge pe cineva zilele*; përmendim edhe shprehjen në shqip *më arriti pleqëria*, në rumanisht *m-a ajuns bătrânețea*;

4° 'të kapësh nga mbrapa (dikë)': në shqip *I-am ajuns din urmă*; të njëjtin kuptim gjetëm edhe në *Dicționarul albanez-român* [Fjalorin shqip-rumanisht] *arrij* (pa shembuj);

5° 'realizoj': në shqip *arrij qëllimin*, në arumanisht *li-agiumsi tuti* 'i ka realizuar të gjitha' (të gjitha synimet)';

6° shprehja në rumanisht *a-l ajunge pe cineva mintea (capul)*, në shqip *aq të arrin ty mendia*.

Shprehje dhe ndërtime në të cilët të dyja foljet, në rumanisht dhe në shqip, përdoren si *folje jokalimtare*:

1° 'mjafton': në shqip *ky stof arrin për një fustan*, në rumanisht *stofa asta ajunge pentru o fustă*;

2° 'arrij (në destinacion)': në shqip *arrij me kohë*, në rumanisht *a ajunge la timp*;

3° 'arrij kulmin/maksimumin': në shqip *arrin deri në gju*, në rumanisht *a ajunge până la genunchiul broaștei*; në shqip *as në thembër s'i arrin*, në rumanisht *nu-i ajunge nici până la degetul cel mic*;

4° 'arrij (të bëj diçka)': në shqip *arriti të vjedhë*, në rumanisht *a ajuns să fure*;

5° 'Mbiemri me prejardhje nga forma e pjesores në rumanisht *ajuns*, në shqip *i (e) arrirë* përdoret me kuptimin 'i pjekur, i bërë': në shqip *rrush i arrirë*, në rumanisht *strugure copt*, në shqip *mollë e arrirë*; me kuptimin figurativ 'i pjekur': në shqip *djalë i arrirë* 'djalë i pjekur (përsa i përket moshës)', *vajzë e arrirë* 'vajzë e pjekur'; dhe në rumanisht *e copt la minte* [*Është i pjekur në mend*];

6° Në ndërtime që përdoren për moshën: në rumanisht *a ajuns la optzeci de ani*, në shqip *arriti të tetëdhjetat* 'ka mbushur tetëdhjetë vjet' (me foljen kalimtare).

Kujtojmë vërejtjen e Sekstil Pushkariut në lidhje me këto konkordanca: "ngjashmëritë midis gjuhës rumune nga Dakia rumune dhe gjuhës shqipe [...] shpjegohen si forma arkaike të ruajtur në zona anësore në kohët e lashta" (Pushkariu 1959: 325, cituar në Brancus 1999:9).

Më lejoni të përfundoj pjesën e parë të ekspozimit tim me citate nga veprat e dy gjuhëtarëve të njohur, Grigore Brancus dhe Eqrem Çabej, që sollën kontributet më të rëndësishme në studimin e konkordancave midis rumanishtes dhe shqipes: "Çdo hulumtim për një periudhë më të vjetër në historinë e gjuhës shqipe na çon domosdoshmërisht në raportimin me gjuhë të tjera ballkanike. Nga këto, vendin e

parë e zë pa dyshim gjuha rumune. Shqipja dhe rumanishtja kanë lidhje të ngushta në fushën e fonetikës, morfologjisë, fjalorit, fjalëformimit, sintaksës dhe frazeologjisë, të thënieve dhe fjalëve të urta sa që - pa lënë dallime të pashënuar - shpesh ke përshtypjen se ajo është pikërisht e njëjta frymë e gjuhës, e manifestuar në dy forma " (Çabej 1959: 531). "Synimi ynë ishte për të nxjerrë në dritë [...]« mrekullinë » e origjinës së përbashkët të të dyja gjuhëve dhe kështu afirmitetin shumë të vjetër shpirtëror midis popullit rumun dhe popullit shqiptar."

Do të paraqes, në pjesën e dytë të ekspozimit tim, disa konsiderata rreth *bashkësisë së gjuhëve ballkanike*: rreth gjuhësisë ballkanike dhe studimit krahasues të gjuhëve ballkanike, i cili është objekti i gjuhësisë ballkanike.

Termi *lidhje gjuhësore* (në gjermanisht *Sprachbund*) u përdor për herë të parë nga gjuhëtari N.S. Trubetzkoy në vitin 1928 në Kongresin e parë Ndërkombëtar të Gjuhësisë në Hagë, dhe më vonë është përkthyer, apo të adoptuar nga gjuhë të tjera: në frëngjisht *union linguistique*, në rusisht *jazykovoj sojuz*, në italisht *unione linguistica*, në spanisht *alianza de lenguas*, në anglisht *language union* etj. Për të përcaktuar të njëjtin koncept gjuhësor, më parë përdorehin një serë termash të përafërt, por që nuk u imponuan: në gjermanisht *geschichtliche Verwandtschaft* "farefisnie historike" (H. Schuchardt), në italisht *parentela acquistata* "farefisnie e fituar", *affinità culturale* "afinitet kulturor" (G. I. Ascoli). Sandfeld përdorte *lidhje gjuhësore* ("unité linguistique des Balkans" Sandfeld 1930: 6, 214). V. Pisani preferonte termin *unitet gjuhësor* (në italisht *lega linguistica*, që përdoret edhe nga E. Banfi) dhe tek U. Weinreich shfaqet termi i *zonës së konvergjençës* (në anglisht *convergence area*). *Spracheinheit* (Jokl, në Nandriç 1952/1956: 448) [Kongresi VII].

Duke diskutuar te Kongresi i sipërmendur për "vendosjen dhe përcaktimin e termave teknikë", N.S. Trubetzkoy bënte propozimin nr. 16, sipas të cilit dallonte brenda grupeve të gjuhëve (të përcaktuar si "grup i gjuhëve të lidhura nëpërmjet një numër të konsiderueshëm konkordancash sistematike" [cit. ngjashmëri]), *lidhjet gjuhësore* (në gjermanisht *Sprachbünde*) nga *familjet e gjuhëve* (në gjermanisht *Sprachfamilien*).

"Breda në grupet gjuhësore duhet të dallojmë dy kategori:

Grupe që përbëhen nga gjuhë të cilat paraqesin një ngjashmëri të madhe nga pikëpamja sintaksore, nga pikëpamja strukturës morfologjike, një numur të madh termash kulturorë të përbashkët dhe një ngjashmëri të jashtme në ndërtimin e sistemeve fonetike, por që nuk paraqesin **korespondenca** fonetike sistematike, asnjë llojë konkordance në shprehjen fonetike të elementeve morfologjike dhe nuk kanë të përbashkët termat elementarë- *këto grupe i quajmë lidhje gjuhësore*.

Grupet që përfshijnë gjuhë të cilat kanë një numër të konsiderueshëm termash elementarë, të cilat paraqesin konkordanca në shprehjen fonetike të kategorive morfologjike dhe, sidomos, konkordanca fonetike konstante – *këto grupe i quajmë familje gjuhësh* (Trubetzkoy 1928: 18)."

Për t'i ilustruar të dy termat, Trubetzkoy jep si shembull bullgarishten, e cila, "nga njëra anë, i përket familjes së gjuhëve sllave (së bashku me serbokroatishten, polonishten, rusishten, etj.) dhe, nga ana tjetër, lidhjes gjuhësore

ballkanike (së bashku me greqishten moderne, me gjuhën shqipe dhe atë rumune” (*ibidem*).

Rezulton se lidhja gjuhësore karakterizohet nga tipare pozitive, domëthënë për shkak të **konkordancave** midis gjuhëve që e përbëjnë dhe nga tipare negative, për shkak të mungesës së **korrespondencave** midis atyre gjuhëve. Prania e konkordancave konstatohet:

- a) në rrafshin sintaksor;
- b) në parimet e strukturës morfologjike;
- c) në ndërtimin e sistemeve fonetike;
- d) ku shtohet një numër i madh termash kulturorë të përbashkët.

Konstatohet *mungesa e korrespondencave*, sepse ato karakterizojnë familjet e gjuhëve.

Lidhjet gjuhësore nuk paraqesin:

Familjet e gjuhëve paraqesin:

a) korrespondenca fonetike sistematike;
b) asnjë konkordancë [cit. korrespondencë] në shprehjen fonetike të elementeve morfologjike.

a) korrespondenca fonetike konstante;
b) konkordanca [cit. korrespondenca] në shprehjen fonetike të kategorive [cit. elementëve] morfologjike.

Konstatohet, gjithashtu:

– mungesa e termave elementarë të përbashkët.

– prania e një numri të konsiderueshëm termash elementarë të përbashkët.

Nëse familjet e gjuhëve janë rezultat i evolucionit divergjent, i mungesës së kontaktit gjuhësor dhe ndoshta të izolimit gjeografik, lidhjet gjuhësore shfaqen, në të kundërtën, pas një evolucionit konvergjent të gjuhës, bazuar në afërsinë gjeografike dhe kontakte të drejtpërdrejta ndërmjet folësve. "Kontakti lind imitimin dhe imitimi lind *konvergjencën gjuhësore*. *Divergjenca gjuhësore* rezulton nga tjetërsimi, nga ndarja gjuhësore apo nga humbja e kontaktit" (Martinet 1963: VIII). Pranohet në ditët e sotme që edhe familjet e gjuhëve mund të rezultojnë nga evolucionit konvergjent të gjuhëve të ndryshme përsa i përket origjinës (p.sh. familja e gjuhëve indo-evropiane, sipas N. S. Trubetzkoy). Gjithashtu, afërsia gjeografike dhe kontakti i drejtpërdrejtë mes folësve nuk shkaktojnë domosdoshmërisht një evolucion konvergjent i cili të çojë në shfaqjen e lidhjes gjuhësore.

Lidhja gjuhësore është një rast i veçantë i evolucionit konvergjent të gjuhëve në kontakt (në anglisht *Languages in contact*, U. Weinreich). Sipas formulimit të U. Weinreich, "dy ose më shumë gjuhë janë konsideruar të jenë NË KONTAKT nëse ato janë përdorur në mënyrë alternative nga të njëjtët njerëz; njerëzit të cilët përdorin gjuhën në fjalë janë/përfaqesojnë vendi i kontaktit" (Weinreich 1963: 1). Praktika e përdorimit alternativ të dy (ose më shumë) gjuhëve quhet *dygjuhësi/bilinguizëm*

(ose *shumëgjuhësi/plurilinguizëm*); këto persona janë *dygjuhësh* (ose *shumëgjuhësh*). Si pasojë e kontaktit gjuhësor, shfaqet fenomeni i *interferencës*.

Interferenca përfshin/nënkupton riorganizimin e sistemit në të gjitha rrafshet (fonetik, morfologjik, sintaksor, leksikor). "Një element mund të kalojë nga një sistem në tjetrin vetëm me kusht që të riinterpretohet brenda sistemit që e merr/pranon. Sepse çdo pasurim apo varfërim i një sistemi domosdoshmërisht përfshin një riorganizim të të gjitha karakteristikave të mëparshme dalluese. Të pranosh mundësinë se një element thjesht i shtohet sistemit që e merr, pa lënë asnjë gjurmë në këtë sistem, do të thotë të shkatërrosh konceptin e vetë sistemit" (Vogt 1949: 35).

Lidhur me ndikimet gjuhësore të ushtruar nga gjuhët të cilat gjenden në kontakt, duhet të përkufizojmë termat *substrat*, *superstrat* dhe *adstrat* (të formuara nga fjala "strat", e cila nënkupton gjuha së cilës i referohemi).

Substrati është gjuha e cila, në kontakt me një gjuhë tjetër, zhduket, duke lënë disa gjurmë në gjuhën fituese. Në përgjithësi, flitet për substratin në procesin e formimit të një gjuhe të re, kur lind një gjuhë e re, si rezultat i përzjerjes së popullsisë, të bashkëjetesës afat-gjatë të dy (ose më shumë) bashkësive që flasin gjuhë të ndryshme. Nga popullsitë që vijnë në kontakt, njëra është vendase dhe tjetra vendoset në territorin që bëhet i përbashkët nëpërmjet pushtimit, migrimit ose kolonizimit. Ajo që zhduket është gjuha e popullsisë vendase/autoktone. Kështu, pas kontaktit midis latinishtes, gjuhës së pushtuesve romakë, dhe gjuhës trako-dake të popullsisë autoktone të Dakisë, kjo e fundit u zhduk, duke lënë "gjurmë" në gjuhën fituese, latinishten, e cila më vonë u kthye në gjuhën rumune. Frëngjishtja, pasardhësia e latinishtes e folur nga pushtuesit romakë të Galisë, u formua mbi substratin kelt.

Pas kontaktit midis gjuhës së pushtuesve dhe gjuhës së popullsisë autoktone të pushtuar mund të ndodhë edhe fenomeni i kundërt, pikërisht gjuha autoktone të mposhtë gjuhën e pushtuesve. Në gjuhën autoktone (të popullsisë vendase) transmetohen një seri elementesh nga gjuha e pushtuesve, elemente të cilët i quajmë *superstrat*, pa formimin e një gjuhe të re. Për shembull, mbi bullgarishten, një gjuhë sllave, u ushtrua, në një moment të caktuar, ndikimi i gjuhës së protobullgarëve (popullsi pushtuese me origjinë turke, e asimiluar nga popullsia sllave vendase), ndikim të cilin e quajmë *superstratin* e gjuhës bullgare. Një rast identik ishte gjuha e frankëve nga Franca (popullsi gjermanisht folse e asimiluar nga popullsia vendase e romanizuar), e cila përfaqeson *superstratin* e gjuhës frënge. Në rastin e rumanishtes, *superstrati* përfaqësohet nga elementet që kanë hyrë nga gjuha e popullsisë sllave, e asimiluar nga popullsia rumune.

Adstrati është një ndikim gjuhësor, por asnjëra nga gjuhët në kontakt nuk zhduket. Një ndikim i tillë është, për shembull, ndikimi i gjuhës greke ushtruar mbi gjuhët e Ballkanit, nëpërmjet të cilit shpjegohet përgjithësisht dobësimin, ndonjëherë deri në zhdukje, e paskajores në këto gjuhë. Nëpërmjet një fare ndikimi të rumanishtes mbi bullgarishten shpjegohet tranzicioni nga fleksioni sintetik (specifike për gjuhët sllave) në fleksionin analitik në këtë gjuhë.

Çështje të tjera që diskutohen lidhen me përcaktimin e zgjerimit në hapësirë (e përhapjes) të konkordancave (të izoglosave), me përcaktimin e "intensitetit" me të cilin konkordancat shfaqen në zona të caktuara, etj. Flitet, në këtë drejtim, përse i përket lidhjes gjuhësore, për "qendrën", - ku konkordancat kanë një intensitet më të madh dhe paraqesin një "dendësi" të lartë – dhe për "periferinë", ku "intensiteti" ose "dendësia" e konkordancave është më i/e ulët. Gjuhët që përbëjnë një lidhje gjuhësore përmbajnë konkordanca në përqindje të ndryshme, ato që përmbajnë më shumë konkordanca përfaqësojnë bërthamat e lidhjes.

Edhe pse ka një komponent gjeografik – afërsinë në hapësirën e gjuhëve - lidhja gjuhësore nuk është një koncept gjeografik, por një koncept gjuhësor. Në rastin e lidhjes gjuhësore ballkanike, rumanishtja tejkalon, nëpërmjet njëri prej dialekteve të saj, pikërisht dakorumanishtes, hapësirën gjeografike të Gadishullit Ballkanik, i cili kufizohet në veri nga Danubi; në të kundërt, gjuhë që fliten në Gadishullin Ballkanik, për shembull gjuha turke dhe gjuha indeospaniole etj. nuk bëjnë pjesë të lidhjes gjuhësore ballkanike. Prandaj, bëhet dallimi midis "gjuhëve ballkanike" (te cilat marrin pjesë në konkordancat që karakterizojnë lidhjen gjuhësore ballkanike) dhe "gjuhët (e folur) në Ballkan" (të cilat nuk marrin pjesë në këto korrespondenca).

Gjatë gjithë historisë së disiplinës që ne e quajmë gjuhësi ballkanike, ditëtarët kanë pasur pozicione të ndryshme në lidhje me gjuhët që duhet të merren parasysh në studimin e konkordancave gjuhësore ballkanike. B. Kopitar (1780-1884), një nga ballkanologët e parë, botoi në vitin 1829 studimin *Albanische, walachische und bulgarische Sprache* ("Jahrbücher, der Literatur", XLVI, Vienë, 1829, fq. 59-106), nga i cili rezulton se gjuha greke nuk ishte nën hetim. Gjithashtu, G. Weigand (1860-1930) u jepte prioritet shqipes, bullgarishtes dhe rumanishtes: "Wir sehen zwischen Albanisch, Rumänisch und Bulgarisch eine Reihe gemeinschaftlicher Züge, die diesen drei Sprachen einen besonderen Character aufdrücken, den ich den balkanischen nenne, weshalb ich, wenn ich von Balkansprachen rede, in erster Linie diese drei Sprachen meine" ("Balkan-Archiv", I, Leipzig, 1925, fq. VIII), duke konsideruar gjuhën greke, gjuhën serbe dhe gjuhën turke si gjuhë ballkanike nga pikëpamja gjeografike. Vl. Georgiev, më afër me ditët e sotme, mbron te njëjtën ide: "Le centre, le noyau des courants convergents était formé par l'albanais, le roumain et le bulgare; le grec, le serbo-croate et le turc restaient à la périphérie"(GEORGIEV 1968: 9). Gjuhëtarë të tjerë, si A. Schleicher (1821-1868), Fr. Miklosich (1813-1891), Kr. Sandfeld, Al. Rosetti, morën parasysh edhe gjuhën greke në studimin krahasues të gjuhëve ballkanike. Siç dihet, Sandfeld i kushtoi gjuhës greke një rol vendimtar në shfaqjen e konkordancave midis gjuhëve ballkanike. Në këtë aspekt, në përgjithësi, bëhet dallimi midis "gjuhëve ballkanike" (në gjermanisht *Balkansprachen*) të cilat paraqesin karakteristika të përbashkëta dhe "gjuhët e Ballkanit (ose gjuhët e folur në Ballkan)" (në gjermanisht *Sprachen des Balkans*) (shih SCHALLER 1975 : 30 , 37); vetëm gjuhët ballkanike përfqesojnë objektin e gjuhësisë ballkanike. Konsiderohen si " gjuhë ballkanike" *shqipja , bullgarishtja, maqedonishtja* (gjuha sllave maqedonase), *rumanishtja, greqishtja* dhe *serbokroatishtja*, ndërsa *turqishtja* – gjuhë që nuk merr pjesë në konkordancat

gjuhësore ballkanike, por që ka ushtruar një farë ndikimi në gjuhët ballkanike - është njëra nga gjuhët "e folur në Ballkan". Ndër gjuhët e Ballkanit bëjnë pjesë nga pikëpamja gjeografike edhe *dalmatishtja* (sot një gjuhë e zhdukur) dhe *sllovenishtja*. " Gjuhë të Ballkanit " janë edhe gjuha iudeospaniole, gjuha e tatarëve, gjuha rome etj, gjuhë të cilat fliten në Gadishullin Ballkanik, por pa marrë pjesë në konkordancat gjuhësore ballkanike. Një tjetër kufizim i gjuhëve ballkanike (shih më lart) lidhet me faktin se disa prej tyre janë konsideruar 'qëndrore', domethënë përbëjnë "bërthamën" ose *zonën qendrore* - shqipja , bullgarishtja, maqedonishtja, rumanishtja - për shkak të faktit se tek ato gjenden karakteristikat/tiparet e përbashkëta më të shumëta dhe më të rëndësishme, ndersa të tjerat janë konsideruar "periferike ", duke përfaqësuar *zonën periferike*, si për shembull serbokroatishtja. Lidhur me gjuhën greke, shumica e gjuhëtarëve konsiderojnë se hyn në kategorinë e parë (SANDFELD 1930: 3, TRUBETZKOY 1930: 17-18, SOLTA 1980: 7, FEUILLET 1986: 29, ASENOVA 1989: 12, DEMIRAJ 1994: 18-22), ndersa të tjerë, në të dytën, me serbokroatishten SCHALLER (1975 : 37) . Duke rikujtuar dallimin që bën H.W. Schaller midis " gjuhëve ballkanike " dhe "gjuhëve të Ballkanit ", E. Banfi përfshin në kategorinë e parë të gjitha gjuhët të sipërmendura (bullgarishten, rumanishten, shqipen, maqedonishten, serbokroatishten, greqishten moderne); "gjuhët e Ballkanit" konsiderohen sllovenishtja , turqishtja dhe hungarishtja, duke përmendur dhe gjuhë të tjera: spanjishten, italishten, dalmatishten, armenishten, gjuhët rome (shih BANFI 1985: 3-4) . Vështirësia e dallimit e "bërthamës " apo të zonës qendrore nga " periferia" haset në grupin e gjuhëve ballkanike konsideruar individualisht, si një e tërë, si për shembull në nivelin e gjuhëve letrare. Nëse u referohemi dialekteve, gjërat bëhen të qarta edhe në lidhje me greqishten dhe me serbokroatishten. Në rastin e këtyre gjuhëve, bëjnë pjesë të bërthamës dialektet greke të veriut (nga Maqedonia dhe Epiri) dhe dialektet serbe të lindjes (*torlace*), nga kufiri me Bullgarinë.

„Bei der Betrachtung der Dialekte verschiebt sich das Bild ein wenig, indem sowohl die nordgriech. Dialekte (Epirus und Mazedonien) wie die ostserbischen (torlakischen) Dialekte zur Kernzone gerechnet werden können” (SOLTA 1980: 7); shih edhe ASENOVA 1977: 29.

Nga pikëpamja gjeografike, "qendra" u përfaqësua deri kohët e fundit, sipas disa ballkanologëve, nga Ballkani Jug- Perëndimor - Shqipëria e Jugut, Epiri, Maqedonia perëndimore - një zonë ku shfaqet jo vetëm dygjuhësia, por edhe shumëgjuhësia, duke marrë parasysh faktin se këtu kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejtë shqiptarë, sllavë, grekë, arumunë, turq. Shih ASENOVA 1977: 29, SOLTA 1980:7-8.

Në zonën e Ballkanit, dygjuhësia, e cila është aktive, manifestohet në nivel dialektor përmes kontaktit të drejtpërdrejtë midis folësve të gjuhëve të ndryshme. Prandaj, studimi i interferencave në nivelin e dialektëve është një nga fushat kryesore të kërkimit në gjuhësinë ballkanike. "Eine der wichtigsten Grundlagen für die Balkanlinguistik ist und bleibt die Erforschung vor allem der Dialekte” (STEINKE 1977: 39).

Duke pasur të gjitha origjine indo-evropiane, gjuhët ballkanike u përkasin familjeve të ndryshme: *rumanishja* është pjesë e familjes së gjuhëve neolatine; *bullgarishtja*, *maqedonishtja* (sllavishtja maqedonase), *serbokroatishtja* u përkasin familjes së gjuhëve sllave; *greqishtja* dhe *shqipja* janë përfaqësuese unike të familjeve të tyre. Ndryshe nga gjuhësia neolatine ose gjuhësia sllave, objekti i studimit i të cilave përfaqësohet nga gjuhë që i përkasin një familje, gjuhësia ballkanike mbulon studimin e disa gjuhëve që u përkasin disa familjeve.

Ekzistojnë gjuhëtarë të cilët nuk pranojnë ekzistencën e gjuhësisë ballkanike si një disiplinë autonome. Ky qëndrim rrjedh nga absolutizimi i kriterit e lidhjes/farefnisës gjenetike si bazë për krahasimin gjuhësor dhe nga konceptimi i njëanëshm të funksionit të metodës krahasuese. Farefnisia gjuhësore është dy lloje: *gjenetike* dhe *tipologjike*. Në bazë të farefnisës gjenetike, gjuhët grupohen në *familje gjuhësore*, në bazë të farefnisës tipologjike ato grupohen në *degë gjuhësore* (në rumanisht *tipuri lingvistice*) (shih HJEMSLEV 1963: 14). Në rastin e gjuhëve ballkanike, duke marrë parasysh se nuk kemi të bëjmë me një marrëdhënie të drejtpërdrejtë gjenetike, duhet të flasim në termat e një farefnisie tipologjike dhe të kërkojmë të zbulojmë një tipar gjuhësor ballkanik.

Justifikimi i gjuhësisë ballkanike si një disiplinë autonome është dhënë nga fakti se gjuhët ballkanike kanë një numër karakteristikash të përbashkëta, të cilat i dallojnë ato nga gjuhët fqinje dhe të ngjashme (me të njëjtën origjinë). Zbulimi i ngjashmërive synon të ndriçojë disa aspekte të strukturës të gjuhëve ballkanike që nuk mund të shpjegohen nga studime që kufizohen vetëm nga marrëdhëniet gjenetike brenda familjeve gjuhësore. Për shembull, rumanishtja dhe bullgarishtja paraqesin disa karakteristika të cilat nuk i gjejmë në gjuhë të tjera neolatine, apo sllave, por që i gjejmë në gjuhë të tjera ballkanike (në greqisht, në shqip) dhe shpjegimin e tyre duhet ta kërkojmë në fushën e gjuhëve ballkanike. Me këtë qëllim, gjuhësia ballkanike është një disiplinë jo vetëm *përshkruese*, por edhe *shpjeguese*: përshkrimi shoqërohet nga shpjegimi.

Termi *gjuhësi ballkanike* u përdor për herë të parë nga gjuhëtari danez Kristian Sandfeld në titullin e librit e tij, *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats* (Paris, 1930), i cili ishte përkthimi në frëngjisht, në një version të përmirësuar dhe të zmadhuar të punimit e tij në gjuhën daneze *Balkanfilologien* (Kopenhagë, 1926). Termi *filologji ballkanike* ka filluar të qarkullojë që nga fillimi i shekullit e kaluar në mjedisin gjuhësor gjerman, duke qënë akoma i përdorur në vitin 1975 nga H. W. Schaller në nëntitullin e librit e tij *Die Balkansprachen. Eine Einführung in die Balkanphilologie* (Heidelberg, 1975).

Konkordanca midis rumanishtes dhe shqipes në kuandër të *lidhjes gjuhësore ballkanike*:

Në *fonetikë*: zanorja e timbrit [ə] (në rumanisht *ă*, në shqip *ë*, në bullgarisht *ъ*) në rumanisht, shqip dhe bullgarisht.

Në *morfologji*:

a) *nyja shquese* në rumanisht, shqip dhe bullgarisht:

rum.: *munte* 'mal' – *muntele* shqip: *gur* – *guri* bullgarisht: *kon* 'kalë' – *konjat*

<i>trup</i> 'trup' – <i>trupul</i>	<i>mik</i> – <i>miku</i>	<i>trup</i> 'trup' – <i>trupët</i>
<i>fată</i> 'vajzë' – <i>fata</i>	<i>vajzë</i> – <i>vajza</i>	<i>voda</i> 'ujë' – <i>vodata</i>

Rumanishtja dhe shqipja kanë nyjen e mbiemrit (në rumanisht *articol demonstrativ /adjectival*): në rum. *bărbatul cel bun* – në shqip *njeriu i mirë*.

b) ndërtimi i numërorëve nga 11 deri në 19 sipas modelit *unus super decem* [= një mbi dhjetë] në rumanisht, në shqip dhe në gjuhët sllave jugore:

rumanisht: *unsprezece, doisprezece, treisprezece* etj.

shqip: *njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë* etj.

bullgarisht: *edinadeset, dvanadeset, trinadeset* etj.

b) ndërtimi i kohës së ardhme me fjalën ndihmëse *dua* në shqip (në dialektin tosk), në rumanisht (*a voi*), në greqisht dhe gjuhët sllave jugore:

shqip: *do (të) shkruaj*;

rumanisht: *o să scriu* (në dialekt *va să scriu*);

greqisht: *θα (vá) γράφω*;

bullgarisht: *šte (da) piša*.

Ndërtime foljore të përbërë në gjuhët ballkanike. Krahassimi i arumanishtes me gjuhët ballkanike evidenton faktin se disa prej këtyre gjuhëve, si greqishtja moderne dhe shqipja dhe në një masë më të vogël, bullgarishtja dhe sllavishtja maqedonase, veprojnë në mënyrë të ngjashme për të ndërtuar format foljore të përbëra. Në greqishten moderne dhe në shqip përdoren të njëjtat elemente parafoljore për ndërtimin e formave foljore të përbëra: folja ndihmëse *kam* në kohën e tashme, mënyrën dëftore: në greqishten moderne *έχω*, në shqip *kam*, ose në kohën e pakryer: në greqishten moderne *είχα*, në gjuhën shqipë *kisha*; në mënyrën lidhore, kohën e tashme: në greqishten moderne *va έχω*, në shqip *të kem*, ose në kohën e pakryer: në greqishten moderne *[va]είχα*, në shqip *të kisha*; folja ndihmëse *voi* (në greqishten moderne *θέλω*, në shqip *dua*) e përdorur pa ndryshime: në greqishten moderne *θα*, forma e pandryshueshme omonime të mënyrës dëftore, koha e tashme dhe koha e pakryer, veta e tretë, nr. njëjës, në shqip *do*, forma e pandryshueshme omonime të mënyrës dëftore, koha e tashme dhe koha e pakryer, veta e tretë, nr. njëjës; fjala lidhëse *s-*: në greqishten moderne *va*, në shqip *të*. Si komponent foljor greqishtja moderne përdor forma të mënyrës dëftore: koha e tashme (*χάνω* „humb”), koha e pakryer (*έχανα*), aorist/koha e kryer (*έχασα*), ose pjesorja (*χάσει*). Shqipja përdor format e mënyrës dëftore: koha e tashme (*afroj*), koha e pakryer (*afroja*) ose pjesorja (*afruar*). Rregullat e kombinimit evidentohen në ndërtimet foljore të përbërë të cilët greqishtja moderne dhe shqipja i realizojnë. Ne do t'i ndjekim sipas tipareve të strukturave që i realizon arumanishtja.

	<i>arumanisht</i>	<i>greqishtja moderne</i>	<i>shqip</i>
1.	s-cântu	να χάνω 'a pierde'	të afroj
	s-cântam	να έχανα	të afroja
	s-cântai		
2.	va s-cântu	θα [να] χάνω	do të afroj
	va s-cântai	θα [να] έχανα	
3.	vrea (va) s-cântu	θα [να] χάνω	
	vrea (va) s-cântam	θα [να] έχανα	do të afroja
4.	am cântată	έχω χάσει	kam afruar
5.	aveam cântată	είχα χάσει	kisha afruar
6.	s-am cântată	να έχω χάσει	të kem afruar
7.	s-aveam cântată		të kisha afruar
8.	vas-am cântată	θα [να] έχω χάσει	do të kem afruar
9.	vrea (va)s-aveam cântată	θα [να] είχα χάσει	do të kisha afruar

Tetë nga nëntë llojet e strukturave foljore të arumanishtes gjenden në greqishten moderne; në shqip gjenden të gjitha nëntë. Në greqishten moderne llojet e strukturave foljore kanë më shumë forma sesa në gjuhën shqipe: 11 për 8 lloje, krahasuar me 10 për 9 lloje. Specifike për arumanishen është forma foljore e përbërë *s-cântai*.

Më lejoni të mbaroj ekspozimin tim me një citat nga një studim i cili i referohet arumanishtes, të dijetarit shqiptar Eqrem Çabej, studim i botuar në Rumani, në revistën „Studime dhe hulumtime gjuhësore”, XXVII, 1976, nr. 1, në gjermanisht, me titullin *Zur aromunischen Wortforschung* [Mbi kërkimin në fushën e fjalorit e arumanishtes]: „Pozicioni qendror, nga pikëpamja gjeografike, që ka arumanishtja në Gadishullin Ballkanik ka bërë që kjo degë e gjuhës rumune, si pasoje të kontakteve shekullore të arumunëve me pupujt fqinjë, të ketë lidhje të shumëfishta me gjuhët e këtyre popujve.” (Çabej 1976: 3).

RRETH LIGJËRIMIT TË SHKRUAR KULINAR NË SHQIP

Pavlo Cicko, Robert Stratoberdha, Fabiola Kadi
Universiteti "Fan S. Noli", Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Përmbledhje

Artikulli studion ligjërimin e shkruar të recetave të gatimit në shqip duke synuar të nxjerrë në pah karakteristikat formale dhe ato që lidhen me përmbajtjen e tyre. Natyrisht këto të dhëna paraqesin tipare të përbashkëta por edhe veçori që shprehen nëpërmjet tipareve leksikore, morfologjike dhe sintaksore, të cilat ndikojnë më tej në kuptimin dhe marrjen e mesazhit nga lexuesi. Karakteristikat e këtij ligjërimi synojnë të realizojnë synimet e tij pragmatike. Studimi i tij do të bëhet duke trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse këtë lloj shprehje të gjuhës së shkruar.

Metodologjia e punimit ka të bëjë me zgjedhjen e një korpusi përfaqësues të recetave të gatimit, nga libri "Si të gatujmë" i E. Harizit dhe faqe interneti për gatimin, krahasimin e karakteristikave të tyre nga pikëpamja gjuhësore dhe nxjerrjen në pah të anëve të përbashkëta dhe dallimeve.

Tek ligjërimi i recetave të gatimit dallohet një shprehje që prodhuesi i mesazhit ja drejton marrësit, i cili mund të jetë amvisë, apo çdo njeri i interesuar për të. Qëllimi i tij është që ta ndihmojë këtë të fundit për të arritur një rezultat më të mirë në gatimin e një recete të caktuar dhe më tej në përmirësimin e aftësive të tij në këtë fushë të lakmuar nga shumë amatorë të kulinarisë...

Një nga shenjat më të dukshme të këtij qëllimi është përdorimi i foljeve në urdhërore por edhe në infinitiv si edhe i foljeve modale *mund* e *duhet*, gjë që shpreh synimin se këshillat dhe udhëzimet duhet të ndiqen dhe të respektohen nga marrësi i mesazhit, në rastin tonë lexuesi.

Fjalët çelës: Ligjërimi i recetave të kuzhinës, tipare morfologjike e sintaksore, forca e mesazhit.

Abstract:

This research paper deals with the study of written interpretation of the cooking recipes in Albanian language aiming at putting forward the formal characteristics and those which have to do with their contents. This data shows common features but also peculiarities that are expressed through lexical, morphological and synthetically features which influence on the meaning and getting of the message from the reader. The characteristics of this sort of speech aim at realizing its programmatic goals. Its study will be carried out treating widely this sort of expression of the written language.

The methodology of the research has to do with the selection of a number of cooking recipes, picked up from the book "How to cook" prepared by E. Harizi and a web page dealing with cooking, comparison of their characteristics from the linguistic point of view and pinpointing the common and different elements.

The reading of the cooking recipes distinguishes the message that the producer wants to send to the receiver, who may be the housewife or the any other interested in it. Its goal is to help them in order to reach the best result in the preparation of certain recipe and further more in the improvement of his capability in the culinary art...

One of the most obvious reasons is the use of the verbs in indicative mode and sometime in the infinitive and especially the use of the modal verbs *can*, *may* and *must*. This shows the goal that the instructions must be followed by the receiver of the message which is the reader.

Keywords: Interpretation of cooking recipes, the morphological and synthetical features, the power of the message.

Hyrje

Cili është vendi i ligjërimit të shkruar të kuzhinës?

Krahas formave të tjera të ligjërimit edhe kjo formë e gjuhës së shkruar ka rëndësinë e vet në gjuhën shqipe. Ajo mund të renditet krahas ligjërimeve që lidhen me fusha të tjera të ngjashme siç janë ligjërimi i këshillave mjekësore apo ai që lidhet me konsumin e ilaçeve, ai i udhëzimeve për përdorimin e pajseje elektronike shtëpiake etj.

Rëndësia që i jepet sot të ushqyerit si pjesë e rëndësishme e jetës së përditshme lidhet ngushtë me shëndetin e njeriut por pse jo edhe me kënaqësitë që na sjell të ushqyerit si një aspekt i rëndësishëm i jetës, nuk mund të konsiderohen të ndara nga dëshira dhe përpjekjet e të gjithë të interesuarve dhe amatorëve të gatimit për të realizuar receta sa më të shijshme dhe të shëndetshme dhe për të jetuar sa më mirë dhe me shëndet. Në këtë kontekst edhe letërsia e kulinarisë mund të konceptohet si një lloj ligjërimi me anë të të cilit prodhuesi i një mesazhi(kuzhinieri autor) i drejton bashkëbiseduesit lexues një shprehje që është receta. (Mainguenu. D)

I. Karakteristika të përgjithshme.

Le të shohim së pari, disa karakteristika gjuhësoretë përbashkëta të recetave të kuzhinës. Këto karaktersitika përsëriten rëndom në pothuajse të gjitha recetat duke qenë tipare të rëndësishme të ligjërimit që po analizojmë. Ato lidhen në mënyrë të qenësishme me aspektin pragmatik të ligjërimit të recetave të gatimit.

1. Elementet e përgjithshme të organizimit pragmatik të ligjërimit nuk ndryshojnë nga një recetë tek tjetra. Recetat dallohen për natyrën e tyre urdhëruese ose të këshillimit dhe përpjekjen për ndikim psikologjik tek marrësi i mesazhit, amvisa ose ai që gatuan. Me shpjegimet e hollësishme dhe qartësinë e mesazhit receta synon të ngjallë besimin se marrësi i mesazhit do të arrijë të realizojë cilësinë e kërkuar të gatimit. Kjo vërehet nga përdorimi i një leksiku të veçantë si folja *duhet*, (*dihet të mbulohet me kapak, duhet të kihet parasysh koha e zjerjes së tyre*, fq 80,) përdorimi i foljeve në lidhore që shprehin dëshirën për realizimin sa më cilësor dhe të shijshëm të recetës. (*copa ngjitet me gishta që të mos hapet, peta paloset përgjysmë në mënyrë*

që të krijohet gjysmëhënëzë..., gjatë ngrënies secila kokërr mund të njomet me të..., petkat mund të bëhen dhe me salcë domatesh..., makaronat mund të mbushen edhe me spinaq të zierë...)

1. 1. Përsa i përket mënyrës së foljeve të përdorura dallojmë se në recetat që jepen në internet përdoret më tepër urdhërorja ose veta e parë shumës e dëftores, psh tekreceta *Supë me selinor. Qërojini, pritini, merreni selinon, përzini, shtoni koprën* etj.

2. Një element tjetër që tregon se recetat nuk ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra është fakti se ka një skemë të përgjithshme e cila shpaloset në disa etapa që janë: **përgatitja, realizimi dhe përbërësit**. Etapat e recetës ndjekin në mënyrë kronologjike njëra-tjetrën. Dallojmë fazën përgatitore dhe atë kryesore të realizimit të veprimeve të gatimit.

2. 1. Në fazën përgatitore përshkruhen shkurt veprimet që i paraprijnë fazës kryesore të gatimit si larja, prerja dhe rregullimi paraprak me kripë e erëza. Kjo fazë ose jepet në recetë ose tejkalohet pjesërisht duke treguar veprimet e mëtejshme që duhen kryer. Kjo shprehet me përdorimin e mbiemrave pjesorë me kuptim pësor që shprehin mesazhin se këto veprime duhen kryer më përpara veprimeve të pjesës të realizimit të recetës. Kjo dukuri duket qartë nëse krahasojmë psh. pjesën e parë të dy recetave. *Patate jahnit dhe Patëllxhanë të mbushur*. Tek e para dallojmë: *Patatet e qëruara dhe të lara priten në kubikë të mëdhenj.....*, ndërsa tek e dyta shpjegimi është më i plotë: *Patëllxhanëve iu qërohet bishti duke e lënë atë 2 cm të gjatë, u hiqet lëkura në tre rripa sipër dhe nga të dyja anët, ndërsa poshtë lihet me lëkurë*.

2. 2. Në fazën kryesore paraqiten veprimet kryesore që lidhen me realizimin e recetës. Përgjithësisht këto faza janë të ndara qartë, por ndodh që edhe të përzihen lehtë me njëra-tjetrën.

2. 3. Në fund jepen këshilla për konsumimin e pjatës së përgatitur me perime të ndryshme. Psh: *Roleja shoqërohet me patate të skuqura, të ziera, me pure patate, ose mund të jepet si meze me perime të ndryshme*.

2. 4. **Në recetat e internetit** përbërësit paraqiten në fillim, ndryshe nga libri që i jep në fund. Veçori tjetër që e dallon ligjërimin këtu është dhënia e shpjegimeve në kllapa mbas përbërësve në këtë pjesë të recetës, gjë që nuk ndodh asnjëherë në recetat e librit.

3. Siç u përmend më sipër, në recetat shprehet vijueshmëria ose njëkohshmëria e veprimeve që duhen kryer gjatë etapave të ndryshme të gatimit. Mjetet gjuhësore me anë të të cilave realizohen këto mesazhe janë të ndryshme. Pjesoret e foljeve, rrethorët e kohës, periudhat me fjali të varura kohore, fjalitë asindetike etj. , i japin ritmin dhe fuqinë bindëse recetave duke i nxitur përdoruesit e tyre që t'i ndjekin hap pas hapi këshillat e dhëna.

3.1 Rrethorët e kohës dhe të vendit shprehin saktë kohën e kryerjes së një veprimi si edhe vendin apo enën ku gatuhet a hidhet një përbërës i një recete të caktuar. (Gramatika e Gjuhës Shqipe. Sintaksa) Psh. *Patatet lahen, zihen në ujë të vluar me kripë, qërohen dhe **pastaj** priten në feta të trasha. Patatet e nxehta kalohen në makinë ose shtypen me*

lugë druri, **pastaj** shtohet qumësht, vezë, gjalpë.... **Pas** pjekjes ftohet pak, pritet në copa dhe vendoset në pjata. Kripa hidhet në **fillim ose gjatë** skuqjes. Yndyra nxehet **përsëri** dhe hidhte pjesa tjetër e patateve. Kështu vazhdohet **derisa** të skuqen të gjitha. **Në fund të zierjes** shtohet majdanoz i grirë imët. ...në lëngun e vluar ku shtohen petët e dorës të cilat janë përgatitur **që më përpara...** , **Para ndarjes** në pjata supës i hidhet majdanozi..., **Gjatë kësaj kohe** përgatiten patëllxhanët etj.

3.2 Marrëdhëniet që lidhen me vijimësinë ose njëkohshmërinë e veprimeve shprehen edhe me anë të mbiemrave prejfoljorë me kuptim pësor (*Gramatika e Gjuhës Shqipe, Morfologjia, Mbiemri*) psh. **patatet e qëruara** lahen= pra pasi janë qëruar, **patatet e skuqura** vendosen në pjatë...) Receta 110- **Petka të mbushura me mish**, Mishi i lopës dhe i derrit të përzier së bashku, mishi i përgatitur... , lyhen me vezë të rrahura me ujë... , peta e mbetur..., petët e hapura priten..., petkat e mbushura...

3.3 Periudhat me fjali të varura kohore (*Gramatika e Gjuhës Shqipe, Sintaksa*) shprehin renditjen e veprimeve sipas udhëzimeve që jep autori. Ato mund të shprehin njëkohshmëri ose veprime që kryhen njeri pas tjetrit. Po sjellim disa shembuj me fjali të tilla: **Pasi** të mbahet në furrë 15-20 minuta dhe **kur** të jetë bërë gati i hidhet majdanoz i grirë hollë. **Kur** këto të jenë skuqur, shuhen me verë, **pastaj** i hidhet piper kokër, dafinë, ujë sa të mbulohen deri në gjysmë **dhe pasi** i vihet pakaku lihen në zjarr të ngadalshëm. (*Rosto në tenxhere*, fq. 198)

4. Karakteristika leksikore të ligjërimit të recetave

Leksiku i përdorur në receta ka karakteristika të veçanta. Kështu emrat zënë vendin e parë nga pikpamja e dendurisë së përdorimit, më pas vijnë foljet, mbiemrat që shprehin cilësi konkrete dhe numrorët me ndajfoljet. Karakteristikë e ligjërimit është përsëritja e disa emrave dhe foljeve në fazat e ndryshme të recetës. Është e natyrshme që emra përbërësish të gjellëve si edhe enëve të gatimit të rimerren gjatë recetës.

Emrat e përbërësve kryesorë të një recete përdoren që në etapën e parë në trajtën e shquar. Kjo ka kuptim sepse përdoruesi e di se për çfarë recete dhe përbërësish bëhet fjalë që nga emërtimi i saj. Pra, kjo shquarsi është plotësisht e ligjshme (*Gramatika e Gjuhës Shqipe, Morfologjia, Emri*). Ndërsa emrat e sendeve që shenjojnë përbërës që rregullojnë shijen si *domate, kripë, piper, dafinë* etj. , përdoren zakonisht në trajtë të pashquar. Kjo ndodh edhe kur përbërësit ose emrat e enëve shprehen të cilësuar nga ana sasiore me ndajfolje ose mbiemra si psh. : në zjarr të javashëm, shtohet fare pak ujë etj.

Një tjetër karakteristikë leksikore morfologjike e ligjërimit të recetës ka të bëjë me përdorimin e një numri të konsiderueshëm foljesh, të cilat konkurrojnë me emrat e përbërësve dhe mbiemrat apo ndajfoljet. Përveç dendurisë së përdorimit vihet re edhe përsëritja e disa foljeve ashtu si edhe e emrave apo togfjalëshave *emër+ mbiemër* të cilat shprehin rrjedhën logjike të veprimeve dhe etapave që ndiqen gjatë realizimit të një recete gatimi.

5.Karakteristika morfologjike

Në lidhje me tiparet morfologjike të ligjërimit të recetave vërejmë të përdoren: Mbiemra prejfoljorë me kuptim pësoren. Psh. *vendoset... të pastruara, të lara, receta 110 petka të mbushura me mish. Mishi i lopës dhe i derrit të përzier së bashku, mishi i përgatitur... , lyhen me vezë të rrahur me ujë... , peta e mbetur..., petët e hapura priten..., petkat e mbushura... ,*

Folje të përdorura kryesisht në diatezën pësore (shiko nr. 224 *Kallamarë ose supie të stufuara*, psh. *kallamarët pastrohen mirë.. u hiqet koka, i hiqet cipa etj.* Por gjejmë dhe folje të përdorura në diatezën veprorë, veta e parë shumës koha e tashme në mënyrën dëftore apo në atë lidhore, psh. *që cipa të hiqet lehtë... kallamarët i zhysim në ujë të nxehtë... gjatë pastrimit gishtat i lyejmë me kripë etj. forma të pashtjella foljore: 167 Musaka me kungull:duke e mbuluar mirë fundin e tavës... , “e vemë në tigan me yndyrë duke e përzierë në zjarr për pesë minuta” Fli me miell misri 127. Harizi. E. , “Si të gatuajmë”. Vetëm tek tre – katër receta vërejmë se foljet janë përdorur në diatezën veprorë në vetën e parë numri shumës në kohën e tashme të dëftores. Kjo ndodh tek recetat *Lakror me hithra, (Hithrat i lajmë. .. i shtypim, i grijmë, ...i ziejmë etj.), trahana me qumësht, përgatitje e trahanasë së gatshme (shkrijmë gjalpën, hedhim trahananë, e përziejmë, shtojmë djathë etj.).**

Në recetat e paraqitura në internet vihet re një përdorim më i gjerë të mënyrave të ndryshme të foljeve. Kështu, dallojmë folje në urdhërore në ndryshim nga dëftorja dhe diateza pësore e recetave të librit. Kështu tek *Supë me selino*. Dallojmë: *qërojini, pritini, merreni selinon, përzini, shtoni koprën.*

Shprehjeve të sasisë të **përafërt-** *pak verë, kripë, piper, majdanoz, yndyrë e nxehët, fletë dafinë, feta limoni, priten në copa të vogla, shtohet pak gjalpë i freskët, copa me diametër rreth 4 cm, mund të jepet edhe pak uthull.*

Shprehjeve të sasisë të **saktë** me anën e numërorëve: *500 gr gjalpë, 5 kokrra patate, 3 karota, lihet 20 minuta.*

Shprehjeve të krahasimit: *me madhësi sa një kokërr ulliri, zihet brumi njëlloj si për petët.*

Shprehjeve të kohës dhe renditjes kronologjike të veprimeve: *f. 164 bamje jahni, para se të hiqen nga zjarri... .. pastaj shpëlahen dhe kalohen në tigan... , bamjet lihen sa të marrin valë, pastaj hiqen. (E. Harizi)*

6.Veçori sintaksore të ligjërimit të recetave

Ligjërimi i recetave të kuzhinës karakterizohet nga një larmi e madhe e llojeve dhe tipeve të fjalive. Ato më të përdorurat janë: *fjalitë e thjeshta, ato të përbëra, asindetike, me bashkërenditje, me nënrenditje si edhe të përziera*. Mendojmë se mbizotërojnë fjalitë me bashkërenditje dhe ato me asindetizëm dhe bashkërenditje krahas periudhave me nënrenditje. Psh. një recetë *kukureci f. 223* ka gjithsej 8 fjali dhe periudha. Aty dallojmë: një fjali të thjeshtë, tre me bashkërenditje, tre me nënrenditje kohore, një me nënrenditje kushtore. Por, skemat e periudhave janë

shpesh shumë të larmishme. Përgjithësisht vihet re se gërshetohen bashkërenditja me asindetizmin si edhe me marrëdhëniet e tjera sintaksore si koha, qëllimi, kushti etj. psh. *kukurreci bëhet më i shijshëm kur piqet në hell, mbi prush ose në zjarr të ngadaltë në mënyrë që të mos përvëlohet.* f. 223

Pas analizës së bërë do të theksonim se modeli më i përdorur sidomos në fazën e parë të recetës është periudha me asindetizëm dhe bashkërenditje, psh. *pula pastrohet, lahet, fshihet, rregullohet në formë xhepi dhe vendoset në tenxhere me yndyrë të nxehtë.* fq 230 *pula pastrohet, lahet dhe bëhet mbushja.* 232

6.1 Përdorimi i dendur i gjymtyrëve homogjene me bashkim asindetik dhe lidhëzor (*Gramatika e Gjuhës Shqipe, Sintaksa*) është karakteristikë e ligjërimit të recetave. Në shpjegimet e tyre përdoren dendur kallëzues dhe kundrina homogjene por edhe kryefjalë të tilla.

Le të sjellim disa raste të kundrinave homogjene, psh. *Rregullohen me kripë, piper, gjalpë, majdanoz dhe kopër të grirë hollë. Shtohen gështenjat, rrushi i thatë ose bajamet, pak kripë dhe lëng pule ose ujë.*

Kallëzues homogjenë të përdorur në receta. *Zorrët e bagëtive të imëta pasi pastrohen e lahen mirë me ujë të bollshëm kthehen nga ana tjetër dhe lahen përsëri.*

Raste të përdorimit të kryefjalëve homogjene. *Qepët e njoma me gjithë bishta si edhe hudhrat* pastrohen, priten dhe vendosen mbi mish.

Mund të theksojmë se rëndom hasen në receta më shumë se dy gjymtyrë homogjene ku të parat janë bashkuar pa lidhëza ndërsa gjymtyra e fundit ose dy të fundit lidhen me lidhëzat *dhe, ose* etj. Raportet midis tyre janë përgjithësisht këpujore.

6.2 Fjalitë e thjeshta përdoren zakonisht në fillim ose në fund të recetës. Përkrah fjalive të përbëra ato plotësojnë qëllimet pragmatike të recetave të kuzhinës, psh. *:bifteku i skarrës mund të shoqërohet edhe me limon. Të gjitha këto vendosen rreth e qark mishit.*

Në fillim: *Për mashurka parapëlqehet mish qengji ose vici të njomë, fq. 207 ose në një pjatë porcelani të thellë rrihet e verdha e një veze me lëng limoni ose limontoz.* fq. 220

Në fund: *Serviret njëlloj si mishi me perime të tjera. Në fund hidhet majdanoz ose kopër e grirë hollë. Rregullohen me kripë, piper, gjalpë, majdanoz dhe kopër të grirë hollë.*

6.3 Periudha me bashkërenditje: Vërehen raste të fjalive të lidhura me lidhëza bashkërenditëse. Këto përdoren vetë por më dendur i shohim të përdorura bashkë me fjalitë asindetike, psh. *:kjo masë i hidhet qofteve sipër dhe së bashku futen në furrë. Skuqen nga të dyja anët në yndyrë të nxehtë dhe shoqërohen me patate të skuqura ose me perime të tjera të zierra. (f. 216, nr. 278.) (mishi i qengjit dhe i dashit priten në copa dhe vihen në tenxhere. f. 208), (E. Harizi)*

6.4 Periudha me nënrenditje: *Nëqoftëse mishi është prej qengji, në të njëjtën kohë me të vihen edhe bamjet. Mishi përgatitet siç u tha më lart. Lihet sa të marrë valë, pastaj hiqet nga zjarri. Fjalitë nënrenditëse me folje në lidhore shprehin kujdesin që duhet pasur që të realizohet sa më mirë receta, psh. : Pasi të mbahet*

në furrë 15-20 minuta dhe kur të jetë bërë gati i hidhet majdanos i grirë hollë,. .. ndërsa peshqit e mëdhenj (mbi 500 gram) duhet të ndahen në fileta.

6.3.1. Fjali me nënrenditje shkakore: 221-Mëlçi jahni, nuk duhet të ziejnë shumë sepse nga zierja e tepërt zakonisht forcohen. 210-Mish me bizele kokërr, bizelet zihen veç, sepse gjatë zierjes në ujë me kripë e salcë ato forcohen e nxihen.

6.3.2. Fjali me nënrenditje kohore: Shpesh këto marrëdhënie gërshetohen me ato bashkërenditëse ose asindetike etj. , psh. : *Si të jenë shkuar të gjitha të brendshmet në hell, pleksen me zorrët duke i mbuluar këto. Si të jetë skuqur nga të gjitha anët vendoset në pjatë dhe i hidhet piper i zi i bluar.*

6.3.3. Fjali me nënrenditje kushtore: psh. *Nëqoftëse musakaja nuk mbulohet me salcë të bardhë, atëhere mbi tavë shtrohen disa feta domate... 212-Tavë kosipo të jetë me mish qengji ai piqet drejtpërdrejt ndërsa me mish dashi zihet më parë.*

6.4. Fjali asindetike: Theksojmë se fjalitë e këtij tipi janë me karakteristiket dhe më të përdorurat në gjuhën e recetave. Ato i japin ritmin dhe qartësinë shpjegimit dhe shprehin njëkohësisht sa më thjesht renditjen e kryerjes së veprimeve, psh: *Zgjidhet një pulë e re..Pula pastrohet, lahet dhe bëhet mbushja. Pula pastrohet, lahet, fshihet, rregullohet në formë xhepi dhe vendoset në tenxhere me yndyrë të nxehtë.*

6.5. Shpesh ka periudha që përshkruajnë me hollësi dhe përpikmëri veprimet dhe etapat që duhen ndjekur. Sintaksa e tyre është mjaft komplekse. Kështu hasim dendur periudha me asindetizëm e bashkërenditje, psh. tek receta 64- *Supë orizi me vezë dhe limon:*“*Në fund supës i shtohet pak lëkurë limoni e grirë me rende, i jepet valë, hiqet nga zjarri dhe pas 5-6 minutash rregullohet me të verdhën e vezëve, ose periudha kur kombinohen fjalitë nënrenditëse me ato me asindetizëm e bashkërenditje, psh. :Në qoftë se peshku është i vogël, pastrohet nga luspat dhe të brendshmet, lahet, i çahet lëkura në dy-tri vende për të ruajtur formën gjatë skuqjes, i hidhet kripë, lyhet me miell dhe skuqet nga të dyja anët. Kordhëzat vihen në tavë, iu hidhet kripë, piper, rigon, yndyrë si dhe pak ujë, e vihen në furrë për tu pjekur.*

6.6. Një tip tjetër i fjalive të përdorura në ligjërimin e recetave janë **fjalitë e ndërmjetme të lidhjes së kumtimeve**. Ky tip i cili përdoret pak, tregon lidhjen logjike të veprimeve midis recetave të ndryshme ose krahason një veprim a etapë të gatimit me njohuri ose këshilla të dhëna në receta të mëparshme apo të ngjashme. psh. *Ashtu siç e pamë në.. .. Serviret njëlloj si mishi me perime të tjera (fq. 208, Mish qengji me qepë të njoma).*

II. Tipare të veçanta të ligjërimin të recetave të gatimit

Në paraqitjen tonë u vunë në dukje karakteristikat kryesore gjuhësore të ligjërimin të shkruar të recetave të gatimit.Por, gjatë krahasimit dhe analizës që kemi bërë, vihen re disa anë të veçanta që dallojnë nga një recetë tek tjetra.Këto veçori lidhen me faktin sesi rrjedhin veprimet në tekste recetash të ndryshme, me karakteristika morfologjike të foljeve, me dhënien në disa raste të këshillave të veçanta, përsëritjen e informacioneve nga receta paraardhëse etj.

1. Në disa receta ndodh që të jepen shpjegime ose informacione shtesë për vlerën ushqimore të një përbërësi apo për mënyrën e parapërgatitjes së tij. Kështu, në fillim të recetës *Mëlçi derri të skuqura* fq.221 gjejmë këto të dhëna: Mëlçitë e derrit kanë vlerë ushqimore njëlloj si mëlçitë e tjera dhe kanë shije të mirë. Nëqoftëse gjatë therjes nuk ka plasur tëmthi, ato pastrohen vetëm nga dhjami, zhapat dhe damarët kryesorë. Po sjellim edhe një këshillë tjetër të dhënë në fillim të recetës “*Makarona me gjalpë.*” (*Makaronat zakonisht ziejnë pak kohë, 20-30 minuta para ngrënies sepse të ftohura dhe të ringrohura përsëri humbasin shijen.*)
2. Në disa recetatë tjera shpjegimet ose ndonjë këshillë e veçantë jepen në fund si psh. tek recetanr. 149 *Tavë pure me kimë*(shënim; *Mbushja në këtë tavë mund të bëhet dhe me gjizë e vezë... perime të kaurdisura etj.*), ose *Mish me spinaq* fq. 209, *spinaqi nuk duhet të zihet shumë sepse humbet vlerat ushqimore.* ose tek *Supë me perime*, fq.91 (*Në rast se bizelet dhe mashurkat nuk janë shumë të njoma, ato më parë duhet të. ziejnë në ujë të vluar për disa minuta dhe pastaj ti hidhen supës.*), fq. 125, *Përgatitje e trahanasë së gatshme.* Përmeti psh.e bën me qepë të skuqura e *salcë.* *Disa krahina me cingaridhe të dhjamosura të bagëtime.*
3. Qëllon që kur këshilla është e rëndësishme autori e përsërit në mënyrë që të arrihet cilësia e kërkuar e gatimit nga përdoruesi. Kështu tek receta *Pure patatesh* dallojmë: *duhet theksuar edhe njëherë se patatet shtypen të nxehta, në rast të kundërt pureja del e lëngshme dhe e humbet shijen.* fq. 131
4. Në disa receta përdoren fjali të varura qëllimore të ndërtuara me lidhëzat nënrenditëse *me qëllim që, që etj.* të cilat shprehin rolin këshillues dhe udhëheqës të autorit ndaj lexuesit, psh. : *Hedhim menjëherë gjithë sasinë e miellit, e përziejme që të mos krijohen kokrramisri (122)mëmëlige, që të gatuhet një turli e mirë duhet të sigurohen 3-4 lloj perimesh.*
5. Në disa receta gjejmë të përdorura fjali të varura me përemra lidhorë. Edhe ky tip fjalie shpreh me saktësi dhe sqarime të hollësishme në lidhje me enët dhe përbërësit e ndryshëm të një recete. Shpjegimet e dhëna janë një mjet dhe një kusht i nevojshëm për suksesin e realizimit të recetës nga të gjithë të interesuarit, psh.: *më të shijshme janë ato që skuqen të paziera, me përjashtim të patateve të vogla, të cilat më parë zihen, qërohen pastaj, priten në feta dhe skuqen*
6. Angazhimi dhe “pjesëmarrja” e autorit në suksesin e realizimit të recetës shprehet edhe me përdorimin e fjalive të varura kushtore. Mesazhi i këtyre fjalive i drejtohet përdoruesit që të bëjë kujdes kur ndonjë veprim a rezultat nuk zhvillohet sipas udhëzimeve, psh.: *Nëqoftëse peshku është i vogël, pastrohet nga luspat dhe të brendshmet, lahet, i çahet lëkura në dy-tri vende për të ruajtur formën gjatë skuqjes, i hidhet kripë, lyhet me miell dhe skuqet nga të dyja anët.*
7. Fjalitë me bashkërenditje lejuese me lidhëzën *ose* si edhe shprehjet: *po të doni, si të dëshironi*, etj. tregojnë se autori i drejtohet drejtpërdrejt “lexuesit kuzhinier” shprehin njëkohësisht mundësinë e zgjedhjes së amvisës dhe të përshtatjes aq sa mundet të recetës me kushtet, mundësinë dhe dëshirën e atij që e realizon atë, psh. : *.. Shuhet me dhallë ose kos të holluar...* Kjo mund të jetë dhe njëfarë angazhimi krijues që autori ia “lejon” lexuesve të tij. Mendojmë që ky është edhe një tipar i kuzhinës së sotme e cila mund të përshtatet sipas shijeve dhe kërkesave të veçanta të përdoruesve.

8. Tek disa receta shpesh kemi rimarrje të informacioneve nga receta të tjera. Kjo është karakteristikë e bashkësisë së materialeve që shprehin një sistem të plotë të njohurive rreth gatimit, psh. :receta 171 *Domate e specat të mbushur me oriz. Specat dhe domatet bëhen njëlloj si më sipër (autori i referohet receta 170 Specat e domate të mbushura me kimë.)*

9. Në disa receta dallohet në fillim një pjesë hyrëse ose paraqitje e shkurtër shtesë. Kështu ndodh tek 215 fq. 176, *Peshk i zier*. Në fillim të receta, para se të pëshkruhen veprimet dhe etapat e saj autori thotë: “*Për zierje përdoren të gjitha llojet e peshqve, me përjashtim të ngjalës, kublës, etj. , që kanë erë të rëndë*”, ose tek 220 *Peshk i fërguar*, fq. 178 thuhet: “*Për të fërguar përdoren të gjitha llojet e peshqve. Nëqoftëse peshku është i vogël, pastrohet nga luspat e të brendshmet, lahet, i çahet lëkura në dy tri vende për të ruajtur formën gjatë skuqjes.. .*”

Rastis që autori i librit të shprehë në fund të receta mendimin ose vlerësimin e tij personal për pjatën që ai propozon, mënyrën e shërbimit (*shërbehen të ngrohta, shoqërohen me pure etj.)* ose një konkluzion të vogël, psh. *Peshku i fërguar shoqërohet me patate të fërguara dhe me sallata të stinës (jeshile, domate, kastraveca, etj.).* Ai shpreh gjithashtu pajtimin me ndonjë ndryshim të lehtë që mund t'i përshtatet shijeve dhe kërkesave të konsumatorëve të ndryshëm apo të veçantë. Mendojmë se këto lloj ndërhyrjesh mund të jenë gjithashtu tregues i karakterit personal që ai kërkon t'i japë receta duke shprehur në këtë mënyrë edhe një lloj subjektiviteti ose më mirë personalizimin e receta së tij, e cila nuk është thjesht dhe vetëm përshkrimi i etapave... kështu tek “*Mëlçi derri të skuqur*” dallojmë: *shënim: Mëlçitë e skuqura, sipas dëshirës, mund të mos kalohen në miell.* Këto lloj ndërhyrjesh mund t'i gjejmë edhe në mes të receta, psh: tek e njëjtareceta vërejmë: *Së bashku me mëlçitë, sipas dëshirës, gjatë skuqjes mund të hidhen edhe qepë të grira hollë në formë gjysmë rrethi.*

Përfundime

Kuzhina është një art me vete për çdo kombësi apo popull. Ajo është thelbësore në vetë ndërtimin e universit, ku çdo qenie njerëzore varet nga ky element kaq i domosdoshëm, ushqimi.

Në këtë artikull u analizuan disa nga karakteristikat më të qenësishme gjuhësore të ligjërimit të receta të kuzhinës në gjuhën shqipe. Ato lidhen me përdorimin e një leksiku të veçantë që lidhet me fushën e gatimit, me tipare pragmatike, si: skema e përgjithshme e realizimit të receta; qartësia dhe karakteri konçiz i shprehjes si edhe natyra këshilluese ose urdhëruese. Gjatë analizës së këtij lloj ligjërimit u vu re gjithashtu se përveç strukturës dhe elementeve të tjera të përbashkëta, receta dallohen nga njëra-tjetra nga tipare të veçanta të tyre si mendimi ose vlerësimi personal i autorit, shpjegimet shtesë, përshtatja me shijet e përdoruesve etj.

Në shpjegimet e receta përdoren dendur kallëzues kryefjalë dhe kundrina homogjene. Ligjërimit karakterizohet gjithashtu nga një larmi e madhe e llojeve dhe tipave të fjalive, si: fjalitë e thjeshta; të përbërat, asindetike, me bashkërenditje, me nënrenditje, të përzjerat. Këto elemente lidhen në mënyrë të natyrshme dhe janë në funksion të synimeve pragmatike të ligjërimit të autorit i cili kërkon ta bindë lexuesin që të zbatojë udhëzimet e receta.

Bibliografia

- Gramatika e Gjuhës Shqipe, Sintaksa, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002
- Gramatika e Gjuhës Shqipe, Morfologjia, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002
- Harizi, E. , “Si të gatuajmë” EDFA, Tiranë, 1997
- Teknologjia e përgatitjes së gjellëve, Tiranë, 1987
- Koçi, K. , Mrekullitë e tenxheres me presion, Shtëpia botuese enciklopedike, 1984
- P. Y. Chupin, S. , Laroze, V. , Le Normand, Douceur de France, Editions du Chene, 1995
7. Gillet. Ph, Le goût et les mots, Littérature et gastronomie (14e-20e siècles). Paris, Payot, 1987
- Alain, G. ,Le triomphe de la cuisine bourgeoise » dans Revue d’histoire moderne et contemporaine. Tome XXIV, octobre-décembre 1977, pp. 497-523
- MainguenuD. ,Le discours littéraire. Paratopie et scène d’énonciation. Coll. U – Lettres, Paris, Armand Colin, 2004. 4e Journée liégeoise de Traitement des Sources galloromanes (TraSoGal), Liège, 14 mai 2012

“KOHA E ARDHME E FOLJES NË SHQIPEN STANDARDE ASPEKTI KOHË, MËNYRË DHE MODALITET”

Msc. Sejdi M. GASHI

Instituti Albanologjik i Prishtinës

Përmbledhje

Në këtë punim objekt studimi është zgjedhur koha e ardhme e foljes. Hulumtimi i kësaj kohe përfshin përfaqësimet e kohëve të së ardhmes në gjuhën shqipe, rrafshin e përdorimit duke përfshirë këtu edhe dallimet e përdorimit të së ardhmes në ligjëratën e drejtë dhe atë të zhdrejtë.

Konceptet e kohës në gramatikë paraqesin rrafsh në këndvështrimin të gjuhësisë së tekstit. Në drejtëzën e vazhdimësisë kohore, fenomenet mund të vendosen në raport me një çast të tanishëm. Veprimet e kryera para këtij çasti do të njihen si kohë e shkuar, veprimet e atij çasti, si të tashme dhe veprimet e së ardhmes do t'i njohim si kohë e ardhme-ndarje në kohë absolute. Mirëpo, krahas kësaj në drejtëzën e vazhdimësisë kohor, raportet mund të lidhen jo thjesht për një çast të tanishëm, por në një çast, i cili është në raport me një çast të ligjërimin e që mund të jetë qoftë në të kaluarën, qoftë në të ardhmen. Këto janë kohët relative. Një klasifikim i tillë mundëson kohë të tilla, si: e pakryera, e kryera e tejshkuar, ose e ardhmja e përparme e së shkruarës. Kjo bën që në rrafshin e së ardhmes si kohë absolute të lihet hapësirë më e gjerë diskutimi.

Fjalët çelës: kohë e ardhme, dallim gramatikor, kohë relative, kohë absolute, modalitet.

Abstract

As you can see from the title, the topic of this paper is the future tense, its use as a grammatical mood and its modality. Also, the future tense is viewed by contrasting it to other simple tenses, the past and the present. Starting points of this tense are also addressed. For example, it is noted how often it occurs that verbs used in present tense express the future, not as a tense but as a modality.

Also, the study shows what is the paradigmatic and syntagmatic relevance of the future tense; how is it manifested; to what extent it is hypothetical and why is it so, and so on. Amongst else, future tense, from both grammatical and modality aspects is examined in what cases it is epistemic and in what cases it is deontic, why is it this or why that, what measures prove such a thing and what separates such juxtapositions.

These and other observations during this study reinforce my conviction that Albanian language, as an age-old language of Indo-European pillar, needs to be studied and researched much more than now, both in terms of grammatical rules as well as in its rhetoric in general, which is being handled by the linguistic science of text. Nonetheless, the paper “On some functions of future tense of verbs in Albanian standard language” is not an end to this issue, but to some extent it has revealed

relevant facts which more than anything lead to encouragement of other researchers to study and re-study the future tense, as well as other tenses, which until a few years back, in a way, have been static in grammar textbooks of Albanian language.

Hyrje

Si në gjuhë të tjera indoevropiane, edhe e ardhmja e shqipes vazhdon të trajtohet nën dilemën e periudhës së themelimit të saj, ka ekzistuar apo jo në periudhën e hershme të PIE. Gjuhëtarët, nga aspekti historik kohën e ardhme të foljes e vështrojnë në forma të ndryshme. Studiuesi Eqrem Çabej thotë se kjo kohë e foljes nuk i përket periudhës së hershme indoevropiane.

Ndër studimet më të elaboruara dhe të argumentuara për formimin e futurit të shqipes është punimi i Besim Bokshit (*Bokshi 2012:36*) sipas të cilit i pari futur i protoshqipes ishte ai sintetik me parashtesën *-syo, ndërsa pas tij futuri me do + lidhore, i cili u krijua para formës kam + paskajorje (*me punue*) dhe kam + paskajoren e dytë (*për të punuar*). Bokshi thotë se futuri i përdorur ndër arbëreshët kam + lidhore është krijim i shekujve XII – XIII.

Në gramatikat e para të studimit të gjuhës shqipe koha e ardhme e foljes zë një vend të rëndësishëm, megjithëse trajtimi i saj është bërë sipërfaqësisht, shpesh dhe me paqartësi. Disa nga hartuesit e gramatikave nuk janë marrë fare më foljet ose edhe nëse janë marrë, për më tepër se më kategorinë e saj, i kanë trajtuar temat e fjalëve si folje dhe mbaresat e tyre. Kjo sepse foljet e gjuhës shqipe në përgjithësi gjatë zhvillimit të tyre kanë pësuar lëvizje. Ato paraqesin larmi të mëdha formash. Nuk janë të rralla rastet kur një folje ndër dialektet e kësaj gjuhe në fillzhvillimin e vet shfaqet në trajta të nduarnduarta, prandaj me një formë ajo merr pjesë në një tip të foljeve me trajtë tjetër, pasqyron kategori tjetër foljesh (Ajeti 1983:73). Veprimi i shprehur me anë të trajtave kohore të futurit më së miri vërtetohet kur ai hyn në funksion, duke ndërtuar fjali të nënrenditur (Badallaj 2010), por mjaft shpesh del edhe në fjali të bashkërenditura me karakter imperativ dhe optativ: ***Të gëzosh festën! Të rrojë djall!***, si dhe në fjali pyetëse - thirrmore të tipave: ***Ku të vendosem? Ta kap apo mos ta kap?*** Kjo mënyrë e ndërtimit të fjalive të shtruara tregon qartë edhe për karakterin modal të së ardhmes së të tashmes.

Shikuar në strukturën gramatikore dhe vlerën semantike (kuptimore), e ardhmja si trajtë kohore shprehet edhe si mënyrë e ndërtimeve gramatikore. Sa i përket formimeve të ndryshme analitike të kohës së ardhme, duhet t'i marrim parasysh format analitike: ***do të punoj, kam me punue, kam për të punuar dhe kam të punoj***, të cilat nismën e kanë te sintagmat e lirë të tipit ***dua+ të punoj***.

Çështje më vete e studimit të foljeve në përgjithësi dhe kohës së ardhme në veçanti, pra, është trajtimi i tyre në periudha të ndryshme historike. Padyshim, format e së ardhmes dhe foljet në përgjithësi nuk ka pasur mundësi të studioheshin pa pasur një bazë të dokumentuar, siç ka ndodhur me gjuhët e tjera të lashta indoevropiane, të cilat duke pasur shkrim të hershëm dhe të dokumentuar kanë dhënë edhe mundësitë e studimit. Të parët që janë marrë më çështje gramatikore, konkretisht me sistemin e foljeve në rastin konkret të së ardhmes së foljes ishin studiues të huaj. Edhe këta,

fillet e para të studimit i nisin me fjalorë, siç ishte “Fjalorthi i Arnold von Harff-it”, ku gjejmë trajtën (*do da ble*). Më vonë në shekullin XVII kemi fjalorin e Frang Bardhit. Gramatika e parë shqipe, ishte shkruar nga Francesco Maria de Lecce 1716, (Kastrati 1988:8) Këtë gramatikë studiuesi Jup Kastrati e vlerëson si më të vjetrën të gjuhës shqipe. I përkiste dialektit verior, kurse misionari italian e kishte titulluar “*Vërejtje gramatikore mbi gjuhën shqipe dhe ortografinë e saj*” (Kastrati 1988: 8). Kastrati zë ngoje edhe një gramatikë tjetër, para De Leces, e cila daton nga vitit 1710. Për të thekson se mendohet të jetë në Manastirin e Grotafferatës

Sistemi foljor i shqipes

Në gjuhën shqipe, riorganizimi i sistemit foljor është kushtëzuar në radhë të parë nga riorganizimi i vetë kategorive gramatikore, që janë të trashëguara nga një fazë e hershme indoevropiane. Siç e shpjegojnë disa gramatika, ndryshimet në këtë fushë janë bërë shkallë- shkallë, porse më të mëdhatë janë përfituar në kategoritë gramatikore të kohës, të mënyrës e diatezës, si në aspektin formal ashtu edhe në atë kuptimor. Por, nuk kanë mbetur prapa as kategoritë gramatikore të vetës dhe të numrit. Kategoria e kohës, ta zëmë, gjithnjë paraqitet si një sistem kundërvëniesh, jo vetëm në rrafshin kohor por edhe në rrafshin aspektor. Kuptimi kohor është mpleksur me atë të modalitetit. Modaliteti, sipas studiuesit Agim Spahiu, në një punim të vitit 2001, është një term që përdoret në disa fusha të dijes, por dhe në atë të gjuhësisë. Modaliteti është përkufizuar si qëndrim i folësit ndaj asaj që kumton, në lidhje të ngushtë me realitetin objektiv, realizuar me mjete të ndryshme gjuhësore – shprehëse dhe intonacionore. Nga kjo del se modaliteti është një kategori e rëndësishme gjuhësore me një shtrirje madje edhe përtej saj (Spahiu, 2001). Me përjashtim të formave kohore të mënyrës dëftore, te format kohore të mënyrave të tjera, kuptimi kohor është i gërshtetuar me atë të modalitetit, i cili shpeshherë del në plan të parë. Kështu, për shembull, mënyra dëshirore nëpërmjet së cilës shprehet dëshira e folësit në formë urimi apo mallkimi, del në përdorim kryesisht një formim kohor, që në gramatologjinë shqiptare quhet kohë e tashme, por që kuptimisht i referohet së ardhmes, **modaliteti i dëshirueshmërisë**, i shprehur nëpërmjet urimit apo mallkimit, që lidhet rregullisht me veprimet që pritet të ndodhin pas çastit të ligjërit. P.sh. urimi **paça mësuar**, që i kundërvihet së ashtuquajturës kohë e tashme **mësofsha**, e përlij pranimin e kategorisë gramatikore të kohës të mënyrës dëshirore, duke u spikatur në këtë mënyrë kuptimi modal. Shembull tjetër që e përforcon këtë është urimi që i bëhet dikujt për ditëlindje. **U bëfsh 100 vjet!**. Folja **U bëfsh**, si kohë gramatikore i përket kohës së tashme, por si kuptim i përgjigjet së ardhmes dhe është mënyrë. Janë, pra, këto elemente që e komplikojnë studimin e kohës së ardhme. Gramatikologët kanë theksuar se nga tri kohët themelore të foljes më e pasura në forma kohore që i kundërvihen njëra -tjetrës, paraqitet koha e shkuar e pas kësaj e ardhmja. Që të dy këto kohë si pikë referente e kanë kohën e tashme, çastin e ligjërit.

Studiuesi Tafil Kelmendi ka spikatur se e tashmja në referimin e të ardhmen realizohet rëndom me ndajfolje që shënon pozicion kohor a me ndajfolje të kohëpozicionit për të treguar se ngjarja që më parë është fiksuar dhe prandaj

ndodhja e asaj ngjarjeje është aq e sigurt thuhet është duke ndodhur në kohën e tashme, në kohën e thëniesimit, sikur ndodh tani: **Arbani udhëton për në Francë sonte në orën 22**. Ai vëren se e tashmja me referim në të ardhmen del sidomos në fjali të varura kushtore, si edhe në fjali të mëvetësishme me ndajfolje pyetëse, përemra pyetës etj. Sidoqoftë, koha e ardhme ka format kohore të së ardhmes, të së ardhmes së përparme dhe të së ardhmes së të shkuarës.

Për sa u përket formave të kësaj kohe, sipas Shaban Demiraj janë krijuar tri lloj kundërvëniesh, sipas çastit që merret si pikë refemi kohor. Për një veprim pas çastit të ligjërimit përdoret forma e së ardhmes e tipit (**do të mësoj**), e cila në lidhje me çastin e ligjërimit qëndron në raport të përkundërt me atë të kohëve të së shkuarës (**do të punoja**), e cila qëndron ndaj së ardhmes të tipit (**punoja**) ndaj së tashmes (**punoj**). E ardhmja e së shkuarës shpreh një raport kohor të përkundërt me atë kohëve “relative” të së shkuarës, që tregojnë **parakohësi**, ajo tregon **paskohësi**, në lidhje me një çast të së shkuarës. Kur është fjala për dy veprime që priten të kryhen në të ardhmen, domethënë pas çastit të ligjërimit, atëherë veprimi që pritet të kryhet para tjetrit, mund të dallohet formalisht duke shprehur formën e së ardhmes së përparme të tipit (**do të kem punuar**). Kur përdoret në këtë kuptim, kjo formë kohore ndaj së ardhmes së tipit (**do të punoj**) shpreh një raport **parakohësie** të ngjashëm me atë të kohës së kryer (**kam punuar**) ndaj kohës së tashme (**punoj**). Në kuptimin e komunikimit, këto elemente kanë qenë vazhdimisht të shprehura, mirëpo deri vonë nuk janë studiuar sa duhet. Pra, kjo kategori i është nënshtruar vazhdimisht evolucionit historik, duke shkaktuar ndryshime largvajtëse në sistemin foljor. Ajo që bie në sy në disa gramatika, por mjaft të rralla, sepse shumica syresh nuk i janë qasur sa duhet këtij problemi, është lidhja e ngushtë e kategorisë së mënyrës me atë të kohës. Në të shumtën e rasteve treguesi gramatikor i mënyrës është edhe tregues i kohës.

Me më shumë kompleksitet paraqiten foljet me vlerë modale. Folje me vlerë modale quhen foljet që shërbëjnë për të shprehur modalitet – qëndrimin e folësit lidhur me veprimin e emërtuar nga folja ndihmëse. Ato e humbin mëvetësinë e tyre si folje të zakonshme. Duke qenë të pjesë të sitagmës foljore, në të cilën bëjnë pjesë, nuk kanë mundësi ta kryejnë funksionin e kallëzuesit si të pavarura. Si folje me vlerë modale në gjuhën shqipe Gramatika e Akademisë pranon foljet: **mund**, e ndjekur nga një folje në mënyrën lidhore, si **mund të punoj**; **duhet**, e ndjekur nga një folje në pjesore ose në mënyrën lidhore, **Duhet të ketë qenë fundi i vitit**; **do**, e ndjekur nga një folje në pjesore dhe **kam** e **jam**, të ndjekura nga forma e pashtjelluar e tipit **për të larë**.

Në gjuhën shqipe, nga pikëpamja e studiesit Besim Bokshi, folja modale gjysmëndihmëse ka qenë formë veprorë e foljes **mund** (**muj**) dhe forma pjesore e foljes **dua** (**duhet**) dhe se **do** e **mundem** janë bërë të tilla nën ndikimin e mëvonshëm të të parave. Pjesorja pjesore e së kryerës u seleksionua vetëm nga folja modale që ishte në formën e diatezës pjesore. Ishte, pra, forma pjesore e vetës së tretë, në të cilën dilte folja modale **duhet** ajo që e bënte mundur relacionin me pjesoren për të krijuar një kallëzues modal (**duhet larë**). Bokshi vëren ndërkaq se folja modale **mund** vetëm si formë veprorë kishte arritur funksionin e foljes modale gjysmëndihmëse. Jo vetëm

në relacion me pjesoren, vetëm për shkak të formës së tillë dietike. Ky studies e shpjegon me bazë të fuqishme shkencore edhe foljen modale *duhet*. Ai konstaton se në futurin (*do të punoj*) forma e ngurosur *do* e foljes dua nuk është përfituar nga funksioni i foljes gjysmëndihmëse modale, sepse këtë funksion nuk e ka pasur e as që e ka forma veprorë e foljes dua. Prandaj, funksioni gjysmëndihmës modal i formës *do* del të jetë i përfituar nga ndikimi i formës *duhet*. Forma joveprorë *duhet*, si formë e vetes së tretë njëjës e foljes *dua*, është bërë pavetore si në bashkëvjajtje me lidhoren (*duhet të them*), ashtu edhe me paskajoren (*duhet me thanë*), ndërsa në bashkëvjajtje me pjesoren ajo është njëvetore në vetën e tretë njëjës (*do thanë*). Meqë edhe forma veprorë do vetëm vetën e tretë e njëjësit dhe vetëm në bashkëvjajtje me pjesoren është në funksion të foljes gjysmëndihmëse modale, del e qartë se e tillë është bërë nën ndikimin e formës pësore *duhet*.

Disa gramatika e përkufizojnë qartë se folja gjysmëndihmëse që shpreh kuptimin modal të detyrimit ose të domosdosë, përdoret kryesisht në kohën e tashme dhe në të pakryerën e mënyrës dëftore dhe pothuaj vetëm në vetën e tretë njëjës. Por, ajo mund të përdoret edhe në kohën e ardhme si edhe në të tashmën dhe në të pakryerën e mënyrës habitore.

Breu duke pasur parasysh foljet modale që shprehin mundësi, obligim, dëshirë dhe detyrim, e vëren edhe të ashtuquajturin leJOR (jussive). Në kuptimin e funksionimit të foljeve ato shprehin edhe mënyrën e veprimit. Disa folje në sintagma të caktuara përdoren për të shprehur fillimin, vazhdimin, rritjen progresive ose mbarimit e veprimit të emërtuar nga fjala ndjekëse. Foljet që shprehin mënyrën e shtjellimit të një veprimi, e humbasin mëvetësinë si gjymtyrë fjalie. Kështu, për të shënuar fillimin e një veprimi, përveç foljeve filloj e nis, përdoren edhe foljet zë, bëj, marr, vihem etj., të ndjekura prej foljes themelore të sintagmës foljore përkatëse, p.sh.: Hëna e bukur që sapo *filloi të dilte*, shkëlqeu në zallin e Përroit të Thatë, E mori djalnin dhe *nisi t'ia lëmonte* flokët. Prandaj kur *filloi të lidhte* plagën zuri të bërtiste një zë nga brenda. *Bëri të ikte* nga dera po atje ishte gardh me njërëz.

Kurse për të shënuar vazhdimin e një veprimi përdoren kryesisht foljet *vazhdoj e vijoj*, të ndjekura nga një folje në mënyrën lidhore. P.sh.: *Vazhdoi të vraponte*. Djali *vijonte të rrinte* në gjunj. Për të shprehur rritjen progresive të një veprimi përdoret folja *vij* (kryesisht në vetën e tretë njëjës ose shumës), e ndjekur me nga një folje në përcjellore, si *vinte duke kënduar*; *Sa vinte e shtoej gëzimi* etj. Ndërkaq, për të shprehur mbarimin e një veprimi, përdoret edhe sintagma e tipit *mbarova së foluri*. Në këtë tip sintagma si gjymtyrë e parë përdoret kryesisht folja *mbaroj* ose *pushoj*, e ndjekur nga forma e rrjedhores së ngurosur të një emri prejfoljor asnjans në trajtë të pashquar, e cila luan rolin kryesor: Shkencëtarët nuk *pushuan së mbledhuri* fakte. Profesori kishte *mbaruar së ligjeruari* në klasë e të ngjashme me këto. Në funksion të rëndësishëm të foljeve janë edhe foljet kalimtare, veprimi i të cilave i kalon një personi ose sendi tjetër, d.m.th. që pranojnë një kundrinor, p.sh. Afërdita e *mbaroi temën*. Foljet që pranojnë një kundrinor të drejtë janë folje kalimtare të drejta, si: Arsimi i *vëzhgon lulet* nga ballkoni. Foljet që mund të marrin kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë janë kalimtare të zhdrejta: Agroni i *hipi makinës*. Ndodh që një folje të marrë njëkohësisht një kundrinor të drejtë dhe një kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë,

pra të jetë njëkohësisht folje kalimtare e drejtë dhe e zhdrejtë. *Ia dhashë librin Kaonit. Ia afrova Kaonit tufën e luleve.* Folje jokalistare janë ato që nuk pranojnë kundrinor: *fle, eci, rri, qëndroj, dal* etj.: *Agroni ecte i shqetësuar. Dje fjeta gjithë ditën.* Disa folje përdoren herë si kalimtare, herë si jokalistare. Për të gjetur se cilit grup i përkasin duhet parë se në ç'kuptim janë përdorur foljet veprorë dhe joveprorë. Foljet kalimtare të drejta kanë dy forma: formën veprorë dhe formën joveprorë.

Forma veprorë: *laj, fshij, thaj.*

Forma joveprorë: *lahem, fshihem, thahem.* Veprorë (laj, fshij, thaj) janë foljet që tregojnë se subjekti vepron (laj fytyrën, fshij dhomën, thaj rrobat) kurse, joveprorë foljet që tregojnë se subjekti pëson, d.m.th. i nënshtrohet veprimit të një tjetri (lahem nga dikush), ose tregon se subjekti vepron dhe veprimi i tij kthehet po tek ai (lahem = laj vetveten).

Format e së ardhmes (domosdoja dhe voluntativja)

Për t'u shprehur kuptimi i së ardhmes kryesisht përdoren disa forma analitike, të cilat ndërtohen me anë të pjesës foljore **do** (**do të punoj**), përkatësisht me anë të foljes ndihmëse **kam** (*kam për të punuar ose kam me punue*). Sipas Idriz Ajetit (Ajeti 1983: 128) janë dy lloje të futurit në gjuhën shqipe: futurin volitiv (i vullnetit, dëshirës *do të shkoj*) dhe futuri i domosdosë (duhet të shkoj). Ajeti të ardhmen e shprehur me foljen ndihmëse **kam** në Kosovë e konsideron si të ardhme të **domosdosë**. Ai me të drejtë ndërton shembujt: *Kam me punue më vonë.*

Në gjuhën standarde ky komunikim do të bëhej me fjalinë: *Më vonë do të më duhet të punoj.* Vërehet shumë qartë se kjo fjali në komunikim praqet formën e detyrimit. Kurse, nëse fjalia ndërtohet në formën: *Më vonë dua të punoj diçka,* automatikisht, na del se subjekti shfaq një vullnet, një dëshirë. Ndërsa, në fjalinë: *Nesër më nevojitet të punoj,* shihet se subjekti nuk e ka të domosdoshme të punojë, porse e shpreh njëlligim obligimi. Në studimet e publikuara deri sot ndërtimi i së ardhmes është bërë në bazë të mjeteve gramatikore dhe mjeteve të tjera gjuhësore.

Huddelston vëren se shumica e foljeve ndihmëse shprehin një sërë kuptimesh:

Foljet ndihmëse	Kuptimi i brendshëm jothelbësor
Mund, munda	Lejim-mundësi
Duhet, nevojitet (jo e sigurt)	Obligim-nevojë
Do të	Vullnet-parashikim (për të ardhmen)

Huddelston, prandaj, fillon inventarin e tij me një dallim në mes të modalitetit **epistemik dhe deontik**.

Fjalia epistemike shpreh një mundësi a domosdo më vete, kurse fjalia deontike paraqet një mundësi a domosdo si liri veprimi, si zgjedhje. Por, këto dy modalitete **epistemik** dhe **deontik** bashkëveprojnë me fjali mohore. Po kështu bashkëveprojnë edhe me kohën (gramatikore). Të dy modalitetet: **epistemik e**

deontik mund të shprehin edhe mundësinë edhe domosdoshmërinë, gjë kjo e shënuar në tabelën e mëposhtme.

Dallimi kryesor midis modalitetit epistemik dhe modalitetit deontik është se folësit e modalitetit epistemik bëjnë gjykime për statusin faktik të pohimit, ndërsa me modalitetin deontik ata nënkuptojnë se çfarë dëshmie ata kanë për atë që deklarojnë.

Epistemik

Mundësi: Ti mund të kesh keqkuptuar

Domosdoshmëri: Ai duhet të ketë arritur
deri tani

Deontik

Ti mund të marrësh sa të duash

Ti duhet të punosh më shumë

Nga ç'verehet foljet me vlerë modale janë: **mund**, e ndjekur nga një folje në mënyrën lidhore; **duhet (a lipset)**, e ndjekur nga një folje në pjesore ose në lidhore; **do** e ndjekur nga një folje në pjesore; **kam e jam**, të ndjekura nga forma e pashtjelluar e tipit **për të larë**. Me **mund** plus lidhore, shprehet modaliteti i mundësisë; me **do** plus pjesore shprehet modaliteti i detyrimit domosdoshmërisë e kështu me radhë. **Mund: *Për këtë mund të bëhen studime të mira; do: *Do shikuar e vërtetuar mirë lëvizjet e tij; kam: *kam për të festuar*****. Modaliteti mund të shprehet edhe me anë të togjeve të foljeve: si ***është e mundshme, është e nevojshme, është e domosdoshme***.

Nga krejt këta shembuj del që rëndësia paradigmatiche e së ardhmes në shqipe është akti që kryhet pas çastit të të folurit. Por e ardhmja ka edhe rëndësinë sintagmatike, e cila lidhet me të ardhmen hipotetike. Rëndësia hipotetike qëndron nëpërmjet kundërvënies: nga një nivel tjetër kohor, përkatësisht nga niveli i së tashmes, që do të thotë nga një nivel tjetër modal, përkatësisht nga kuptimi indikativ në kuptimin e kundërvënies me rëndësi hipotetike. Për shembull: ***Ai do të jetë në shtëpi. (Ai ndoshta është në shtëpi – supozim i së tashmes)***.

E ardhmja mund të imponohet edhe në urdhërore, gjë kjo që bëhet nëpërmjet formës modale, për shembull: ***Ju do të jeni të saktë!*** (urdhër). Kuptimi saktësohet në bazë të intonacionit thirrës, ndërsa i përshtatet numrit njëjës dhe shumës. Me këtë shihet se si e tashmja e urdhërores i shërben urdhërores të së ardhmes. Ndryshe nga e ardhmja, koha e ardhme e përparme merr për bazë parakohësinë e së ardhmes. Ajo themelohet duke u lidhur me kohën e ardhme, si rrjedhojë nga e tashme. P.sh., ***Ti do të më ngushëllosh, në rast se ke për t'i dëgjuar të gjitha***. Nëpërmjet kundërvënies kohore dhe modale qëndron edhe e kaluara, si: ***Ju do të keni dëgjuar***. Kundërvënia kohore në këto raste shënon lëvizjen nga e tashmja në të shkuarën e në të ardhmen, ndërsa mjetet shprehëse nuk kanë ndonjë ndryshim të madh. Kur jemi tek e ardhmja hipotetike, pra, shihet se ajo si pikënisje të ndërtimit ka çastin e të folurit.

Përfundime

Siç shihet edhe nga titulli, kryefjalë e këtij punimi është e ardhmja, përdorimi i saj si kohë gramatikore dhe si modalitet, Po kështu, e ardhmja është kundruar edhe nga aspekti i kundërvënies me kohët e tjera themelore, me të shkuarën dhe të tashmen. Janë prekur edhe pikënisjet e kësaj kohe. Për shembull, është parë se sa shpesh ndodh që foljet e përdorura në kohën e tashme e paraqesin të ardhmen, jo si kohë por si modalitet.

Gjithashtu, studimi ka nxjerrë në sipërfaqe se cila është rëndësia paradigmatiske dhe sintagmatike e së ardhmes, në çfarë forme shfaqet, sa është hipotetike, pse është e tillë, e kështu me radhë. Pos tjerash, koha e ardhme, edhe nga aspekti gramatikor i saj edhe nga aspekti i modalitetit është vërejtur se në cilat raste është epistemike dhe në cilat deontike, pse është ashtu e pse kështu, me cilat matje vërtetohet një diçka e tillë dhe ku ndahen kundërvëniet e tilla.

Këto dhe vlerime të tjera gjatë këtij punimi sforcojnë bindjen tonë se gjuha shqipe, si një gjuhë e lashtë e trungut indoevropian ka nevojë të hulumtohet dhe të studiohet shumë më tepër se deri në këtë kohë, si në aspektin e ligjësisë gramatikore ashtu edhe në atë të ligjëritimit në përgjithësi, me të cilën po merret shkenca e gjuhësisë së tekstit. Sido që të jetë, punimi **“Mbi disa funksione të kohës së ardhme të foljes në shqipen standarde”** nuk i ka vënë pikë kësaj çështjeje, por sadopak ka arritur të nxjerr fakte të rëndësishme të cilat, për më tepër se në gjithçka tjetër, çojnë në nxitjen e studiuesve të tjerë për t’u marrë e rimarrë me të ardhmen, por edhe me kohë të tjera, të cilat deri para pak vitesh, në një mënyrë, kanë qenë të ngurtësuara nëpër gramatika të gjuhës shqipe.

Bibliografi

Bokshi, B., *“Format e futurit të shqipes në raport me ato të gjuhëve ballkanike”*, në Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit (red. Rexhep Ismajli), ASHAK, Prishtinë, 2012.

Bokshi, B., *“Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes”*, botim i veçantë, ASHAK, Prishtinë, 2010.

“Gramatika e gjuhës shqipe”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1995

Ajeti, I., *“Historia e gjuhës shqipe (Morfologjia historike)”*, Shtëpia botuese “Rilindja”, Prishtinë, 1983.

Badallaj, I., *“Vështrim mbi tipat e formave foljore me vlerën e së ardhmes”*, (në: *Çështje të studimeve diakronike të shqipes*), ASHAK, Prishtinë, 2010.

Kastrati, J., *“Histori e gramatologjisë shqiptare 1635 – 1944”*, Shtëpia botuese “Rilindja”, Prishtinë, 1988.

Demiraj, Sh., *“Gramatikë historike e gjuhës shqipe”*, Shtëpia botuese “Rilindja”, Prishtinë, 1988.

Kelmendi, T., *“Kështjellat e Sintaksës (Kohë foljore dhe njësi tekstore)”*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2006.

Breu, W., “*Mood in Albanian*”, public in: B. Rothstein, R. Thieroff (eds.), *Mood in the Languages of Europe*, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins, 1984.

Palmer, F. R., “*Mood and Modality*”, second edition, Cambridge, 2001.

McShane, M., Nirenburg, S., Zacharski, R., “*Mood and Modality: Out of theory and into the fray*”, 2008.

Spahiu, A., “*Çështja e klasifikimit të modalitetit*”, artikull i botuar në www.shkenca.com, 2001.

ÇËSHITJE TË HOMONIMISË LIDHUR ME MËSIMDHËNIEN E GJUHËS ANGLEZE

Suela Mangelli

Përmbledhje

Trajtimi praktik i homonimisë gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies së gjuhës së huaj merr një rëndësi të veçantë. Këtu janë trajtuar me detaje të gjitha gabimet drejtshkrimore dhe kuptimore që nxënësit bëjnë, si rrjedhojë e paqartësisë që homonimia shkakton.

Përveç pasqyrimin të problemeve janë sugjeruar edhe disa qasje për një zgjidhje sa me efektive të tyre, edhe pse jemi të bindur se është thuajse e pamundur të gjejmë një metodë apo mënyrë të përsosur për t'u dhënë përgjigje pikëpyetjeve që lidhen me një çështje kaq problematike e te ndërthurura sa kuptimi apo dukuritë e lidhura me të.

Abstract

The practical analysis of homonymy during the process of teaching and learning a foreign language takes a special importance. Below are explained in detail all the spelling and meaning mistakes that students make, as the result of the confusion that homonymy causes.

In addition to reflecting the problems, there are also suggested several approaches for a more effective solution to them. We are convinced it is almost impossible to find a perfect method or way to answer the question related to such a problematic and complex issue as the meaning and phenomena related to it.

Fjalëkyç: homonimi, mësimdhënie, gjuhë angleze, qasje, vlerësim, testim, tekst, etj.

Hyrje

Çështja e homonimisë dhe e gjithë problematika e shqyrtuar në lidhje me të, nuk paraqet vështirësi vetëm për folësit e gjuhës amtare, qofshin të gjuhës angleze apo edhe shqipe. Homonimia dhe problemet e saj të qënësishme gjuhësore bëhen akoma edhe më të vështira për folësit e gjuhës së huaj. Ashtu sikundër mund të jetë në këtë rast gjuha angleze për studentët apo nxënësit që dëshirojnë ta mësojnë atë.

Kur flasim për leksikun e një gjuhe dhe se si fjalët e kuptimet që ato mbartin përdoren në kontekste të caktuara, një theks i veçantë i duhet vënë pikërisht çështjes së homonimisë. Kjo për arsye se përveç kuptimit, homonimia paraqet edhe disa vështirësi jo vetëm në lidhje me mënyrën se si shkruhen fjalët, por edhe si shqiptohen ato. Në varësi të shqiptimit apo ortografisë së fjalës homonimike, ndryshon edhe kuptimi i saj.

I. Klasifikimi i gabimeve

Gabimet në të shkruar, në fakt, nuk janë problematike vetëm për studentët e gjuhës së huaj, por edhe për ata që e kanë anglishten gjuhë amtare. Për këta të fundit, kjo vjen si rrjedhojë e pakujdesisë. Ndërsa për studentët e gjuhës së huaj lidhet me aftësitë e tyre për të aktivizuar njohuritë gjuhësore, në lidhje me shqiptimin apo shkrimin e fjalëve.

Rrjedhimisht gjatë mësimdhënies së gjuhës së huaj, mësuesit duhet të përdorin teknika e strategji të veçanta që studentët të jenë në gjendje të përballen me këto vështirësi. Meqënëse gjuha angleze është mjaft e pasur me homonime, mësuesit duhet të përballen me këto çështje që në hapat e para të përvetësimit të gjuhës. Ndërsa për nxënësit që e kanë anglishten gjuhë amtare, ky problem del gjatë klasës së tretë ose të katërt; për nxënësit e anglishtes si gjuhë e huaj, ky problem shfaqet më vonë. Gjithsesi, homonimet janë të pranishme, herët a vonë, mësuesit duhet të përballen me to.

Në përkufizimin e homonimisë, identifikua tre aspekte thelbësore të saj: formën, kuptimin dhe përkatësinë në kategorinë leksiko-gramatikore. Këto tre aspekte thelbësore të homonimisë duhet të orientojnë përgatitjen e metodave apo të përzgjedhjes së teknikave të mësimdhënies së gjuhës së huaj. Mospërputhja e formës grafemore me atë fonetike, në anglisht, është shpesh burim i gabimeve ortografike. Si për tëmos mjaftuar kjo, homonimia e vështirëson edhe më shumë situatën.

Studiues të ndryshëm janë përpjekur që të bëjnë një klasifikim të këtyre gabimeve ortografike, me qëllim që të nxjerrin disa përfundime dhe sugjerime lidhur me mënyrën e mësimdhënies së anglishtes. Kështu që mësuesit dhe nxënësit do t'ja dalin mbanë të zvogëlojnë numrin e gabimeve ortografike.

Shkrimi është një aktivitet gjuhësor, ku njësitë e gjuhës së folur shndërrohen në tekste të shkruara. Ai përfshin tre nivele të ndryshme informacioni gjuhësor: atë alfabetik, fonetik dhe semantik. Duke u bazuar në secilin prej këtyre niveleve gjuhësore, ne mund të bëjmë dhe klasifikimin e gabimeve ortografike në anglisht.

Një nga këto modele që lejon vlerësimin cilësor të gabimeve sipas kategorisë gjuhësore, njihet me emrin POMAS (Vlerësimi Fonologjik, Ortografik dhe Morfologjik i të Shkruarit). Sipas këtij modeli, gabimet në të shkruar klasifikohen sipas kategorive gjuhësore të fonologjisë, ortografisë dhe morfologjisë dhe më pas, identifikohen veçoritë më specifike brenda secilës kategori.

Për shembull, nëse lidhëza *anddelad*, ky lloj gabimi ortografik klasifikohet si fonologjik, pasi jo të gjithë tingujt janë përfaqësuar në shkrimin e fjalës. Ndërsa gabimi në të shkruar *triped* dhe *jotripped*, (dublimi i bashkëtingëllores pas zanoreve të patheksuara) quhet gabim ortografik, sepse struktura fonologjike është e sakte, por grafemat nuk janë paraqitur saktë. Gabimet në të shkruar të fjalëve homonimike, si *there – their*, *sea – see* kur ato ngatërrohen me njëra-tjetrën, i quajmë gabime ortografike me natyrë morfologjike, sepse këtu janë ngatërruar pjesët e ligjeratës.

Disa nga gabimet ortografike me natyrë morfologjike që hasen më shpesh përfshijnë ngatërrimin e prapashtesës 's të shumësit, me prapashtesën 's që është e barasvlefshme me rasën gjinore të shqipes apo përemrat pronore me format e tyre

homofonike, si për shembull: *its – it's, their – there, whose – who's* etj. Megjithatë shmangia e këtyre gabimeve mund të bëhet duke analizuar të gjitha rregullat gramatikore, si dhe kontekstin kuptimor.

Mëtej gabimet morfologjike mund të hasen edhe ndër fjalët shënuese, mbarsat e të cilave mbarojnë me /s/ ose /z/, për shembull në anglisht fjala *tax – “takse”* mund të ngatërrohet me *tacks*; ose fjala *raise – me rays – “rreze”*.

Fjalët e përbëra si *whalebone – “dhëmb balene”*; *copyright – “e drejta e autorit”*; *forehead – “balli”* dhe *busyness – “i zënë me punë”* mund të ngatërrohen përkatësisht me fjalët e thjeshta homofonike si *wail – “vajtim”*, *write – “shkruaj”*, *for – “për”* dhe *business – “biznes”*.

Ka edhe raste kur nxënësit nuk bëjnë gabimet ortografike të identifikuar më lart; ata e përdorin fjalën e duhur, por në kontekstin e gabuar. Këtë mund ta ilustrojmë me dialogun e mëposhtëm:

A man was holding in hand some pine cones and asked a child:

- *What are these?*
- *Cones- the child replied*
- *And, where do you get them?*
- *In the ice-cream shop*

Fjala e cila shkakton paqartësi në këtë rast është *cone*, e cila në fjalët e përdorura *pine cone* dhe *ice-cream cone* do të thotë përkatësisht, boce pise dhe kaush akulloreje. Në shëmbullin e mësipërm, fëmija i di të dyja kuptimet e kësaj fjale, por ai nuk ipërdor në kontekstin e duhur.

Prania e problemeve që nxënësit hasin në të shkruar dhe konfuzioni që mund të shkaktohet me kuptimet, kërkon një zgjidhje. Edhe pse në mësimdhënie asnjëherë nuk kemi një metodë apo një teknikë të vetme si zgjidhjen më të mirë, mund të ofrojmë disa sugjerime apo mënyra për të arritur ngulitjen dhe përvetësimin e kësaj dukurie gjuhësore. Me qëllim që gabimet ortografike të shmangen, mësuesit duhet t'i kushtojnë vëmendje si ortografise ashtu edhe kuptimit, si edhe të jape sa më shumë shembuj që të jetë e mundur. Duke qënë me shumë të informuar për ekzistencën e këtyre çifteve apo grupeve homonimike, ka më shumë gjasa që gabimet të reduktohen dhe fjalët e kuptimet të përdoren në kontekstin e duhur.

Një nga arsyet pse kërkojmë ngulitjen e këtyre dukurive nëpërmjet dhënies së shembujve sa më të shumtë apo duke tërhequr vëmendjen herë pas here ndaj problematikave të homonimisë, është se në metodat e mësimdhënies që përdoren në shkollat e mesme, çështja e homonimisë nuk del dhe aq shpesh. Në pjesën më të madhe të rasteve, ato vijnë në formën e një grimce humoristike apo loje fjalësh në fund të kapitullit. Në këtë mënyrë mësuesi ka shumë pak hapësirë që të shjtellojë më tej këtë çështje.

Po citojmë disa prej tyre:

- *I know someone who whistles at work*
- *He must like his job a lot*
- *No, he's a traffic warden.*

- *Why did you park your car there*
- *Well, there was a sign saying, "Fine for parking".*
- *I took a trip to Paris last week.*
- *Oh, what a shame! Did you hurt yourself?*

Në mësimdhënie, nuk mund të flitet për metodën e duhur apo metodat më të mira, pasi çdo gjë varet nga situata, nga materialet që mësuesi përdor në klasë, nga njohuritë gjuhësore që ka studenti, si dhe nga aftësitë e një mësuesi.

II. Qasje të ndryshme në mësimdhënien e homonimisë

Mësimdhënia e homonimisë përfshihet brenda çështjeve të mësimdhënies që kanë të bëjnë me fjalorin e gjuhës angleze. Çdo qasje ndaj përvetësimit të fjalorit, ka sfidat e saj, pasi kemi të bëjmë me një fjalor të gjerë dhe është e pamundur të arrihet përvetësimi i tij në një shkallë të përkryer. Megjithatë, theksi vihet në përfshirjen sa më aktive të nxënësit gjatë mësimdhënies, por edhe ndërgjegjesimin e mësuesit ndaj kësaj çështjeje.

Numri i çifteve apo vargjeve homonimike në anglisht është mjaft i madh, çka e vështirëson më shumë punën e mësuesit. Në çdo moment ata mund të gjenden para një vështiresie të tillë, që kërkon jo vetëm përzgjedhjen e fjalës së duhur, por edhe kuptimin e saj të saktë në kontekstin e duhur.

Për këtë arsye mund të sugjerojmë disa mënyra të ndryshme se si mësuesit mund t'i qasen homonimeve:

II.1Përdorimi i teksteve të leximit

Nxënësve u jepet një tekst që përmban të paktën 10 – 15 homonime. Pasi e lexojnë tekstin, ata mund të jenë në gjendje t'i identifikojnë homonimet, ndërsa për ata që janë te një nivel më të ulët, s'do të ishte më mire që mësuesi t'ua nënvizonte homonimet.

Pas leximit dhe identifikimit të homonimeve, mësuesi fillon diskutimin në klasë për nxjerrjen e kuptimit të tekstit në përgjithësi dhe më pas diskutohen kuptimet e homonimeve. Nxënësit inkurajohen që të gjejnë fjalën tjetër homonimike ose sa më shumë homonime që të jetë e mundur me këtë fjalë. Ato mund të jenë homografe ose homophone. Në këtë mënyrë, ata praktikojnë shqiptimin, shkrimin, por edhe aftësohen për të bërë dallimet kuptimore ndërmjet këtyre fjalëve kaq të ngjashme për nga forma, por shumë larg njëra-tjetrës për nga kuptimi.

Deri më tani, mësuesi dhe nxënësit janë njohur me dy aspektet e homonimisë, formën dhe kuptimin. Ata mund të njihen edhe me aspektin e tretë të tyre, përkatësinë leksiko-gramatikore. Në këtë fazë, mësuesi së bashku me nxënësit, bëjnë klasifikimin e homonimeve dhe çifteve të gjetura sipas pjesëve të ligjeratës.

Së fundi, mësuesi u ofron nxënësve mundësinë që të praktikojnë e përvetësojnë njohuritë e sapofituara, duke përgatitur disa fjali me vende bosh, kështu që nxënësi të shkruajë homoniminë e duhur; ose nxënësit fillojnë dhe i përdorin homonimet në

kontekst, duke formuar fjali apo duke krijuar tekste, si aktivitet që mund të zhvillohet në grupe.

II.2Përdorimi i lojës së fjalëve / gjëagjësive

Përdorimi i lojës së fjalëve dhe gjëagjësive është një aktivitet argëtues dhe zbavitës, si rrjedhojë e dykuptimisë që krijohet nga homonimet. Para se mësuesit të përdorin këto aktivitete, ata duhet të sigurohen që nxënësit i dinë tedy kuptimet e homonimeve. Këtu mund të përfshihen aktivitete të ndryshme për të ilustruar dykuptimin e shkaktuar.

Nëpërmjet lojës së fjalëve dhe gjëagjësive, nxënësit analizojnë kuptimin e homonimeve brenda kontekstit, si dhe efektin që ato shkaktojnë. Në lidhje me ushtrimet që mund të përdoren, mësuesi mund të sjellë fillimisht disa gjëagjeza apo shembuj me lojën e fjalëve ose nxënësve mund t'u kërkohet të gjejnë e të sjellin edhe ata shembujt e tyre.

II.3Përdorimi i këngëve / poezisë

Mësimdhënia e gjuhës së huaj nëpërmjet poezisë dhe këngës është një art më vete. Përdorimi i këngëve dhe poezisë gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, është më i këndshëm dhe më i efektshëm. Kjo për shkak të natyrës mbresëlënëse të melodisë, duke ngulitur më mirë strukturat gramatikore dhe fjalorin tek nxënësit.

Nëpërmjet muzikës dhe poezisë përçohen edhe shumë faktorë shoqërorë, kulturorë dhe poetikë të gjuhës së huaj, të cilat përbëjnë materiale autentike që në mënyrë të natyrshme transmetojnë dhe pasqyrojnë kulturën e asaj gjuhe. Mësuesit që e kanë përdorur këtë metodë, kanë vërejtur se nxënësit janë më të vëmendshëm dhe ju jepet mundësia që të argëtohen përveçse të mësojnë.

Mësuesi e fillon këtë aktivitet duke i njohur nxënësit me këngën apo poezinë që ka zgjedhur, e cila duhet të jetë e përshtatshme jo vetëm për nga përmbajtja, por edhe në përputhje me nivelin gjuhësor të studentëve.

Një model të tillë po japim më poshtë:

Këngë Poezi

Homonyms The Earthquake

I saw *Jim* As if with an *ax*,

Earth breaks and hides my *acts*

In the *gym* - The broken dirt's *effects*

I heard *him* - Will always my mind *affect*

Sing a *hymn* - Was I only *two*?

Have you ever *heard* - Well, I was suffering *too*.

A cattle *herd*? - At least love's grip *tightened*

For words like that - Even against a fallen *titan*.

Here is a word - Although the soil was *thrown*
 Refrain: In its place was God's *Throne*
 They're called homonyms - For even when life is a *stile*
 Not antonyms I get by with my own *style*.
 Not synonyms
 I'm talking about homonyms
 I was *weak*
 For an entire *week*
 'Til I got to *meet*
 A piece of *meat*
 Then I *ate*
 At a little past *eight*
 The cheese I *grate*
 It tasted *great*
 Refrain:

Gjatë dëgjimit të këngëve dhe poezive, nxënësit ushtrohen edhe në shqiptimin e fjalëve duke u kushtuar vëmendje dhe mënyres se si ato janë shkruar, vecanërisht homofoneve. Nxënësit marrin vargjet e shkruara që të gjejnë sa më shumë homonime dhe të diskutojnë kuptimet dhe dallimet ndërmjet çifteve homonimike.

III. Vlerësimi si pjesë e procesit të mësimdhënies/nxënies

Pjesë e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies është edhe vlerësimi. Ai luan një rol të rëndësishëm në çdo aspekt të mësimin të gjuhës së huaj. Nëpërmjet vlerësimit identifikohet niveli i nxënësve, monitorimi i progresit të tyre, përvetësimi i metodave dhe teknikave në mësimdhënie.

Një nga mënyrat e vlerësimit është edhe testimi. Më poshtë po japim disa nga tipet e ushtrimeve që mund të përdoren gjatë një testi mbi homonimet:

I. **Homonym meanings.** Write the letter of the correct meaning in the blank in front of the homonym.

_____ die	A. to color
_____ dye	B. to stop living

II. **Homonym editing.** Read this paragraph and identify the homonyms. Underline the ones that are used correctly and give their meanings. If wrong homonyms are used, write their correct spelling.

Daddy says there was a king who rained four 40 years. Sometimes mommy says all we get in the mail are big bills. My big sister is getting married and she says I can hold up her train. Daddy says we should live in the present. I've heard mommy speak about the blue prints for the knew room in our house. Daddy says some boars are coming to dinner. Did you ever hear such a bunch of fairy tails?

III. Matching homonyms. Write the homonym for each word.

- | | |
|---------------|----------------|
| 1. Buy _____ | 3. Horse _____ |
| 2. Deer _____ | 4. Been _____ |

IV. Fill in the homonyms. See if you can think of two homonyms to complete each sentence.

1. During class, we are not _____ to speak _____. (allowed, aloud)
2. At _____ o'clock we _____ our meal. (eight, ate)

Më tej, disa hapa të tjerë që mësuesit mund të ndjekin gjatë mësimdhënies janë edhe përdorimi imjeteve pamore. Dhënia e informacionit nëpërmjet kanaleve të ndryshme ndihmon në përvetësimin e materialit, i cili merret në forma të ndryshme.

Gjithsesi, homonimet duhet të jepen brenda kontekstit dhe nxënësve ju kerkohet që të japin shembujt e tyre, se sa vetëm të memorizojnë përmendësh një listë fjalësh.

Këngët, poezitë, gjeagjëzat, grimcat humoristike dhe loja e fjalëve përbushin këtë qëllim më së miri. Studentët janë më të përkushtuar gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies; kjo metodë ju jep atyre mundësinë ta përvetësojnë më lehtë mësimin, ndërkohë edhe argëtohen e zbaviten.

Përfundime

Homonimet ekzistojnë në gjuhë në çifte ose në vargje dhe kjo është mënyra më e mirë për t'i mësuar ato. Por pavarësisht nga metodat dhe materialet që përdoren gjatë mësimdhënies, nëse homonimet nuk përsëriten shpesh, atëherë ato mund të harrohen. Një fjalë mund të ruhet në memorjen afatgjatë vetëm pasi ka kaluar disa pengesa dhe filtra. Përsëritja, ushtrimi dhe përdorimi i fjalëve në kontekst, mund të ndihmojë në kapërcimin e këtyre pengesave.

Mësimdhënia dhe nxënia e fjalorit duhet të përfshijë me cdo kusht edhe ato fjalë që shkaktojnë dykuptimësi, ku kuptimet e ndryshme duhet të jepen në mënyrë të qartë së bashku me shembujt përkatës.

Bibliografia

Dempere, J., (2008), *"The Practice of Poetry"*

Delija, Sh., Tabaku, E. (2009), *"Language Teaching Methodology: Assessment and Testing"*

Doherty M. J., (2004), *"Children's difficulty in learning homonyms"*, 2004, Cambridge University Press

Dooley, J., Evans V. (2007), *"Blockbuster 3"*, Express Publishing

Dooley, J., Evans V. (2007), *"Blockbuster 3"*, Express Publishing

Evans V., Dooley J. (2008), *"Wishes B2.1"*, Express Publishing

Jacobson, J., Lapp, D., Flood, J. (2007), *"A seven-step instructional plan for teaching homonyms"*, International Reading Association

Julia, S. (1981), *"Teaching ESL Through American Songs"*

Parks, J., Corbet, S. (2008) *"Homonym Test"*

Perfetti, C.A., Rieben L., Fayol, M. (1997), *Learning to spell: Research, theory and practice across languages*

Wood, C., Connelly, V. (2009) *Contemporary Perspectives on Reading and Spelling*, Routledge

"English Homonyms", <http://www.lessonsips.com/does/pdf/learnhomonyms.pdf>

Crow, D., (2002-2010), <http://www.songsforteaching.com/dancrow/homonyms.htm>

"Humorous Homonym Sentences"

<http://www.hse.k12.in.us/staff/rvanlandingham/Documents/Vocabulary/Humorous%20Homonym%20Worksheet.pdf>

<http://smith9h0708.blogspot.com/2008/03/homonym-poem.html>

<http://www.hipark.austin.isd.tenet.edu/mythology/homotest.html>

“TOGFJALËSHI I QËNDRUESHËM” NË FJALORË (ANGLISHT DHE ANGLISHT-SHQIP) PËR STUDENTËT SHQIPTARË

Suela Pici (Koca)

Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti
“F. S. Noli”

Permbledhje

Ky punim synon të trajtojë në mënyrë të përmbledhur ato lloj dukurish, që në një farë mënyre, për studentët që mësojnë anglishten si gjuhë të huaj gjithmonë kanë qenë të vështira në fushën e gjerë të frazeologjisë dhe sintaksës. Trajtimi i përgjithshëm i llojeve të ndryshme të “togfjalëshave të qëndrueshëm” është mbështetur te të dhënat e vjela nga fjalorë një- dhe dy-gjuhësh të anglishtes dhe shqipes. Fokusi i secilit prej fjalorëve është vlerësuar duke hulumtuar 70 njësi të përzgjedhura sipas kategorive të ndryshme. Rezultatet janë komentuar dhe krahasuar me kujdes. Në fund të punimit jemi përpjekur të nxjerrim disa përfundime në lidhje me ndihmën e këtyre fjalorëve për studentët si dhe disa mendime modeste për ndryshime të mundshme.

Fjalë kyce: *togfjalësh i qëndrueshëm, frazeologji, sintaksë, fjalorë, anglisht, shqip*

Abstract

The aim of this study is to treat some phenomena in the field of phraseology and syntax. These are difficult for learners of English as a second language. The general treatment of different types of “set phrases” is based on the data collected from mono- and bilingual dictionaries of English and Albanian. The focus of each of the dictionaries is estimated by checking 70 selected items according to several categories. The results of our research are carefully compared and commented. In the end, we have tried to draw some conclusions related with how much these dictionaries offer for English learners on these fields. We have also expressed our modest ideas for any possible improvement.

Key words: *set phrase, phraseology, syntax, dictionaries, English, Albanian.*

Hyrje

“Togfjalëshat e qëndrueshëm” të llojeve të ndryshëm, qoftë me kuptim të figurshëm ose jo, janë bërë objekt studimi i shumë studiuesve të huaj dhe shqiptarë. Pavarësisht numrit të madh të studimeve dhe hulumtimeve, këta togfjalësha gjithmonë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të vështirë për t’u kuptuar, interpretuar dhe përvetësuar nga studentët. Akoma më vështirë bëhet përvetësimi i tyre në gjuhë të huaj. Si mund t’i zbulojnë dhe përvetësojnë këta togfjalësha studentët tanë? Meqë burim kryesor për mësimin e një gjuhe të huaj mbeten fjalorët, qofshin këta një- apo dy-gjuhësh edhe shtysën për trajtimin e kësaj çështjeje e mora nga punimi “Richard J. Aleksandër (Richard J. Alexander); *Fixed expressions, idioms and phraseology in recent English*

learner's dictionaries”, [2]i cili është ndër autorët e parë që hulumtoi se çfarë vendi zë frazeologjia në fjalorë të ndryshëm të anglishtes.

Punimi ynë nuk kufizohet vetëm në fjalorë një-gjuhësh të anglishtes, por edhe në fjalorë dy-gjuhësh anglisht dhe shqip sepse, herët a vonë, studentët tanë gjithmonë duhet nevojën për të përkthyer në shqip një fjalë, togfjalësh apo shprehje të panjohur dhe të pakuptueshme për ta.

Në fillim të këtij punimi parqiten kategoritë e togfjalëshave të qëndrueshëm që do të hulumtohen (10 njësi për çdo nga 7 kategoritë) duke shpjeguar shkurt edhe arsyet përse janë përzgjedhur. Më pas përshkruhen edhe fjalorët që kemi hulumtuar si edhe mundësitë që ofrojnë këta fjalorë për të kuptuar sa më mirë kategoritë e togfjalëshave të përzgjedhur si edhe terminologjinë e përdorur në secilin prej tyre në lidhje me çështjen që na intereson.

Të dhënat e grumbulluara jepen të gjitha në tabela me komentet përkatëse për secilën prej tyre. Në fund të punimit jemi përpjekur të nxjerrim disa përfundime për vlerën e këtyre fjalorëve në fushën e frazeologjisë dhe të japim mendimet tona modeste për ndryshime apo përmirësime të mundshme.

I. Përshkrimi i togfjalëshave të qëndrueshëm të hulumtuar

Nëse u referohemi autorëve të ndryshëm, qoftë të huaj apo shqiptarë, vërejmë se ata përfshijnë një numër kategorish që mund të konsiderohen si “togfjalësha të qëndrueshëm”. Këtu përfshihen edhe “njësitë frazeologjike”. Studentët që mësojnë një gjuhë të huaj, edhe kur janë të një niveli të përparuar, hasin mjaft vështirësi në përvetësimin e këtyre njësive. Pavarësisht nga klasifikimet e ndryshme, në punimin tonë, ne do të shqyrtojmë vetëm një pjesë të togfjalëshave të qëndrueshëm që ne mendojmë se studentët i hasin më shpesh dhe u duhet t’i përdorin më shpesh.

Në mënyrë të përmbledhur po japim kategoritë që do të trajtojmë duke përmendur edhe pse i kemi zgjedhur: [3], [4]

- 1) *Foljet frazale* janë togje që përbëhen nga një folje dhe një ose më shumë para-fjalë ose pjesëza ndajfoljore. Ato janë shumë të vështira për studentët shqiptarë sepse në shqip nuk kemi të tilla. Shpesh edhe anglishtfolësit përpiqen t’i shmangin, por kjo nuk është zgjidhje sepse këto konstrukte janë tipike në ligjërimin e folur. Jo të gjitha foljet frazale janë idiomatike dhe disa janë më idiomatike se të tjerat. Disa prej tyre mund të kenë më shumë se një kuptim. [4] Ne kemi kemi përzgjedhur disa folje që janë idiomatike, por edhe shumë të përdorshme prandaj studentët shqiptarë duhet t’i njohin ato. Në kllapa kemi dhënë edhe numrin e kuptimeve që kanë disa prej tyre.
- 2) *Togfjalëshat e qëndrueshëm jofrazeologjikë* përbëhen nga kombinime fjalësh si folje + emër, emër + folje apo mbiemër + emër etj. Një student mund të njohë një numër të madh fjalësh, por mund të mos jetë në gjendje t’i përdorë si duhet për të formuar këto togje tipike të anglishtes. Nëse këta togfjalësha hasen dhe përdoren shpesh, mund të bëhen pjesë aktive e fjalorit të gjithkujt. [4]

- 3) *Togfjalëshat e qëndrueshëm frazeologjikë* nuk janë pjesë e ndarë e gjuhës, të cilët dikush mund të zgjedhë t'i përdorë ose t'i shmangë. Në fakt, ata janë një pjesë e rëndësishme e leksikut të gjuhës dhe përdorimi i tyre mund të na tregojë se si gjuha ndryshon dhe zhvillohet. [4] Përdorimi i tyre e bën ligjërimin, qoftë të shkruar apo të folur më të bukur dhe interesant. Këta togfjalësha i kemi ndarë në dy nëngrupe: ata që janë të ndryshëm nga shqipja dhe ata të ngjashëm me shqipen.
- 4) *Togfjalëshat e qëndrueshëm frazeologjikë të ngjashëm me shqipen*, jo pa qëllim i kemi klasifikuar më vete. Kjo ndarje është bërë për të parë raportin midis dy nëngrupeve në fjalorët një-gjuhësh të anglishtes dhe në fjalorët dy-gjuhësh anglisht dhe shqip.
- 5) *Togfjalëshat e qëndrueshëm me emra të përveçëm* përbëhen nga kombinime mbiemër + emër që gjithmonë shkruhen me shkronjë të madhe dhe kanë vlerën e një emri të përveçëm. Këtu nuk kemi përfshirë emra gjeografikë, por emra të veçantë për koncepte, objekte, vende, etj. , që kanë një kuptim të veçantë në anglisht [4] dhe që nuk mund të merren me mend nga studentët, pavarësisht se disa prej tyre janë përkthyer fjalë për fjalë në shqip dhe shënojnë koncepte të njëjta si *the Promised Land (Toka e Premtuar)* apo *the Third World (Bota e Tretë)* etj.
- 6) *Proverbat (thënie)* apo *fjalët e urta* kemi përfshirë në hulumtimin tonë pavarësisht se kanë strukturën e një fjalie dhe jo të një togfjalëshi. Edhe A. P. Kau (Cowie) i quan ato me të drejtë “*set sentences*” [3] (fjalë të qëndrueshme). Ato janë pjesë e fjalorit të përditshëm të gjuhës dhe, në fakt, bisedat tona pa to do të ishin të mërzitshme. Shumë prej proverbave janë marrë nga Bibla, Shekspiri dhe shumë autorë të tjerë. Ato janë pranuar nga folësit për vlerat universale që lidhen me përvoja të jetës së përditshme. [4] Proverbat që ne kemi përzgjedhur janë shumë të përdorshme dhe disa prej tyre përdoren edhe në shqip të huazuara nga anglishtja, si: *All that glitters is not gold (Jo gjithçka që shkëlqen është ar)* apo *All roads lead to Rome (Të gjitha rrugët të shpien në Romë)* etj. Por kemi edhe të tjera që nuk janë përkthime të drejtpërdrejta, fjalë për fjalë, por që japin mesazhe të njëjta, si: *A bird in the hand is worth two in the bush (më mirë një vezë sot sesa një pulë mot)*, apo *don't make a mountain out of a molehill (mos e bëj qimen tra)*, e shumë e shumë të tjera.
- 7) *Formula në ligjërimin e folur (speech formulae ose 'gambits')* ku përfshihen shprehje në formën e një togfjalëshi apo fjalie të qëndrueshme që përdoren për të transmetuar vlerësimin e folësit ndaj të tjerëve dhe mesazheve të tyre si edhe përgjithësisht, për ta bërë rrjedhën e ligjërimit më të lehtë. Këto formula të gatshme janë shumë të domosdoshme dhe janë gjithmonë pjesë e një ndërveprimi verbal. [3] Për këto arsye, studentët duhet t'i njohin mirë për t'i përdorur ku dhe kur duhet për të shmangur keqkuptimet.

II. Fjalorët

Fjalorët mbeten gjithmonë një burim parësor në mësimin e një gjuhe të huaj. Në gamën e gjerë të fjalorëve për mësimin e anglishtes, ne kemi zgjedhur për të hulumtuar vetëm katër prej tyre, nga të cilët dy janë një-gjuhësh dhe dy të tjerët janë dy-gjuhësh anglisht dhe shqip. Nëpërmjet hulumtimit do të mund të shohim konkretisht se çfarë vendi zënë kategoritë e mësipërme të “togfjalëshave të qëndrueshëm” në secilin prej këtyre fjalorëve dhe çfarë u ofrojnë studentëve shqiptarë për t’i përvetësuar sa më mirë këto kategori. Më poshtë po japim një përshkrim të shkurtër të informacionit që fjalorët japin në lidhje me çështjen në fjalë.

2.1 Terminologjia dhe pritshmëritë metalinguistike

CIDOE në fillim (ix) jep informacion për gjetjen e njësive (fjalë apo togfjalësha e shprehje).[7] Duke iu referuar pjesës për togfjalëshat e shprehjet fillimisht jepet përkufizimi ‘some phrases and combinations of words have a special meaning which is not clear from the meanings of the separate words’ (disa togfjalësha e kombinime fjalësh kanë një kuptim të veçantë që nuk është shumëi qartë nga kuptimi i fjalëve tëveçanta). Pastaj, shpjegon se në fund të fjalorit mund të gjendet indeksi për togfjalëshat (f. 1708-1771) ku jepet faqja dhe rreshti në të cilin mund të gjendet togfjalëshi. Duhet të përmendim se në fjalor jepet vetëm termi për foljet frazale (phrasal verbs) si kategori më vete, kurse kategoritë e tjera thjesht përfshihen në termin ‘togfjalësh’.

WNWD gjithashtu jep informacion për gjetjen e njësive në fjalor (xii-xvi) dhe në një ndarje të veçantë jep informacion për ‘togfjalëshat idiomatike’ (idiomatic phrases) se si mund të gjenden, por pa dhënë asnjë përkufizim apo kategori më vete (xvi).[6]

FASH 1 jep udhëzime për përdorimin e fjalorit në përgjithësi (viii-xiv) dhe në një ndarje të veçantë (x-xi) jep informacion për gjetjen e grupit të idiomave, proverbave dhe togfjalëshave me përdorim të posaçëm, pa dhënë ndonjë përkufizim.[8]

FASH 2, nga ana tjetër, nuk jep aspak udhëzime për përdorim, por në parathënieën e fjalorit duke përmendur vlerat e tij, krahas të tjerave ai shprehet se ky fjalor “...ofron një paraqitje më të plotë se deri më sot të anglishtes së Amerikës, një trajtim të gjerë të foljeve me parafjalë, si dhe një mori togfjalëshash e shembujsh, duke përfshirë shprehjet idiomatike dhe frazat e ngurtësuar” (v). [5]

Me sa mund të vihet re nga ky prezantim paraparak i fjalorëve shohim se CIDOE është më i lehtë në përdorim, vetëm se ndonjëherë, duke mos përdorur termat ‘idiom’ apo ‘phrasal verb’ për të përshkruar togfjalëshat e ndryshëm, nuk është shumëi qartë. Shpesh në të gjejmë të përdorur ‘saying’ për të përshkruar proverbat. Një fakt tjetër pozitiv është edhe dhënia e shembujve konkretë për të ilustruar kuptimet e dhëna, gjë që nuk e gjejmë te fjalorët e tjerë. Nga ana tjetër, WNWD është më pak i qartë në përdorim dhe terminologji. FASH 1 dhe 2 janë shumë të vlefshëm sepse japin variantin shqip të togfjalëshave apo shprehjeve, por nuk japin informacion në lidhje me terminologjinë.

III. Përshkrimi i hulumtimit dhe analiza e të dhënave

Në pjesën në vijim do të paraqesim të dhënat e hulumtimit tonë duke e paraqitur secilën prej kategorive në tabela të veçanta. Për t'i kuptuar dhe interpretuar më lehtë të dhënat po japim edhe simbolet e përdorura. Për çdo kategori kemi përzgjedhur nga 10 njësi.

Simbolet e përdorura: + = gjendet p. sh. = vetëm si shembull
0 = nuk gjendet ? = formë e ngjashme

Tabela 1: Foljet frazale

Fjalorët e përdorur	CIDOE	WNWD	FASH 1	FASH2
1 Foljet frazale	10/10	9/10	9/10	9/10
1 ask after (someone)	+	?	+	+
2 bear (something) out	+	+	+	+
3 break down (4)	+	+	+	+
4 call by	+	0	0	0
5 carry on (4)	+	+	+	+
6 come across (someone/thing)	+	+	+	+
7 get along (4)	+	+	+	+
8 go off (4)	+	+	+	+
9 look out	+	+	+	+
10 make (something) up (5)	+	+	p. sh.	+

Siç mund të shihet nga të dhënat, foljet frazale gjenden të gjitha në CIDOE, madje edhe në të gjitha kuptimet. Duket se vetëm 'call by' nuk gjendet në tri fjalorët e tjerë. Kjo gjë tregon se ato janë shumë të përdorshme, prandaj edhe autorët janë të kujdesshëm t'i përfshijnë ato nëpër fjalorë për t'i ndihmuar studentët dhe këdo që mëson një gjuhë të huaj.

Tabela 2: Togfjalësja të qëndrueshëm (jofrazeologjikë)

Fjalorët e përdorur	CIDOE	WNWD	FASH 1	FASH2
2 Togfjalësja të qëndrueshëm	10/10	7/10	6/10	8/10
1 gain entry	+	0	0	?
2 concede defeat	+	?	+	0
3 suffer a shock	?	0	0	0
4 a blind alley	+	+	+	+
5 a golden opportunity	+	+	+	+

6 a narrow escape	+	+	+	?
7 burn one's fingers (fig.)	+	+	+	+
8 change one's mind (fig.)	+	+	+	+
9 hold a view	p. sh.	0	0	+
10 keep a secret	+	+	0	+

Edhe për këtë kategori CIDOE duket se është më gjithëpërfshirëse, pavarësisht se 'suffer a shock' gjendet si 'suffer from a shock', kurse në fjalorët e tjerë nuk gjendet aspak. Edhe 'hold a view' gjendet vetëm i përdorur si shembull, pa i dhënë shpjegimin. WNWD togun 'concede defeat' e jep në formë tjetër 'acknowledge defeat'. Kurse 'gain entry' na jepet në formën 'gain entry to' në FASH 2 dhe, po aty, 'a narrow escape' na jepet me folje 'have a narrow escape'.

Tabela 3: Togfjalësha të qëndrueshëm (frazologjikë)

Fjalorët e përdorur	CIDOE	WNWD	FASH 1	FASH2
3 Togfjalësha të qëndrueshëm (frazologjikë)	9/10	10/10	10/10	10/10
1 let the cat out of the bag	+	+	+	+
2 kick the bucket	+	+	+	+
3 show the white feather	0	+	+	+
4 once in a blue moon	+	+	+	+
5 play truant	+	p. sh.	+	?
6 a white elephant	+	+	+	+
7 pull someone's leg	+	+	+	+
8 burn the midnight oil	+	+	+	+
9 red tape	+	+	+	+
10 smell a rat	+	+	+	+

Po ashtu si foljet frazale edhe kjo kategori duket se gjendet në të katër fjalorët. Duket se i vetmi togfjalësh që mungon te CIDOE është 'show the white feather'. Te WNWD kemi përdorimin e 'play truant' vetëm si shembull, dhe te FASH 2 na shfaqet në formën 'play truant from the office'.

Tabela 4: Togfjalësha të qëndrueshëm (frazologjikë) të ngjashëm me shqipen

Fjalorët e përdorur	CIDOE	WNWD	FASH 1	FASH2
4 Tog. të qënd. (fraz.) të ngjashëm me shqipen	9/10	6/10	9/10	6/10
1 (a) the black sheep	+	+	+	0

2 have butterflies in one's stomach	+	?	+	?
3 a wolf in sheep's clothing	+	+	+	+
4 (a) white lie	+	+	+	+
5 be all ears	+	+	+	+
6 roll one's sleeves up	?	0	?	0
7 read between the lines	+	+	+	+
8 lose the thread of	+	0	?	0
9 (the) new rich	0	0	+	0
10 keep one's word	+	0	0	+

Nga këta togfjalësha shohim se '*the new rich*' është më pak i përdoruri. Na tërheq fakti që atë e gjejmë në një fjalor të shqipes dhe jo në të anglishtes. Edhe 'roll one's sleeves up' ose nuk e gjejmë fare ose e gjejmë në formën 'roll up one's sleeves'. 'Keep one's word', e cila është më pak idiomatike se të tjerat gjendet vetëm në dy prej fjalorëve, kurse 'have butterflies in one's stomach' e gjejmë edhe pa 'have' ose si 'get butterflies in one's stomach'. Edhe 'lose the thread of' e gjejmë vetëm te CIDOE dhe në formën 'lose the thread of one's discourse' te FASH 1.

Tabela 5: Togfjalësha të qëndrueshëm me emra të përveçëm

Fjalorët e përdorur	CIDOE	WNWD	FASH 1	FASH2
5 Tog. të qënd. me emra të përveçëm	9/10	7/10	8/10	6/10
1 the Big Four	0	0	0	0
2 Father Christmas	+	0	+	+
3 (a) the Golden Age	+	+	+	+
4 Good Friday	+	+	+	0
5 John Bull	+	+	+	0
6 (the) Promised Land	+	+	+	+
7 (the) Third World	+	+	+	+
8 Tin-Pan Alley	+	0	+	0
9 Uncle Sam	+	+	+	+
10 (the) Yellow Pages	+	+	0	+

Në këtë kategori togfjalëshash shohim se nuk kemi tjetërsim forme, ato i gjejmë ashtu si përdoren dhe pa ndryshime. '*The Big Four*' është i vetmi që nuk e gjejmë në asnjë fjalor. Ndoshta kjo lidhet me kuptimin e tij, pasi është vetëm britanik sepse i referohet katër bankave kryesore në Britaninë e Madhe. Më habit paksa fakti që 'the Yellow Pages' nuk gjendet te FASH 1 pasi edhe në shqip përdoret po kështu.

Tabela 6:Proverba (thënie) ose fjalë të urta

Fjalorët e përdorur	CIDOE	WNWD	FASH 1	FASH2
6 Proverba (thënie) ose fjalë të urta	9/10	2/10	9/10	4/10
1 All roads lead to Rome	+	0	+	+
2 All that glitters is not gold	+	0	+	+
3 Barking dogs seldom bite	0	0	+	0
4 A bird in the hand is worth two in the bush	+	0	?	+
5 Clothes do not make the man	?	0	?	0
6 Cut your coat according to your cloth	+	0	0	0
7 Don't count your chickens before they hatch	+	?	+	0
8 Don't make a mountain out of a molehill	?	?	?	+
9 Necessity is the mother of invention	+	0	+	0
10 Too many cooks spoil the broth	+	0	+	0

Proverbat i gjejmë pothuajse të gjitha te CIDOE dhe FASH 1, kurse te dy fjalorët e tjerë duket se nuk i gjejmë shumicën e tyre. Te FASH 1 këto emërtohen si fjalë të urta. Duket se ‘Barking dogs seldom bite’ nuk gjendet te fjalorët e anglishtes. Po ashtu ‘Cut your coat according to your cloth’ gjendet vetëm te CIDOE. ‘Clothes do not make the man’ e gjejmë edhe në formën ‘It's not the coat that makes the man’. ‘Don't make a mountain out of a molehill’ e gjejmë edhe pa foljen ‘don't’.

Tabela 7:Formula të ligjëritimit të folur

Fjalorët e përdorur	CIDOE	WNWD	FASH 1	FASH2
7 Formula të ligjëritimit të folur	8/10	4/10	5/10	7/10
1 I beg your pardon?	+	+	+	+
2 Are you with me?	0	0	0	0
3 You know what I mean?	+	0	0	0
4 Call it what you like	0	0	0	0
5 For all I know/care...	+	0	+	+
6 How about something/doing something?	+	+	0	+
7 I know (what)...	?	0	?	+
8 What about...?	+	+	+	+
9 All in all...	+	+	0	+
10 The point is ...	+	0	?	?

Nga të gjitha formulat e ligjërit të folur vetëm ‘I beg your pardon?’ dhe ‘What about...?’ gjenden te të gjithë fjalorët. Shumë prej tyre nuk gjenden aspak ose në forma të ndryshme, gjë që tregon se duket e pamundur që një fjalor të përfshijë të gjitha shprehjet që përdoren në ligjërimin e përditshëm, pavarësisht se sa i gjerë dhe gjithëpërfshirës është aidhe aq më pak në një fjalor dy-gjuhësh të hartuar nga të huaj.

IV. Përfundime

Dallimet për nga ana sasiore midis fjalorëve që hulumtuam janë mjaft interesante, por jo shumë të mëdha. Fokusi i çdo fjalori varet nga qëllimet e hartuesit të tij. Pyetja është cili prej fjalorëve ofron më shumë për studentët shqiptarë në përvetësimin e kategorive të ndryshme të “togfjalëshave të qëndrueshëm”.

Nga të katër fjalorët e hulumtuar do të thoshim se CIDOË ka mjaft përparësi sepse jo vetëm që nga ana sasiore ofron më shumë, por edhe cilësia e dhënies së informacionit është më e mirë. Të gjitha njësitë e përfshira në fjalor, krahas shpjegimit, ilustrohen edhe me shembuj konkretë të vjelë nga vepra të ndryshme (përveç proverbave). Edhe mënyra e shpjegimit është mjaft interesante sepse jepen me *if-clauses* (fjali kushtore), p. sh. *If you let the cat out of the bag, you let a secret be known, usually without intending to:* dhe menjëherë vjen shembulli: *He let the cat out of the bag when he mentioned the party to her – it was supposed to be a surprise.* (f. 203) [7]

Nga ana tjetër, WNWD nuk duket se ka shumë për të ofruar si nga ana sasiore edhe ajo cilësore sepse pasi jepet shpjegimi asnjëherë nuk jepen shembuj për të ilustruar konkretisht kuptimet e njësive të hulumtuara, p. sh. *let the cat out of the bag – to let a secret be found out.* (f. 219) [6]

Dy fjalorët e tjerë FASH 1 dhe FASH 2 nuk kanë dallime të shumta për nga ana sasiore. Edhe në to nuk jepen shembuj konkretë, por thjesht jepet përkthimi i njësive. Në shumicën e rasteve, autorët përpiqen të japin një variant sa më shqip të togfjalëshave duke u munduar t’i përkthejnë po më shprehje të figurshme. Nëse i referohemi FASH 1 si shembull do të kishim: *to let the cat out of the bag – nxjerr të fshehtë; më shpëton goja.* (f. 586) [8] Po kështu te FASH 2 kemi: *let the cat out of the bag – nxjerr të fshehtë.* (f. 91) [5]

Këta fjalorë, pavarësisht nga të metat, janë mjaft të vlefshëm. Ndonjëherë studentët tanë preferojnë të dinë variantin në shqip sesa të mundohen të arrijnë në kuptimin e saktë të këtyre togfjalëshave që, për hir të së vërtetës, janë më të vështirë për t’u kuptuar e përdorur sesa thjesht fjalët e veçanta.

Një e metë e përbashkët e të gjithë fjalorëve është mangësia në përfshirjen e formulave të gatshme që përdoren në ligjërimin e përditshëm. Ato janë shumë të përdorshme dhe kurrësi nuk mund të lihen jashtë fjalorëve. Shumë prej tyre përvetësohen në biseda konkrete, por për studentët shqiptarë kjo është e pamundur sepse mundësitë e tyre për të komunikuar janë shumë të pakta dhe, si rrjedhim, fjalorët mbeten një burim parësor informacioni.

Si përfundim, do të theksonim se duke u bazuar te të dhënat e vjela, pavarësisht se çfarë ofrojnë këta fjalorë, secili në mënyrën e vet, gjithmonë mbetet detyra e mësuesit që t'u mësojë studentëve se si ta kërkojnë dhe nxjerrin informacionin që u duhet nga fjalorët, dhe më kryesorja si ta përdorin këtë informacion në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ky punim, mbetet modest sepse numri i togfjalëshave të hulumtuar është shumë i vogël (vetëm 70) dhe numri i fjalorëve është i kufizuar. Ndoshta në ndonjë studim të mëvonshëm më të thelluar mund të përfshijmë edhe hulumtimin e "togfjalëshave të qëndrueshëm" në gjuhën shqipe dhe vendin që zënë kategori të veçanta në fjalorë të gjuhës shqipe, pse jo edhe në fjalorë shqip-anglisht.

Bibliografia

Alexander, R. J. ,(1984) *Fixed expressions in English: reference books and the teacher*, ELT Journal 38/2.

Alexander: *Fixed expressions, idioms and phraseology in recent English learner's dictionaries*, Euralex '92 – PROCEEDINGS, www.euralex.org/elx_proceedings/Euralex_1992_1/009.. .

Cowie, A. P. ,(2009), *Semantics*, Oxford University Press.

Seidl / McMordie, (1978), *English idioms and how to use them*, Oxford University Press.

FJALORËT

Hysa, R. ,(i përmirësuar), (2000), *Fjalor Anglisht-Shqip*, Botime EDFA, Tiranë, (FASH 2).

Neufeldt, V. ,Guralnik, D. B. , (ed) (1994), *Webster's New World Dictionary*, Prentice Hall (WNWD).

Procter, P. ,(ed) (1996), *Cambridge International Dictionary of English*, Cambridge University Press (CIDOE)

Qesku, P. ,(2004), *Fjalor Anglisht-Shqip*, Botime EDFA, Tiranë, (FASH 1).

LETËRSI

ANALIZË E ROMANIT “QYTETI ME KATËR PORTA”, DORIS LESINGUT

Erinda Papa

Universiteti “Fan S. Noli”, Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Përmbledhje

“Qyteti me katër porta”, romani i fundit i serisë “Fëmijët e dhunës”, shënon jo vetëm fundin e rrugëtimit të heroinës së shkrimtares, por edhe zgjidhjen e ngërçit ideor dhe strukturor të serisë. Nëpërmjet kësaj analize ne synojmë të tregojmë disa nga zgjidhjet lesingiane të pështjellimit të Martha Kuestit, si dhe kthesën “e papritur” drejt teknikave pasmoderne të rrëfimit. Kolazhi, metateksti, ironia, fantazia dhe përralla janë disa nga strategjitë e përdorura në këtë roman për tëna sjellë imazhin e një shkrimtareje që duket sikur sfidon kohën. Jo më kot është zgjedhur romani i fundit i një serie realiste. Ne, synojmë të japim rritjen dhe zhvillimin e heroinës rebele, tashmë të ikonizuar të prozës së Lesingut, si dhe rritjen dhe zhvillimin e Doris Lesingut si shkrimtare pasmoderne.

Fjalët kyç: *vetëdija kolektive, vetëdija individuale, çmenduria, pështjellim, ngërç, zgjidhje*

Abstract

The Four-Gated City, the last novel of *The Children of Violence* series, illustrates not only the ending to the journey of the writer’s heroine, but also the solution to the conceptual and structural cramp of the series. Through this analyses we aim at showing some of the Lesingian choices to Martha Quest’s mental and spiritual confusion. We are revealing, at the same time, “the unexpected” turn to the postmodern narrative techniques. Collage, pastiche, metafiction, irony, fantasy and fabulation are some of the strategies used in the novel to convey the image of a writer who seems to challenge the time. There is a point in depicting and analyzing this novel, the last of a realistic series. We attempt to show the development and the growth of the mythical Lesingian heroine, as well as the development and the growth of Doris Lessing as a postmodern writer.

Key Words: *collective consciousness, individual consciousness, insanity, confusion, cramp, solution*


Romani i fundit i serisë “Fëmijët e dhunës” shpalos një sintezë a përmbledhje të ideve dhe teknikave rrëfimtare të cilat kanë përparuar në prozën e deriatëhershme të shkrimtares. Meqenëse e gjithë përmbledhja përfshin zhvillimin e Martha Kuestit gjatë fazave të ndryshme të jetës, duke filluar që nga adoleshenca, rinia e hershme, pjekuria dhe vdekja, e shkruar në një periudhë që ngërthen dy dekada, nuk është e çuditshme të mendohet që ideja qendrore e përmbledhjes ka ndryshuar krahasuar me idenë e fillimit të serisë. Në vitin 1957, kur shkrimtarja kishte nxjerrë në dritë vetëm dy vëllimet e para, ajo i përshkruan ato si “një studim të vetëdijes individuale në

marrëdhënie me atë kolektive”[4]. Me ndryshimet që u bënë gjatë botimeve të romaneve të tjera, me të drejtë themi se ideja qendrore e romanit të fundit të serisë, “Qyteti me katër porta” mund të përmblihet si *studimi i ndjeshmërisë individuale në marrëdhënie me atë kolektive*. Me mendimin se proza artistike është pasqyrim i realitetit, shkrimtarja modelon formën dhe përmbajtjen e këtij romani. Ide të tjera të pranishme në romanet e para të serisë, ndër të cilat mund të përmendim marrëdhëniet ndërpersonale ndërmjet burrave dhe grave, prindërve dhe fëmijëve, unit vetjak dhe atij publik, apo artistit dhe shoqërisë, si dhe roli i politikës, artit apo institucioneve të tjera në jetën e individit, marrin një trajtim të ri në romanin “Qyteti me katër porta”. Heroina e Lesingut përjeton një gjendje hegeliane ku mendja dhe shpirti, pavarësisht shfaqjeve kontradiktore, bashkohen dhe njësohen pa përjashtuar njëri-tjetrin [2].

Ky roman nuk ngërthen në të njëjtën shkallë teknikat novatore të rrëfimit të hasura tek romanit “Blloku i artë”, megjithatë, ai mbetet një nga ndërtimet e pazakonta të Lesingut për shkak të ndërthurjes që shkrimtarja u bën elementeve realiste me ato romantike.

Nga mënyra e ndërtimit, ky roman i fundit i serisë ka të njëjtën vlerë për katër romanet e mëparshme sikundër *Blloku i Artë* për romanin me të njëjtin titull. Ai “mbyll, pajton dhe shndërron spektrin e ideve të serisë, ashtu siç është ngjyra e bardhë, fryt i shkrirjes së të gjitha ngjyrave të spektrit të dritës”. [7] Duke shkuar më tej, mbështetur në interpretimin që Jungu i bën organizimit në katër pjesë, si imazhi i plotësisë dhe njësimi, me të drejtë themi se edhe qëllimi i Lesingut është i njëjtë me atë të Jungut në këtë roman ku vihen re përsëritjet e vazhdueshme të “katërsheve”: romani ndahet në katër pjesë, secila me nga katër kapituj. Shtojca në fund të romanit, e ngjashme me *Bllokun e Artë*, përbën një pjesë më vete, e cila mund të vlerësohet si sintezë me një fund të hapur për të gjithë romanin.

Ndarja në katër pjesë është një imazh i rëndësishëm edhe për përmbajtjen ideore të romanit. Martha, gjatë zhvillimit të ngjarjes shpërngulet në katër shtëpi: fillimisht në apartamentin mbi restorantin e Ajrisit, më vonë në hyrjen e Xhekut e më tej në shtëpinë e Mark Kolërixh dhe Pol Kolërixh. Në secilën prej tyre Martha zbulon anë dhe vlera të ndryshme të personalitetit të saj. Imazhi më i qartë është ai i qytetit mitik me katër porta, me rrugët që bashkoheshin “nga veriu, jugu, lindja dhe perëndimi. Kur ata hynë në këtë qytet, filluan ta ndajnë në harqe, duke formuar rrugë në formë spirale... një rrjetë harqesh të ndërprera nga rrugë që bashkoheshin në një pikë qendrore.” [5]



Ky qytet të sjell ndërmend edhe formën e qytetit të shenjtë, të shtrirë në katër pika kryesore qendra e të cilave simbolizon qendrën e shenjtë të universit. Irish Nojman e përshkruan kështu një shtrirje të tillë:

“Simboli i mandalës rrethore përkon me vetëdijen individuale dhe atë kolektive. Në fillim ai merr formën mitike të parajsës; në fund atë të Jeruzalemit të shenjtë. Pamja e përkorë e një rrethi nga qendra e të cilit rrezatojnë katër krahët e një kryqi... është një simbol sa i lashtë aq edhe i ri... [Mandala] është vendi i shndërrimit dhe i ndriçimit, fundi si dhe origjina e gjithçkaje.” [6]

Domethënia simbolike e këtij qyteti filtrohet nëpër të gjitha nivelet e romanit duke u shndërruar në simbol të vetëdijes së Martha Kuestit. Heroina e Lesingut që shfaqet “pas” romanit “Blloku i artë” jo vetëm mbart me vete farat e ndarjes së brendshme të Tomas Stërnit, por edhe risjell copëzimin e Ana Ulfit. Ashtu si Ana edhe Martha duhet të gjejë një mënyrë për të bashkuar dhe njësuar copat e ndara të unit të saj. Vetë motivi i kërkimit dhe i zbulimit të vetvetes shoqërohet me ulje dhe ngritje apo shfaqje të dytësorit a kipcit të vetvetes. Ashtu, sikundër treshja: *Ana, Ela dhe Soll Grin*, edhe lidhja në treshe, ménage à trois, e Marthës me Mark dhe Linda Kolërixh, plotëson qëllimin e Lesingut për të nxjerrë në pah anë të ndryshme të personalitetit apo të energjisë psikike të individit.

Në roman një rëndësi të veçantë merr roli i vetëdijes në lidhjen që duhet të vendoset ndërmjet realitetit të brendshëm dhe të jashtëm. Një realitet i shkapërndarë bëhet objekt pasqyrimi i vetëdijes, e cila ose do t'i nënështrohet strukturave të këtij realiteti ose do ta kapërcejë atë duke shfrytëzuar elementet e saj të brendshme.

Në hyrje të tregimit, Martha Kuesti është rreth të tridhjetave. Tashmë dy herë e divorcuar, emigrante në një mjedis të ri, i cili shumë shpejt shndërrohet në një tablo të re të botës së brendshme, Martha përballet me mundësi të mëtejme për rritje emocionale, seksuale, intelektuale dhe psikike.

“Në çdo jetë ka një kurbë të rritjes ose të rënies; në qendër vepron një trysni e fortë ashtu sikurse limfa që rrjedh në trungun e pemës në vitin e fundit të jetës së saj, teksa nga një syth a nyjë thujse e vdekur shpërthen papritur një degëz e re në një formë të pashmangshme, por me një fuqi që vetëm ajo e dinte derisa bëhet e dukshme për të tjerët.” [5]

Metafora është e qartë teksa shkrimtarja krahason procesin e jetës së re vegjetative me rrjedhën e rritjes së brendshme të heroinës së saj. Tema e ndarjes a copëzimit të brendshëm është sjellë edhe më herët nëpërmjet personazheve të tjerë të Lesingut, si dhe nëpërmjet konflikteve dhe ndarjeve të mëparshme të Marthës në vëllimet e tjera të serisë. Në kapitullin e parë të romanit “Qyteti me katër porta”, ndërkohë që Martha përpiqet t'i shpëtojë kaosit të Londrës dhe pështjellimit të brendshëm, ajo është njëherazi Meti dhe Martha. Meti përfaqëson unin e saj të ephëm; ai që është pranuar nga shoqëria; “armiku” [5], “djalli” [5] i saj, apo “një formë histerie” [5]. Këto aspekte të personalitetit të Marthës do të shërbejnë më vonë si qendra e vëzhgimeve

të mëtejshme të unit të brendshëm të saj, për të treguar ndarjet psikike dhe emocionale të trashëguara të heroinës.

Me shumë pak të holla në xhep, por me kënaqësinë e madhe e të qenit e panjohur në këtë qytet të madh, Martha fillon të ndiejë shijen e lirisë, të pavarësisë nga detyrimet dhe trysnitë shoqërore. Teksa takon njerëz të ndryshëm, Martha duket sikur luan me ta duke u shfaqur si njeriu që ata do të donin të ishte. Me një burrë që e takon në një lokal nate ajo prezantohet si Filis Xhons, një e ve nga Bristol. Pavarësisht faktit se ai e njihnte Bristolin shumë më mirë se ajo vetë, përshkrimi që Martha i bën këtij qyteti bregdetar e kënaq të panjohurin, ndonëse ai ishte një përshkrim që përshtatej me çdo qytet tjetër bregdetar. Për Stelën, gruan që banon në zonën e molit, me të cilën Martha ndan për njëfarë kohe banesën, ajo është një udhëtare e huaj nga një vend i largët. Me Henri Methësën, i afërm i familjes Mejnard, ajo paraqitet si “vajza e shkujdesur e aventurave” [5], sepse e kupton se ky tip personaliteti i përgjigjet fantazisë së fshehtë që Henri ruan për veten. Prej këtyre përjetimeve Martha arrin të kuptojë se pjesa më e madhe e personalitetit të individit krijohet nga përshtypjet që të tjerët kanë formuar për të. Në secilin prej këtyre rasteve ajo e sheh se këta njerëz i kënaq njohja me një anë të pavërtetë të Marthës.

Kur Martha takon Fibi Kolërixh, motrën e madhe të mikes së saj nga Zambezia, Marxhëri, ajo vëren se sa shumë ngjasojnë të dy motrat, e në të njëjtën kohë sa të ndryshme janë ato në karakter. Ajo e ka të vështirë të mos sillet me Fibi si me të motrën, por marrëdhënia me të e bën të kuptojë se sa pak e kishte njohur miken e saj nga Zambezia. Ajo nuk arrin ta mendojë se cila ishte natyra e vërtetë e Marxhërisë, duke vënë në dukje “hijeshinë e saj që të linte pa frymë, por një bukuri mbrojtëse dhe nervoze” [5]. Martha nuk mund t’i kuptojë të tjerët po aq sa edhe ata nuk arrijnë ta njohin dhe ta kuptojnë Marthën e vërtetë.

Ndërkohë që endet rrugëve të Londrës, Martha njihet me Xhekun njeriun që i ofron një pamje të re të lirisë dhe shkujdesjes, si dhe me Fibi Kolërixh, e cila përfaqëson vlerat tradicionale të rregullit dhe përgjegjësisë. Xheku merr jetë kryesisht nëpërmjet marrëdhënieve fizike, por tërheqja ndaj seksit është mënyra për të arritur në atë gjendje “të lartë” psikike, të cilën Martha e arrin në forma të tjera. Me Xhekun ajo mëson se aftësia e tij për të depërtuar në psikikën e saj shkon në “valenca” të ndryshme krahasuar me të njëjtën “gjatësi vale” [5] të Tomas Stërnit. Xheku ka të njëjtën aftësi të hapë portën e mendjes së saj, “të hyjë në të, thuajse si të ishte një qytet” [5]. Megjithatë, ndryshe nga Tomasi, ai mbart me vete edhe armikun e tij të brendshëm, emocionet negative të urrejtjes. Martha arsyeton se çdo njeri ka një pasion që e udhëheq në jetë, një nevojë nxitëse, e cila në formën e saj më të skajshme “prish drejtpeshimin e personalitetit të këtij njeriu, duke çuar në shfaqjen e armikut të tij të brendshëm, çmendurisë” [1]. Nëse nuk njihet si pjesë e unit, energjia emocionale negative pasqyrohet në botën e jashtme dhe mund të çojë në ndarje a copëtim të unit e rrjedhimisht drejt çmendurisë.

Në roman, shkrimtarja e shfaq hapur idenë se Xheku në mënyrë simbolike merr pamjen e një prej ndarjeve psikike të Marthës. Asaj, ashtu si dhe Ana Ulfrit, i duhet të pranojë seksualitetin e vet para se të arrijë një lloj njësimi; por armiku i brendshëm që shfaqet në formën e Xhekut është e njëjta hije që Martha mbart në

vetvete. Qëllimi i Lesingut është të tregojë se individit duhet t'i njehet të gjitha këto pjesë, duke përfshirë këtu edhe hijen e tij, me qëllim që të arrijë lumturinë dhe lirinë e kërkuar. Ky njehim për Xhekun merr një formë negative. Dhjetë vjet më vonë kur Martha kthehet për ta takuar sërish, ajo vë re se si armiku i tij i brendshëm e ka pushtuar të gjithë personalitetin e tij, duke e shndërruar nga një forcë e vërtetë epshi në një shembull të rrënimt psikologjik, i cili stërvit vajzat e reja kundrejt favoreve seksuale. Ky Xhek i keq, sadist, është një shndërrim i kundërt i Xhekut të parë apo, siç thotë Martha, “hija e Xhekut të vjetër e nxjerrë në dritë” [5]. Me kohë edhe Martha do të përballlet me hijen e saj dhe do të përjetojë të njëjtin shndërrim, ndonëse përkohësisht, duke “u kthyer nga mbarë mbrapsht si të ishte një dorashkë apo një fustan...” [5]. Megjithatë, ndryshe nga Xheku ajo qëndron në pritje, vëzhguese e gjithçkaje duke i bërë ballë në këtë mënyrë njehimit të plotë me armikun e brendshëm.

Në hapat e parë të rrugëtimit psikik, kur ajo është ende e përfshirë në marrëdhënien me Xhekun, pamja e Marthës vazhdon të mbetet e mjegullt, e dyshimtë. Marrëdhënia erotike me Xhekun është më tepër fizike, pa përfshirjen e plotë emocionale që karakterizonte lidhjen me Tomas Stërnin. Zhgënjimet në dashuri i shtojnë personazhet e mëvonshme të Lesingut të kërkojnë rrugë të tjera psikike për të arritur njehimin e plotë. Lidhja e ngushtë seksuale me Xhekun e çon drejt mëtimeve të tilla të cilat arrijnë kulmin me dy parashikime të shfaqura në formën e ëndrrave. Imazhi i parë është ai i “periudhës së artë” – simbol i prototipit të Kopshtit të Edenit, apo i harmonisë familjare dhe individuale para Mëkatit të Madh [5]. Imazhi i dytë është një makth i cili parashikon ngjarjet e mëvonshme në familjen Kolërixh, me të cilën do të lidhet shumë shpejt Martha duke provuar ndarjet dhe problemet e saj të brendshme. Në qendër të të dy ëndrrave është familja e shoqëruar me një ndjenjë dhimbjeje. Në ëndrrën e parë dhimbja shkaktohet nga mëtimi i humbjes së përsosmërisë, në të dytën nga zhgënjimi i një jete të mërzitshme.

Këtu, si askund tjetër në prozën e vet, Lesingu i mëshon idesë së dështimit të familjes si një institucion shoqëror:

“Fëmija lind me mundësi të pafundme. Por asaj nuk mund t'i shpëtosh; është si të gjendesh në një pus të errët, të thellë e ti bën çmos që të dalësh jashtë prej tij; dhe prindërit e tu janë pjesë e këtij pusi, e asaj së cilës ti lufton t'i shpëtosh. Është gabim të mendohet se ka një mënyrë për të dalë jashtë pa luftuar. Ti duhet të luftosh. Secili nga ne duhet.” [5]

Rrugëtimi nga pafajësia drejt tjetërsimit, korrupsionit, apo anasjelltas, është një udhëtim shpirtëror drejt njehimit, i cili i jep formë qëllimit të Martha Kuestit në roman. Pika e dobët e dëshirës për t'u njësuar është familja. Është tejet domethënës fakti pse Martha Kuesti e romanit “Qyteti me katër porta” është pa vatër e pa familje, gjë që i jep dorë për të kapërcyer ngërçet në rrugëtimin e saj drejt plotshmërisë.

Pavarësisht dyshimeve që ka, Martha vendos të qëndrojë në shtëpinë e familjes Kolërixh “duke u çuar drejt dritës” [5]. Kështu, kapitulli i fundit i pjesës së parë të romanit hapet me një tregues të vendodhjes së Marthës që shënon rrugën drejt ndriçimit shpirtëror. Në kontekstin e lidhjes së dhomave dhe shtëpive me

gjendjen psikike të heroinës, mund të themi se Martha ka zgjedhur të banojë në një ndërtesë më “të respektuar”, por jo më tradicionale.

Ndonëse Martha fillimisht punësohet si sekretarja e përkohshme e Mark Kolërixh, shumë shpejt ajo bëhet një mikeshë e mirë dhe ndihmëse në punët e shtëpisë. Më herët në marrëdhënien e tyre ajo i tregon Markut për ëndrrën e saj të qytetit me katër porta, të cilën ai ia ushqen më tej duke e kthyer në një ëndërr të përbashkët. Imazhi i qytetit me katër porta, i formuar në bisedat e tyre, pasqyron tensionin ndërmjet gjendjes ideale (mundësitë pozitive të unit) dhe asaj djallëzore (e simbolizuar prej hijes negative), argument i cili modelon idenë qendrore të romanit.

Në fund të pjesës së parë lexuesi njihet edhe me dy personazhe të tjerë: Linda Kolërixh, gruan “e çmendur” të Markut dhe Xhimi Ud, ortakun e tij në tregti. Për vite me rradhë Linda është kurrar nëpër spitale psikiatrie dhe ka marrë mjekime të ndryshme. Ndeshmërinë e saj mjekët e kanë përkufizuar si një formë të veçantë skizofrenie. Edhe Xhimi Ud vizatohet në roman krejt ndryshe nga shumica. Por, siç e tregon edhe emri i tij “ai është si prej druri”. “Atje ku të tjerët oshëtinjë, ai hesht” [5]. Ndërkohë që Linda shquhet për një ndeshmëri të jashtëzakonshme, Xhimi Ud vlerësohet si “një i metë, me një moskokëçarje thujse patologjike ndaj çdo forme mirësjellje” [5]. Si Xhimi edhe Linda “i përgjigjen” një realiteti që nuk përshtatet me normën apo me qasjen e shumicës. Që të dy janë “mbartës të shndërrimit psikik që zë fill në skajet e vetëdijes së zakonit njerëzor dhe i tejkalon përmasat e gjeografisë, shtrirjes së brendshme, të cilën e zbulon më tej Martha Kuesti” [7].

Pjesa e parë na njeh edhe me brezat e ndryshëm të familjes Kolërixh: me Margaret Paten, nënën e Markut; me Fransis, djalin e heshtur të Lindës dhe Markut; dhe me Polin, djalin jetim të vëllait të Markut, Kolin, i cili ishte arratisur për në Rusi e që për këtë shkak e shoqja, Selli, kishte vrarë veten. Këta janë personazhet, lidhjet e të cilëve do të përcaktojnë edhe strukturën e pjesës së dytë të romanit. Në këtë pjesë, banesa e familjes Kolërixh merr një domethënie të veçantë si tregues i mikrokozmosit psikik të personazheve. Linda Kolërixh, pasi del nga spitali, vendoset në katin përdhes të shtëpisë duke sjellë me vete edhe shopen e saj Dorothi. Së bashku ato plotësojnë një çift që dallon për ndeshmërinë e pazakontë të Lindës dhe për përkushtimin e rëndomtë të Dorothisë.

Dy kate më lart Marku dhe Martha i janë përkushtuar “punës” së shkrimeve të Markut, por në të vërtetë ky është një angazhim për “thithjen” e tipareve të personalitetit të njëri – tjetrit. Marrëdhënia e tyre të sjell ndërmend turbullirën mendore të Ana Ulfit dhe Soll Grinit, të përkushtuar ndaj personalitetit të njëri – tjetrit, si dhe lidhjen më të hershme të Marthës me Tomas Stërnin në romanin “E penguara” të kësaj serie. Marku, nën frikën se mos spiunohet për shkak të sjelljes së Kolinit, detyrohet të nxjerrë nga vetja me dhjetra individë, duke përfshirë këtu edhe “dalëzotin”, ruajtësin, të cilin Martha e njihnte si pjesë të personalitetit të saj të shfaqur në kohën kur ajo ishte angazhuar rregullisht në veprimtari politike. Si shenjë e lidhjes psikike të vendosur mes tyre, Marku fillon të shkruajë një roman bazuar mbi imazhin fantastik që Martha ka të qytetit me katër porta. Dorëshkrimi mbart shenja të copëzimit psikik të Mark Kolërixh. Ky dorëshkrim afron shumë me ditarin e Tomas Stërnit. Madje, Martha nxjerr në dritë këtë ditar dhe duke e krahasuar me

shënimet e Markut, vë re se “shtojcat e përfshira në romanin e Markut ... përcillnin të njëjtën “ndjenjë” si një pjesë e mirë e shënimeve të Tomasit. Ato vinin nga i njëjti vend, nga e njëjta gjatësi vale. Diku, këta dy njerëz të jashtëzakonshëm por të ndryshëm, Marku dhe Tomasi, kanë ndarë të njëjtin vend...” [5].

Duke “thithur” të kaluarën e Marthës, Marku thith edhe aspekte të ndryshme të Tomas Stërnit, të cilat janë bërë pjesë e vetëdijes së Marthës. Ajo i sheh disa pjesë të ndryshme të personalitetit të Markut, si anë të unit të saj, “sikur e kaluara e saj ishte shkrirë me të tashmen e Markut. Thuajse; ose më mirë Marku ishte ajo vetë, apo ajo, Marku... ajo s’mund ta vendoste veten përsëri atje ku ndodhej më parë, pasi ai vend ishte zënë prej Markut.” [5]

Fëmijët e kësaj shtëpie janë gjithashtu pjesë e procesit që ndodh tek të rriturit duke qenë simbolikisht “e kaluara dhe e ardhmja e të rriturve” [5]. Ndonëse Poli dhe Fransis vuajnë vetë ndarjet e brendshme (pjesërisht edhe për shkak të prindërve të tyre të pazakonshëm), ata e pranojnë më me lehtësi “çmendurinë” sesa të rriturit. Vetëm Poli gjashtëvjeçar ka liri hyrje në katin përdhes të Lindës. Duke qenë se ndarja e shtëpisë i përgjigjet ndarjeve të brendshme në psikikën e Marthës, mund të themi se fëmijët në kuptimin e figurshëm shfaqen si pjesa “fëminore” e saj: njëri i bindur (Fransis) që të kujton Metin e bindur dhe të urtë, kurse tjetri, Marthën rebele “pa ndjenjën e të drejtës dhe të gabuarës” [5]. Kjo pjesë e dytë ka rëndësi të veçantë për Marthën, pasi i jep mundësi të analizojë kufijtë e parimeve tradicionale, të pezullojë gjykimin moral, si dhe të mësojë prej përvojave të pazakonta.

Qëndrimi i Marthës gjatë kësaj kohe në familjen Kolërixh karakterizohet nga “një atmosferë e keqe”, e cila lidhet jo vetëm me gjendjen psikike të heroinës, por edhe me vetë atmosferën shtypëse politike dhe sociale të kësaj familjeje. Media e ka cilësuar prej kohësh këtë familje si “armiqtë brenda portave tona” [5] për shkak të lidhjes së njohur me Rusinë. Frika prej “armikut të brendshëm”, hija e përbashkët e urrejtjes, i përgjigjet hijes individuale të shtrirë në një shkallë më të gjerë: “Kombe të tëra u çmendën brenda natës” [5]. Përveç kësaj atmosfere “ të keqe”, në familjen Kolërixh ndodhën edhe mjaft gjëra interesante. Romani i Markut, “Një qytet në shkretëtirë”, i frymëzuar nga vizioni i Marthës për qytetin me katër porta, del në dritë duke e forcuar emrin e tij si shkrimtar. Është ironik fakti se pavarësisht këtyre ndryshimeve, vlerat dhe parimet e Markut mbeten të pandryshueshme gjatë gjithë ecurisë së ngjarjes. Ajo që ndryshon është përshtypja që shoqëria ka për të.

Ndonëse në sipërfaqe jeta e Marthës është e qetë, brenda ajo zien. Lajmi për vizitën e së ëmës nga Zambezia pas shumë kohësh, i sjell ankth dhe tension. Gjatë kësaj kohe, ajo e kupton se marrëdhënia e nderë mes saj dhe së ëmës ka penguar ecjen dhe zhvillimin e një pjese të mirë të unit të saj. Duke pranuar këtë fakt, ne shohim se sa shumë ka ndryshuar Martha prej fillimit të serisë. Duke e njohur rolin negativ të marrëdhënies nënë – bijë, Martha tashmë ka mundësi të dalë nga ajo gjendje gjumi që e karakterizonte më parë dhe të fillojë të komunikojë me atë pjesë të vetvetes të cilën e kishte mbajtur të mbyllur brenda prej kohësh. Për t’i shpëtuar kurthit të këtij ankthi, Martha pyet Lindën në lidhje me mundësinë nëse psikanaliza do ta ndihmojë të kapërcejë dhimbjen e brendshme të shkaktuar nga vizita e papritur e së ëmës. Paniku është kaq i madh saqë asaj i dukej sikur nuk do të ishte në gjendje

të kapërcente të kaluarën sërish. Sapo fillon të ndiejë këtë dhimbje, Martha e kupton se “për vite me rradhë ajo kishte bërë sikur e kishte dëgjuar zërin në katin përdhes, i cili, në atë kohë, për të ishte një zë i çmendur që nuk duhej përfillur. Tani ajo po e kuptonte – po kuptonte një pjesë të mirë të këtij zëri. Madje po e mësonte këtë gjuhë.” [5] Këto hyrje të shkurtra në katin përdhes dhe në unin e saj janë procese ta krahasueshme me njëri – tjetrin: çmenduria e humbet vlerën e saj si një sëmundje, si një proces i pakuptueshëm; gjuha “e çmendur” që buron prej psikikës së saj tashmë bëhet më e kuptueshme.

Martha vendos të takohet me psikiatrin e Lindës, dr. Lemb, por vizita me të shtyhet për pak kohë. Në këto kushte Martha fillon e mendohet në vetmi për të kaluarën e saj dhe kur takohen sërish, doktori i përforcon atë ide që tashmë kishte zënë rrënjë tashmë në mendjen e saj:

“Dikush foli, dikushi bëri këtë apo atë: më në fund tjetri dëgjoi për herë të parë atë që jeta kishte kohë që i përsëriste vazhdimisht, në mënyrë të ndryshme, për vite me rradhë. Ai s’e kishte dëgjuar më parë, sepse ai nuk kishte me çfarë “të dëgjonte”. Jeta ishte thjesht një proces ku individ i fiton “veshët” apo ndjesitë për të dëgjuar a provuar atë që nuk e kishte dëgjuar e ndërë më parë.” [5]

Ky përfundim, shënon edhe fillimin e fazës tjetër në zhvillimin psikik dhe emocional të Marthës drejt njësimi, e ngjashme me filozofinë Sufiste sipas së cilës “vetëdija njerëzore nxjerr, prodhon organet e duhura për të lehtësuar zhvillimin e saj të mëtejshëm” [7].

Kapitulli i fundit në pjesën e dytë të romanit, rrëfëhet prej këndvështrimit të znj. Kuest. Lesingu zgjedh me qëllim këtë mënyrë rrëfimi për të na njohur me realitetin tradicional të vetëdijes së znj. Kuest. Perceptimi i saj i realitetit – dikur i kushtëzuar prej paragjykimeve të marrëdhënieve ndërmjet të bardhëve dhe zezakëve – sot varet nga keqardhja për vetveten, kotësia, sqima dhe seksualiteti i ndrydhur. Përshtkrimi i një marrëdhënie të vonuar por të lënë në mes ndërmjet saj dhe një shërbëtori të ri zezak, të filluar para se të largohej nga Zambezia, tregon shkallën e aftësisë së saj të kufizuar për rritje dhe vetëdërgjegjësim. Në Londër marrëdhënia e Marthës me të ëmën, shumë e ngjashme me marrëdhënien e shkrimtares me nënën e saj, përshtkruhet si një lidhje që shteron energjitë psikike të secilës. Ato nuk arrijnë të vendosin komunikimin e ndërsjellë me njëra – tjetrën, si të thuash se ishin “dy polet e njëjta të magnetit që shtynin njëra – tjetrën” [8]. Ndonëse në pamje të parë Martha e sheh të ëmën si një grua të moshuar për të cilën ndien keqardhje, thellë brenda vetes ajo e përjeton figurën e së ëmës si burimin e shkatërrimit të saj psikik në të kaluarën, dhe kanalin që shteron sot energjinë e saj psikike dhe emocionale. Pavarësisht përpjekjeve të saj, Martha nuk arrin të vendosë dot lidhjet që kërkon me të ëmën.

Është shumë domethënëse fakti që gjatë qëndrimit të saj në shtëpinë e familjes Kolërixh, znj. Kuest qëndron në një dhomë në katin më të lartë të shtëpisë dhe zbret në katin përdhes vetëm një herë. Takimi me njerëzit e katit përdhes është i pakuptimtë për të, sepse ajo nuk mund “të dëgjojë” çfarë thuhet atje. Ajo i interpreton fjalët e znj. Mellëndip në lidhje me moshën e tretë si një periudhë e çmuar reflektimi, si fjalë ofenduese të drejtuara ndaj asaj vetë prej një gruaje njëzet

vjet më të re se znj.Kuest.Gjatë qëndrimit me Marthën, znj.Kuest kalon një krizë të shkurtër nervore, ndaj dhe ato vendosin të takojnë dr. Lemb veças, pasi asnjëra nuk mund ta durojë dhimbjen që injekton tek tjetra (burimin e së cilës Martha është në gjendje ta kuptojë, ndërsa e ëma jo). Znj. Kuest largohet nga Londra dhe Martha tashmë “shkund” nga vetja atë pjesë të saj që e ëma e kishte kontrolluar prej kohësh.

Pjesa e tretë e romanit fillon me një vit vendimtar, vitin 1956, i cili shënon një vit të rëndësishëm jo vetëm për botën dhe për jetën në shtëpinë e familjes Kolërixh, por edhe për vetëdijen e Marthës. Ajo dhe Marku vazhdojnë të jenë “njerëz të ndarë” [5]; fëmijët e shtëpisë, Poli dhe Fransis u krijojnë tensione të rriturve; Linda, pasi ka hequr dorë nga mjekimet sëmuret më tepër dhe kthehet sërisht në spital; Dorothy, pas disa përpjekjesh të pasuksesshme, ia del të kryejë vetëvrasje. Gjendja e trazuar në katin përdhes të shtëpisë, përkon me gjendjen psikike të Marthës.Siç shprehet edhe rrëfimtaria: “Të jetosh me një mendje “të trazuar” është një mësim për çarjet, grindjet dhe mosmarrëveshjet tona.” [5]

Për Marthën vazhdon operacioni i shpëtimit, i përforcuar edhe me korrigjimin e disa zonave të psikikës së saj, të cilat nuk e dinte se kishin ekzistuar më parë.“Ajo zbuloi dyer të cilat nuk i njihnte më parë.Kishte luftuar për ta nxjerrë veten nga errësira, sepse duhet ta bënte këtë; kishte hyrë në vende brenda vetes, të cilat nuk e dinte që ndodheshin atje.” [5] Duke filluar me parashikimin e vetëvrasjes të nënës së Markut, ajo fillon të dëgjojë zëra dhe të shohë pamje të çuditshme, për të cilat kërkon këshillën e dr. Lembit. Doktorin e ka të vështirë t’i shpjegojë Marthës kufirin ndarës mes sjelljes normale dhe çmendurisë, duke na përcjellë në këtë mënyrë zërin e Lesingut kur shprehet se nuk është e lehtë të përcaktohet kufiri ndarës midis skizofrenisë dhe mendjes së shëndoshë.

Një vend të rëndësishëm në jetën e Marthës tani zënë edhe ëndrrat. “Duke sikur diçka brenda saj që kishte nevojë të fliste, të shprehej, të këshillonte, mund të përdorte këtë kanal – të ulej e qetë në dhomë e të priste, të dëgjonte, nëse jo, atëherë ishte e përgatitur të përdorte ëndrrat.” [5] Këto janë përvoja të drejtuara nga pjesët më të fshehta të vetëdijes sonë, të cilat kërkojnë vëmendje të veçantë. Siç e vë në dukje edhe shkrimtarja:

“Pjesa më e fshehtë e mendjes sonë komunikon me ne nëpërmjet ëndrrave.Unë ëndërroj shumë dhe i analizoj me kujdes ato.Sa më shumë i analizoj aq më shumë ëndërroj. Kur puna nuk më ecën me një libër, atëherë ëndërroj... E mbush trurin me materialin që më duhet për një libër të ri, shkoj të fle dhe zakonisht përfundoj me një ëndërr që më zgjidh gjithçka.” [3]

Për Marthën kanë rëndësi të veçantë si zërat që dëgjon pareshtur në kokën e saj, po ashtu edhe pamjet që objektet marrin në sytë e saj si dhe ëndrrat me domethënien e tyre.Ajo e kupton se këto imazhe surreale janë tregues i aftësive të saj të veçanta që jo të gjithë njerëzit i kanë. Ajo tronditet nga mendimi se në qytetërimin perëndimor me qindra e mijëra njerëz gjymtohen prej mjekëve psikiatër për arsyen e thjeshtë se ata zotërojnë aftësi përtej normales, aftësi të cilat njerëz primitivë i kanë njohur dhe vlerësuar.Ajo e di se njerëz të thjeshtë sot si dhe në qytetërimet e vjetra kanë zotëruar fuqi të jashtëzakonshme si telepatia dhe parashikimi.Jo më kot shkrimtarja në hyrje të kësaj pjese përfshin dy citime të sufistëve Shah dhe Rumi,

me qëllimin që të tregojë larminë e fuqive mendore përtej aftësisë për të gjykuar dhe arsyetuar. Martha përcjell zërin e Lesingut kur shprehet se arsimi është “programuar” për të nxitur tek individ arsyen duke lënë mënjanë rastet, ndonëse të shkëputura, kur mendja njerëzore kalon përtej fuqisë së arsyesimit dhe logjikës dhe shpalos “forma të paarsyeshme të intelektit” [5]. Martha beson se në të ardhmen, kur njeriu do të ketë mësuar të shfrytëzojë edhe fuqitë e tij të veçanta, duke vështuar pas në këtë kapitull të historisë së njerëzimit do të ndiejë turp për veten.

Kjo përsiatje në turbullirën mendore zë fill nga fundi i viteve '60. Gjatë kësaj kohe fëmijët e shtëpisë Kolërixh janë rritur dhe shfaqin hapur shenja të një brezi që ka parime dhe stil jete shumë të ndryshme nga brezi i Marthës. Koncepti i tyre për familjen ka ndryshuar. Fransi merr përgjegjësinë për të rritur fëmijët e Xhillit, vajzës së Fibit. Poli ia ka dalë të bëhet një tregtar i suksesshëm pa mbushur mirë të njëzetat. Për habinë e Marthës, në kundërshtim me tipin e tregtarit të suksesshëm të brezit të saj, Poli shfaqet i ndjeshëm dhe njeri i sakrificës me miqtë e tij. Në çastet kur Zena, e dashura e tij, gjendet në vështirësi financiare, ai i gjen një banesë dhe kujdeset për nevojat e saj të përditshme. Nën të njëjtin rol e shohim edhe në lidhjet e tij me Xhillin, Lindën, apo Guenin.

Duke e ndier veten në udhëkryq, pa ditur ku të shkojë, Martha mendon se po bie prapë në atë plogështi që e karakterizonte vite më parë. Kjo ndjenjë dyshimi të hedh tek ideja e shkrimtares se rrugëtimi drejt zbulimit të vetvetes nuk përfundon asnjëherë. Individu zbulon vazhdimisht rrugë të panjohura brenda mendjes së tij. Megjithatë, në ndryshim nga çastet e dyshimit, në të cilat gjendej vite më parë, sot Martha e kupton se hapi tjetër nuk është të shohë mundësitë jashtë saj, në lidhjet me të tjerët, por brenda vetes. Kështu, kur Martha vendos të analizojë më tej shfaqjet e saj “të çmendurisë”, ajo mbështetet tek Poli, sepse askush nga brezi i saj nuk do ta kuptonte. Për këtë arsye ajo shpërngulet për në shtëpinë e tij dhe kërkon të mos e shqetësojnë për tre muajt në vazhdim. Ndërkohë që ajo fillon udhëtimin e saj të brendshëm, e ndien se është e frikësuar. Ajo kalon javë të tëra me “armikun” e saj të brendshëm. Ai i shfaqet shumë i fuqishëm dhe ajo e di se nuk mund ta mposhtë, por vetëm ta shpërfillë kur do. Për të, kyarmik i brendshëm i ngjason *djallit*, ndaj dhe takimi me të i përaftron një kalimi nëpër Ferr. Ferri është i njohur për të: një vend ku dritat nuk shuhën kurrë, porsi në burg, në qelitë e torturës, apo në kthinat e spitaleve psikiatrike. Njerëzit në Ferr kanë pamje normale deri në çastet kur shpërftyrohen prej urrejtjes a emocioneve të tjera. Martha shkruan: “Jam unë ajo që krijoj mendjen time” [5]. Fytyra merr atë pamje që mendja nxjerr nën pushtetin e emocioneve.

Përfundimet e një rrugëtimi të tillë nëpër *Ferr* jepen në pjesën e fundit të romanit. E quajtur ironikisht “*Shtojcë*”, analiza e ngjarjeve në të shënon fundin e domosdoshëm dhe të nevojshëm të ngjarjeve që kanë ndodhur më herët. Krahasuar me *Bllokun e Artë* në romanin me të njëjtin titull, kjo shtojcë përmbledh strukturën dhe idetë me të cilat është modeluar romani deri në këtë pikë. Duke shfrytëzuar fantazinë dhe pushtetin e imagjinatës, Lesingu i jep romanit një fund apokaliptik, i cili shënon edhe fundin e të gjithë serisë. Shkrimtarja heq dorë nga realizmi i rreptë formal duke besuar se “shkrimtarët fantastiko-shkencorë kanë kapur idenë e kulturës sonë për të ardhmen. Romani “*Qyteti me katër porta*” është një roman profetik. Unë

besoj se ai është një roman me të vërtetë parashikues... Për mua e ardhmja jonë do të jetë fatale, tragjike.” [3]

Shënimet dhe mendimet e Marthës, shënimet e Markut të gjetura pas vdekjes së tij, letrat e Fransis Kolërixh, përshkruajnë epokën para katastrofës, si dhe njëzetepesë vitet që vijnë pas ngjarjes shkatërruese, shkaku i së cilës lihet i paqartë, por që sigurisht ka lidhje me politikat njerëzore. Pjesa që lidhet me Fransis thekson se katastrofa ndodhi jo prej ngjarjeve të jashtëzakonshme, por prej “grumbullimit të ngjarjeve të zakonshme” [5].

Letra e Fransis drejtuar thjeshtres së tij, Amandës, flet për fundin e viteve shtatëdhjetë, për një shoqëri në kaos, të shkapërndarë. Fransis kujton takimin e së ëmës me Marthën dhe paralajmërimin e tyre për shkatërrimin. Ky parashikim ishte përforcuar edhe më tej prej vizioneve të “pacientëve” të shtruar në spitalin psikiatrik, paralajmërimet e të cilëve për katastrofën e ardhshme nuk u morrën parasysh prej njerëzve “normalë”. Ky shkatërrim i përfshiu që të gjithë, “ndikoi tek të gjithë dhe i dha frymën gjithë dekadës” [5]. Paralajmërimet profetike të Lindës në lidhje me shkatërrimin u interpretuan prej të afërmeve dhe mjekëve të saj si shenja të përkeqësimit mendor. “Mbështetja në gjykimin e vet në kundërshtim me mendimin e shumicës i kushtoi Lindës shëndetin dhe për një kohë të gjatë edhe normalitetin.” [5] Nga ana tjetër Martha, e cila kishte mësuar nga Linda t’i besonte ndjeshmërisë së saj, fillon të kapë disa nga valët e përcjella prej Lindës. Të dy gratë më vonë ishin në gjendje t’ia përshkruanin këtë ndjeshmëri edhe Fransis, në mënyrë të tillë që ai të ishte në gjendje “të dëgjonte”. Martha dhe Linda janë bërë pjesë e një grupi njerëzish me fuqi “mendore” të pazakonta, qëllimi i të cilëve ishte që nëpërmjet intuitës dhe fuqive të tyre ata të shpëtonin qytetërimin prej asgjesimit të plotë. Ky qëllim përkon edhe me rolin e sufistëve për të përcjellë atë “rrymë që do t’i ndihmonte njerëzit të zhvilloheshin drejt një stadi më të lartë” [4]. Ky grup vepronte në fshehtësi duke e ditur se çfarë do të shkaktonte nxjerrja e së vërtetës se “një numër i madh i popullsisë karakterizohet nga fuqi të jashtëzakonshme psikike – jo thjesht si një mundësi teorike, por si një fakt” [4]. Parashikimet e tyre dhe paralajmërimet për një katastrofë të afërt nuk i shpëtuan dot njerëzit që nuk donin “të dëgjonin”.

Në kontekstin e idesë madhore që Lesingu përcjell në gjithë serinë, pra të lidhjes mes vetëdijes individuale dhe asaj kolektive, përfundimet e nxjerra nga këto paralajmërimet tregojnë se shkrimtarja vazhdon t’i qëndrojë besnike të njëjtës ide të përcjellë në nivelin moral, por tashmë të zhvendosur nga rrafshi politik në atë psikologjik. Ndërkohë që letra e Fransis mbyllet me ngjarjet që i paraprijnë *Shkatërrimit të Madh*, letra e Marthës drejtuar Fransis zbulon hollësi sesi grupi i saj ia doli të mbijetojë në ishullin ku zbritën pas katastrofës, duke i mëshuar lajmit më të rëndësishëm që lidhet me fëmijët e lindur pas shkatërrimit. Dukej se këta fëmijë, këto qenie “mutante” do t’i zbulonin njerëzimit stadin tjetër në shkallën e tyre të zhvillimit. Martha i tregon Fransis se fëmijë të tjerë si ata që lindën në ishull “*kanë lindur në vende të tjera të fshehta të botës, dhe një ditë e gjithë raca njerëzore do t’u ngjasojë atyre. Njerëz si ti dhe unë janë thjesht një model eksperimental dhe natyra është te jingopur me ne.*” [4]

Me shtojcën në fund të romanit shkrimtarja ka dashur t'u japë përgjigje shumë pyetjeve që i linden lexuesit në lidhje me fundin e personazheve të romanit. Megjithatë, me dëshirën për t'i dhënë fund rrugëtimit të Marthës, Lesingu më shumë ka krijuar sesa ka zgjidhur probleme me një fund të tillë. Gjatë gjithë serisë shkrimtarja është përqëndruar në analizën e marrëdhënies së individit me shoqërinë, të vetëdijes individuale dhe asaj kolektive. Në një farë kuptimi rrugëtimi i Marthës nuk është thjesht një udhëtim për veten, por për të gjithë njerëzimin. Martha arrin të kuptojë se individit është i dështuar nëse ai nuk arrin të zbulojë gjatë njohjes së vetvetes forcat shkatërruese të cilat ndikojnë në sjelljen e tij. Gjatë gjithë romaneve të serisë, Martha dhe padyshim edhe Lesingu, i kanë njohur njerëzimit aftësinë për të krijuar, dashuruar, urreyer dhe për të shkatërruar. Sidoqoftë, humanizmi i shkrimtares zbehet me romanin e fundit të serisë. Ajo e humbet shpresën se njerëzimi do të jetë në gjendje të mbijetojë nëpërmjet individësh të tillë të mençur dhe të përkushtuar si Martha. Nëse qëllimi i Lesingut, me imazhin e racës së re të fëmijëve që do të zëvendësonin individët e deriatëhershëm, ishte të përcillte optimizëm, ajo sigurisht që nuk ia doli.

Bibliografi

Bergquist Wells, Dorothy, (1976), *The Unity of Doris Lessing's "Children of Violence"*, Phd. Dissertation. Tulane University, UMI number: 76 – 21, 428.

http://en.wikipedia.org/wiki/Georg_Wilhelm_Friedrich_Hegel

Ingersoll, Earl G. (ed.), (1994), *Doris Lessing: Conversations*, Princeton, New Jersey: Ontario Review Press.

Lessing, Doris, (1974), *A small Personal Voice*, ed. Paul Schlueter, New York: Alfred A. Knopf.

Lessing, Doris, (2010), *The Four-Gated City*, Adobe Digital Edition, HarperCollins e-books.

Neumann, Erich, (1969), *The Origins and History of Consciousness*, Trans. R. F. C. Hull, Princeton, N. J. : Princeton University Press.

Rubenstein, Roberta, (1979), *The Novelistic Vision of Doris Lessing: Breaking the Forms of Consciousness*, Urbana, Chicago, London: University of Illinois Press.

Watkins, Susan, (2010), *Doris Lessing*, Manchester, New York: Manchester University Press.

“PARATHËNIA SI NJË ELEMENT I RËNDËSISHËM NË PËRKTHIMIN E LETËRSISË PËR FËMIJË”

Msc. Eriola Qafzezi
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Përmbledhje

Ky artikull synon të paraqesë një sërë argumentash që theksojnë rëndësinë e parathënies si një nga elementët më të rëndësishëm në përkthimin e letërsisë për fëmijë. Në fillim të artikullit përmenden disa qëndrime nga studiues dhe përkthyes të ndryshëm në lidhje me shkallën e dukshmërisë së përkthyesit nëpërmjet parathënies si dhe funksionet e saj. Nëpërmjet shembujve të shkëputur nga korpusi nën shqyrtim, do të analizojmë funksionet e parathënies në disa vepra të letërsisë për fëmijë të përkthyer në gjuhën shqipe. Në përfundim të këtij artikulli do të rendisim qëllimet kryesore të parathënieve të përfshira në këtë studim si dhe do të parashtrijmë disa mundësi për shtrirjen e këtij punimi në të ardhmen.

Fjalët çelës: letërsi për fëmijë, parathënie, funksione, përkthyes, shkrimtar, krahasim

.

Abstract

This article aims at presenting a series of arguments in order to emphasize the importance of the preface in translation of children's literature. In the beginning there will be mentioned some viewpoints of various scholars and translators with relevance to the degree of visibility of the translator witnessed through the preface. The examples extracted from the actual corpus will serve the aim of observing and analyzing the functions of the prefaces in some works of children's literature translated into Albanian. The article is concluded by listing the main aims of prefaces studied and by giving some recommendations concerning the way the present study can be further extended in the future.

Key words: children's literature, preface, functions, translator, writer, comparison.

1. Hyrje

Ky artikull ka për qëllim të parashtrijë një sërë argumentash dhe pikëpamjesh që nxjerrin në pah rëndësinë e parathënies si një nga elementët që shfaqin praninë e përkthyesit në letërsinë për fëmijë. Do të përmendim fillimisht disa pikëpamje të përkthyesve dhe studiuesve në lidhje me rolin dhe funksionet e parathënies. Më pas do të shqyrtojmë konkretisht disa vepra për fëmijë të letërsisë angleze të përkthyer në gjuhën shqipe dhe parathëniet e tyre (nëse veprat kanë të tilla). Do të shohim çfarë të dhënash përfshihen dhe sesa na ndihmojnë këto të dhëna për të mësuar më shumë rreth procesit të përkthyerit dhe vështirësive me të cilat është përballur përkthyesi gjatë këtij procesi. Artikulli do të mbyllet duke përmendur në mënyrë të përmbledhur qëllimet e parathënieve të korpusit në fjalë dhe duke sugjeruar disa mënyra sesi mund të shtrihet ky punim në të ardhmen.

2. Qëllimet e punimit

Krahasimi i veprave të shkruara në anglisht me variantet e tyre në gjuhën shqipe si dhe sjellja e shembujve konkretë do të na ndihmojë t’iu përgjigjemi pyetjeve të mëposhtme, që mbulojnë edhe qëllimet e këtij punimi:

- Çfarë qëndrimi mbajnë studiues të ndryshëm për nivelin e dukshmërisë së përkthyesit dhe cilët janë disa elementë, nëpërmjet të cilëve shfaqet përkthyesi?
- A janë të shoqëruar me parathënie shkruar nga vetë përkthyesit variantet në gjuhën shqipe? Nëse po, çfarë roli luan një element përbërës i tillë dhe si mund të na ndihmojë parathënia në analizën studimore dhe krahasimore të korpusit në fjalë? A ka ndonjë ndryshim në plan diakronik?
- Çfarë të dhënash mund të zbulojmë nëpërmjet parathënies edhe nëse ajo nuk është shkruar nga vetë përkthyesi?
- Sa ndikon parathënia në mënyrën e perceptimit të origjinalit?
-

3. Korpusi i përdorur dhe metodologjia e punimit

Për të përmbushur qëllimet e këtij punimi, kemi analizuar një sërë veprash origjinale në gjuhën angleze dhe i kemi krahasuar ato me variantet e tyre në gjuhën shqipe. Vepra të tilla, si: “*Alice’s Adventures in Wonderland*”, “*Gulliver’s Travels*”, “*The Big Fat Giant*” dhe variantet e tyre në gjuhën shqipe i janë nënshtruar një procesi të kujdesshëm leximi dhe krahasimi paralel në të dyja gjuhët me qëllim identifikimin e të dhënave të shprehura nëpërmjet parathënies ose komenteve të përkthyesit të shprehura në fillim ose në fund të veprës. Prania e varianteve të ndryshme në gjuhën shqipe të së njëjtës vepër, shkruar në gjuhën angleze, do të na ndihmojë edhe më tepër në këtë studim përjasës. Parashtrimi i dukurive të spikatura në të gjithë korpusin, shoqëruar me shembuj ilustrues, mundëson përmbushjen e qëllimeve të sipërpërmendura.

4. Parathënia dhe roli i saj

Pozicioni i përkthyesit në të ardhmen është po kaq i vështirë për t’u përcaktuar sadhe vetë termi ‘përkthim’. Por roli i përkthyesit në të ardhmen është më pak i hapur ndaj diskutimeve. Ai duhet të konsiderohet si një figurë kyçe gjatë nxitjes së nivelit më të lartë të kuptimit mes popujve dhe kombeve. Ai nuk duhet të konsiderohet si anonim...Ai është “i padukshëm” vetëm kur komunikimi është i qartë dhe nuk lë asgjë për t’u diskutuar. Në raste të tjera, kur fillojnë dyshimet ose dallimet kulturore, përkthyesi duhet të shkruajë një parathënie më vete, ku të shpjegojë sesi e ka kryer punën e tij ... një roman i përkthyer që nuk ka parathënie, si përkthyesit duhet të jetë diçka qëi përket së shkuarës, dhe, rrjedhimisht, si parathënia, ashtu edhe vetë vepra, duhet të tërheqin vëmendjen e kritikut. [13]

Këto fjalë, shkruar tridhjetë vjet më parë nga studiuesi dhe përkthyesi Njumark(*Newmark*), vazhdojnë të jenë të vërteta edhe sot. Një pjesë e mirë e veprave të përkthyer në gjuhën shqipe kanë shumë pak gjurmë të dukshme të pranisë së përkthyesit, një ndër elementët e së cilës shprehet, pikërisht, nëpërmjet

parathënies. Akoma më shumë theksohet një dukuri e tillë në letërsinë e përkthyer për fëmijë, duke e anashkaluar parathënien dhe duke e trajtuar atë si një element deri diku të panevojshëm qoftë nga ana e përkthyesit, qoftë nga ana e shtëpisë botuese, kryesisht nisur nga paragjykimi se lexuesit në moshë të re nuk priren të ndalen në shfletimin e faqeve të tepërta që do t'i largojnë nga procesi aktual i të lexuarit dhe kuptuarit të veprës. Gjatë këtij punimi, ne do të sjellim një sërë argumentash dhe shembujsh për të mbështetur mendimin se parathënia është një përbërës me mjaft rëndësi që vendos ura komunikimi me veprën origjinale, shkrimtarin origjinal, përkthyesin dhe strategjitë e përdorura prej tij, vështirësitë e hasura gjatë procesit të të përkthyerit, etj., dhe nëpërmjet së cilës, përkrah elementëve të tjerë, ne mund të diskutojmë rreth shkallës së pranisë së përkthyesit dhe mënyrës së perceptimit të veprave të përkthyer.

4.1 Qëndrime të ndryshme mbi rolin e parathënies

Në këtë nënçështje do të përmendim në mënyrë të përmbledhur disa qëndrimembi rolin e parathënies, që do të na ndihmojnë të reflektojmë edhe më shumë rreth nevojës së pranisë së tyre në përkthimet në ditët e sotme.

Ritva Hartama-Hajnonen (Ritva Hartama-Heinonen) në artikullin e saj “Translators’ Prefaces—A Key to the Translation?” arrin në përfundimin: *Përkthyesi është lidhja mes tekstit origjinal dhe përkthimit, dhe për këdo që është i interesuar mbi përkthimet dhe cilësinë e tyre, parathëniet ofrojnë një pikë fillestare shumë të mirë, ndoshta një mënyrë për të njohur tekstin e përkthyer ose edhe për të hapur një dritare për botën e përkthyesit.*[7]

Nga ana tjetër, *Lorens Venuti (Lawrence Venuti)*, një studiues i njohur gjerësisht për studimet e tij të hollësishme në lidhje me dukshmërinë e përkthyesit në produktin përfundimtar, shprehet pozitivisht dhe e mbështet dukshmërinë e përkthyesit, duke e konsideruar parathënien si një nga elementët që ndihmon për të nxjerrë më në dukje praninë e tij. Ja sesi shprehet vetë *Venuti* në këtë drejtim:

Përkthyesit duhet të bëjnë detyrimisht njëpërsëritje të kodeve kulturore, ekonomike, ligjore, që i kufizojnë dhe i shfrytëzojnë ata. Ata mund të punojnë për të përsëritur konceptin individualist të autorësisë që e ka kufizuar përkthimin në kufijtë e kulturës anglo-amerikane, jo vetëm duke zhvilluar risi të praktikave përkthimore nëpërmjet të cilave *puna e tyre bëhet e dukshme për lexuesit*, por edhe duke prezantuar keto praktika nëpërmjet *parathënieve, eseve, leksioneve, intervistave.* [17]

Padukshmëria e përkthyesit në ditët e sotme ngre një sërë çështjesh kaq shqetësuese në lidhje me ekonominë gjeopolitike të kulturës saqë, për t’u përballur me to, nevojitet një numër edhe më i madh të dhënash në lidhje me përkthimin. Pikëpamja jonë nënkupton një besim utopik në fuqinë e përkthimit për të bërë dallimin, *jo vetëm për lindjen e formave të reja kulturore, por edhe në lindjen e marrëdhënieve të reja kulturore në botë.* [17]

Pra, sipas *Venutit*, përkthimi duhet të kontribuojë në arritjen e kuptimit mes popujve dhe kombeve të ndryshme, gjë që bëhet e mundur nëpërmjet rritjes së dukshmërisë

së përkthyesit në veprën e përkthyer, ku një element i rëndësishëm për përmbushjen e këtij misioni është pikërisht *parathënia*.

Pitër Bush (Peter Bush), shkrimtar dhe përkthyes e mbështet dukshmërinë e përkthyesit duke u shprehur pozitivisht në lidhje me *parathënien* si dhe shënimet në fund të faqes dhe shfaqjes së emrit të përkthyesit në kopertinë, si një nga mënyrat për ta dalluar përkthimin si të tillë[1]. Nga ana tjetër, *Kerëlmajer (Carol Maier)* mendon se vetë përkthyesit kanë faj që nuk janë shumë të famshëm. Shënimet e përkthyesve shpesh shkruhen në fund të faqes ose në fund të librit, në hyrje ose në përfundim të veprës, dhe jo si komunikime nga “*hapësira e ndërmjetme*”[12]. Kjo ndodh edhe për arsye se shtëpitë botuese dhe lexuesit presin që përkthyesit të “*sjellin rezultatet e përkthimit më shumë se sa të flasin rreth eksplorimeve të tyre*”. Në të vërtetë, do të ishte me shumë interes për lexuesit dhe studiuesit që kjo “*hapësirë e ndërmjetme*” të ofronte një diskutim nga ana e vetë përkthyesit nisur nga vetë përvoja e tij gjatë procesit konkret të përkthimit, dhe jo vetëm të dhëna rreth shkrimtarit të veprës origjinale dhe subjektit apo personazheve.

Njumarku shprehet se *parathënia* është një mënyrë për të nxitur të kuptuarin në nivel ndërkulturor [13]. Ai beson se dukshmëria e përkthyesit duhet të rritet kur boshllëku kulturor ndërmjet tekstit burimor dhe mbërritës rritet, dhe *parathënia* e përkthyesit është një mjet që mund ta ndihmojë lexuesin ta kapërcejë këtë boshllëk.

Sipas *Edvin Gentzler (Edwin Gentzler)* shtëpitë botuese po eksperimentojnë me forma të reja për prezantimin e përkthimeve, duke përfshirë përdorimin e materialeve shtesë suplementare, si për shembull *parathëniet*, hyrjet, intervistat, shënimet në fund të faqes [6], gjë që tregon se idetë e Venutit po fitojnë gjerësisht mbështetje. Diçka e tillë do të gjente vend edhe për përkthimet në hapësirën shqiptare, dhe do të ishte shumë domethënëse në përkthimin e letërsisë për fëmijë.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se funksionet e *parathënies*, sipas studiuesve të sipërpërmendur, janë rritja e nivelit të dukshmërisë së përkthyesit, dhënia e shpjegimeve mbi aktivitetin e të përkthyerit, eksplorimi ndërkulturor, etj.

4.2 Të dhëna konkrete rreth *parathënies* në korpusin nën shqyrtim

Në këtë nënçështje do të rendisim disa nga të dhënat që kemi zbuluar në *parathëniet* e korpusit të këtij studimi, gjë që do të na ndihmojë të reflektojmë rreth shkallës së pranisë së përkthyesit në variantet në gjuhën shqipe.

4.2.1 *Alice's Adventures in Wonderland* dhe variantet në gjuhën shqipe

Varianti i parë është botuar në Tiranë në vitin 1944 nga shtëpia botuese *Tirana me botonjës Ismail Mal' Osmani*. Në kopertinë shënohet emri i autorit siç shkruhet në anglisht *Lewis Carroll*, titulli i librit “*Liza në Botën e Çudinave*” si dhe shënimi *Përkthyer prej origjinalit nga Hysejn Çela dhe Beqir Çela* (shënim ky që përsëritet edhe në pjesën e brendshme të librit së bashku me shënimin tjetër *Të drejtën e ribotimit e rrujë përkthyesat*). Në faqen nr.7 dhe 8 gjejmë një *Parathënie* mjaft të vlefshme të shkruar nga vetë përkthyesit, ku ata, pasi njohin faktin se vepra është një kryevepër në *letërsinë feminare* anglo-saksone, shkëputin një pjesë të *parathënies* së një botimi amerikan të shkrimtares *Anna Eleonor Roosevelt* - “si përrallëz, **fëmijët** e

çdo gjenerate kanë gjetë në Lizën të vërteta dhe marrina të blueme e të gërshtueme aq bukur, sa me mbetë përherë të kënaqun prej tyne; por kur fillojmë **të rritemi** dhe të lexojmë në të disa nga kuptimet më të holla, që përmban mbi politikën dhe jetën përgjithësisht, e shijojmë ndoshta edhe më tepër...'[2]. Për këto arsye, shprehen përkthyesit, “prej shumë kohësh e kishim quejtë një punë të dobishme përkthimin e Lizën në gjuhën t'onë, kështu-që edhe fëmijët Shqiptarë të mund të kishin në dorë një libër të kandshëm dhe të përshtatun nga çdo pikëpamje për moshën dhe kërkesat e mendjeve të tyre në formim e sipër”[2]. Përkthyesit përmendin faktin se punën për përkthime patën nisur para shumë vjetësh por u desh të kalonte shumë peripeci të ngjashme më vetë Lizën derisa u botua. Është me rëndësi të përmendim se përkthyesit japin më poshtë edhe një *justifikim të nevojshëm*, faktin se *Lewis Carroll* e ka shkruar origjinalin në një gjuhë fëminore angleze dhe kjo përbën një vështirësi për përkthyesat *për me e përkthye në një gjuhë fëminore Shqipe*. Para botimit të variantit përfundimtar, përkthyesit kanë bërë shumë **prova** duke lexuar pjesë të përkthyer në klasa të ndryshme të shkollave fillore të vendit, megjithatë shfaqësohen për vështirësi ose mungesë rrjedhshmërie që mund të gjenden në gjuhën e tekstit. Në fjalët e fundit ata përmendin krenarinë e tyre për faktin se kanë sjellë në duart e lexuesve të **vegjël** dhuratë të rallë siç është “*Liza në Botën e Çudinave*”, meqenëse *letërsia fëminore në Shqipëri është dhimbshunisht aq e vorfën*, sa me e meritue të përfillet si e paqënë. Prandej, punëtorët e kësaj lëme kujtojmë se meritojnë njëfarë **miradije**, ose, të paktën një gjykim të zbutun mbi vlerën e punës së tyre[2].

Bazuar në këtë parathënie mund të parakuptojmë një sërë gjërash edhe pa nisur të lexojmë më tej përkthimin: vepra në origjinal u drejtohet si fëmijëve edhe të rriturve, ndërsa përkthyesit e përmendin disa herë se *Liza* u drejtohet lexuesve të vegjël, libri është përshtatur për formimin mendor të fëmijëve, janë bërë përpjekje për të përdorur një gjuhë fëminore shqipe etj. Me rëndësi është të vemë në pah edhe faktin se përkthyesit kërkojnë të ndërgjegjësojnë lexuesit për vështirësitë në punën e tyre (si praktike ashtu edhe materiale) si dhe të fitojnë mirënjohje për përkthimin e bërë. Gjithashtu, theksohen edhe kontributi që sjell vepra e përkthyer në letërsinë për fëmijë në Shqipëri si dhe disa nga vështirësitë me të cilat janë përballur përkthyesit gjatë sjelljes së veprës në gjuhën shqipe.

Në faqen e parë të **variantit të dytë** kemi këto të dhëna: emrin e shkrimtarit *Levis Karoll*, titullin të shkruar me gërma të mëdha *LIZA NE BOTEN E ÇUDIRAVE*, shënimin *Përkthyer prej origjinalit nga Maqo Afezulli* si dhe *Tiranë, 1961*. Më tej vjen parathënia (në faqet 3-4) e shkruar jo nga vetë përkthyesi i veprës, por nga *Bedri Dedja*. Që në titullin e parathënies lexojmë *Një libër i dashur për fëmijë* ku libri prezantohet si një *dhuratë e bukur* që iu bëhet fëmijëve nga ndërmarrja shtetërore e botimeve “Naim Frashëri”. Bedri Dedja rrëfen fillimisht historinë sesi është krijuar kjo *vepër e dashur për fëmijë* nga **Levis Karoll**. Në parathënie njihemi edhe me faktin se ky është botimi i dytë i librit në gjuhën shqipe, pas botimit të vitit 1944. *Bedri Dedja* na lënë të kuptojmë se përkthimi u drejtohet fëmijëve. Nuk gjejmë asnjë koment në parathënie lidhur me vështirësitë apo humbjet gjatë përkthimit të veprës, apo të dhëna për vetë përkthyesin. Pra, në përmbledhje,

mund të themi se qëllimet kryesore të kësaj parathënieje janë informimi i lexuesve në lidhje me shkrimtarin dhe subjektin e veprës si dhe me përkthimet e mëparshme të kësaj vepre.

Varianti i tretë paraqet në kopertinë një pamje të një vajze të vogël (nuk është aspak e ngjashme me ilustrimet origjinale të *Tenniel*), duke parë në një qiell të errët të rrethuar nga yje. Në krye jepet emri *Ljuis Kerël* dhe më poshtë titulli me gërma të mëdha *LIZA NË BOTEN E ÇUDIRAVE*, si dhe *Shtëpia Botuese Mesonjëtorja*. Në ballinë shkruhet përsëri autori, titulli *Liza në botën e çudirave* si dhe, poshtë titullit, *Përktheu: Maqo Afezolli*, e më poshtë *Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja”, Tiranë, 1998*. Parathënia *E fshehta e botës së çudirave* është shkruar nga *Naum Prifti* në faqet 3-9. Që në fillim *Prifti* përmend se vepra u bë dalëngadalë një nga më të përhapurat në letërsinë angleze **për fëmijë**, dhe, *si çdo vepër e mirë e letërsisë për fëmijë, ajo filloi të tërhiqte vëmendjen e të rriturve dhe të lexohej me dëshirë dhe prej tyre*. *Prifti* përmend gjithashtu se letërsia e shek. XIX u shkëput nga *kërkesat didaktike e moralizimet e drejtpërdrejta* dhe se merita e veprës në letërsinë për fëmijë ka të bëjë me *zbulimin e një bote të jashtëzakonshme e të zakonshme nga vetë fëmijët*. Më pas jepen të dhëna në lidhje me *Kerëln*, aftësitë e tij krijuese, dëshirës për të qëndruar me fëmijë e për t’i fotografuar ata. Pasi na informon saktë edhe në lidhje me historinë e krijimit të veprës origjinale gjatë një shëtitjeje me varkë të autorit me të tria vajzat *Lidëll*, *Prifti* zhbiron arsyet e suksesit të veprës, zbulon disa parodi (krijimet poetike të kohës) dhe satira (skena e gjyqit), kundërsense e ilogjizma, kalimet nga bota e vërtetë në botë fantastike si dhe gërshetimin e fantazisë me humorin. Në fund të parathënies lexojmë *Është e kuptueshme se përkthimi i veprave humoristike pëson humbje, po megjithatë, edhe kështu na jepet mundësia të shijojmë humorin dhe talentin e njërit prej autorëve të shquar të letërsisë botërore për fëmijë* [9]. *Naum Prifti* që në fillim të parathënies na njeh me faktin se vepra lexohet si nga fëmijë edhe të rritur, megjithatë nënkuptohet se ky përkthim u drejtohet kryesisht fëmijëve. Vetëm rrjeshtat e fundit të parathënies na lënë të kuptojmë se vepra përmban humor dhe si e tillë do të pësojë humbje, por qëllimi është të njohim dhe shijojmë talentin e autorit origjinal, kështu që një farë humbjeje do të duhet të tolerohet. Kështu, ndër qëllimet e kësaj parathënieje, ndonëse të shkruar jo nga vetë përkthyesi, përmendim informimin e lexuesve, vështirësitë në përkthimin e disa llojeve të veçanta zhanresh si dhe humbjet e pashmëngshme gjatë përkthimit.

Varianti i katërt jep në kopertinë emrin e autorit *Ljuis Kerël*, titullin *Liza në botën e çudirave* dhe shtëpinë botuese *Botimet Vëllezërit Tafa*. Në ballinë ndodhet shënimi *Kolana Kryeveprat e letërsisë botërore për fëmijë* – pra, kypërkthimi u drejtohet lexuesve të vegjël (gjë që kuptohej edhe nga kopertina). Në faqen tjetër lexojmë **Përkthyer nga Taulant dhe Eri Tafa, Diplomuar në Universitetin e Bolonjës, © Të drejtat janë të rezervuara** dhe po në të njëjtën faqe *Letërsi e sotme për fëmijë ... Shqipëruar nga Taulant dhe Eri Tafa përkth. Taulant dhe Eri Tafa*, dhe në faqen tjetër *Ljuis Kerël, Liza në botën e çudirave, Përkthyer nga Taulant dhe Eri Tafa, Diplomuar në Universitetin e Bolonjës*. Mund të shikojmë se si kalohet nga *përkthej* në *shqipëroj* pa i dhënë rëndësi dallimit mes

këtyre termave. Parathënie nuk ka, pra, mungojnë komentet që do të mund të informonin në lidhje me autorin, statusin e veprës origjinale, komentet mbi vështirësitë gjatë përkthimit, etj.

Varianti i pestë titullohet *Liza në botën e çudirave* dhe në kopertinë gjejmë këto të dhëna përveç titullit: emrin e shkrimtarit *Luis Kerol* dhe gjininë *novelë*. Në faqen më tej zbulojmë përkthyesin *Frederik Shuraja*, si dhe shtëpinë botuese dhe vitin e botimit - Redona, Tiranë 2008. Në brendësi të parathënies, përkthyesi na njeh me faktin se vepra origjinale përmban një sërë lojërash fjalësh gjë që përbën jo vetëm vështirësi gjatë përkthimit, por edhe interes të veçantë. Që në fillim ai vetështron pyetjen “*Përse edhe një përkthim tjetër i Lizës*” dhe më pas na sjell këtë përgjigje “*Problemi është se përkthyesit e ‘Lizës’ i janë përmbajtur më tepër variantit të tyre të ritregimit, përshtatjes, rikrijimit. Këto përkthime, megjithëse janë sjellë në gjuhë më të gjallë se origjinali, kanë një problem: Keroli nuk ka shkruar ‘këtë Lizë’. Ndaj qëllimi im është të sjell në gjuhën shqipe një përkthim sa më të saktë, kuptohet aq sa lejojnë ndryshimet e gjuhës angleze me atë shqipe*” [11]. Misioni i përkthyesit është që të na sjellë në duart tona **një përkthim sa më të saktë** brenda mundësive që i lejon gjuha shqipe dhe ndryshimet e saj me anglishten. Mbetet për t’u diskutuar fakti se përse përkthyesi iu referohet përkthyesve të mëparshëm duke theksuar se ata kanë sjellë një “Lizë tjetër” në duart e lexuesve dhe gjithashtu, çka është edhe më me rëndësi për diskutimin tonë, çfarë nënkupton ai me “përkthim sa më të saktë”. Më tej ai shprehet “*Natyrisht, vështirësia më e madhe qëndron te përkthimi i lojës së fjalëve...Në përkthimet e tjera, përkthyesit kanë synuar të mos i përkthejnë lojërat e fjalëve, por të japin variantin e tyre, që nuk ka asgjë të përbashkët me origjinalin. Kam synuar, si rregull, të ruaj variantin e autorit, qoftë edhe pjesërisht.*” [11]. Nuk është shumë e qartë se pse përkthyesi mendon se mospërkthimi i lojërave të fjalëve përbën një shmangie nga *përkthimi i saktë*, në fund të fundit, edhe vetë përkthyesi në fjalë tregohet kontradiktor kur thotë se synon të ruajë variantin e origjinalit, por një gjë e tillë nuk është gjithmonë e mundur. Vështirësi të tjera që përkthyesi ka hasur përmenden prej tij në vazhdim të parathënies, si për shembull, përkthimi i vargjeve (parodive), të cilat përkthehen saktë, ndërsa vargjet e parodizuara jepen me shënime. Përkthyesi na shpjegon se në disa raste *ka qenë i detyruar të shmanget nga përkthimi i saktë i tekstit të Kerolit*, raste që kanë të bëjnë me përkatësinë gjinore si dhe përdorimin e përemrit “*ju*” në raste politese. Siç mund të vihet re, përkthyesi që në fillim na njeh me arsyen e përkthimit të tekstit burimor (sjellja në gjuhën shqipe e një përkthimi sa më të saktë) dhe, njëkohësisht, na bën të ditur problemet gjatë procesit të përkthimit të veprës origjinale (përkthimi i lojërave të fjalëve, parodive etj.) duke theksuar vazhdimisht *përkthimin e saktë* dhe rastet kur i është dashur t’i shmanget një përkthimi të tillë. Pavarësisht faktit se nuk janë të qarta kriteret për përcaktimin e një përkthimi të saktë apo vetë cilësimit *përkthim i saktë* që lë vend për diskutim, nuk përmendet publiku të cilit i drejtohet ky përkthim, fëmijëve apo të rriturve. Mendojmë se përkthimi u drejtohet njëkohësisht të rriturve dhe fëmijëve. Kjo për arsye se në fund të librit jepen një sërë shpjegimesh për lojërat e fjalëve dhe paroditë, gjë që do të ishte krejt e panevojshme për lexuesit (fëmijët) dhe kërkon vëmendjen dhe përqëndrimin e të rriturve. Megjithatë, pas këtyre shënimeve, në faqet që vijojnë në

përmbyllje të përkthimit, jepet rubrika *Studim i thelluar* që rendit një sërë ushtrimesh reflektuese mbi tekstin, punësh të pavarura, teknika të tilla si klaster, brainstorming, diagrami Ven, etj., gjë që pikësepari, e largon shumë përkthimin nga qëllimet e origjinalit (Kerol nuk ka shkruar këtë “Lizë” didaktizuese) dhe së dyti, e kanalizon librin si një vepër për fëmijë

4.2.2 *Gulliver’s Travels* dhe variantet në gjuhën shqipe

Kemi përzgjedhur dy variante në gjuhën shqipe, i pari është botuar në vitin 1974 dhe i dyti në vitin 2007. Varianti i parë hapet me një parathënie shkruar nga Spiro Çomora (pra, jo nga vetë përkthyesi). Në këtë parathënie fillimisht jepen një sërë të dhënash biografike për shkrimtarin si dhe epokës historike të Anglisë në shekullin XVIII dhe ndikimet e ngjarjeve të ndryshme në formësimin dhe shprehjen e satirës të Suiftit. Më tej shtjellohen një sërë faktesh interesante rreth veprës origjinale, organizimit të saj, perceptimin e saj nga bashkëkohësit si dhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm në qesëndisjen e hapur apo të fshehtë, të endur hollësisht dhe mjeshhtërisht prej shkrimtarit. Vetëm në paragrafin e fundit të hyrjes gjejmë të dhëna në lidhje me përkthimin e veprës dhe vështirësitë e këtij procesi. Vepra cilësohet si e shqipëruar dhe, për më tepër, *puna e shqipëruarit të saj ... s’duhet të ketë qenë e lehtë*. Vështirësia kryesore duhet të ketë qenë sjellja në gjuhën shqipe e një leksiku të pasur në emra, vende, zakone dhe objekte dhe përcimi me po aq thjeshtësi të stilit karakterizues të shkrimtarit [16]. Me interes është fakti se në fund të veprës së përkthyer jepen një sërë shpjegimesh për çdo kapitull nga ana e përkthyesit, të cilat qartësojnë për lexuesit nënkuptimet, pjesët satirike si dhe elementëndërtëkstualë që nuk janë të kapshëm për lexuesit shqiptarë, veçanërisht fëmijët. Në këtë drejtim, mund të themi se këto shënime përmbushin pjesërisht qëllimet e parathënies nëse ajo do të ishte shkruar nga vetë përkthyesi. Varianti i dytë nën shqyrtim është botim i vitit 2007 dhe që në fillim lexojmë se libri është përshtatur për fëmijë nga Astrit Bishqemi. Vepra në gjuhën shqipe nuk shoqërohet as me parathënie dhe as me shënime apo komente në fund të librit, pra, nuk ndiehet prania e përkthyesit nëpërmjet këtyre elementëve. Një studim dhe krahasim më i hollësishëm tregon se ky variant nuk përmban shumë pjesë nga vepra origjinale, duke sjellë kështu në shqip njëpërmbledhje të origjinalit ku kanë humbur shumë elementë satirikë, gjë që nënkuptohet edhe nga fakti i shprehur qartë se kemi të bëjmë me një përshtatje për fëmijë.

4.2.3 *The Big Fat Giant* dhe varianti i përkthyer në gjuhën shqipe

Në gjuhën shqipe kemi gjetur një përkthim të vitit 1990 të “*The Big Fat Giant*” shkruar nga Roald Dahl. Në kopertinë jepet emri i shkrimtarit ashtu siç transkriptohet në gjuhën angleze, ndërsa në brendësi lexojmë se vepra është shqipëruar nga Naum Prifti. Varianti i përkthyer shoqërohet edhe me parathënie të shkruar nga redaktorja e veprës në gjuhën shqipe Brikena Çabej. Janë një sërë të dhënash që përcjillen nga kjo parathënie. Së pari, pozicionohet origjinali brenda letërsisë humoristike angleze, duke iu referuar në këtë drejtim edhe romanit “*Liza nëbotën e çudirave*” si një shembull klasik i kësaj letërsie. Më tej përshkruhet personazhi kryesor Sofia si dhe qëllimet e shkrimtarit në krijimin e një personazhi të tillë. Nuk mungojnë gjithashtu edhe të dhënat biografike mbi shkrimtarin. Në

paragrafin e fundit që mbyll parathënien lexojmë një koment me rëndësi për procesin e të përkthyerit: *Veçanësi e romanit GjMM janë lojërat e fjalëve që krijojnë në çdo çast situata komike shumë zbavitëse. Këto natyrisht nuk mund të përkthehen, ato duhen krijuar sërish në gjuhën që sillen. Kjo e vështirëson së tepërmi punën e përkthimit të veprës, e nxirte atë përtej kufijve të përkthimit. Duhej pra një shkrimtar, madje një shkrimtar humorist, që t'i krijonte ato sërish në shqip. Naum Prifti e mori përsipër me kënaqësi këtë punë dhe ia doli mbanë me sukses të plotë, duke e bërë GjMM të flasë shqip*[3]. Këto janë gjithë të dhënat që mund të zbulojmë rreth përkthimit dhe përkthyesit meqenëse ky i fundit nuk e ka shkruar vetë parathënien dhe kështu që nuk mund të zbulojmë më konkretisht vështirësitë e sipërpërmendura.

5. Diskutim përmbledhës

Pasi kemi renditur një sërë shembujsh ilustrues mund të themi se qëllimet e parathënies që shoqërojnë veprat e përkthyerja janë:

- Informimi në shkallë të ndryshme në lidhje me shkrimtarin dhe me veprën origjinale (të dhëna biografike, qëllimet e veprës, mesazhet, subjekti, personazhet);
- Qartësimi i arsyeve përse është marrë përsipër përkthimi ose ripërkthimi i veprës;
- Njohja me përkthimet e mëparëshme (nëse ka);
- Identifikimi i publikut të cilit i drejtohet vepra e përkthyer kundrejt veprës origjinale;
- Parashtrimi i vështirësive me të cilat është përballur përkthyesi gjatë përkthimit të veprës (gjuha fëminore, humori, lojërat e fjalëve);
- Shfajësimi ose justifikimi për pasaktësira të mundshme;
- Pozicionimi i veprës së përkthyer brenda letërsisë shqipe;
- Përcaktimi i veprës si përkthim apo shqipërim;
- Kërkim mirënjohjeje nga ana e publikut për punën e bërë nga përkthyesi.

Vërejmë gjithashtu se, në një këndvështrim diakronik, parathënia fillon të mos shfaqet në veprat e përkthyerja ose nuk shkruhet nga vetë përkthyesi. Duke e mbyllur këtë diskutim theksojmë se parathënia është një element që nuk duhet të mungojë në një vepër të përkthyer dhe do të ishte vërtet me interes jo vetëm për studime krahasuese, por edhe për një të kuptuar më të thellë të veprës dhe ndërgjegjësim të rolit dhe vështirësive të përkthyesit, veçanërisht në rastet kur ajo shkruhet nga vetë përkthyesi.

6. Shtrirja e studimit në të ardhmen

Qëllimi kryesor i këtij punimi ishte të rendisnim disa nga arsyet e nevojshmërisë së pranisë së parathënies në veprat e përkthyerja, duke e argumentuar këtë edhe përmes shembujve konkretë. Punimi mund të pasurohet në të ardhmen edhe më thellësisht duke nxjrrë në pah edhe elementë të tjerë që theksojnë dukshmërinë e përkthyesit si

për shembull shënimet në fund të faqes ose në fund të veprës, komentet e përkthyesit, shprehjen e qëndrimit të tij nëpërmjet interpretimeve subjektive etj. Studimi i hollësishëm i elementëve të tillë do të na ndihmojë për të krijuar përshtypje edhe më të sakta në lidhje me përkthyesin, rolin e tij në përkthimin e veprës përkrah shkrimtarit origjinal dhe përjasje rreth mënyrës së perceptimit të veprës në gjuhën origjinale kundrejt përkthimit në gjuhën shqipe.

Bibliografi

- Bush, P.**, *Quarantine* by Juan Goytisolo. London: Quartet Books, (trans.)(1994) .
- Carroll, L.**, *Liza në Botën e Çudinavet*, (përkth.) Hysejn dhe Beqir Çela, Botonjës Ismail Mal'Osmani: Tiranë, (1944).
- Dahl, R.**, *Gjiganti i madh i mirë*, Naum Prifti, Naim Frashëri, Tiranë, (përkth.) (1990) .
- Dahl, R.**, *The BFG*, Clays Ltd., Great Britain, 2013.
- Gardener, M.**, *The Annotated Alice – the Definitive Edition*, W. W. Norton & Company: New York, USA, 2000.
- Gentzler, E.**, *Contemporary Translation Theories*, 2d ed. Clevedon: Multilingual Matters, 2001.
- Hartama, H., R.**, “Translators’ Prefaces—A Key to the Translation?” *Folia Translatologica* 4: 33-42, 1995.
- Karoll, L.**, *Liza ne Boten e Çudirave*, (përkth.) Maqo Afezolli, Mihal Duri, Tiranë, 1961.
- Kerël, L.**, *Liza në Boten e Çudirave*, Maqo Afezolli, Shtëpia Botuese ‘Mësonjëtorja’: Tiranë, 1998) (përkth.).
- Kerël, L.**, *Liza në Botën e Çudirave*, Taulant dhe Eri Tafa, shtëpia botuese Botimet Vëllezërit Tafa: Tiranë, (2008) (përkth.).
- Kerol, L.**, *Liza në botën e çudirave*, (përkth.) Frederik Shuraja, Redona, Tiranë, (2008).
- Maier, C.**, “Toward a Theoretical Practice for Cross-Cultural Translation”. In *Between Languages and Cultures: Translation and Cross-Cultural Texts*, Anuraha Dingwaney and Carol Maier (eds). Pittsburgh and London: University of Pittsburgh Press, (2008).
- Newmark, P.**, “Introductory Survey”. In *The Translator’s Handbook*, Catriona Picken (ed). London: Aslib, (1983).
- Suift, Xh.**, *Udhëtimet e Guliverit*, (përkth.) Halit Selfo, Shtypshkronja “8 Nentori”, Tiranë, (1974).
- Suift, Xh.**, *Udhëtimet e Guliverit*, (përkth.) Astrit Bishqemi, Dy lindje dhe dy perëndime, Tiranë, (2007).
- Swift, J.**, *Gulliver’s Travels*, London J. M. Dent & Sons Ltd. Aldine House, Bedford Street, London, (1961).
- Venuti, L.**, *The Translator’s Invisibility: A History of Translation*. London and New York: Routledge, (1995).

“ANIMUS VS. ANIMA: VËSHIRËSIA E PAJTIMIT TË ARTIT DHE BESIMIT NË VEPRËN LETRARE TË POETIT FRANCEZ PAUL CLAUDEL”

Fabiola Kadi

Universiteti “Fan S. Noli”, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Përmbledhje

Punimi ynë ka në qendër poetin katolik të shekullit XX, Pol Klodel. Si ka mundur ky artist të bashkojë në veprat e tij artin poetik dhe besimin? Klodeli përshkruan betejën e përhershme në jetën e tij mes Animus dhe Anima, mendjes dhe shpirtit, arsyes dhe besimit. Poeti ka ditur të dallojë të përjetshmen dhe tokësoren pa i ndarë dhe ka bashkuar shpirtëroren dhe truporen pa i ngatërruar me njëra-tjetrën. I shpëtuar nga “*burgu materialist*” dhe relativizmi mbizotërues, ai gjeti në përvojën fetare, kuptimin e jetës njerëzore dhe burimin e pashtershëm të shpresës te besimi. Veprat e tij dëshmojnë se ky poet ka ditur t’u përgjigjet kërkesave të artit poetik edhe duke u frymëzuar nga fetarja. E përkohshmja dhe e përjetshmja gërshetohen ëmbëlsisht në veprat e tij duke u dhënë vargjeve një aromë erëmirë. Punimi mbyllet me rezultate specifike dhe përfundime në lidhje me çështjen e bashkëjetesës mes artit dhe besimit.

Fjalë çelës: animus, anima, shpirtërore, besim, bashkëjetesë.

Abstract

The aim of the present study is to investigate on a catholic poet of the twentieth century: the famous Paul Claudel. How did this artist merge poetic art and faith in his literary works? Claudel describes the persistent struggle in his life between Animus and Anima, mind and spirit, reason and faith. The poet managed to distinguish the divine from the secular and the spiritual from the physical, without posing any kind of separation or confusion between them. Being liberated from ‘*materialistic imprisonment*’ and dominating relativism, and having religious experience, he discovered in faith the sense of human life and the inexhaustible source of hope. His literary works are living proof that this poet rightfully meets the demands of poetic art, with religion being a source of inspiration. The temporary and the eternal are delightfully intertwined in his literary works, impressing everyone with delicate traces naturally felt on each verse. The paper is concluded by specific results and conclusions referring to the coexistence of faith and art in literary works.

Key words: animus, anima, spiritual, faith, coexistence.

Hyrje

Çdo vepër artistike është reflektim i autorit të saj, por gjithashtu i epokës në të cilën ai jeton dhe shkruan. Vetë autori i veprës është ai që zgjedh të shkruajë me qëllim që

të tërheqë një publik të caktuar. Vepra e poetit Pol Klodel na ofron një fushë studimi të përbashkët me atë të veprave të tjera letrare, por ajo ngre gjithashtu edhe një problem specifik të një autori që flet e shkruan për të vërtetën absolute të Ungjillit. I gjithë arti i tij lidhet ngushtë me të vërtetat biblike që ai i përjeton pas kthimit në besim. Vepra e tij na paraqet Zotin edhe atëherë kur nuk duket në pamje të parë. Ai është i pranishëm edhe atëherë kur mungon. Vepra klodeliane, për dikë që i afrohet për ta lexuar, mund të duket si një masiv i gjerë malor ; prej tij dalin maja të thepisura, si: *Tête d'Or*, *Les Grandes Odes*, *Le Partage de Midi*, *Le Soulier de satin*, por i gjithë peizazhi duket i vështirë për t'u përshkuar. Ai mund të përshkohet vetëm duke gjetur disa shtigje, përgjatë të cilave do të mund të qartësohet, ndriçohet i gjithi. Zhanret në të cilat shkroi Klodeli janë të ndryshme, të shumëllojshme, ashtu si domethëniet e veprës së tij, faqe të tëra të shkruara me këngë të një liriku, me dialogët e një dramaturgu, me analizat e një eseisti. Po si mund të hyjmë, si mund të depërtojmë në brendësi? Cilën udhë, cilin shteg duhet tëndjekim në gjithë këtë volum faqesh kaq të ndryshme nga njëra-tjetra? Ka shumë lexime të mundshme, por meqenëse Klodeli për mirë apo për keq është cilësuar si poet i krishterë, meqenëse ka një mori fjalësh nga fjalori fetar, madje teologjik që bie në sy qysh në leximin e parë të veprave të tij, ne propozojmë një lexim të veprës së Klodelit nën dritën e besimit të krishterë. Mendojmë se kjo do të na bëjë të mundur të kapim më në thellësi kuptimin e veprës së tij. Poeti i shkruan me humor mikut të tij, shkrimtarit francez, Romain Rolland-it (Romën Rolan) se është “*një përzierje e trishtë [...] mes poetit dhe teologut*”. Për këtë arsye na u duk interesante të studiojmë takimin, ndërthurjen e temave të krishtera me ato profane në vargjet e Klodelit. Në veprën e tij ka një lloj bashkëjetese dhe konflikti mes njerëzores dhe hyjnore, tokësore dhe qiellore që në të njëjtën kohë e habit dhe e mrekullon lexuesin.

1. Një fillim i ri

Poetët e shekullit XIX, secili sipas mënyrës së tij, përpiqen të zhbirojnë patejdukshmërinë dhe misterin e botës. Ata duan të njohin domethënien e gjithçkaje dhe rreken të çkodojnë, të shpjegojnë aspekte të ndryshme të ekzistencës njerëzore. Por në përpjekjen e tyre për të kuptuar botën, ata zbulojnë se nuk mund t'u japin përgjigje shqetësimeve themelore të jetës së njeriut. Në shumë raste ata theksojnë fatalitetin e jetës njerëzore në të cilën mbretëron rastësia.

Për të riun e viteve 1885-1890, ka shumë elemente që duken të errëta dhe të panjohura. Sipas fjalëve të poetit, ai, ashtu si gjithë të rinjtë e moshës së tij, lëkundej midis “*burgut materialist të filozofisë dhe shkencës ... Kur isha tetëmbëdhjetë vjeç, besoja atë që besonin pjesa më e madhe e njerëzve të kulturuar të kohës... por jetoja në imoralitet dhe pak nga pak po më pushtonte dëshpërimi*”. [11] Ai u kthye në katolicizëm më 25 dhjetor 1886, një natë Krishtlindjeje: “*Isha më këmbë, pranë shtyllës së dytë, në të djathtë, nga ana e shenjtërores. Fëmijët e korit po këndonin dhe përnjëherësh u preka thellë në zemër dhe vendosa të besoj*” [10]. Te *Contacts et circonstances*, teksta flet për ‘vitet e trishta tetëdhjetë’, dhe për kthimin në besim, Klodeli prezanton edhe diçka tjetër që lidhet njëkohësisht me letërsinë dhe me anën shpirtërore të tij, njohjen me Rembonë dhe leximin e *Illuminations* dhe *Une saison*

en enfer. Këto lexime përbëjnë një nga burimet kryesore të poetikës klodeliane. Shkrimi i Rembosë është një model, një derë drejt së resë. Por vepra e tij *Une saison en enfer* do të thotë shumë më tepër për Klodelin. Atje ai lexon problemin e tij, ‘*dëshirën për t’ia mbathur, për të lënë pas këtë burg të tmerrshëm ...! Kjo dëshirë për Oqeanin! Më në fund diçka sipas masës së mushkërive të mia.*’ Dhe ëndrra e fundit – fraza e fundit e *Une saison en enfer*: ‘*Të zotëroj të vërtetën në një shpirt dhe në një trup*’, është gjithashtu ëndrra e poetit të ri. Leximi i Rembosë përbën njëkohësisht edhe një pikë kyçe të çlirimit të tij shpirtëror: “*Për herë të parë, këta libra hapën një të çarë në burgun e materializmit në të cilin ndodhesha dhe më dhanë përshtypjen e gjallë dhe pothuajse fizike të të mbinatyrshmes*”. [10]

Megjithëse veprat e Rembosë e drejtojnë poetin tek ana shpirtërore, ato nuk mjaftojnë për t’i sjellë shpëtimin. Poeti rrëfen: “*Por gjendja ime e zakonshme e asfiksionit dhe e dëshpërimit mbetej po ajo*”. [10] Dhe në këtë pikë, kthimi në besim ndryshon situatën në të cilën ndodhet poeti dhe kështu kryhet çlirimi i tij. Natën e krishtlindjes, i riu Klodel hyn në katedralen Notre-Dame dhe dëgjon korin e kishës që këndon *Magnificat*. Klodeli kishte qenë gjithë kohën në kërkim të dashurisë, megjithatë deri në atë moment nuk kishte gjetur një përgjigje të kënaqshme. Kënga e fëmijëve të kishës dhe muzika ishte një përgjigje e mbinatyrshme ndaj kësaj nevoje për dashuri. Në këtë kohë ai kupton se njeriu nuk mund të jetë kaq i sigurt për madhësinë e tij, për dhuntitë e tij, sepse një ditë gjithçka do të zhduket, se gjithë ky thesar do të venitet dhe nuk do të ekzistojë më. Prandaj ajo çka i duhet, është përjetësia. Besimi e pushton të riun dhe e mbush të tërin. Ky besim nuk e largon atë nga poezia, ai e shtyn edhe më tepër drejt saj, duke u shfaqur në formën e një kënge. Dhe në gjithë punën e tij si poet ai do të jetë njëkohësisht këngëtar. Ai do të këndojë një këngë e cila para se t’i këndojë Zotit, do t’i këndojë veprës së Zotit, tokës. Gjatë gjithë jetës së tij, si çdo tokësor tjetër, Klodeli ka provuar të njëjtat ndjenja, të njëjtat nevoja dhe vështirësi. Poeti nuk është ndierë aspak rehat në këtë botë tokësore, nuk e ka gjetur veten këtu. Asnjë element i tokës nuk ka mundur ta mbushë boshllëkun, zbrazëtinë e tij:

“Betohem për diellin që asgjë s’e ndryshon/Qëllimin tim dhe shtegun nëpër të cilin eci dhe vajtoj,/Grua, ar tokësor, zjarr nga larg, kthesë apo qoftë hon,/Madje as buka, urinë time nuk ma shuan dot”. Ai ndihet i lodhur nga jeta që ka kaluar në këtë botë: “*E gjatë ishte mërzia, i gjatë përgjërimi!/I gjatë mërgimi! E gjatë ishte rruga deri këtu!*”. [5] Nga gjithë kjo lodhje e ky mundim, poeti ka vendosur të gjejë një rrugëdalje, një portë për të kaluar nga lëngata dhe mjerimi që e rrethon. Ai i lutet Zotit të tij që t’ia çlirojë shpirtin nga kjo botë e pavlerë:

“Një derë, një derë, o shpirti im, një derë për të dalë nga kotësia pa mbarim !/Një derë s’ka rëndësi ku, por thoni që tani ka një derë për shpëtimin e shpirtit tim.” [4]

Për Klodelin, bota pa Zotin është jo vetëm e paplotë, por tkurret në hallakatje, në pakuptimësi dhe në zbrazëti. Kaosi, anarkia, misteri i së dukshmes në veprën e tij zhduken sepse besimi në Perëndinë, në të padukshmen, e transformon çdo formë të reales në diçka domethënëse. Shpresa që përjeton poeti pas kthimit në besim është më e fuqishme se të gjitha ndjenjat e tjera. Asnjëherë, për asnjë çast, shpresa, besimi që ndien Klodeli në atë natë krishtlindjeje nuk do ta braktisin. Këto dy ndjenja do të

marrin forma nga më të ndryshmet, por sido që të jetë, do të jenë të pranishme në gjithë jetën, ashtu si edhe në gjithë veprën e tij, si një forcë, si shtysë, por njëkohësisht edhe si një mbrojtje, ndonjëherë edhe nga vetja e tij. Besimi do t'isjellë Klodelit një lloj çlirimi dhe zbulese të Shpresës. Ja si shprehet ai për këtë moment të jetës së tij: *“Dhe atëherë ndodhi ngjarja që e ka prekur gjithë jetën time. Në një çast të vetëm zemra m'u prek dhe besova. Besova me një forcë të tillë pohuese, që e çoi peshë gjithë qenien time, me një bindje aq të fuqishme, me një siguri të tillë sa që nuk mbeti pikë dyshimi, dhe që atëherë të gjithë librat, gjithë arsyetimet, gjithë rastësitë e një jete të trazuar nuk kanë mundur të tronditin besimin tim, madje as ta prekin në të vërtetë”*. Sipas poetit, nuk ka çlirim shpirtëror pa ndërhyrjen e të mbinatyrshmes dhe sipas tij, pa besim nuk mund të ketë Shpresë. Optimizmi dhe ndjenja e lirisë e shoqërojnë poetin: *“Fijet e rrjetës u shkëputën dhe vetë rrjeta u zhduk./Rrjeta në të cilën isha kapur u hap dhe unë nuk gjendem më atje. [...] Unë njoh dhe shoh me sytë e mi një gjë që nuk më gënjen. Jam i lirë dhe burgu përreth meje është drita !”*. [6]

2. Drama shpirtërore e poetit

Një mendim dhe një praktikë e vetme përshkojnë gjithë veprën e Klodelit : vepra e Zotit në natyrë dhe puna e poetit bashkohen në një. Fuqia e shprehjes së tij poetike dhe vizioni i tij për fatin e njeriut dhe mirësinë e pafund të Krijuesit janë mjaft tërheqëse. Poemat e tij marrin jetë nga toka e krijuar ku gjithçka është e mirë sepse është reale, sepse gjithçka është krijuar nga Perëndia i mirë. Përgjatë gjithë rrugëtimit të tij poetik gjejmë mendimin për Zotin. Dialogu midis muzës dhe poetit duket më shumë si lufta midis shpirtit dhe trupit. Ai nuk paraqet një imazh të jetës njerëzore të zhveshur nga konflikti. E keqja dhe vuajtja janë pjesë e gjendjes sonë njerëzore. Në veprat e tij dramatike shpesh konfliktet, pasionet dhe ndarjet e njerëzve jepen kaq fuqishëm sa ndonjëherë të duket se je duke lexuar poetët tragjikë. Megjithatë, referimi më i mirë që mund të bëhet për Klodelin është vizioni i krishterë për njeriun. Personazhet e dramave të tij janë njerëz të lirë, të përgjegjshëm për fatin e tyre duke marrë pjesë gjithmonë në betejën universale mes së mirës dhe të keqes. Drama që pëson poeti në dhjetor të vitit 1886, është në fakt drama e zgjedhjes midis trishtimit dhe gëzimit, midis humbjes dhe fitores.

Mund të themi me bindje se vepra e Klodelit shpreh qartë dramën e poetit i cili ndodhet në një udhëkryq, ai ndihet i tërhequr njëkohësisht nga gjërat e kësaj toke dhe nga Zoti. Shpesh, poeti e gjen veten në një gjendje të dëshpëruar për shkak të kësaj beteje të fuqishme që ndodh brenda tij. Ai ndodhet në një betejë shpirtërore, mes thirrjes së krijesave dhe thirrjes së vetë Krijuesit, atij i duhet të zgjedhë shpesh mes njerëzores dhe hyjnoses, të refuzojë sakrificën dhe të mbetet një qenie e kufizuar dhe mëkatore, ose të pranojë thirrjen dhe të bëhet një qenie e rikrijuar nëpërmjet Perëndisë në universin e shpenguar.

Teksa sheh krijimin, botën me mrekullitë e saj, poeti ndien se ashtu si rrjedha e ujit priret të shkojë drejt detit, edhe shpirti i tij poetik kërkon Perëndinë, *‘frymën krijues’* dhe ai nuk ka besim te vetja, madje liria e tij i duket si një barrë e rëndë, për shkak

se ka frikë nga zgjedhjet që mund të bëjë në jetë. Kështu ai i drejtohet Krijuesit të tij: “*O Perëndia im, qenia ime të kërkon me ngulm Ty! / Më çliro nga vetvetja! / Jam i lirë, më shpëto nga kjo liri që kam!*” [6. Claudel P. (1952): 76]. Tek ai, si tek çdo besimtar, ka një luftë që zhvillohet të cilën ai e shpreh nëpërmjet një imazhi të huazuar nga Bibla: ‘*trup i lavdishëm ka dëshira kundër trupit tokësor*’. Klodeli përjeton një krizë të brendshme që e pengon të shkojë drejt Perëndisë të cilit i beson. Te *Magnificat*, teksa thur vargje për çlirimet e Perëndisë, ai shkruan: “*Më duhet të heq dorë, jo vetëm nga ky trup, / Por nga e gjithë kjo botë në tërësinë e saj*”. Në forma nga më të ndryshmet, Klodeli nuk do të reshtë së shprehuri këtë tragjedi të gjendjes njerëzore, dialogun e përjetshëm patetik midis dëshpërimit dhe shpresës, konfliktin e përherëshëm tek njeriu midis gjendjes në të cilën ndodhet dhe qëllimit pse është krijuar, midis tokësore dhe qiellores. Në shpirtin njerëzor zhvillohet një betejë e ashpër mes asaj që është njerëzore dhe hyjnore. Në këtë dyluftim, Klodeli nuk pranon asnjëherë zgjidhjen tepër të thjeshtë të kthimit të njeriut në një engjell. Ai refuzon gjithnjë atë që poeti francez Charles Péguy (Sharl Pegi) e quan me një fjalë të vetme ‘*déracinement*’ – çrrënjosje, sepse ai vetë, Klodeli është një njeri ‘tokësor’. Për të, Shpresa dhe Besimi duhen rrënjosur në zemër të tokës dhe të trupit edhe pse këto dy elemente mund ta shtyjnë njeriun në tundimin e pesimizmit. Sipas Klodelit, e keqja është një forcë pozitive dhe jo thjesht mohimi i së mirës. Në veprën e tij, si në dramë, ashtu edhe në poezi, hasim një lloj tensioni që përfshin tërësinë e gjithçkaje që është njerëzore dhe tokësore, marrëdhëniet e njeriut me vetveten, me dashurinë, me të tjerët, me botën, me Zotin. Toka është imazhi i njeriut dhe njeriu gjithashtu është imazhi i saj, por ai njëkohësisht është edhe imazhi i Perëndisë nëpërmjet shpirtit të tij dhe fuqisë krijuese të mendjes. Në odën e katër të *Cinq Grandes Odes*, me titull *La Muse qui est la Grâce*, na jepet dialogu konfliktual midis Njeriut-Poet dhe Muzës-Hir. Poeti përpiket ta largojë Muzën teksa ajo i kujton gëzimin hyjnor dhe i flet për shenjtërimin personal. Por ai i mbyll veshët dhe vendos t’i kthehet tokës:

*Largohu ! Unë po i kthehem tokës me gjithë shpirt ! Largohu !
 Ti nuk mund të ma heqësh aspak këtë etje për tokën, këtë lidhje
 Me tokën që gjendet në palcën e kockave të mia dhe në grimcat
 E thelbit të qenies sime dhe në qelizat e përbrendshmeve të mia!* [6]

Dialogu midis poetit dhe Muzës së hirshme nxjerr në pah temën e përballjes mes udhës së Zotit dhe rrugëve të botës. Rruga që Muza i kërkon poetit të ndjekë, është rruga e sakrificës e cila është një nga temat kryesore të dramës klodeliane. Poeti kthehet drejt tokës dhe oda përfundon me thirrjen për dashuri njerëzore e cila është një temë tjetër e rëndësishme e veprës së poetit. Klodeli përjeton para dashurisë, një lloj tërheqjeje të fortë e cila mishërohet në shumicën e personazheve femërorë, sidomos te personazhi i Izesë (Ysé), dhe njëkohësisht edhe një lloj “tmerri” të shenjtë, ashtu si kur flet për artin. Por dashuria jepet e lidhur ngushtë me sakrificën dhe agoninë dhe kjo jo vetëm në vepër, por edhe në jetën e Klodelit. Pasi është i bindur se nuk mund të bëjë jetë murgjimore, Klodeli takon një polake e cila do të

bëhet në fakt edhe Izeja e veprës *Partage de Midi*. Ajo bëhet figura qendrore e të gjitha veprave dramatike të tij. Ize është mishërim i dashurisë, por i një dashurie të ndaluar për Klodelin, pasi gruaja është e martuar dhe kjo dashuri nuk do të mund të realizohet plotësisht, për shkak jo vetëm të rrethanave, por edhe të bindjeve të forta katolike të poetit. Kështu lindin dihatjet e shpirtit që nuk orientohet nga Perëndia. Por poeti ka bindjen se nëse shpirti njerëzor nuk kërkon të kapë të pafundmen, të përjetshmen, por e gjen kënqësinë tek e përkohshmja, ai do të përjetojë shpesh hidhërim dhe vdekje:

“Edhe unë gjithashtu e gjeta në fund, vdekjen që më duhej./Njoha këtë grua, njoha dashurinë e gruas...” [6] Ai vuan për humbjen e dashurisë për këtë grua. Megjithatë, poeti gjen ngushëllim tek dhuntia e tij për të shkruar. Pas betejës me Muzën Hir, ai bindet për thirrjen që i është bërë dhe pranon të ecë nëpër shtegun që duhet të ndjekë. Drama e fuqishme brenda shpirtit të poetit përfundon me dorëzimin e tij, ashtu siç shprehet në ligjëratën që mban para Akademisë Franceze më 13 mars 1947: *“Prandaj, si një notar që nisat për në det, ja tek e shohim se si çlirohet nga veshja e tij që po e burgoste, ose më saktë burgoste këtë Zot të tmerrshëm të gjallë që si një zjarr dhe si një dritë, si një forcë dashurie dhe njohjeje, e pushtoi të tërin dhe tashmë del prej tij edhe nga poret e lëkurës së tij!”*

Poeti pranon të luajë rolin e caktuar nga Krijuesi i tij: *“Unë erdha për të qenë në një nivel me përjetësinë/Vendi im nuk është me gjërat e krijuara,/por me atë që i krijon”*. Ai kthen sytë drejt Zotit dhe gjen kështu gëzimin, arsyen për të jetuar dhe për të ndjekur udhën që ka nisur, krijimtarinë poetike. Poezitë e tij shprehin ngjitjen drejt gëzimit, kalimin përmes dëshpërimit të kësaj bote, drejt një Gëzimi qiellor, i cili është dhuratë nga Perëndia. Ndryshon plotësisht sjellja estetike dhe shpirtërore e Klodelit. Ai kalon nga dëshpërimi i kësaj bote, drejt një Gëzimi qiellor që ekziston vetëm për shkak të mëshirës së Perëndisë. Ai shkruan: *“Drita mbuloi gjithçka pak nga pak dhe nata iku, u përjashtua”*. [4]

Poeti vendos të marrë një udhë tjetër, të ndryshme nga e para, më të bukur dhe më të gëzueshme dhe në këtë mënyrë i përgjigjet thirrjes që ai beson se i është bërë nga Perëndia. Ai shpreh nëpërmjet vargjeve vullnetin e mirë për të bërë gjithçka që Zoti po i kërkon: *“Ti që më thirr, më thuaj çfarë do!”*. Dhe pasi bindet se cila është rruga që duhet të zgjedhë, i bën thirrje vetes: *“Pol, duhet të nisemi drejt një fillimi më të bukur!”* Gëzimi i poetit dhe mahnitja e tij para gjithë këtij ndryshimi që po ndodh në jetën e tij, shprehen në vargje të tjera:

Gjithë këto rastësi dhe gjithë këto vite !

Dhe pas një ndarjeje të gjatë gëzimi i ritakimeve të befasishme !

Por tani qielli është aq poshtë sa mund ta prek edhe me dorë,

Dhe hija që ti bën është aq e gjatë sa duket sikur një shteg më tregon.

Kush i mban sytë të fiksuara drejt teje nuk i trembet hezitimit as hutimit! [3]

3. Beteja e përhershme mes Animus – Anima

Marrëdhënien mes mendjes dhe shpirtit, Klodeli e përshkruan, përmes një shëmbëlltyre, si një marrëdhënie martesore. Animus dhe Anima janë një çift i

pandashëm. Animus është pushteti i arsyes. Pranë tij është Anima, të cilën një lexim i sipërfaqshëm mund ta marrë thjesht si pushtetin e imagjinatës, por ajo përbën bazën e çiftit. **Dualiteti Animus-Anima gjendet te çdo njeri me arsye dhe ndjenja. Animus është mendja e cila di shumë mirë sesi të përdorë arsyen dhe inteligjencën. Mendja është liri, etje për liri, ajo dyshon, tejkalon masën, ndjen nevojën për aventurë dhe e ka tmerr çdo gjë që mund ta mbajë lidhur. Anima është shoqja e mendjes, ajo ka të bëjë me ndjeshmërinë, ndjenjën dhe intuitën.** Në fillim të marrëdhënies së tyre, domethënë në fillim të kthimit në besim, marrëdhëniet e tyre ishin shumë të mira, por me kalimin e kohës, fillojnë dyshimet dhe shpesh raporti i tyre fillon të ndryshojë. Shpesh Animus e lëndon Animën nëpërmjet thënieve të ndryshme të librave që lexon, por Anima hesht dhe me heshtjen e saj i lë të kuptojë Animus-it shumë gjëra, me përlusësinë dhe me përkushtimin e saj e bën atë të kuptojë se është duke gjykuar gabim. Anima është plot dhunti dhe aftësi të cilat nuk kërkon t'i vërë në dukje, por përkundrazi, rri në heshtje dhe pret që Animus-i t'i zbulojë. Klodeli e mbyll shëmbëlltyrën me një fjali shumë domethënëse: *“Shpirti hesht sapo mendja e vështrohet”* Poeti është duke na folur përmes kësaj shëmbëlltyre për lidhjen e besimit me mendjen dhe shpirtin. Shpesh besimi duket sikur lidhet më shumë me ndjenjat, por sipas Klodelit, arsyeja gjithashtu na thërret të besojmë. Madje kontradikta e përhershme që duket se është shpallur që herët mes arsyes dhe besimit duhet të mos ekzistojë më sepse në vend të konfliktit, mund të ketë një bashkëjetesë mes tyre. Këtë ide Klodeli e mbështet edhe në pikëpamjet e Shën Thoma Akuinit, sipas teorisë së të cilit, mes mendjes dhe ndjenjave duhet të ketë shkëmbim dhe jo përjashtim.

Poeti mbetet gjithnjë bir i tokës. Edhe pse i këndon hyjnisë, ai e lidh atë gjithnjë me këtë botë, me këtë jetë. Brenda tij ka një nevojë për shpirtëroren konkrete, të prekshme. Klodeli nuk del para Perëndisë si një shenjtor, por si një krijesë e dobët, ai përulet para Hyjnisë dhe duke qenë i ndërgjegjshëm për gjithë mëkatet e tij, e di shumë mirë që Perëndia erdhi me qëllim që të shërojë të sëmurët dhe jo të shëruarit. Te *Le jour des Cadeaux* (Dita e dhuratave), ndërkohë që shenjtorët paraqiten para Perëndisë me shumë dhurata, poeti ul kokën dhe i shpalos varfërinë e shpirtit, por i tregon gjithashtu se e do dhe e adhuron, dhe se nuk dëshiron gjë tjetër përveç pranisë së Perëndisë në zemrën e tij: *“Por nëse rastësisht të duhet ndonjë dembel/Apo një i çmendur,/Nëse të duhet ndonjë mburracak apo frikacak, nëse /të duhet ndonjë mosmirënjohës apo i papastër,/një njeri me zemër të mbyllur dhe me fytyrë/të ngurtë, /Në fund të fundit Ti nuk erdhe/për të shpëtuar të drejtët,/edhe nëse nuk do të gjeshe vend askund,/mua do të më kesh gjithnjë gati.”*[4] Klodeli thekson se gjërat tokësore, të krijuara, janë pa kuptim nëse nuk gjejmë tek ato një analogji që na çon te vetë Krijuesi: *“Jam i lodhur nga kotësia! Ti e sheh që i jam nënshtruar asaj edhe pse nuk dua!...Unë preferoj absoluten. Mos më lër të kthehem tek vetvetja ...”*[4] Madje edhe dashuria njerëzore e udhëheq drejt një dashurie të shenjtë dhe të panjollë, drejt dashurisë për Perëndinë; ai tashmë njeh dhe kupton dashurinë e vërtetë të Perëndisë për njeriun mëkatar: *“Ah! E di tani/se ç’është dashuria! Dhe e di se ç’ke duruar në kryq, në Zemrën tënde/Nëse na ke dashur secilin prej nesh/Tmerrësisht shumë, ashtu si unë e desha këtë grua .../Ajo më bëri për vete! e arriti këtë gjë!... Ajo ma shkatërroi botën, asgjë për mua/Nuk ekzistonte përveç asaj*

dhe tani po shkatërroj vetveten./Por ja që kështu ajo po ma bën më të shkurtër shtegun drejt teje”. [4]

4. Triumfi i një shpirti që dëshiron të ndryshojë

Rreth viteve 1927-1928, Klodeli braktis hartimin e dramave dhe pjesëve teatrale për t’iu përkushtuar plotësisht poezisë dhe sidomos asaj me frymëzim fetar. Ai shkruan se deri atëherë ia kishte lënë fjalën egos së tij, por kishte ardhur momenti të ishte i gatshëm të linte dikë tjetër të fliste nëpërmjet tij. François Angelier (Fransua Anzhëlie) shkruan: *“Pasi i ka dhënë Klodelit atë që i përket Klodelit, tashmë mund t’i japë Perëndisë atë që i përket Perëndisë”*. Marrëdhënia e krijuar mes Klodelit dhe Poetit të madh, Krijuesit të plotfuqishëm ndikon ndjeshëm në krijimtarinë e artistit. Në zemrën e poetit zë vend shpresa e cila është një prej faktorëve më bashkues të veprës së tij. Në poezitë e tij gjejmë një lloj misticizmi të Shpresës. Klodeli ndien një lloj habie dhe mahnitet përballë kësaj fjale sepse gjithçka në këtë botë është kundër saj. Kjo botë moderne për Klodelin është plot me ‘idhuj’, prandaj shpresa nuk mund të dhurohet, as të merret lehtë. Sipas tij, shpresa duhet të gjendet në të tashmen, në të përkohshmen, në tokë. Kjo botë na çon vërtet në dëshpërim, por njeriu dhe bota nuk mund të presin të mbinatyreshmen për të shpresuar. Konflikti te njeriu, në histori dhe në botë, midis të përkohshmes dhe të mbinatyreshmes sjell fitoren ose humbjen e Shpresës. Klodeli është kundër idesë së mbizotërimit të rastësisë në jetën e njeriut, ide që pohohej fuqishëm nga Malarmeja. Si i krishterë, ai beson se Perëndia e ka krijuar njeriun me një qëllim të caktuar. Njeriu nuk është rastësi, gjithçka është krijuar nga Perëndia sipas një plani të përjetshëm; dhe kështu gjithçka merr kuptim. Gjithçka që sheh poeti, e shikon nën këndvështrimin e përjetësisë. Siguria në ekzistencën e Perëndisë, në të Padukshmen, e shndërron çdo formë të reales në domethënie. Bota i shfaqet poetit si ‘e re’, sepse tashmë ajo është e lidhur me Krijuesin e saj dhe ‘e plotë’ sepse ‘gjërat e dukshme’ u bashkohen ‘gjërave të padukshme’. Ai shkruan: *“Ne e dimë që në fakt bota është një tekst që na flet përulësisht dhe me gëzim për mungesën dhe praninë e përjetshme të dikujt tjetër, për dijeni, të Krijuesit të saj”*. [10]

Poeti i krishterë ka si mision të deshifrojë këtë tekst. Krijesë si gjithë të tjerat, njeri si gjithë të tjerët, poeti përshkon dhe hyn më thellë se të tjerët në misterin e krijimit. Roli i poetit është të bashkojë, të zbulojë gjërat duke u vendosur emrin secilës, të kuptojë ç’ndodh në botë. Por për ta bërë këtë gjë, për të qenë në harmoni me universin, atij i duhet të ketë një marrëdhënie me Zotin, i cili është burim i bashkimit: *“Ti mund të shikosh vetëm për shkak të diellit, të kuptosh vetëm nëpërmjet Zotit brenda teje”*. Poeti gjen kënaqësi te Krijuesi i tij: *“Kjo botë ashtu siç është, e vetme, është e vështirë që të na bindë se është e plotë dhe e mjaftueshme (...)*

A do të lidhem fort pas këtyre objekteve të gatshme, pas këtyre gjërave që bëhen dhe zhbëhen,

Të kënaqem me gjërat e krijuara, kur më kanë thënë se vetë Krijuesi është në dispozicionin tim?”. [6]

Me anë të pyetjes, fjalja e fundit lë të nënkuptohet përgjigjja e krishterë: gjërat e krijuara kanë vlerë nëse njeriu, në vend që të kënaqet me to, gjen përmes tyre Krijuesin për të cilin ato dëshmojnë: “Çfarë kuptimi do të kishin gjërat nëse nuk do të ishin kalimtare ? ...

Nëse bota nuk do të fliste kaq shumë për Ty, unë nuk do të shqetësohesha kaq shumë.”. [6]

Pas dukjes së përkohshme të gjërave, poeti zbulon gjithnjë shenjën e përjetësisë dhe të qëndrueshmërisë së saj. Klodeli e sheh njeriun në plotësinë e tij: Trup dhe Shpirt. Ajo që është karakteristike tek ai, është ideja që ka për shpëtimin: trupi nuk ndahet nga shpirti. Trup edhe shpirt janë të shpëtuar dhe jo vetëm pas vdekjes, por që tani, në këtë jetë, në këtë botë. Ai shkruan : “E shoh në fund me sytë e mi se zotërimi i madh është

i mundur,

i mundur jo vetëm për shpirtin tonë, por edhe për trupin,

I mundur për njeriun në tërësi që në këtë jetë, kur e di se është

Më i fuqishëm se vdekja! [9]

Përfundime

Klodeli është poet humanist. Në qendër të poezive të tij përshkruhet historia jonë njerëzore, aspiratat tona njerëzore të transformuara nëpërmjet artit. Ka një gëlim temash të cilat ai i ka trajtuar me një mjeshtëri të madhe. Janë çështjet themelore që shqetësojnë njeriun e të gjitha kohëve, të cilave ai dëshiron t’u japë përgjigje. Ai është njeriu që jeton në këtë botë, që merr pjesë aktive në ngjarjet që ndodhin dhe prandaj është i aftë të trajtojë probleme të njerëzimit. Ai nuk është i pari poet që bën këtë gjë, por ajo që e dallon Klodelin nga të tjerët është se tek ai, përvetësimi i botës, i njerëzimit jepet gjithmonë nën shenjën e katolicizmit. Besimi dhe poezia bashkohen në universalitetin e mendimit të tij për botën. Në të gjitha këto tema, shohim se ekziston një lidhje e ngushtë mes artit të poetit dhe besimit të tij. Arti i tij, ashtu si jeta e tij, është gjithnjë i lidhur me Perëndinë. Nuk ka asgjë në këtë botë, asnjë aspekt që nuk lidhet me Perëndinë, që nuk mund ta gjejë përgjigjen te besimi, sipas Klodelit. Me besimin dhe artin e tij ai përpiqet të sjellë një tablo të plotë të botës duke bashkuar të dukshmen me të padukshmen, të prekshmen dhe të paprekshmen, të përjetshmen me të përkohshmen. Ai është çdo ditë një besimtar dhe gjithashtu një poet, dhe poeti dhe besimtari janë të pandashëm tek ai.

Përhëndetje pra, o botë e re për sytë e mi, o botë e plotë tashmë !

O Kredo e plotë e gjërave të dukshme dhe të padukshme,

Unë ju pranoj me një zemër katolike! [6]

Bibliografi

1. Angelier, F., *L’Approbation sacrée Paul Claudel et la Bible*, Coll. Question de, N° 94, Albin Michel, Paris, 1993.

2. **Antoine, G.**, *Paul Claudel ou l'enfer du génie*, Laffont, Paris, 1988.
3. **Claudé, P.**, *Pages de prose*, N.R.F., 1943.
4. **Claudé, P.**, *Paul Claudel Poésies*, Gallimard, 1950.
5. **Claudé, P.**, *Vers d'exil II, Poésies*, Gallimard, 1950.
6. **Claudé, P.**, *Œuvres Complètes de Paul Claudel*, Gallimard, 1952.
7. **Claudé, P.**, *Mémoires improvisés, quarante et un entretiens avec Jean Amrouche*, « Les Cahiers de la NRF », Gallimard, 1954.
8. **Claudé, P.**, *Positions et propositions*, bibliothèque de la Pléiade Gallimard, 1965.
9. **Claudé, P.**, *Bréviaire poétique*, Gallimard, 1999.
10. **Ouvrard, P.**, *Aux sources de Paul Claudel*, SILOË, 1994.
11. <http://www.asmp.fr>

PARODIA DHE ‘LËVIZJA E KALIT’ TEK “LOLITA” E VLADIMIR NABOKOVIT

Griselda Danglli (Abazaj)

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Fakulteti i Edukimit

Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Përmbledhje

Ky artikull trajton dy teknika të parapëlqyera nga Vladimir Nabokovi, parodia dhe “lëvizja e kalit” në veprën “Lolita”. Në këtë roman, ai parodizon shkrimtarë të ndryshëm si T. S. Eliot, stilet e tyre të shkruarit, lëvizjet letrare, duke krijuar një lloj loje estetike. Nabokovi nuk e pranonte përdorimin e satirës në veprat e tij, pasi e urrente moralizimin. Ne do të vëmë re se thellë brenda stilit të tij letrar përvijohet një ndjenjë humori me anë të parodisë, por nxirren edhe mësimet me anë të satirës. “Lëvizja e kalit” si një teknikë që ka të bëjë me një ndryshim të papritur nga një shtresë ose shkallë tek një tjetër, ka një përdorim të gjerë tek “Lolita”. Kjo teknikë do të studiohet si në mënyrën e rrëfimitarisë, në mënyrën e përshkrimit, ashtu edhe në lidhjen mes shkrimtarit dhe lexuesit. Tek kjo e fundit, Nabokovi na paraqitet si një mjeshtër i shkëlqyer i fjalës i cili na bën të përjetojmë të ashtuquajturën kënaqësi estetike.

Fjalë kyçe: Nabokov, parodi, lëvizja e kalit, shkrimtar, stili

Abstract

This paper discusses two favourite techniques of Vladimir Nabokov, parody and “knight’s move” in “Lolita”. In this novel, he parodies various writers, such as T. S. Eliot, their writing styles, literary movements, thus creating a kind of aesthetic play. Nabokov did not admit the use of satire in his books because he detested morality. We notice that within his literary style a feeling of humour through parody is observed, but lessons are drawn from satire as well. “Knight’s move”, as a technique which consists of a sudden shift from one layer to another, is widely used in “Lolita”. This technique shall be studied both in narrative strategies, manner of description, and the relationship between the writer and the reader. In the latter one, Nabokov is presented as an excellent master of the word who makes us experience the so-called aesthetic bliss.

Key words: *Nabokov, parody, knight’s move, writer, style*

Dihet se Nabokovit nuk i pëlqente aspak të etiketohej si modernist apo pasmodernist. Në veprat e tij vihen re përpjekje për të qenë i veçantë dhe për të mos iu bindur rregullave të një drejtimi të caktuar letrar. Në veprat moderne vihet re një prirje e përgjithshme për të shpalosur një ndjenjë krize. Ajo çka për një shkrimtar modernist si Elioti, është një krizë serioze, për Nabokovin është një lojë. Në poezinë që përmend Hamberti të “Lolita”, parodizohet poema “Gerontion” e T.S. Eliot, gjë e cila vihet re tek përmendja e zonjushës fon Kulp. Poezia e Eliotit merret

me krizën e njeriut në kohën moderne, mungesën e komunikimit mes njerëzve dhe izolimin, si dhe boshllëkun e madh që lë jeta moderne tek njeriu. Për Hambertin kjo krizë kthehet në një lojë:

“Në krye, unë kisha ndërmend të merrja një gradë në psikiatri siç bëjnë shumë nga ata që u mungon talenti; por mua më mungonte edhe më shumë se kaq; shkova tek një mjek: një rraskapitje e veçantë, jam shumë i dëshpëruar doktor; dhe kalova në letërsinë angleze ku shumë poetë të zhgënjyer përfundojnë si mësues me llullë e me setra të leshta. Parisi më shkonte. Unë diskutoja filmat sovjetikë me të çatdhesuarit që andej. Ulesha me homoseksualët në *Deux Magots*. Botoja ese dredharake në revista pa ndonjë emër. Kompozova pastishe si kjo:

...Zonjusha fon Kulp

Mund të kthehet, me dorën tek dera;

Unë s’do t’i vete pas. As Freska

As ajo pulëbardha.” [2]

Parodia e përdorur tek “Lolita”, si një nga teknikat më të parapëlqyera nga Nabokovi, është çelësi i gjetjes së kuptimit të kësaj vepre. Parodia është një imitim i tepruar dhe tallës ndaj stilit të një shkrimtari, të një vepre apo të një rryme të caktuar. Nabokovi na jep këtë përkufizim të parodisë: “Satira është një mësim, parodia është një lojë”. [3] “Lolita” ngre çështje etike, por në të njëjtën kohë i ngre pritë etikës nëpërmjet parodisë. Kështu për shembull, gjithë vepra është e ndërtuar me një retorikë të bazuar në dashurinë romantike, por ne e kuptojmë se në të njëjtën kohë Nabokovi e parodizon atë.

Përdorimi i parodisë vërehet edhe në vepra të tjera të Nabokovit. Kështu për shembull tek “Jeta e vërtetë e Sebastian Nait” ai parodizon tregimet dedektive tradicionale. Tek “Kthesë e keqe” dhe “Ftesë për prerje koke” parodizohet proza e ashtuquajtur utopike dhe tek “Zjarr i zbehtë” parodizohen studimet kritike të perëndimorëve. Tek “Lolita”, Nabokovi largohet nga temat tradicionale të trajtuara deri atëherë në letërsi dhe nga koncepti që ekzistonte për “realitetin”, për të na paraqitur një mënyrë të re të gjendjes mendore të një nimfoleptiku, Hambertit, nëpërmjet parodisë. Në këtë vepër ai parodizon romanet që mbështeten tek njerëz që rrëfejnë për veten e tyre, si për shembull, “Rrëfimi” i Zhan Zhak Rusosë.

Në mënyrë që Hamberti të mos na duket shumë fajtor, Nabokovi pothuajse në të gjithë veprën parodizon poemën “Anabel Li” të Edgar Allen Posë. Hamberti kujton “traumën e tij seksuale” [5] nga një lidhje dashurore në fëmijërinë e tij me një vajzë të vogël, Anabel Li, e cila vdes nga tifoja. Për Hambertin, Lolita është vetëm një kopje e Anabel Lisë. Në kreun e njëmbëdhjetë, pjesa e parë, Hamberti me një retorikë mbrojtëse në formën e një ditari, e përshkruan kështu Lolitën:

“Vetëm me termat më të rëndomta (përmbledhur tek ditari) mund t’i përshkruaj unë tiparet e Lo. Mund të them se flokët e saj janë të kuqërremtë dhe buzët e saj janë aq të kuqe sa sheqerka e kuqe që lëpihet, e poshtmjia hedhur bukur përpara...jam skërfyelli, eshta-madhi, gjoks-leshatori Lambert Lambert, me vetulla të dendura të zeza, me një theks të çuditshëm dhe një gjiriz monstrash të kalbëzuara prapa

buzëqeshjes së tij të ngadalshme djaloshare. Dhe as ajo nuk është fëmija e brishtë e një romani femëror...” [2]

Mes rreshtave të kësaj retorike mund të pikasim satirën e tij për shkrimtarët femra. Ai madje satirizon edhe shkrimtarët në përgjithësi të cilët shkruajnë për turmën dhe veprat e tyre të ashtuquajtura “bestseller”:

“...por Hejzi trashaluke befas e prishi gjithçka duke u kthyer nga unë dhe duke më kërkuar të ndizte cigaren nisi një muhabet koti rreth një libri koti të një mashtrulesi popullor.” [2]

Nabokovi e ka shkruar këtë roman si një parodi të një historie dashurie. Ai e mohon praninë e një domethënieje morale në të:

“Unë nuk jam as lexues e as shkrimtar i prozës didaktike dhe pavarësisht nga pohimi i Xhon Reit, ‘Lolita’ nuk ka asnjë moral nga pas. Për mua një vepër letrare ekziston për aq kohë sa më ofron atë që unë me fjalë të thjeshta e quaj kënaqësi estetike, e cila ka të bëjë me ndjesinë e të qenit i lidhur deri diku me gjendjet e tjera të ekzistencës, atje ku arti (kureshtja, butësia, mirësjellja, kënaqësia) përbën normën.” [4]

Lexuesi përballet që në parathënien e romanit me thënien e Xhon Reit se “ ‘Lolita’ duhet të na bëjë të gjithëve- prindër, punonjës socialë, arsimtarë - të tregojmë më shumë kujdes dhe largpamësi për të përmbushur detyrën e rritjes së një brezi më të mirë, në një botë më të sigurt.” [4] Ndryshe nga Reji, Nabokovi urren moralizimin për faktin se ai është vetëm bardhë e zi dhe se gjuha e moralit është gjuha e klisheve. Kështu për shembull, stili i Xhon Rejit në parathënien e “Lolita”, është plot me klishe. Stili i Nabokovit, stili i kënaqësisë estetike, dallon nga ai i Xhon Rejit dhe kjo vihet re qysh në fillimin e romanit. Asnjë lexues nuk mund të mos joshet nga paragrafi i mëposhtëm. Nabokovi na bën t’i ndiejmë fjalët në trupin tonë dhe ai kërkon prej nesh të ndihemi ashtu siç është ndier ai teksa shkruante romanin:

“Lolita, drita e syve të mi, zjarri i nënvetes sime. Mëkati im, shpirti im. Lo-li-ta: maja e gjuhës bën një udhë prej tre hapash poshtë qiellzës për të ciku dhëmbët tek e treta. Lo.Li.Ta...”

Zonja dhe zotërinj të jurisë, prova numër një është ajo që serafimët, të keqinformuarit, të thjeshtët, serafimët me flatra fisnike zilepsnin. Vështrojeni këtë kurorë gjembash.” [2]

Ashtu si Xhon Rei, edhe Hamberti përdor gjuhën e klisheve për t’u shfaqësuar para lexuesit. Ai aludon shpeshherë mbi *Anabel Li*-në e Po-së në mënyrë që dashurinë e tij të dënuar, ta kthejë në diçka estetike. Por kjo është një klishe. Hamberti merret me klishtë letrare ashtu si Xhon Rei merret me klishtë të tij morale. Në paragrafin e mëposhtëm vihet re humori dhe vetëparodizimi dhe ne kuptojmë se jo i gjithë rëfimi është romantik:

“Dhe sikur të isha mëndeshë e përrallave e një princeshe të vogël (të humbur, të rrëmbyer, gjetur me rreca arixhofkash nëpër të cilat lakuriqësia e saj i buzëqeshte mbretit dhe zagarëve të tij),...Njëzetë pesë vjet kisha rrojtur qysh atëherë, mprehur deri në një pikë fërgëlluese dhe i shuar.” [2]

Në fjalinë e fundit të citimit të mësipërm, dallohet zëri i vërtetë i Hambertit, pa klishe. Ne kuptojmë se Lolita është vazhdimi i romancës së tij të lënë përgjysmë me Anabel Linë. Talenti i Nabokovit vihet re tek aftësia e këtij shkrimtari për të manipuluar lexuesin. Hamberti shfaqësohet para nesh duke theksuar se “ky zbulimi im i saj ishte një pasojë fatale e asaj ‘principate anës detit’ në të kaluarën time torturuese.” [2] Ai ia vë fajin poezisë së Po-së dhe mëton se ngjarja me Lolitën ishte pasojë e asaj poezie.

Nabokovi e përdor shumë mirë retorikën e dashurisë në duart e Hambertit. Ne jemi ata të cilët duhet të vendosim nëse është apo jo “Lolita” një histori e madhe dashurie. Kjo çështje përbën një pjesë të rëndësishme të përjetimit estetik të kësaj kryevepre. Në pjesën e dytë të romanit duket sikur vepra merr një kthesë të fortë dhe timoni kalon në duart e Lolitës, dhe ajo fillon të përdorë klishe e veprime romantike për ta joshur Hambertin:

“Në korridor, përflakur nga dritat mirëseardhëse, Lolita ime hoqi trikon, shkundi flokët e saj me smeralde, shtriu duart e zhveshura nga unë, ngriti njërin gju:

‘Më shpjerë lart, të lutem. Ndiehem pak si romantike sonte.’ ” [2]

Tashmë është Lolita që merr rolin e artistes dhe Hamberti e shpreh frikën e tij se Lolita i kishte mësuar të gjitha hilet e zanatit të aktrimit. Hamberti besonte se roli i saj në dramën ku do të luante, kishte ndikuar në sjelljen e saj. Në pjesën e mëposhtme vëmë re se Lolita e gënjen Hambertin duke i thënë se autori i dramës ku ajo luante, nuk ishte Kuiliti por një grua plakë :

“...një grua e re tërheqëse, e hollë si atlete (ku e kisha parë atë?) me një fytyrë të gjallë e shpatulla të gjera dhe flokë të shndritshëm ngjyrë bronz, përshëndeti Lo-në me një “Haj!” tringëlluese dhe pastaj duke m’u drejtuar mua, me fjalë të shkapërderdhura e të sforcuara, tha: ‘Sa gjynah ishte ta hiqnit Dollin nga ajo pjesë ...duhet ta kishit dëgjuar autorin se si u dalldis me të pas provës!... ‘Jeshilja, hutaq’ tha Lo, nën zë ...

‘Kush ishte tamam? Vermont apo Rumpelmajer?’

‘Jo,...Edusa Gold,...vajza që na ushtronte ne.’

‘Nuk thashë për të. Kush e ka bërë tamam atë pjesë?’

‘Oh! Po, natyrisht. Një grua plakë, Klerë Fisteku, ma do mendja. Kishte një turmë të gjithë prej tyre atje.’

‘Dhe ajo të përgëzoi ty?’

‘Më përgëzoi sytë, më puthi mu në ballë ’...dhe e dashura ime lëshoi atë kuisje gëzimi të ri, që ndoshta në lidhje me manierat e saj teatrale, kishte filluar të ndiente së fundmi.” [2]

Lolita aktron edhe kur luan tenis. Ajo mundohet të mbajë qëndrime joshëse ndaj Hambertit dhe ai joshet prej saj duke besuar se Lolita është një kampione e vërtetë tenisi:

“Forma e saj ishte me të vërtetë një imitim absolutisht i përkryer i tenisit absolutisht të klasit të parë, pa ndonjë rezultat utilitar...Lolita ime kishte një mënyrë të ngritjes së këmbës së majtë të përkulur në nisjen e plotë dhe elastike të ciklit të

shërbimit...unë ngulmoj se po të mos ishte brenda saj diçka e thyer prej meje (të cilën gjë nuk e kuptoja atë kohë), ajo do të kishte në krye të formës së saj të përkryer, dëshirën për të fituar dhe do të ishte bërë një vajzë e vërtetë kampione.” [2]

Abuzimet e Hambertit me Lolitën, si fizike ashtu edhe emocionale e morale, maskohen nën petkun e lojës që ai bën me retorikën. Kur Lolita arrin moshën e pjekurisë, ajo i drejtohet kështu Hambertit: “Ai (Kuilti) më theu zemrën. Ti thjesht më shkatërrove jetën time.” [2] Lolita është realiste duke na lënë të kuptojmë se e shkuara është e shkuar. Ajo nuk do të kthehej më tek Hamberti. Teknika e parodisë e përdorur nga Nabokovi për dashurinë tradicionale tek “Lolita” ka veçanërisht domethënie morale ashtu siç e citon ai në poezinë e mëposhtme:

“Ndjenja morale në vdekatarët është tatim,

që duhet të japim për ndjenjën e vdekshme të bukurisë” [2]

Një aspekt tjetër tek “Lolita” është parodizimi i tregimeve tradicionale me dyzues. Ndyshe nga ç’ndodh në këto tregime, Kuilti, dyzuesi i Hambertit, nuk është i njëjtë me Hambertin nga pamja fizike. Por është e rëndësishme të theksojmë se “Kuilti është në të njëjtën kohë një pasqyrim i fajit të Hambertit dhe një parodi e dyzuesit psikologjik”. [1] “Lolita” nuk do të ishte një kryevepër pa antiheroïn Kuilti i cili është një parodi e Hambertit.

“Lolita” parodizon edhe psikanalizën e Frojdit. Marrëdhënien e Nabokovit me Frojdin ne e kemi trajtuar gjerësisht në kreun e dytë, por ajo që duhet theksuar në këtë rast është fakti se, duke parodizuar Frojdin, Nabokovi parodizon të gjithë ata lexues të cilët guxojnë ta lexojnë romanin nga një këndvështrim frojdist. Në parathënien e veprës, përmes botuesit Xhon Rei, Nabokovi ngacmon lexuesin: “si një çështje për t’u trajtuar, “Lolita”...do të bëhet një rast klasik në qarqet psikiatrike.” [4] Në çdo përpjekje tonën për ta lexuar veprën me një qasje frojdiste, ne biem pre e kurthit që Nabokovi u ka thurur lexuesve të përciptë duke i satirizuar ata:

“Për përfitimin e lexuesve të dalë nga moda, të cilët dëshirojnë të dinë fatin e njerëzve “të vërtetë” pas kësaj ngjarjeje “të vërtetë”, mund të japim disa hollësi...Zonja “F. Shiler” (Lolita) vdiq teksa ishte duke lindur vajzën e saj të vdekur ditën e Krishtlindjeve më 1952... “Vivian Darkblum” ka shkruar një biografi, “Sugjerimi im”, e cila do të botohet së shpejti dhe kritikët që e kanë lexuar dorëshkrimin e saj mendojnë se është libri i saj më i mirë. Rojtarët e varrezave të ndryshme na raportuan se nuk ka asnjë gjurmë fantazme.” [4]

Krahas teknikave të tjera moderniste, Nabokovi, si një njohës shumë i mirë i lojës së shahut, përdor te Lolita edhe ‘lëvizjen e kalit’ si një teknikë origjinale. Kali në lojën e shahut lëviz në formën e shkronjës l, dy kuti djathtas dhe pastaj një më lart. Kjo teknikë ka të bëjë me një ndryshim dhe kalim të papritur nga një shtesë ose shkallë në një tjetër.

Kështu, Nabokovi mundohet të mos i përmbushë pritshmëritë tona dhe kalon menjëherë nga një ngjarje shumë serioze tek një përshkrim i bukur i natyrës, duke bërë një lloj loje estetike:

“Ime më, shumë fotografenike, vdiq në një aksident tekanjor (në piknik, nga një rrufe) kur unë qeshë tre vjeç dhe pa përmendur një xhep ngrohtësie në të kaluarën e errët, asgjë prej saj s’ka mbetur brenda zgavrave e luginave të kujtesës, mbi të cilën, po qe se ma duroni ende stilin tim (unë po shkruaj nën mbikëqyrje), kishte perënduar dielli i fëmijërisë sime: pa dyshim ju të gjithë i dini ato mbetjet erëmira të ditës së pezullt, me mushicat rreth një gardhi të lulëzuar apo ku hyn dhe i përshkon papritmas shtegëtari, rrëzë një kodre, në muzgun e verës; një ngrohtësi pushtore mushicash të arta.” [2]

Nabokovi luan shpesh me fjalët në vepër: “Sidoqoftë, diçka abdominale. E pështirë? Jo, abdominale e barkut.” [2] Fjalët që ngatërrohen janë “abdominal” (e barkut) dhe “abominable” (e pështirë). Një shembull tjetër në vepër na tregon për përdorimin e fjalëve që nuk ekzistojnë: “J’ai toujours admiré l’œuvre ormonde du sublime Dublinois.” [2] Këtu është fjala për Xhejms Xhojsin dhe fjala ‘ormonde’ nuk ekziston në frengjisht.

Hamberti fiksohet pas një personi që nuk ekziston, të cilin ai e quan Mekfejt. Ky është një emër të cilit Hamberti i referohet shpesh në vepër dhe ai mendon se Mekfejt e rregullon fatin e Hambertit:

“Sa për mua, ndonëse prej kohësh qeshë mësuar me një lloj fati dytësor (sekretarja e pazonja e Mekfatit, si me thënë) që me shpirtvogëlsi ngatërrohej me planin bujar e madhështor të vetë bosit, të vija vërdallë e të kërkoja qorrazi nëpër rrugët e Brajslëndit, ishte ndoshta prova e rëndë, më pezmatuese që kisha hasur.” [2]

Mekfejt është një version artificial i Fejt (fate), pra fatit. Mekfejt është një parodi e rastësisë. Lista e emrave në kreun e dytë të veprës së Xhojsit “Portreti i artistit djalosh” është vërtet krejt e rastësishme, kurse lista me emrat e klasës së Lolitës që na paraqet Nabokovi nuk është aspak e rastësishme. Kjo duket pikërisht tek përdorimi i emrit Mekfejt. Mekfejt duket sikur është dora e Nabokovit që ndërhyr. Kështu për shembull, Hamberti na thotë: “Asnjë njeri nuk mund të zbatojë një vrasje perfekte; rasti megjithatë mund ta bëjë.” [2] Ne lexojmë më pas se ka ndodhur në fakt vrasja perfekte. Pikërisht në momentin kur Charlota ishte duke shkuar për t’i dërguar letrën Lolitës mbi të vërtetën e Hambertit dhe ndoshta të lajmëronte policinë, ajo shtypet për vdekje nga një makinë. Duket sikur Nabokovi me duart e tij merr fatin dhe e bën Mekfejt. Asgjë në vepër nuk i lihet rastësisë. Në shembullin e mëposhtëm Hamberti vëren një rastësi, ku numri në adresën e tij përkon me numrin e dhomës së hotelit, por kuptojmë se asgjë nuk është e paplanifikuar:

“Me dorën time të lirë, të krimin, unë shkrova: Dr. Edgar H. Humbert dhe vajza, 342 Llon Strit, Ramsdejell. Një çelës (342!) m’u tregua vetëm përgjysmë mua (magjistari tregon objektin që është gati ta fshehë në pëllëmbë)...” [2]

Përdorimi i Mekfejtit është një përgjigje ndaj mërgimit. Kjo “lëvizje e kalit” nga Fati tek ‘Mekfati’ bëhet për të mënjeluar pengesat dhe vështirësitë e jetës në një vend të panjohur, sidomos vështirësinë e gjuhës të cilën Hamberti e shpreh në citimin e mëposhtëm:

“Fqinji im në perëndim, që mund të kishte qenë biznesmen apo mësues kolegji apo të dyja bashkë, do të fliste me mua një herë në ca kohë tek qethte ca lule të vona të

kopështit, apo ujiste makinën, apo më vonë, shkrinte akullin nga rrugica e tij (nuk më duhet nëse këto folje janë të gjitha gabim)...”. [2]

Hamberti e përdor “lëvizjen e kalit” për të mënjeluar botën e huaj e të panjohur që shfaqet para syve të tij si emigrant. Kështu, në shembullin e mëposhtëm ai kalon nga një natyrë e panjohur siç është Amerika për të, në një përshkrim të njohur, siç ishin për të artistët evropianë:

“Nga një paradoks i mendimit piktoresk, ultësira mesatare e fshatrave veri-amerikane, më ishte dukur mua së pari diçka që e pranova me një tronditje të njohjes të këndshme për shkak të atyre mushamave të ngjyrosura që importoheshin nga Amerika në ditët e vjetra për t’u varur mbi lavamanët në çerdhet e fëmijëve të Europës qendrore dhe që e mahnisinin fëmijën e përgjumur në kohën e fjetjes, me pamjet e gjelbërta fshatareske që përshkruanin, pemët e patejdukshme të kokolepsura, një plevicë, bagëtia, një prrua, e bardha e topitur e orkideve të zbehta në lulëzim...Por gradualisht modelet e këtyre elementeve fshatareske bëheshin të huaja e më të huaja për syrin, sa më pranë që vije tek to... Mund të kishte një vijë pemësh të hapësirta me silueta përkundër horizontit dhe mesditë të nxehta të palëvizshme përmbi një shkretëtirë tërëfi dhe retë e Klod Lorrenit...ose prapë, mund të ishte një horizont i rreptë El Greko mbarsur me shiun e nxirosur, dhe një vështrim kalimtar i një fermeri...i gjithë kompozimi hapej si erashkë diku në Kanzas.” [2]

Këto ‘lëvizje kali’ që bën Hamberti për të lehtësuar jetën e tij prej mërgimtari janë edhe të rrezikshme. Kështu, nga një peizazh i bukur amerikan kalohet tek paragrafi i mëposhtëm, i cili na tregon se anashkalimet, këto “lëvizje kali”, janë të rrezikshme:

“Ne kishim qenë ngado. Në të vërtetë nuk kishim parë asgjë. Dhe e gjej veten duke menduar tani se udhëtimi ynë i gjatë vetëm e kishte fëlliqur me një shteg gjarpërues lëmashku vendin e madh, të besuar, të ëndërruar që prej atëhere, në prapavështrim, nuk ishte për ne më shumë se një koleksion hartash sikur i kishte ngrënë qeni, librash të shkatërruar udhëtimi, goma të vjetra makine dhe dënesat e saj natën, çdo natë, çdo natë, në çastin kur bëja sikur flija.” [2]

Duket se “lëvizjet e kalit” që ai bën në rrëfimin e tij, nuk e kanë shpëtuar Hambertin, madje ato duken si të çuditshme:

“Ja tek është, i lirë nga çfarëdo lloj talenti, një mësues mediokër, një studiues i pavlefshëm, një homoseksual i vjetër e i zyrtë, i pështirë e i dhjamosur, tepër përbuzës i mënyrës amerikane të jetesës, triumfalisht injorant i gjuhës angleze, ja tek ishte ai në Nju Englandin mburravec, që i thurnin hymne të vjetrit dhe e përkëdhelnin të rinjtë, oh, duke e kaluar mirë dhe duke bërë budalla gjithkënd; dhe ja tek isha unë.” [2]

Nëpërmjet Hambertit, Nabokovi shfaq dhimbjen e tij për një jetë përgjithmonë në mërgim. Edhe pse, ndryshe nga Hamberti, Nabokovi e zotëronte në mënyrë të shkëlqyer gjuhën angleze, në veprat e tij mërgimit është një nga plagët që nuk shërohet lehtë.

Bibliografia

Appel, Jr. Alfred, (1987) *Vladimir Nabokov's Lolita*, New York: Chelsea House Publishers, fq.40.

Nabokov Vladimir, (2006) "Lolita", përkth. B. Muço, Equinoxes, fq. 14-15.

Nabokov Vladimir, (1990)*Strong Opinions*, New York: Random House, fq. 75.

Nabokov Vladimir, (1995)*Lolita*, Great Britain: Penguin Books, fq. 6.

Zhan Shukui, (2005) *Vladimir Nabokov: From Modernism to Postmodernism*, Xiamen University Press, fq. 51.

FIGURACIONI SI SHENJYES I MODERNITETIT NË LIRIKËN SHQIPE TË PERIUdhËS SË MIDIS DY LUFTËRAVE

Klodiana Kullolli

Përmbledhje

Poezia lirike shqipe e periudhës së midis Dy Luftërave reflekton ndikime të disa shkollave e drejtimeve letrare europiane. Në studimet tona janë evidentuar tipare e dukuri letrare që e vendosin këtë periudhë në raport me zhvillimet moderne e postmoderne në Europë e më gjerë.

Vetëm një hallkë e makrosistemit, figuracioni, mund të hetohet për të parë se si kthehet në tregues dhe shenjyes i modernitetit brenda një periudhe të caktuar.

Ndikime të rrymave dhe shkollave moderne europiane shfaqen së pari te Asdreni në vëllimin e dytë *Ëndra e lotë* (1912) e më së shumti në vëllimin e tretë, *Psallme murgu* (1930), e më tej te Noli, L. Poradeci, Migjenin etj.

Moderniteti në poezinë e këtyre poetëve mund të hetohet edhe n.p.m tipareve që shfaq sistemi figuracional, tipare që lidhin poezinë e tyre me poetikat moderne e postmoderne europiane, si: simbolizmi, parnasizmi, futurizmi etj.

Lirika e periudhës së Midis Dy Luftërave duket se shfaq qartësisht në një linjë të saj (Asdreni, Noli, Poradeci etj) ndërtimin e poezisë mbi parimin e përsëritjes dhe ritmit, dhe në një linjë tjetër (Migjeni etj.) ndërtimin e poezisë mbi parimin e metaforës.

Në linjën e parë poetikat e poetëve përfaqësues kanë si parim drejtues parimin e përsëritjes dhe ritmit, ndaj edhe figuracioni priret kah strukturat që ndërtojnë muzikalitet. Si e tillë kjo poezi e vendos vëmëndjen jo vetëm tek fjala dhe lidhjet midis tyre, si njësi sematike e ndërtimit të figuracionit, por në të gjitha nivelet gjuhësore, deri te fonema që kthehet në shenjë bartëse e kuptimeve poetike. Në linjën e dytë, në poetikën e Migjenit dhe të ndonjë tjetri, vërehet ndërtimi i poezisë mbi parimin e metaforës.

Fjalët çelës: figuracion, lirikë, modernizëm, zhvillime stilistike, periudhë.

Abstract

Lyric Albanian Poetry of period between two fights reflect indication of some schools a of European literary direction. In our studies are evident feature and literary occurrence which put this period in rate with modern development and postmodern in Europe and wider.

Only one ring of macro system, figuration can be investigate to see as he is turned in the indicative and pointer of modern inside in a certain period.

Influence of streams and modern European schools shows at the first at Asdreni in his second volume *Ëndra e lotë*(1912), and most in third volume, *Psallmemurgu* (1930) and further at Noli, L.Poradeci, Migjeni etc.

Modernism in his poetry can be investigated through features that show figuration system, features that connect their poetries with modern and postmodern European poetical as symbolism, parnasism, futurism etc.

In the first line the poetics of deputy poets which have as managing principle, the principle of repeating and rhyme and by figuration tends through structures which build musicality. This poetry puts attention not only at word and connection between them, as a semantic unit of building of figuration, but as in all language levels which turns in a sign bearer of poetic meaning. In the second line, in the Migjeni poetic, we see the building of poetry through principle of metaphor.

Figuacioni si shenjyes i modernitetit në lirikën shqipe të periudhës midis Dy Luftërave

Poezialirikeshqipe e periudhës midis Dy Luftërave reflekton ndikimet e disa shkollave e drejtimeve letrare europiane. Në studimet tona janë evidentuar tipare e dukuri letrare që e vendosin këtë periudhë në raport me zhvillimet *moderne* e *postmoderne* në Europë e më gjerë.

Dukuritë dhe prirjet moderne lidhen me të dy aspektet, me brendinë dhe formën të cilat nuk mund të shihen si të shkëputura nga njëra-tjetra.

Në këtë punim do të ndalemi vetëm në një hallkë të makrosistemit, figuracionin, për të parë se si ai kthehet në tregues dhe shenjyes i modernitetit brenda një periudhe të caktuar.

Çabeji pari i sheh fillesat e modernizmit në poezinë e Asdrenit. *Studiues të tjerë* referohen këtij autori kur flasin për kalimin nga poezia romantike në atë moderne.

Ndikime të rrymave dhe shkollave moderne europiane shfaqen së pari te Asdreni në vëllimin e dytë *Ëndra e lotë* (1912), e më së shumti në vëllimin e tretë, *Psallme murgu* (1930) e më tej te Noli, L. Poradeci, Migjenin etj.

Moderniteti në poezinë e këtyre poetëve mund të hetohet edhe n.p.m tipareve që shfaq sistemi figuracional, tipare që lidhin poezinë e tyre me poetikat moderne e postmoderne europiane, si: simbolizmi, parnasizmi, futurizmi etj.

“Lotman-i pohon ‘ [Kështu] teksti artistik është ndërtuar në bazë të dy tipave raportesh: kundërvënia e ndërsjelltë e elementeve ekujvalente të përsëritura dhe kundërvënia e ndërsjelltë e elementeve afërndenjëse, joekuivalente. Gjithë varieteti i elementeve përbërës të një teksti mund të grupohet në këto dy parime’ (...). I pari është parimi i përsëritjes dhe i ritmit që barazon ato çka në gjuhën natyrore nuk janë ekuivalente dhe i dyti është parimi i metaforës që bashkon atë që është që në gjuhën natyrore nuk mund të bashkohet. Parimi i parë është qëndror për poezinë, i dyti për prozën”

Poezia lirike e midis Dy Luftërave mund të interpretohet nga këndvështrimi i këtyre dy parimeve. Edhe pse në pohimin e cituar theksohet se këto dy parime janë qëndrorë për dy llojet e teksteve letrare, përkatësisht poezisë dhe prozës, lirika e periudhës në fjalë duket se shfaq qartësisht në një linjë të saj (Asdreni, Noli,

Poradeci etj) ndërtimin e poezisë mbi parimin e përsëritjes dhe ritmit, dhe në një linjë tjetër (Migjeni etj.) ndërtimin e poezisë mbi parimin e metaforës.

Në linjën e parë poetikat e poetëve përfaqësues kanë si parim drejtues parimin e përsëritjes dhe ritmit, ndaj edhe figuracioni prirret kah strukturat që ndërtojnë muzikalitet. Si e tillë kjo poezi e vendos vëmëndjen jo vetëm tek fjala dhe lidhjet midis tyre, si njësi sematike e ndërtimit të figuracionit, por në të gjitha nivelet gjuhësore, deri te fonema që kthehet në shenjë bartëse e kuptimeve poetike. “Përsëritjet tingullore bëjnë që fonema të bëhet një shenjë e aftë “të pilotojë” kuptimin”

Në linjën e dytë në poetikën e Migjenit vërehet ndërtimi i poezisë mbi parimin e metaforës. Kujdesi për formën, muzikaliteti dhe prirja simboliste janë ndikime të simbolizmit dhe parnasizmit. Figurat tingullore dhe simbolet nuk janë të rastësishme në poetikën e Asdrenit, Nolit e të L. Poradecit. Janë këto shenja të risive në poezinë shqipe që po kalonte traditën romantike.

Kujdesi për gjuhën, vargun, rimën, ritmin spikat që tek Asdreni.

Asdreni shënon fillesat e përpunimit gjuhësor në nivel të ri estetik. Vetëdijësimi për krijimin letrar si ligjërim autonom reflektohet pikë së pari në këndvështrimin e ri ndaj gjuhës si mjet i sendërtimit të këtij ligjërimi. Tashmë poetët e kthejnë vëmëndjen tek gjuha dhe mundësitë e saj shprehëse, vlerat artistike-estetike që përfohen nëpërmjet shfrytëzimit të gjuhës në të gjitha nivelet. Lëvrimi që i bëjnë gjuhës shqipe poetët e kësaj periudhe dëshmon pasurinë e saj shprehëse.

Frymëzimet e reja në poezinë e Asdrenit shoqërohen edhe me një shprehje të re poetike.

Poezitë e tij të periudhës Midis Dy Luftërave e dëshmojnë kujdesin për anën tingullore të vargut dhe muzikalitetin. “Tani Asdreni përpiqet ta konceptojë dhe ta krijojë poezinë si një procedë aludive dhe sugjестive...”

Te Asdreni e ka fillesën prirja për ta çliruar vargun nga strukturat pamore që kishin mbizotëruar në poetikat e rilindjes dhe për të nxjerrë në pah strukturat auditive (tingullore). Një procedë e tillë dëshmoi mundësitë shprehëse e figurative të shqipes. (Përmendim poezitë: *Vegim perëndimi, Ylberi, Nakar, Vaja e pyllit, Lulja e këputur* etj.)

Ky kujdes për efektet tingullore të vargut, ritmin dhe muzikalitetin është rezultat i kërkimeve për të arritur bukurinë e shprehjes artistike. Këto prirje të poezisë së Asdrenit reflektojnë njohjen e simbolizmit rumun dhe për më tepër të atij francez, që është më i dukshëm në vëllimin *Psallme Murgu*.

Prirja simboliste e poezisë së Asdrenit, që bëhet më e dukshme në vëllimin “Psallme murgu” me të cilin hyn në poezinë moderne shqipe si nismëtar i saj, përpos kujdesit për aspektin tingullor, reflektohet edhe në përdorimin e figurës së simbolit (edhe pse në thelb simbolizmi nuk nënkupton përdorimin e simbolit), përdorur shpesh në këtë vëllimin. Përmendim poezitë: *Syt’ e Argusit, Lulja e vetëm, Lulëkuqja, Ngjyrat* etj. Asdreni shfrytëzon simbole të marra nga mitologjia, folklori dhe historia shqiptare si edhe nga mitologjia greke, romake e kristiane (Skënderbeu,

Tomori, Drini, Apollonia, Butrinti, Shkodra, Vlora apo Zana, E Bukura e Dheut, si edhe simbole të tilla si flamuri, fyelli, shkaba etj.)

Ajo që kishte filluar me Asdrenin, përkujdesja për aspektin tingullor, muzikalitetin e vargut kthehet te Noli në parim kryesor, parim drejtues i krijimit poetik. Që në krye të herës ky tipar është vënë në dukje në studimet tona. Kuteli, në parathënien që i ka bërë përmbledhjes me vjersha të Nolit, përgatitur prej tij, e cilëson muzikalitetin si tiparin kryesor të vargut të Nolit. “Vargu i tij nuk është vizual, po auditiv. I drejtohet, pra, veshit, jo syrit.”

Pikërisht te ky tipar ka parë Qosja veçantinë e poezisë noliane në sfondin e poezisë shqipe të kohës. “Vjershat e Nolit, me gjithë përgjithësimin simbolik që përmbajnë, do të ishin artistikisht të zbehta, sikut të mos ishin aq muzikore sa janë. Mungesën e shprehjes metaforike ai e ka zëvendësuar me ato dridhjet ritmike dhe muzikore çfarë nuk ka përjetuar poezia shqipe para, as pas tij.”

Asonanca, aliteracioni, asidenti, polisidenti, anafora, rima në fund të vargjeve por edhe rima e brendshme ndërthurur me lloje të ndryshme vargjesh i japin vargut të tij ritëm, muzikalitet e dinamizëm të veçantë. Tek Noli janë të shumtë vargjet ku dominojnë zanoret (të gjitha zanoret përdoren prej tij, duke qenë secila prej tyre dominante në vargje e poezi të ndryshme) si edhe bashkëtingëlloret (veçanërisht bashkëtingëlloret ç, m, n, s, r, sh, gj).

Noli është një rast unik në poezinë shqipe pikërisht për veçoritë që paraqet vargu i tij. Ndikimi i simbolizmit është evident në këtë aspekt. Por gjithashtu nuk duhet të harrojmë se lidhja me muzikën ka qenë e hershme në formimin dhe edukimin e Nolit. I rritur nën ndikimin e muzikës kishtare, pjesmarrja në korin e kishës, për të vijuar me studimin “Bethoveni dhe Revolucioni francez” dëshmojnë një lidhje të brendshme me muzikën. Kjo do të reflektohet edhe në krijimtarinë poetike të autorit.

Nën ndikimin e simbolizmit e sheh Qosja muzikalitetin e vargjeve të Nolit dhe përdorimin prej tij të simboleve. *“Intonimi muzikor i vargjeve të tij flet qartë sesa shumë ishte nën ndikimin e simbolistëve. Kjo vërehet edhe në futjen e ideve të tij politike brenda kornizës së simboleve të biblës. Prej këtyre dy fakteve mund të shihet, gjithashtu, sesa bukur e ka ditur ai kahun e zhvillimit të poezisë bashkëkohore dhe sesa i ri është treguar me ndjeshmërinë e vet poetike”*.

Muzikaliteti është i dukshëm në disa poezi të Asdrenit, veçse vargu nolian duket se në ndërtimin e tij nuk ka lidhje të dukshme me vargun e Asdrenit. Tonet dhe dridhjet e vargut nolian shfaqen origjinale sa vështirë të evidentohet burim apo model të cilin autori e ka shfrytëzuar, apo është ndikuar. Muzikaliteti i vargut nolian ka pamje krejt të ndryshme prej gjithë poetëve të tjerë të periudhës dhe të mëvonshëm, në poezinë e të cilëve dëshmohet prania e këtij tipari. Ndryshe prej Asdrenit, prej Lasgushit e ndonjë tjetri vargu i Nolit nuk është i butë, lirik, por buçitës. Karakteri kushtues i vargjeve shkon në të njëjtën linjë me llojin, përmbajtjen dhe idetë e poezive.

“Fan S. Noli sjell në letrat e shqipes një stil individual, të tijë, një vibracion energjik, një verb violent me shprehje metaforike të forta, që rrokullisen njëra pas tjetrës.”

Ky stil i veçantë qëndron në harmoninë mes përmbajtjes dhe formës. Edhe tipari kryesor, muzikaliteti, ashtu si edhe simbolet me domethëniet e tyre, por edhe tiparet e tjera të formës në vargun e Nolit (rima, ritmi, toni, strukturat sintaksore etj.) qëndrojnë si përzgjedhje në përshtatje me përmbajtjen e poezive.

Sa ndikues mund të ketë qënë përkthimi i vargjeve të autorëve anglezë në këtë drejtim?

Përsëritja, në nivele të ndryshme (tinguj, fjalë, shprehje) është mjet nëpërmjet të cilit ndërtohet atmosfera e vargut. Në këtë pikë vargu i Nolit ka pika takimi me vargun e E. A. Poe, ku mjeshtërisht ndërtohet atmosfera e dhimbjes me anë të përsëritjeve. Kjo mund të interpretohet edhe si ndikim prej njohjes dhe përkthimit që i ka bërë Noli vargjeve të Poe-së.

Prirjen kam muzikaliteti Qosja nuk e sheh të rastit, duke patur parasysh një trashëgimi prej të atit, pjesmarrjen e Nolit fëmijë në korin e kishës e dashurinë për muzikën, dëshmuar deri në fund të jetës.

Hetimi në gjithë fazat e jetës dhe krijimtarisë së Nolit në fusha të ndryshme dëshmon jo thjesht një prirje të rastit ndaj muzikës. Ka disa premisa që janë domethënëse në këtë aspekt. Noli trashëgon prej të atit, psallt në kishë, dashurinë për muzikën kishtarë. Ndoqi një gjimnaz që i dha një formim muzikor. Ishte drejtues i korit të kishës dhe organizonte ceremonitë kishtarë.

Poezia e Nolit e dëshmon aftësinë kompozuese më parë se të shfaqet në muzikë.

Kompozimet e tij muzikore, edhe pse më të mëvonshme se krijimtaria poetike (që mund ta quajmë pa frikë kompozim fjalësor), vetëm e përforcon më tej prirjen ndaj muzikës.

Por nuk ishte thjesht një prirje, një dashuri ndaj muzikës. Monografia “Bethoveni dhe Revolucioni francez”, studim serioz në fushën e muzikës, dhe kompozimet muzikore janë tregues i formimit kulturor ndaj muzikës.

Ky receptim i muzikës në tërë etapat e jetës shndërrohet në muzikë e fjalës. Pra, nuk është e rastit fakti që i dha poezisë karakterin muzikor, auditiv. Kjo nuk përjashton preferencat dhe ndikimet e poetëve të huaj që krijonin në këtë terren.

Figura e simbolit gjen përdorim të veçantë në poetikën e Nolit. Shfrytëzon simblote të njohura në poezinë botërore si edhe simbole biblike nëpërmjet të cilave realizon kapërcimin nga shqetësimet personale në përgjithësime artistike.

Ato prirje gjuhësore-figurative që evidentohen në poezinë e Asdrenit do të jenë më të qarta e më trajta më të plota te një tjetër poet, L. Poradeci, ku ashtu si te Asdreni ndikimi më i madh do të jetë nga simbolizmi francez dhe rumun.

Lasgush Poradeci është parë në afri me disa drejtime e shkolla pasromantike europiane që si tipar të përbashkët kanë vëmendjen e veçantë për formën dhe rolin e të gjitha elementeve në realizimin e asaj që ai e quante *forma e përsosur artistike*, të

cilën e pati ideal krijues. Në këtë aspekt figura, si çelësi i transformimit të jolettrares në letrare, i shërben poetit për ta arritur idealin. Për t'iu shmangur një interpretimi vetëm formalist theksojmë këtu që për L. Poradecin nocioni *formë e përsosur artistike* nuk lidhet vetëm me aspektin formal të poezisë, por me tri elementet që, sipas L. Poradecit janë të domosdoshëm në krijimin e një poezia: përmbajtja, forma dhe stili i ri.

Të tri këto elemente mund të sendërtohen në radhë të parë nëpërmjet figurës, e cila nuk duhet konceptuar si zbukurim i jashtëm. “figurat nuk janë as një zbukurim i jashtëm dhe as një lojë fjalësh. Figura është një dukuri ideoestetike, e cila i përshtatet natyrës së letërsisë si arti i fjalës. Poezia nuk është një ilustrim i një ideje me anë të figurave, por është një përpjekje për të arritur tek ideja nëpërmjet një mënyre njohjeje specifike, të lidhur ngushtë me vështrimin tërësor të botës, me përfytyrimin e saj konkret e të individualizuar, me qëndrimin ideor e emocional, me përvojën vetjake etj.”

Poezia e Lasgush Poradecit shfaq dukshëm disa tipare të përveçme. Këtë në radhë të parë e demonstroi figuracioni në sistemin e tij poetik. Figura është çelësi që i jep jetë ideve dhe realizon formën artistike.

Lasgushi shfaqet si *casus unicum* në shumë drejtime në poezinë e tij. Ndërthurja e një lloji *romantizmi të veçantë* me drejtime e rryma postromantike, moderniste vjen jo si një kombinim i detyrueshëm por si një rezultante unike në korpusin e letrave shqipe.

Ajo vijë që kishte filluar me Asdrenin do të vazhdojë në poezinë e L. Poradecit duke u ngritur më tej.

Nën ndikimin e simbolizmit, parnasizmit, dekadentizmit Lasgushi krijon formën e përsosur. Ndjeshmëria, emocionaliteti i lartë poetik, përdorimi i përftesave të sferës emocionale (pasthirrma, apostrofa), fjalori i pasur, polisemantizmi e polivalenca gjuhësore, maksimalizimi i thënies në kontekste variacionale, sintagma poetike, muzikaliteti e funksionalizimi i elementeve formalë prej të cilëve përfton vlera poetike janë një arsenal që ndërthuren e shfrytëzohen mjeshtërisht prej poetit duke krijuar një sistem. Lasgushi është ndër të rrallët poetë që ka qenë i vetëdijshëm se po krijonte një sistem poetik.

Sipas këndvështrimit strukturalist në gjuhën e letërsisë çdo shenjë e denotative (substanca e shprehjes denotative, forma e shprehjes denotative, forma e përmbajtjes denotative, substanca e përmbajtjes denotative) mund të funksionojë si substancë e shprehjes së shenjës konoative. Kështu mund të marrim vetëm rastin e thjeshtë të substansës denotative të poezitë e Lasgush Poradecit, p.sh. lojën e tingujve, shpërndarjen e tyre, pozicionin dhe deri të shenjat e pikësimit, të cilat janë një element i rëndësishëm i komunikimit me lexuesin.

Muzikaliteti është tipari më i qenësishëm i poezisë lasgushiane. Për të arritur efektet e dëshiruara poeti përdor mjeshtërisht gjithë mundësitë e gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e saj. Aliteracioni dhe funksionalizimi i shenjave të pikësimit janë procedetë të dallueshme nëpërmjet të cilave poeti ndërton ritmin e duhur në poezi.

Ashtu siç thotë Sabri Hamiti teksti poetik te Lasgushi tingëllon si fjalë e folur, si këngë.

Kujdesi për muzikalitetin është ndikim i simbolizmit dhe parnasizmit, drejtime që kanë lënë vulën e tyre në poetikën lasgushiane.

Po të ndalemi te figura e aliteracionit mund të sjellim shembuj pa fund ku secili prej tyre paraqitet i veçantë e funksional në lidhje me elementet e tjerë të poezisë.

Por loja tingullore mund të hetohet më nga afër po t'i referohemi strukturës grafike që krijon vargu në poezinë e Poradecit.

Në poezinë “Ku shtrohet vala...” shfaqen dukshëm disa tipare të stilit të përveçëm të Lasgushit. Zanoret e vargut të parë janë: u – o – e – a – ë – i – a. Struktura grafike që krijon vargu, duke u nisur nga cilësia e këtyre zanoreve në shqip është në formën e valëve.

Nga kjo strukturë grafike ne mund të shohim harmoninë tingullore të vargut, muzikalitetin e tij në formë vale, që paraqet strukturën emocionale të poezisë.

Kjo është karakteristikë jo vetëm për vargun si qelizë, por edhe për strofën në tërësi. P.sh. në vargun e parë siç vihet re mbizotërojnë zanoret e ngritjes së ulët, në vargun e dytë mbizotërojnë zanoret e ngritjes së lartë (e – y – ë – e – a – u – a). Raporti është katër me dy. Në vargun e tretë kemi sërish një mbizotërim të zanoreve të ngritjes së ulët e të mesme (ë – a – ë – o – e – a). Në vargun e katërt, siç dëshmohet kemi vetëm një zanore të ngritjes së lartë (ë – e – i – ë – a – a – u – a). Raporti është gjashtë zanore të ngritjes së lartë dhe tre të ngritjes së ulët. Pra, dhe vetë strofa ka një strukturë vale. Edhe duke u nisur nga rimat ne e shohim këtë strukturë vale (a – uar – a – uar). Simetria sonore është krejt e dukshme.

Kjo strukturë tingullore që është karakteristikë e gjithë artit të Lasgushit tregon se ky element është një tipar thelbësor në artin poetik lasgushian dhe nuk është element i rastësishëm.

Ashtu si simbolistët e brezit të parë ai e çliron vargun, poezinë në vetvete nga përmbajtja e zakonshme. Vargu dhe strofa pushojnë së shërbyeri përmbajtjes, siç kishte qenë deri më parë dhe tani e çliron vargun nga strukturat e tij pamore për të nxjerrë në pah strukturat tingullore e gojore.

“Kuptimi leksikor, konvencional, është vetëm një ‘lëndë e parë’ që riformulohet nga struktura poetike sidomos sipas efekteve të muzikalitetit. Muzikaliteti nuk është qëllim në vetvete, por ai krijon zona komplekse kuptimi që rinovohen pas çdo leximi dhe ekzekutimi”.

Ky është i ashtuquajturimi imazh i pastër sonor që është tipar i dekadentizmit. Ky imazh nuk qëndron vetëm në lojën tingullore të fjalëve, por edhe në tërësinë e elementëve që përbëjnë planin e shprehjes (formën), si përdorimi i fjalës sipas një kodi gjuhësor, kolektiv a vetjak; kuptimin jo si element i referencës, por si shënues i lidhjes kuptimore që është në qendër të figurës poetike etj.

Lasgushi është cilësuar, ndër të tjera, si poet simbolist. Nëse nisemi nga numri i poezive të konsideruara simbolike për të përcaktuar një poet si simbolist ose jo, ky

kriter nuk do të bënte të mundur përcaktimin e Lasgush Poradecit si poet simbolist. Poezitë simbolike të Lasgushi nuk zenë hapësirën më të madhe të krijimtarisë së tij.

“Simbolizmi shënon kalimin nga alegoria në simbolin, nga mbyllja e metaforës në hapjen ndaj metonimisë dhe më së fundi në fuqinë evokative të fjalës së thjeshtë e cila shërben si prizëm ndaj asociacioneve dhe domethënieve”.

Është theksuar nga studiuesit puna e hollë e Lasgushit me gjuhën, ku fjala e thjeshtë rimerr forcën e saj dhe çlirohet nga karakteri i rëndomtë, duke bërë pjesë në kontekste me ide të përzgjedhura. Në këtë pikë, teknikisht Lasgushi ofron me punën e simbolistëve me gjuhën.

Poetët shpesh afrohen krejt spontanisht drejt simboleve ndërsa më rrallë simbolet krijohen nga poetët dhe mbeten si të tillë në sajë të tyre. Ajo që na shtyn ta cilësojmë Lasgushin poet simbolist është fakti se elementet simboliste që përdor janë të harmonizuara brenda sistemit të tij poetiko-filozofik, dhe këto elemente marrin statusin e simbolit prej përzgjedhjes së tyre në mënyrë të vetëdijshme nga ana e poetit.

“Si është e ditur, simbolet e përdorura nga Lasgushi janë mjaft të kufizuara si kuantitet dhe si të tilla ato nuk e bëjnë atë një poet simbolist, përkundrazi, të tillë e bëjnë qëndrueshmëria e simboleve (lidhja e brendshme) dhe më shumë aspekti filozofik i trajtimit të tyre”.

Te ky poet temat qëndrore janë tema, vizione, gjendje shpirtërore të fjalësuar me statusin e simbolit.

“... një simbol mund të jetë ose një gjë shumë e qartë (një shprehje njëkuptimshëshe, me përmbajtje të përcaktueshme) ose një gjë shumë e errët (një shprehje shumëkuptimshëshe, që ndjell një mjegullnajë përmbajtjeje)”. Brenda poetikës së Lasgush Poradecit luhet me të dy format e simbolit. Gjenden në poetikën e tij simbole që në një kontekst të caktuar e kanë të dallueshme përmbajtjen e përcaktuar nga poeti, dhe simbole që, në mënyrë të qëllimshme, lejojnë shumëkuptimësi.

Leksiku i Poradecit përfton vlera simbolike duke e parë në relacionet që krijon jo vetëm brenda një poezie, cikli poetik por brenda vëllimit e gjithë poetikës.

Veçanërisht në ciklet **Vallja e Përjetësisë, Zemra e Përjetësisë, Vallja e Vdekjes, Zemra e Vdekjes** dëshmohej një simbolikë e thellë. Vetë titujt e cikleve, titujt e poezive përbërëse e më tej brendia e poezive ngihen mbi bazën e simboleve.

Gjithë poetika lasgushiane, veçanërisht në këto katër cikle, dëshmon procesin krijues si rrugëtim drejt njohjes, si kërkim i njohjes së vetvetes, të njohjes së mikrokozmosit dhe makrokozmosit. Autori ngul këmbë në “njohjen e raportit mes botës dhe njeriut dhe jo në njohjen e botës dhe njeriut veç e veç”. Pikërisht simbolet e evokuara nga poeti lënda, *fryma, qëllimi, qielli, dheu, yjet, vallja, njeriu, Zoti, përjetësia, lundra, flamuri, anija* etj., janë simbole të fuqishme që shenjojnë njohjen poetike.

Me poezinë e Asdrenit, Nolit, Poradecit në periudhën e midis Dy Luftërave ndërtohet një linjë e re në lirikën shqipe që dëshmon modernitetin e letrave shqipe, një modernitet që hetohet në dy aspekte: nga njëra anë shkëputja prej poetikave

tradicionale dhe nga ana tjetër lidhja me poetikat moderne europiane. Lidhja me poetika të tilla si simbolizmi e parnasizmi, shfaqet n.p.m disa tipareve pa u konsoliduar në shkolla e drejtime të mirëfillta letrare. Këtë e reflekton dhe figuracioni që bëhet shenjes i këtyre prirjeve.

Migjeni shfaqet si një poet që e ndërpret linjën e krijuar nga Asdreni e të çuar më tej nga Noli e Poradeci dhe sjell në lirikën shqipe një frymë të re, një mënyrë të re të të bërit poezi.

Poetika e tij shënon përmbyshjen e vlerave të krijuara në letërsinë shqipe, shmangien prej traditës nëpërmjet një sistemi të ri vlerash. Nëse tek poetët e tjerë të periudhës gjenden gjithmonë gjurmë të atij sistemi letrar që bazohej mbi kultin e heroit, kultin e identitetit, kultin e epopesë “ishte pikërisht Migjeni që e ‘shmangu letërsinë shqipe nga kulti i epopesë’”.

Përmbyshja nënkupton të huajzimin ndaj vlerave të krijuara në letërsi, ndaj dogmave (ndaj të cilave Migjeni është shfaqur gjithmonë skeptik, ironizues deri dhe rebelues), dhe rrjedhimisht në të huajzimin e lexuesit duke thyer teknikat poetike mbizotëruese.

Në këtë pikë krijohet nyja lidhëse me disa poetika moderne europiane, si: ekspresionizmi, futurizmi, krepuskolarizmi, rryma pa një kufi të qartë mes tyre, e shpesh rrjedhim i të njëjtit moment.

Ndërsa simbolizmi dhe ekspresionizmi janë arte tipike moderne, futurizmi dhe surrealismi janë tipike avangardiste.

Tipare të poezisë së Migjenit duket se e lidhin poetikën e tij me modernizmin apo qofte dhe me avangardizmin, veçse si përjasje ndaj tyre, si prani me disa prej elementeve që ndërthuren, përshfaqen e krijojnë prirje.

Përmbyshja në planin përmbajtësor shoqërohet me përmbyshje në planin formal. Vetë përdorimi i veçantë i gjuhës nga Migjeni, *çlirimi i shprehjes nga çdo shtrëngim dhe pengesë e gjuhës artistike tradicionale* (shembja e sintaksës, organizim i ri ritmik, liria e fjalëve dhe e shenjave të pikësimit etj.), jo vetëm në poezi, dëshmon organizim të vetëdijshëm të një sistemi të ri letrar. “poezitë dhe prozat e shkurtra hyjnë në marrëdhënie edhe në brendi të tyre, për të krijuar përmbyshjen groteske të mitit religjioz dhe atij “të fjalës”, duke përvijuar një sistem vlerash artistike, nëpërmjet zgjidhjeve formale homogjene.”

Përmbyshja e mitit “të fjalës” te Migjeni arrihet nëpërmjet përdorimit që i bën gjuhës, rrjedhimisht ndërtimit dhe funksionit të figurës.

Migjeni dëshmon një qëndrim të ri ndaj gjuhës. Leksiku i poezisë së Migjenit është leksiku i jetës së përditshme.

Nëse te Asdreni apo akoma më shumë te L. Poradeci fjala krijonte një rreth të gjerë ngjyrimesh e shtresash kuptimore, te Migjeni ndodh e kundërta. Ai me vetëdije e zhvesh fjalën nga “mëndafshi i butë” për të goditur më anë të saj sa më fuqishëm. Ai i drejtohet fjalëve të zakonshme, kuptimeve të parme të fjalëve, për të përcjellë në mënyrë sa më të thellë atë realitet të ashpër që e rrethonte dhe si e tillë, fjala e zakonshme fiton vlerë estetike kur futet në krijimin poetik. Ai e synon përputhjen,

harmonizimin mes formës dhe përmbajtjes, ndaj edhe përzgjedhja dhe përdorimi i fjalorit të zakonshëm shkon në të njëjtën vijë me vendosjen në qendër të krijimtarisë së tij të problematikave të jetës së përditshme (motivet humane, mjerimi, prostitucioni janë tipare të ekspresionizmit).

Migjeni duket se nuk kërkon të krijojë imazhe të tjera për dukuritë, por i jep ato përmes përmasave reale të kohës dhe hapësirës. Këtë e tregon afria me stilin e gjuhës bisedore (fjalori, vargëzimi, stili përgjithësisht i zhveshur, ashpërsia e shprehjes etj.). Duke ndërtuar një poezi që mbështetet në modelin e komunikimit përmes gjuhës së përditshme, çka e bën poezinë e tij të afërt me prozën (fjalori i jetës së përditshme, strukturat e thjeshta, fokusimi i vëmendjes tek ajo që thuhet etj.), poeti krijon struktura dhe kode të reja poetike.

Vepra e Migjenit, në këtë kontekst poezia, dëshmon veçori në boshtin formal; në aspektin stilistikor, veshjen gjuhësore, përdorimin e stilemave të veçanta, figuracion.

Figura, si prani dhe si mungesë, në lirikën e Migjenit kthehet në shenjë. Vargu i tij nuk shquhet për pasurinë figurative.

Figura në poetikën e tij del e ndryshme si në aspektin e ndërtimit, edhe në atë të funksionalizimit të saj.

Si ndërtim figura në vargun migjenian realizohet shpesh nga lidhja gjuhësore e fjalëve të thjeshta, madje edhe të rëndomta, jopoetike, të vrazhda, pa ngjyresa kuptimore emocionale, nga evokimi i drejtëpërdrejtë i fjalës me kuptimin themelor të saj.

Kjo lidhet me funksionalizimin që i bën poeti figurës. Figura është konsideruar si zbukurim, si e tillë ajo më tepër përdoret për ta fshehur, zbukuruar realitetin. Kjo nuk ndodh te Migjeni. Ndaj dhe përgjithësisht figuracioni i tij del në përdorim si përshfaqëse e realitetit jetësor duke krijuar realitetin letrar.

Migjeni duket se nuk ka dashur që në poezi për dukuri të ndryshme të krijojë një imazh tjetër, përkundrazi ai i mbetet besnik përmasave reale të kohës dhe hapësirës. Si rrjedhim ai e ndërton imazhin duke u bazuar te detaji. Detajet i nxjerr nga realiteti, i përzgjedh dhe i vë në lidhje të tillë që paraqesin imazhe të fuqishme. Kjo procedë realizohet gjuhësisht duke përdorur fjalorin e jetës së përditshme, kuptimet themelore të fjalëve dhe si rrjedhim dyfishohet projeksioni artistik i realitetit duke krijuar imazhe poetike të forta. Migjeni synon përputhjen e thënies dhe arthënies në tekstin poetik.

Ky është një parim i ndërtimit të figurës nga poeti, veçanërisht i spikatshtëm në rastin e metaforës.

Në poezinë tonë të Rilindjes, dhe jo vetëm, metafora është përdorur për ta fshehur realitetin. Një teknikë e tillë mund të hetohet edhe në letërsinë evropiane në periudha të ndryshme. Ndryshe ndodh me Migjenin.

“Ajo çka e shquan Migjenin prej çdo shkrimtari tjetër shqiptar është shija e tij për metaforën, e cila në veprën e tij është hiperbolike dhe eksentrike. Metafora është themeli i gjuhës poetike, nuk ka letërsi pa të. Por metafora në poezinë shqipe është

zakonisht shpjeguese dhe illustrative, e afërt me krahasimin. Shqiptarët, që priren të jenë realistë dhe praktikë, anojnë kah një stil diskursiv, pa kalime të dhunshme apo kontraste të thella. Përkundrazi, Migjeni nuk procedon shkallë-shkallë, por me hapa viganë dhe metafora i shërben si trampolinë. Mund të thuhet se metafora është forma e tij natyrore e shprehjes.”

Metafora, mjet themelor i shkrimit letrar, është mjet themelor në konceptimin dhe sendërtimin e poetikës migjeniane, rrjedhim i konceptimit dhe sendërtimit të realitetit.

Nëse si tipar dallues i poetikës migjeniane është evidentuar mbështetja *në ritmin e të folurit emocional sipas stilit të gjuhës bisedore*, ajo që e ngre vargun migjenian në nivelin artistik është ndërtimi i metaforave të forta, apo gërshetimi i figurimit metaforik me atë metonimik. (*Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi; Mjerimi rrit fëmin në hijen e shtëpive; Mjerimi punon, punon ditë e natë; Mjerimi s'ka gëzim, por ka vetëm dhimba; Mjerimi s'don mëshirë;... etj.*)

Ndërtimi i metaforës, por edhe i figurave të tjera, nga lidhja mes fjalëve të thejshta, shpesh të vrazhda, jopoetike, pa ngjyresë emocionale, duke paraqitur imazhe të forta është tregues i zgjedhjeve stilistikore të afërta me futurizmin apo ekspresionizmin.

Thjeshtësia e shprehjes, të folurit e drejtëpërdrejtë, parimi i vërtetësisë (shpesh vargjet e tij dhe gjuha e përdorur synojnë paraqitjen me një vërtetësi dokumentare të realitetit, dukurive që e rrethojnë), përzgjedhja e detajit, shmangia e sintaksës, vargu i lirë, shmangia e rimave etj., janë tipare të poezisë së tij që lidhen me parimin estetik të ekspresionizmit: *çlirimin e shprehjen nga çdo shtrëngim dhe pengesë e gjuhës artistike tradicionale dhe, në përgjithësi, nga çdo konvencion i traditës letrare.*

Këto elemente që ne përvijojmë, të cilat kërkojnë një studim më të thelluar, janë dëshmi e disa prirjeve moderniste, si zhvillime stilistike që prekën lirikën tonë në segmentin kohor midis dy Luftërave, por që nuk arritën të konsolidoheshin si drejtime të qarta.

Bibliografi

Barthes, Roland, “Elementetësemiologjisë”, Sejko 1999.

Berardi, Roberto, *Dizionario dei termini della critica*, Firenze, Le Monnier 1989.

Bini, Valter *La poetica del decadentismo*, Firenze, Sansoni 1968

Çabej, Eqerem, *Mbi poesinë e Lasgush Poradecit*, në “Gazeta e Re”, 22 shkurt 1929.

Elsie, Robert, *Letërsiashqipe, njëhistori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë 2006.

Enciclopedia della letteratura Garzanti, Milano 2002.

Guiraud, Pierre, et Kuentz, Pierre, *La stylistique*, Klincksieck, Paris 1978.

Hamiti, Sabri, *Lasgushi qindvjeçar*, Faik Konica, Prishtinë 1999.

Hjelmslev, Lous, *I fondamenti della teoria del linguaggio*, Torino, Einaudi, 1968.

Kuteli, Mitrush, *Poeti Fan S. Noli, Parathënie e Albumit*, Rilindja, Prishtinë 1968.

- Kuteli, Mitrush, *Poeti F. S. Noli, Vështrim panoramik*, në “Kuteli, Shënime letrare”, GrandPrind 2007, fq. 61: Botuar për herë të parë në librin “*Fan S. Noli, Mall e brengë*” (*Me një vështrim kritik prej Mitrush Kutelit*), Tiranë, 1943.
- Kolevica, Petraq, *Lasgushi më ka thënë...*, Tiranë 1992.
- Lloshi, Xhevat, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë 1987.
- Mia Pozzato, Maria, *Semiotica del testo. Metodi, autori, esempi: Semiotika e tekstit. Metoda, autorë, shembuj*, përktheu Dhurata Shehri, Shblu, Tiranë 2005.
- Pipa, Arshi, *Për Migjenin (tri ese)*, Tiranë 2006, f. 55.
- Plasari, Aurel, «*Princ*»përballë «*princërve*», në Don Kishoti zbret në Shqipëri, Tiranë 1987.
- Qosja, Rexhep, *Lirika shqipe*, në Jehona, Shkup 1970, Nr. 6.
- Qosja, Rexhep, *Panteoni i rralluar*, Tiranë 1988.
- Sejdiu, Shefki, *Struktura e relacione në sistemin poetik të Lasgush Poradecit*, në Sisteme, struktura, raporte, Era, Prishtinë 2002.
- Suta, Blerina, “*Pamje të modernitetit në letërsinë shqipe*”, Onufri, Tiranë 2004
- ShabanSinani, Shaban, *Miti i “idesë” në vend të kultit të heroit*, SF., 1998, n. 3 – 4.
- Tufa, Agron, *Një vështrim mbi zhvillimet moderniste e avanguardiste të shek. XX*, në Fenomeni i avanguardës në letërsinë shqiptare (Aktet e seminarit shkencor), Tiranë 2004.
- Xhevat Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe*, Albass, Tiranë 2005.
- Xhiku, Ali, *Nga Romantizmi rrjedhave të realizmi*, Tiranë 1989.

STRUKTURA SIMBOLIKE E SUBJEKTIT TE “KUSH E SOLLI DORUNTINËN” E SHKRIMTARIT ISMAIL KADARE

Marina Prifti

Permbledhje

Punimi është një përpjekje në zbërthimin e një teksti që vetë Kadareja e mistifikon, duke rifurur dimensione të reja mitike mbi një nënshrat ekzistues mitologjik. Për këtë arsye analiza rreket të zbërthejë simbolet te cilat mundësojnë sipershtresëzimet kuptimore dhe strukturale të rrëfimit, duke realizuar kështu një formë të re “mistifikimi”, përmes destruktualizimit të elementëve përbërës tekstualë. Jo rrallë punimi ndesh në vështirësi të raportit simbol-strukturë simbolike, vështirësi kjo që kapërcehet përmes ndërthurjes së të dyjave në një linjat narrative janë parë si simbole të vetvetes, po aq sa janë parë personazhet aktancilë si simbole të linjave të narracionit dhe simbole të vetvetes. Kjo i ka mundësuar analizës të jetë disa-dimensionale dhe të operojë në disa nivele tekstualë njëherazi duke ruajtur në të njëjtën kohë strukturalizimin e elementëve përbërës rreth qendres së monomitit, i cili është struktura narrative modale që i përmban njëherazi të gjitha gjendjet e subjektit.

Fjalë kyç:analize, strukturë, monomit, simbol, program, narrativ

Abstract

The article deals with a multidimensional way, with the variety of symbolic procedures and structures, which enable the coexistence of the ancient myth of rebirth with the modern myth of the moral values established by the main characters of the novel. The three main characters, Doruntina, Konstandin and Stress, create a puzzle which portrays not only their inner world, but also a much deeper reality, that of the archetypal and mythical thinking, where the interchangeability of images and movement is intersected with undestructibility of patterns which repeat themselves creating the new myth paralleling the old one.

Hyrje

Te romani “Kush e solli Doruntinën”, subjekti ka formën e një shkalle, ku niveli i parëi rrëfimit, është linja qëi përket Kostandinit, niveli i dytë, linja qëi përket programit narrative të Stresit, linja e tretë, ajo qëi përket shokëve të Kostandinit. Të gjitha këto linja, janë të mbivendosura mbi njëra – tjetrën, në formën e një shkalle e cila është ngjitëse dhe zbritëse. Jo rastësisht, përpara fjalimit të Stresit, autori nënvizon faktin se punëtorët po ngrinin disa shkallë druri, ndërsa sapo mbaron fjalimi i tij dhe personazhi zhduket, shkallët ç’montohen një nga një. Shkallët simbolizojnë ngjitjen drejt enigmës si dhe zbritjen prej saj. J. Campbell shpreh se mite të ndryshme të cilat kanë mbijetuar për mijëra vjet, kanë të gjitha një strukturë fundamentale të përbashkët, të cilën ai e quan “monomit” në veprën e tij shumë të

njohur “The hero ëth a thousand faces”. Ai shkruan në mënyrë të përmbleshur për monomitin:

“Një hero guxon të shkëputet nga bota e së përditshmes dhe të hyjë në zonën e mrekullisë së mbinatyrshme, atje ai përballet me forca mostruoze dhe fiton një diçka shumë të rëndësishme; heroi kthehet nga aventura e tij misterioze me pushtetin për t’iu falur bekim bashkëkohësve të tij”

Në përshkrimin e monomitit, Campell përshkruan një seri fazash nëpër të cilat duhet të kalojë heroi gjatë udhëtimit. Heroi është në botën e tij të zakonshme. Ai merr një thirrje për të hyrë në një botë të pazakontë, me ngjarje dhe fuqi të çuditshme (thirrjen për aventurë). Në qoftë se heroi e pranon këtë thirrje për aventurë, ai duhet të përballet me detyra dhe vështirësi (rruga e provave), të cilat duhet t’i kalojë vetëm ose me ndihmë. Në rastin më të vështirë, heroi duhet të përballet me një detyrë shumë të zorshme, shpesh me anën e ndihmës që ai fiton gjatë udhëtimit. Në qoftë se heroi mbijeton, ai mund të arrijë një dhuratë ose bekim shumë të madh (arritja ose “bekimi” nëterminologjinë e Campbell) e cila rezulton në një vetnjohuri të rëndësishme.

Heroi duhet të vendosë, atëherë nëse duhet të kthehet me këtë bekim (kthimi në bota e zakonshme), shpesh duke u përballur me vështirësi në rrugën e kthimit. Në qoftë se heroi është i suksesshëm në kthim, bekimi ose dhurata që ai ka marrë, mund të merren me këto faza, por ë vendosura me një tjetër rradhitje. Këto faza, mund të organizohen në disa mënyra, duke përfshirë edhe ndarjen në tri sektorë: ndarja, inicimi, kthimi. Ndarja ka të bëjë me hedhjen e heroit në veprim sipas thirrjes që ka marrë, inicimi ka të bëjë me aventurat e heroit përgjatë rrugës dhe kthimi ka të bëjë me kthimin e heroit në shtëpi, së bashku me pushtetin dhe dijet që ka fituar gjatë udhëtimit. Shembujt klasikë të monomitit, sipas Campbell, përfshijnë tregimet për Osirin, Prometeun, Budën, Moisiun, Krishtin së bashku me shumë mite të tjerë, të cilat bazohen mbi këtë strukturë. Campbell bën një përzierje të arketipave të Jungut, forcave të subkoshienës dhe teorisë së Arnold Van Gennep për strukturat e ritualeve të pasazhit.

Prova kryesore që duhet të kalojë heroin ë “rrugën e provave”, shpesh paraqitet si një martesë, midis heroit dhe një figure-mbretëreshë ose figure- nënë. Kjo përfaqëson zotërimin e jetës prej heroit (jeta e përfaqësuar simbolikisht nga një figurë femërore, figura tjetër me të cilën bashkohet është figura mashkullore. Kthimi i heroit në botën e zakonshme, shpesh paraqitet si fluturim magjik. Pasi ka marrë dhuratën e bekimit, ai duhet të luftojë kundër forcave që e pengojnë në rrugën e kthimit. Heroi mund të ketë nevojë për ndihmë prej forcave që ndodhen në botën e zakonshme. Kjo ndodh sepse heroi ka refuzuar të kthehet ose ndoshta sepse është krjetësisht i bllokuar në rrugën e tij të kthimit, së bashku me bekimin. Heroi humbet ego-n e tij, në këtë fazë. Kur heroi kthehet në botën e zakonshme, duhet ta pranojë këtë botë, si reale. Për shkak të bekimit apo përvojës që ai fiton prej udhëtimit, heroi mund t’i perceptojë të dyja botët njëherësh; atë reale dhe atë hyjnore. Në “Odisea” kemi tre udhëtime. Njëri është ai i Telemakut, që kërkon të atin. i dyti është udhëtimi i Odisesë, i cili ka për qëllim kryesor bashkimin me principin femëror në sensin e marrëdhënies mashkull-femër se sa në dominimin e femrës prej mashkullit, që është

në qëndër të “Shadës”. Udhëtimi i tretë është ai i Penelopës, udhëtimi i së cilës është qëndresa dhe durimi. Kemi dy udhëtime përmes hapësirës dhe një udhëtim përmes kohës.

Carl Young, shkruan për simbolikën e heroit: “Pasi kalon provën e kthimit, heroit duhet të pajtohet me dy figurat simbolike prindërore me nënën dhe babain. Figura e nënës paraqitet si një lloj perëndie mitike, ose si princeshë, apo zanë, që përveç të tjerave simbolizon Nënën – Natyrë dhe e bekon heroin si zotëruesin dhe njohësin e saj. Ajo mund të jetë e mirë, ose e keqe, e bukur ose e shëmtuar. Ajo e mbështet, e përkrah dhe e ushqen shpirtërisht heroin, gjatë udhëtimit të tij, duke i ofruar shpresë dhe duke e inkurajuar. Por ajo përfaqëson dhe frytin e tundimit për heroin, në qoftë se ai është i etur për kënaqësi apo pasuri tokësore. Nëna – Natyrë, në formën e perëndeshës, shpesh i ofron ndihmë heroit, por ajo thjesht mund t’i tregojë atij rrugën e Ndrichimit të së vërtetës. Vetëm babai mund ta zbulojë atë të vërtetë. Nëna dhe Babai ipërfaqësojnë pricipet më të larta, të cilat përbëjnë natyrën njerëzore. Atman, kulmi mashkullor i perfeksionit human, ndërgjegjje e pastër, e pakompromentuar dhe Buddhi, aspekti femëror, i transformuar i atman, i cili, kur unifikohet me trurin njerëzor sjell kuptimin e plotë të jetës.

Koncepti i “buddhi”-t në hinduizëm është “aftësi e lartë mendore, instrument dijeje, përcaktueshmëri dhe vendim.” Ai kontraston me “manas”, mendjen, regionin i së cilës është ndërgjegjja e zakonshme dhe lidhja e atmanit me shqisat. Buddhi është në qëndër të ekzistencës onologjike, një lloj si zvarranikët e lashtë që janë në qëndër të jetës që evoloi më pas. Buddhi është aftësia mendore që qëndron më afër atman, Vetes së vërtetë, apo Shpirtit. Atman, do të thotë “vete”, por shpesh përkthehet edhe si shpirt, apo “ego”. Fjala rrjedh nga indoevropianishtja “et- mer” frymë. Realiteti final i atman barazohet me potencialin e brendshëm, të lindur të çdo qenieje, për të ndryshuar dhe për të arritur në statusin final të Budës.

Në vepër, miti fillestar, ai i sjelljes së Doruntinës prej vëllait të vdekur, zbrazet nga kuptimi, merret si formë shënjuese për të shënuar një mit të ri, i cili është mit inicimi i heroit. “Kur bëhet formë, kuptimi e lë kontigjencën e tij pas, ai e zbraz vetveten, varfërohet, historia avullon, vetëm shkronjat mbeten. Regresioni nga kuptimi te forma, nga shenja gjuhësore te shënjesi mitik, ndodh në mënyrë të tillë që forma nuk e preson më kuptimin, ajo vetëm e varfëron atë dhe e vendos në distancë.

Forma fillestare e mitit të vjetër, mbushet me mitin e ri. Personazhet e mitit të ri, janë tre: Kostandini, Doruntina, Stresi. Forma e mitit, është ajo e monomitit të Campbell; heroit merr thirrjen, del nga bota e zakonshme (Kostandini del nga bota e vdekjes), hyn në zonat e dijes supreme dhe kthehet duke iu sjellë bashkëkohësve bekimin e besës.

Doruntina, merr thirrjen, nisat prej botës së zakonshme, në botën e çuditshme, kthehet në realitetin esëpërditshmes duke iu sjelle njerëzve vërtetimin e mbajtjes së fjalës së dhënë.

Udhëtimi i të dyve, përzien të dyja botët, realen dhe irealen, të gjallën dhe të vdekurën, sepse të dy nisen nga pikënisje të ndryshme; Konstadini nisat prej

vdekjes për të shkuar tek jeta, ndërsa Doruntina niset prej jetës për të shkuar tek vdekja.

Bashkimi i të dyve në një fluturim magjik, është bashkimi i heroit me figurën – nënë ose Perëndeshë – Natyrë (aludimi i dashurisë inçensore është aludimi i etjes së heroit për të zotëruar të mirat materiale dhe sensuale të jetës).

Bashkimi me Doruntinën është bashkimi me Nënë – Perëndi, e cila është zëri thirrës, qëi caktoi detyrën Kostandinit, është dhënësja e jetës dhe vetëqëndrimi final i heroit.

Bashkimi i Doruntinës me nënën, është bashkim simbolik idy gjysmave që përbëjnë një të tërë; jetën me tërësinë e ndjesive dhe rrethanave ekzistuese. Jeta, Natyra, Toka – Nënë apo Nëna – Perëndi; paraqitet në formë mallkimi mbi heroin që s’ka arritur përsosmërinë ideale.

Ai niset në udhëtimin e përsosmërisë, në formën e atman (vetes shpirtit) që shkon të takohet me arketipin femëror buddhi të aftësisë më të lartë inteligjente të njeriut.

Një figurë tjetër femërore mitike, që lidhet me simbolin e dijes është Eva. Ajo e shtyn Adamin në udhëtimin e tij të rebelimit ndaj porosisë së Zotit, duke ngrënë nga tërësia, e plota, një copë dhe duke e lënë pjesën tjetër të kafshuar.

Adami merr me vete atë pjesë të dijes, që s’e ka Eva.


Kështu, Doruntina, përfaqëson atë pjesë të dijes që s’e ka Kostandini, prandaj ajo krahasohet gjithmonë me dritën (edhe flokët e saj janë të verdha si drita e diellit) dhe me ngjyrën e bardhë.

Në të kundërt, Kostandini përshkruhet gjithmonë si i errët dhe me pluhur, i paqartë, i pa konturuar. Paqartësia dhe errësia e tij lidhen me subkoshiencën e cila kërkon rrugën për t’u bashkuar me dritën, me koshiencën. Stresi përfaqëson rrugëtimin e kundërt me rrugëtimin që bën Kostandini. Ai është bartës i dirtës dhe errësirës (zhguni i zi me brirët e bardhë të dhisë mbi të) është bashkëekzistenca e subkoshiencës dhe koshiencës, në qetësi të plotë, pa ndodhur tronditja, apo thirrja.

Stresi merr thirrjen prej ndihmësit, për të zgjidhur enigmën. Ai niset nga realiteti i tij i zakonshëm për të hyrë në zonat e vdekjes, ku operon Kostandini përplasat aty me tëdy me hijen, errësirën (Kostandinin) dhe dritën, të bardhën (Doruntinën). Ai merr prej të dyve, duke përcjellë tek tëdy njëherësh, elementët e kundërt, Kostandinit i përcjell të bardhën e Doruntinës (borës, brirëve të dhisë, eshtrave të kalit) dhe Doruntinës i përcjell të zezën e Kostandinit (nata e errët, sfondi i zi i vdekjes, zhguni i zi, kalorësi i pluhurosur).

Ai është veprimtaria e ndërgjegjshme e shpirtit, për të vënë në ndërlidhje, koshiencën me subkoshiencën, ai është ego-ja (ose “persona” sipas terminologjisë së Jungut).

Të gjitha variantet e sjelljes së Doruntinës, që krijon Kadare, krijojnë një shumësi projeksionesh të mitit të cilat mund të lexohen para – mbrapa, majtas – djathtas, djathtas - majtas, mbrapa – para.



Mënyra si mbivendosen këto kuptime tek njëri – tjetri, krijon shumëkuptimësinë e mitit, i cili në këtë mënyrë, në trajtën e një shumësie projeksionesh konverguese e diverguese. Që të gjithë sjellësit e mundshëm të Doruntinës, shpërblehen në udhëtimin e tyre të supozuar me ardhjen e saj. Vetë emir Doruntinë; e ka rrënjën e vetë “doron”, që do të thotë dhuratë.

Ata marrin si dhuratë bashkimin e shenjtë.

Qenia e Doruntinës larg, paraqitet si qenie e “Së bukurës së dheut”, që indentifikohet me të bukurën dhe të mirën, larg errësirës së vdekjes që paraqitet simbolikisht nga shtëpia e Vranajve.

Shtëpia e Vranajve (emir Vranaj fillon me V, vdekje dhe tingëllon njëllor me fjalën i vranët, i vrerët) është hapësira sakramentale e vdekjes, është qendra e saj, e cila për t’u shpirtëzuar dhe për t’u kthyer në hapësirë të shenjtë të jetës, ka nevojë për këtë sakrificë sublimë të sjelljes së Doruntinës.

Fakti që Doruntina ishte e martuar, i jep hapësirës në të cilën ndodhet Doruntina, pamje rrethuese, kufizuese, ndaluese. Ajo ndodhet prej hapësirës (djerrinave) dhe martesës (ajo s’lajmëron asnjëri, nga frika se mos e ndalojnë ; apo nga hipnotizimi total prej kalorësit që paraqitet si i vëllai).

Kapërcimi i hapësirës martesore dhe kthimi në gjini, në familje, për Doruntinën përbën herezi, kryengritje ndaj rregullave morale ekszistuese. Ajo vendos një rregull tëri, atë të dominimit të shpirtit prej ndjenjës dhe jo prej detyrës. Misioni i udhëtimit të Doruntinës, është të sjellë dashuri, prandaj figura e saj shoqërohet vazhdimisht nga dashuria (Stresi, i vëllai, i dashuri; të gjithë e duan Doruntinën.

Stresi dyzon tëdyja udhëtimet, atë të Kostandinit (në aludimet e vazhdueshme për ngjashmërinë e tyre, troku i kalit, nata, zhguni i zi) dhe udhëtimin e Doruntinës, në formën e të dashurit të Doruntinës.

Ai merr prej të dyve, prej Doruntinës dashurinë, lartësinë, prej Kostandinit guximin, burrrërinë, sakrificën. Ai i bashkon të gjitha elementet me virtytin e Besës, për t'iu dhuruar bashkëkohësve provat e udhëtimit tëdy heronjve, të cilët s'vijnë dot vetë, sepse janë të vdekur.

Stresi zhduket në “Udhën e madhe të Veriut” e cila fillon me V njëlloj si fjala “vdekje”. Udhë e madhe e Veriut është aludim simbolik për udhën e vdekjes, sepse shoqërohet nga shënjeshtet e zinxhirit semantik të Kostandinit: veri - vdekje – trok kali – leshra të pluhurosura – muzg.

Të tre heronjtë kthehen në realitetin e vdekjes, të tokës – Nënë, të fushës së paanë të errësirës.

Kjo është arsyeja, pse hapësira mbizotëruese e veprës, është hapësira e vdekjes, vazhdimisht e ngrirë e ftohtë dhe e errët. Në njëfarë kuptimi, ajo është hapësirë e shpirtit, ku subkoshienca bën udhëtimin e vet nga vdekja te jeta (Kostandini) koshienca udhëton nga jeta tek vdekja (Doruntina), ndërsa parallel me të dyja udhëton egoja (Stresi).

Hapësira e shpirtit është e paanë (fusha e pafund që shihte vazhdimisht Stresi) e patjetërsueshme (fusha thjesht errësohej apo zbardhej, ngrinte apo lagej nga shiu,por ishte aty, e palëvizshme).

Vdekja ndodhej brenda kësaj hapësire, në formën e një dijeje të errët, të kondësuar, si subkoshienca.

Jeta paraqitet në formën e dritës, bardhësisë së kalit të nusërisë; përsëritjes së dasmës së Doruntinës, duke krijuar kështu, një cikël të mbyllur.

Pejsazhi i zymtë dimëror dhe vjeshtor që mbizotëron te “Kush e solli Doruntiën”, luan rol organizues të cilësive të hapësirës, e cila do të jetë në gjëndje të mbajë pikëtakimin mes dy të kundërtave,mes jetës dhe vdekjes, të tregojë bashkëekzistencën e të dyjave, në të njëjtin cast kohor dheta bëjë të besueshme të gjithë këtë paraqitje.

Hajdeger, e shpjegon termin e ekzistencës nëpërmjet rrënjës së fjalës existere (ek sistere), që do të thotë të shfaqesh nga...

Pra, në fillim, ekzistenca është shkëputje; një shkëputje prej nga? Për Hajdegerin, kemi të bëjmë me një shkëutje nga e zakonshmja ; nga “marrëdhëniet e dobësisë” të lidhjeve midis mjeteve ose veglave me qëllimet e përdorimit të tyre, me përshtatjen tonë në botën që na rrethon.

Ekzistenca shkëputet nga marrëdhënia që pranohet vetiu dhe që na fsheh çështjen parësore të asaj që ekziston në mënyrë individuale.

Kështu, duke realizuar shkëputjen, ekzistenca lind për veten e saj mundësinë.

Për Hajdegerin, mundësia është një kategori vendimtare.

Ekzistenca është ajo që në vetvete ka mundësi për t'u realizuar. Kështu ai që ekziston, ka mundësi për t'u realizuar. Midis tyre thelbësore është mundësia për çdo cast dhe më së fundi; siguria për vdekjen. Ai që ekziston e zbulon qënien e tij si “qenie për vdekjen”.

“Kishin synuar drejt njëri – tjetrit, për t'u bashkuar në gjallje dhe në vdekje, në një jetëvdekje apo vdekjejetë të përzier. Qenë përpjekur të shkelinin ligjet, qëi mbanin të mbërthyera qëniet e gjalla, për të mos kaluar nga vdekja në jetë, pra ishin orvatur të thyenin ligjet e vdekjes, të arrinin të pamundurën, të bashkoheshin prapë; një çast kishin kujtuar se e kishin arritur atë, siç ndodh nëëndërr kur të besohet se ke takuar njeriun e dashur të vdekur, por y s'është veçse një gënjim i shkurtër, (nuk e përqafoja dot, diçka më pengonte) dhe nëpër terr e hutim qenë ndarë prapë; i gjalli kishte ecur drejt shtëpisë, i vdekuri drejt varrit të vet (ti ik përpara ,se unë kam pak punë në kishë; dhe pavarësisht se kjo s'kishte ndodhur, pavarësisht se Stresi s'e besonte kurrë ngritjen e të vdekurit nga varri; prapësëprapë; në njëfarë mënyre, kjo kishte ndodhur. Qe shfaqur te cepi i rrugës kalorësi – vëlla qëi kishte thënë motrës; eja me mua”. S'ka rëndësi vërtet, në mendimet e saj apo në mendimet e të tjerëve, sepse, në fund të fundit, kjo ishte një histori qëi kishte ndodhur pak a shumë gjithkujt, në çdo vend dhe në çdo kohë. Sepse për gjithkënd, gjithmonë ka pasur një njeri për të cilën është ëndërruar të vijë nga larg, nga trojet e tejjetshme, të rrijë një copë herë me të , të udhëtojë mbi të njëjtin kalë, sepse gjithkush në këtë botë ka pasur një peng të mbetur për dikë që nuk është në jetë dhe që me vete ka thënë; të kthehet edhe një herë, ta kap për qafe (por diçka më pengonte ta përqafoja), sepse kurrë kjo s'ndodh në këtë tokë dhe as që do të ndodhë kurrë , sa të jetë jeta, dhe ky është një nga pikëllimet më të mëdha të dheut, që do ta mbështjellë atë si mjegulla, gjer në shuarjen e tij...

Realiteti i vdekjes në vepër ështëi pranishëm në formën e Kostandinit dhe të vëllezërve të tjerë të vdekur dhe në formën e një realiteti të mundshëm, që kthehet në “qenie për vdekjen” për Doruntinën dhe nënën dhe Kostandinin. Ekzistenca e Kostandinit ështëshkëputje nga realiteti i vdekjes.

Nëpërmjet shkëputjes ai kthehet në “qenie në mundësi”. Tek ai lind mundësia për t'u kthyer nga bota e të vdekurve dhe të kryejë misionin qëi ka mbetur pa kryer, në botën e të gjallëve. Nga “qenie në mundësi” ai kthehet prapë në “qenie për vdekjen”.

Po kështu, Doruntina, shkëputet nga bota e saj e zakonshme, për të hyrë në zonën midis vdekjes dhe jetës. Ajo kthehet në “qenie në mundësi”, e realizon mundësinë e saj, udhëtimin me të vdekurin dhe kthehet në fund në “qenie për vdekjen”.

“Nëpërmjet kësaj shkëputje, ekzistuesi nuk zbulon veten në qenie e tij për vdekjen”, por në mënyrë të veçantë dhe në një kohë të përcaktuar. Kjo mënyrë, “për t'u ndodhur në...” luan rol të madh tek Hajdeger.

Ekzistuesi zbulon se ai ndodhet në botë (Hajdeger e quan këtë “qenie në botë”, gjithmonë në rrethana kohore dhe hapësinore krejt të veçanta, të cilat nuk gjejnë asnjë justifikim në dobinë e jetës së përditshme dhe që nuk kanë asnjë zgjidhje.

Rrethanat kohore dhe hapësinore në të cilat ndodhet Doruntina, janë krejt të huaja për të. Ajo shkëputet prej situatës së saj, për të hurë në situatën e mundësisë dhe të“

të qenit për vdekjen”. Kostandini shkëputet prej situatës së tij, kohës dhe hapësirës së vdekjes, për t’u kthyer në qenie, në mundësi dhe në “qenie për vdekjen”.

Tëdy kthehen në kohë – hapësirën e vdekjes, pasi rrethanat kohore dhe hapësinore, në të cilat ndodhen përpara se të ndërmarrin veprimin, nuk kanë asnjë zgjidhje. Në këtë mënyrë vdekja në vepër, paraqitet jo vetëm si mundësi potenciale e qenieve në ekzistencë, por dhe si pamundësi zgjedhjeje dhe realitet i vetem ekzistues.

Kjo e shpjegon peisazhin e zyrtë që mbizotëron, ku koha është vazhdimisht e ftohtë, e ngrirë, e lagësht, drurët dhe zoqtë janë të zinj, ftoma përshkon tej për tej fushën dhe e vetmja godinë që duhej të ishte symbol i jetës, për shkak të numrit të madh të djemve dhe nuseve me fëmijë që strehonte, nxin në mes të këtij peisazhi dhe kthehet në simbol të vdekjes.

Vdekja paraqitet si mundësi pa zgjedhje, si realitet i dhënë, tek i cili do hynë, në çaste kohore të ndryshëm, të gjithë njerëzit dhe prej të cilit s’do mund të dalë dot askush, për veçse dikujt me përmasat e heroit, që zgjedh të hyjë në një formë apo në një tjetër, në një realitet ku ekzistenca e tij si “qenie për vdekjen” e mban të rrethuar dhe të izoluar brenda një kohë – hapësire të veçantë, e cila është kohë – hapësirë shpirtërore, sepse vetë autori e mohon ngritjen e të vdekurit nga varri, duke e paraqitur udhëtimin e Kostandinit, si udhëtim që kishte ndodhur në mendjet e njerëzve.

Të vetmit elementë tëpatransformueshëm dhe të palëvizshëm, janë katër shokët e Kostandinit të cilët jetojnë në një hapësirë, ku nuk depërton errësira e të parës. Në këtë pikëpamje, ata janë simbole arketipalë jurgianë, që përfaqësojnë hijen, animus, anima dhe persona. Ata janë katër shfaqje të të njëjtit thelb, të përjetësisë së shpirtit në raport me virtytin moral, i cili shënohet nga “Besa”. Besa është simboli kryesor i veprës, e cila nuk shfaqet asnjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por vetëm si funksion veprimi dhe motor veprimi. Ajo është shtysa dhe energjia e saj, prandaj shokët e Kostandinit nuk preken nga errësira mbizotëruese e hapësirës në vepër, sepse, simbolikisht, ata qëndrojnë në anën e ndriçuar të shpirtit njerëzor, te jeta. Errësirën dhe dritën, i përmban Kostandini dhe Stresi, Kostandini sepse s’kishte mbajtur fjalën e dhënë dhe u ngrit nga varri për ta mbajtur, Stresi sepse udhëton për së dyti në të gjitha zonat ku kishte udhëtuar Kostandini dhe sjell fjalën e dhënë në formën e një realiteti material përpara dëgjuesve. Dritën e përmban vetëm Doruntina, e cila, nëpërmjet elementit të dritës, hyn në lidhje me hapësirën ku ekzistojnë katër shokët e Kostandinit dhe me retë e ankoruara në mes të qiellit. Ajo është e vërteta supreme, dija e tej jetës që ndodhet në kupolën më të lartë të qiellit, siç shprehet autori, Doruntina i përkiste më shumë horizontit, se sa njerëzve.

Bibliografia

Campbell, Joseph “The hero with a thousand Faces”. Princeton University Press 1968, fq 30

J.Campbell “Mythology and Personal Transformation fq, 132-133

J.Campbell, Pathways to bliss, Mythology and Personal Transformation, fq, 145-159

“Sunrise April\May 1999

R. Barthes “Mythologies” fq,73

Fjalori I emrave Vladimir Zoto, fq. 11

Habia filozofike, fq.286

Kush e solli Doruntinën fq.129

Habia filozofike, fq.287

THERRTORJA-PESE, NJË RRËFIM PASMODERN

MA. SIDITA HOXHIQ DANO

Departamenti i Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Përmbledhje

Në realitetin e ri pasmodern, gjithçka kishte ndryshuar, edhe narracioni kishte ndryshuar. Kjo është edhe ajo që përbën edhe veçantinë e romanit “Therrtorja-pesë” e shkrimtarit amerikan Kurt Vonnegut. Prandaj synimi i këtij punimi është të nxjerrë në pah teknikat e reja të rrëfimit pasmodern, që kristalizohen në këtë vepër. Studimi do të jetë kryesisht teorik, duke u mbështetur në analizën e kritikave të reja letrare pasmoderne që pasqyrohen në roman. Romani shfaq përqëndrim në subjekt, i cili e kthen rrëfimin e luftës brenda vetes. Në të njëjtën kohë, narratori shkëputet duke e gjendur veten në realitete fantastiko-shkencore. Kështu, romani kthehet në një çrregullim kohor dhe shumëdimensional i ndërgjegjes dhe botës së personazhit kryesor, Bill Pelegriinit. Prandaj, “Therrtorja-pesë” mund të cilësohet si një manifest i autorit për prozën pasmoderne, si dhe një pikëpamje sa reale, aq edhe e çuditshme e së vërtetës.

Fjalët çelës: *pasmodern, rrëfim, teknika, fantastikja*

Abstract

In the new postmodern reality, everything had changed, even narration. This is what makes “Slaughterhouse-Five” of Kurt Vonnegut, such a special novel. Thus, the aim of this study is to show the new techniques of postmodern narration that are reflected in this novel. My study has a theoretical character, basing mainly on the analysis of new postmodern literary criticism that is shown in this novel. It is very concentrated on the subject (plot), which makes the narration of the war turn into the novel. At the same time, the narrator is detached, going to realities of science-fiction. So, the novel is a total “mess” of time and multidimensional consciousness of the world of the protagonist. To conclude, “Slaughterhouse-Five” can be considered as a manifest of the author for the postmodern prose, as a real and strange point of view of the truth.

Key words: postmodern, narration, techniques, fantastic

HYRJE

Kurt Vonneguti është një ndër autorët më të njohur të viteve të fundit në letërsinë amerikane. Etiketimet për të kanë qenë të shumta, por ai e futi veten mes autorëve që lëvruan dhe mbështetën teknikat pasmoderne të kohës, sidomos me botimin e romanit të tij, në 1969 “Therrtorja-pesë”. Ky roman, mbështetur në përvojën e autorit në Luftën e Dytë Botërore, sjell me mjeshtëri dhe ndjeshmëri mizorinë e luftës. Lufta s’kishte ndryshuar vetëm autorin dhe rininë e atyre viteve, por ajo kishte hyrë thellë në romanin amerikan, e sidomos atë Vonnegutian. Prandaj, për të shfaqur këta mizori, duhej shpikur një rrëfim i ri dhe në ndihmë të autorit do të vinin

pikërisht ato që njihen si teknika pasmoderne. Megjithatë, pasmodernia për Vonegutin s'kishte të bënte vetëm me teknika, por edhe me atë që do ta mundonte gjithmonë, kërkimi dhe shfaqja e së vërtetës. Prandaj, ky punim mundohet të shfaqë veçoritë pasmoderne që romani "Therrtorja-pesë" mbart, veçanërisht në narracion.

1. Voneguti dhe arti i tij pasmodern

Më 11 prill 2007 ndërron jetë një prej autorëve më të njohur amerikanë të shekullit XX, Kurt Vonegut. Gjatë karrierës së tij si shkrimtar ai shkroi ese, drama dhe tregime. Por lexuesi e njeh më shumë si romancier. Romanet e tij u kthyen në simbol për studentët amerikanë të viteve '60 dhe '70. Ata mund t'i gjeje në xhepat e xhinseve apo në dhomat e konvikteve të studentëve amerikanë të atyre viteve. Ashtu si Mark Twini, Kurt Voneguti përdori humorin për t'u dhënë përgjigje disa nga pyetjeve që e shqetësonin atë si shkrimtar dhe shoqërinë amerikane në përgjithësi të atyre viteve. Në qendër të krijimtarisë së tij është interesi për çështjen e moçme të vullnetit të lirë dhe kuptimit të jetës e dashurisë. Përdorimi i figurave të Jonahut dhe Krishtit është një shfaqje e magjepsjes së tij se si mund të pajtohet fati njerëzor me vullnetin hyjnor. Megjithatë, jo të gjitha temat e Vonegutit janë metafizike. Me anë të elementeve fantastiko-shkencor, humorit të zi, teknikës pasmoderne, stilit të mprehtë dhe teknikave kinematografike, ai shkroi gjithashtu edhe për tema të ditës, të kulturës urbane amerikane.

Romanet e tij – 14 gjithsej – janë të ndërtuara nga një kompozicion i shkapërderdhur që e lejon autorin të futë në veprat e tij edhe parabola ironike, edhe parodi të ndërlikuara, edhe skica shpotitëse, që duket sikur nuk lidhen me temën kryesore. Shkrimtari, në pamje të parë, herë i jep krahë lojës së shfrenuar të fantazisë, herë e zvogëlon elementin fantastik dhe atë grotesk në minimum. Në krijimtarinë e tij nuk mungojnë jetë të krijuara në planete të tjerë, siç janë tralfamadorianët, apo banorët e planetit Merkur. Duke parë se si besimet e kohës nuk i jepnin shpresa për të marrë përgjigjet që ai kërkonte, ai krijon edhe një besim imagjinar, Bokononizmin, i cili bazohet në "të pavërtetat e padëmshme".

Momenti më domethënës në jetën e Vonegutit është përvoja e tij në qytetin gjerman të Dresdenit, si pjesëtar i ushtrisë së aleatëve, në 1945, gjatë Luftës së Dytë Botërore. I zënë rob nga gjermanët dhe i mbajtur në një thertore, e cila shërbente edhe si vendqëndrim për forcat ushtarake, ai bëhet dëshmitar i bombardimit të këtij qyteti nga forcat aleate. Me mijëra vetë vdiqën, dhjetra të tjerë ose u dogjën të gjallë, ose u asfiksuan dhe i gjithë qyteti u kthye në rrënojë. Në një intervistë, Voneguti shprehet kështu për bombardimin e Dresdenit: "Bombardimi i Dresdenit ishte një vepër arti. Ishte një kullë e lartë tymi dhe flake për të nderuar inatin dhe dhimbjen e mijëra njerëzve që ishin masakruar dhe vrarë nga ushtria gjermane" (Allen). Kjo përvojë shërbeu si bazë për romanin e tij të njohur "Therrtorja-pesë" ose "Kryqëzata e fëmijëve".

Ai është i njohur gjithashtu edhe për romanet "Djepi i maces", "Zoti ju bekoftë, z. Rozuoter", "Galapagos", "Pianoja automatike" etj.

Kritikë të ndryshëm e kanë quajtur me terma të ndryshëm gjatë karrierës së tij, si shkrimtar fantastiko-shkencor, humorist i zi, pasmodern. Por ai gjithmonë i ka kundërshtuar etiketimet. Megjithatë, vepra e tij më e njohur, “Therrtorja-pesë”, është edhe nyja që e lidh atë me shumë me pasmodernen.

Diskutimet për këtë term kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të shumta. Diskutimet fillojnë që nga përkufizimi i termit e deri te periudha. Studiuesit mendojnë se periudha që mund të quhet pasmodernizëm fillon nga fundi i shekullit XIX-të e deri në vitet '80, duke njohur si lulëzimin më të madh në vitet '60 e '70. Ajo që pranohet është se pasmodernizmi është një fenomen kulturor, i afërt me kulturën masive dhe pop-artin. Arti pasmodern merret me shumë me artin se sa me realitetin. Dhe për letërsinë pasmoderne, teksti është vetë arti. Letërsia pasmoderne ushqehet nga vetja dhe ka si objekt veten. Në këtë periudhë gjejmë shumë vepra letrare që kombinojnë fantastiken me forma të tjera të stilit të rrëfimit. Gjithashtu, hasim nocione të hipertekstualitetit, intertekstualitetit, intermedialitetit etj. Teknika të ndryshme si kolazhi, mozaiku, përzierja e zhanreve, shumëkuptimësia, shumëkohësia etj. i gjejmë të pranishme në shumë prej veprave. Lidhja mes shkrimtarit dhe autorit ndryshon deri aty sa pretendohet “vdekja e autorit”.

2. Therrtorja-pesë, si një manifest i narracionit pasmodern

Qëllimi i këtij punimi qëndron në kthimin e “Thertores-pesë” në një rrëfim pasmodern. Për 23 vjet me radhë Voneguti ishte përpjekur që të shkruante diçka për përvojën që kishte kaluar vetë si ushtar në Luftën e Dytë Botërore. Si shumë shkrimtarë të tjerë të brezit të tij, Voneguti e përjetoi kataklizmin e luftës në vitet e fundit të rinisë së tij, ku përvoja më e rëndë ishte vdekja e mijëra njerëzve në Dresden. Pa dyshim që ndikimi fizik dhe psikologjik i një holokausti të tillë kishte prekur edhe pikëpamjen e Voneguti për luftën dhe vdekjen. Ai dëshmon se i ishte dashur shumë që të kujtonte diçka dhe ta hidhte në letër. “E kisha harruar fare se si ndodhi bombardimi i Dresdenit, sepse s’e mbaja mend. Pyeta edhe disa shokë të luftës, por as ata s’e mbanin mend. Ata s’donin fare të flisnin fare për të. E kishin harruar se si ishte”. (Allen) I zhgënjyer nga lufta, nga sistemi, nga politika, sepse “s’kishte asgjë të mençur për të thënë për një masakër”, Voneguti vendos të shkaputet nga format dhe konvencionet e romanit modern, duke krijuar romanin e tij të famshëm pasmodern. Kjo vjen si rezultat i luftës së shkrimtarit për të gjetur një paradigmë të re në trajtimin e traumës së Dresdenit. Ai madje vendos të krijojë metoda metanarrative, duke vendosur kështu një lidhje të hapur me lexuesit dhe duke i lejuar të komunikojnë më lirshëm me njëri-tjetrin. Voneguti e përdor formën e re të të shkruarit dhe të rrëfyerit si një terapi dhe një protestë sociale.

Ai shprehet shumë qartë në roman për përpjekjet pafund për të shkruar rreth Dresdenit, duke krijuar fabulën më të mrekullueshme me lapsat me ngjyra të vajzës së tij, ku çdo ngjyrë përfaqësonte një pjesë të subjektit. Por për Vonegut, një libër për Dresdenin duhet të ishte më shumë se sa një rrëfim për atë që kishte parë. Në mënyrë që të shkruante për këtë traumë, në mënyrë që jeta e tij të merrte kuptim dhe të mos ndihej i pashpresë në një botë të pakuptimtë, ai krijon një planet imagjinar, i quajtur Talfamador. Protagonisti, Bill Pelegrini udhëton në kohë dhe në hapësirë,

duke vizituar shumë herë këtë planet dhe duke shkëmbyer dialogje me banorët e tij. Po pse duhej të shkonte Billi në Tralfamador? Ndoshta kjo ndodh sepse është pikërisht ajo që kërkon edhe vetë autori. Janë kufizimet në kohë dhe në hapësirë që e bëjnë të vështirë për shkrimtarin të përballët me traumën e Dresdenit, siç ia kërkojnë edhe konvencionet e rrëfimit tradicional. Në Tralfamador, romanet s'janë aspak të tillë. Në fakt, s'ngjajnë fare me romane. Banorët e këtij planeti i hedhin të gjitha mesazhet përnjëherë, sepse vetëm ashtu mund të marrin vërtet kuptim. Rrjedha e ashtuquajtur "logjike" e tokësorëve vë aq shumë kufi dhe barriera, sa e ngurtëson Billin dhe herë pas here ai arratiset në një botë tjetër – aty ku gjërat marrin kuptim. Ky lloj rrëfimi s'është aspak kronologjik. Rrëfimi kërcen në kohë dhe në hapësirë, ashtu si Billi. Kalimet nga njëra te tjetra, shpeshherë ndërpriten. Madje edhe fjalitë janë të shkurtra, si dhe struktura gramatikore është shumë e thjeshtë. Prandaj, romani tradicional me të cilin ishim mësuar deri në ato vite 'vdiq' dhe u rishpikën forma të reja.

"Therrtorja-pesë" është një histori brenda historisë. Në të vërtetë, i gjithë konteksti jepet në kapitullin e parë dhe në atë përmbyllës. Kapitulli i parë fillon me një lloj sigurie që na jep autori-narrator se "e gjitha kjo ka ndodhur", si një lloj garancie që na jepet për integritetin e një punimi mbushur me fantazi. Çdo lexues që lexon këtë fjali, që në fillim e rrit vigjilencën dhe ndryshon perspektivën. Por autori-narrator nuk na jep siguri aq të madhe që në çastin kur kjo frazë ndiqet me frazën "pak a shumë". Më pas autori-narrator na bën të ditur se cilat janë faktet e vërteta në roman. Po në faqen e parë të librit, ai thotë: "Njëri që njihja unë u vra vërtet në Dresden.. . Vetëm se kishte marrë një çajnik.. . Një tjetër kërcënoi vërtet se do të vriste armiq të e tij nga disa vrasës me pagesë.. . Unë shkova vërtet në Dresden me paratë e Gugenhaitit."

Voneguti i mbledh të gjitha këto copa dhe formon me to një kolazh interesant, gjë që është tipike për këtë roman. Megjithatë, këto janë vërtet copa thelbësore në historinë e tij. Në një narracion pak më konvencional vrasja e Billit nga një vrasës me pagesë i Pol Lazaros apo ekzekutimi i Ērl Derbit se mori një çajnik nga rrënojat e Dresdenit do të shërbenin si pika kulmore në roman dhe do të ndiqeshin nga një lloj zgjidhjeje dramatike. Por këtu Voneguti vendos të bëjë "humor". Ai i përmend aq shumë këto lloj vdekjesh në roman sa që bëhen motive të tij, siç është edhe shprehja tipike, sa herë që përmendet vdekja e dikujt – "S'ke ç'i bën" (So it goes). Kjo lloj përsëritjeje i bën ngjarjet aq të njohura për lexuesin sa duket sikur narratori po na tregon një histori që tashmë lexuesi e di. Këtë Voneguti e bën qëllimisht, pikërisht për të frenuar mosbesimin kur kemi të bëjmë edhe me elemente fantastiko-shkencore. Duke i bërë këto ngjarje të njohura para se të rrëfohen bën që të krijohet edhe një lloj kuptimi i kohës së romanit. Gjithçka që ndodh, ka ndodhur më përpara dhe do të ndodhë përsëri. Asgjë nuk ndodh, nuk ecën, por gjithçka kthehet prapa.

Pa një lloj rrjedhe lineare nuk krijohet kuptimi i historisë. Historia është e bazuar në perceptimin se një gjë ndjek tjetrën dhe pranohen lëvizjet nga e tashmja tek e shkuara. Tek "Therrtorja-pesë", rrëfimi jo-linear krijon përshtypjen se gjithçka na paraqitet që ta përjetojmë në një çast, se të gjitha çastet janë të njëkohshme dhe gjithçka ekziston jashtë perceptimit të kohës, që do të thotë se nuk ekziston. Kështu

është ndërtuar edhe planeti Tralfamador. Në mungesë të një sensi të kohës, ata mohojnë vdekjen, dhimbjen, humbjet. Vdekja s'është një çast kulmor, por thjesht një ngjarje mes shumë të tjerash. Vdekja s'është hallka e fundit e një zinxhiri të quajtur jetë. Duke qenë se e gjithë koha përjetohet në mënyrë të njëkohshme, asnjë çast në jetë s'është më i rëndësishëm se tjetri. S'ka asnjë dallim mes "tani" dhe "atëherë". Asnjëra prej këtyre s'ekziston.

Përballja që i bën Voneguti asaj që ndodhi në Dresden vjen në njëfarë mënyre edhe nga stili i tij. Ai është një stil i zhvilluar nga puna që ka bërë ai si gazetar dhe si reporter i policisë në Çikago. Është një stil rrëfimtar i thjeshtë, që i ngjan atij të Ernest Hemingueijt. Por që gjejmë shenja të theksuara cinizmi, distance, serioziteti dhe ironie. Gjithashtu s'mungon edhe ritmi i Mark Tueijnit që shpesh është hezitues dhe satirik. Ky lloj stili i lejon Vonegutit të na tregojë se gjithçka është e rëndësishme dhe asgjë s'ka rëndësi, si dhe për të treguar se duhet besuar në mirësinë e njeriut, sado absurde mund të duket hera herës.

"Therrtorja-pesë" s'është quajtur vetëm romani më i mirë i Vonegutit, por ishte dhe romani që i dha atij vendin mes shkrimtarëve më të mirë amerikanë të kohës. Duke qenë se në romanet e Vonegutit s'mungon elementi fantastiko-shkencor dhe duke qenë se kritikët e kohës e shikonin këtë si një letërsi të ulët, shkrimtari ka vuajtur shumë nga epiteti "shkrimtar fantastiko-shkencor". Elementet e tillë e lejonin atë të krijonte një realitet alternativ që drejtohej nga ligje të tjera, shumë ndryshe nga ata të Tokës. Nga ana strukturore, romani imiton shkëputjet dhe shumëdimensionet e mendjes së protagonistit, Bill Pelegrinit.

Kështu, Voneguti "e vdes" romanin e tij, sepse kështu kërkonte Amerika e viteve '60, për të cilën ai shkruan. Voneguti portretizon një komb që ka tradhtuar parimet themelore, si demokracinë, lirinë, drejtësinë dhe mundësitë e barabarta. Jo më kot, kur viziton mikun e tij, e shoqja Meri Oheir, i lutet që ai mos të shkruajë një roman, që pastaj të bëhet film me akte heroike e më pas të bëheshin prapë luftëra. Jo më kot, shprehja "S'ke ç'i bën" shkruhet në pankartat e studentëve që protestonin kundër luftës në Vietnam. Studiuesi Uilliam Rodni Alen shprehet se "pavarësisht rëndësisë së madhe që kishte Dresdeni në jetën dhe karrierën artistike të Vonegutit, ai iu ka rezistuar tundimit për ta dramatizuar atë më shumë seç duhet, apo ta ngrejë atë në apoteozën që i bën Heminguej Luftës së Dytë Botërore". (Allen)

Ndërsa studiuesi tjetër Piter Friz (Peter Freese), e quan *Thertoren-pesë* "një shembull të plotësuar që tregon sesi një ngjarje historike mund të kthehet në tekst imagjinar nga mjete dhe strategji të avancuara metanarrative". (Todd)

Kritikë të ndryshëm e kanë vlerësuar dhe analizuar në mënyra të ndryshme këtë vepër, por pa dyshim ata të gjithë bien dakord në një pikë: "Thertorja-pesë" shpalos mjaft mirë teknikat pasmoderne, që ndoshta edhe për kohën ishin avangarde. Humanizmi që vjen nga masakra dhe mizoria e luftës ngjall vetëm ndjenja dhembshurie dhe dashurie.

Bibliografia

Allen, William Rodney, *Understanding Kurt Vonnegut*. University of South California, 1991.

Bloom, Harold, *Kurt Vonnegut's Slaughterhouse-Five*. Infobase Publishing, 2009.

Hipkiss, Robert A., *The American Absurd: Pynchon, Vonnegut and Barth*. Port Washington, NY., National University Publications/Associated Faculty Press, 1984.

Klinkowitz, Jerome, *The Vonnegut Effect*. University of South Carolina Press, 2004.

Marvin, Thomas. *Kurt Vonnegut, A Critical Companion*. Greenwood Press, 2002.

May, John R., *Vonnegut's Humor and the Limits of Hope. The Critical Response to Kurt Vonnegut*. Greenwood Press, 1994.

Schatt, Stanley., *Kurt Vonnegut, Jr.* Boston: Twayne, 1976.

Scholes, Robert, *Kurt Vonnegut and Black Humor. Critical Essays on Kurt Vonnegut*. Robert Merrill. Boston: G. K. Hall, 1990.

Todd, Davis, *Kurt Vonnegut's Crusade: Or how a postmodern harlequin preached a new kind of humanism*. State University of New York, 2006.

QASJA TRAGJI-KOMIKE NË PROZËN E BERNARD MALAMUDIT

Shpëtim Madani, Shqiponjë Dautaj
Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu

Përmbledhje

Punimi përpiqet të hedhë dritë mbi qasjen tragjiko-komike në prozën e Bernard Malamudit (1914-1986), një nga shkrimtarët më të njohur hebreo-amerikanë të shekullit të kaluar. Megjithë tonin tragjik që ndjehet, sidomos në gjysmën e dytë të krijimtarisë së tij, vepra e Malamudit mbështetet fort mbi përdorimin e humorit si element qendror artistik dhe tematik. Në mënyrë të veçantë, komedia shërben për të neutralizuar efektin shkatërrues të forcave shoqërore kundër njeriut, si dhe të individit ndaj vetes, me qëllim përballimin më me lehtësi të absurditeteve të jetës. Artikulli e analizon qasjen tragji-komike duke u ndalur tek trajtimi i humorit hebraik dhe humorit të zi.

Fjalët çelës: Tragji-komikja, humori, humori hebraik, shlemili, humori i zi

Abstract

The paper tries to throw light on the tragicomic approach in the prose of Bernard Malamud (1914 - 1986), one of the major Jewish American writers of the last century. Despite the tragic tone adopted, especially during the second half of his writings, Malamud's works rely heavily on the use of humor, as a central artistic and thematic element. In particular, comedy serves to neutralize the destructive effect of social forces against man, and of the latter against himself, with the intention of more easily facing up to life's absurdities. The article analyzes the tragi-comic approach by centering on the Jewish humor and black humor.

Key words: Tragicomic, humor, Jewish humor, schlemiel, black humor

Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është fokusimi në vizionin tragji-komik të Bernard Malamudit, duke e konsideruar me rëndësi të veçantë artistike dhe tematike. Në këtë mënyrë, humori, i cili shërben si barrierë kundër dëshpërimit, shkrihet në mënyrë të natyrshme me sensin tragjik për jetën, i cili shihet si burim stabiliteti dhe sigurie. Risia e këtij punimi qëndron në faktin se qasja tragji-komike në veprën e Malamudit mbart ngjyrimet e dukshme të kulturës hebraike të Evropës Lindore, të cilat “transplantohen” dhe riinterpretohen në një kontekst amerikan dhe perëndimor.

Humori hebraik dhe humori i zi, si elemente përbërëse të qasjes tragji-komike, do të trajtohen veçanas – megjithë ngjashmëritë ekzistuese ndërmjet tyre – duke u ndalur në romanet kryesore të shkrimtarit.

1. Humori hebraik

Tragji-komedia, si zhanër letrar, i ka fillesat nga gjinia e dramës në Greqinë e Lashtë. Në atë kontekst, termi përdorej për t’iu referuar veprave që përfshinin

karaktere të “larta” dhe të “ulta”, përmes pranëvënies së perëndive dhe mbretërve me sklevërit dhe fshatarët. Një gjë e tillë shpesh kritikohej dhe shihej si eksperimentale apo dështim i dramës. Termi më vonë i referohej pjesëve teatrale që nuk përmbanin elementin e mjaftueshëm të vdekjes për t’u quajtur tragjedi, por që nuk mund të kategorizoheshin plotësisht as si komedi. Sidoqoftë, gjatë gjithë shekullit XX, tragji-komedia u popullarizua si gjini që i kombinonte të dy elementet në një mënyrë më të përmbledhur, përmes ngjarjeve që ndërthurin gëzimin dhe hidhërimin. Kjo lloj tragji-komodie synon të ilustrojë natyrën e dyfishtë të realitetit, brenda të cilit bashkëjetojnë dy ekstremet, shpesh brenda të njëjtit moment.

Pjesë e një dualiteti të tillë është edhe kultura hebraike, e cila karakterizohet nga vizioni i saj paradoksal, i shprehur më së miri në identitetin etnik të hebrenjve si populli i zgjedhur i Zotit, por edhe populli i shtypur në fshatin polak apo rus. Ndërkohë, pas emigrimit në Shtetet e Bashkuara, sidomos në shekullin XX, ndonëse jo një minoritet veçanërisht i rrezikuar në shoqërinë amerikane përgjithësisht tolerante, hebrenjtë shpesh shpalosin një vetëdije të dyfishtë, duke u joshur ndaj shoqërisë amerikane, nga njëra anë, por edhe duke u ndjerë të kërcënuar prej asimilimit, nga ana tjetër. Një konflikt i tillë pasqyrohet dhe në veprën e Malamudit, përmes humorit hebraik, i cili është ironik, i zymtë, skeptik dhe kritik. Një pjesë e mirë e humorit hebraik daton nga shekulli XIX dhe XX, kur edhe ndodhi shkëputja e madhe nga jeta tradicionale me vlerat e saj fetare dhe kulturore të rrënjësura thellë.

Nga shkrimtarët evropiano-lindorë të traditës popullore jidishe, Malamudi përshkruan në krijimtarinë e tij humorin e fortë hebraik. Humori hebraik nuk vjen nga feja e hebrenjve – Dhjata e Vjetër dhe Talmudi karakterizohen nga mungesa e humorit. Humori hebraik lidhet në fakt me gjendjen shoqërore të hebrenjve evropiano-lindorë që mbijetonin me vështirësi si minoritet brenda kulturës dominuese kristiane. Ndonëse krenarë, këta hebrenj ishin mëse të vetëdijshëm për statusin e tyre të ulët. Humori filloi të shihej si mënyrë për të ngushtuar hendekun ndërmjet aspiratave shpirtërore dhe situatës së tyre reale. Ndërsa zbehej besimi në Judaizëm dhe shtoheshin skepticizmi, u bë gjithnjë e më ironik kontrasti ndërmjet shpresës dhe realitetit. Ky bashkim i padëshiruar i rrethanave me besimin çoi në lindjen e figurës së *shlemilit*, budallait zemërmirë dhe në dukje komik që vazhdimisht e gjen belaja. Marifeti në veprimet e tij komike synon të na bindë se pafuqia e tij është në të vërtetë fuqi. Në thelb, figura e *Shlemilit* përcjell me besnikëri vizionin e dyfishtë hebraik mbi jetën. Simbol i mirësisë, ai është budallai në realitet. Si rezultat i çiltërsisë dhe sjelljes morale, ai shndërrohet në një viktimë të “kapur” në izolim total. Fatkeqësia është veçoria dalluese e tij, ndërsa dështimi është fati i tij. Ai është sintezë paradoksale e shpirtmadhësisë dhe fatit të keq.

Si teknikë ironike, humori hebraik krijon njëfarë vizioni të dyfishtë që shkrin në një shpresën dhe dëshpërimin; si mjet artistik, humori hebraik krijon situata sa komike aq edhe tragjike. Si perspektivë morale, ky lloj humori ndërthur vlerat e humanizmit me realitetin e hidhur të jetës së përditshme që duket absurde. Përdorimi nga Malamudi i humorit hebraik shërben për të kuptuar qëndrimin e tij ndaj ekzistencës njerëzore dhe teknikallitetit të tij si shkrimtar.

Romani “Shitësi”(1957), i cili shquhet për praninë e elementeve të kulturës hebraike, ka në qendër bakallin Moris Boberi, imigrant hebreo-rus në Amerikë, i cili ka më shumë se 20 vjet që është “ngujuar” në ushqimoren e tij që ngjan më tepër si burg, në pamundësi për ta gëzuar jetën siç duhet apo t’i sigurojë jetesën familjes së vet. Në këtë vepër vihet re përshtatja e materialeve popullore jidishë që ndërthuren me një ironi të nënkuptuar dhe disi absurdiste, me qëllim krijimin e një humori të hollë që njëkohësisht ngjall optimizëm dhe pesimizëm, shpresë dhe dëshpërim. Në këtë mënyrë, Moris Boberi është sa komik aq edhe tragjik. Humori përqendrohet në figurën e tij si shlemil. Ai i ngjan personazhit të folklorit jidish që rrëzohet nga dora e fatit, por që gjithmonë ngrihet në këmbë për ta provuar fatin prapë, me shpresën për më mirë por që pret më të keqen, vazhdimisht i vetëdijshëm për absurditetin e gjendjes së tij dhe veprimeve të tij në mungesë të fatit.

Morisi Boberi ecën në gjurmët e heronjve të përrallave jidishë që flasin me vete dhe ankohen me zë të lartë për vështirësitë e tyre në jetë. Fqinji i tij Karpi, pronari i dyqanit të mbushur plot me pije alkolike, ka frikë se po e grabisin, por është Morisi i varfër që grabitet. Tërësisht i vetëdijshëm për këtë gjë, ai mendon me vete: “Fund iu përshtat ditës. Ishte fati i tij; të tjerët kishin më shumë.” [30] Kur Morisi tundohet të paguajë një *maher* (jidish: *macher* - një njeri që di si t’i bëjë gjërat) për të marrë sigurimin, dyqani i Karpit digjet falas. “Çdo gjë për atë që ka.” [264] Gjatë gjithë romanit, ashtu si personazhi tipik i pafat i folklorit jidish, Morisi është arkitekti i paqëllimtë i fatkeqësisë së tij. Sa herë që përpiket të dalë nga vetëvetja – duke iu dorëzuar kërkesave të Ëndrrës Amerikane – ai vuan nga rezultati i kundërt, përherë i vetëdijshëm për kontrastin me efekt komik. Me rrënimin e Morisit, mëshiruar në paaftësinë dhe mosgatishmërinë për t’iu përshtatur një kulture gjithnjë e më oportuniste, na dëshmojnë triumfin e ëndrrës si ankth. Kujtimet që e ndjekin Morisin gjatë gjithë romanit nuk janë, për ironi, të parajsës amerikane, por të Evropës Lindore: “Jo, prej një kohe të gjatë nuk kishte jetuar një ditë përjashta. Kur ishte i ri, vraponte gjithmonë në rrugët me baltë të fshatit ose përgjatë fushave, apo duke u larë me djemtë e tjerë në lumë; por si i rritur në Amerikë, ai rrallë e kishte parë qiellin. Në kohët e mëparshme, kur punonte me kalë dhe karrocë, po, por jo prej dyqanit të tij të parë. Në dyqan, ishe i burgosur. [4]

Pra, Morisi është një viktimë e mashtruar nga të gjithë – jeta, miqtë, fqinjët dhe blerësit. Përpara fillimit të ngjarjeve në roman, ai është mashtruar keq nga një njeri që e besonte si ortakun e tij; jeta i është nxirë nga “miku” i tij Karpi, i cili e përqesh për paaftësi; çdo ditë ngrihet në pikë të mëngjesit për t’i shitur simiten tricentëshe një grua të moshuar polake, por që shpërblehet vetëm me antisemitizmin e saj të hapur; gruaja e tij, ia “ha” shpirtin për bujarinë e tij të pavend; e bija, gjithashtu, e përbuz për karakterin e tij të ndershëm në një botë të egër dhe mosmirënjohëse. Me një fjalë, Morisi është budalla, shlemil në sytë e të gjithëve.

Zymtësia kapluese që krijohet në dyqanin e errët “zbutet” nga prania e episodeve komike. Në mënyrë të dukshme, është rasti kur një natë, një njeri thatim, i veshur keq, me mjekër të hollë të kuqe i shfaqet Morisit përpara banakut dhe i ofron atij zgjidhjen e të gjitha problemeve, siç ilustron në dialogun e mëposhtëm:

- A gut shabos [*jidish: Kalofsh një të shtunë të këndshme*], tha dordoleci.

- A gut shabos, ia ktheu Morisi, megjithëse e shtuna ishte një ditë larg.
- Bie erë këtu, tha i huaji thatim, me sytë e vegjël të mprehtë, si një varr i hapur.
- Nuk po ecën biznesi.

Burri lagu buzët e tij dhe përshpëriti, “Ke sigurim – sigurim ndaj zjarrit?”

Morisi u frikësua, “Çfarë pune bën?”... .

- Një njeri i zgjuar dëgjon një fjalë, por kupton dy. Sa është sigurimi yt?
- Dy mijë për dyqanin.
- Bah.
- Pesë mijë për shtëpinë.
- Turp. Duhet të jenë dhjetë.
- Kujt i duhen dhjetë për këtë shtëpi.
- Askush s’e di.
- Çfarë dëshiron këtu, pyeti Morisi, i irrituar.

Burri fërkoj duart e tij të thata, me qime të kuqe, “Çfarë dëshiron një *maheri*?”

- Çfarë lloj *maheri*? Çfarë bën?

Ai rrudhi shpatullat me dinakëri... . Unë bëj zjarre... . Magji... . Pa hi. [255]

Morisi e dëbon këtë të dërguar të djallit, por më vonë bie pre e tundimit dhe përpiqet ta ekzekutojë vetë planin, i cili shoqërohet me efekte komike. Duke shkuar fshehurazi në bodrum në mes të natës, ai i fut negativët e disa fotografive të vjetra brenda një të çare ndërmjet dy dërrasave. Me dorën që i dridhet dhe duke i dhënë guxim vetes, Morisi i vë flakën celuloidit dhe shikon, si në ekstazë, flakët që ngjiten përpjetë murit. I tmerruar papritmas nga ajo që po bënte, përpiqet t’i shuajë ato. Duke e parë që fundi i përparësës i ka marrë flakë, “ai goditi flakët me të dyja duart dhe pastaj mëngët e trikos filluan t’i flakëronin. Rënkoj për mëshirën e Zotit dhe menjëherë u kap nga mbrapa dhe u vërvit përdhe. ” [258] Në këtë moment, sipas mënyrës magjike të Malamudit, komikja fillon t’i lërë vendin tragjikes.

Nga pikëpamja gjuhësore, dialogu ndërmjet Morisit dhe zjarrvënësit është mjaft dramatik dhe ka karakter tragji-komik, përmes pranëvënies së bakallit të dëshpëruar dhe maherit komik. Nga njëra anë, kemi Morisin që ka frikë nga propozimi i tjetrit, duke iu përgjigjur pyetjeve të tij po me pyetje (“Çfarë pune bën?”, “Çfarë lloj *maheri*? Çfarë bën?”), ndërsa, nga ana tjetër, të shprehurit e zjarrvënësit me një mençuri lakonike (“Një njeri i zgjuar dëgjon një fjalë, por kupton dy. ”, “Bah”, “Turp. Duhet të jenë dhjetë. ”, si dhe “Unë bëj zjarre... . Magji... . Pa hi. ”) përcjell forcën imponuese për t’i ardhur patjetër në “ndihmë” një bakalli të shkretë, i cili duke mos qenë në gjendje të çajë në shoqërinë e egër kapitaliste amerikane, mjaftohet duke shqiptuar fjalët “Nuk po ecën biznesi”.

Në pranverë, Morisi vdes në spital, pas qëndrimit jashtë për të hequr borën – ndërkohë që e shoqja me të drejtë i thotë: “ Prit, nesër do të shkrihet. ” [266] – që ka penguar kalimin, në një ditë të pazakontë fillim prilli, të krishterëve që shkojnë në

kishë të dielën. Vdes duke shqiptuar fjalët: “ E dhashë jetën time për asgjë. Kjo ishte e vërteta ogurzezë. ” [273] Pas elozhesë që i bëhet Morisit në funeral, Helena shprehet se “ai e shndërroi veten në viktimë. ” [278] Megjithëse ajo me fjalën “viktimë” nënkupton pamundësinë e Morisit për të mbijetuar, është pikërisht kjo sakrificë e Morisit që e shndërron në një model të mirëfilltë të sjelljes morale. Ai bëri mirë dhe e dha jetën në shërbim të të tjerëve, ndonëse mirësia e tij nuk kuptohet asnjëherë siç duhet prej tyre.

Zëdhënës i fuqishëm i etikës hebraike, shlemili është figura e duhur për ta konkretizuar lëndën letrare të autorit. Ai [shlemili] është heroi i përlulur që duron sprovat e jetës, duke mbajtur barrën e ekzistencës së tij dhe duke luftuar për mbijetesë. Është heroi që përpiket moralisht të rigjejë vetveten. Kjo ide gjen shprehjen e duhur në romanin “Portretet e Fidelmanit: Një Ekspozitë” (1969), i cili duke ndërthurur dy nënzhane: pikareskun dhe bildungsromanin, përshkohet i tëri nga një ton tragji-komik që lidhet me aventurat e shlemilit hebreo – amerikan, të quajtur Fidelman, në Itali.

Nëse e ndjekim heroin tonë shlemil në tregime të ndryshme, atëherë mund ta shohim në një prizëm: shumë refleksione të ndryshme. Gjashtë tregimet janë gjashtë episode apo tablo, të cilat të marra së bashku formojnë një portret.

Tabloja e parë realizohet në Romë. Djaloshi Fidelman, pseudo-kritiku i artit, ka shkruar kapitullin e parë të librit të tij mbi piktorin Xhoto, përfaqësues humanist i Rilindjes Italiane. Dorëshkrimin ia vjedh Suskindi, një tjetër emigrant hebreu që jeton kryesisht duke lypur apo duke shitur objekte të ndryshme fetare. Si pasojë, Fidelmani, nga i përndjekur kthehet në ndjekës të Suskindit nëpër lagje të ndryshme të qytetit. Më në fund, e gjen duke ia djegur faqen e fundit të punimit, duke i thënë se i kishte bërë nder, pasi “fjalët ishin aty, por shpirti mungonte. ” [37]

Ngjarjet e tablosë së dytë, “Jetë e vdekur”, vendosen po në Romë. Në vend të Suskindit të bezdisshëm, Fidelmani ka Anamarinë – një piktoresh neurotike mjaft e dobët artistikisht. Ai merr me qira një pjesë të studios së saj dhe të dy pikturojnë bashkë. Por Fidelmani kalon më shumë kohë në ndjekje të Anamarisë sesa të artit të tij. Ajo çfarë pason është një sërë aventurash eksentrike. Që t’i bëjë qejfin asaj, ai eksperimenton me disa ndryshime që sugjeron Anamaria: “vrime spontane, për shembull, disa rishikime të ‘Trajtave Ngritëse’, si dhe dy elemente lirike abstrakte ekspresioniste bazuar në Yllin e Davidit, të ndërthurura me të dhe në fund duke e fshehur atë. ” [40] Megjithatë, përpjekjet e tij sjellin përbuzjen e vazhdueshme të Anamarisë, në vend të vullnetit të saj të mirë. Është e natyrshme se në tregimet e Malamudit, fshehja e identitetit hebraik – në këtë rast i përfaqësuar nga Ylli i Davidit – sjell dështim në dashuri. Ai e mallkon fatin e tij të keq: “Ujë, kudo ujë që derdhet me curril, që rrjedh dhe pikon, përshpëritje sekrete, dashuri, dashuri, dashuri, por jo për të. Nëse Roma është kaq erotike, ku ishte seksi për të? Roma joRomë e Fidelmanit. Ajo u përkiste më pak atyre që e donin më shumë. ” [42-43]

Fidelmani, më në fund, e ngushëllon veten duke e pikturuar, për ironi, Anamarinë pa leje, si “Virgjëresha me fëmijën”. Ai ndjen njëfarë zotërimi indirekt me këtë akt. Sidoqoftë, kjo i siguron pëlqimin e saj. Ajo i thotë “Ti ma ke parë shpirtin” dhe bie në dashuri me të.

Raporti intim i Fidelmanit dhe Anamarisë vonohet në mënyrë qesharake, për shkak të pengesave të shpeshta që ndeshen zakonisht në prozën e Malamudit. Edhe pas dështimit të tij në dashuri, Fidelmani nuk ndalon së vardisuri Anamarisë. Përulet edhe më tej, duke i kryer asaj edhe shërbimet më të neveritshme. Ftesa e saj në një festë e lumturon Fidelmanin e dëshpëruar. Kur Anamaria dhe Balduçi futen në garë për të piktuar një mashkull lakuriq, Fidelmani pranon menjëherë të bëhet modeli, me shpresën se do të zgjonte interesin e saj. Por shpresat e tij shemben. Anamaria dëshiron të flejë me Balduçin dhe e urdhëron Fidelmanin t'i zhduket nga sytë.

Fidelmani arrin ta shtjerë në dorë, krejt papritmas, duke u veshur si prift. Në këtë maskim, ai përpiket të krijojë një autoportret “të artistit si prift.” Kjo sjell rëfimin e menjëhershëm të Anamarisë:

- Më fal, At, se kam bërë mëkate.. .

Me furçën që i pikonte në duar, ai i hodhi një vështrim të habitur.

- Të lutem, unë. ..

- Oh, At, po ta dinit se çfarë kam bërë. Kam qenë kurvë.. . [51]

Pesha e fajit të Anamarisë është kaq e rëndë, sa që ajo nuk arrin të dallojë Fidelmanin e veshur si prift. Ai e shfrytëzon rastin dhe i shpreh gatishtërinë për t'ia falur mëkatet. Anamaria i rrëfen inçestin me xhaxhain e saj, Auguston. Fidelmani i thotë se e ka falur. Por ajo ngul këmbë tek pendesa. Ai i kërkon të shqiptojë emrin e Atit dhe Marisë, por Anamaria nuk ndihet e kënaqur. “Më shumë”, qante Anamaria. “Më shumë, më shumë. Shumë më shumë.” [51] Atëhere, Fidelmani përfiton nga ndërgjegja e vrarë e saj për të shuar epshin e tij. Ai i thotë të zhvishet dhe bën seks, duke e mbërthyer pas kryqit të saj. Imazhi është një shkrim tronditës e kryqëzimit dhe rënies në mëkat. Akti, në asnjë mënyrë, nuk tregon dashurinë e singhtë të tyre. Siç ka vërejtur me të drejtë Barbara F. Lefkovitsi: “... larg të qenët një akt i singhtë ndërmjet dy qënieve njerëzore apo një lidhje e vërtetë ndërmjet vetes dhe tjetrit, seksi shndërrohet në parodi të kryqëzimit, ndërsa “Dashuria” e Fidelmanit për Anamarinë kthehet thjesht në një shkëmbim fantazish neurotike të një natyre sado-mazokiste.” [Cit. në Rajagopalachari 135]

Në tablonë e tretë, “Nudoja lakuriq”, skena zhvendoset në Milano. Këtu Fidelmani është një artist pa një dyshkë, hajdut i vogël, derisa kapet peng nga dy krijesa mafioze (Anxhelo dhe Skarpio) të cilët e detyrojnë të bëjë punë të rënda në një bordello milaneze. Gangsterët thurin planin për të vjedhur një nudo të Ticiano Veçelios dhe ta zëvendësojnë me një kopje të falsifikuar të Fidelmanit. Ky i fundit duhet të bëjë falsifikimin dhe vjedhjen, nëse dëshiron të lihet i lirë. Ai e bën një gjë të tillë, por gjatë punës bie në dashuri me veprën e tij, të cilën e vjedh dhe ia mbath. Përpara fundit, antiheroi përjeton poshtërimin e pritshëm që i rezervohet një *shlemili* të mirëfilltë. I rrahur nga kapësit e tij dhe i ngacmuar nga lubitë e shtëpisë publike, Fidelmani nuk mund të përqendrohet në pikturën që duhet të kopjojë. Ai ka nevojë për një model të gjallë. I dëshpëruar dhe në prag të panikut, sepse koha po kalon kaq shpejt, ai mendon për Terezën, pastruesen e hotelit. Ajo është një përfaqësuese e dobët e bukurisë femërore, por imagjinata mund të ngrejë çdo gjë. Fidelmani i kërkon të pozojë për të dhe Tereza, pas një të qeshure të ndrojtur, pranon. Por në

vend që ta pikturojë atë, Fidelmani e bind që të bëjnë dashuri bashkë. Një gjë e tillë zbulohet nga Anxhelo, i cili e ndëshkon Fidelmanin duke e detyruar të lajë nevojtoret për pjesën e mbetur të ditës. Fidelmani e përfundon pikturën dhe synon ta vjedhë për vete origjinalin. Por në mision shoqërohet nga Skarpio. Në momentin e vjedhjes së pikturës, ai ndërron mendje dhe vjedh krijimin e vet dhe jo atë të Ticianit. I mashtron konspiratorët dhe ia mbath me veprën e vet. Një veprim të tillë Lefkovitsi e quan një “Akt pseudomoral, i cili fsheh qëllimin e mirëfilltë narcist të Fidelmanit.” [Cit. në Rajagopalachari 138] Megjithëse piktura përfaqëson “veten e idealizuar”, përpjekja e Fidelmanit për t’i tradhëtuar konspiratorët, gjatë vjedhjes së origjinalit, e zbeh narcizmin e tij.

Vendi i ngjarjeve për tablonë e katërt, “Hakmarrja e kodoshit”, është Firenze. Fillimisht, Fidelmani skalit Madona me cilësi të dobët, të cilat i shet për hiçgjë, në mënyrë që të pikturojë kryeveprën e tij. Një ditë takon dhe merr si dashnore Esmeraldën prostitutë. Ndërkohë, Fidelmani lufton me pikturën e tij të madhe. Në fillim e ideon dhe e quan “*Nëna dhe i biri*”, pastaj “*Vëllai dhe motra*” dhe në fund “*Prostituta dhe kodoshi*” – nga e cila heq dorë, për t’i gjetur klientë Esmeraldës. Përfundimisht, ai e mbaron pikturën, të cilën ai dhe Esmeralda e konsiderojnë një kryevepër. Por Fidelmani (ose “F”, siç thirret në këtë tablo) nuk e lë dot pa e trazuar dhe prish atë që përbënte kulmin e pesë viteve punë të mundimshme.

Në tablonë e pestë, “*Portreti i artisti*”, Fidelmani është endacak. Ai lëviz nëpër Itali si në një kaleidoskop. Gjithçka paraqitet episodike dhe e fragmentuar. Një mozaik psikodelik. Fidelmani këtu merr rolin e skulptorit, duke realizuar vrma në tokë, të cilat përpiqet t’i ekspozojë si art modern kundrejt një pagese. Sipas modelit të *shlemilit*, Suskindi e godet me lopatë dhe pasi e hedh në gropë e mbulon me dhe, duke krijuar një varr. “Pra, tani kemi formë, por kemi edhe përmbajtje.” [160]

Tabloja e fundit, “*Qelqfryrësi i Venecias*”, realizohet në Venecia. Këtu Fidelmani heq dorë përfundimisht nga piktura dhe jeton duke bërë punë prej shërbëtori. Pastaj, një ditë i vardiset Margaritës, gruas së Bepos, i cili është fryrës qelqi. Natyrisht, Bepo zbulon tradhtinë e saj me Fidelmanin. Por gjithçka përfundon mirë, pasi fryrësi i qelqit rezulton të jetë homoseksual, i cili e merr në punë Fidelmanin si çirak dhe të dashur.

Bepo i mëson Fidelmanit zanatin dhe e udhëzon në lidhje me artin, dashurinë dhe jetën. Ai i shkatërron të gjitha pikturat e Fidelmanit, sepse janë shumë të këqija. “Mos e ço dëm jetën tënde duke bërë atë çka nuk mund të bësh. .. Nëse këndesi nuk ka kënduar për njëzetë vjet, duhet ditur se është pulë.” [198] Dhe përfundimisht është Bepo që e udhëheq drejt së ardhmes – “Nëse nuk mund të bësh art, atëherë jeto jetën.” [199] Fidelmani ia kthen Bepon gruas së tij dhe fabula përfundon me fjalët: “Fidelmani lundroi nga Venecia në një anije mallrash” dhe se “në Amerikë ai punoi si esnaf dhe dashuroi burrat dhe gratë.” [208] Në këtë mënyrë, artisti si shlemil përfundon udhëtimin e tij, heq dorë nga ambiciet artistike dhe kthehet në shtëpi. Ndonëse duket se ka humbur shumë, Fidelmani është gjithsesi fitimtar, pasi përfundimisht arrin të çlirohet nga vetvetja për të fituar lirinë e nevojshme dhe kuptimin e jetës jashtë artit.

2. Humori i zi

Shoqëria amerikane e pasluftës së Dytë Botërore ishte bërë kaq e strukturuar dhe e planifikuar, saqë një rregullsi e tillë filloi të dukej e çuditshme dhe e frikshme. Nga ana tjetër, dy superfuqitë – Shtetet e Bashkuara dhe Ish-Bashkimi Sovjetik – propagandonin siguri përmes arsenalit bërthamor, por nga ana tjetër ishte e qartë se Lufta e Ftohtë në vetvete varej si shpata e Demokleut mbi gjithë njerëzimin. Zhvillime të tilla iracionale sollën natyrshëm lindjen e një humori të zi, i cili i trajtonte temat dhe ngjarjet serioze si: vdekja, lufta, krimi, racizmi, shovinizmi, abuzimi etj., me humor dhe satirë, duke ruajtur ndërkohë seriozitetin e tyre. Si rezultat, synimi i humorit apo komedisë së zezë është të përcjellë tek lexuesi ndjesinë e qeshjes dhe të tensionit njëkohësisht. Humori i zi është vala e parë e letërsisë postmoderne dhe fillon të ndjehet në fundin e viteve '50, duke ruajtur ndjeshëm terrenin edhe gjatë viteve '60 dhe '70 të shekullit të kaluar.

Në romanin “Riparuesi” (1967) humori i zi lidhet me politikën antisemite të Rusisë së Pararevolucionit kundër popullit hebre. Fabula ka në qendër hebreun 30-vjeçar Jakov Boku, i cili lë shtetin ukrainas ku jeton për të kërkuar një jetë më të mirë në Kiev. Pas disa muajsh qëndrimi aty nën emër të remë, akuzohet dhe burgoset me të padrejtë për vrasjen e një fëmije 12-vjeçar rus, Zhenias. Me provën kryesore e “të qenët hebre”, Jakovi lihet për më shumë se 2 vjet në burg, me shpresën se do pranonte krimin e tij ose do kryente vetëvrasje; apo do komprometonte hebrenjtë e tjerë a do të pranonte të lirohej si kriminel i falur. Ai nuk pranon të bëjë asnjërin prej tyre, duke i shpëtuar, në këtë mënyrë, hebrenjtë rusë nga një tjetër fushatë spastrimi e qeverisë.

Vrasja në fjalë merr ngjyrimë fetare dhe për të akuzohen menjëherë hebrenjtë, të cilët sipas autoriteteve e kanë përdorur gjakun e fëmijës për të përgatitur bukë të ndorme për Pashkët e hebrenjve. Ndonëse akuza i duket qesharake Jakovit, ai frikësohet pa masë, ngaqë edhe sepse trupi i pajetë është gjetur afër vendit të tij të punës, në një zonë të ndaluar për hebrenjtë. Tipike për një shlemil, Jakovi fillimisht kujton se do t’ia hedhë lehtë, se duhet të ndëshkohet vetëm për falsifikim të identitetit të tij dhe me të drejtë pyet: “Për mëkatin tim të vogël pse duhet të akuzohem për një të madh?” [78] Ndërkohë, pas disa muajve, ai e kupton se “.. ishte vetëm komploti i tyre kundër një hebreu, çdo hebreu; ai ishte zgjedhje rastësore për sakrificën. .. Të lindësh hebre, do të thotë të ishe i cënuar nga historia, duke përfshirë gabimet e saj më të këqija”. [141]

Ndërkohë, gjatë qëndrimit në burg, protagonisti helmohet nga rojet e burgut që ta paraqesin si vetëvrasje nga turpi për veprën e vrasjes rituale, çka do t’i jepte të drejtë Grubeshovit, prokurorit famëkeq. Po ashtu, ky i fundit përpiqet ta frikësojë duke i thënë se vetë cari është në dijeni të çështjes së tij dhe e konsideron atë fajtor. Për ta vërtetuar këtë, prokurori i tregon riparuesit copa gazetash që lidhen me të. “Madhëria e tij ka shprehur bindjen e tij se krimi ishte vepër e ulët e një hebreu i cili duhet dënuar për aktin barbar.” [202] Pra, në mënyrë mjaft groteske, i gjithë aparati shtetëror mobilizohet kundër një njeriu të thjeshtë dhe të pafajshëm, i cili mbrohet duke thënë “Nuk jam revolucionar. Jam njeri i parrahur me jetën.. Jam riparues.” [205]

Pikë kulminante e humorit të zi në vepër është supersticioni mesjetar dhe mendimi i gabuar i rusëve se meshkujt hebrenj menstruojnë:

Ditët po kalonin dhe zyrtarët rusë po prisnin me padurim që atij t'i fillonin menstruacionet. Grubeshovi dhe gjenerali i ushtrisë herë pas here i hidhnin një sy kalendarit. Nëse nuk i vinin shpejt, ata kërcënonin se do pomponin gjak nga penisi i tij me një aparat që e përdornin për atë qëllim. Aparati ishte një pompë prej hekuri, i pajisur me indikator të kuq për të treguar se sa gjak nxirrej. Rreziku qëndronte në faktin se nuk funksiononte gjithmonë mirë dhe ndonjëherë shteronte çdo pikë gjaku nga trupi. Aparati përdorej vetëm tek hebrenjtë; përshtatej vetëm në organin e tyre. [123]

Jakovi, përfundimisht ngrihet kundër çdo lloj iracionaliteti të tillë dhe triumfon duke e vrarë – në mënyrë simbolike dhe në ëndërr – carin dhe t nga Jakovi dhe organizimin e një gjyqi publik, i cili është dhe shpresa e vetme e Bokut dhe e gjithë njerëzve.

Në romanin “Mirësia e Zotit” (1982), humori i zi lidhet me përpjekjet absurde të njeriut për ta krijuar njerëzimin nga e para, tashmë me një grup primatësh. Fabula ka në fokus paleontologun Calvin Koni, i cili është njeriu i vetëm i mbijetuar i katastrofës nukleare. Në një ishull alla Robinson Kruzo, Koni fillon misionin e tij të shenjtë të rikrijimit të qytetërimit me disa shimpaze dhe gorilla, duke iu mësuar etikë, kulturë dhe shkencë. Ndërkohë, debaton me Zotin dhe e fajëson atë që lejoi një përmbytje të dytë, pas asaj së Noes. Ndërkohë, i Plotfuqishmi e shpall njeriun fajtor për katastrofën nukleare:

Shkatërrimi aktual, i cili përfundon në tym dhe pluhur, vjen si pasojë e tradhtimit të vetvetes nga njeriu.. . Duke patur shkatërruar veprën time.. . ajrin e ëmbël.. . ujin e pastër, ozonin dhe oksigjenin [të nevojshëm] për mbijetesën e tyre, ata kanë fyer kozmosin tim.. . Unë e bëra njeriun të ishte i lirë.. . Përmbytjen e dytë e shkaktuan vetë. Ata nuk kanë jetuar sipas Marrëveshjes. [5]

Në roman bëhet e qartë se Koni i është mirënjohës Zotit që ia kurseu jetën – ndonëse mbetja e tij gjallë ishte më tepër një gabim. Që të vazhdojë të jetojë, Koni beson duhet të fitojë dashamirësinë e Zotit, dhe se një mënyrë e mirë për ta bërë këtë mund të ishte krijimi i një komuniteti social të civilizuar në ishull. Në këtë mënyrë, përpjekjet e Konit për të rikrijuar ndërmjet shimpazeve më të mirën e shoqërisë njerëzore lidhet sa me vetëmbijetesën aq edhe me altruizmin. Lidhja e tij me Zotin është më tepër intelektuale sesa shpirtërore.

Shoqëria që Koni dëshiron të themelojë është një shoqëri vegjetariane, e dashur me të gjithë, që e ndan ushqimin në mënyrë të barabartë dhe që u jep vlerë të gjitha qenieve të gjalla. Fatkeqësisht natyra e kafshëve dhe ajo njerëzore nuk e lejojnë përmbushjen e këtij ideali. Pyetjes së Bazit – shimpazeja që ka shpëtuar në anijen e Konit dhe me të cilën krijohet një lidhje e ngjashme baba-bir – se ç’do të thotë të jesh ‘njeri’, Koni i përgjigjet në mënyrë madhështore: “.. . të jesh njeri do të thotë të tregohesh i ndjeshëm dhe të mbrosh jetën dhe civilizimin. Bazi tha që do preferonte të ishte shimpaze. ” [70] Në këtë kontekst, Malamudi akuzon qytetërimin modern

për shkatërrimin e vlerave primitive. Si i mbijetuari i vetëm, Koni duhet të përpiqet t'i kuptojë gabimet e njeriut dhe jo t'i përsëritë ato.

Ç'është më e keqja, i mbijetuari i vetëm i njerëzimit, Koni, merr kontrollin e plotë të "qytetërimit" të ri dhe shkakton holokaustin përfundimtar, duke dhunuar rendin natyror. Duke u mësuar primatëve gjuhën, por jo komunikimin, ai krijon hapësira për rebelim; duke u çiftuar me një shimpaze që duket si njeri, Koni nxit zilinë dhe rivalitetin e kafshëve të tjera, gjë që finalizohet me vrasjen e tij nga Bazi, një inversion biblik ky i *Akedah*, i quajtur edhe *Lidhja e Isaut*. Vetëm Xhorxhi, gorilla gjigande, duket se i ka përvetësuar mësimet morale të Konit, duke refuzur të marrë pjesë në kasaphanë, si dhe duke vajtuar vdekjen sakrifikuese të Konit dhe si pasojë, humbjen e civilizimit të tij.

3. Konkluzion

Të katër protagonistët e romaneve të trajtuara më sipër janë heronj tragji-komikë. Ata vuajnë nga një tjetërsim identiteti, një *hubris* apo krenari komike që i pengon ata të shohin unin real pas fasadës joreale. Aty ku tragjedia ndjek fatin e njeriut, komedia përpiqet t'i korrigjojë marrëzitë e tij, ndërsa vizioni komik i Malamudit e rikthen njeriun tek vetvetja dhe shoqëria. Në fantazitë dhe zhgënjimet e tyre, në disfatat dhe njohjen përfundimisht të vetes, heronjtë malamudianë janë antiheronj modernë që u ngjajnë karaktereve tragji-komikë të Teatrit të Absurdit. Humori apo satira e Malamudit përqendrohet në largimin komik të personazhit nga vetja dhe realiteti, por kjo figurë prej budallai apo maniaku nuk na shkakton më thjeshtë të qeshura, siç ndodhte në komeditë e mëdha të së shkuarës. Një reagim i tillë vjen si pasojë e faktit që shkrimtari dhe lexuesi nuk mbajnë më haptaz anën e shoqërisë dhe vlerave të saj. Ne mund të qeshim akoma me viktimën komike, por edhe identifikohemi me të në kërkimin e tij tragji-komik të identitetit dhe realitetit në një botë që duket se nuk e zotëron asnjërin. Nga pikëpamja gjuhësore, proza e Malamudit kap ngrohtësinë dhe humorin, patosin e fortë për vuajtjen njerëzore, si dhe nëntonet e thella tragjike të prozës jidishe. Si përfundim, mund të themi se përmes humorit hebraik dhe humorit të zi, vepra e Malamudit hedh dritë mbi kompleksitetin e jetës dhe raportin e brishtë e shpeshherë të pakuptueshëm që ekziston apo krijohet ndërmjet individit dhe shoqërisë, nga njëra anë, dhe individit me veten, nga ana tjetër.

Bibliografi

- Abramson, Edward A., 1993, *Bernard Malamud Revisited*, New York, New York, Twayne Publishers.
- Field, Leslie A., and Field, Joyce W., eds., 1975, *Bernard Malamud: A Collection of Critical Essays*, Englewood Cliffs, N. J., Prentice-Hall.
- Lasher, Lawrence M., ed., 1991, *Conversations with Bernard Malamud*, New York, Jackson and London, University Press of Mississippi.

- Malamud, Bernard, 1982 *God's Grace*, New York, Farrar, Straus and Giroux.
- 1969, *The Pictures of Fidelman: An Exhibition*, New York, Farrar, Straus & Giroux.
- 1967, *The Fixer*, New York, Penguin Books.
- 1957, *The Assistant*, New York, Avon Books.
- Rajagopalachari, M., 1988 *The Theme of Compassion in the Novels of Bernard Malamud*, New Delhi, Prestige Books.

LETËRSIA E PENGUAR DHE DESTRUKSIONI I MITEVE

Yzedin Hima

“Albanian University”, Berat

Përmbledhje

Në këtë punim do të trajtojmë çështjen e ekzistencës së një letërsie tjetër, krahas “*Letërsisë së realizmit socialist*” në Shqipëri gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, që e kemi emërtuar si “*Letërsia e penguar*”.

Kjo letërsi zë një vend të rëndësishëm në mozaikun e *letërsisë shqipe* si vazhdim i *letërsisë së modernitetit*, letërsi e ndërprerë dhunshëm nga metoda e realizmit socialist, por që vijoi rrjedhën pikërisht në kushte ilegale ose gjysmë ilegale.

Kjo letërsi, ruajti tiparet e modernitetit si shkrimtari ashtu edhe teksti, duke i pasuruar më tej këto tipare. Do të sjellim shembuj se me kohë kjo letërsi ka tërhequr vëmendjen e lexuesit dhe sidomos të interpretuesit të saj, për të realizuar atë mision që e përmend Ian Meclan: “*Roli i interpretimit është që të korrigjojë ose të orientojë një lexim*”.*

Fjalët çelës: poet, burg, letërsi e modernitetit, letërsi e penguar, letërsi e soc-realizmit, mit

Hyrje

“Letërsia e penguar”

“*Letërsia e penguar*” përfshin të gjithë tekstet letrare që u krijuan gjatë periudhës së diktaturës në Shqipëri, por që nuk u nyjëtuan sipas metodës së soc-realizmit dhe parimeve të saj. Pavarësisht fatit të autorëve, fati, i cili na duhet të shënojmë, se nuk ishte i njëjtë për të gjithë krijuesit e kësaj letërsie. Kjo letërsi bashkohet për shkak të tipologjisë, diskurset e kësaj letërsie nuk ishin qëllimore, nuk ishin ideologjike. Kjo letërsi nuk u kthye në instrument për edukimin dhe formimin e masave me botëkuptimin marksist. Madje, kjo letërsi, në mjaft raste ka ndjekur edhe modelet e shkrimit të letërsisë bashkëkohore evropiane. Në diskurset e teksteve të kësaj letërsie dallohet edhe realizmi, hermetizmi, ekzistencializmi, irracionalizmi, akmeizmi, surrealizmi, simbolizmi, e plot rryma e drejtime të tjera bashkëkohore apo të kaluara në letërsinë perëndimore, por që jehona e tyre jetonte ende në letërsinë e krijuar në izolim. Tekstet e kësaj letërsie vijuan në shtratin e “*Letërsisë së modernitetit*”, duke u zhvilluar fshehur, në mënyrë të nëndheshme (mjaft dorëshkrime pas vitit ’90 dolën nga dheu ku qenë propozuar për t’i shpëtuar ndjekjes.) Ajo, i shpëtoi kontrollit të censurës zhdanoviste (në pjesën e saj më të madhe) për faktin e thjeshtë se nuk u botua, e për rrjedhojë nuk kaloi nëpër morskën e shtrënguar mirë të letërsisë së soc-realizmit. Shembull tipik është poezia e Zef Zorbës, krijimet e Mihal Hanxharit, proza e Astrit Delvinës dhe at Zef Pllumitëj., të cilat e gjetën lexuesin e tyre pas viteve ’90. Pjesë e rëndësishme e kësaj letërsie është edhe letërsia sfiduese, e cila i kishte shpërfillur parimet e drunjtë të soc-realizmit dhe ashtu, me të gjitha tiparet e letërsisë së modernitetit, u paraqit në redaksinë e vetme shtetërore për t’u botuar. Kjo

letërsi u ndalua, u dënua, së bashku mëtekstet edhe autori. Ka disa shembuj të tillë, por rasti i shkrimtarit dhe poetit Visar Zhiti është më domethënësi. Ai u dënua për shkak se poezitë e tij nuk qenë poezitë soc-realizmit, por, siç pohojnë edhe ekspertët e policisë për letërsinë, poezia e tij kishte tipare të njëjta me poezinë moderne që botohej në vendet kapitaliste e revizioniste. Edhe poezia e Frederik Rreshpjes u dënua dhe u ndalua sëbashku me autorin e saj. Të njëjtin fat patën tekstet në prozë të Pjetër Arbnorit, të cilat u shkruan në burg dhe u kapën aty, u dënuan, u ndaluan, bashkë me to edhe autori. Fatin më tragjik e pati Vilson Blloshmi dhe tekstet e poezisë së tij. Ai u ekzekutua nga diktatura sëbashku me poetin Genc Leka. Poezitë e Blloshmit nuk kanë të bëjnë fare me poezinë e soc-realizmit. Tekstet poetike të Blloshmit u gjetën në dosjet e sigurimit. Tek *“Letërsia e penguar”* bashkohen edhe tekstet e shkrimtarëve dhe poetëve që nuk mund t’i afroheshin shtëpive botuese për shkak të biografisë politike të familjes së tyre ashtu si poetët Sherif Bali dhe Gëzim Hajdari nga Lushnja, tekstet e të cilëve e panë dritën e botimit pas viteve ’90. Gjithashtu, me tekste të veçanta, i bashkohen kësaj letërsie edhe shkrimtarët që shkruan dhe botuan gjatë diktaturës, por duke thyer kornizat e soc-realizmit krijuan vepra të mirëfillta artistike me të gjitha tiparet e modernitetit. Për shkak të këtyre teksteve autorët u kritikuan, u dëbuan dhe shkuan për edukim në gjirin e klasës punëtore, ndërsa tekstet e tyre u nëmën dhe u burgosën në fondin e rezervuar të bibliotekave. Disa prej tyre humbën edhe të drejtën e botimit si Dhimiter Xhuvani, Sadik Bejko, Roland Gjoza etj., të cilët u dërguan në kantiere apo miniera për t’u edukuar. Edhe vepra e shkrimtarit të shquar Ismail Kadare, me tekstet thelbësore të saj të ndaluara dhe gjysmë të ndaluara, nuk rrodhi në shtratin e soc-realizmit. Falë meritave të pazakonta artistike dhe modernitetit, këto tekste fituan lexuesin e gjerë evropian dhe atë botëror të disa gjeneratave. Po kështu, mund të përmendim poetin Dhori Qiriazhi, shkrimtarin Zija Cela, të cilët u braktisën në zona rurale për mjaft vite. *“Letërsia e penguar”* përfshin, për mendimin tonë, edhe tekstet letrare të disa poetëve dhe shkrimtarëve të viteve ’70 – ’80, të cilët përfituan nga përmirësimi i përkohshëm i klimës letrare në një hark kohor.

Destruksioni i miteve në *“Letërsinë e penguar”*

a. Miti i kohës

Një letërsi e nyjetuar nga miti dhe simboli arrin nivele të larta të poetikës dhe komunikimit letrar. Letërsia nyjtohet duke u lindur nga mitet, por edhe duke destruktuar mite. *“Letërsia e penguar”* ka ndjekur rrjedhën normale të *“Letërsisë shqipe të modernitetit”*, duke ruajtur tiparet më të mira të saj dhe duke fituar cilësi të reja të diskursit letrar. Në tekstet e kësaj letërsie ne ndeshim destruksionin e mitit të kohës. Në tekstet poetike të Frederik Rreshpjes koha subjektive e perceptuar nuk i katë tre dimensionet e saj, herë s’ka kohën e shkuar, herë s’ka kohën e tashme dhe herë s’ka kohën e ardhme. Shpeshherë është e pranishme *“koha e përjetësisë”*. Destruksioni i mitit të kohës në tekstet e tij poetike vjen si thyerje e kohës, në këtë rast të kohës subjektive, duke e reduktuar atë që Ibrahim Rugova e quan trodimensionalitet (I. Rugova- *“Strategjia e kuptimit”*). Në tekstin e poezisë *“Ushtari i vjetër”* mungon koha e shkuar, pra koha e fëmijërisë për subjektin: *Pashë fëmijët në*

rrugë. Të qeshur / Të bukur dhe delikatë si vazot e çmuara/ Ku nënat fshehin ëndërrat e tyre./ Më panë dhe u trishtuan. E kuptuan / Që unë nuk kam qenë kurrë fëmijë... (F. Rreshpja-“Erdhi koha të vdes përsëri”-poezi)

Ndërsa në një tekst tjetër pa titull mungon *koha e tashme* dhe uni poetik jeton në kohën e përjetësisë: *Fëminia më kujton motet e shkuar/ Asokohe kur isha ende gjallë.../Ishte një kohë kur pranvera vinte vetëm për mua/ Por duke ecur e ecur trëndafilat u vyshkën / Tani ka kohë që pranvera nuk vjen më...*(po aty)

“Gjymtimi” i kohës në poezinë e Frederik Rreshpjes është edhe tipar i modernitetit nëtekstet e tij.Në trodimesionalitetin e kohës *si fenomen i perceptuar* (I. Rugova- “Strategjia e kuptimit”) në poezinë e Frederik Rreshpjes mungon më shpesh koha e ardhme.Ja çfarë thotë ai në poezinë me titull “*Kënga e fundit*”: *Shkoi edhe marsi i kësaj nate! / Jo, në këtë botë nuk do të ketë mars.* Ndërsa në tekstin e poezisë “*Dhembje*” duket qartë mungesa e kohës së ardhme për unin poetik: *...Rritu, rritu druri i qershisë! / Unë s’kam për të lulëzuar më...*(F. Rreshpja-“Erdhi koha të vdes përsëri”-poezi). Në tekstet e “*Letërsisë së penguar*” ndeshim edhe fenomenin e përfuturit të kohës së katërt ose atë që quhet “*dimesioni i katërt prustian, i kohës së kthyer në shumë “momente të tashme”, që lidhet me një logjikë jashtëkohore.*”(po aty) Në tekstin e poemës “*Menhir*”të poetit Mihal Hanxhari kemi edhe këto vargje: *...Deti që tregon historinë e botës / biblën e biblave të gjatën histori / Deti që mbulon kokën me togën e gjakosur të diellit / Deti që tret fantazma gjemish / Ah, deti që tregon historinë e hënës...* (Mihal Hanxhari-Gdhend një statujë”, poezi)

Në këtë fragment teksti kemi përfutimin e dimensionit të katërt prustian të kohës, ku të gjitha foljet janë në kohën e tashme: tregon, mbulon, tret, pra kemi të gjitha kohët e kthyer “*në shumë momente të tashme*”. Deti kryen në të njëjtën kohë disa veprime: tregon historinë e botës, mbulon kokën me togën e gjakosur të diellit, tret fantazma gjemish, shuan yje në gjirin e tij, tregon historinë e hënës etj. Studiuesi Ibrahim Rugova, shkruan: “*Po ashtu në poezinë dhe në romanin modern, koha si fenomen i perceptuar gjithnjë e më shumë vjen duke u shndërruar në hapësirë, që lidhet drejtpërdrejt me teorinë e relativitetit...Kjo tendencë krijuese në letërsinë moderne merret si destruktiv i kohës...*”(Ibrahim Rugova-“Strategjia e kuptimit”)

Në një tekst poetik pa titull të Visar Zhitit e ndeshim këtë fenomen.Koha, si masë e dënimit, për të dënuarin kthehet në hapësirë të kufizuar, pra në burg: *Në qeli /na mbajnë gjatë... / Që, nëse dalim/ qelinë ta mbajmë mbi supe / si hamalli një arkë.*(Visar Zhiti-“Dyert e gjalla”, poezi). Tjetërsimi apo metamorfoza për të cilën kemi folur më lart, kohën e gjatë e kthen në hapësirë të ngushtë, në qeli.Jo vetëm koha shndërrohet në hapësirë, në qeli, por edhe subjekti nuk shpëton nga ky shndërrim, në mënyrë metaforike ai do ta mbajë atë kohë burgu të shndërruar në qeli tërë jetën mbi supe *si hamalli një arkë*. Të njëjtin fenomen e ndeshim edhe në një tjetër tekst poetik pa titull të këtij poeti, ku koha e burgut është shndërruar në hapësirë.Tjetërsimi ka përfshirë edhe subjektin duke e kthyer edhe atë në një hapësirë burgu: *Një copë burg / jam për tjetrin / dhe gjithë të tjerët / për mua janë burg / rob mbajmë veten.*

Zhorzh Pule shkruan: “*Ne nuk na është dhënë koha, por momenti. Është çështja jonë që me momentin e dhënë të ndërtojmë kohën.*” (Ibrahim Rrugova-“Strategjia e kuptimit)

Në “*Letërsinë e penguar*”, në botën e trillimit sikurse në botën e njëmendësisë, pra në kohën e burgut të perceptuar nga subjekti, koha nuk rrjedh normalisht. Destruksioni i mitit të kohës shfaqet në tekstet e kësaj letërsie, kur perceptimi artistik i kohës, çasti (apo momenti që na jepet, siç përmendëm më lart) ngurtësohet, shndërrohet në gur, në psherëtimë, në klithmë, në pikë djerse të tmerrit, *në kurriz breshke, i pathyeshëm prej nga nuk dalim dot*, sikurse thuhet në poezinë e Visar Zhitit “*Çasti i fat(alitet)it*”(Visar Zhiti-“Dyert e gjalla”, poezi). Edhe në këtë tekst ndeshim dukurinë e destruksionit të mitit të kohës, ajo nuk rrjedh më, ngec dhe shndërrohet në objekte, shndërrohet nëhapësirë të mbyllur si kurrizi i breshkës dhe ndryn subjektin, i cili ankohet se nuk mund të shpëtojë, nuk mund të dalë dot nga ajo hapësirë e ngushtë hermetike që dikur ka qenë kohë. Momenti i dhënë, për të cilin flet Zhorzh Pule, nuk mund të kthehet në kohë.

Subjekti nuk mund të ndërtojë kohën historikesepe i mungon *liria* e tij, e cila, sikurse kemi vënë re edhe më lart, është *kohë*, për rrjedhojë kur mungon *liria* për subjektin, nuk është e pranishme askoha. Poeti thote se çasti këtu është i trashë sa një shekull, pra ka ndodhur thyerja e perceptimit të rrjedhës normale të kohës nga subjekti. Edhe më qartë koha kthehet në hapësirë në një tekst poetik të Zef Zorbës. Kjo hapësirë shndërrohet sërish në një *rryp* qielli që rëndon plumb mbi supet e të dënuarve. Hapësira më tej mbyllet kur vijat e horizontit lidhen nyje dhe subjekti ndihet rob edhe i kohës së destruktuar, edhe i hapësirës së mbyllur: *Mbi supe të kanalit/ jarguar currilash, plumb një rryp qielli / peshon. /...Atje, përpara, larg, në mugëtirë, / ku vijat paralele lidhen nyje / dhe e kyçin atë shteg të vetëm që mbeti...*(Zef Zorba-“Buzë të ngrira në gaz”)

b. Miti i Itakës

Poeti Frederik Rreshpja në tekstet e tij poetike më së miri ka realizuar destruksionin e mitit të Itakës. Uni i tij poetik nuk i beson Itakës në botën e trillimit artistik, sikurse poeti Frederik Rreshpja nuk i beson Itakës në botën e njëmendësisë. Sikurse kemi nënvizuar edhe më lart, poeti Frederik Rreshpja nuk u rikthye. Edhe uni poetik në tekstet e poezisë së tij nuk rikthehet në shtëpi. Itaka për unin poetik është sajim, ajo nuk ekziston. Frederik Rreshpja nuk e përmend pothuajse fare burgun në tekstet e tij poetike. Në poezinë e tij ka një odise të vetme, odiseja estetike. Uni poetik udhëton në gjuhë. Të gjitha peripecitë i ndesh aty. Edhe magjepsjen e ka po nga gjuha. Në librin e tij poetik “*Erdhi ora të vdes përsëri*”, cikli i parë titullohet “*Nuk jam një Odise i shpikur*”, më pas kemi poezinë “*Ulisada*” në tekstin e të cilës Miti i Itakës destruktohet si një mit që fsheh të vërtetën, dhe ngrihet mbi gënjeshtër. Janë katër pyetje retorike që thyjnë mitin e mallkimit të Odisesë, apo Ulisit, i cili endet nëpër deteje për t’u kthyer në Itakë, por në kërkim të “*Trojave*” të tjera, pikërisht për t’i shkatërruar ato: *Cili Poseidon të ka mallkuar? Cila perëndi deti? Nga cili ankth ujërash dole? Cilën Trojë kërkon të shkatërrosh*

tani?/ Ihitiozaur i mallkuar! / Sa shfaqesh në horizont /Dëgjojmë galopin e drurit që ëndërronte /krime... (F. Rreshpja-“Erdhi ora të vdes përsëri”-poezi)

Në këtë tekst miti i endjes së Odiseut nëpër dete për t’u kthyer në shtëpi, bie.Odiseu thirret me emrin e një peshku prehistorik monstër, ihitiozaur.Poezia përfundon me tre pyetje të tjera retorike dhe një konkluzion, ku Odisea vizatohet si një shpifës: *“Cili Polifëm banon këtu? /Po atje? / Kush i hëngri detarët e mi?” / Shekuj të tërë ke shpifur për gjigandët e botës. / (po aty)*

Poeti Frederik Rreshpjabeson te udhëtimi, te ikja, por nuk beson te rikthimi, nuk beson te Itaka si shenjë e intertekstit, por beson te Itaka që ka shpikur vetë, një atdhe poetik të krijuar nga ai, sipas shijeve personale dhe preferencës së njohur për vetmi. Përdorimi i fjalës *ishull* në vargun *se kam nevojë për ishuj* do të thotë se uni poetik kërkon ishullin si veçim, si vetmi: *Zot, jam tmerrësisht i vonuar! / Tani duhet të isha diku përtej shiut. /... Përditë më duhet të nxitoj drejt diçkaje që nuk është, / Por nuk jam një Odise i shpikur. / Eh, Itakën time e kam shpikur vetë, / Se kam nevojë për ishuj. / (po aty)*

Më poshtë, në strofën e fundit sqarohet se udhëtimi i unit poetik ndodh, jo në kërkim të Itakës së të gjithëve, por në kërkim të Itakës së unit poetik, Itakës së krijuar nga ai vetë, vetmisë: *Më vështron me sytë prej uji/ Te dritarja, fëmija lakuriq. / Bien itakat e legjendave, / Pas bregut madhështor të vetmisë. (F. Rreshpja- Në vetmi”-poezi)*

Dimensioni që uni poetik i jep vetmisë në këtë varg tregon se Itaka e tij, *bregu madhështor i vetmisë*, është atdheu ideal.Udhëtimi i unit poetik është një udhëtim në kohë, në një kohë të pakufizuar si kohë burgu, si kohë dënimi, por ai udhëton nëpër kohë për t’u larguar nga kjo kohë, të cilën e quan të padenjë për t’u jetuar, kohë të padenjë për t’u kënduar. Homeri që i madh se jetoi një kohë të madhe, me heronj të vërtetë.Në tekstin e poezisë “Shtëpia e këngës” thuhet: ... *Por koha jonë ka Kuaj Prej Druri/ Koha jonë nuk ka Iliadë / C’të këndojmë iliada të stisura?C’të këndojmë Akilët e gënjeshtërt?Homerin e bënë heronjtë/ Homerin nuk e bëri talenti.*/(F. Rreshpja- “Në vetmi”-poezi)

Udhëtimi i unit poetik është në kohë dhe në hapësirë.Hëna është shenjë në tekstet poetike të Frederik Rreshpjes.Janë të pakta tekstet poetike ku mungon fjala hënë.Hëna si mit zanafillor është ishulli i vetmisë së unit poetik, është bregu madhështor i vetmisë.Po pse hëna?Mendojmë se hëna përdoret si shenjë e refuzimit të tokës, si refuzim i diellit apo dritës së fortë.Pothuajse në të gjitha tekstet poetike të Frederik Rreshpjes, mungon fare fjala diell dhe është e pranishme mjaft shpesh fjala hënë: *Hëna e artë mesdhetare / Vijnë ciganët me dauille dhe me hënë/Hëna mbi lumë vizaton /Hënëzat që hëngrën dhëntë e vjeshtës /Ti erdhe nëpër udhën e hënës / Kasolle prej hënë! Tutje shtrihet hëna /Ndoshta shkallët e kësaj nate deri te hëna /Tani te hëna shkoj i vetëm /Rreth drurëve të galvanizuar me hënë /Hëna po shuhet në pëllëmbët e gjetheve / Do të shkoj të rri pranë zjarrit të hënës /Një hënëz argjendi e larë me flori / Me një qiri hëne në dorë/Hëna ikën nëpër mjegulla / Tingulli i këmbanës si gjëmim hëne / Nën një hënë që nuk di të buzëqeshë/ Hëna hidhet flokëlëshuar katarakteve/ Për llambadhën e shuar të hënës/ Hëna e shuar nga shiu.*

Përdorimi kaq i shpeshtë i fjalës *hënë* krijon një *mit të hënësne* poezinë e Frederik Rreshpjes. Në një nga tekstet e poezisë uni poetik e konsideron Hënë të vetmin ishull të denjë dhe të vërtetë vetmie, ku mund të gjejë prehje për shpirtin e tij. Në fragmentin e tekstit që vijon pohohet qartësisht ajo që nënvizuar më lart, moskthimi. Uni poetik shpjegon këtë moskthim si mungesë besimi a humbje e besimit të të gjithë brigjet e kthimit: ... *Tani jam bir i ajrit si në ditën e parë të botës/ I mallkuar në mënyrë biblike. / Jo nuk ka Itakë në këtë botë. / Tani jam bir i Hënës, tërë ishujt e tjerë janë të rremë. / Shpirtrat e ujit të shtyrë nga dhembja / Vështrojnë që prapa shirave, / Po unë s'kam për t'u kthyer më kurrë; / Më kurrë nuk kam besim në asnjë breg.* * (F. Rreshpja- “Në vetmi”-poezi). Udhëtimi i i unit poetik në botën e trillimit artistik, në një kohë tjetër nga e jona, në një kohë prej gjuhe, ndodhi. Rikthimi i unit poetik gjithashtu ndodhisi rikthim prej gjuhe, në trajtën e këtyre tekste të pazakontë poetikë të Frederik Rreshpjes, ku fjala *hënë* është edhe shenjues në tekstet e tij, si e kuqja e Onufrit te pikturat e tij.

Destruksioni i mitit të Itakës në tekstet e poezisë së Frederik Rreshpjes, për mendimin tonë, është rrjedhojë e koncepteve që ka poeti për botën, individin dhe fatin e tij. Rikthimin ai e sheh si ndryshim të rrjedhës së fatit me dhunë nga individi, gjë që ai nuk e beson dhe nuk i pëlqen të ndodhë. Rrjedha e fatit për të është një proces i pandryshueshëm, i paracaktuar dhe i pakorrigjueshëm (ose i padhunueshëm). Në tekstin e poezisë së tij “*Testament*” dallojmë qartë rrjedhën e fatit të unit poetik, të cilën ai (uni poetik) nuk ia uron askujt, kur pas çdo strofe përdor vargun: *Mos e pastë njeri këtë fat!* Që nga fëmijëria, rinia, e deri në fund, uni poetik ka qenë i mallkuar me art, që do të thotë se kishte një perceptim krejt origjinal për botën, gjë që e pengonte të jetonte normalisht si të gjithë njerëzit e tjerë normal. Mallkimi me art është për unin poetik, me sa kuptojmë ne, mungesa e pragmatizmit, gjë që në këtë shoqëri shihet si anormalitet. Në tekst pohohet se kjo natyrë e unit poetik gjatë udhës së tij mbeti e pandryshueshme, e pamodifikueshme që nga fëmijëria, rinia e burrëria e tij. **Fëmijëria:** *Që fëmijë e kam kuptuar se kisha lindur / I mallkuar me art. / Gjërat i shihja ndryshe / Njëpër shirat e vdekur Peshqit fluturonin drejt çerdheve, te yjet. / Në vend të borës binin zogi në çdo dru. / Era si ketër brente degët. / Qante mbi mua nëna, shënmëria ime. Ave nëna ime! / Mos e pastë njeri këtë fat! /* **Rinia:** *Kam dashuruar një Afërditë në Olimpin e trëndafilave / Pastaj erdhe ti tërë ikje. / Më*

vonë vije vetëm në ëndrra, si perënditë ilire / Kështu iku edhe rinia, filigrami i djalërisë/

I mallkuar me art. Mos e pastë njeri këtë fat! **Burrëria** (pleqëri nuk pati): *Tani që po vdes ëndërroj vetëm një kryq te koka, / dhe të harrohem, se nuk dua që edhe pas vdekjes / Të më ndjekë mallkimi i artit. / Mos e pastë njeri këtë fat!* **Pasvdekja:** *Po ku të vdes, portreti im ka për t'u shfaqur nëpër gjethe/ Se unë kam patur miqësi me çdo dru. / Në stinët kur bien gjethet do bien sytë e mi. / Tani e tutje shirat do të jenë lotët e mi. / Mos e pastë njeri këtë fat! /* (Frederik Rreshpja – “Në vetmi”- poezi)

Siç shihet, pas vdekjes ka një rikthim të unit poetik, një rikthim në formën e gjethëve, në formën e shiut. Sikurse thuhet dhe në tekste të tjerë të Frederik

Rreshpjes, uni poetik shndërrohet në vjeshtë, shndërrohet në dimër, shndërrohet në natyrë.

b. Miti i atdheut si fanar ndriçues

Trifon Xhagjika është para së gjithash një poet disident. Ai u përball me diktaturën në të dy dimesionet e tij njerëzore: edhe si qytetar, edhe si shkrimtar. Është meritë e madhe tij, që pikërisht në kulmin e euforisë që kishte mbërthyer regjimin dhe turmat për ndërtimin e një jete të re, ai dalloj qartësisht thelbin e diktaturës: dhunën, mashtrimin, privimin e lirisë dhe rrjedhojat dramatike, si: mjerimi, izolimi, shkretimi i vendit, vrasjet dhe burgosjet permanente të kundërshtarëve realë dhe atyre imagjinarë. Poezia e Trifon Xhagjikës është e nyjtuar me destruksionin e miteve, mite me të cilat qe ngjizur letërsia e soc-realizmit. Miti i atdheut si fanar ndriçues në brigjet e Adriatikut gjendet rëndom në letërsinë e soc-realizmit të fundit të viteve '50 dhe fillimin e viteve '60. U shkruan mjaft poema, poezi, tregime dhe romane, ku mitizohet atdheu socialist. Ndërsa në tekstet poetike të Trifon Xhagjikës të krijuara në këtë kohë atdheu jo vetëm që nuk është fanar ndriçues, por është lakuriq. Jo vetëm që nuk mund të jetë shembull për vende të tjerë, por është foshnjarak, sa që nuk këput dot asnjë degë. Jo vetëm nuk ka asnjë lavdi të sotme, por rron me lavdinë e shekujve që shkuan. Është koha kur Shqipëria qe veçuar nga kampi socialist për shkak të stalinizmit të diktatorit dhe nisi izolimi total i vendit. Në tekstin e poezisë me titull “*Ndihmomëni të qesh*” thuhet: ...*E pashë Atdheun lakuriq/ (vetëm, pa miq e shokë)/ mundahej të këpuste një degë dafine nga lavdia e shekujve.*/* Trifon Xhagjika ka një kthjelltësi dhe qasje kah e vërteta, gjë jo fort e zakonshme për kohën. Dy janë shërbimet e shkrimtarit nga të cilat ai nuk mund të shmanget: *shërbimi ndaj së vërtetës dhe shërbimi ndaj lirisë*, për të cilat flet shkrimtari i njohur Albert Camus (Albert Camus- Nga fjala e mbajtur në ceremoninë e çmimit “Nobel” për Letërsinë). Trifon Xhagjika nuk iu shmang këtij detyrimi të shenjtë dhe e pagoi me çmimin e jetës së tij shërbimin ndaj lirisë dhe të vërtetës. Në një tjetër tekst poetik Trifon Xhagjika sheh atë që të tjerët ose nuk e shihnin, ose bënë sikur nuk e shihnin, ose e mbulonin dhe e zbuluronin. Portreti i atdheut në këtë tekst është realist, madje i vizatuar fatalisht si i tillë dhe në perspektivë: *Një vend i ëndrrave pa fat / një vend latydësh të tërbuar/ një vend i mendjeve sakate/ me turp kusari mbuluar/ Një vend me fjalë kotësie/ ku vdekja e fshehtë është modë/ ku drita e Diellit u bë hije/ Atdhe i dashur je ti sot.*(Trifon Xhagjika- poezia.) Edhe në tekstet poetike të poetit Visar Zhiti e takojmë destruksionin e mitit të atdheut si fanar ndriçues. Ai e sheh atdheun në diktaturë, si një burg të madh, ndërsa burgun “*si këlysh në xhepin e kangurit të dhunës*”: *Qëndro i fortë! / I gjithë atdheu ynë është burg / I thurur me tela me gjemba. / 3000 vjet i dënuar. Para Krishtit./ Burgu ynë i vogël / në barkun e burgut të madh / ndjehet si këlyshi në xhepin e kangurit / të dhunës.* / (V. Zhiti-“Hedh një kafkë te këmbët tuaja). Visar Zhiti në tekstet e tij poetike atdheun e shikon edhe si burg të madh, por edhe si qenie tragjike, si një rrjedhojë e diktaturës së vendosur në të. Duke u shpirtëzuar, edhe atdheu vuan, sikurse subjekti poetik. Të dy janë viktime në këtë tragjizëm: *Atdheu im – hamlet / me kafka burgjesh ndër duar.* (po aty).

Në poezinë e Zef Zorbës atdheu vizatohet si një greminë e përhershme në kohë dhe hapësirë. Kjo greminë, kjo rënie ka përfshirë gjithçka edhe njeriun edhe natyrën, edhe hapësirën edhe kohën. Pasi rrëpira ka pushtuar tokën orvatet të pushtojë edhe detin, madje edhe qiellin: *Harbon përbindshëm rrëpira / e ngeshme në perspektivë / për t'u qepur në një kënd / me qiellin dhe detin.* (Zef Zorba – “Buzë të ngrira në gaz”). Mozaiku i atdheut ndërtohet poetikisht nga Zef Zorba në dimesionin shpirtëror dhe fizik, me të djeshmen dhe të sotmen e tij. Në tekstin e poezisë “Kujtime” me pak vargje eliptike vizatohet Rmaji, Zalli i Kirit, toponime në trupin e atdheut, diku në rrethinat e qytetit të Shkodrës, ku u pushkatuan njerëz, që ishin kundërshtarë realë e imagjinarë të diktaturës: *Kot ëndërrime na duken. / Zemra u beson / shpirtnave / që natën gufojnë / prej gurësh / të Rmajit/ netësh si kjo*(po aty).

Shkalla e Kakarriqit është një tjetër toponim, në shtatin e atdheut, një ferr, ku njerëzit janë kthyer në eshtra *që vetëm lëkura i lidh e vullneti*(po aty). Në tekstin e poezisë “*Kashta e kumtrit dikur*” poeti Zef Zorba nëpërmjet kontrastit e vizaton atdheun në dy kohë; (koha e tashme) *Mu në palcë / pikëllimi i kujtimeve tua/ o rrugë të errta.* / Ndërsa dikur, ku subjekti ishte i ri, atdheu kishte këtë fytyrë; (koha e shkuar): *Mbi avulli të blera përgjatë, / Kashta e Kumbarës dikur / si tandë pezullohej e lehtë, / dekor për kremtime entusiaste; / kur njohja kish nisur posa me lindë e mitet kishim pranë, / të qartë / e qielli desh kapej me dorë*(po aty). Një tjetër vend, Kruja, pjesë e lavdisë së dikurshme, në tekstin me të njëjtin titull vjen si e tillë: *Gjerdan margaritarësh / mbi gjoksin tënd / t'irmuar. / o atdhe.* Në tekstin e poezisë “*Kesh ngopeshim me frymë*”, e shkruar në vitin 1948, kur poeti Zef Zorba gjendej në burg, destruksioni i mitit të atdheut ndërtohet me dramacietin e së vërtetës të një atdheu të pajetueshëm: *Shikonani: / vërtetojmë burime primitive: / me nofulla kërcëlyese/ të dërmishura/ përtypim mundim / e balta e në unji.* (po aty). Dhuna dhe urrejtja ka shfityruar atdheun, e ka kthyer atë në kohën primitive, me skllevër e skllavopronarë. Kjo pamje reale e diktaturës retushohej nga letërsia soc-realiste duke e mitizuar atdheun si më të begatin e më të lumturin në botë.

Poeti Bilal Xhaferri në një tekst të tij për atdheun, botuar te “*Krahu i shqiponjës*” më 1977 shkruan: *I vogël atdheu im në hartën e botës / si një fletë lisi. / I lashtë atdheu im në thellësi të kohës / si një rrënjë lisi / I fortë atdheu im, në stuhi e shqotë / si trung lisi... / Dhe zemrën e atdheut tim e ha sot / një krimb lisi.* / (B. Xhaferi – vepra 1). Bie në sy përdorimi i përemrit pronor të vetëssë parë *im*. Poeti, ndonëse i mërguar nga atdheu, ose më mirë i dëbuar, e shikon veten si pjesë të atdheut. Të dy, atdheu dhe poeti ndihen në këtë tekst si e tëra me pjesën. Madje poeti përdor përemrin vetor *im* në vend të *ynë*, duke mos e ndarë atdheun me të tjerë. Destruksionii mitit të atdheut si fanar ndriçues duket qartë në këtë tekst ku thuhet *se zemrën e tij e ha sot një krimb lisi*. Edhe më i spikatur është ky destruksion i mitit të atdheut në një tekst tjetër të Bilal Xhaferrit që titullohet “*Do t’ju tregoj*”: *Ajo fije teli / te opingat tona / është vazhdim i telit / që rrethon kufinë / e atdheut. / Kalojmë / në sfondin e atdheut / ne, bijtë e tij / ne ushtarët e popullit / të rreckosur/ të përulur/ si robër lufte / të huaj* (po aty).

c. Miti i lirisë në diktaturë

Në tekstet poetike të Trifon Xhagjikës ndihet qartë destruksioni i mitit të lirisë, i cili në letërsinë e soc-realizmit “lindi nga gryka e pushkës”. Në poezinë “*Apoteoza e ditëve tonë*” poeti vizaton një pamje mjaft trishtuese, në kontrast të thellë me tekstet e letërsisë së pranuar zyrtarisht. Në fokusin e poetikës së Trifon Xhagjikës janë pikërisht *e vërteta* dhe *liria*. Siç kemi nënvizuar edhe më lart, nuk mund të këtë liri pa të vërtetën, ndërsa mungesa e lirisë lind gënjeshtërën dhe hipokrizinë: *Kurthi / dhe gënjeshtër / shëtisin të lirë nëpër rrugë. / Njerëzit i njohin, / por kanë frikë t’i prekin / kanë frikë t’i ndalojnë; / I ruajnë roje të blinduara. / Gjithkush i nderon ato. / Kapelen ua heqin të diturit, / trimat i ftojnë të pijnë me ta/ bujarët i mirëpresin nëpër shtëpira.* (T. Xhagjika – Poezia)

Siç shihet në këtë tekst *e vërteta* nuk ekziston më, ajo është zëvendësuar nga gënjeshtër. E kur kurthi dhe gënjeshtër shëtisin të lirë nëpër rrugë, natyrisht që liria mungon, apo është mërguar. Të hidhje në letër një të vërtetë të tillë, krahas kurajos qytetare, duhet të kishe edhe një vetëdije të thellë të misionit të shkrimtarit për të vërtetën dhe lirinë. Të mos harrojmë se poezia është krijuar në kulmin e euforisë së fitimtarëve, në kulmin e mitizimit të lirisë në letërsinë e soc-realizmit. Visar Zhiti e quan mallkim lindjen e brezit të tij pas gjeneratës së fitimtarëve (nënkupto vendosjen e regjimit komunist, shënimi im, Y. H.). Mungesa e së vërtetës, mungesa e lirisë, dhuna ka lindur hipokrizinë. Në tekst ndihet dhuna që vjen nga shteti: *Njerëzit i njohin/ por kanë frikë t’i prekin / kanë frikë t’i ndalojnë / I ruajnë roje të blinduara*(po aty).

Rojet e blinduar që ruajnë kurthin dhe gënjeshtërën janë rojat e shtetit të diktaturës. Shekspiri ka një varg të famshëm për të vizatuar kohën, kur e keqja ka triumfuar: “*Vjen një ditë kur virtyti i kërkon ndjesë vesit*”. Që e keqja është ulur këmbëkryq dallohet në katër vargjet e fundit: *Gjithkush i nderon ato. / Kapelen ua heqin të diturit/ trimat i ftojnë të pijnë me ta/ bujarët i mirëpresin në shtëpira*(po aty).

Po si shpjegohet që ndodh një deformim i tillë? Pikërisht mungesa e lirisë dhe prania e dhunës lind hipokrizinë. Në poezinë me titull “*Hapi fodull*” gjendet një pyetje retorike destruktive, ku qartësisht çmitizohet atdheu socialist dhe miti i lirisë: *...ç’ndryshim ka varri / nga vendi yt? / Më tej në tekst vizatohen dhunuesit e atdheut dhe lirisë: Është hapi i tyre/ shushunja/ lindur llumit të vijave. / që dhe në kuvend, / se duan fjalëm liri.* (Po aty).

Në poezinë- trakt të titulluar “*Kënga e verbër*” poeti nënvizon idenë se një atdhe ku e vërteta dhe liria mungon shndërrohet në njerkdhe: *Turp/ Atdhe! / S’të di kush je! / ...Te ti jam i lirë pa liri...*(Po aty). Poeti Trifon Xhagjika në poezitë e tij me temë politike është pa asnjë mëdyshje një kundërshtar i hapur i dhunës dhe gënjeshtërës, sikurse është një adhures i së vërtetës dhe lirisë. Ai e sfidon dhunën dhe verbërinë e saj, që paturpësisht ka marrë edhe emrin e republikës: *Nuk mundem të të fal. / Gjuha m’u zgjidh. / Vramë po të duash. / Në netët e tua të gjakosura / do të dëgjosh zërin tim: “Të urrej o Republikë, / Lavire e zotërve gjakprishur!”* (Po aty)

Në një tekst poetik të poetit Mihal Hanxhari destruksioni i mitit të lirisë nën diktaturë nyjëtohet me finesë në tekstin e poezisë “*Iriqët e detit*”. Në tekst nëpërmjetasocacioneve të thurura kalohet nga iriqi i detit te telat me gjemba, te rrethimi i burgut, te rrethimi i të gjithë vendit, te burgosja e individit, te burgosja e

popullit. Përdorimi i simbolit të iriqit, i burgosur brenda lëkurës me gjemba, i kujton subjektit poetik gjendjen e vetes, i rrethuar po ashtu si iriqi me telat me gjemba të përndjekjes, izolimit, mungesës së lirisë: *Kërkova dhe unë iriqët e detit / Mbusha duart dhe u ula mbi shkëmb / Vetëm një çava vura buzët pranë gjembave / Po buzët më dridheshin / Kujtimi ishte i hidhur / Dhe i hodha të tjerët pa i vrarë / Një nga një përsëri në det / O sa herë më pyet zemra / Kush i shpiku telat me gjemba.*(Po aty)

Destruksioni i mitit të lirisë në diskursin poetik të Zef Zorbës është i pranishëm në mjaft tekste poetike. Në poezinë “*Qyqja*” thuhet: ... *Shuhen motet pikëllueshëm. Ti mësove / me sajue nëpër shkëmb vrima shprese / t’ndëlikuara: kandrra! Kuku/ duke ofsharë gjithashtu ëndërrimet / dalin rrena. Kuku e kuku, / ditë e natë; zhel e mel, zemrën thatë e / shpirtin myk...* (Zef Zorba – “Buzë të ngrira në gaz”). Mungesa e lirisë dhe gjithë mungesat e tjera e kanë çuar gjendjen deri në atë pike, sa që motet e jetuar shkojnë të mbushur jo me jetë, frute pune, gëzime e kënaqësi si kudo në botën e lirë, por me pikëllim, dert e mjerim. Ky fragmenti, sjell një gjendje dramatike nga mungesa e lirisë: *shpresat janë vrima në shkëmb nga dalin kandrra*. Njerëzit e zhgënjyer nga e pritshmja shndërrohen në qyqe, teksa shqiptojnë të pikëlluar për mote e mote të tërë: kuku! (Kjo thirrme është karakteristike në të folmën e shkodranëve. Ata shpesh për dukuri e fenomene që i trishtojnë thërrasin: kuku, moj nanë!) Brenda tekstit të kësaj poezie gjendet një varg që mbart te vetja një pyetje retorike, e cila përcjell një energji tronditëse, në të dy rrafshet në atë estetik dhe kuptimor: “*Ku s’ka dritë ç’i do sytë?*” Simbolet *dritë* dhe *sy* fshehin te vetja edhe nocionet *liri* dhe *jetë*. E drejtpërdrejtë, e liru nga jonet estetike, pyetja përkthehet: *Kur s’ka liri ç’e do jetën?* Poezia e Zef Zorbës, si një diskurs tejet modern i komunikimit artistik dekodifikohet nëpërmjet zbërthimit të sistemit të simboleve që krijojnë mitologjinë e tij poetike. Në tekstin e poezisë “*Pa elemente*” kemi gjashtë vargje eliptike. Fjalët çelëste ky tekst janë: *dhimbje, e mjerë, kënaqësi, dritëshkurtër*. Përdorimi i përemrit pronor *jonë*, lë të kuptohet se bëhet fjalë, jo për një dhimbje individuale të subjektit, por më gjerë, pra dimesioni i dhimbjes e kalon individualen. Nuk është thjesht një pikëllim estetik mode nga humbja e kuptimit të jetës së provuar katërcipërisht, gjë e njohur në gjysmën e dytë të shekullit XX. Është një gjendje e pashpresë nga mungesa e lirisë: *Sado që të largohemi/ o dhimbje/ mos ti cekohesh? / ç’e mjerë / kënaqësia jonë / dritëshkurtër.* (Po aty). Edhe më e trishtë vjen pamja e tablosë poetike në një tjetër tekst të Zef Zorbës të titulluar “*Hej, zemërplasura!*” Fjalët dhe shprehjet që thurin tekstin janë: *shuhet, të rralla, të mekura, kënga kujtuesë, kumbonëve, vajzave, zemërplasura, me vdekë qind herë në ditë*. Në kundërshti me ritmet futuristo - metalike të teksteve mitizuese të lirisë së zbritur nga malet, këtu përdorimi i zanoreve u, a, e, u, a në vargun *Shuhet me rrahje të rralla, të mekura* të jepndiesinë e kundërt, atë mortore. Tamburet, sirenat dhe çangat në tekstet e letërsisë të soc-realizmit, këtu kundërvihen nga kënga kujtuese e kambanave të kishave, të cilat bien vetëm në kujtesë, sepse janë ndaluar të bien. Dy vargjet e fundit të tekstit sjellin dilemën subjektive të ekzistencës: *Sepse nuk ka kuptim me vdekë / qind herë në ditë.* (Po aty)

d. Miti i turmës

Në letërsinë e soc-realizmit mitizimi i turmave, të cilat emërtoheshin masë, ose krejt padrejtësisht popull, gjë për të cilën kemi shkruar edhe më lart, është i pranishëm pothuajsenë çdo tekst. Një nga parimet e metodës së soc-realizmit ishte edhe raporti masë – individ në letërsi, ku kishte përparësi absolute e para. Madje edhe në këtë letërsi, sidomos në poezi, kur u veçua uni poetik me dilemat e tij individuale, kritikët zyrtarë u shqetësuan. Turma vërshoi në këtë letërsi duke tretur në vete individin, unin, sikurse ndodh në vërshimet e verbëra të lumenjëve që edhe pemët e veçuara i shkulin dhe, duke i bashkuar me të tjerë pemë rrënjëdala, i kthejnë thjesht në trungje. Në poezinë e Frederik Rreshpjes destruksioni i mitit të turmës takohet në pak tekste poetike, për vetë natyrën e poezisë së tij. Në tekstin e poezisë *“Miting për Enver Hoxhën”*, tekst të cilin e kemi parë edhe më lart në një kënd tjetër, Frederik Rreshpia e quan masën e njerëzve të përulur para diktatorit si turmë pa tru, servilë, injorantë, madje deri edhe popull i mallkuar: *Ulërijnë servilët dhe injorantët: hosanna! / Turma pa tru të bie ndër këmbë/ Si popull i mallkuar, fis i arbitrit/ I bie më gjunjë urdhërit tënd.* (Frederik Rreshpia- “Në vetmi”, poezi). Në krijimin e turmave të verbëra, të cilat duke ndjekur pas diktatorin kthehen në barbare, autori nuk shfaqëson askënd. Pas rënies së diktaturave ndodh çudia që turma shkoqet dhe të gjithë fajet i ngarkohen njëshit, i cili pa turmën, siç thuhet, pa zerot do të ishte thjesht një. Në tekstin poetik *“Barbarët”*, janë të pranishme pasojat e barbarisë, por nuk dihet se ku shkuan barbarët: *Barbarët ikën. Po nga vanë? Askush nuk i pa./ Asnjëri nuk e di nga shkuan. / Mirëpo barbarët ishin. / Të vrarët janë aty, por barbarët, thonë, nuk ka patur kurrë. / ... Atëherë pamë njëri – tjetrin në sy / Dhe e kuptuam që barbarët ishim vetë. / Ah, prandaj asnjëri nuk e diti nga shkuan barbarët?! (Po aty)...* Në një tekst tjetër të Frederik Rreshpjes turma emërtohet si maurët, një popullsi afrikane e shkretëtirës. Ai ndihet i vrarë pikërisht nga kjo turmë që i shërben dhunës.: *Të mallkuarit e rërës fshinë thikat / dhe ikën me turbanët tërë gjak. / Shtrirë si perëndia i shkretëtirës/ Unë jam zezaku i bukur / I komunizmës. / (Po aty)*

Poeti Visar Zhitinë poezinë e tij me titull *“Të burgosurit në ndihmë të dhunës”* vjen në përfundimin se pa turmat diktatura nuk mund të qëndronte: *As telat me gjemba, / as rojet me armë / (si hunj të gjallë mes tyre)/por ne, vetë ne / e mbajtkemi burgun / bashkë me popullin!/(Visar Zhiti – “Hedh një kafkë te këmbët tuaja”).* Më tej, ndeshim një pyetje retorike që zbulon një të vërtetë të pamohueshme: *A ka kohëra që atdheu do vetëm të marrët?* (Visar Zhiti – “Hedh një kafkë te këmbët tuaja”). Për vetë natyrën e poezisë së tij të drejtpërdrejtë dhe temës së preferuar politike, destruksionin e mitit të turmës e ndeshim në disa tekste poetike të poetit Trifon Xhagjika. Në tekstin e titulluar *“Perëndive”* thuhet: *Pa besuar, thërrasin Urra. / Mos kemi lindur të bindemi! / Ja ligji i sotëm: / -Beso pa menduar. / Edhe më i qartë ndeshet destruksioni i mitit të turmës në tekstin e poezisë “Idhulli gjel dhe kokat boshe”. Turma portretizohet si lulëzim i kokave boshe, besnike deri në vdekje të zbrazëtisë së tyre dhe idhullit gjel, diktatorit: Me guxim derdhin gjakun / vetëm Idhulli gjel të hapi gojë / Një copë vend qiellit i morën, / monument idhullit i ngritën / e kurora opinionesh thurën.../(Trifon Xhagjika- Poezia)*

Literatura e shfrytëzuar

- *Ibrahim Rugova-“Strategjia e kuptimit”
- *Frederik Rreshpja-“Erdhi koha të vdes përsëri”
- *Mihal Hanxhari-Gdhend një statujë”, poezi
- *Visar Zhiti-“Dyert e gjalla”, poezi
- *Zef Zorba - “Buzë të ngrira në gaz”
- *Frederik Rreshpja - “Në vetmi”
- *Trifon Xhagjika- Poezia
- *Albert Camus- Nga fjala e mbajtur në cermoninë e çmimit “Nobel” për Letërsinë
- *Trifon Xhagjika -poezia “Atdheu”, po aty
- *Visar Zhiti - “Hedh një kafkë te këmbët tuaja”, poezia “Burgu i madh, burgu i vogël”
- *Visar Zhiti-poezia “Ringjallja imagjinare e Kafkës”
- *Zef Zorba - “Buzë të ngrira në gaz”-poezia “Shkalla e Kakarriqit”
- * Zef Zorba - “Buzë të ngrira në gaz”
- *Bilal Xhaferri- poezi-Vepa I
- *Trifon Xhagjika – poezia
- *Mihal Hanxhari- “Gdhënd një statujë”, poezi
- *Zef Zorba - “Buzë të ngrira në gaz”, poezi
- *Frederik Rreshpja- “Në vetmi”, poezi
- *Po aty, poezia “Skllavi i maurëve”
- *Visar Zhiti - “Hedh një kafkë te këmbët tuaja”
- *Trifon Xhagjika- poezi.
- *Visar Zhiti - “Hedh një kafkë te këmbët tuaja”
- *Po aty
- *Po aty
- *Frederik Rreshpja - “Në vetmi”
- *Fatos Lubonja - “Ahlemi”, revista “Përpjekja”, 1998
- *Maks Velo - “Spaçi”, roman

HISTORI

NDËRMARRJET FINANCIARE TË QEVERIVE SHQIPTARE TË VITEVE 1920-1939 SIPAS KËNDVËSHTRIMIT TË AUTORËVE TË HUAJ

Dr. Benita Stavre
Universiteti Fan S.Noli



Permbledhje

Periodha e viteve 1920 dhe 1930 është bërë shpesh fokus studimi për historiografinë shqiptare. Ajo vazhdon të jetë një periudhë jo pak kontradiktore, mendimet për të cilën nuk kanë munguar të vijnë edhe nga shkrimtarë, historianë, studiues dhe gazetarë të huaj. Këndvështrimi i këtyre të fundit ka paraqitur në pjesën më të madhe të rasteve përshkrime faktike që qëndrojnë shumë pranë realitetit shqiptar të asaj kohe. Ky punim përsiatet të sjellë një përmbledhje të zhvillimeve ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës në fjalë ashtu siç ka qenë përshkruar, paraqitur dhe analizuar nga shkrimtarë britanikë dhe amerikanë, që e kanë vizituar Shqipërinë gjatë viteve '20 dhe '30 të shekullit të kaluar, që kanë hartuar raporte për institucione të rëndësishme ndërkombëtare apo që kanë zgjedhur këtë periudhë si fokusin e tyre të studimit sipas këndvështrimit të kohëve moderne. Aty bëhet një përshkrim i sistemit të transportit dhe mundësive për përmirësim që relievi shqiptar i ofronte tregtisë së brendshme në Shqipëri, mundësive që kishte Shqipëria për të mbuluar shpenzimet e buxhetit të shtetit dhe mënyrës se si kabinetet qeveritare dhe më vonë Mbreti Zog u përpoqën të përballonin sfidat financiare me anë të ndihmës që i kërkuan Lidhjes së Kombeve dhe marrëveshjeve politike që vendosën me shtetin italian.

Fjalë çelës : *qëndrueshmëri politike, ndërmarrje ekonomike, rrjet i transportit, sistemi bankar, sfida financiare*

Abstract

The period between the years 1920 – 1939 has recently been the focus of research for the Albanian historiography. Its contradictory features and developments have attracted even the attention of foreign writers, historians, researchers and journalists. Time after time they have written objective descriptions of the Albanian reality of that time in their travel books, in their newspaper articles, in their reports addressed to important international institutions, and later, in analytical reviews they have written about this period. This paper focuses on their writings about the economic developments of Albania during the years '20 and '30 of the last century. It describes the infrastructure and the opportunities that the Albanian geography offered to the creation of a network of local markets, the way the state managed its budget and the way the financial challenges compelled later cabinets and King Zog himself to sign political agreements with its overseas neighbour after the League of Nations refused their frequent requests for financial help.

Key words : *political stability, economic enterprises, transport network, bank system, financial challenges*

“(…) në kushtet e sotme Shqipërisë i duhet të arrijë kërkesat e zhvillimit evropian dhe të paguajë për të shkuarën duke bërë sakrifica të rënda në të tashmen. Qeverisë së Zogut i del si detyrë t’i bindë shqiptarët se tani reputacioni i secilit varet më shumë nga të qenit një punëtor i mirë sesa një luftëtar i flaktë.” [13]
Xhozef S. Rousek, 1933

Ekonomia shqiptare e viteve 1920 dhe 1930 është përshkruar nga autorët e huaj si një vazhdimësi e strukturave të prodhimit që kishin mbijetuar nga shekulli i 19^{-të}, pasojë e zhvillimeve historike në vend për më shumë se tre shekuj. Edhe gjatë dy dekadave të para të shekullit të 20^{-të} Shqipëria kishte qenë arenë lufrtrash, territor i pushtuar, madje nuk ishte cilësuar më tepër se "një shprehje gjeografike". Periudha të gjata të karakterizuara nga mungesa e rregullit, e lidhjeve që logjikisht ekzistojnë mes territoreve të një shteti, si dhe e vëmendjes së brendshme dhe të jashtme politike e kishin mbajtur pezull ekonominë e vendit për një kohë të gjatë. Situatat e ngarkuara politike i kishin mëshuar më shumë mbijetesës së territoreve sesa strategjive të zhvillimit ekonomik. Vëmendja e shqiptarit ishte përqëndruar në luftë dhe, pushteti, për të cilin i ishte dashur të luftonte, kishte kalitur tek ai nevojën për liri. Kjo nuk i kishte lënë kohë të mendonte seriozisht për ndërmarrje ekonomike në rang individual apo në rang shtetëror. Nga ana tjetër politikat e shteteve fqinjë kishin qenë të tilla që me anë të pretendimeve të njëpasnjëshme ia kishin dalë ta mbanin peng zhvillimin ekonomik të vendit për hir të interesave politike me të cilat Shqipëria përballej në kufijtë e jugut dhe të veriut.

Me një fjalë, Shqipërisë i kishte munguar stabiliteti, pra, qëndrueshmëria shtetërore dhe shoqërore, që është shtylla bazë e zhvillimit të një vendi. Kabinetet qeveritare ishin ndërruar shpesh dhe kishin pasur pikëpamje të ndryshme në lidhje me zhvillimin ekonomik. Këto sjellje të ndryshme politike ose i kishin lënë në mes reformat e ndërmarra, ose nuk u kishin dhënë kohë të mjaftueshme ministrive të hartonin ndonjë strategji kombëtare të zhvillimit ekonomik. Pavarësisht se misionet e ardhura nga vendet e huaja deri para viteve ‘20 piketuan shenja të mundshme të zhvillimit ekonomik në zona të ndryshme të Shqipërisë, shtetet e tyre përkatëse nuk kishin qëndruar mjaftueshëm në vend për t’i shfrytëzuar ato. Deri pas Luftës së Parë Botërore gjasat për zhvillim ekonomik në vend dhe rritje të nivelit të mirëqënies ishin të pakta.

Në fillim të dekadës së tretë të shekullit të kaluar ekonomia shqiptare bazohej kryesisht në bujqësi, blegtori, pak në tregëti, shumë pak në industri dhe një pjesë e vogël e të ardhurave të vendit vinin nga emigracioni. Këto të fundit, pavarësisht shifrave modeste që kishin, mbartnin vlerë ekonomike të konsiderueshme (në vitet ‘30 shqiptarët në Shtetet e Bashkuara u dërgonin familjeve të tyre më shumë se 800. 000 dollarë në muaj [12]). Pavarësisht vlerave si kjo apo si ato që do të paraqiten në vijim të këtij punimi, qeveritë e ndryshme që pasuan njëra-tjetrën gjatë këtyre viteve nuk ia dolën të ndryshonin shumë prej strukturave të mëparshme në vend. Arsyeja kryesore ishte që nevoja për reforma në vend nuk mund t’i mbijetonte konservatorizmit turk të ngulitur thellë në pozitat shoqërore. Shtresat e pasura ndiheshin aq të sigurta në pozitat ekonomike që gëzonin, sa nuk i

konsideronin investimet një formë të besueshme për përmirësimin e vet financiar. Mungesa e komunikimit mes tyre dhe tregtia e cunguar që pasoi nga kjo gjendje nuk e kapërcyen cakun e traditave primitive dhe mungesës së bashkëpunimit. Kjo, bëri që idetë e reja që erdhën nga jashtë me kthimin e emigrantëve shqiptarë, të mos gjenin përkrahje mes atyre që kishin vërtet në dorë mundësi financiare dhe pozita shoqërore që t'i jepnin shtysë zhvillimit ekonomik. Idetë e reja që erdhën prej përtej kufijve u dukën shumë të guximshme për një vend që kishte shekuj që flinte në prapambetje. Shumë prej tyre, së bashku me investime të tjera të huaja të planifikuara herë pas here, nuk arritën kurrë të merrnin formë.[24]

Në faqet që u shkruan për ekonominë e Shqipërisë dhe ndryshimet që ajo pësoi gjatë njëzet viteve të shekullit të kaluar vizitorët, gazetarët, historianët dhe ekonomistët britanikë dhe amerikanë u kanë lënë hapësirë të mjaftueshme përshkrimeve të gjendjes ekonomike, analizave rreth politikave të vëna në jetë nga shteti shqiptar, pa anashkaluar sugjerimet për fusha të caktuara të interesit ekonomik në vend. Shumica prej tyre, qoftë edhe ata që nuk ishin ekspertë të mirëfilltë në fushën e ekonomisë, u përpoqën të hulumtonin shkaqet pse zhvillimi ekonomik shqiptar nuk mori hov të mjaftueshëm në vend pavarësisht periudhës së gjatë që pati në dispozicion, pavarësisht burimeve natyrore që Shqipërisë nuk i mungonin dhe depozitave financiare që ekzistonin brenda vendit apo ato që hynë në arkën e shtetit shqiptar në formën e huave. Argumentet e mëposhtme paraqesin në mënyrë të detajuar përsiatjet e tyre rreth çështjeve të mësipërme.

I. Infrastruktura rrugore dhe transporti – faktorë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e zhvillimit ekonomik

Kur profesor Albert Kalme (Albert Calmé) i raportoi Lidhjes së Kombeve në lidhje me gjendjen ekonomike të Shqipërisë në shtator 1922, ai vuri re se sistemi rrugor i vendit ishte një pengesë që e tejkalonte tiparin infrastrukturor. *“Në pikpamjen politike”*, shkroi ai, *“Shqipëria mund të quhet një shtet, por ekonomikisht ai është ende larg të qenit një njësi; ajo është një koleksion pa lidhje i zonave ekonomike dhe tregjeve lokale. (...) Problemet që sjell me vete kjo gjendje nuk është e nevojshme të vihen në dukje (...) ajo i bën shqiptarët të huaj për njëri-tjetrin.”*[6] Vërejtja e tij nuk mund të quhej e pavend; në fakt, infrastruktura rrugore në Shqipëri linte shumë për të dëshiruar. Ato pak rrugë të shtruara në periudhën në fjalë ishin filluar nga ushtritë austro-hungareze gjatë Luftës së Parë Botërore. Ishin ata që ndërtuan “bërthamën e një sistemi inxhinierik rrugor për përdorimin e transportit motorik.”[20] Ato përbënin nevojën më të madhe në vend jo vetëm për përmirësimin e transportit dhe zhvillimin e tregëtisë, por edhe “për të bashkuar vendin në një njësi politike dhe kulturore”. [20] Vendi kishte nevojë për një komunikim më të madh midis veriut dhe jugut, lindjes dhe perëndimit dhe në këtë aspekt shteti kishte shumë për të bërë.

Në vitin 1922 Shqipëria kishte vetëm 500 km rrugë të pashtuara siç duhet, të ndërtuara pa një sistem të mirëfilltë, pa kanale kulluese dhe shumë pak të rrahura nga trafiku. [6] Mbi Shkumbin rrugët ishin shtigje të ngushta ku kafshët e ngarkuara mezi kalonin. Rruga e vetme kryesore Shkodër-Lezhë kishte vite pa u

rikonstruktuar. Në Kukës ajo takohej me një rrugë tjetër, vazhdonte në jug përgjatë Drinit të Zi, kalonte në Peshkopi dhe pastaj i linte territoret gege për të përfunduar në Ohër dhe Korçë. Pjesë të kësaj rruge u zgjeruan për trafik makinash në 1929, por nuk mundën të bashkohen deri në ardhjen e trupave ushtarake gjatë pushtimit Italian. Një tjetër rrugë dilte nga Tirana për te Guri i Madh në Mat, në Bulqizë dhe përfundonte në Peshkopi. Vendasit e konsideronin këtë, rrugën kryesore që lidhte kryeqytetin me zonat verilindore.

Pjesa tjetër e rrugëve ishin ose të pakalueshme në periudha të gjata dimri, ose shumë të dëmtuara për përdorim makinash. Në to mallrat dhe njerëzit mund të transportoheshin vetëm me anë të kuajve dhe karrocave të tërhequra nga qe. Këtë mënyrë tepër të ngadalë udhëtimi që merrte ditë dhe u kushtonte lodhje të madhe udhëtarëve Xhozef Suaiër (Joseph Swire) (gazetar i The Near East 1929 -1937) e përshkroi duke shkruar: *“Ka diçka satanike te këta qe të mëdhenj, të zinj (...) që ecin me një ngadalësi të patrazuar (...). Karrot që ata tërheqin rënkojnë ngaqë rrotat luhaten aq shumë sa të vjen çudi tek i sheh që qëndrojnë ende në këmbë. Kërcitja e tyre të vjen natyrshëm si një protestë tinguish orientale që thonë fjalën e tyre kundër zhvillimit.”*[22] Aty ku rrugët ndërpriteshin nga lumenj, malësorëve u duhej të futeshin në ujë deri në brez apo edhe me lart për të gjetur një kalim të cekët që t'i çonte në anën tjetër. Urat ishin të rralla dhe të gjitha prej druri. *“E kam kaluar një urë që ishte ndërtuar vetëm me dy dërrasa,”* shkroi Karleton Kun (Carleton Coon) për udhëtimin e tij të vitit 1930, *“njëra për të ecur dhe tjetra e mbërthyer pak më lart për t'u mbajtur.”*[7] Më vonë kjo ndryshoi; urat që u ndërtuan në kuadër të rikonstruksionit të segmenteve rrugore në vend e ndihmuan lëvizjen e shpejtë të njerëzve dhe mallrave. Numri i urave ndryshoi ndjeshëm nga 360 (1921), në 2674 në vitin 1936.[12]

Tregtia e brendshme e vuanë më shumë se çdo aspekt tjetër ekonomik mungesën e rrugëve të përshtatshme. Nëse tregu gjirokastrit kishte nevojë për lëkurë, tregtarët vendas i importonin ato nga Italia; kjo ndodhte në të njëjtën kohë kur Shkodra prodhonte lëkurë me shumicë dhe i eksportonte ato në Itali. Përvojat ishin të ngjashme edhe me vajin e ullirit dhe drithërat. Prof. Kalme vuri re se në disa prej zonave ku këto produkte prodhoheshin me shumicë, fshatarët kultivonin aq sa nevojitej për të plotësuar nevojat e tyre, sepse nëse prodhonin më shumë, pjesa tjetër mbetej stok në pamundësi të transportit të sasive shtesë në tregjet e afërta. Qeveria shqiptare kishte kohë që e kishte kuptuar se mungesa e sistemit rrugor nuk kishte thjesht funksion ekonomik në vend. Ajo lidhej drejtpërdrejt edhe me ndarjet politike, gjeografike dhe ishte shkak për përçarjet që karakterizonin unitetin kombëtar në vend. Meqenëse vetë qeveria kishte buxhet shumë të kufizuar ose nuk kishte fare për të mbuluar këtë zë të investimeve, Ahmet Zogu iu drejtua italianëve, të cilët e mirëpritën idenë, duke qenë se kjo ishte një mundësi e mirë për shtrirjen e ndikimit të tyre edhe në brendësi të Shqipërisë. Kjo ishte arsyeja përse shumë prej rrugëve që u ndërtuan në vitet 1920-1939 paraqesnin “prioritetet italiane” duke qenë se iu drejtuan kufirit me Greqinë dhe Jugosllavinë[26] dhe të pakta ishin ato që krijuan pika lidhjeje mes Shqipërisë jugore dhe asaj veriore. Pas marrjes së huasë nga qeveria italiane dhe përcaktimit të vlerës së buzhetit që do të shpenzohej për rrugët,

Gjenerali Malieta (në atë kohë Drejtor i Përgjithshëm i Xhenjos Ushtarake Italiane) u ngarkua të hartonte një skemë të ndërtimit të rrugëve dhe mbikëqyrja e realizimit të saj iu caktua kapitenit Gornbino. Suaiër e interpretoi në mënyrën e mëposhtme përfshirjen italiane në këtë drejtim pa dashur t'i japë të drejtë reagimeve jugosllave për faktin që sistemi rrugor kishte si pikësynim depërtimin e ushtrive italiane gjatë gjithë shtrirjes territoriale të Shqipërisë. “*Sistemi i projektuar i rrugëve udhëhiqej vetëm nga karakteristikat gjeografike dhe nga nevojat ekonomike – ekzistuese apo të parashikuara. Nën sovranitetin turk udhëheqësit shqiptarë u kishin kërkuar vazhdimisht turqve rrugë në malësi – megjithëse disa prej fiseve e kishin kundërshtuar ndërtimin e tyre, sepse kjo do lejonte futjen e artilerisë në male – dhe ishte krejt e natyrshme që shqiptarët të kapnin rastin më të parë, për të siguruar ato rrugë që turqit nuk ua kishin dhënë kurrë. Ishte po kështu e natyrshme që portet e vogla që gjendeshin pranë trungut kryesor të rrugëve bregdetare të lidheshin me të, duke i dalë përpara zhvillimit të tregëtisë dhe peshkimit.*” [21]

Pas vitit 1933, transporti rrugor përshkruhet disi më i përmirësuar nga ata që e vizituan Shqipërinë. Në vazhdë të nismave të saj për modernizimin e vendit, qeveria kishte marrë masa për shtrirjen e mëtejshme të rrjetit rrugor të filluar nga austro-hungarezët. Fondet për punët e krahut thuajse mungonin dhe nuk ishte e lehtë t'i bindje shqiptarët të punonin pa pagesë, qoftë edhe për të mirën e tyre. Prandaj, kabineti iu duk e arsyeshme të vinte në përdorim një sistem tjetër pune. Bernard Njuman (Bernard Newman), i cili e vizitoi Shqipërinë me biçikletë dy herë gjatë viteve '30 vuri re se shqiptarët bënë punë vullnetare dhe megjithëse kjo nuk ishte shkruar në ndonjë ligj, [23] ky aktivitet plotësoi një pjesë të forcës punëtore që nevojitej për krijimin e veprave publike. Me anë të një sistemi të quajtur *corvée*, shtetasit shqiptarë ishin të detyruar “*të punonin gjashtë ditë në vit për ndërtimin e rrugëve, ose të paguanin taksat respektive; fiset e veriut që njiheshin për praktikën e tyre me revolucionare kishin më shumë detyrime në këtë drejtim.*” [19] Por gjashtë ditë punë në vit nuk e shndërronin një bujk në një punëtor të specializuar rrugë dhe përveç pengesave të tjera të menaxhimit dhe ndarjes së punëve, kjo sillte me vete një cilësi shumë të dobët punimi. Për këtë u sugjerua edhe përdorimi i forcave të ushtrisë për ndërtimin e rrugëve (me justifikimin se 12-24 muaj shërbim ushtarak ishte një periudhë e gjatë që e mbante forcën më produktive të vendit larg frontit të punës). Nëse ushtrisë i besohej ndërtimi i rrugëve nën mbikëqyrjen e inxhinierëve të specializuar, ajo mund të justifikonte buxhetin që shteti harxhonte në mbajtjen e saj. Në fakt ushtarët u përdorën rrallë për ndërtimin e rrugëve. Rindërtimi i rrugës Tiranë – Shkodër dhe pajisja e segmentit Durrës - Vlorë me pjesë që lidhnin rrugën kryesore me Beratin dhe Elbasanin i kushtoi qeverisë jo pak të ardhura nga buxheti. Po kështu, rëndoi në buxhet edhe rruga Durrës–Elbasan - Korçë, ndërtimi i të cilës pati për qëllim lehtësimin e lidhjeve tregtare midis Durrësit, Manastirit dhe Selanikut. [19]

Megjithatë që t'i quaje ato pak kilometra të shtruar, rrjet i mirëfilltë transporti, do të nevojitej diçka më shumë sesa thjesht puna e krahut të njerëzve që u përdorën për t'i ndërtuar. Mbi to nuk lëviznin fare ose lëviznin shumë rrallë mjete motorike dhe deri në vitin 1923 në Shqipëri mjetet e transportit ishin thuajse ende

primitive. Me përjashtim të tre Fordeve të lënë pas nga një mision amerikan ndihmash, [11] transporti kryej me anë të kafshëve, qerreve ose në këmbë. Në qytete, automobilat përdorehin aty-këtu vetëm nga personat që e kishin njëfarë statusi shoqëror dhe mundësi financiare për t'i mbajtur. Në vitin 1938, nëpër rrugët deri diku të riparuar qarkullonin rreth dymijë makina. [24] Zotërimi i një biçiklete ishte një mundësi që vetëm një pjesë e vogël mund ta përballonte. Kur biçikleta e parë arriti në Mat në 1936 gratë thirrën nga frika, megjithëse syri u ishte mësuar me “zogjtë e argjendtë” të *Ala Littoria-s* që fluturonin mbi majat e maleve. Transporti ajror u mundësua për herë të parë nga kompania gjermane *Adria Aero Lloyd*. Jo shumë kohë pas themelimit, duke qenë se kostot po i tejkalonin fitimet e kësaj kompanie, ajo u detyrua të reduktonte shpenzimet e saj në minimum duke punësuar vetëm një menaxher, një sekretare, dy pilotë, dy mekanikë, të cilët kujdeseshin për

“Realizimi i linjave të mëposhtme hekurudhore në një të ardhme të afërt është një mundësi që nuk ka pse të mbelet në letër. E para mund të lidhë bregun adriatik shqiptar me linjën qëndrore Beograd – Selanik (...); një tjetër mund të fillojë në Shkodër të ecë përgjatë luginës së Drinit për në Prizren dhe pastaj të vazhdojë në Shkup (...) vetëm 50 km nga kufiri shqiptar. Tjetër mund të fillojë në Vlorë dhe të arrijë në Korçë përmes Devollit e të vazhdojë në Manastir e më tej në Selanik. E mundshme është edhe një linjë tjetër që do të bashkojë Durrësin me Tiranën dhe, duke u shtrirë përmes luginës së Shkumbinit, të arrijë në Strugë.”

Albert Kalme, 1922

lidhjeje midis këtyre qyteteve një monoplan gjerman me një motor që valëzonte dy krahë alumini dhe që mund të transportonte katër pasagjerë. Më vonë ky tip u zëvendësua me biplanin *Havilland*, që kishte edhe dy vende më shumë. [17] Shqipëria ishte një ndër vendet e pakta ku linjat ajrore u kishin paraprirë linjave hekurudhore. Përsa u përket këtyre të fundit do të duhej ende shumë kohë që ato të bëheshin një mjet udhëtimi normal i shqiptarëve.

Deri në vitin 1922, traseja ishte mjeti i fundit i transportit që mund ta ndihmonte ekonominë shqiptare. Relievi i thyer i vargmaleve ishte (përveç kostos së lartë) një arsye pse hekurudha mbetej e fundit në listën e detyrimeve qeveritare përsa i përket transportit. Në Shqipëri ekzistonte një sistem linjash të ngushta hekurudhore,

dy aeroplanë. Ajo kishte preferuar t'i kufizonte oraret e udhëtimeve nga ora 7.00 deri në orën 9.00 në mëngjes, moment ky, kur rrymat ajrore mbi male ishin të qeta. Kjo masë paraprake e kishte ndihmuar deri atëherë të mënjanonte mjaft aksidente të mundshme. Në vitin 1927 kompania u ble nga italianët të cilët morën nga qeveria shqiptare të drejtën ekskluzive të transportit ajror në Shqipëri. [18] *Ala Littoria* vazhdoi transportin e rregullt në linjat ajrore që lidhnin aeroportin e Tiranës jo vetëm me Selanikun dhe Brindisin, por edhe me disa nga qytetet kryesore të Shqipërisë, Shkodrën, Vlorën, Korçën. Në to qeveria ndërtoi pista të pashtuara për shërbimin ajror postar dhe për transportin e pasagjerëve. [24] Në vitet 1930-1931 kjo kompani vuri në përdorim si linjë

i ndërtuar nga austriakët gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri. Ato quheshin “Decauville”¹ dhe shtriheshin nga Shkodra në Durrës, Lushnjë dhe Berat (madje kishin edhe disa degëzime për në Tiranë). Ndonëse të amortizuara, në vitet ’20 ato vazhdonin të përdoreshin kryesisht për transportin e materialeve të ndërtimit të segmenteve rrugore që u riparuan përgjatë tyre. Gjendja më tipike e linjës ekzistuese hekurudhore përshkruhet si më poshtë: “*Një linjë e ngushtë zgjatej anës pjesës më të madhe të rrugës që lidhte Shkodrën me Tiranën. Ishte aq e lënë pasdore sa dukej sikur nuk e kishin përdorur për një kohë shumë të gjatë. Në një stacion flinin një gjysmë dyzine lokomotivash të dala nga përdorimi dhe të mbuluara me ndryshk. (...) Mesa duket linja ishte prishur nga austriakët gjatë tërheqjes së tyre në fund të Luftës; megjithatë rivënia e linjës në punë nuk do të kërkonte ndonjë fond marramendës.*” [9]

Për të kompesuar mungesën e transportit rrugor dhe atij hekurudhor Xhozef Rousek (Joseph Roucek) (1933) sugjeroi përdorimin e rrugëve detare si mënyrën më të dobishme të lëvizjes nga veriu në jug, nga porti i Shëngjinit, në Durrës, në Vlorë e deri në Sarandë, megjithëse portet dhe limanet ishin thuajse të pakonsiderueshëm përgjatë bregdetit shqiptar. Suaiër (1937) vuri në dukje se për të shkuar nga Tirana në Vlorë, në fillim të viteve ’30, preferoheshin tre tragete të vegjël primitivë; kjo, sepse urat mbi Shkumbin, Seman dhe Vjosë që do të mundësonin lëvizjen në rrugë tokësore për në jug të Shqipërisë ishin ende në ndërtim e sipër. [22] E drejta e përdorimit të linjave detare u ishte dhënë kompanive italiane (Pulia dhe Trieste – Lloyd) dhe kompanive jugosllave. Tre prej tyre hynin rregullisht në portet shqiptare, ndërkohë që gjashtë të tjera ankoroheshin në intervale kohe më të gjata. [20] Ndërkohë qeveria shqiptare po merrte në konsideratë krijimin e një kompanie detare vendase financimi i të cilës të bëhej kryesisht nga vetë shteti dhe pjesërisht nga vlera koncesionare e një shoqërie minierash. [6]

II. Ndërmarrjet finaciare të qeverisë së Ahmet Zogut

“Shqipëria mori nga Italia në formë huaje më shumë se 50.000. 000 dollarë; një shumë mjaft e madhe për një shtet të vogël dhe të varfër, me vlerë tëtë ardhurave kombëtare vetëm 5. 000. 000 dollarë.” [16]
Bernard Njuman

Nga vëzhgimet e tij në vend në vitin 1921 profesor Kalme konstatoi se shqiptarët jetonin një jetë në caqet e modestisë dhe sado pak të ardhura individuale të kishin ia dilnin të mblidhnin kapital sepse kishin natyrë mjaft kursimtare. [6] Cilado qoftë sasia e kapitalit, ky i fundit ishte gjithmonë në ar. Si rrjedhim, Shqipëria kishte depozita të konsiderueshme floriri, të cilat sipas Kalmesë ishin vlerësuar deri atëherë në shifra të ndryshme midis 50. 000 dhe 100.000 frangash ari, pa përfshirë këtu arin e investuar në bizhu. Nëse kjo sasi investohej, do të mjaftonte për ta vendosur zhvillimin ekonomik të Shqipërisë në shina të shëndosha. Por, ekonomistët e huaj nuk e shihnin këtë pasuri si mjetin që do ta shpëtonte Shqipërinë.

¹ Termi *Decauville* u përdor për t’iu referuar shinave portative me përmasa (0. 40- 0. 60m) për transportin në distancë e përdorur në ndërmarrjet e punimeve publike, e krijuar për herë të parë nga industrialisti frances Paul Decouville.

Koncepti i bankave dhe i llogarive bankare në fillim të viteve '20 në Shqipëri ishte një risi për shqiptarët e shtresës së mesme dhe të lartë. Gjendja e pastabilizuar që

“Shqipëria nuk ka një sistem kombëtar monedhash metalike apo kartmonedhash. Ngjësia që përdoret në llogaritë publike është franga e ari. Në marrëdhëniet tregëtare të jetës së përditshme përdoren napoleonat dhe koronat. Napoleonat kanë vlerë 20 franga ari. (...) Monedha që gjendet gjerësisht në përdorim është monedha e Bashkimit Latin dhe monedhat austriake me 8 florina. Koronat janë monedha argjendi austriake (...) pranohen për pagesa që arrijnë një vlerë të caktuar (...). Vlera e tyre varion në varësi të numrit të koronave që nevojiten për të vlerësuar një napoleon. Zakonisht ndryshon nga 44 deri në 58 korona; për momentin (shën. i përkth. 1921) ajo arrinte 52 deri 54. Monedhat e bakrit janë kryesisht italyane. Përsa u përket kartmonedhave, në bregdetin shqiptar përdoren lirat, kurse drahmitë nuk përdoren më as në pjesë jugore të vendit. (...) Në një fjalë edhe pse në Shqipëri nuk ka një monedhë kombëtare të njohur nga shteti, vendi e ka ruajtur mirë standardin e përdorimit të ari në vlerë monetare; kjo e ka bërë të pandryshuar vlerën e argjendit dhe të kartmonedhave. Në këtë mënyrë Shqipëria është një nga pak shtet evropiane ku monedha qarkullon e sigurt në treg.”

Albert Kalme, 1922

politika shqiptare kishte jetuar për një kohë të gjatë e kishte mësuar shqiptarin të mos kishte besim në ndërmarrjet financiare që i kalonin caqet e iniciativave personale. Përfitimet e depozitimit në bankë të një thesarit të groposur ishin padyshim më frytdhënëse; megjithatë shtetit i duhej të ndërmerre politika të posaçme për të nxitur besimin e individit në depozitimin e kapitalit të tij. Në këtë kuadër u sugjerua krijimi i një banke nën drejtimin e të huajve, strategjitë e së cilës do të mbroheshin me një marrëveshje të veçantë; kjo

marrëveshje duhej të përjashtonte çdo mundësi që shteti të përfshihej drejtpërdrejt apo tërthorazi me kapitalin privat të depozituar aty. Strategjia parashikonte rritjen e besimit të shqiptarëve edhe në nivel aksionesh dhe krijimin e shtigjeve për investime të përbashkëta të kapitalit shqiptar dhe atij të huaj. Përveç Bankës Kombëtare në fillim të viteve '20, u sugjerua edhe krijimi i një Banke Kursimesh, si kusht themelor për ta përqasur konceptin që shqiptarët kishin për kursimet vetjake me ato të konceptit modern. Një bankë e tillë do t'i nxiste shqiptarët të investonin dhe do t'i forconte pozitat financiare të shtetit shqiptar në masën e sigurimit të një fondi të konsiderueshëm për ndërmarrjen e politikave dhe hartimin e strategjive ekonomike.

Në fillim të vitit 1922, megjithë përpjekjet e qeverisë për të kufizuar shpenzimet, buxheti trashëgoi një deficit prej afërsisht 2.448. 342 frangash ari nga viti i mëparshëm. Kjo erdhi kryesisht nga fakti që shpenzimet e Ministrisë së Mbrotjtjes i kishin kaluar 9.000. 000 frangat e caktuara në buxhet, nga të cilat vetëm çarmatimi i popullsisë kishte kushtuar 123. 000 franga ari.[6] Megjithëse qeveria e përdorte ngritjen e taksave si një strategji për plotësimin e deficitit, ky i fundit fatkeqësisht vazhdoi t'i rëndonte buxhetit shqiptar për një kohë të gjatë. Kjo vazhdoi edhe një

dekadë më pas.Ronald Mathius (Ronald Matthews) (udhëtar i viteve 1935 - 1937) fajësoi për këtë faktin që qeveria nuk kishte ndërmarrë strategjinë e duhur për mbledhjen e taksave në vend. Ai vuri re se taksat e vetme që mbledheshin në vend ishin ato që merreshin nga të varfrit, taksa e të dhjetës dhe ajo e bagëtive. Për vitin 1936 të ardhurat nga taksat në vend ishin vetëm 79. 000 franga ari nga 15.000. 000 që zinte i gjithë buxheti. Taksën mbi pronën zor se e paguanin më shumë se një gjysmë dyzine personash në të gjithë Tiranën.[14]

Shqipëria iu drejtua disa herë Lidhjes së Kombeve për të marrë prej saj një hua financiare, por kjo e fundit e gjykoi situatën në vend si të papërshtatshme, sepse “(...) *reforma e organizimit të brendshëm ekonomik dhe administrativ ishte një prelude i domosdoshëm për ndihmë financiare, që përndryshe do t’i lehtësonte vetëm përkohësisht vështirësitë e Shqipërisë dhe do ta rëndonte atë me barrën e borxhit kombëtar*”[22]. Në këto kushte, qeveria u detyrua të ndërmerre masa për reduktimin e shpenzimeve në shtet, themelimin e një banke dhe nxitjen e tregëtisë për të reduktuar hendekun që ekzistonte midis importeve dhe eksporteve në Shqipëri. U ndërmorrën madje të gjithë hapat e mundshëm për rritjen e kursimeve dhe, për të marrë një shembull, “ceremonitë e martesës që deri atëherë zgjasnin shpesh një javë me pjesëmarrjen e një numri të pakufizuar të ftuarish, u shkurtuan me ligj deri në njëzet e katër orë dhe numri i të ftuarve u kufizua në dymbëdhjetë.”[22]

Në vitin 1923 në Shqipëri mbëriti në funksionin e këshilltarit për administrimin e financave Jan Hunger, një ekspert hungarez. Ai përshkruhet si “*një njeri i ftohtë dhe nga natyra i mbyllur në vetvetë*”, dhe si i tillë, “*e shqyrtoi gjendjen ekonomike të vendit gati në vetmë*”[13]. Nuk u përpoq të fitonte besimin e shqiptarëve, por ia doli të argumentonte se situata ekonomike ishte alarmante. Pas qëndrimit të tij në Shqipëri për disa kohë, ai vuri re se në janar të vitit 1924 situata financiare e vendit ishte jashtëzakonisht e pakënaqshme dhe se, po të mos bëheshin kursime të mëtijshme, të rrepta, çorganizimi i plotë i sistemit financiar do të ishte i pashmangshëm. Si masa për të shpëtuar situatën ai propozoi “*një rritje të tatimit të shkallëzuar ekzistues mbi të ardhurat (që klasat e pasura mund ta përballonin mjaft mirë) (...), një pakësim të numrit të zyrtarëve dhe deputetëve (...), dhe likuidimin e ushtrisë e cila ishte tepër e vogël dhe e pamjaftueshme për t’i bërë ballë një agresioni të huaj*”[22]. Në gjendjen aktuale duke qenë se fshatarësia, që siç u tha më sipër jetonte në nivele jetese nën standardet minimale, paguante 76, 2% të taksave. Kjo ishte e papranueshme për ekonominë e vendit dhe Hungeri sugjeroi që “pronarët e pasur myslimanë të tokave, të cilët kontrollonin 80% të tokës më të mirë të vendit dhe paguanin vetëm 6% të taksave, të detyroheshin të merrnin përsipër një barrë më të madhe”. [10] Me një fjalë ai sugjeronte që qeveria të taksonte shtresën shoqërore që mund të paguante. Megjithatë rekomandimet e tij ishin të thjeshta dhe lehtësisht të praktikueshme, qeveria shqiptare ndoqi shumë pak prej tyre. E gjendur në oponencë të plotë me bejlerët e tokave të cilët e kishin mbështetur për të ardhur në pushtet, ajo preferoi të anashkalonte një pjesë të mirë të sugjerimeve të mësipërme.

Disa vjet më vonë, Ahmet Zogu, atëherë president, e kuptoi se zhvillimi ekonomik i vendit nuk do të realizohej nëse ai nuk siguronte një hua dhe nuk themelonte një bankë shqiptare. Çështja e vendit nga i cili do të tërhiqej huaja ishte e

nxehtë sepse vendet e gatshme për dhënien e saj ishin të gjitha të përfshira në interesa politike me Shqipërinë. Sipas Suaiërit, Jugosllavia kishte si pikësynim “*ta pengonte zhvillimin e Shqipërisë në një vend të fuqishëm e të pavarur, i cili do t’i zinte asaj rrugën drejt ngushticës së Otrantos*”[22]. Si rrjedhim, dhënia e një huaje nga ky shtet do të ishte e pamundur. Nga ana tjetër, Italia ishte e gatshme që të investonte në Shqipëri për të shtrirë në mënyrë të justifikueshme ndikimin e saj mbi këtë vend. Bisedimet për hapjen e bankës shqiptare filluan gjatë pranverës së vitit 1925 dhe në fund të qershorit u mirtua ligji me të cilin *Il Credito Italiano* merrte koncesionin për krijimin e Bankës Kombëtare të Emetimit dhe Kredisë, që do të funksiononte si thesar i qeverisë shqiptare. Banka drejtohej nga një bord tërësisht italian me përjashtim të përfaqësuesit të vetëm shqiptar në të Tefë Curani; selia e saj qendrore ishte në Romë, ndërkohë që zyrat kryesore ishin në Shqipëri. Banka kishte degë në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Korçë. Kur po diskutohej për formimin e korporatës bankare, u tha se 51% e aksioneve do të qëndronin në palën shqiptare. Megjithatë duke qenë se personat e interesuar shqiptarë kishin lidhje të drejtpërdrejta me bankat italiane, në fund u vendos që do të ishte Italia ajo që kontrollonte interesat e Bankës Shqiptare. Ndër vendet e tjera që u ftuan të merrnin pjesë në korporatë Zvicra dhe Belgjika pranuan të blinin një numër të vogël aksionesh; bankat jugosllave u ofruan më vonë. Në këtë mënyrë aksionet e bankës shqiptare u ndanë në raportet e mëposhtme:

“Italia -----	320.000 (53% të aksioneve)
Jugosllavia -----	50. 000
Zvicra -----	50.000
Belgjika -----	25.000
Shqipëria -----	150.000
TOTALI	595.000” [18]

Xhozef Suiaër ishte i mendimit se banka ishte në thelb një biznes Italian sepse edhe kartmonedhat që u vunë në qarkullim prej saj me një vlerë prej 2. 657. 000 frangash ari në vitin 1927 nuk mbanin nënshkrimin e zyrtarëve përkatës shqiptarë. Megjithatë ajo pati vlerë sepse unifikoi sistemin e kartmonedhës në vend duke emetuar më vonë kartmonedha me vlerë 100, 20, 5 dhe 1 franga dhe monedha metalike me një vlerë prej 455. 000 frangash ari. “*Gjatë vitit 1926 qindarka, leku dhe franga e arit kapën vlera përfundimisht të prekshme (...): 100 qindarka për 1 lek dhe 5 lekë për 1 frangë ari shqiptare. (...) kartmonedha një-frangëshe dhe monedha dy-frangëshe mbanin të stampuar shqiponjën romake në vend të dykrerëshes shqiptare. Simbolika ishte mëse e qartë. Banka kombëtare shqiptare ishte një bankë italiane që vepronte përtej detit sipas ligjeve italiane.*”[24]

Gjatë tetëmbëdhjetë muajve të parë veprimtaria e bankës bëri të mundur të shpërndahej një dividendi prej 5% për aksionet e zakonshme, për bordin e drejtorëve dhe një shpërblim prej 10 për qind për personelin, duke mbartur ndërkohë, 2.259 franga.[22] Monedha 20-frangëshe peshonte 6. 34161 gram me një tolerancë prej 1.29%. Kartmonedhat e lëshuara nga banka kishin vlerën e pesë, njëzet dhe njëqind

franga ari, kurse monedhat në qarkullim kishin vlerën e një leku, gjysmë leku, çerek leku, kur dihej që një lek kishte vlerën e një të pestës së frangës së arit ose njëzet qindarkave. [25] Emetimi i kartmonedhës ishte një mundësi që shteti shqiptar të mund të legalizonte një vlerë të caktuar të këmbimit valuator, gjë që do ta përjashtonte plotësisht përdorimin e kartmonedhave të vendeve të tjera në marrëdhëniet e zakonshme tregtare brenda territorit shqiptar. Shumë nga ndryshimet që ndodhën në Shqipëri në dekadën e tretë të shekullit të kaluar iu kushtuan huave të njëpësnjëshme që ekonomia shqiptare i pranoi krahëhapur nga qeveria italiane. Në vitin 1925 qeveria shqiptare mori hua 60 milion franga ari dhe 100 milion të tjera në vitin 1931. Me anë të tyre u bë i mundur rikonstruksioni i një pjese të mirë të segmenteve rrugore të përmendura më sipër, “ndërtimi i 60 urave, rikonstruksioni i portit të Durrësit dhe (...) vënia në punë e një linje ajrore që lidhte Shkodrën, Tiranën, Vlorën dhe Korçën. Vlera e frangës së arit u fiksua në £1 = 25.2215 franga ari (= \$4. 86); deri në vitin 1931 vlera e saj në shkëmbimin valutor ndryshoi një £1= 15 franga ari”. [24]

Huatë e dhëna nga Italia duhej të shpenzoheshin nën mbikqyrjen e një korporate italiane që u quajt SVEA (*Societa per lo Svilupo Economico Albania* - Shoqëria për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë). Si shenjë garancie për huatë, monopolet e shtetit shqiptar kaluan nën kujdesin italian dhe kompanive italiane iu dhanë koncesione për shfrytëzimin e pyjeve dhe të pasurive minerale; këto masa ekonomike kishin patjetër një ngjyrim politik. [5] Kushtet e dhënies së huasë, vlera e saj dhe mënyra e shpenzimit të parave ishin një ndër çështjet të cilat Xhozef Suiër i trajtoi me kujdes në librin e tij “*Shqipëria: Ngritja e një Mbretërie*” të botuar për herë të parë në vitin 1929. Sipas autorit qeveria shqiptare mori një hua prej 2.000. 000 stërlinash, që iu dha nëpërmjet grupit të mësipërm tregtar italian (SVEA) të krijuar enkas për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare midis të dy vendeve nga një grup bankash italiane dhe nga Instituti i Këmbimeve. Në dukje kjo ishte një shumë që i kapërcente kufijtë e mundësive shqiptare për të paguar interesat vjetore të cilat ishin 224.000 stërlina, ndërkohë që buxheti shqiptar nuk i kalonte 900.000 stërlinat. Në fakt shuma do të qëndronte e depozituar në Itali (në Bankën Kombëtare Shqiptare), ndërkohë që shpenzimi i saj do të shtrihej në disa vite duke ngritur një interes vjetor “prej 67/8 përqind, që e ulte shumën e interesit të pagueshëm nga Shqipëria në 86. 500 stërlinë”. “Për më tepër, ” shpjegon Suaiër, “qeveria shqiptare, duke vepruar sipas këshillës së qeverisë italiane, e ktheu në lira huanë që i ishte livruar në franga ari, në një kohë kur vlera e lirës ndaj stërlinës ishte 1:140; ky veprim e rriti shumën e kredisë së saj deri në rreth 2. 800. 000 stërlina dhe e ngriti interesin e marrë nga huaja në 192. 000 stërlina duke e ulur nivelin e interesit të paguar nga Shqipëria në 32.000 stërlina.”[22]

“Objektet për të cilat do të shpenzohesh huaja, të përcaktuara në *Gazetën Zyrtare* shqiptare të 2 prillit 1926 dhe 27 prillit 1927, ishin si vijon:

£	
Hekurudha	-----
92. 000	
Rrugë	-----
--- 560.000	
Ura	-----
---- 264. 000	
Porte (okela, etj)	-----
--- 284. 000	
Ndërtesa	-----
--- 333. 000	

Në nëntor 1927, qeveria italiane e autorizoi SVEA-n që t'i livronte qeverisë shqiptare shumën e interesave të huasë që ishin mbledhur deri atëherë. Kjo i dha mundësi kësaj të fundit të shfrytëzonte përfitimet e huasë dhe t'i shpenzonte ato në mënyrë të arsyeshme duke qenë njëkohësisht e aftë të paguante interesat me të ardhurat e doganave shqiptare. Të gjithë autorët e mësipërm bien dakord në faktin që huaja italiane ishte një mënyrë e justifikuar e qeverisë italiane për ta shtrirë ndikimin e saj në Shqipëri. Ata ndajnë të njëjtin mendim edhe në faktin që huatë italiane ishin e vetmja mënyrë e qeverisë shqiptare për t'i mbijetuar nivelit të ulët ekonomik në të cilin gjendej Shqipëria, duke qenë se edhe Lidhja e Kombeve, siç u tha më sipër, e kishte gjykuar jo të arsyeshme t'i jepte Shqipërisë një mundësi zhvillimi ekonomik pa stabilizuar më parë gjendjen e saj politike. Vlerën ekonomike të huasë Suaiër e përmbloodhi si më poshtë në vitin 1929: “(...) *shqiptarët, duke përfshirë Ahmet Zogun, nuk mund të prisnin dhe nuk pritën ndihmë financiare të pashoqëruar nga një shkallë e caktuar kontrolli ekonomik, dhe nëse ky kontroll do të ushtrohet deri në një pikë, ai padyshim do të jetë i dobishëm. Nëqoftëse ai ushtrohet përtej kësaj pike, Shqipëria mund t'i drejtohet Lidhjes ose Jugosllavisë dhe për këtë Italia është e vetëdijshme; prandaj nuk ka të ngjarë që ajo ta ushtrojë këtë kontroll në atë shkallë*

“Kushtet e huasë përcaktojnë se para se të lidhet kontratë për ndonjë sipërmarrje, duhet shpallur nxjerrja e saj në ankand dhe se kompania italiane e njohur is SVEA (...), ushtron privilegjin e miratimit para nxjerrjes në ankand të çdo projekti si dhe parimin e ofertave; veç kësaj gëzon të drejtën të marrë vetë përsipër çdo repër ndërtimi me çmimin e dhënë nga ofruesi më i lirë. Kjo klauzolë në kontratën e lidhur me qeverinë i jep shoqërisë italiane ndikim shumë të madh në

që në mënyrë të pashmangshme do të shkaktonte pasojë shkatërruese.”[22]

I njëjti autor gjykon që, e nisur nga këndvështrimi i mësipërm, qeveria shqiptare i dha me të drejtë përparësi firmave italiane një zë në çdo sipërmarrje kombëtare të bazuar në kapitalin e huaj. Në vitin 1931, për shembull, Shqipëria u përball me një dimër me shira të rrëmbyeshëm të cilat nuk pushuan edhe gjatë periudhës së mbjelljeve. Fshatarët mund të punonin tokën vetëm një herë në vend të dy apo tre herëve të zakonshme. Për më tepër, vera që pasoi ishte e thatë për thujtë gjashtë muaj dhe të korrat nuk rezultuan ashtu siç duhej. Pesë të gjashtat e prodhimit shkoi dëm dhe qeveria u detyrua të importonte sasinë e nevojshme, 30.000 ton misër, që në një vit normal përbënte zërin e dytë të eksportit shqiptar. Në të tilla situata, qeveria ishte e detyruar të shtrinte dorën në një drejtim të jashtëm për të plotësuar një nevojë të ngutshme të ekonomisë së brendshme. Me një fjalë, kjo urgjencë që një shtyrje drejt Italisë që, fatkeqësisht për shqiptarët, kjo nuk rezultoi siç ishte parashikuar në fillimet e saj. Në përfundim të marrëveshjes mes dy shteteve rreth huasë financiare të vitit 1931 “*Italia e bëri të qartë se pagesat vjetore për Shqipërinë do të vareshin nga ecuria e bashkëpunimit të plotë dhe të sigurt teknik dhe politik midis dy qeverive, duke lënë të nënkuptohej se me pushimin e këtij bashkëpunimi do të ndalej edhe dhënia e këtyre të hollave*”. [10]

Mbreti Zog kishte ditur sesi ta tërhiqte kapitalin Italian në Shqipëri pa e rrezikuar drejtpërdrejt sovranitetin e vendit të tij. Në përvijim të huave të marra nga

SVEA pati edhe kërcënime të njëpasnjëshme që nëse shteti shqiptar nuk paguante borxhin që i kishte kësaj kompanie, shteti italian mund të kërkonte të drejtën mbi doganat shqiptare dhe mbi monopolet shtetërore brenda vendit. Në vitin 1933 qeveria shqiptare e pati të pamundur të mblidhte shumat e nevojshme për të paguar këstet e kredisë së mësipërme. Ahmet Zogu, atëherë Mbret i Shqiptarëve, përdori një sërë strategjish për të mos humbur mundësinë e një huaje tjetër nga vendi fqinj. Ai u mundua të reduktonte forcat ushtarake në vend, duke e ditur që një pjesë e mirë e tyre ishin nën mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të 100 oficerëve italianë; [24] me fjalë të tjera Zogu shpresonte që nëse forcat ushtarake reduktoheshin, qeveria italiane do të shqetësohej për uljen e ndikimit të saj në këtë fushë të rëndësishme që siguronte stabilitetin e brendshëm dhe të jashtëm të shtetit shqiptar. (Në atë periudhë Italia synonte reduktimin në maksimum të ndikimit jugosllav në bregun e Adritikut.) Megjithatë, ngjarjet e reja ndërkombëtare, sidomos ngritja e Hitlerit në Gjermani, i dhanë këtyre marrëdhënieve një prespektivë të ndryshme nga ajo e mëparshme. Tani nevojitej që, për të balancuar pushtetin e Gjermanisë së madhe, Italia të krijonte një aleancë me Francën, në kuadër të trashëgimisë së tyre latine. Sipas studiuesit Xhejn Toms (Jason Toms), kjo e detyroi Italinë t'i përmirësonte marrëdhëniet me Jugosllavinë, një aleatë të përhershme të mikes së saj, Francës. Për të fituar simpatinë e Francës, Italisë iu desh të mos i acaronte edhe më marrëdhëniet me Jugosllavinë. Për këtë ajo zgjodhi të qëndrojë indiferente ndaj Shqipërisë, si për t'i treguar rivalës së saj të vjetër në Ballkan se interesat e qeverisë italiane për fqinjin adriatikas i përkisnin së shkuarës. Për më tepër, duhej kuptuar se nëse Italia dhe Franca nuk e trajtonin siç duhej Jugosllavinë, atëherë kishte shumë të ngjarë që kjo e fundit të hidhej në krahët e Gjermanisë e cila po synonte krijimin e territoreve të reja të ndikimit të saj në Ballkan. Këto marrëdhënie të reja ndërkombëtare e vunë Shqipërinë në një pozicion të ri, fatkeqësisht jo shumë të favorshëm për të. Tani ajo po shihte që shtetet që dikur kishin konkurruar për të – duke i dhënë asaj mundësinë e përfitimit – tani e kishin humbur interesin e tyre të drejtpërdrejtë në të. [26]

Në këto rrethana Mbreti u përpoq të reduktonte sferën e dytë të ndikimit italian në Shqipëri, kulturën. Në një periudhë njëjavore në prill 1933 në vend u mbyllën afërsisht 60 shkolla private, nën pretekstin e nacionalizimit të sistemit arsimor; lëvizja e nacionalistëve *Shqiptarët e Rinj* kishte kohë që kundërshtonte sistemin privat të shkollave në vend duke i quajtur ato shkolla të pavarura që funksiononin si “*fondacione fetare të subvencionuara nga jashtë*” [24]. Kjo ishte një sipërmarrje e vështirë për arsimin shqiptar të cilit i mungonte stafi me të cilin do të zëvendësohej numri mjaft i konsiderueshëm i mësuesve të huaj të kualifikuar që u larguan nga vendi. Për më tepër, viti shkollor mbyllej pas tre muajsh dhe zëvendësimi nuk ishte gjë që e linte cilësinë e programeve të mësimdhënies së paprekur. Së fundmi, botimi i teksteve shkollore në gjuhën shqipe kërkonte një shumë prej 50.000 frangash ari [10] të cilën shteti nuk kishte mundësi se si ta siguronte në një periudhë aq të shkurtër dhe në mungesë të burimit të të ardhurave përtej detit. Për Italinë kombëtarizimi i shkollave donte të thoshte refuzim i kulturës italiane dhe kjo masë ngjalli reagim në qarqet italiane. Ata tërhoqën çdo ekspert dhe punonjës italian që deri atëherë kishte marrë pjesë në ndërmarrjet administrative dhe punimet në terren të qeverisë shqiptare. Marrëdhëniet u ftohën dhe kërcënimet e

klaneve katolike të veriut, të nxitura nga ndikimi fetar italian, u shtuan. Kjo, zgjati pak sepse Mbreti u detyrua të bënte lëshime duke nxjerrë një dekret sipas të cilit gjuha italiane bëhej e detyrueshme në të gjitha shkollat e mesme të vendit dhe 80% e studentëve shqiptarë kishin të drejtë të merrnin bursa studimi për në Itali.

Taktika e tretë që u ndërmor kur edhe kultura nuk ndikoi shumë në marrjen e huasë ishte ajo e “balancimit të pushtetit”, që në rastin tonë i referohej aleancës që Mbreti shqiptar tentoi të bënte me Jugosllavinë dhe Greqinë për t’i treguar Italisë se Shqipëria kishte edhe të tjerë miq që mund t’i gjendeshin në ditë të vështira dhe që ishin njëkohësisht të etur të zinin vendin e Italisë në sferën e ndikimit në politikën dhe ekonominë shqiptare. Më 9 Shkurt 1934, Jugosllavia, Greqia, Turqia dhe Rumania nënshkruan në Athinë *Paktin e Ballkanit* në të cilin ato garantuan reciprocikisht sigurinë e kufijve të tyre ballkanikë. Megjithëse Zogu nuk u ftua në këtë pakt ai deshi ta shfrytëzonte vlerën anti-italiane të tij; nëse Italia përballej me katër shtete njëkohësisht, a nuk do trajtonte ndryshe aleatën e saj të vogël Shqipërinë?[24] Në fakt, shpresat e Mbretit Zog edhe këtë herë u shuan kur Ministri grek i Punëve të Jashtme deklaroi se Greqia nuk kishte ndërmend t’i shpallte luftë një fuqie të madhe, duke lënë të kuptohej se qeveria greke nuk do ta përkrahte Shqipërinë nëse kjo gjë i kushtonte asaj miqësinë me Italinë.

Arka e shtetit shqiptar nuk ia doli të mbushej as këtë radhë. Në vitin 1934 të ardhurat e shtetit ranë dhe printimi i parave të reja nuk pati dobi. Zogu vendosi uljen e pagave të zyrtarëve dhe madje pushoi edhe disa prej tyre. Pothuajse të gjitha punimet publike u ndalën në fillim të vitit dhe, duke pasur kaq pak qarkullim leku në vend, tregtia thuajse ra fare. [8] Arsyeja kryesore për këtë ishte se sistemi i taksave thuajse u rrënua. *“Ndërkohë që taksat e të dhjetave e shtrydhte të varfrin në maksimum, vlera më e lartë e taksës së të ardhurave që mundi të mbledhej nuk kaloi 6% dhe kjo i dha rrugë të lirë invazionit fiskal. Zogu nuk guxonte t’i taksonte të pasurit dhe ata që ruanin poste të qëndrueshme në vend duke iu trembur ndonjë rebelimi nga ana e tyre. Shteti mezi mbahej më këmbë sepse 1/3 e shpenzimeve publike deri atëherë ishte mbuluar nga huatë italiane.”*[24]

Kur ngjarjet e para Luftës së Dytë Botërore po i vendosnin shtetet evropiane në akset aleate apo kundërshtare, Mbreti Zog pati mundësinë e tij të fundit të tërhiqte vëmendjen finaciare të shtetit të tij fqinj. Gjithësesi kjo zgjati fare pak; në vigjilje të ngjarjeve që precipituan në lidhje me shtrirjen imperiale të Italisë dhe Gjermanisë, Shqipëria ishte vendi i dytë pas Etiopisë për të cilët Italia dëshironte të kishte siguri të plotë territoriale. Këtë radhë ishte ndërhyrja britanike ajo që e ndihmoi Shqipërinë të rivendoste marrëdhëniet financiare me Italinë. Ndikimi italian në Etiopi cënonte interesat britanike në Egjipt dhe qarqet ndërkombëtare nuk e përjashtuan mundësinë e një lufte detare mes Britanisë së Madhe dhe Italisë. Në këtë pikë Italia do të dëshironte të kishte nën ndikimin e saj të plotë bregdetin e Adriatikut në mënyrë që ta mbronte bregun e saj lindor nga ndonjë sulm i mundshëm i flotës britanike. [26] Shpejt qeveria italjane filloi bisedimet me mbretin Zog, i cili duke shfrytëzuar situatën, ia doli që në vitin 1936 ta lironte buxhetin e vendit të tij nga detyrimet e huasë së vitit 1931, si dhe të siguronte *“12, 000, 000 franga ari që do të shlyeshin në tre kështe; 13, 000, 000 të tjera që do të shlyeshin për një periudhë më të gjatë në*

këste më të vogla, nga të cilat 10. 000. 000 do të shpenzoheshin për investime në sektorin e bujqësisë shqiptare dhe 3. 000. 000 për ta ndihmuar shtetin të siguronte një monopol në industrinë e duhanit. Një tjetër hua do të përgatitej për rimëkëmbjen e Portit të Durrësit’. [The Times, 3 prill 1936] Shqipëria ia kishte dalë edhe njëherë të mbijetonte falë ndihmës financiare të një shteti të fuqishëm. Megjithëse shumë nga komentet e ekspertëve të kohës e cilësonin lidhjen midis të dy shteteve si koloniale, Robert Hoxhson e përkufizoi si më poshtë strategjinë financiare të qeverisë shqiptare: *“Këmbëngulja e Mbretit Zog u shpërblye sepse ai ia doli më në fund t’i merrte para Italisë pa iu dashur të nënshkruante ndonjë dokument që e detyronte atë ta prekte sovranitetin e Shqipërisë.”*[24]

III. Mendime përmbyllëse rreth zhvillimit ekonomik në Shqipëri gjatë viteve 1920-1939

“Sipas mendimit tim në Shqipëri ka mjaft pasuri- pasuri të llojit më të mirë, ajo që vjen nga puna e ndershme e tokës - dhe më vjen çudi sesi një shqiptar që rropatet në Amerikë, Kanada dhe Australi nuk i hedh sytë të mundësitë e arta që i ofron vendi i tij. Ndodh rëndom që

njerëzit e kërkojnë gjatë atë që mund ta kenë para syve.”[9]

Paul Edmonds, 1927

Nga pikëpamja gjeografike, toka dhe nëntoka shqiptare i kishin të gjitha mundësitë për një hapje të shpejtë drejt zhvillimit ekonomik në çerekun e dytë të shekullit të kaluar. Por, siç u vu në dukje edhe më sipër, kjo varej nga një sërë faktorësh që kryesisht kishin të bënin me sipërmarrjet qeveritare dhe besimin që ato ishin të aftë të krijonin në individët shqiptarë apo të huaj, në mënyrë që këta të fundit të investonin në drejtime të ndryshme ekonomike. Shqiptarëve nuk u mungonte kapitali, madje disave prej tyre as zgjuarsia për të nuhatur hapësira mjaft të nevojshme të zhvillimit ekonomik si ato që u përmendën më lart. Ajo që nevojitej ishte që shteti shqiptar të krijonte mundësitë e duhura për ndërmarrje individuale në vend dhe qeverisë i duhej të luante rolin e promotorit në këtë drejtim. Pa mohuar ndryshimet ekonomike, investimet publike dhe hapjen e fronteve të reja të punës në vend, rritjen e buxhetit falë taksave, përmirësimit të arsimit dhe të infrastrukturës, Shqipërisë i mbetej ende shumë për të bërë. Raportimi i prof. A. Klamesë për Lidhjen e Kombeve në vitin 1922, që shërbeu si një fillesë këshillimore për qeveritë në vazhdim, nxori në pah tre nga problemet më të nxehta të cilat duheshin zgjidhur në Shqipëri: ndërtimin e rrugëve (që kërkonte një investim prej 60 milion frangash ari), tharjen e kënetave dhe ndërtimin e një sistemi të plotë kullimi (50 milion franga) dhe, së fundmi, krijimin e një banke kapitali fillestar i të cilës të ishte 10 deri 15 milion franga). Në fund të viteve ’30 ishin realizuar vetëm pjesërisht sugjerimet që eksperti kishte bërë për strategjitë e mundshme të zhvillimit ekonomik që mund të funksiononin në Shqipëri. Kjo u gjykua së pari, pasojë e paaftësisë së qeverisë shqiptare për të riformuar arsimin, si kushtin kryesor për rimëkëmbjen e forcës punëtore në Shqipëri. Krahu i punës në vend nuk mungonte, por iniciativat që do t’u hapnin shtigje zhvillimeve ekonomike të vendit kishin nevojë për një lloj tjetër të

menduari që dilte nga konceptet e prapambetura me të cilat ishin rritur të rinjtë shqiptarë për breza të tërë; shkollimi duhej të ndryshonte pikëpamjet e tyre në lidhje me konceptin e tokës dhe lidhjes së individit me të, kapitalit dhe rritjes së tij nëpërmjet investimit, dhe fushat e interesit për një vend në zhvillim. Megjithatë arsimi pati zhvillimet e veta, ai nuk mundi të përgatiste një apo dy breza që të ishin të aftë të përballeshin me konservatorizmin shqiptar qoftë në rang individual, qoftë si strategji kombëtare zhvillimi. Shqipëria vazhdoi të kishte një popullsi të vogël (që vazhdonte të mos rritej si pasojë e kushteve të këqija sanitare në të cilat jetonin pjesa më e madhe e familjeve shqiptare), e megjithatë qeveritë e kohës nuk ditën apo nuk mundën të ndryshonin shumë nga konceptet e mësipërme. Politikat promotore që duheshin ndjekur, ose nuk gjetën rrugën e duhur, ose nuk mundën t'i bënin ballë konservatorizmit primitiv në vend. Ndoshta kabinetet e njëpasnjëshme nuk ishin të përgatitur sa duhej për të dalë nga guacka e mbyllur e prapambetjes. Në vend që të shpenzonin 8 milion franga në rikonstruktimin e portit të Durrësit, qeveria ndoshta, sipas Xh. Toms, duhej të kishte shpenzuar më shumë në krijimin e rrugëve lidhëse midis luginave pjellore dhe qendrave tregtare në qytete në mënyrë që të stimulohej edhe më krijimi i fermave qoftë edhe të vogla. [24]

Faktori i dytë që ndikoi negativisht në zhvillimin ekonomik ishte që asnjëra prej qeverive shqiptare të kohës nuk mundi të siguronte një hua nga Lidhja e Kombeve, huatë që në situata të ngjashme kishin ndihmuar vende të tjera të Ballkanit t'ia dilnin ekonomikisht. Që të fillonte përçarjet e veta ekonomike nga vendi u kërkua që të arrinte një stabilitet politik, i cili në vetvete do të mbartte qëndrueshmërinë e buxhetit dhe sigurinë e investimeve. Kur dukej se vendi i arriti deri në një fare mase standardet e qetësisë dhe stabilitetit politik, qeveria shqiptare e gjeti veten të lidhur financiarisht me Italinë. Huatë e dhëna nga ky shtet i siguruan vetëm një pjesë të vogël të zhvillimit ekonomik të planifikuar, por nga ana tjetër e lidhën atë politikisht me shtetin fqinj. Kjo pati ndikimin e saj në zhvillimet politike që pasuan midis shteteve të përfshira në Luftën e Dytë Botërore.

Mesa duket 17 vjet nuk rezultuan mjaftueshëm për shtetin shqiptar që të realizonin parashikimin e profesor Kalmesë në vitin 1922, sipas të cilit mbikëqyrja e Lidhjes së Kombeve do t'i shërbente Shqipërisë si garanci për mbrojtjen e jashtme. Shqipëria ishte një vend që kishte burime ekonomike të mjaftueshme për t'ia dalë edhe pa një hua; ajo që i nevojitej ishte besimi i brendshëm që shqiptarët mund ta siguronin vetëm falë maturisë politike të shtetit të tyre.

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 1984. *Historia e Shqipërisë: Vol. III (1912-1944)*. Tiranë, Instituti i Historisë.
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2002. *Historia e Popullit Shqiptar I: Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën perandorinë Osmane gjatë shek. XVI-vitet '20 të Shek. XIX*. Tiranë, Botimet Toena.
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2007. *Historia e Popullit Shqiptar: Periudha e Pavarësisë 28 Nëntor 1912 – 7 Prill 1939*. Tiranë, Botimet Toena.

Blake, Maxwell, *Economic conditions in Albania*, Supplement to Commerce reports. Bureau of Foreign and Domestic Commerce. Trade Information Bulletin. No. 83, April 2, 1923. <http://hdl.handle.net/2027/uiug.30112104075129>.

Bowman, Isaiah. 1928. *The New World: Problems in Political Geography*, New York, Yonkers-on-Hudson.

Calmè Albert, 1922. *Report on the Economic and Financial Situation of Albania*. Report to the League of Nations, Luxemburg.
<http://www.archive.org/details/economicfinancia00calm>.

Coon, Carleton S., 1950. *The Mountains of Giants: A Racial and Cultural Study of the North Albanian Ghegs*, Massachusetts, Cambridge.

Crampton, Richard J., 1997. *Eastern Europe in the Twentieth Century and After*, London, Routledge.

Edmonds, Paul, 1927. *To the Land of the Eagle*, London, George Routledge & Sons LTD.

Fischer, Bernd J., 2004. *Mbreti Zog dhe Perpjekja për Stabilitet në Shqipëri*, Tiranë, Çabej.

Fodor, Marcel W., 1937. *Plot and Counterplot in central Europe*, Boston: Houghton – Mifflin.

Jacques, Edwin E., 1995. *Shqiptarët: Historia e Popullit Shqiptar nga Lashtësia deri në Ditët e Sotme*, Tiranë, Kartë e Pendë.

Kontos, Joan F., 1994. *Kryqi i Kuq- Shqiptonjë e Zezë: Biografi e Shkollës Teknike Shqiptaro-Amerikane të Tiranës*, Tiranë, Shtëpia Botuese Enciklopedike.

Matthews, Ronald., 1937. *Sons of the Eagle; Wanderings in Albania*, London, Methuen & Co. LTD.

Newman, Bernard, 1936. *Albanian back-door*, The University of California, H. Jenkins, limited.

Newman, Bernard, 1945. *Balkan Background*, New York, The Macmillian Company.

Oakley-Hill, Dayrell R., 2002. *An Englishman in Albania: Memories of a British Officer 1929-1955*, London, The Center for Albanian Studies.

Robinson, Vandeleur, 1941. *Albania's Road to Freedom*, London: George Allen & Unwin ltd.

Roucek Joseph S., "Economic Conditions in Albania". *Economic Geography*, Vol. 9, No. 3, July, 1933
<http://www.jstor.org/discover/10.2307/140835?uid=3739256&uid=2&uid=4&sid=21102067553>.

Roucek Joseph S., "The Geopolitics of the Adriatic" *American Journal of the Economy and Sociology*. Vol. II, No. 2, January, 1952, p. 171-178. www.jstor.org/stable/3483356.

Swire, Joseph, 1937. *King Zog's Albania*, New York, Liveright Publishing Corporation.

Swire, Joseph, 2005. *Shqipëria; Ngritja e një Mbretërie*, Tiranë, "Dituria".

Tafani, Vilma, 2003. *Shqipëria dhe Elbasani në syrin e udhëtarëve të Huaj*, Elbasan, Sejko.

Tomes, Jason H., 2003. *King Zog of Albania: Europe's Self-Made Muslim King*, New York University Press.

Von Redlich, Marcellus, D. A. R. 1935. *The Unconquered Albania*, U. S. A., International Courier Publishing Company.

Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Konferencë Shkencore Ndërkombëtare 1 shtator 2008. *Monarkia Shqiptare: 1928 – 1939;Përmbledhje studimesh*. Tiranë, Botimet Toena, 2011.

Silajxhiç, Harris.,1999. *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Washingtonit*. Tiranë, Dituria.

FILOZOFI - SOCIOLOGJI

“DUKURI GJINORE NË TRANZICION, RASTI I SHQIPËRISË”

Adelina Nexhipi

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i FilologjisëE-mail:

Përmbledhje

Historikisht, gruaja është trajtuar në shoqërinë shqiptare si një faktor i dorës së dytë. Në vitet e para të shtetit shqiptar gruaja gëzonte shumë pak të drejta. Gjendja e gruas shqiptare ndryshoi disi me miratimin e Kodit Civil në vitin 1929. Pas Luftës së Dytë Botërore, në kuadër të reformave socialiste, u bë një propagandë e madhe për emancipimin e gruas, gratë shqiptare fituan për herë të parë të drejtën e votës në zgjedhjet e 2 Dhjetorit 1945. Pas viteve '90 ka pasur zhvillime të rëndësishme institucionale dhe strukturore për përparimin dhe emancipimin e mëtejshëm të grave në shoqërinë shqiptare, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen aktive të tyre në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit. Në aspektin ligjor, sanksionohet barazia e të gjithë shtetasve përpara ligjit që do të thotë se burri dhe gruaja, de jure trajtohen në mënyrë të barabartë. Për sa i përket pjesëmarrjes së gruas në jetën ekonomike nuk mund të flasim me shumë entuziazëm. Pabarazitë në respektimin e të drejtave të grave thellohen dhe nga niveli i ulët i përfaqësimit të tyre në procesin vendimmarrës. Përfaqësimi i grave në parlamentet pluraliste të pas viteve '90 ka qenë i ulët. Numri prej 23 deputetesh gra (16.4%), në legjislaturën e fundit parlamentare, përfaqëson gati gjysmën e kuotës së detyrueshme ligjore (30%) për përfaqësimin e gruas në parlament, vendosur në Kodin e ri Elektoral në Shqipëri. Barazia gjinore nuk është e mbrojtur akoma në mënyrë të mjaftueshme në shoqërinë shqiptare. Kjo gjendje nuk vjen nga indiferentizimi i grave për t'u përfshirë në politikë dhe nuk tregon as paaftësinë e tyre në këtë drejtim. Ajo është e lidhur me mentalitetin, klimën e ashpër politike, mungesën e strukturave sociale mbështetëse ndaj gruas dhe pasqyron mungesën e standardeve dhe mekanizmave efikase për përcaktimin e përparësive që do të mundësonin rritjen e pranisë së grave në drejtimin e vendit.

Fjalë çelës: barazi gjinore, kuotë gjinore, kuadri ligjor, strukturat sociale, klima politike.

Abstract

Historically, the woman in the Albanian society is treated as a second hand factor. At the first years of the Albanian state, the woman had very few rights. The state of the Albanian woman changed a bit with the approval of the Civil Code in 1929. After the Second World War, during the socialist reforms, there was a great propaganda for women's emancipation and the Albanian women won for the first time the right to vote in the election of 2 December 1945. After the "90-s there have been important institutional and structural developments for the advance and the emancipation of the women in Albanian society and also to secure the active participation like the men in the political, economical, social life of the country. In

the legal aspect is sanctioned the equality of the citizens to the law, that means that the man and the woman legally are treated equally. According to the participation of the woman in the economic life we can't speak with a lot of enthusiasm. Inequalities in the respect of the women's rights are made deeper even from the low level of their representation in the decision process. The representation of the women in the pluralist parliaments after the nineties has been low. The number of 23 women deputies (16.4%) in the last parliamentary legislative represents almost half of the legal obligatory quote, 30% for the presentation of the woman in the parliament, decided in the New Electoral Code in Albania. The gender equality is not still protected enough in the Albanian society. This is not because of the indifference of the woman to be included in politics and does not even show their incapacity in this direction. It is linked with the mentality, the political rough climate, the lack of the social supporting structures to the woman and it represents the lack of the standards and the efficient mechanisms for the definition of the advance that would enable the growth of women's presentation in the country's government.

Key words: gender equality. Gender quote, the legal framework, the social structures, the political climate.

Hyrje

Në Shqipëri, gratë kanë arritur nivele të larta të edukimit, progres në tregun e punës dhe në jetën publike. Megjithatë pabarazia gjinore mbetet një shqetësim. Shumë gra gjenden në dilemë midis rritjes së fëmijëve apo zhvillimit të karrierës, për shkak të mungesës së përshtatjeve në orare, shërbimeve sociale dhe pengesave që sjellin stereotipet tradicionale gjinore dhe mendësia mashkullore e shoqërisë. Në aspektin ligjor, gruaja shqiptare gëzon të drejta të barabarta me burrin dhe mbrohet nga çdo formë diskriminimi gjinor. Që të mund të flasim për një barazi të plotë mes burrit dhe gruas në një shoqëri, duhet veç të tjerash të analizojmë dhe barazinë gjinore në jetën politike dhe proceset vendimarrëse të saj. Pikërisht kjo çështje do të jetë objekti kryesor i këtij studimi. Ç'rol luan gruaja shqiptare në jetën publike të vendit dhe veçanërisht në atë politike? Sa e përfaqësuar është ajo në institucionet vendimarrëse të vendit? Kjo është një çështje e rëndësishme jo vetëm për gruan shqiptare, por për shoqërinë në tërësi, pasi barazia në jetën politike është e rëndësishme në procesin e përparimit të rolit të gruas në shoqëri. Pa pjesëmarrjen aktive dhe përfshirjen e saj në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, qëllimet e barazisë, të zhvillimit dhe paqes nuk mund të arrihen. Është pikërisht kjo arsyeja që na shtyhu të bëjmë një panorama përshkruese- analitike të raportit gjinor në jetën politike në Shqipëri. Në këtë studim do të bëhet një analizë cilësore dhe sasiore të të dhënave të nxjerra nga INSTAT-i, KQZ-ja, Kuvendi I Shqipërisë dhe organizata të ndryshme për mbrojtjen e të drejtave të grave në Shqipëri. Analiza do të mbështetet, veç të tjerave, në një përballje të aspektit ligjor me situatën reale në vend. Nuk mungon gjithashtu dhe një analizë krahasuese mes përfaqësimit të gruas në jetën politike në Shqipëri dhe në vendet e tjera të Rajonit. Studimi arrin në përfundimin se: pavarësisht rëndësisë që ka pjesëmarrja aktive e gruas në jetën politike dhe megjithë përparimet që janë bërë në këtë drejtim, përsëri femrat shqiptare janë te jetë nënperfaqësuar.

në parlament, në postet e larta qeveritare, si dhe në pozicionet vendimmarrëse në administratën publike.

I.Një vështrim i shpejtë mbi gjendjen e gruas gjatë viteve të diktaturës komuniste

Historikisht, gruaja është trajtuar në shoqërinë shqiptare si një faktor i dorës së dytë. Gjatë periudhës së pushtimit osman, por edhe në vitet e para të shtetit shqiptar gruaja gëzonte shumë pak të drejta. Ajo nuk kishte të drejtën e trashëgimisë, të drejtën e pronës, të drejtën e votës, të drejtën për të kërkuar divorcin. Edhe më e rënduar ishte gjendja e gruas dhe e vajzës myslimane e cila nuk lejohet të arsimohet, nuk mund të dilte në mjedise publike pa perçe. Përdorimi i perçes u ndalua me ligj në vitin 1927. Gjendja e gruas shqiptare ndryshoi disi dhe pozitën e saj u forcuan në mënyrë relative me miratimin e Kodit Civil në vitin 1929. Nga ky përshkrim i shkurtër kuptohet se dhe përfaqësimi i gruas në këtë periudhë në procesin vendimmarrës ishte zero. Kështu nuk kemi asnjë përfaqësuese femër në qeverinë e Vlorës, në qeverinë e Turhan Pashë Përmetit (e Vidit), në qeverinë e Lushnjës, në Këshillin Kombëtar të viteve 1920–1924, në Asamblenë Kombëtare të Republikës Shqiptare 1925 – 1928, në Asamblenë Kushtetuese (1928) në dy parlamentet në periudhën monarkiste apo në institucionet e krijuara nga pushtuesit italianë e gjermanë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në këtë periudhë gruaja shqiptare nuk kishte fituar ende të drejtën e votës, pra të drejtën për të zgjedhur.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në kuadër të reformave socialiste, u bë një propagandë e madhe për emancipimin e gruas. Menjëherë pas luftës, angazhimi i grave në forcat e punës kontribuoi në rritjen e numrit të fuqisë punëtore. Teorikisht gratë ishin të barabarta me burrat, por në të vërtetë *“megjithëse ato nuk mund të shiteshin më si pronë e burrave, tani ishin shndërruar në pronë të shtetit”* – shprehet Miranda Vicker në librin e saj Shqiptarët.

Gratë në emër të emancipimit, u bënë ushtarë, muratore, traktoriste, kryenin stërvitje ushtarake, aksione, punë vullnetare. Kjo jo vetëm që nuk e lehtësoi gruan, por edhe e rëndoi barrën e saj. Gruaja duhet të punonte në prodhim e industri, duhet të mbante dhe gjithë peshën e kujdesit për shtëpinë (kushtet e jetesës dhe mungesa e elektroshtëpiakeve e vështirësonin këtë proces) dhe për rritjen e fëmijëve. Politika shtetërore për shtimin e popullsisë nxiste lindjet e fëmijeve dhe grave u mohojë e drejta e kontrollit të shtatzanisë, ndërkohë, që aborti dhe kontraceptivi ishin ilegal. Përballë politikës shtetërore *“burrat shqiptarë pranonin rolin e ri të grave në jetën publike, por vazhdonin t’i trajtonin gratë si shërbëtore në jetën shtëpiake”*.

Në kuadrin e të drejtave politike gratë shqiptare fituan për herë të parë të drejtën e votës në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945. Ndërkohë që në botë e drejta e votës u është dhënë për herë të parë grave në Zelandën e Re, në vitin 1893, një gjysmë shekulli më herët se në Shqipëri (megjithëse vlen të theksohet se në disa vende demokratike gratë e kanë fituar të drejtën e votës më vonë se në Shqipëri).

Tabela 1.Renditja kronologjike e fitores së të drejtës së votës për gratë në botë.

Shteti	Viti	Shteti	Viti
Zelanda e Re	1893	BM	1928
Finladë	1906	Afrika e Jugut	1930
Norvegji	1913	Spanjë	1931
Danimarkë	1915	Brazil	1932
BS-së	1917	Tajlandë	1932
Austri	1918	Ceilon	1934
Çekosllovakia	1918	Kubë	1934
Poloni	1918	Turqi	1934
Suedi	1918	Uruguaj	1934
SHBA-së	1920	Rumani	1935
Gjermani	1919	Filipine	1937
Luksemburgg	1919	Shqipëri	1945

Megjithatë, fakti që gratë fituan të drejtën e votës nuk do të thotë se tashmë gratë përmirësuan statusin e tyre në mënyrë të menjëhershme. Prof. Zyhdi Dervishi shkruan: *“Përvoja historike dëshmon se e drejta e vajzave për të votuar, për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në strukturat politike të çdo niveli është një ndër kushtet e nevojshme por jo të mjaftueshme për përmirësimin e vazhdueshëm të statutit të tyre në çdo fushë të jetës dhe të veprimtarive”*.

Zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 shënuan një arritje tjetër të madhe për gruan shqiptare. Për herë të parë dyert e Kuvendit Popullor u çelen për tri gra: *Ollga Plumbi, Naxhie Dume dhe Liri Gega*. Në vitet në vazhdim kjo pjesëmarrje ka ardhur duke u zgjeruar. Tabela e mëposhtme tregon nunrin e grave pjesëmarrëse në kuvendin popullor nga legjislatura e parë deri në të njëmbëdhjetën.


Tabela 2.Përfaqësimi i grave në kuvend gjatë diktaturës komuniste.

Legjislaturat	Vitet	Nr.i deputetëve	Nr.i deputetëve gra	Pesha pecifike grave (%)
I	1945-1950	82	6	7.3
II	1950-1954	121	17	14
III	1954-1958	134	16	11.3
IV	1958-1962	186	17	9.1
V	1962-1966	214	25	11.7
VI	1966-1970	240	39	16.3
VII	1970-1974	264	71	26.9
VIII	1974-1978	250	88	35.2
IX	1978-1982	250	81	32.4
X	1982-1986	250	78	31.2
XI	1987-1991	250	75	30

Nga të dhënat e tabelës shohim se numri i grave në Kuvendin Popullor ka ardhur duke u rritur, ashtu si dhe pesha specifike e saj në raport me numrin e përgjithshëm të deputetëve në kuvend. Numri më i madh i deputeteve gra është në legjislaturën VIII, në vitet 1974-1978, përkatësisht 88 deputete ose 35.2%.

E shprehur në formë grafike do të na jepte një panoramë më të qartë:

Grafiku 1. Gratë në Kuvendin Popullor 1945-1991 (shprehur në %).



Por, duke pasur parasysh mënyrën e qeverisjes dhe politikëbërjes në Shqipërinë e këtyre viteve, pra një pushtet i centralizuar, roli i vajzave dhe grave në organin ligjvënës apo dhe në institucionet e tjera politike ishte me shumë pak ndikim, më tepër formal dhe propagandistik, që synonte të forconte propagandën profeministe të regjimit totalitar komunist.

II. Barazi apo disbalancë gjinore

Pas viteve '90 ka pasur zhvillime të rëndësishme institucionale dhe strukturore për përparimin dhe emancipimin e mëtejshëm të grave në shoqërinë shqiptare, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen aktive të tyre në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit. Në aspektin ligjor, Kushtetuta e Shqipërisë dhe gjithë kuadri ligjor i Republikës së Shqipërisë sanksionon barazinë e të gjithë shtetasve përpara ligjit që do të thotë se burri dhe gruaja, de jure trajtohen në mënyrë të barabartë. Një sërë kodesh trajtojnë çështjen e barazisë gjinore dhe janë hartuar politika që mbrojnë barazinë gjinore. Parimi i diskriminimit, përfishrë dhe diskriminimin gjinor sanksionohet në një nen të veçantë të kushtetutës (neni 18, pika 2). Në lidhje me të drejtat e femrave, ekzistojnë dispozita ligjore për të drejtat e barabarta në një numër fushash të jetës, si *sigurimet sociale dhe arsimi*. Kodi i Punës i 1995-ës (neni 9) përcakton garanci për mosdiskriminimin në të dy sferat publike dhe private. Kodi i Punës dhe Akti i Barazisë Gjinore i 2004-ës i referohen parimit të trajtimit të barabartë të femrave dhe burrave, me qëllimin që punëdhënësit duhet të japin rrogën e njëjtë për punët me vlera të njëjta dhe janë të aplikueshme si për sektorin publik, edhe atë privat. Legjislacioni i punës akordon masa speciale mbrojtëse për punonjëset shtatzëna dhe me fëmijë në periudhën e ushqimit me gji, që janë një shkallë më lartë sesa masat e përgjithshme mbrojtëse për të gjithë punëtorët. Përsa i përket mbështetjes financiare qeveria promovon punësimin e femrave, veçanërisht për të ndihmuar femrat pa përkrahje që të gjejnë një punësim afatgjatë. Këtu përfshihen viktimat e trafikimit, femrat rome, personat me aftësi të kufizuara dhe femrat me probleme sociale. Veç kësaj Shqipëria ka ratifikuar një sërë konventash ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në mënyrë të veçantë "*Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas*" (nënshkruar në 1978 dhe ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 9. 11. 1993).

Në këtë drejtim vihen re gjithnjë e më tepër përpjekje të vazhdueshme për të koordinuar iniciativat shtetërore me angazhimin gjithnjë e më në rritje të shoqërisë civile. Gratë luajnë një rol aktiv në OJF –të(organizatat jo fitimprurëse), të cilat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimet demokratike në vend, për rrjedhojë në mënyrë indirekte gratë kanë ndikuar në vendimmarrjen politike. Në sektorin joqeveritar gratë dhe vajzat kanë gjetur hapësirë dhe liri për t'u angazhuar për çështje të tilla, si: *të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve, por edhe për komunitetin në tërësi, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, kujdesin social e shëndetësor, zhvillimin ekonomik etj.* Nga 614 shoqata që janë regjistruar në Shqipëri 112 ose 18. 24% e tyre drejtohen nga gratë.

Për sa i përket pjesëmarrjes së gruas në jetën ekonomike nuk mund të flasim me shumë entuziazëm. Ndryshimet ekonomike dhe politike të vitit 1990 çuan në mbylljen e shumë ndërmarrjeve prodhuese e për rrjedhojë në rritjen e numrit të papunësisë. Nga kjo u goditën shumë gratë. Gjatë gjithë viteve të tranzicionit punësimi te gratë dhe vajzat ka qenë më i ulët se te burrat për disa arsye si, përgjegjësia dhe detyrimi për rritjen e fëmijëve, kryerjen e punëve të shtëpisë, niveli arsimor (edhe pse vajzat kanë akses të barabartë me djemtë në procesin e arsimimit), pronësia dhe mundësia për të fituar kredi. Nga të dhënat e INSTAT-it, 53% e grave nuk janë aktive në jetën ekonomike. Po në bazë të të dhënave të këtij institucioni për vitet 2007-2010 përqindja e grave të punësuar është dukshëm më e ulët se punësimi te meshkujt. Më hollësisht këtë na e tregojnë të dhënat e tabelës së mëposhtme:

Tabela 3. Shkalla e punësimit sipas gjinisë, 2007-2010.

Mosha 15-64 vjec/ Viti	2007	2008	2009	2010
Meshkuj	63.6	63.0	64.3	63.0
Femra	49.3	45.6	43.6	44.4

Situata e punësimit të gruas është më e favorshme në sektorin publik ku ajo zë 56% të të punësuarve, ndërsa në sektorin privat, pabarazia gjinore është e dukshme, vetëm 17 % e vajzave arrin në nivelin e menaxhereve, po kështu vetëm 2% e bizneseve në sektorin e transportit është e drejtuar nga gratë dhe 25% në sektorin e shërbimeve. Gratë kanë ngritur bizneset e tyre kryesisht në aktivitetet ekonomike, si: *dentist, noteri, avokati, parukeri, rrobaqepësi, punime artizanale, tekstil, botime librash, tregti me pakicë*. Megjithatë numri i grave shqiptare që zotërojnë ligjërisht prona është i ulët, vetëm 18 % e grave.

Pabarazitë në respektimin e të drejtave të grave thellohen dhe nga niveli i ulët i përfaqësimit të tyre në proceset vendimmarrëse. Vendosja e ekuilibrit gjinor në qeveri dhe në politikëbërje përfshin një pjesëmarrje të plotë, aktive dhe të barabartë të gruas në jetën publike dhe politike për të nxitur ndryshimet në natyrën dhe praktikatat e politikës, në mënyrë që të adresohen problemet dhe nevojat e gruas. Pjesëmarrja e ulët e grave dhe vajzave shqiptare në vendimmarrje është një pengesë shumë e madhe në përmbushjen e reformave dhe politikave të orientuara sipas nevojave të grave, fëmijëve dhe familjes. Studiuesit pranojnë njëzëri se pjesëmarrja aktive e gruas në jetën politike ndikon në tre aspekte:

- *Së pari, në vendet në të cilat gruaja është më aktive në politikë, jeta është më cilësore dhe më demokratike*
- *Së dyti, gratë përkrahin interesa të ndryshme nga ato që u kushtojnë vëmendje burrat, ndaj pjesëmarrja e grave në strukturat*

vendimmarrëse do t'u siguronte prioritet çështjeve që nuk u kushtohet rëndësi prej burrave

- *Së treti, pjesëmarrja e grave në vendimmarrje, në mënyrë të ndjeshme rrit nivelin e qeverisjes.*

Megjithëse vitet e fundit prania e grave dhe vajzave në administratën publike është disi më inkurajuese, përsëri burrat dominojnë në pozicione drejtuese. Përfaqësimi i grave është i ulët në parlament, qeveri, në pushtetin vendor, në postet drejtuese të partive politike. Këtë fenomen e përsërit në mënyre kritike në raportet e tij për Shqipërinë edhe Komisioni Evropian. Kështu në progres-raportin e vitit 2011 theksohet: *“Gratë vazhdojnë të mos përfaqësohen sa duhet në tregun e punës, në politikëbërje dhe në politikë. Zbatimi i instrumenteve ekzistuese legjislative dhe të politikave në këtë fushë vazhdon të jetë i dobët. Koordinimi mes institucioneve në nivelin vendor dhe qendror duhet rritur ndjeshëm.*

Përfaqësimi i grave në parlamentet pluraliste të pas viteve '90 ka qenë i ulët, duke variuar nga 4% në 16.4% të numrit të përgjithshëm të deputetëve, përqindje e ulët kjo po të krahasohet me periudhen komuniste, ku që në legjislaturën e parë, në vitet pas luftës përqindja e grave në parlament arriti 7.3% .

Tabela 4. Përfaqësimi i grave në kuvend 1991-2013.

Legjislatura	Vitet	Nr.i deputetëve	Nr.i deputetëve gra	Pesha pecifike grave (%)
XII	1991-1992	250	10	4
XIII	1992-1996	140	8	5.7
XIV	1996-1997	140	21	15
XV	1997-2001	155	11	7
XVI	2001-2005	140	8	5.7
XVII	2005-2009	140	10	7.1
XVIII	2009-2013	140	23	16.4

Një hap pozitiv në përfaqësimin e gruas në institucionet ligjvënëse apo vendimmarrëse, u hodh në vitin 2005, kur për herë të parë zgjidhet një grua në postin e kryetares së parlamentit, po ashtu për herë të parë kemi një grua që kryeson Gjykatën e Lartë, si dhe të parën kryeprokurore femër. Pavarësisht nga kjo, po në të njëjtin vit, peshorja vazhdonte të anonte shumë më shumë nga burrat, kështu në kabinetin qeveritar me 14 poste ministrore, vetëm një ishte femër, zëvendësministre ishin 8-të, që zinin në peshë specifike 23%; ambasadore të Shqipërisë të akredituara nëpër botë vetëm 5, ose 10% ishin femra; në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, nga 10 anëtarë vetëm dy ishin femra; në Gjykatën Kushtetuese, ishte vetëm një femër nga tetë anëtarë gjithsej. Edhe në qeverisjen vendore përfaqësimi i gruas është i ulët.


Edhe këtu ajo është në një disbalancë të thellë me burrin. E shprehur kjo në gjuhën e shifrave, në qeverisjen vendore, referuar të dhënave të zgjedhjeve lokale 2007, për periudhën 2007-2011 kishte 1 kryetare bashkie nga 65 bashki ose 1.5%, 9 gra kryetare të Këshillave Bashkiakë ose 16%. Ndërsa anëtare gra të Këshillave Bashkiakë ishin 157 nga 1178 gjithsej ose 13.3%. Nga 11 kryetarët e minibashkive të Tiranës 3 ose 27.3% ishin gra, ishin 6 kryetare komune nga 309 gjithsej ose 1.9% e tyre. Gratë vazhdojnë të mos përfaqësohen sa duhet në politikëbërjen lokale, vetëm pesë gra u zgjodhën kryetare bashkie dhe dy kryetare komune në zgjedhjet lokale të vitit 2011. Gratë vazhdojnë të përbëjnë një përqindje të vogël edhe në strukturat e lidershipit të partive politike të ngarkuara me politikëbërjen. Janë burrat ata që bëjnë programet dhe vendosin mbi prioritetet në zgjedhje. Burrat mbajnë gjithashtu postet e lidershipit edhe në nivelin lokal. Rrallë gjejmë gra në postet e lidershipit si kryetare të partive.

Shqipëria, sot në parlamentin 140 vendësh, ka 23 deputete femra ose 16.4% të numrit të përgjithshëm. Kjo shifër është larg vendit të parë në Evropë për përfaqësimin më të lartë të grave në parlament, Andorës me 53.6%, por edhe larg vendeve të Rajonit, ku vendin e parë për përfaqësimin më të lartë të grave në parlament e mban Maqedonia me 30.9%. Të dhënat e tabelës së mëposhtme na lejojnë të bëjmë një krahasim të thjeshtë në lidhje me përfaqësimin e grave në organet ligjvënës në vendet e Rajonit:

Tabela 5. Përfaqësimi i vajzave, grave në parlamentet e vendeve ballkanike, viti 2011.

Shtetet	Maqedoni	Kroaci	Serbi	Bullgari	Greqia	B_H	Shqipëri	Sloveni	Rumani	Mali i ZI
Anëtarë gjithsej	123	153	250	240	300	42	140	90	334	81
Vajza/ gra	38	36	54	50	52	7	23	13	38	8
Pesha spec. %	30.9	23.5	21.6	20.8	17.3	16.7	16.4	14.4	11.4	11.1

Grafiku 2. Gratë në parlamentet e Rajonit.



Nga të dhënat e tabelës vërejmë se Shqipëria renditet e shtata në Ballkan për përfaqësimin e gruas në parlament. Pësia specifike, 16.4%, e gruas shqiptare në parlament është 47% më e ulët se pësia specifike e gruas në parlamentin maqedonas. UN WOMEN (United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Woman), në raportin e vitit 2012 për Shqipërinë, ku analizon respektimin e të drejtave të grave në Shqipëri, në lidhje me GII-në (indeksin e pabarazisë gjinore) e vlerëson Shqipërinë me 0,545 pikë, në një sistem pikësh ku 0 nënkupton barazi të plotë mes burrit dhe gruas, kurse 1 do të thotë një pabarazi e madhe, një gjendje e pakrahasueshme mes burrit dhe gruas. E përkthyer në notë, kjo do të ishte një notë kaluese minimale për Shqipërinë.

Ashtu si dhe në shumë vende të tjera të Rajonit, në Shqipëri u përdorën kuotat e përfaqësimit, për të nxitur dhe rritur pjesëmarrjen e grave në institucionet vendimmarrëse. Kjo gjë ishte kërkuar që në vitin 2003 kur Komisionit Parlamentar, të ngritur për rishikimin e Kodit Zgjedhor iu paraqitën 109 mijë firma të mbledhur në mbarë vendin që kërkonin amendamentin për kuotim. Por Komisioni nuk e miratoi këtë si kusht në Kodin e Ri Zgjedhor. Pavarësisht kësaj, me nismën e tyre dy partitë më të mëdha politike në vend, vendosin një sistem kuotimi për zgjedhjet e pushtetit lokal të vitit 2003. Në maj 2003 Këshilli i Përgjithshëm Drejtues i PS-së, merr vendim për vendosjen e raportit 2 me 1 (2 burra- 1 grua) në listat e kandidatëve për zgjedhjet lokale të atij viti. Nga fundi i qershorit 2003, edhe Partia Demokratike sipas një rezolute të liderit të saj, vendosi të përdorë sistemin e kuotës me raport 2 me 1 në qytetet e mëdha, kuotën 3 me 1 në qytetet e vogla dhe sistemin e kuotës 4 me 1 në nivel komune. U desh të kalonin pesë vjetë që kuotimi gjinor i përfaqësimit të bëhej kusht i detyrueshëm me ligj. Kjo ndodhi me ndryshimet në Kodin Zgjedhor, në dhjetor 2008, kur u sanksionua me ligj kuota 30% e përfaqësimit të grave në Kuvend. Pika 6 e nenit 67 të Kodit Zgjedhor përcakton “*për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumemërore duhet t’i përkasë secilës gjini*”

Numri prej 23 deputetesh gra (16.4%) në legjislaturën e fundit parlamentare, përfaqëson gati gjysmën e kuotës së detyrueshme ligjore (30%) për përfaqësimin e gruas në parlament vendosur në Kodin e Ri Elektorale në Shqipëri. Me ndryshimet në Kodin Zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të 29 qershorit 2009 u vendos kuota e

detyrueshme për çdo parti, për një përfaqësim prej 30% vajza ose gra të kandidateve për deputet. Ky “rregullim” ishte një kurth, pasi 30% e kandidateve nuk do të thoshte 30% të deputetëve, pra e përfaqësimit në parlament. Që të mund të arrihej ky përfaqësim duhej që në renditjen e kandidatëve të çdo partie, për çdo zonë elektorale të renditej në tre emrat e parë një grua, gjë që në fakt nuk ndodhi. Në parlament u përfaqësuan vetëm 16.4% gra, pra vetëm gjysma e kuotës prej 30%. Në raportin e vet, për zgjedhjet, OSBE-ODIHR rekomandoi se duhej marrë parasysh rritja e gjobave për subjektet elektorale që nuk respektojnë kriterin gjinor dhe të kushtëzojë marrjen e fondeve publike nga respektimi i këtyre dispozitave. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor të miratuara në gusht të 2012-ës përfshinin rritje të penaliteteve për partitë në rast mosrespektimi të kuotës gjinore, por Komisioni Evropian në progresraportin e atij viti kritikon faktin që nuk parashikohen dispozita për refuzimin e listave që nuk respektojnë kuotat dhe tërheq vëmendjen se *“është i nevojshëm aplikimi më strikt i kuotës gjinore në prag të përgatitjeve për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Zbatimi i legjislacionit dhe politikave ekzistuese për të drejtat e grave duhet të përshpejtohet.”*

Përfundime

1. Barazia gjinore nuk është e mbrojtur akoma në mënyrë të mjaftueshme në shoqërinë shqiptare. Ndërsa mundësia që u jepet grave për poste të rëndësishme politike, sociale dhe ekonomike është e mundshme, tradita e një shoqërie të dominuar nga burrat mbetet mbizotëruese, në mënyrë të veçantë në zonat rurale. Duhet të bëhen përpjekje për të siguruar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, përta i përket burimeve, mundësive dhe përfitimeve në realitetin praktik.
2. Por që barazia gjinore të arrihet vërtet duhet jo vetëm të njihet ligjërisht, por dhe të zbatohet me efikasitet në të gjitha aspektet e jetës, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Nëse barazia gjinore nuk do të vihet në qendër të politikave sociale do të dëmtojë përpjekjet e Shqipërisë për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, pasi jo vetëm nuk do të shfrytëzohet potenciali i plotë njerëzor i vendit, por arritjet nuk do t'i gëzojnë të gjitha grupet shoqërore. Për rrjedhojë integrimi gjinor duhet të bëhet pjesë e të gjitha institucioneve shtetërore, qendrore, ekzekutive apo ligjvënëse.
3. Kjo gjendje nuk vjen nga indiferentizimi i grave për t'u përfshirë në politikë dhe nuk tregon as paaftësinë e grave dhe e vajzave në këtë drejtim. Ajo është e lidhur me mentalitetin, klimën e ashpër politike, mungesën e strukturave sociale mbështetëse ndaj gruas dhe pasqyron mungesën e standarteve dhe mekanizmave efikase për përcaktimin e përparësive që do të mundësonin rritjen e pranisë së grave në drejtimin e vendit, një rol për të cilin edhe ato vetë duhet të jenë më këmbëngulëse. Fakti që gratë marrin pjesë dhe tregohen mjaft aktive gjatë fushatave elektorale, janë promovuese shumë të mira të programeve të forcave të tyre politike, luajnë me përgjegjshmëri rolin e komisionerit, tregon se gratë janë të afta për të mbajtur përgjegjësi politike. Por ky rol nuk është vlerësuar nga forcat politike. Ky përfaqësim dëshmon edhe njëherë

konservatorizmin e një politike, si politikë e dominuar nga meshkujt në Shqipëri.

4. Vendosja e kuotës gjinore në Kodin e Ri Zgjedhor, ishte një hap pozitiv dhe një shtysë për të rritur pjesëmarrjen e gruas në jetën politike të vendit, por kuota gjinore nuk u respektua në të gjithë vendin gjatë zgjedhjeve legislative të vitit 2009 dhe në zgjedhjet vendore të majit 2011. Për rrjedhojë në parlament vetëm 16.4% e numrit të përgjithshëm të deputetëve janë gra, ndërsa në pushtetin lokal kemi vetëm pesë gra kryetare bashkie dhe dy kryetare komune.

Rekomandime

Mënyra për të rritur pjesëmarrjen e grave në institucionet vendimmarrëse dhe në jetën politike:

- Npërmjet aplikimit strikt të kuotës gjinore të përfaqësimit.
- Ndërgjegjësimi të shoqërisë se pjesëmarrja aktive e gruas në politikë do t'i sjellë jetës politike vlera të reja, do të rrisë solidaritetin dhe barazinë dhe do të ndihmojë në ndërtimin e një shoqërie më demokratike dhe mëpaqësore.
- Të kuptuarit se barazia gjinore në politikë nuk është një problem vetëm i grave, por një përgjegjësi e partive politike dhe e shoqërisë shqiptare në tërësi.

Bibliografia

Vicker, M., *“Shqiptarë”*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2008.

Dervishi, Zyhd., *“Gratënë turbulencat e mëndësive dhe realitetit politik”*, Tiranë, 2011.

Kuvendi i Shqipërisë, *“Gratënë kuvend”*, Tiranë, 2003.

MPÇSSH,

OSCE, *“Strategjia Kombëtare për barazi gjinore dhe kundërdhunë në familje”*, Tiranë, 2008.

<http://www.instat.al>

Social Research Centre INSTAT, *“Albania woman-children report”*, 2006.

<http://www.mie.gov.al>

Kuvendi i Shqipërisë, *“Gratënë kuvend”*, Tiranë, 2003.

<http://www.cec.org.al/index/rezultatet>

Dervishi, Z., *“Gratënë turbulencat e mëndësive shoqërore dhe realitetit politik”*, Tiranë, 2011.

<http://www.un.org.al>, *“Un women in Albania”*, 2012.

DALLIMET SOCIO-ETNIKE DHE NXITJA E KONFLIKTEVE TEK GRUPMOSHAT ADOLESHENTE NË RAJONIN E TETOVËS

Ardita Abduli

Departamenti i Sociologjisë, Fakulteti Filozofik

Universiteti Shtetëror i Tetovës

Permbledhje

Shqetësimi dhe interesi i shoqërisë sonë për konfliktet ndëretnike tek grupmoshat shkollore është goxha i madh sidomos kur bëhet fjalë për veprime të cilat sjellin destabilizim në komoditetin dhe lirinë e individit. Pothuajse edhe sot në kohën e demokracisë kulminante vendi ynë ballafaqohet akoma me urrejtje, nënçmime, përbuzje, dhunë e konflikte, e aq më tepër tek moshat e reja.

Të hulumtosh në mënyrë sociologjike shkaqet dhe pasojat që vijnë nga dallimet socio-etnike si dhe format e manifestimit të konflikteve tek grupet adoleshente do të thotë të nxjerrësh në dritë shumë elemente të cilat konsistojnë në nxitjen e urrejtjes dhe dhunës tek të rinjtë me tendencë edhe në paraqitjen e një diversioni mbi shoqërinë në tërësi.

Kështu, duke u bazuar në kërkimet empirike ky punim do të jetë një projekt i cili do të na sjellë të dhëna mbi shkaqet dhe pasojat e konflikteve të moshave adoleshente në vendin tonë, kryesisht në zonat rurale dhe urbane të Tetovës, format e manifestimit të urrejtjes dhe konflikteve ndëretnike si dhe paragjykimet negative ndaj dallimeve socio-kulturore.

Fjalët kyçe: *dallime etnike, konflikte, adoleshentë, urrejtje, paragjykime*

Abstract

The concern of our society about inter-ethnic conflicts between teenage group is pretty big, especially when it comes to actions which bring instability in the comfort and freedom of the person. Almost today in time of culminat democracy our country confront with hatred, humiliating, contempt, violence and conflict, and even more so to young people.

To search in sociological way the causes and consequences of socio-ethnic differences and forms of manifestation of conflicts to adolescent groups means bring to light many elements which consist on incitement to hatred and violence in young people awith tendencing presentation of a diversion on society as a whole.

Thus, based on empirical researches this paper will be a project that will bring us data on the causes and consequences of adolescent ages conflicts in our country, mainly in rural and urban areas of Tetovo, forms of manifestation of hatred and interethnic conflicts and negative prejudice towards socio-cultural differences.

Key words: ethnic differences, conflicts, adolescent, hatred, prejudice

Urrejtja ndëretnike shkas për nxitjen e konflikteve mes adoleshentëve

Duke pasur parasysh faktin që vendi ynështë një përbërje heterogjene e shoqërisë padyshim se në mënyrë të pashmangshme egzistojnëparagjykime negative të cilat në të shumtën e rasteve shoqërohen me ngacmime dhe konflikte. Periudha e tranzicionit e cila u shoqërua me ndryshime thelbësore në të gjitha sferat sociale, në një farë mënyre sikur solli një frymë demokratike mbi lirinë dhe barazinë e pakicave etnike, megjithatë edhe përkundër ndryshimeve kushtetuese urrejtja ndëretnike vazhdon të jetë pjesë e pandashme në shoqërinë tonë me tendencën dhe shtyrjen e gjeneratave të reja për aksione konfliktuoze, sidomos tek grupet adoleshente të cilët janë më të ndjeshme në këtë aspekt. Duke folur mbi urrejtjen ndëretnike disa sociologë do ta trajtonin këtë si një problem i cili inkorporohet në të gjitha shoqëritë ku ka përzierje etnike dhe multikulturore, nga vetë fakti se jo vetëm Maqedonia është një vend me shoqëri multikulturore, porse ky problem pikë së pari është paraqitur edhe në shtetet më të zhvilluara si në Amerikë, Evropë e gjetiu. Kështu Stiven Best dhe Daglas Kelner do të theksonin se në periudhën më të re, respektivisht në periudhën e shoqërisë globale, e njohur si shoqëri postmoderniste popullata akoma merret me probleme mikrosociologjike që në këtë rast do të ishin tensionet etnike.


(B. Stiven& Kelner. D, 1991 : 43).

Në anën tjetër ndër faktorët kryesorë që ndikjonë në nxitjen e urrejtjes ndëretnike janë paragjykimet dhe stereotipet negative të cilat përveç tjerash kanë bazë psikologjike dhe socio-kulturore, pastaj faktori politik i cili nuk reagon në kohë të duhur. Në të njëjtën kohë sociologu i njohur anglez Anthony Gidens do tëshprehej se urrejtja ndëretnike është burim psikologjik i individëve të cilët shprehin antagonizma kundër atyre që për shkak të të tjerëve fajësohen për gjithçka (A. Gidens, 2000:252), që do të thotë se paragjykimet negative ndaj të tjerëve janë pasojë e fajësisë së pakicave etnike për çështjet ekonomike, politike, kulturore, arsimore etj.

Në vazhdim të këtij teksti do të paraqesim të dhënat argumentuese që të rinjtë e shkollave të mesme të qytetit të Tetovës janë shprehur për burimin e konflikteve ndëretnike dhe në çfarë baze ata etiketohen.

Duke u bazuar në mostrën hulumtuese që në rastin konkret janë nxënësit e shkollave të mesme të Tetovës, ne, kemi arritur të nxjerrim disa të dhëna që pak a shumë na tregojnë për raportet ndëretnike në këtë rajon. Në anketim janë përfshirë gjithsej 200 nxënës nga 3 shkolla të mesme, kryesisht të moshës 15-18 vjeçe të cilët kanë qenë dhe mbeten dëshmi e ngacmimeve ndëretnike.

Çka mendoni ju: Ku qëndron thelbi i konflikteve tek të rinjtë në qytetin tuaj?




Duke u nisur nga fakti se në qytetin tonë kemi një përzierje etnike në mes shqiptarëve dhe maqedonasve, padyshim që egzistojnë qëndrime nacionaliste kur është në pyetje kombi. Kështu, në rastin e hulumtimit tonë në pyetjen se ku qëndron burimi i konflikteve mes të rinjëve nga gjithsej 200 të anketuar, nxënës shqiptarë dhe maqedonas janë shprehur se burimi i konflikteve janë përkatësia etnike, edhe raporti qëndron në mes 52 %. Ndërkaq rreth 24, 5% i nxënësve kanë deklaruar se burim i konflikteve mund të jetë edhe xhelozia, pra mund të jetë xhelozia për para, prestigj, për femra etj. Afër 23, 5 % kanë deklaruar se shkas i konflikteve mes të rinjëve janë faktorë të tjerë, dmth. jashtë përkatësisë etnike dhe xhelozisë, e ndër ta si shembuj kanë deklaruar si psh. provokimet, kryençësia, vjedhjet të cilat shpeshherë janë pasojë e moskujdesit familjar dhe moskontrollit institucional në shoqëri.


Nga rezultati i të dhënave të sipërshënuara mund të vëmë re se përkatësia etnike është një ndër faktorët e shfaqjes së konflikteve në shoqëri, sidomos tek moshat e reja, e këtë përveç rezultatit numerik na dëshmojnë edhe shumë raste të tjera të cilat ne i ndjekim përmes mediumeve, dhe nuk janë të rralla ato që dëgjojmë se grupe të rinjsh kanë përdorur forcën e tyre fizike për të mposhtur palën e kundërt e ndër të tjera politika e shtetit nuk është në gjendje që t'i eliminojë.

Cfarë etiketimesh ju jepni të rinjëve më përkatësi tjetër etnike: _____?

Nxënësit maqedonas:



Nxënësit shqiptarë:



Në rrafshin e etiketimit ekzistojnë mjaft emra me të cilët në mënyrë përbuzëse iu ngjitet grupit paragjykses. Kështu, të dhënat e paraqitura në grafik tregojnë se ndër etiketimet më të shpeshta që iu drejtohen palës maqedonase janë shkije, kështu janë përgjigjur rreth 24 % e të anketuarve, *nacionalistë* rreth 29 % si dhe rreth 47% nga masa e përgjithshme janë deklaruar si *racistë* dhe kjo rezulton në faktin se popullata maqedonase gjithmonë ka mbisunduar mbi atë shqiptare përmes formave shtypëse dhe denigruese. Ndërsa nga pala maqedonase rreth 68 % u deklaruan se shqiptarët zakonisht i etiketojnë si terroristë dhe që paraqet përqindjen më të lartë të të anketuarve nga masa e përgjithshme, pastaj rreth 12% u shprehën si *shiptari* ndërsa rreth 20% u shprehën se ata i etiketojnë si *bisha me dy koka*. Këto të dhëna flasin se etiketimi për palën tjetër nuk mund të eliminohet, dhe kjo tregon se akoma ekziston një shkallë e urrejtjes ndëretnike në vendin tonë. Megjithatë nuk mungojnë edhe etiketimet nga aspekti socio-kulturor me çka palët etiketohen përmes formave fetare, veshjeve dhe stilit të të jetuarit.

Format e manifestimit të konflikteve tek grupmoshat shkollë


Egzistojnë forma mjaft të ndryshme përmes të cilave grupet adoleshente qoftë në mënyrë individuale apo grupe e shprehin mllëfin e tyre në baza ndëretnike. Një ndër format më evidente është agresiviteti i cili rrjedhimisht është kushtëzuar nga faktorët psiko-emocionalë. Në këtë rast kemi të bëjmë me agresivitetin kolektiv i cili është përcjellë me thyerje, demolime dhe djegie të objekteve dhe pronave të grupit tjetër etnik. Këtë përshkrim më së miri do ta trajtonte Gystav Le Boni në teorinë e tij të turmës ku në mes të tjerash thekson se arsyeja e veprimit të masës është e ndjekur nga emocionet dhe jo nga mendja e tij. Individu ifutur në turmë tjetërsohet nga vetvetja dhe reagon e vepron në sajë të turmës duke e shprehur kështu ashpërsinë, spontanitetin, egërsinë dhe njëkohësisht heroizmin e tij (Deli, Edi 2003).

Ndër format e tjera karakteristike përmes të cilave grupet adoleshente futen në konflikte ndëretnike janë rrahjet, zënkat dhe brohoritjet nëpër rrugë, oborret e shkollës, vendet publike etj. Zakonisht këto vijnë si rezultat i ngacmimeve dhe provokimeve të rastësishme të cilat rezultojnë me forma konfliktuoze. Konfliktet, pavarësisht mënyrës se si manifestohen, paraqesin një situatë ku dëmtohet integriteti social dhe individët shkrihen në ndjenjat e tyre saqë nuk arrijnë më të shohin dhe perceptojnë se ç'ndodhnë të vërtetë përreth, kushtu shprehet Friedrich Glasl –drejtuesi i shumë seminareve për menaxhimin e konflikteve i cili në vazhdimësi shpreh edhe faktin se problemi i vërtetë i konflikteve qëndron në rrezikun e vazhdueshëm të përshkallëzimit


të tyre, duke iu mësuar gjithnjë e më shumë strategjive të pushtetit dhe dhunës. Kështu, konflikti bëhet gjithnjë e më i vështirë për t'u drejtuar derisa del jashtë kontrollit, kalon pragun e dhunës duke u bërë shkak i shkatërrimit të jetës. Një bashkëjetesë e mëtejshme bëhet në këtë mënyrë për një kohë të gjatë shumë e vështirë gatie pamundur (Glasl. F – 2002 : 2-3).

Për më tepër, që të jemi më të përafërt nga mënyrat e manifestimit të konflikteve le të shohim qëndrimet e të anketuarve tanë:

1. Cila lloj e dhunës dominon në shkollën tuaj:




2. Kur ndodhin rrahjet dhe zënkat më së shumti:



Rezultati nga pyetjet e lartpërmendura tregon të dhëna adekuata mbi atë se ç'ndodh në të vërtetë në vendin tonë. Të gjithë e dimë se koha e lirë ka rëndësi të posaçme në relaksim e individit përmes aktiviteteve kulturore e sportive dhe organizimin e tribunave multikulturore ku mund të krijohet një frymë humaniste mes etnive të ndryshme, por në të vërtetë rreth 27, 0% kanë deklaruar se konfliktet më shpesh ndodhin gjatë kohës së lirë. Duke qenë dëshmitarë të konflikteve shkollore afër 54, 5% janë shprehur se të rinjtë më shumë konfliktohen gjatë pushimit të shkurtër pra, ata në vend që ato pak minuta t'i shfrytëzojnë për argëtim apo ushqim ata mezi presin që t'i shfaqin armiqësinë grupit tjetër etnik. Derisa 18, 5% nga numri i përgjithshëm thonë se konfliktet ndërretnike të rinjtë presin pas mbarimit të mësimit pra, përfundimi i mësimit ditor nuk korrespondon me përfitimin edukativ por me kureshtje dhe pritje e padurim të për të sulmuar të tjerët. Nga kjo mund të konstatojmë se: *pavarësisht qëndrimeve të të anketuarve të rinjtë në*

përgjithësi nuk kanë ndonjë kohë të caktuar për shfaqjen e urrejtjes së të tjerëve, kështu që konfliktet mund të shfaqen në çdo kohë të pacaktuar.

Në cilat vende ndodhin më së shumti konfliktet mes grupeve të ndryshme etnike?



Duke pasur parasysh vendet, të cilat frekuentohen më shumë nga të rinjtë, është me rëndësi të shqyrtojmë qëndrimet e të anketuarve se në cilat vende ndodhin më shpesh konflikte mes grupeve me etni të ndryshme. Përqindje më e lartë rezultoi të jetë nëpër sheshe publike, ku rreth 48,5 % e popullsisë së përgjithshme, armiqësia ndëretnike është e dukshme sidomos nëpër stadione të lojrave sportive, aktiviteteve kulturore etj., dhe shfaqet në format më të ashpra, si: rrahje, brohoritje raciste, djegie të simboleve etnike, këngë me përmbajtje raciste etj. shpeshherë Pastaj afër 37,0 % e të anketuarëve deklarojnë se konfliktet ndodhin më shpesh në oborrin e shkollës, ku paralele të dy etnive të ndryshme përmes dhunës fizike e shprehin mllëfin e tyre ndëretnik i cili në të shumtën e rasteve burimin e ka nga politika famëkeqe e vendit tonë dhe mungesa e kontrollit dhe sigurisë në shkollë. Rreth 14,5% deklarojnë se konfliktet mund të ndodhin edhe në rrugë, e sidomos kjo është pasojë e bandave rrugore të cilët duke lëvizur nëpër lagje të ndryshme përmes pamfleteve raciste, brohoritjeve nxisin në aksion edhe palën tjetër me çka mund të vijë deri tek rrahjet dhe format e tjera fatale. Përgjithësisht përqindja më e madhe rezultoi në konfliktet nëpër sheshe publike që tregon se këto vende paraqiten si rrezik i jetës së të rinjve deri në momentin që shteti nuk ndërmerr masa të duhura për mbrojtje dhe siguri.

Reagimi i shkollës dhe shtetit në parandalimin e këtyre konflikteve

Procesi edukativo-arsimor ndikon në marrëdhëniet ndëretnike që krijohen në kuadër të shkollës dhe mjedisit të saj, literaturës shkollore dhe qëndrimeve politike në vend. Shpeshherë ndodh që si pasojë e tensioneve politike në nivel shtetëror dhe ideologjisë blasfemike të paraqiten stereotipe negative edhe në mjedisin shkollos të cilat shoqërohen me pasoja konfliktuoze mes nxënësve, të cilat edhe procesi arsimor nuk është në gjendje t'i tejkalojë. Roli kryesor në ndërtimin e marrëdhënieve ndëretnike i takon personelit të shkollës dhe arsimtarëve të cilët përmes leksioneve


të tyre bartin vlera në mendjen e nxënësve. Sipas prof. Zyhdi Dervishit shkolla luan rol në procesin kompleks të shoqërizimit të nxënësve dhe adoleshentët për dallim nga nxënësit e shkollave fillore dhe studentëve janë më të prirur për tu konfliktuar me njeri-tjetrin. (Dervishi Z. 2007: 115-116).

Duke e ditur natyrën e konflikteve në shkollë, në rastin konkret konfliktet për shkak të urrejtjes ndëretnike shkolla mban një përgjegjësi të madhe për këtë, pasi tregon nivelin edukativ përpara opinionit dhe tregon faktin se ajo nuk është në gjendje të krijojë një frymë harmonike dhe krijimin e vlerave edukative për një shoqëri të shëndoshë. Andaj në kushte të shkollave me përzierje ndëretnike ku emocionet patriotike janë shumë sensuale nevojitet shumë kujdes për harmonizimin e raporteve ndërmjet nxënësve. Studiuesi i njohur i konflikteve në mjedisin shkollor Daniel Shapiro thotë se në raste të konflikteve së pari, është e domosdoshme rivendosja e kushteve normale, shmangia e krizave ndërmjet nxënësve, korrigjimi i sjelljeve të ngjajshme etj. (Murati Xh. 2002: 204).

Në këto situata rol mjaft të madh luan edhe arsimtari. Studiuesi i njohur Silvo Devetak në librin e tij “*Minoritetet, të drejtat njerëzore dhe demokracia*” thekson: Në shoqëritë ku jetojnë grupe të ndryshme etnike, arsimtarët duhet të jenë të njoftuar me të gjitha dallimet, në atë mënyrë që do të kuptohen normat dhe vlerat e ndryshme kulturore të cilat do të ballafaqohen në shkollë. (S. Devetek, 2005).


Ndonjëherë ndodh që edhe shkolla nuk reagon në mënyrën e duhur, sidomos kur mungon cilësia dhe personeli i duhur për trajtimin e mirëfilltë të nxënësve që konfliktuohen. Në vendin tonë këto raste janë shumë të shpeshta pasi shkollat tona akoma ndikohen nga urrejtjes ndëretnike. Miclekthwait dhe Wooldrige theksojnë se shteti është një vegël jashtëzakonisht jo e mprehtë, ai merr një ide të përgjithshme dhe ua bën të detyrueshme të tjerëve pa marrë aspak parasysh rrethanat vendore, e kjo është dëshira e dëshpëruar e politikanëve për të gjetur një zgjidhje magjike (Fullan M. 2001: 323). Konfliktet janë të varura edhe nga politika shtetërore pasinë kuadër të acarimeve ideologjike, kulturore dhe nacionale ato pa kontekst reflektohen tek nxënësit adoleshent sepse ata janë më të ndjeshëm në aspektin psiko-emocional dhe ne jemi dëshmitar të shumë rrahjeve që kanë ndodhur nëpër shkolla të mesme në vend.

Cfarë masash ndërmerr personeli i shkollës për nxënësit që konfliktuohen:



Përgjithësisht roli i procesit mësimor është të edukojë nxënësit për eliminimin e paragjyimeve ndëretnike duke i krahasuar ata drejt bashkëpunimit dhe ndërtimit të një ardhmërie të shëndoshë me vlera humane. Megjithatë rezultatet e anketimit flasin se, në vendin tonë përkundrazi, shkolla dhe procesi arsimor paraqiten si gjeneratorë të konflikteve ndëretnike e aq më tepër të intensifikimit të paragjyimeve ndëretnike, sidomos kur udhëheqësi i shkollës i takon palës superiore. Kështu, edhe qëndrimet e nxënësve lidhur me masat që ndërmerr personeli i shkollës në raste të paraqitjes së konflikteve janë në balancin e sipërshtuar në grafik. Pra rreth 49,0 % e nxënësve deklarojnë se nxënësit që konfliktuohen automatikisht largohen nga shkolla, kjo tregon faktin se shkolla në këtë rast nuk zotëron mënyra të përshtatshme për riedukimin e këtyre nxënësve. Ndërkaq rreth 23% përsëri deklarojnë se personeli i shkollës nuk ndërmerr asnjë hap lidhur me paraqitjen e konflikteve, respektivisht ai paraqet një neglizhencë dhe një papërgjegjësi për atë që ndodh në mjedisin shkollor. 19% e nxënësve deklarojnë se nxënësit që konfliktuohen me moshatarët e tyre të etnive të ndryshme dënohen fizikisht nga ana e personelit të shkollës. E kjo nuk është mënyra më e efikase për tejkalimin e konflikteve, përkundrazi dhuna fizike ndikon në shtytjen e agresivitetit të mëtejshme tek nxënësit. Përqindja më e vogël qëndron në çështjen e dërgimit të nxënësve që shkaktojnë konflikte, nëpër institucione rehabilitimi, respektivisht kurimin e tyre nëpër qendra psiko-pedagogjike. Vetëm 9% e nxënësve deklarojnë në këtë mënyrë. E gjithë kjo tregon për nivelin e shkollave tona, respektivisht aftësinë e shkollës për të menaxhuar dhe eliminuar konfliktet e mundshme ndëretnike. Shkollat të cilat nuk kanë mbrojtje dhe siguri të posaçme, nuk kanë kontroll të mjaftueshëm ndaj nxënësve dhe nuk kanë qasje të mirëfilltë në organizimin dhe edukimin e nxënësve pa dallime etnike dhe religjioze e kanë të vështirë të eliminojnë konfliktet. Për këtë nevojitet shumë punë!

Cili është reagimi i arsimtarëve në raste të konflikteve:



Arsimtari përmes qëndrimeve të tij ndaj nxënësve i bart qëndrimet dominante, vlerat, normat, pikëpamjet e ndryshme etj. Meqë arsimtari i takon një grupi etnik shpeshherë ndodh që ato qëndrime t'i bartë edhe tek nxënësit e tij. Nga dëshmitë që zotërojmë, thuhet se ekzistojnë raste kur nxënësit e një përkatësie etnike diskriminohen nga ana e arsimtarit të tyre në vlerësim, trajtimin gjatë orëve mesimore etj. Duke u mbështetur në analizat e të dhënave që posedojmë nga hulumtimi ynë vërejmë se qëndrimet e nxënësve lidhur me këtë çështje janë se rreth 47, 5% e arsimtarëve nuk prononcohen publikisht për konfliktet e mundshme. Kjo mund të jetë pasojë e bindjes ideologjike të vet arsimtarit, frikës nga mediumet për të cilën arsimtari më vonë mund të ndiejë pasojat, në mbrojtje të etnitetit të vet ai nuk dëshiron që ta fajësojë grupin e etnisë përkatëse që tregon se ka raste kur arsimtari është vet nxitës i konflikteve. 36% e nxënësve deklarojnë se në rastet e konflikteve, arsimtarët kërkojnë ndihmë nga familja dhe shteti, pasi dihet që familja është katalizatori kryesor i edukimit dhe kujdesit të fëmijëve dhe në këtë rast prindërit janë ata të cilët do t'i dalin në ndihmë fëmijëve të tyre. Masa sigurimi në rastin konkret duhet të marrë edhe shteti i cili përmes politikës sociale do të vendosë masa disiplinimi për nxënësit problematikë, e atë më tepër të ndajë mjete për organizimin e tribunave dhe aktiviteteve socio-kulturore ku do të mund të zbuten ndjenjat paragjykuuese ndaj nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike. Në rastin e kësaj çështje nxënësit janë prononcuar edhe për mungesën e përgjegjësisë së arsimtarëve të tyre në rastet e konflikteve. Kështu shprehen rreth 16% e të anketuarve nga numri i përgjithshëm. Kjo, tregon faktin e neglizhencës së arsimtarëve për rastet e tilla, dmth. arsimtari qëndron në një gjendje indiferente ndaj konflikteve dhe nuk sensibilizohet për të përdorur metodat e tij efektive për eliminimin e konflikteve. E kjo është pasojë e faktit që nëpër shkollë nuk është zgjedhur kuadër i mirëfilltë edukativ, respektivisht arsimtar i cili i plotëson kushtet profesionale për të qenë pjesë e shkollës andaj edhe ekzistojnë kushte nga të cilat paraqiten konfliktet.

Thënë përgjithësisht roli i arsimtarit është mjaft i rëndësishëm në ndërtimin e marrëdhënieve ndëretnike në shkollë andaj ky si agent i socializimit në shkollë bart padyshim vlera apo antivlera në drejtim të formimit të personalitetit të nxënësit.

Konkluzione

Analizat përmbyllëse të këtij hulumtimi shtjellojnë qasjen sociologjike mbi paragjykimet dhe konfliktet e mundshme ndëretnike në qytetin e Tetovës si një qytet me përbërje heterogjene të popullatës, ku egzistojnë mjaft shkolla të mesme me paralele të përziera etnike. Për të vënë në spikamë nivelin e marrëdhënieve ndëretnike mes të rinjëve, respektivisht shkollarëve të mesëm si dhe shkaqet për nxitjen e konflikteve mes tyre, ne kemi përdorur instrumentet anketuese, dhe përmes qëndrimeve të nxënësve kemi arritur deri tek rezultatet e mundshme. Duke e ditur faktin se në vendin tonë secili individ trashëgon nga pak ideologji dhe paragjyime që nga familja, rrethi shoqëror dhe shteti i cili në situata të caktuara paraqitet si agjent i nxitjes së urrejtjes ndëretnike padyshim që edhe konfliktet janë të mundshme.

Dallimet socio-etnike dhe paragjykimet negative in korporohen në të gjitha sferat e jetës, por masa më sensuale është ajo kur kjo dukuri i përfshin moshat e reja për të cilat paraqet pengesë në inkuadrimin e mëtejshëm shoqëror.

Përfundimisht duke parë mirë situatën politike në vendin tonë ky punim paraqet një potencial kërkimor i cili i bazuar në të dhëna empirike tregon për gjendjen aktuale ndëretnike të të rinjëve në qytetin e Tetovës.

Bibliografia

Best, Stiven & Kelner, Douglas – Postmodern Theory, The Guilford Press – New York, 1991

Gidens, Anthony – Sociologjia, Sh. b. Çabej – Tetovë, 2000

Deliu, Edi–Përkthim, Dosie: Psikologjia e turmave: Diktatorët e përdorin si vrasëse mendore, FAKTI, shtator 2003

Glasl, Friedrich – Conflict analysis tools – Broshurë, Swis Agency for Developmentand Cooperation (SDC), 2002

Dervishi, Zyhdi – Bashkëjetesë me demonët e konflikteve, Sh. b. Jerusalem” Tiranë, 2002

Fullan, Michael – Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim. Botimi III, CDE 2001, Tiranë

Murati, Xheladin – Komunikologjia, Sh. b Çabej, Tetovë, 2002

Devetak, Silvo – Minority, human rights and democracy” – International project of ISCOMET and ECERS, Maribor, 2002

MIGRIMI RURAL-URBAN: DINAMIKAT DHE PERSPEKTIVAT PËR INTEGRIMIN NË RRAFSHIN SUBKULTUROR- RASTI I QYTETIT TË KORÇËS

Denisa Titili

Departamenti i Shkencave Sociale, Universiteti “Fan S. Noli”

Përmbledhje

Përgjatë njëzet viteve të fundit shoqëria shqiptare ka pësuar një sërë ndryshimesh ekonomike, sociale e kulturore, të shkaktuara veçanërisht prej flukseve në rritje të migrantëve të brendshëm dhe atyre ndërkombëtarë. Ndryshime të theksuara kulturore evidentohen edhe në mjedisin social e kulturor të qytetit të Korçës, i cili është karakterizuar nga dukuria e zhvendosjes masive të popullsisë nga zonat rurale drejt qytetit. Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e fenomenit të migrimit dhe pasojave që ai sjell në planin kulturor, ne synojmë të hulumtojmë procesin e përshtatjes dhe integrimit ndërmjet nënkulturës rurale dhe subkultures së banorëve të qytetit të Korçës.

Ky studim sjell njohuri të reja në përputhje me studimet ekzistuese dhe hedh dritë mbi procesin e integrimit ndërmjet subkulturave në kontekstin lokal të qytetit të Korçës. Të dhënat për këtë studim janë siguruar në sajë të përdorimit të pyetësorit dhe intervistave në thellësi me banorët e disa lagjeve të qytetit.

Fjalët kyç: integrim kulturor, subkultura rurale/urbane, diversitet kulturor, megrim

Abstract

Over the past twenty years the Albanian society has experienced a number of economic, social and cultural changes, caused especially by increasing flows of internal and international migrants. Significant cultural changes are evidenced in social and cultural environment of Korca city, which is characterized by the phenomenon of massive displacement of population from rural areas to the city. Taking into consideration the complexity of the phenomenon of migration and the consequences that it brings in the cultural plan, we intend to examine the process of adaptation and integration between the subculture of migrants coming from rural areas and the subculture of Korca citizens.

This study provides new insights in line with existing studies and sheds light on the process of integration between subcultures in the local context of the city of Korca. Data for this study were provided thanks to the use of the questionnaire and in-depth interviews with residents of several neighborhoods of the city.

Key words: Cultural integration, rural/urban subculture, cultural diversity, migration

Hyrje

Ky punim ofron një qasje teorike për konceptualizimin e fenomenit të migrimit rural-urban si një sistem, duke identifikuar elementët bazë ndërveprues, atributet dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Kjo bazë teorike na ndihmon të kuptojmë dukuritë migratore në qytetin e Korçës, si edhe të identifikojmë faktorët shtytës dhe tërheqes që ndikojnë në procesin e migrimit të brendshëm.

Nëpërmjet identifikimit të dukurisë së migrimit si një sistem, synojmë të shqyrtojmë dhe analizojmë problemin e integritit në rrafshin subkulturore, si dhe të identifikojmë shkallën e integritit dhe përshtatjes socio-kulturore të migrantëve në mjedisin e ri urban dhe ndikimet e subkulturës rurale në atë urbane.

Nuk ka dyshim që jeta urbane e qytetit të Korçës ka pësuar një sërë ndryshimesh, të cilat lidhen me faktorë të ndryshëm, ndërmjet të cilëve dukuritë migratore kanë ndikuar në mënyrë të dukshme në krijimin e një shoqërie heterogjene dhe diverse nga pikpamja kulturore.

Ky studim u shtri në tre lagje të qytetit të Korçës, lagjia 1, 2, 3 si edhe në dy lagje periferike të qytetit. Arsyeja e shtrirjes së studimit në këto lagje të qytetit të Korçës është se ato prezantojnë një mjedis kulturor ku bashkëjetojnë subkultura rurale e banorëve të zbritur nga fshatrat dhe zonat periferike përreth, si edhe subkultura urbane korçare.

Për mbledhjen e të dhënave u përdorën intervista dhe pyetësori. Për përpunimin e të dhënave u përdor analiza e kombinuar e metodave sasiore dhe cilësore që mundësuan bërjen e krahasimeve dhe identifikimin e problemeve.

1 - Përkufizimi i sistemit të migrimit rural- urban

Një sistem mund të përkufizohet si një kompleks i elementëve ndërveprues, së bashku me atributet dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Një nga çështjet më të rëndësishme për konceptualizimin e fenomenit të migrimit si një sistem, është identifikimi i elementeve bazë ndërveprues, attributeve dhe marrëdhënieve të tyre. Sistemi vepron në një mjedis të caktuar. Për një mjedis të dhënë ky sistem përfshin një tërësi elementesh, ndryshimi i attributeve të të cilave ndikon në gjithë sistemin dhe ndikohet nga sjellja e sistemit.

Përpyekja për konceptualizimin e migrimit rural -urbankonsiston në evidentimin e elementeve bazë të një sistemi të migrimit rural- urban ashtu si edhe mjedisin brenda të cilit sistemi operon. Qasja ndaj sistemeve të migrimit rural-urban është e lidhur, jo vetëm me arsyen se pse njerëzit migrojnë, por edhe të gjitha implikimet dhe pasojat e procesit. Kjo qasje synon t'u japë përgjigje pyetjeve të tilla si:

Si dhe pse një individ nga zonat rurale bëhet një banor i përhershëm i qytetit?
Çfarë efektesh ka ky ndryshim si në hapësirën rurale, prej nga ai vjen, ashtu edhe në hapësirën urbane ku ai zhvendoset?

Cila është struktura/modeli bazë i këtyre lëvizjeve dhe si përcaktohet ai?

Këto dhe të tjera pyetje përcaktojnë problemet të cilat kërkojnë një teori të migrimit rural- urban

Në shoqërinë shqiptare të paraviteve 90' hapësirat rurale konsideroheshin si të vetëmjaftueshme dhe politikat nuk lejonin lëvizjen e banorëve nga zonat rurale drejt atyre urbane. Ndryshimet politike, ekonomike e shoqërore që karakterizuan vendin në vitet 1990-1991 dhe më pas, u shoqëruan me zhvendosjen masive të popullsisë nga hapësirat rurale drejt atyre urbane e suburbane. Në këtë kuadër është e rëndësishme të pyesim:

Cilat forca kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë në dobësimin e kushteve si vetëmjaftueshmëria në zonat rurale dhe dyndjen e banorëve në zonat urbane?

Këto forca janë kryesisht të vëna në lëvizje nga rritja e zhvillimit ekonomik. Ne të gjithë jemi dëshmitarë të lëvizjeve të mëdha demografike dhe flukseve migratore që shoqëruan ndryshimet politike, ekonomike e sociale në shoqërinë shqiptare pas viteve 90'-të. Nga një ndalim i përgjithshëm i lëvizjes së lirë, ku çdo gjë kontrollohej nga shteti, u kalua në një shpërngulje të pakontrolluar të popullsisë, që jetonte në zonat rurale drejt qendrave të mëdha urbane. Sjelljet e migrantëve të brendshëm, dimensionet, intensiteti, drejtimi dhe motivet e migrimit janë përcaktuar nga zhvillimet ekonomike, politike dhe sociale, që kanë ndodhur në Shqipëri gjatë kohës(Barjaba, 2000; Vullnetari, 2007; Çaro 2011).

Prishja e izolimit (hapja) i sjell zonat rurale në orbitën e një ose shumë qendrave urbane dhe zgjon vetëdijen dhe dëshirën e fshatarëve për një gamë gjithnjë e më të madhe produktesh apo shërbimesh që vetëm qendrat urbane mund t'i ofrojnë. Për këtë, banorët e zonave rurale ose duhet të prodhojnë mallra bujqësore dhe të hyjnë në marrëdhënie shkëmbimi me qytetet, ose të zhvendosen drejt zonave urbane për të "shitur" punën e tyre në këmbim të pagave më të mira me të cilat mund të blejnë mallra dhe shërbime.

Ky është mjedisi brenda të cilit vepron sistemi i migrimit rural- urban. Ky është mjedisi që stimulon banorët e fshatrave të dëshirojnë, mbi baza lokale dhe racionale të aktiviteteve të tyre ekonomike, të cilat si pasojë përcaktojnë vëllimin, karakteristikat dhe rëndësinë e migrimit rural-urban. Për më tepër ai është një mjedis i cili është vazhdimisht në ndryshim dhe këto ndryshime ndikojnë në funksionimin e sistemit.

Në kuadrin e sistemit të migrimit rural- urban vëmendja fokusohet, jo vetëm tek migrantët, por edhe tek elementë të tillë si nënsistemet e kontrollit, marrëdhëniet sociale e ekonomike, mekanizma rregulluese etj, të cilat janë pjesë integrale e fenomenit të migrimit.

Dy nënsisteme të rëndësishme janë nënsistemet rurale dhe nënsistemet urbane të kontrollit. Një nënsistem kontrolli është ai, i cili mbikqyr funksionimin e përgjithshëm të sistemit dhe përcakton mënyrën **kur** dhe **si** rritet apo zvogëlohet sasia e prurjeve në sistem. Nëse ne pranojmë ekzistencën e nënsistemeve të

kontrollit në këto lëvizje migratore, problem më tej është të identifikojmë se cilat institucione veprojnë në këtë mënyrë si në hapësirat rurale edhe në ato urbane.

Në zonat rurale një nënsistem kontrolli do të ishte familja, e zgjeruar ose nukleare. Familja, është ajo që frenon migrantët potencialë derisa ata arrijnë moshën për të marrë vetë vendime. Edhe kur ata janë në moshë për të marrë vendimin për tu zhvendosur, familja ende vepron si një nënsistem kontrolli në shumë mënyra. Në disa raste familja u mundëson anëtarëve të të dy gjinive të lëvizin lehtësisht, në disa raste të tjera vetëm anëtarët e njëres gjini. Kur migranti potencial është i martuar çështja nëse ai do të zhvendoset i vetëm apo me bashkëshorten dhe fëmijët varet nga rolet zakonore të gjinive në aktivitete bujqësore, mosha e martesës, mosha dhe rrethanat në të cilat një i ri pritët të jetë ekonomiksht i pavarur nga prindërit e tij, etj.

Përveç familjes, komuniteti fshatar mund të shërbejë si një nënsistem kontrolli. Roli i tij kontrollues nuk mund të jetë ndoshta i drejtpërdrejtë, por evidentohet në aktivitete të caktuara, që ai mund të inkurajojë. Psh, një komunitet rural i cili përpaket të përmirësojë kushtet ekonomike të fshatit mund të dekurajojë të paktën për një periudhë të shkurtër migrimin e përhershëm. Nga ana tjetër, një komunitet fshati i cili e vë theksin tek përmirësimet sociale, psh përmes edukimit, mund të stimulojë pa dashje migrimin në qytet nëpërmjet nxitjes së brezit të ri për t'u shkolluar.

Nënsistemet urbane të kontrollit veprojnë në anën e kundërt për të inkurajuar apo frenuar zhvendosjen në mjedisin urban. Një faktor i rëndësishëm është siguri i punësimit. Kështu psh, në qytete, norma e zënies me punë të popullsisë femërore është veçanërisht e ulët, për shkak të mundësive të ulta të punësimit. Për më tepër, gratë që vijnë nga zonat fshatare nuk kanë nivelin e domosdoshëm të aftësive për punët që ofrohen në qytet.

Në zonat urbane mekanizmi i përshtatjes është në thelb përfshirja e migrantëve në një kornizë të re referimi, kryesisht të lidhur me nevojat e tij të reja në qytet.

Cilat aspekte dhe aktivitete të jetës urbane janë të rëndësishme për të kuptuar migrimin fshat-qytet?

Për t'u përgjigjur kësaj pyetje duhet të kujtojmë se qyteti është i përbërë nga një hirearki e specializimeve. Qyteti është një hapësirë ku çdokush përpaket të ofrojë aftësi të specializuara; sa më i madh specializimi, aq më e madhe kërkesa për të dhe aq më i madh çmimi. Sa më tepër ngjitet individ i një hirearkinë sociale, aq më e madhe është përfshirja e tij në mënyrën urbane të të jetuarit dhe aq më e vogël është mundësia e kthimit në mjedisin rural.

Kjo qasje teorike na lejon ta konsiderojmë migrimin rural-urban jo si liner, por si rrethor, si një sistem të ndërvarur, progresiv, kompleks, në të cilin ndryshimi i një pjese çon në ndryshimin e gjithë sistemit. Kjo thekson natyrën dinamike të procesit të migrimit.

2 - Karakteristika të migrimit të brendshëm në shoqërinë shqiptare

Migrimi i brendshëm është një nga fenomenet më dinamike të dekadave të fundit në Shqipërinë post-komuniste dhe ka ndikuar në formimin e situatës socio-ekonomike dhe demografike të vendit (UNDP, 2002).

Në Shqipërinë e viteve 90' të shek. XX një valë popullsie fshatare dhe e periferisë rurale zbriti në qytete duke e shndërruar krejt peisazhin urban, duke sjellë mënyra jetese, veshje, të folme, stereotipe sociale e profile subkulturore të spikatura (Fuga A & Dervishi Z, 2010: 19).

Mungesa e mjeteve të jetesës u bë shkak për dyndje në shkallë të gjerë nga fshati në qytet. Veçanërisht ndryshimet ekonomike pas vitit 1992 patën ndikim mbi krahinat e Shqipërisë, duke thelluar edhe më tepër pabarazitë mes tyre.

Kjo zhvendosje pati një kosto të madhe për shoqërinë shqiptare dhe u shoqërua me probleme, konflikte dhe ngjarje të pandodhura dhe të paparashikuara më parë, si zaptimi i tokave që u përkisnin pronarëve të ligjshëm, ngritja e lagjeve të tëra në periferi të qyteteve pa infrastrukturën e nevojshme dhe pa zbatuar ligjet e urbanistikës, gjë që solli një kaos të vërtetë në çdo pikëpamje.


Migrimi i brendshëm është shprehur në urbanizimin masiv të disa zonave dhe shpopullimin e të tjerave. Për herë të parë në historinë e censuseve të kryera në Shqipëri popullsia e cila jeton në zonat urbane është më e madhe se ajo në zonat rurale. Kështu, 53.7% e popullsisë jeton në zonat urbane dhe 46.3% në zonat rurale (Censusi i popullsisë dhe i banesave në Shqipëri 2011).

Një fenomen i tillë lidhet me proceset e modernitetit.

Migrimi i brendshëm në Shqipëri ka nxitur një proces të paparë dhe të pakontrolluar të urbanizimit dhe zhvillimit informal. Flukset e brendshme migratore janë të drejtuara kryesisht nga veriu i largët drejt qendrave kryesore urbane, si Tirana, qytet i cili ka qenë vendmbërritja më tërheqëse për shumicën e migrantëve të brendshëm.

Procesi i urbanizimit të shpejtë në Shqipëri, edhe pse vërehet edhe në vende të tjera ish- komuniste, për shkak të intensitetit të saj gjatë një periudhe të shkurtër kohe është unik për Shqipërinë (Çaro E, 2011: 2).

Grafiku 1- Popullsia urbane dhe rurale në censuset 1979, 1989, 2001 dhe 2011



Karakteristikë kryesore e migrimit rural-urban në Shqipëri është natyra kolektive e lëvizjes. Njerëzit largohen nga fshatrat si familje, si fis dhe vendosen në qytete, gjë e cila dallon nga migrimi në vendet e tjera evropiane ose jo, që është me natyrë individuale. Migrimi i brendshëm në Shqipëri, shpesh zhvillohet në formën migrimit zinxhir. Prandaj, rrjetet sociale, ndërveprimi farefisnor, mbështetja financiare dhe socio-psikologjike marrin një rëndësi të veçantë në diskutimin e procesit të integritimit dhe përshtatjes së migrantëve të brendshëm në mjedisin e ri urban. Migrimi zinxhir çon në krijimin e grupimeve të veçanta socialkulturore në mjediset urbane. Ndërsa numri i migrantëve në hapësirën urbane rritet, ata krijojnë bashkësitë e tyre, me vlerat dhe stilin e tyre të jetesës, shpesh duke e bërë shoqërinë pritëse të ndihet si e huaj.

3 - Qasje teorike - Vendimi për të migruar, faktorë dhe influenca

Për të kuptuar dukurinë e migrimit masiv që karakterizoi shoqërinë shqiptare si edhe ndikimin e migrimit në ndryshimin social, do t'i referohemi disa diskutimeve teorike në lidhje me këtë çështje.

1. Teoria neoklasike e migrimit - faktorët “shtytës” dhe “tërheqës”

Kjo teori e përcakton migrimin e brendshëm si një lëvizje njerëzish në shkallë të gjerë nga zonat rurale në zonat urbane, që shoqëron proceset e urbanizimit dhe industrializimit. Debati përqëndrohet në çështjen nëse faktorët “shtytës” apo “tërheqës” janë më të rëndësishëm në shpjegimin e dukurisë së migrimit të brendshëm. Sipas kësaj teorie migrimi është një proces vetëkorrigjues, pasi ndryshon ofertën dhe kërkesën për punë si në vendin e origjinës dhe në vendin e destinacionit. Variablat kryesorë që drejtojnë qasjen neoklasike janë niveli i pagave dhe papunësia. Pra, vendimi për të migruar përcaktohet nga një grup faktorësh “shtytës” dhe “tërheqës”.

Transformimet dinamike gjatë periudhës së tranzicionit, situata e vështirë ekonomike dhe politike në vend në përgjithësi dhe në disa rajone në veçanti, së bashku me karakteristikat sociale dhe demografike të popullsisë (grup-mosha e të rinjve, normat e larta të papunësisë) përbënin faktorët shtytës për migrantët e ardhshëm.

Sipas të dhënave të INSTAT (1998, 2001, 2002), shkalla e papunësisë në Shqipëri ka rënë në vitet e fundit në krahasim me vitet e para të tranzicionit, nga mbi 25 për qind në 1993 në 14.4 për qind në 2004.

Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e shpejtë të popullsisë urbane janë komplekse: me karakter vendor, kombëtar, të tanishëm dhe të trashëguara nga e kaluara, të natyrës politiko-shoqërore, demografike dhe ekonomike (Shtëpani V, 2007:262).

Eksodi rural i popullsisë shpjegohet nga modeli shtytës-tërheqës i pabarazisë të nivelit ekonomiko-shoqëror të zonave, qendrave të banuara dhe degëve ekonomike. Qytetet dhe disa rrethe në procesin historik të zhvillimit të tyre kanë siguruar një nivel relativisht të lartë të zhvillimit ekonomik, shoqëror, kulturor, shëndetsor dhe arsimor (faktorë tërheqës) duke u bërë tërheqës për migrantët nga zonat rurale që karakterizohen nga një nivel i ulët zhvillimi (faktorët shtytës).

Për popullsinë e zonës rurale qyteti është një ëndërr, që ata e dëshirojnë, të nxitur edhe nga mjetet e informimit. Pra ato kanë krijuar tek banori i zonave rurale idenë se është jashtë kohe të jetosh në fshat. Këtu ka ndikim edhe fakti që shumë zona rurale janë larg rrugëve, tregëtisë, e natyrisht janë krejt të pafuqishme të mbajnë banorët aty (Nikaj I, 2012: 249).

Duke analizuar dukurinë e migrimit të brendshëm në qytetin e Korçës konstatojmë, se një faktor tërheqës që ka ndikuar në procesin e migrimit të banorëve nga zonat rurale drejt hapësirës urbane është vetë qyteti i Korçës.

Qyteti i Korçës shtrihet në pjesën juglindore të Shqipërisë dhe është një nga qendrat më të njohura të kësaj pjese. Korça ndodhet 181 kilometra larg nga kryeqyteti i vendit. Ajo ka një pozitë të favorshme gjeografike pasi ndodhet në rrugët tregëtare që lidhin Shqipërinë me Maqedoninë (47 km) dhe Greqinë (35 km). Pozicioni i Korçës ka ndihmuar lëvizjen e popullsisë, zhvillimin e biznesit, sepse Korça ka mundësi si nje ekonomike dhe komunikimi si me Selanikun (Greqi) edhe me Tiranën (Nikaj. I, 2011:126).

Kështu në vitin 2008 në qytetin e Korçës kishte 716 banorë të ardhur nga zonat rurale, prej të cilëve 524 femra dhe 192 meshkuj, ndërsa të larguarit nga qyteti i Korçës (kryesisht në Tiranë dhe emigrantë në Greqi) arrinin shifrën 614 prej të cilëve 178 meshkuj dhe 436 meshkuj(Buletini Statistikor Bashkia Korçë 2008).

Gjithashtu një faktor tjetër që nxit largimin nga zonat rurale është prirja e të rinjve dhe të rejave (e gërshetuar kjo edhe me dëshirën e prindërve të tyre) për t'u arsimuar cilësisht në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit dhe më tej kërkesa për të përfituar arsimin universitar në përputhje me kërkesat në tregun e punës. Mungesa e infrastukturës arsimore dhe rënia e cilësisë së mësimdhënies në shkollat e fshatrave i ka detyruar një pjesë të mirë të banorëve të këryre zonave rurale të zhvendosen në qytetin e Korçës për të arsimuar fëmijët e tyre.

Të rinjtë, të cilët përfundojnë studimet e larta në universitetin e Korçës nuk preferojnë të rikthehen në vendbanimet e tyre, pasi e konsiderojnë të pashpresë jetesën e tyre në fshat, si edhe ndihen të mirëintegruar në shoqërinë urbane. Për këtë arsye ata bëjnë përpjekje për tu punësuar në qytet. Shpesh vazhdimësia e jetesës së tyre në qytet pas përfundimeve të studimeve sigurohet nga të ardhurat e prindërve të tyre, në kushtet kur këta të rinj ende nuk janë punësuar. Kjo situatë bëhet shkak për zhvendosjen edhe të familjeve të këtyre të rinjve në qytet.

4 - Migrimi i brendshëm, adaptimi dhe ndryshimi socio-kulturor

Të dhënat statistikore dëshmojnë për dukurinë e zhvendosjes së popullsisë nga fshati në qytet e bashkë me ta transferimit të subkulturave, të migrimit të diversitetit kulturor, të simboleve imagjinare, miteve, tabuve, mënyrave të jetesës dhe të përzierjes dhe interferimeve të tyre të paqta ose konfliktuale, të rregullta ose kaotike, në anonimatin e një qyteti që kahumbur pamjen, strukturat e veta urbanistike, homogjenitetin e opinionit, qoftë edhe të sipërfaqshëm (Dervishi Z & Fuga A, 2010:153).

Për shkak të diversitetit subkulturor, të identitetit psiko-kulturor të veçantë të njerëzve me banim në zona të ndryshme të vendit, lëvizjet migratore dhe përzierja e popullsisë kërkon shqyrtimin e problemit të integritit në rrafshin subkulturor, si dhe identifikimin e shkallës së integritit dhe adaptimit socio-kulturor të migrantëve në mjedisin e ri urban dhe ndikimet e subkulturës rurale në atë urbane.

Për të trajtuar këtë problematikë, duhet të theksojmë:

Së pari, adaptimi kulturor është një proces që ndodh në mënyrë të dykahshme; përfshin ndërveprimin mes migrantëve dhe shoqërisë pritëse. Në këtë rast të dy palët pësojnë ndryshime përshtatëse, megjithëse njëri prej tyre pëson më tepër ndryshime se tjetri, gjë e cila na çon drejt të parit të procesit nga këndvështrimi i migrantëve.

Së dyti, procesi i adaptimit nuk çon domosdoshmërisht në asimilimin e migrantëve në kulturën dhe shoqërinë pritëse, jo vetëm kur migrantët kanë të njëjtin background social, kulturor, regjional, apo vijnë nga i njëjti rajon gjeografik, por edhe kur dallimet sociale dhe kulturore janë të dallueshme. Kjo është arsyeja se pse “hipotezës së shkatërrimit” apo “*melting pot*” nuk mund t’i përmbahemi si koncepte teorike të qëndrueshme për trajtimin tonë (Chhetri B. R, 1987: 43).

Në vend të kësaj, ajo që mund të vërehet është *përshtatja*, ose *adaptimi*, i cili mund të përkufizohet si një proces ku jeta sociale, kulturore dhe ekonomike e një grupi apo komuniteti modifikohet për t’iu përshtatur nevojave të mjedisit të ri. Në diskutimin më poshtë, një përpjekje është bërë për t’iu përgjigjur disa pyetjeve kryesore:

- (a) Cilat janë tiparet kryesore që karakterizojnë modelimin sociokulturor të banorëve në mjedisin urban të qytetit të Korçës?
- (b) Cilat janë mendësitë dhe vlerat kulturore që bartin banorët e ardhur nga mjedisi rural?
- (c) Në çfarë mase kanë ndodhur ndryshime socio-kulturore, apo në vlerat dhe normat e subkulturës së migrantëve të ardhur nga zonat rurale në qytetin e Korçës?
- (d) Në çfarë aspekte janë përshtatur migrantët me kulturën urbane?

Nuk ka dyshim që shoqëria urbane ndryshon nga shoqëria rurale dhe njeriu urban është i ndryshëm nga llojet e personalitetit që shoqëruan komunitetet dhe kulturat e së kaluarës. Individit urban, krahasuar me banorin në mjedisin rural, është më i hapur, më i çliruar nga traditat e mëparshme (Shtëpani V, 20007:13, 56).

Mjediset rurale karakterizohen nga një sistem sociokulturor shumëfamiljar, një tërësi shoqërore e kulturore ndërfamiljare e ndërfisnore. Ndërsa mjedisi qytetar ka mënyrë jetese më të individualizuar, ku përgjithësisht njerëzit janë më të mbyllur brenda sferës së punës dhe interesave vetjake, përgjithësisht indiferente, e herë-herë përçmues ndaj të ardhurve nga fshati (Dervishi Z & Fuga A, 2010:177).

Një aspekt i rëndësishëm për të analizuar migrimin e brendshëm dhe karakteristikat e mjedisit subkulturor rural ka të bëjë me karakterin patriarkal të shoqërisë shqiptare në përgjithësi dhe mjedisit rural në veçanti.

Kur flasim për shoqërinë shqiptare kemi parasysh se ajo në strukturat kryesore të saj ka pasur dhe vazhdon të ruajë kryesisht karakteristika të shoqërive tradicionale, ndërthurur me tipare të modernitetit të hershëm (Nikaj I, 2011: 121).

Nisur nga kjo, me të drejtë mund të themi se në shoqërinë shqiptare, aktualisht sistemi patriarkal bashkëekziston me qëndrime më moderne. Në disa zona rurale në veri të Shqipërisë ekziston një traditë e fortë konservatore me bazë klanore, ndërsa në pjesën qendrore dhe jugore të vendit këto tradita janë më fleksibël (pavarësisht kësaj qëndrimet patriakale vazhdojnë të jenë ekzistente veçanërisht në zonat rurale).

Patriarkalizmi konsiderohet si një sistem praktikash, në të cilin meshkujt dominojnë femrat, ndërsa modernizimi përcaktohet si zhvillim nga një shoqëri tradicionale rurale, në një shoqëri moderne urbane. Në mjedisin e ri urban, gratë rurale e gjejnë veten të bllokuar në mes të patriarkalizmit dhe modernizimit, me elemente të shoqërive patriakale që transferohen në destinacionin e ri.

Përshtatja e migrantëve në një mjedis urban mund të shtrohet në diskutim duke përdorur grupe të ndryshme të indekseve ose variabla, si vendbanimi, përshtatja profesionale, mobiliteti (lëvizshmëria) në punë, përshtatja social-kulturore, lidhja me origjinën (vepër e cit. Lee dhe Kim 1981: 233).

Marrim në konsideratë disa variabla si : lëvizshmëria në punë, pjesëmarrja në organizata, kontaktet me komunitetet e tjera, preferencat për fqinjësi, hapja apo mbyllja ndaj komunitetit.

4.1 - Disa të dhëna prej anketave

Nisur nga parashtrimet teorike të sipërpërmendura u përpoqëm të matim shkallën e integritit të banorëve të ardhur nga zonat rurale në qytetin e Korçës, duke marrë në konsideratë variablat e sipërpërmendur. Kjo analizë e përgjigjeve të të anketuarve na ndihmoi gjithashtu për të identifikuar edhe elementët të cilët bëhen pengesë apo lehtësojnë procesin e integritit urban të tyre.

Nga të dhënat e anketimit rezulton se pavarësisht largimit prej mjedisit rural prej 10-15 vjet, përsëri banorët e ardhur nga fshatrat vazhdojnë të ruajnë lidhjet me mjedisin rural, 85% e tyre, ndërsa vetëm 15 % shprehen se nuk i ruajnë lidhjet me mjedisin rural, madje pohojnë se kontaktet/bisedat telefonike me miq apo të afërm në fshat ndodhin vetëm në raste festash. Ky grup të anketuarish përbëhet kryesisht

nga femra të cilat, pohojnë gjithashtu se e ndjejnë veten shumë, apo plotësisht të integruar në jetën e qytetit.

85 % e të anketuarve që pranojnë se vazhdojnë të ruajnë lidhjet me mjedisin rural, për pyetjen “Sa të shpeshta i keni kontaktet me mjedisin rural?” japin këto përgjigje: 55% pohojnë se kanë kontakte të rregullta (çdo javë/muaj/gjashtëmuaj), ndërsa 45% shprehën se kanë kontakte të rralla (vetëm në raste festash).

Pjesa dërmuese e të anketuarve që vazhdojnë të ruajnë lidhjet me mjedisin rural pohojnë se ndihen aspak të integruar në jetën e qytetit 11%, pak të integruar 5%, disi të integruar 43%, shumë të integruar 16% dhe plotësisht të integruar 10%.

Të anketuarit që pohojnë vazhdimësinë e lidhjeve me mjedisin rural nuk e konsiderojnë atë (lidhjen me mjedisin rural) si pengesë për të ndryshuar mënyrën e jetesës dhe modelet e sjelljes me qëllim integrimin në jetën urbane.

Në lidhje me përpjekjet që kanë bërë këta banorë të zhvendosur në hapësirën urbane të qytetit të Korçës për tu integruar në jetën urbane, rezultojnë se 70% e tyre janë përpjekur të integrohen në sajë të krijimit dhe forcimit të lidhjeve miqësore me qytetarët korçarë. Mobiliteti në punë nuk përbën një faktor lehtësues të integritetit të tyre në jetën urbane, vetëm 23% e tyre pohojnë se janë përpjekur të integrohen në jetën e qytetit duke ndërruar vendin e punës. Një fakt i tillë lidhet me vështirësinë që kanë këta banorë për t’u punësuar në qytet.

Kjo nuk duhet keqinterpretuar si pjesë e strategjive apo politikave përjashtuese të punësimit, të ndjekura nga autoritetet lokale, bizneset apo komuniteti në qytetin e Korçës, por përbën një fenomen të përgjithshëm që lidhet me problemin e mungesës së ofertës për punësim përballë kërkesës së lartë, që karakterizon gjithë shoqërinë shqiptare, situatë, e cila bëhet edhe më problematike nën efektin e flukseve të migrantëve në hapësirat urbane. Ajo pjesë e popullsisë që e vuan më tepër këtë problem përbëhet nga vajzat dhe gratë.

Kështu nga të dhënat e anketimit vihet re se 58% e femrave të anketuara me arsim të ulët dhe të mesëm, të afta për të kryer punë janë të papuna, 25% e tyre punojnë si punëtoreshë krahuri në firmat dhe bizneset private dhe 17% vazhdojnë të kryejnë studimet e larta.

Në lidhje me preferencat për fqinjësi, si një ndër variablat e lartpërmendur të marrë në studim, konstatohet se pavarësisht përpjekjeve të të ardhurve për tu integruar në mjedisin urban të Korçës në sajë të krijimit dhe forcimit të lidhjeve miqësore me qytetarët korçarë, fqinjët me të cilët këta banorë kanë marrëdhënie më të mira janë të ardhurit nga zonat rurale, apo të afërmit e tyre të zbritur nga zonat rurale, të cilët janë edhe fqinjë të tyre.

Kështu 40% e të anketuarve pohojnë se fqinjët me të cilët kanë marrëdhënie më të mira janë të ardhurit nga zonat rurale, 45% shprehën se fqinjët me të cilët kanë marrëdhënie më të mira janë të afërmit të ardhur nga zonat rurale (të cilët janë njëkohësisht edhe fqinjët e tyre) dhe vetëm 15% e të anketuarve pranojnë se janë qytetarët korçarë ata me të cilët ata kanë marrëdhënie më të mira fqinjësie.

Një fakt i tillë lidhet me të ashtëquajturin migrimi zinxhir, ku banorët e ardhur pas një farë kohe qëndrimi në qytet tërheqin të afërmit e tyre, të cilët

vendosen pranë banesave të tyre. Një fenomen tillë ka çuar në formimin e lagjeve të reja në periferi të qytetit, të banuara nga banorë të zbritur nga zonat rurale përreth.

Referenca:

- Biberaj E., (2011), *Shqipëria në tranzicion- Rruga e vështirë drejt demokracisë 1990-2010*, Instituti I Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë AISS
- Bobi, G. (1997). *Paradoks kulturor*, Vepra 2, Dukagjini. Pejë
- Buletini Statistikor 2008, Bashkia Korçë, Botimi i USAID & CSDC,
- Çaro, E. (2011). *From the village to the city - Adjustment process of internal migrants in Albania*, Rozenberg Publishers, Amsterdam
- Chhetri B. Ram,. (1986), migration, Mdaptation and Socio-cultural Change: The case of the Thakalis in Pokhara, CNAS Journal, Vol. 13, No. 3, 239-259
- Fuga, A.,& Dervishi, Z. (2010). *Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global*, Botimet Dudaj, Tiranë
- Fuga, A. (2004) *Shoqëria Periferike. Sociologji e Ndryshimit në Shqipëri*, Tirana: Ora.
- Danopoulos C. Andrew & Danopoulos P. Constantine., *Albanian Migration into Greece: The Economic, Sociological and Security Implications*, MUSE Project, 100-114
- Dervishi, Z. (2011). *Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik*, Shtëpia Botuese Emal, Tiranë
- Dervishi, Zyhdi., *Lente të ndërveprimit simbolik*, Shtëpia Botuese Emal, Tiranë 2011
- Gay, Kathlyn. (2003), *Cultural Diversity; conflicts and challenges*, Scarecrow Press
- INSTAT 2001, Popullsia e Shqipërisë, Prefektura e Korçës
- Jolly, S., & Reeves, H. (2005). *Gender and Migration- overview report*, BRIDGE, Institute of Development Studies, UK
- King, R., & Vullnetari, J.(2009). The intersections of gender and generations in Albanian migration, remittances and transnational care, *Journal Compilation, Swedish Society for Anthropology and Geography*, Vol. 91, 19-38 doi: 10.1111/j.1468-0467.2009.00304.x
- Mabogunie, L. Akin.,(1970), Systems Approach to a Theory of Rural-Urban Migration, *Geographical Analysis*, [Volume 2, Issue 1](#), pages 1–18,
- Moran, T. Robert, Harris, R. Philip, & Moran, V. Sarah. (2010). *Managing cultural*

- differences*, ELSEVIER, UK
- Neto, F. (2012), Re-Acculturation and Adaptation Among Adolescents From Returned Portuguese Immigrant Families, *Journal of Applied Social Psychology*, 42, 1, 133–150.
- Nikaj, I. (2012). *Sociologji*, Shtëpia Botuese Alb- paper, (Botimi i Tretë)
- Nikaj, I. (2011) “Ndryshime individuale dhe shoqërore përmes trajektoreve biografike” tek *Lente Sociologjike, Vëllimi 1, Nr.1*,
- Özdemir, E. (2003). The effects of rural-to-urban migration on the status of women in Turkey, *Turkish Journal of Population Studies*, 25, 69-96
- Shtëpani, V. (2007) *Sociologji urbane*, Tiranë, Botimet ORA
- Vizion dhe Strategji për zhvillimin afatgjatë të Rajonit të Korçës, Korrik 2004, Këshilli i Qarkut Korçë, SIPU
- Vullnetari, J. (2007) *Albanian Migration and Development: State of the Art Review*, IMISCOE Working Paper, No.18.
- Vullnetari, J. (2009) *Women and Migration in Albania: A View from the Village*, International Migration IOM, 9999: 1-30.

DALLIMET SOCIO-KULTURORE NDËRMJET BREZAVE NË QYTETIN E KORCËS

Doralda Tanellari

Përmbledhje

Jeta shoqërore mbart dukuri të ndryshme sociale dhe kulturore të cilat ndërveprojnë dukshëm me jetën tonë, duke krijuar diferenca të thelluara në raportet dhe marrëdhëniet e krijuara rishtazi midis brezave në familje dhe shoqëri. Janë ndryshimet në mendime, sjellje apo veprime fillesat e të kuptuarit nëse pabarazia dhe diferenca lind dhe zhvillohet nga *“shtrëngesat”* shoqërore. Në shoqërinë e sotme që më së shumti i ngjan një hapësire pa kufi ekziston mundësia për të përthithur mënyra dhe ide të reja lidhur me stilin e jetesës, mënyrën e të menduarit dhe të sjellurit në shoqëri. Studimi *“Dallimet socio-kulturore ndërmjet brezave në qytetin e Pogradecit”* u realizua me qëllim identifikimin e faktorëve socialë dhe kulturorë që ndikojnë në rritjen e diferencave midis brezave në familje dhe shoqëri. Evidentimi i faktorëve socializues, si: *media, shkolla, teknologjia si dhe ndikimet që vijnë nga kulturat e tjera nëpërmjet emigracionit.*

Abstract

Social life is made up of various social phenomena and cultural changes which also bring changes into our lives. It is these changes that enable us to understand the importance of social elements that exist and give us the ability to absorb new ideas regarding lifestyle, way of thinking and behavior in society. The study "Socio-cultural differences between generations in Pogradec" was conducted in order to identify the social and cultural factors that influence the progression of the differences between generations in the family and society. Identification of socializing factors such as, media, schools, technology and influences from other cultures through immigration.

Fjalët çelës: kultura, vlerat kulturore, shoqëria, subkultura, diferencë, brez, hendek.

1. Hyrje

Studimi identifikon dhe trajton rëndësinë e faktorëve socialë dhe kulturorë që ndikojnë në rritjen e diferencave midis brezave në familje dhe shoqëri. Analiza e raporteve midis brezave në qytetin e Pogradecit lidhur me ndryshimet sociale dhe kulturore të viteve të fundit është një pikë kyçe mbi të cilën pritet të dalin në pah rezultatet e studimit. A ekziston hendeku në marrëdhënien prind-fëmijë dhe si ndikon ai? Përderisa marrëdhëniet njerëzore përcaktohen përmes ndërveprimit të aktorëve socialë, qofshin këto institucione apo individë, atëherë është krejtësisht e mundur që këto marrëdhënie jo vetëm të analizohen, por edhe të përmirësohen. Kjo duhet të shihet si një mënyrë e mirë për evidentimin e ndryshimeve duke nisur nga mirëkuptimi deri te konfliktet midis brezave.

Nënvizimi irëndësisë dhe analiza e elementëve socialë dhe kulturorë në ndryshim, si faktorë të rëndësishëm në diferencat midis brezave i jep kuptim këtij studimi. Mënyra sesi ka evoluar koncepti i kulturës dhe ndikimi i jetës shoqërore prej sajështë me rëndësi të analizohet. Fakti se familjet shqiptare janë kryesisht të rritura me frymën e tradicionales ndërkohë që fëmijët rriten në një kohë tjetër dhe me mendime të ndryshme për familjen bën diferencën. Një rol të rëndësishëm në këtë studim luajnë edhe materialet apo studimet e kryera nga studiues të *“Shkencave Sociale”*, të cilat kanë shërbyer si rishikim literature me qëllim krijimin e paralelizmave.

Nga studimi rezulton se diferencat midis brezave janë të dukshme dhe shpeshherë influencuese në marrëdhënien prind-fëmijë. Ato identifikohen me ndryshimet socio-kulturore që kanë ndodhur së fundmi në qytetin e Pogradecit. Ndikimi i emigracionit jo vetëm në kulturën material, por edhe në mënyrën e të menduarit ka bërë që, veçanërisht adoleshentët të kenë mendime të ndryshme nga prindërit. Ndikimi i masmedias, televizionit dhe internetit e ka bërë më të lehtë mënyrën e përfitimit të vlerave që vijnë nga kulturat e tjera. Diferenca midis brezave thellohet nga ndryshimet në mentalitet si dhe nga modernizimi i shoqërisë. Në Pogradec, kultura maqedonase ka një influencë të ndjeshme. Kjo ka lidhje me pozicionin gjeografik si edhe me ngjashmëritë në kulturën dhe stilin e jetesës së dy popujve. Ndërkohë që një ndikim të drejtpërdrejtë kanë vlerat e kulturës amerikane në të cilat çmohet individualiteti dhe komforti material. Mënyra sesi këto vlera penetrojnë në shoqëri i ka bërë ato pjesë të bashkëjetesës midis adoleshentësh. Diferencat midis brezave në mentalitet shfaqen nisur nga mënyra e parapëlqimit të modelit familjar, pavarësisht së të rinjve e deri te konceptet mbi karrierën profesionale. Nga studimi del se prindërit nuk po i kapin dot ritmet e ndryshimit në të njëjtën linjë me fëmijët e tyre. Shpeshherë këto mospërputhje kanë qenë iniciatorët kryesorë në lindjen e konflikteve dhe debateve midis adoleshentëve dhe prindërve të tyre. Studimi vlerëson se është qartësisht i dukshëm hendeku i krijuar midis brezave në qytetin e Pogradecit, ndërkohë që të rinjtë i konsiderojnë ndryshueshmëritë në mospërputhje me mendimet e prindërve.

2. Metodika

Për të trajtuar problemet sociale të botës reale, kërkuesit përdorin strategjitë kërkimore që përgjithësisht përcaktohen si metodologji sasiore ose cilësore. Kërkimi sasior lejon të kuptohet më mirë organizimi social në nivel makro dhe kjo është arsyeja përse në këtë studim është përzgjedhur metodologjia sasiore. Përqasja sasiore ka ndihmuar të analizohet marrëdhënia e një target grupi specifik që në rastin tonë janë maurantët e vitit akademik 2011-2012.

Informacioni mbi studimin *“Dallimet socio-kulturore ndërmjet brezave në qytetin e Pogradecit”* u mblodh nëpërmjet një pyetësoi të cilin të anketuarit duhet ta plotësonin gjatë 45 minutave të orës mësimore. Në krye të anketës vendoset titulli dhe qëllimi i studimit, ndërkohë që gjatë zhvillimit u mbajtën edhe shënime me

qëllim përfitimin e sa më shumë informacioneve që ndihmojnë studimin. Pyetëtori përmban 27 pyetje nga të cilat 26 janë të strukturuar dhe 1 gjysmë e strukturuar. Ditari i studiuesit shërbeu si një burim tjetër i rëndësishëm informacioni në procesin e analizimit të të dhënave. Me përfundimin e procesit të anketimit, pyetësorët u mbledhën dhe më pas u analizuan. Studimi për vitin 2011-2012 bazohet te një kampion përfaqësues prej 420 nxënësish i cili përfshin moshën 17-18 vjeçare, përkatësisht maturanët e 4 shkollave të mesme, dy shkollat publike dhe dy shkolla jopublike të qytetit të Pogradecit. Për të patur një pasqyrë sa më të qartë të kësaj situatë në studim janë përfshirë edhe shënime të mbajtura gjatë procesit të plotësimit të anketave.

3. Rezultatet e studimit

3.1 Familja tradicionale

Studimi i familjes përbën një nga fushat më të rëndësishme të sociologjisë. Çdo njeri në të gjitha shoqëritë rritet në një mjedis familjar dhe social, sipas të cilit ai krijon bazat e ndërveprimit. Në shumicën e shoqërive tradicionale, familja bërthamë është e ndërthurur në një rrjet të gjerë marrëdhëniesh farefisnore. Atje ku bashkë me çiftin e martuar dhe fëmijët e tij jetojnë edhe të afërm të tjerë, familja është e zgjeruar. Përzgjedhja e partnerëve zakonisht nuk përcaktohet nga dashuria apo afeksioni, por nga interesa sociale dhe ekonomike^[5]. **Si e konsiderojnë modelin e tyre familjar të rinjtë e qytetit të Pogradecit?** Sa tradicionale e konsiderojnë familjen e tyre? Gjatë pushimit, midis orëve, dëgjohen shpesh mendime të ndryshme që vinin nga maturanët, teksa përmbajtja e anketës u kishte zgjuar dëshirën për të diskutuar rreth familjeve të njëri-tjetrit. Një vajzë diskutonte me shoqet dhe në një moment iu drejtohet kështu: - “Mos më paragjykoni!”. Familja e saj kishte rreth dhjetë vjet që kishte zbritur nga një rrethinë e Pogradecit, por ruante sipas saj me fanatizëm traditën e marrë me vete nga fshati. “Mami dhe babi, shpesh herë më kritikojnë rreth gjërave dhe veprimeve që bëj, ata duan që unë të pohoj gjithçka që ata thonë. Kur iu them se do shkoj me shoqet në ndonjë festë, në familjen time fillon sherri. Prindërit thonë se vetëm vajzat e këqija shkojnë në disko, dalin pa praninë e prindërve sepse sipas tyre ato e kanë marrë “atë rrugë”. I vetmi që e kupton dhe toleron është vëllai 20 vjeçar i cili “zbut gjakrat” në shtëpi pas çdo situatë të acaruar. Respekti për prindërit dhe vendimet që marrin ata për të rinjtë konceptohet ende si virtyt, shpesh herë duket se autoriteti i tyre do të zgjasë përgjithmonë”. Rezulton se është i lartë numri i familjeve të cilësuar më së shumti si disi tradicionale dhe më pak e cilësojnë familjen e tyre ende shumë tradicionale.

Familja ende qëndron në limitet e tradicionales, megjithëse kyndikim është zbutur me kohën, duke patur parasysh që familjet u përballën me ndryshime në marrëdhëniet familjare vetëm pas vitit 1990, ndërkohë që është e vështirë të çrrënjosësh një mendësi dhe ta zëvendësosh atë me një model tjetër. Shembulli i vajzës me inicialen, E.P nuk është i vetmi, ai duket si një dëshmi e thelluar midis dybrezave të lindur në kohë të ndryshme. Duke jetuar mes ndryshimeve sociale dhe kulturore shfaqin konceptime të ndryshme në vlerësimin e marrëdhënies familjare.

Sipas Yinger, në mjaft studime sociologjike e psikologjike argumentohet përfundimi se, veçanërisht nga fillimi i viteve '60-të të shekullit XX deri në ditët tona adoleshentët janë më të prirur të orientohen drejt ideve, praktikave e lëvizjeve të karakterizuara si kundërkulturore. Ata janë të prirur të kundërshtojnë, të modifikojnë e të ndryshojnë shumicën e vlerave, të normave kulturore, të elementëve të mënyrës së jetesës tradicionale ^[3]. Nuk do të thotë që tek ata mënyra sesi janë rritur në familje nuk ka ndërtuar një pjesë të fortë të karakterit të tyre sepse është e vështirë që individët të largohen tërësisht nga kultura e tyre edhe kur kanë dëshirë ta bëjnë diçka të tillë.

3.2 Ndikimi i emigracionit dhe faktorëve të tjerë socializues si media dhe teknologjia në formimin e mendësive të rejatek adoleshentët në ditët e sotme

Emigracioni është përmendur për vite me radhë si një faktor influencues në ndryshimet që kanë përfshirë shoqërinë shqiptare pas vitit 1990, duke mundësuar largimin në masë të popullsisë drejt shteteve të tjera. Pogradeci ka qenë vazhdimisht i influencuar nga kultura maqedonase, ky ndikim ka ardhur në shekuj edhe në gatim dhe mendësi.

Sot, Maqedonia është një vend që vizitohet shumë nga të rinjtë e Pogradecit dhe jo vetëm. Për të vlerësuar në mënyrë të saktë influencat që sjellin me vete kulturat e tjera sidomos nëpërmjet emigracionit përshtypjen e marrim nga të rinjtë të cilët janë katalizatorë të ndryshimeve që vijnë në kohë, pavarësisht impaktit pozitiv apo negativ. **Të pyetur sesa ka ndikuar emigracioni në formimin e mendësive të reja në qytet, ata kanë dhënë opinionet e tyre.** Adoleshentët mendojnë se emigracioni ndikon në ndryshimin e mendësive të prapambetura, por edhe në formimin e mentalitetit të ri. Jo rastësisht, ata e vlerësojnë emigracionin si të tillë, por duket të veçojmë faktin se, emigracioni i vetëm nuk mund të sjellë ndryshime të mëdha. Kjo është arsyeja pse një pjesë jo e vogël e ka cilësuar si disi të rëndësishëm influencimin e emigracionit në jetët e tyre. Duket e vështirë rruga e ndryshimit të një mentaliteti të ndërtuar tradicionalisht. Pyetja rreth emigracionit i bëri adoleshentët të zgjonin edhe më tepër dëshirën për t'u njohur me historitë familjare të shokëve dhe shoqeve të tyre.

Një vajzë 18 vjeçare gjatë bashkëbisedimit, flet për emigracionin dhe ndikimin që ka patur ai tek ajo dhe familja e saj: “Ajo jeton me gjyshërit, nënën dhe babain i ka në Greqi, ata kanë ikur shumë shpejt dhe e kanë lënë të vogël. Fillimisht mbante mend që prindërit telefononin shumë rrallë sepse nuk ishin të stabilizuar me punë, më pas filluan të dërgonin të ardhura për atë dhe gjyshërit, i dërgonin veshje që shoqet e saj nuk i kishin, i dërguan kompjuter, telefon celular dhe shumë gjëra të tjera që në Shqipëri filluan të përdoren shumë vonë. Ajo çfarë i bënte më tepër përshtypje ishte fakti se ata ishin tolerantë dhe të hapur me të. Ndoshta, teprindërit e saj ka ndikuar ekspozimi ndaj mënyrave të reja të jetesës dhe perceptimit të botës”. Emigracioni duket se nuk ka ndikuar vetëm te kultura material, por ka sjellë forma dhe mënyra të reja jetese dhe mendimi, të cilat kanë rezultuar mjaft ndikuese në marrëdhënien prind- fëmijë. Përveç muzikës që është e dëgjuar dhe e kërcyer nga të gjithë, ndikimi

ka ardhur edhe në mentalitet si dhe në sjelljen në familje midis brezave. Prindërit në emigracion kanë mësuar se fëmijët e tyre kanë nevojë për autonomi dhe liri por sidomos autonominë ekonomike pasi atë të kenë mbushur 18 vjet.

Ekspozimi ndaj mënyrave të reja të jetesës, pasurimi i fjalorit me fjalë të reja, mënyra e re e perceptimit të botës e bën shumë të dukshëm ndikimin e kulturave të tjera si pasojë e emigracionit^[4]. Pikërisht ky fenomen bën që në familje të ketë konflikt midis brezave, sepse në të njëjtën banesë bashkëjetojnë mënyra të ndryshme të konceptimit të mënyrave dhe sjelljeve të njëjta. Çdo ndikim sado i vogël të jetë jep rezultat të adoleshenti sepse është ai që i pranon gjërat ashtu siç i vijnë ndoshta kjo edhe për efekt të moshës. Një rëndësi të veçantë në ndryshimin e mentalitetit luan edhe media, e shkruar apo vizive. Media duket se ka një ndikim tepër të madh në jetën e të rinjve, televizioni, revistat e modës me informacione të mbushura nga bota. Modele dhe modelë me veshje nga më tështrenjtat, me forma trupore perfekte janë shumë ndikuese sidomos për vajzat, të cilat dëshirojnë të jenë gjithmonë të pëlqyera nga të tjerët pavarësisht kostos. Media është gjithmonë rreth teje dhe nuk i shpëton dot^[7].

Qyteti i Pogradecit ka dy televizione, **Arv TV** dhe **SOT 7**, programacionin e tyre kryesisht e mbushin me filma të huaj dhe seriale që shpesh herë janë të pakontrolluara. Më shumë se 3500 studime tregojnë se njerëzit bëjnë në jetë ato që shohin në ekranet e televizioneve^[7]. Nuk do të ishte e habitshme po të thonim se tashmë e dimë se nga “lind” moderniteti dhe mendjehapja e tyre ndaj prurjeve të reja.

Maturantët e qytetit të Pogradecit duke u shprehur për faktorët kryesorë që ata mendojnë se ndikojnë në mentalitet veçojnë ndikimet që vijnë nga kulturat e tjera. Ata e lidhin këtë fakt me afrinë dhe ndikimin që ka patur dhe ka kultura maqedonase si në kulturën e të veshurit, e të ushqyerit ashtu edhe në mënyrë jetesës. Nuk duhen përjashtuar aspak edhe kulturat e tjera si ajo greke, italiane, por edhe ajo amerikane që vijnë si rrjedhojë e përçimit të medias, teknologjisë etj. Është vlerësuar se një tjetër aspekt i rëndësishëm që ndikon në ndryshimin e mentalitetit të rinjtë është kultura e internetit edhe pse është një kulturë relativisht e re për shoqërinë tonë. Vendi ynë fqinj me Maqedoninë, me një zhvillim ekonomik dhe teknologjik të ngjashëm me ne, me standard jetese po ashtu si ne është tërësisht me sistem interneti “Wireless”. Mendoni se çfarë do të bëhet në Shqipëri pas disa vitesh. Prindërit Shqiptarë nuk janë ende të përgatitur për t’u përballur me prezencën dhe pushtetin e internetit në familjet tona^[4]. Mos ndoshta të rinjtë po e shpërdorojnë lirinë e të lundruarit në internet apo prindërit nuk po kapin dot ritmet e ndryshimit?!

3.3 Reagimet e prindërve ndaj mendimeve të fëmijëve të tyre dhe ndryshimet në mentalitet midis brezave

Mendimet e ndryshme midis prindërve dhe fëmijëve të tyre shpesh herë janë shkak i debateve, që jo rrallëherë shoqërohen edhe me konflikte. Është shumë e vështirë të flasësh dhe ta analizosh mentalitetin, sepse ai vetë nuk është i dukshëm. Mentaliteti

lind, formohet dhe më pas zhvillohet në mendjen e individit, veprimet që shohim janë pasojë e tij. Megjithatë të gjithë jemi të vetëdijshëm se mentaliteti fillestar krijohet në familje. Prindërit janë ata që japin udhëzimet e para rreth vlerave dhe moralit, rreth kufirit të së mundurës dhe të pamundurës. Megjithatë, mentaliteti është i ndryshueshëm me kohën. Mënyra sesi prindërit reagojnë ndaj mentalitetit të ndryshëm, që ekziston midis tyre dhe fëmijëve, lidhet drejtpërdrejt edhe me mënyrën sesi ata reagojnë lidhur me diferencat në mendime. **Si reagojnë prindërit?** Nervozohen hapur ndaj mendimeve të ndryshme apo nervozohen, por nuk e shfaqin këtë hendek mentalitetesh? Adoleshentët konstatojnë se prindërit shprehin pakënaqësi kundrejt mendimeve të ndryshme të tyre madje një pjesë zgjedhin të konfliktohen me fëmijët e tyre për shkaqe nga më të ndryshmet. Mendimet e ndryshme midis të rinjve dhe prindërve i bëjnë këta të fundit që ndonjëherë të reflektojnë për qëndrimin e mbajtur kundrejt tyre. Prindërit pasi kuptojnë se u mungon koherenca me kohën në të cilën jetojnë atëherë përpiqen t'i tolerojnë fëmijët e tyre. Mënyra sesi pjesëtarët e familjes flasin me njëri-tjetrin është një element i rëndësishëm për komunikimin në familje.

Në zhvillimin e mentalitetit të të rinjve sot kanë ndikuar faktorë që përpara vitit 1990 pothuajse nuk ekzistonin. Sot, një adoleshent rritet mes papunësisë, medias, modës, teknologjisë dhe kulturave të reja, por pavarësia e të rinjve ende varet nga qëndrimi i të rriturve. Mënyra sesi ata i pranojnë këto ndryshime është e ndryshme, sepse lidhet drejtpërdrejt me emancipimin dhe tolerancën e prindërve kundrejt mendimeve të ndryshme të adoleshentëve. Nga studimi qartësisht del në pah fakti se, midis mendimeve të brezave ekziston një hendek shumë i madh, dhe ky fakt është pohuar nga gjysma e adoleshentëve maturantë. Shanset e jetës nuk shpërndahen kurrë në mënyrë të barabartë. Ne nuk njohim ndonjë shoqëri ku të gjithë, burra, gra, fëmijë të kenë të njëjtat tagra dhe të gëzojnë të njëjtat kushtëzime. Nuk njohim asnjë shoqëri ku të gjithë njerëzit të kenë të njëjtin status^[1]. Jeta e prindërve apo gjyshërve ka qenë krejtësisht e ndryshme nga ajo në të cilën jetojnë të rinjtë sot.

Prindërit janë rritur në familje tradicionale dhe me baza patriarkale, janë ushqyer gjatë gjithë kohës me vlera morali dhe respekti të pakushtëzuar ndaj prindërve dhe gjyshërve të tyre. Para vitit 1990 gjithashtu ekzistonin diferenca dhe kontradita ndërmjet brezave, por në vija të përgjithshme kishin të njëjtën bazë dhe pikë referimi. Komunikimi është një aspekt tepër i rëndësishëm i jetës sonë të përditshme. Shpesh herë konfliktet nisin prej “defekteve” në komunikim me prindërit, moshatarët, mësuesit etj. Dhe nga komunikimi gjatë gjithë jetës, ti mëson bukurinë e të jetuarit me të tjerët, arrin t’ju tregosh atë që dëshiron, mëson gjëra të reja, njeh njerëz të ndryshëm dhe zgjidh mosmarrëveshje, mëdyshje dhe konflikte përmes tij^[10].

3.4 Reagimet e prindërve ndaj dëshirës së fëmijëve për pavarësi dhe koha e lirë

Diferenca tregon se çdo ditë është një ditë e re, çdo moment është një fragment i ri në kohë. Në shoqërinë njerëzore të vendosësh se deri ku dhe në çfarë drejtimi është sistemi duhet të tregohet se në çfarë shkalle është modifikuar institucioni që në rastin tonë është familja^[5]. Studimi i fokusuar në qytetin e Pogradecit na njeh qartësisht me faktin se prindërit e kanë të vështirë të pranojnë pavarësinë e fëmijëve të tyre. Mungesa e pavarësisë dhe reagimet e prindërve ndaj dëshirës për të qenë të pavarur nga fëmijët e tyre janë elementë frenues. Maturantët nesër do fillojnë hapat drejt një jete të pavarur, larg familjes për studime apo për arsye pune. Si mendojnë prindërit se do t'i frenojnë të jetojnë jetën e tyre në mënyrën që duan? Shumica e të rinjve i kanë interpretuar reagimet e prindërve si masa mbrojtëse kundrejt frikës se mos pavarësia do të ndikojë keq në përgatitjen e mësimeve nga ana e tyre. E ndërkohë është për t'u përmendur edhe interpretimi sipas të cilit adoleshentët i interpretojnë qëndrimet e prindërve ndaj pavarësisë si rrugën e cila i çon ata drejt humbjes së autoritetit prindëror. Edhe pse janë të paktë në numër prindërit që e çmojnë pavarësinë si iniciativë të mirë ende kanë frikën e ndonjë sjellje devijante e cila lind si pasojë e moshës. Pavarësia e adoleshentit duhet të shihet nga prindërit si një iniciativë e mirë dhe aspak si një tregues i humbjes së autoritetit prindëror. Të konfliktohesh është një pjesë normale e komunikimit në familje, sepse dhe vetë konflikti nuk është gjithmonë negativ, por edhe pozitiv në varësi të situatave. Konflikti ndodh kur dy ose më shumë njerëz ose grupe i përcaktojnë diferencat e interesave si të pamundura për të bërë kompromis. Në kuptimin filozofik, nuk ka njerëz që nuk mund t'i zgjidhin, por ka që nuk dinë t'i zgjidhin ato^[4].

Sipas një studimi të kryer për kohën e lirë në Shqipëri për vitin 2010-2011 tregohen fakte interesante lidhur me mënyrën sesi të rinjtë e kalojnë kohën e tyre. Sipas studimit, për të rinjtë ditët e javës ndryshojnë ndjeshëm nga njëra - tjetra. Ata shpenzojnë shumë më pak kohë për të studiuar dhe më shumë kohë të lirë gjatë ditëve të fundjavës. Koha e lirë rritet ndjeshëm, ashtu sikurse dhe koha për aktivitete personale deri në njëfarë mase. Për grup-moshën 15-65 vjeç diferenca lidhet me punën e paguar. Kjo shpjegohet kryesisht me faktin se përqindja e popullsisë që bën punë të paguar ulet fundjavave, si koha për aktivitete personale dhe koha e lirë rriten, të dyja me dy orë. Për të moshuarit, përdorimi i kohës në dy ditë jave dhe fundjavë është pothuajse i njëjtë^[6]. Nëse bëjmë një përjasje me studimin *"Dallimet socio-kulturore ndërmjet brezave në qytetin e Pogradecit"* do të konstatojmë se frika e prindërve lidhet pikërisht me këto ndryshueshmëri. Prindërit duke mos qenë në kontakt të vazhdueshëm me botën e të rinjve kanë frikën e pavarësisë totale të tyre. Ata besojnë se dëfrimet e tepërta, orët e zgjata jashtë banesës kryesisht në fundjavë do i bëjnë të rinjtë më të predispozuar ndaj sjelljeve devijante.

Prindërit kryesisht janë mësuar që buxheti të manaxhohet nga burri ose gruaja por në asnjë rast nga fëmija i tyre, për më tepër edhe të miratojnë më pas pavarësinë e tyre totale. Këshillat, bashkëbisedimet, sugjerimet shmangin çdo frikë që ka prindi kundrejt sjelljeve devijante, rënien nga mësimet apo çfarëdo lloj frike që mund të

ekzistojë në marrëdhënien midis brezave në familje. Mund ta kuptojnë nëse është e shëndetshme pavarësia e fëmijëve të tyre apo jo, vetëm atëherë kur prindërit të “zhvishen” nga paragjykimet dhe steriotipet.

3.5 Të rinjtë mes karrierës profesionale dhe jetesës familjare të rehatshme

Ajo çfarë maturantët e vitit 2012 në qytetin e Pogradecit konsiderojnë si më të rëndësishme në jetën e tyre është përparimi në karrierën profesionale e më pas vjen jetesa familjare e rehatshme. Karriera politike çuditërisht nuk i ka bërë për vete pothuajse fare, ndoshta ka ndodhur sepse janë lodhur nga politika jonë që vetëm politikë nuk mund të quhet. Pasurimi në vendin tonë është i vështirë të arrihet po nuk pate përparim në fusha të tjera, shprehen të rinjtë. Më e rëndësishmja është karriera profesionale e cila është renditur si më e vlerësuara dhe e dëshiruara prej tyre. Ndërkohë, jeta familjare e rehatshme është cilësuar si pjesë komplementare e arritjeve të tjera duke ndërthurur kështu në harmoni familjen me profesionin pa sakrifikuar kështu asnjërën prej tyre. Barack Obama në librin e tij *“Guximi për të shpresuar”*, në kapitullin dedikuar familjes thotë: Përveç shoqërizimit kudo e kurdo, fëmijët kanë agjenda njëloj të ngarkuara si ato të prindërve, takime për të luajtur, kurse baleti, tenisi, mësimet pianoje, orë gjimnastike, ndeshje sporti dhe së fundmi ditëlindje të përjavshme^[9]. Largimi i të rinjve nga qyteti drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës është një tendencë e re që po përhapet së shumti ndër adoleshentë. Arsyeja pse kam vendosur një pyetje të tillë është për të kuptuar realisht se çfarë duan të rinjtë të arrijnë në jetët e tyre. Në ditët e sotme kur shoqëria është në proces të vazhdueshëm ndryshimi, ku koncepti për familjen dhe jetën ka ndryshuar ishte e rëndësishme të zbuloja diçka konkrete dhe të patjetërsueshme lidhur mendësitë që nesër do të jenë vlerat bazë në jetën e tonë.

Robin Williams ka argumentuar se një ndër vlerat më kryesore të kulturës amerikane është: Mundësia e barabartë, që mund e duhet të kenë të gjithë njerëzit për të përfituar e përparuar në jetë dhe jo si barazi në gjendjen ekonomike, pasurore, në nivelin e arsimit etj. Mjaft sociologë mendojnë se kuptimi e realizimi praktik i barazisë sociale, si mundësi të barabarta, ka nxitur zhvillimin e aftësive krijuese të çdo individi, përpjekjet e shumanshme për të realizuar idealet, qëllimet e dëshirat në jetë, për të afirmuar personalitetin dhe individualitetin vetjak^[2]. Edhe shoqëria shqiptare postkomuniste priret ose më saktë, aspiron të rristrukturohet, të rimodelohet sipas shembullit të shoqërisë amerikane bashkëkohore. Sistemi i vlerave kulturore jo vetëm reflekton karakteristikat kryesore të mendësive, të mënyrës së jetesës, të organizimit e të funksionimit të një shoqërie, por, në një masë të madhe edhe i përcakton karakteristikat e tij^[2]. Janë pikërisht këto ndryshime që po ndodhin me kohën, të cilat nxitin tek individi sidomos tek të rinjtë ndjenjën për komfort material dhe individualitet.

3.6 Parapëlqimet e adoleshentëve rreth zgjedhjeve që bëjnë në jetë

Në shoqërinë shqiptare të dhjetëvjeçarëve të fundit forcimi i liberalizimit në mendësitë dhe sjelljet seksuale të të rinjve është shoqëruar me gjallërimin e mendësive konservatore të prindërve dhe të të afërmeve për të shmangur marrëdhëniet paramartësore të vajzave të reja^[2].

Të rinjtë hyjnë në marrëdhënie më tepër të shtyrë nga rrethanat e rastit sesa pasi kanë bërë plane apo kanë menduar paraprakisht për të. Të rinjtë që bashkëjetojnë një ditë edhe martohen, por jo patjetër me partnerin e tyre^[5]. Marrëdhënia paramartësore ndër adoleshentë është një fenomen dukshëm i përhapur, mjafton të shkosh në shkolla apo edhe në mjedise të tjera, si: bar- kafet, diskot dhe kupton sesa çlirët sillen me njëri – tjetrin. Ata thjesht mundohen t'ua fshehin “*mjeshtërisht*” prindërve këtë fakt, sepse ata e kanë ende të vështirë të pranojnë lirshëm të dashurin apo të dashurën e vajzës apo djalit të tyre. Nuk ka një shifër të saktë sesa është numri i personave që bashkëjetojnë sepse kjo mënyrë jetese nuk është e matshme për faktin se asnjëri nga partnerët nuk ka detyrim ligjor ndaj tjetrit. Në Shqipëri fenomeni i bashkëjetesës së çifteve u përhap disi më gjerësisht në fillim të viteve '90 të shekullit XX, kryesisht në qytetet më të mëdhenj, si: *Tirana, Durrësi* etj. Bashkëjetesa të motivuara nga dashuria janë më të përhapura ndër studentët dhe të rinjtë e diplomuar gjatë 4-5 viteve të fundit që studiojnë ose punojnë në Tiranë dhe i kanë familjet e prindërve të tyre në rrethe të tjera përgjithësisht më të skajshme^[3].

Martese apo Bashkëjetese? Kjo është një pyetje e cila ngrihet së fundmi nga studiues të shkencave sociale, të cilët analizojnë ndryshimet graduale në familje dhe shoqëri. Tendencat e adoleshentëve kundrejt bashkëjetesës po shkojnë gjithmonë dhe në rritje. Duke patur parasysh se qyteti i Pogradecit është një qytet i vogël dhe kryesisht me baza tradicionale mund të cilësohet si një ndryshim i madh në opinionin e të rinjve kundrejt formës së tyre të pëlqyer familjare. Kam dashur që analiza e kësaj pyetje të jetë më tepër e detajuar duke përfshirë edhe bashkëbisedime me vajza dhe djem. Vajza 18 vjeçare me inicialet A.K, shprehet në këtë mënyrë për bashkëjetesën dhe martesën: “Asaj i pëlqen të bashkëjetojë me një person që e do, por nuk dëshiron që kjo të vazhdojë për një kohë të gjatë sepse mendon se martesa është një mënyrë më e sigurt dhe me themele më të forta për krijimin e familjes. Megjithatë, ajo nuk hedh poshtë dëshirën për të bashkëjetuar, sepse mendon se në bashkëjetesë je e lirë të bësh gjërat që dëshiron, mund të jetosh me një person edhe pa dijeninë e prindërve, edhe në moshën që ajo është tani. Këtë mendim nuk e diskuton me prindërit sepse e di që ata nuk do ta aprovin mendimin e saj dhe do ta kishin të vështirë ta kuptonin këtë formë të re të krijimit të familjes”. Djemtë janë ata që interesohen më pak rreth opinionit të familjarëve për mënyrën sesi ata duan ta ndërtojnë jetën e tyre.

Një nga djemtë me inicialet J.Sh., shprehet se i pëlqen të bashkëjetojë, ka dëgjuar se shumë nga shokët apo kushërinjtë e tij pasi janë larguar nga Pogradeci për të studiuar apo punuar në Tiranë nuk janë martuar por bashkëjetojnë. “Mund të ndjekësh karrierën, mund të mos kesh fëmijë dhe mund të mos përfundosh me personin që je duke bashkëjetuar, djemve u pëlqen kjo pavarësi”. Në qytetin e Pogradecit numri i martesave ka ardhur gjithmonë edhe në ulje, nga një informacion

i marrë në Zyrat e Gjendjes Civile rezulton se për vitin 2009 numri i martesave ishte 263 ndërsa në vitin 2010 ishte 154, pra numri i martesave në një vit është ulur me 109 martesa. Shqipëria, ashtu sikurse edhe shumë vende të tjera të botës, ka pasur modelin e familjes tradicionale. Familjet shqiptare ndër vite kanë qenë tepër strikte rreth seksualitetit dhe ruajtjes së virgjërisë nga vajzat. Qytetarët e Pogradecit duke mos u çliruar nga paragjykimet, dhe duke analizuar më tepër jetën e tjetrit do ta kenë të vështirë t'i pranojnë këto forma jetese për fëmijët e tyre. Megjithatë, mendojmë se disa të rinj e duan bashkëjetesën, e disa të tjerë as që duan ta përmendin atë, ndoshta sepse janë edukuar në familje me idenë se të dashurit e një personi tjetër pa miratimin e familjes është “turp”.

3.7 Mendimi i adoleshentëve dhe ndryshimet më të rëndësishme në jetën e banorëve

Vlerat kulturore luajnë rol tepër të rëndësishëm në kulturën e një vendi. Vlerat, si të thuash, *“janë inde të padukshme me fibra ideale”*, të cilat përgjithësisht kanë qëndrueshmëri të lartë. Nga shkalla e përafrimit të vlerave kulturore të sistemeve të ndryshme përcaktohet në një masë të madhe ecuria e përshtatjes së njerëzve kur kalojnë përkohësisht ose përgjithnjë nga mjedisi i njërit sistem kulturor tek ai i tjetrit^[2]. Në studimet sociologjike është i mirëpritur përcaktimi i mendimtarit Robin Williams mbi vlerat kulturore. Sipas tij *“vlerat kulturore janë koncepte të përgjithshme, janë kritere në bazë të të cilave anëtarët e një kulture përcaktojnë se çfarë është e dëshirueshme, e mirë ose e keqe, e bukur ose e shëmtuar”*. Kështu, vlerat kulturore nuk janë pohime përshkruese. Ato janë vlerësime e gjykime nga pikëpamja e kulturës. Këto parime të gjera, interferohen në një masë të konsiderueshme me idealet, reflektohen drejtpërdrejt ose tërthorazi në çdo aspekt të veprimtarive të shoqërisë, të çdo individi. Çdo sistem kulturor ka tërësinë e vlerave të veta. Mirëpo, jo të gjithë anëtarët e kulturës çmojnë e respektojnë në të njëjtën masë të gjitha vlerat kulturore^[2]. Mendimi i të rinjve se cilat janë tre ndryshimet më të rëndësishme në jetën e banorëve të qytetit të Pogradecit, bën kështu të mundur renditjen sipas rëndësisë së elementëve kryesorë, ndryshues të jetës së qytetarëve.

Në ndryshim janë cilësuar: **1.** Përmirësimi i dukshëm i kushteve të jetesës, në ndërveprim me përmirësimin ekonomik, infrastrukturor, teknologjik dhe kulturor në jetën e shumicës së qytetarëve. **2.** Përmirësimi i kushteve të jetesës, për shkak të zhvillimit ekonomik, përmirësimit infrastrukturor, teknologjik dhe kulturor. Ndryshimin e mentalitetit, të rinjtë adoleshentë e kanë lidhur me faktorët e sipërpërmendur si ndikues dhe ndryshues. Është për t'u vlerësuar përkrahja e kulturave të reja dhe marrja prej tyre e gjithë vlerave pozitive, të tilla si liria e veprimit sipas interesit vetjak dhe sjellje më e kultivuar, kundrejt personave me mendime të ndryshme. Emancipimi dhe mendjehapja i ka bërë banorët e qytetit të Pogradecit të jenë më pak paragjykuar dhe thashethemexhinj, konstatuar ky fakt nga të rinjtë është vërtet një zhvillim pozitiv sidomos për veprimtaritë e brejit të ri. **3.** Faktor tjetër i vlerësuar si ndryshim në jetën e qytetarëve është aspekti kulturor. Sipas opinionit të të rinjve familjet cilësohen më pak tradicionale duke pranuar dhe

modifikuar konceptin mbi martesën dhe lirinë. Emancipimi dhe përshtatja me ndryshimet mendohet nga të rinjtë se i bën qytetarët e Pogradecit më tepër tolerantë dhe mirëprirës të ndryshimit. Këto ndryshime janë aspekte të rëndësishme që kanë ndikuar në jetën e familjeve dhe kulturës Pogradecare. Është shumë e vështirë të ndryshosh mentalitetin e gjyshërve, mentalitetin e prindërve e shoh disi të modifikuar por megjithatë faktorët e rinj ndryshues socialë dhe kulturorë po përparojnë. Janë të rinjtë ata që po u shkojnë pas ndryshimeve me hapa shumë të mëdha, pavarësisht kostove, ndërkohë që hendeku midis brezave rritet. Asnjë shoqëri nuk shpëton dot nga diferencat, as qyteti dhe qytetarët e Pogradecit.

3.8 Mënyra se si e karakterizojnë qytetin e tyre të rinjtë në raport me zhvillimet socio-kulturore që po ndodhin

Mënyra se si e vlerësojnë qytetin të rinjtë është e lidhur me vizionin e tyre. Nga analiza e të dhënave, maturantët shprehen me rezerva për ndryshimet që kanë ndodhur. Ndryshimet e qytetit shohin vetëm te fasada e jashtme por jo tek mentaliteti i qytetarëve. Në Pogradec nismat për ndryshimin e mentalitetit kanë nisur shumë vite më përpara, por ende ka rrugë të gjatë për të bërë. Këto nisma kanë patur synim lidhjen midis vendeve të ndryshme të botës me anë të kulturës dhe veprimtarisë sociale sepse kufiri i ditëve të sotme nuk mund të jetë një mur i para vitit 1990. Po citoj një fjalim të mbajtur nga zonja Cane, ish kryetare e Bashkisë Pogradec, rreth nismës së marrë në bashkëpunim me shoqatat e vendit tonë dhe ato ndërkufitare shprehet kështu: *“Mendoj se është shumë e rëndësishme të veçojmë në këtë aspekt rolin e madh që luan mendimi në krahasim me veprimin më vjen ndër mend një porosi e Solomonit: Në qoftëse doni të ndryshoni jetën tuaj, ndryshoni mendimet tuaja!”*¹⁸¹.

Përfundime dhe diskutime

Në keqkuptimet në shoqëri, në konfliktet midis brezave na “pengon mentaliteti” të kuptojmë njëri-tjetrin. Çdo adoleshent, çdo i ri ka dëshira që shpesh nuk realizohen për arsye të ndryshme ndër to edhe për shkak të mentalitetit. Nga studimidel qartazi në pah fakti se kemi rrugë të gjatë për të bërë në lidhje me mentalitetin dhe zbutjen e diferencave shoqërore dhe kulturore në marrëdhënien familjare si dhe mes banorëve të qytetit. Konstatohet se faktorët ndikues shoqërizues si, media, teknologjia, interneti, kulturat e tjera, emigracioni kanë një ndikim tepër të rëndësishëm në krijimin e mendësive të reja. Si pasojë shfaqen kontradita dhe konflikte në komunikimin midis brezave, sepse gjatë kohës është shfaqur një hendek i madh socio-kulturor që i nxjerr në pah të gjitha problematikat. Diferenca që ekziston midis brezave reflektohet në marrëdhëniet familjare midis prindërit dhe fëmijës. Prindërit i përkasin një brezi tjerët, i cili është ushqyer me mendësi të ndryshme nga ato të të rinjve sot.

Hendeku i krijuar rreth ndryshimeve në mentalitet, në mënyrën e ndryshme të konceptimit të vlerave dhe normave shoqërore, erdhi si pasojë e ndryshimeve që ndodhën pas vitit 1990. Tranzicioni bëri që jo vetëm ekonomia, kultura dhe jeta sociale të përfshihej në të, por edhe familja. Ende prindërit nuk po i kapin dot ritmet

e ndryshimit në të njëjtën linjë me fëmijët e tyre. Shpeshherë këto mospërputhje janë shprehur edhe në formën e konflikteve dhe debateve midis adoleshentëve dhe prindërve të tyre.

Sot, nxitjet te të rinjtë vijnë nga të gjitha anët e botës edhe pse shpesh herë me influencë negative, kjo ndoshta për faktin se ata i marrin ashtu siç vijnë. Të rinjtë në këtë mënyrë përballen me dy realitete, ai familjar që është ende tradicional dhe realiteti social që ndryshon si pasojë e rrymave apo kundërrymave të ndryshme shoqërore. Për të rinjtë e ditëve të sotme mund të konstatojmë pa frikë se *“anomia sociale”* pra, dëshira për të zgjedhur vendoset përballë frikës së zgjedhjes. Kështu, ata hidhen në krahët e ndryshimit shpesh herë transformimit social vetëm e vetëm për të qenë të pranuar nga rrethi i tyre shoqëror, pa menduar për pasojat dhe ndikimet negative që mund të kenë tek ata. Është e nevojshme që disa vlera të kulturës ekzistuese të përshtaten me vlerat e reja që vijnë si pasojë e ndryshimeve në kohë dhe hapësirë tek elementët shoqërorë dhe kulturorë. Hendeku midis brezave do të fillojë të ngushtohet kur midis prindrit dhe fëmijës të ketë komunikim normal, liri veprimi, respekt të dyanshëm të mendimit dhe sjelljes së njëri-tjetrit.

Bibliografi

Dahrendorf, R., *“Konflikti shoqëror modern”*, Tiranë: *“Dituria”*, 1997

Dervishi, Z., *“Sociologji kulture 1”*, Tiranë: *“Jerusalem”*, 2003.

Dervishi, Z., *“Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektivave”*, Tiranë: *“Jerusalem”*, 2001.

Djaloshi, D., *“Kultura dhe shoqëria jonë post komuniste”*, Pogradec. *“D.I.J.A-Poradeci”*, 2009.

Giddens, A., *“Sociologjia”*, Tiranë, *“Çabej”*, 2004.

Instituti i Statistikës, *“Studim për përdorimin e kohës së lirë”*, Tiranë: *“Pegi”*, 2011.

Macavinta, C., Pluym, A., *“Respekti për vajzat adoleshente”*, Tiranë: *“Max”*, 2005.

Muçllari, L., *“Të ndryshojmë mentalitetin”*, Pogradec, Gazeta *“Nositi”*, 27.5.2002.

Obama, B., *“Guximi për të shpresuar”*, Tiranë: Dudaj, 2002.

Vendresha, A., *“Adoleshentët të konfliktuar apo...?! Komunikimi”*, Pogradec, *“D.I.J.A-Poradeci”*, 1998.

Institucion: Gjendja Civile, Pogradec

DASHURIA, TOLERANCA DHE DIALOGU NË FILOZOFINË E GYLENIT

Genti Kruja

Përmbledhje

Filozofia dhe mendimi i Gylenit, tashmë është përhapur në të gjithë botën, duke dhënë një shembull të përkryer të dashurisë, tolerancës dhe dialogut, të cilat janë bërë kaq të domosdoshme në këtë kohë konfliktesh dhe përplasjesh mes kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme.

Kështu në kohët kritike që jetojmë ne sot në shekullin XXI, është e domosdoshme që të favorizohet mirëkuptimi, toleranca dhe miqësia ndërmjet njerëzve duke respektuar bindjet, fenë dhe kulturën e secilit dhe duke u mbështetur në parimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë. Respektimi i larmisë fetare dhe kulturore kërkon rritjen e dialogut ndërfetar dhe ndërkulturor në favor të lirisë dhe progresit. Shoqëria duhet të shqetësohet ndaj shfaqjeve të intolerancës dhe të diskriminimit, ndaj frikësimit dhe shtrëngimit, që janë rezultat i intolerancës fetare. Jo më kot, mendimtari i shquar i demokracisë, Tokëvili, porosiste që më 1830: “Lëreni shpirtin njerëzor të ndjekë prirjen e tij dhe ai do ta rregullojë në mënyrë uniforme shoqërinë politike dhe qytetin hyjnor; ai do të kërkojë, në qoftë se do të guxoja të thoja, të harmonizojë tokën me qiellin”

Fjalë kyçe: Dialog, tolerancë, dashuri, falje, filozofi.

Abstract

Gülen's thought and philosophy has now spread throughout the world, providing a perfect example of love, tolerance and dialogue that have become so essential in these times of conflict and confrontation between different cultures and civilizations. Thus the critical times that we live today in the XXI century, it is necessary to favor understanding, tolerance and friendship among peoples while respecting beliefs, religion and culture of each and relying on the principle of respect for human rights and freedoms fundamental to all. Respect for religious and cultural diversity requires increased interfaith and intercultural dialogue in favor of freedom and progress. Society should be concerned against intolerance and discrimination performances, against intimidation and coercion, which are the result of religious intolerance. Not surprisingly, thinker of democracy, Tocqueville, in 1830 prescribed that: "Let the human spirit to pursue his vocation and he would uniformly regulate political society and the divine city, he would ask if they would dare say, to harmonize earth with heaven”

Keywords: Dialogue, tolerance, love, forgiveness, philosophy.

1. Dashuria

Gyleni e përkufizon dashurinë, si elementin më thelbësor për çdo qenie, si ndriçimi më rrezatues dhe forca më e madhe, e aftë të rezistojë dhe të kapërcejë gjithçka tjetër. Është e pamundur për shpirtat pa dashuri të ngrihen në horizontin e përsosjes njerëzore. Ata të cilët janë privuar nga dashuria, si dhe janë ngatërruar në

rrjetën e egoizmit, janë të paaftë të dashurojnë njeri-tjetër veç vetes dhe marrin fund pa e ditur, që dashuria është ngulitur thellësisht në shumë qenie.

Një fëmijë është pritur me dashuri kur ka lindur dhe rritet në një atmosferë të ngrohtë të mbushur me dhembshuri, shpirtrat e dashur. Edhe nëse njeriu mund të mos gëzojë të njëjtën dashuri në të njëjtën masë në pleqërinë e vet, gjithmonë do të ketë mall për dashurinë dhe do ta kërkojë ngado në jetën e vet.

Çdo qenie merr pjesë në një orkestër të madhe me dashuri në univers, me simfoninë e veçantë të tij dhe provon të vërtetojë, me vullnet të lirë ose për shkak të gatishmërisë, një aspekt të dashurisë së thellë që ka gjetur në ekzistencë.

Dashuria është rrënjësuar shumë thellë në qeniet njerëzore, aq sa shumë njerëz lënë shtëpitë e tyre për hir të saj, shumë familje janë rrënuar dhe në çdo qoshe një Mexhnun rënkon me dashuri e me përmallim për Lejlanë e tij. Sa për ata të cilët nuk janë të aftë të zbulojnë dashurinë e natyrshme në qenien e tyre, e vështrojnë një manifestim të tillë të dashurisë si çmenduri!

Altruizmi gjithashtu është një ndjenjë e lartë njerëzore dhe burimi i tij është dashuria. Ai që ka një pjesë të madhe në këtë dashuri, është një hero i njerëzimit. Njerëz të tillë janë të aftë të çrrënjosin çdo ndjenjë urrejtjeje dhe smire në veten e tyre. Këta shpirtra, të cilët çdo ditë ndezin një zjarr të ri të dashurisë në botën e tyre të brendshme dhe i bëjnë zemrat e tyre burim dashurie dhe altruizmi, janë të mirëpritur dhe të dashur për njerëzit.

Një nënë që ka dhënë jetën për hir të fëmijës së saj, është një heroinë e dhembshurisë. Individët që ia kushtojnë jetën e tyre lumturisë për të tjerët, janë quajtur “heronj të devotshmërisë,” por ata të cilët jetojnë dhe vdesin për të gjithë njerëzimin, janë përkujtuar duke u fronëzuar në kujtesën njerëzore.

Asgjë më të vërtetë dhe të qëndrueshme se dashuria nuk ka në çdo komb ose shoqëri në botë. Dashuria nuk është vetëm një nga temat më të frekuentuara në diskutimet e ditëve tona, ajo është gjithashtu një prej debateve më esenciale. Marrëdhënia më e fortë midis individëve që i jep formë familjes, shoqërisë dhe kombit është dashuria. Dashuria universale shfaqet vetë kudo në kozmos, në faktin që çdo pjesëz ndihmon dhe mbështet një pjesëz tjetër.

Humanizmi është një doktrinë për dashurinë dhe ndjenjat njerëzore, artikuluar në mënyrë të pamatur këto kohë dhe që ka një potencial lehtësisht të manipulueshëm nëpërmjet interpretimeve të ndryshme.

Për Gylenin, dashuria është elementi më thelbësor i çdo qenieje, “një fuqi e madhe që mund t’i rezistojë dhe kapërcejë çdo forcë. Ajo e ngre çdo shpirt që e thith atë dhe e përgatit për ditët e përjetësisë”.

2. Falja

Dashuria është e lidhur edhe me faljen. Falja nuk mund të konsiderohet si e shkëputur nga virtyti, ose virtyti si i ndarë nga falja. Ai sjell një maksimum të vjetër: “Gabimet për të vegjlit, falja për të mëdhenjtë”. Për të treguar madhështinë e këtyre dy virtyteve ai sjell shembullin e Jezusit. “Jezusi i tha turmës së njerëzve të etur për të goditur me gurë një grua: “Në qoftë se ndonjëri prej jush është pa mëkate, le ta hedhë i pari gurin mbi të”. A mundet ndokush që e kupton këtë ndalesë, pikë e

bukur për ta konsideruar të goditurit me gurë të dikujt tjetër, kur ai ose ajo është gjithashtu kandidat për t'u goditur me gurë? Vetëm ata të pafat, të cilët kërkojnë që të tjerët ta kalojnë një test lakmues të caktuar mund ta kuptojnë këtë!". Dashuria, dhembshuria, toleranca dhe falja janë shtyllat e dialogut. Nga ligësia dhe urrejtja nuk prodhohet paqe dhe dialog.

Për më tepër, dashuria duhet të jetë e vërtetë. "Po qe se në një zemër dashuria është e vërtetë, armiqësia është simbolike; po qe se armiqësia është e vërtetë, dashuria është simbolike. Një çelës, ky, magjik që zbërthen shumë gjëra të vështira".

Tema e faljes, ka qenë për një kohë të gjatë pothuajse fushë ekskluzive e filozofëve dhe e teologëve. Megjithatë, në tri dekadat e fundit, faljes i është kushtuar rëndësi e veçantë nga një numër i madh studiuesish të fushave të ndryshme.

Shumë nga shkrimet teologjike islame, që ekzistojnë mbi faljen, duket sikur i bëjnë lutje përkrahësve të falin, por shpeshherë nuk ofrojnë ndonjë proces të integruar dhe të plotë për mënyrën e vënies së saj në praktikë. Ndërsa Gyleni në shkrimet, fjalimet dhe predikimet e tij të shumta, ka propozuar një perspektivë koherente të faljes, të pozicionuar në kontekstin e gjerë të mëshirës, e cila është një nga aspektet madhore të spiritualitetit në mësimet e tij.

Sipas prof. Al-Mabuk fjala "falje" shfaqet 61 herë në një nga librat e Gylenit (*Drejt një qytetërimi global me dashuri dhe tolerancë*), i cili ka dhe një kapitull përkushtuar temës së faljes. Gyleni në fakt propozon një rilindje të re, atë të zemrës. Përpjekjet e tij në drejtim të kësaj rilindjeje e vendosën atë në majën e listës së "100 Intelektualëve Publikë më të mirë të Botës" nga revista "Foreign Policy & Prospect" në 2008.

Konceptet e dashurisë, paqes dhe tolerancës, të cilat janë kushte paraprake për faljen, qëndrojnë si cilësi të spikatura, që përcaktojnë njëkohësisht Gylenin dhe lëvizjen e tij.

Koncepti i faljes nuk është i ri; ai është një fenomen i lashtë dhe kompleks, të cilit i është kushtuar një vëmendje e konsiderueshme nga tre fetë më të rëndësishme të botës: Islami, Krishtërimi, Judaizmi, si dhe nga tradita të tjera shpirtërore, si Hinduizmi dhe Budizmi. Ajo gjithashtu ka qenë një temë tërheqëse studimore për filozofët falë funksioneve të saj. Për shkak të karakterit të natyrshëm teologjik që ajo ka, koncepti i faljes është injoruar në mënyrë të konsiderueshme nga shkencëtarët socialë, në veçanti nga psikologët deri në mesin e viteve 1980. Sipas Al-Mabuk, kërkimet empirike mbi faljen filluan në Universitetin Winsconsin-Madison, të udhëhequra nga prof. Robert Enright. Modeli i procesit të faljes dhe teoria zhvillimore që Enright dhe Grupi i Studimit për Zhvillimin Njerëzor (1991) zhvilluan dhe testuan, hodhën themelet për eksplorimin shkencor modern të ditëve tona mbi faljen. Literatura bazë mbi faljen kaloi nga disa artikuj dhe libra, duke arritur në qindra artikuj, libra dhe shumë teza doktorature.

Falja është një proces kompleks, i cili zakonisht ndodh pas një dëmtimi. Ajo ka të bëjë kryesisht me shërimin psikologjik përmes të cilit i dëmtuari çliron dëmtuesin nga çdo mëri e ndjerë dhe nga çfarëdolloj sjelljeje të mundshme

hakmarrëse. Enright (2001) dhe Smedes (1984) përshkruajnë, se lëndimi që përshkon një krizë faljeje ka tre aspekte: ajo është gjithmonë personale, e padrejtë dhe e thellë. Falja është personale për arsye se ajo mund t'iu drejtohet vetëm personave, jo natyrës (p.sh. një uragani), ose një sistemi (p.sh. një institucioni). Ajo është gjithashtu e padrejtë në sensin, që personi nuk e meriton dhimbjen, ose që dhimbja ishte e panevojshme. Aspekti i tretë, thellësia, do të thotë që falja ndjek një dëmtim të thellë dhe të gjatë. Dëmtimi i padrejtë, personal, dhe i thellë mund të jetë psikologjik, emocional, fizik ose moral. Kështu një përkufizim i saktë i faljes është kyç për të kuptuar gjithashtu edhe perspektivën e Gylenit.

Sipas Al-Mabuk, falje nuk do të thotë harresë. Një dëmtim i thellë lë një shenjë të paharrueshme në përbërjen e qenies së dikujt, që është e vështirë ta zhvendosësh. Falje nuk është pajtim ose ribashkim. Falja është një deklaratë e brendshme ndërsa pajtimi është një bashkim, që ka të bëjë me sjelljen. Dikush mund të falë dhe ende të mos pajtohet, pasi ndonjë herë mund të jetë e rrezikshme, ose e pamundur për t'u pajtuar. Mund të jetë e rrezikshme për arsyen se dëmtuesi mbetet i pandryshuar, ose e pamundur për t'u pajtuar me atë, për shkak se personi ose nuk gjendet, ose është i vdekur. Falja sidoqoftë, përfshin gatishmëri, ose pritje me shpresën se pala tjetër do të ndryshojë. Falja, sigurisht, i hap rrugën mundësisë për t'u pajtuar.

Pikëpamja e Gylenit në këtë çështje është e rëndësishme, por nga këndvështrimi i tij, falja nuk është as indiferencë, as ta lësh diçka të kalojë, as shfajësim.

Pavarësisht të gjitha karakteristikave përcaktuese të faljes, literatura përmban shkrime të njerëzve, që kanë ngritur disa kundërshtime filozofike. Fillimisht, Niçe (1887) hodhi poshtë faljen, si një praktikë vetëm për të dobët. Pozicionimi i tij mund të sfidohet në dy mënyra. Së pari, kur dikush fal me të vërtetë ai nuk e lë të kalojë fajin. Së dyti, një falës i vërtetë e njeh mirë dhimbjen. Personi i dobët, nga ana tjetër nuk e njeh dhimbjen; i dobëti nuk lufton për ta parë tjetrin nga një pikëvështrim tjetër. Për më tepër, falja e vërtetë nuk është dëshpërim; por një çlirim i guximshëm.

Perspektiva e Gylenit është e rrënjësuar thellë në besimin e tij islam dhe faljen e shikon si një akt të zellshëm ose akt mëshire Ai gjithmonë i referohet dy burimeve, Kur'anit dhe traditës së Profetit për të ligjëruar në lidhje me faljen ose për të mbështetur qëndrimet e tij falëse dhe paqësore. Në një nga predikimet e tij, Gylen ka cituar këtë pasazh hyjnor: “Pa asnjë dyshim, Mëshira ime e paraprin Zemërimin tim”, dhe ajetet Kur'anore: “Mëshira ime shtrihet në të gjitha gjërat”, dhe “Ata e gëlltisën zemërimin e tyre dhe i falin njerëzit. Zoti i do ato që bëjnë mirë”.

Gyleni ve në dukje se atributi hyjnor i Mëshirës është themelor për konceptin e faljes. Zoti, pa bërë asnjë përjashtim, “edukon dhe mbron të gjitha qeniet njerëzore dhe Ai vazhdon të japë ushqim edhe për ata që e mohojnë atë.

Një pikë kyçe për të kuptuar prespektivën e Gylenit është koncepti i “qëndrueshmërisë në durim”, të cilën ai e nxjerr nga vargjet vijuese në Kur'an: “Në qoftë se doni të merrni hak, atëherë ndëshkoni në atë masë sa jeni ndëshkuar ju; e

nëse duroni, pa dyshim, kjo është më e mirë për ata që durojnë.” Nocioni i “durimit” ku një person e varros dhimbjen në gjoksën e tij është sinonim i nocionit të krishterë të thithjes së dhimbjes, e cila në mënyrë paradoksale e çliron tjetrin nga dënimi. Ky akt i devotshëm i varrosjes së dhimbjes nuk duhet ngatërruar me konceptin psikologjik të shtypjes, e cila është një përgjigje e natyrshme ndaj dhimbjes.

Një tjetër term kyç që Gyleni përdor, që nganjëherë mund të zëvendësohet me faljen, është toleranca. Ai i referohet një shembulli nga Profeti Muhamed mbi tolerancën dhe faljen në veçanti me njerëzit e Mekës, të cilët ishin armiqësorë në mënyrë të dhunshme ndaj tij. Ata e luftuan atë, komplotuan për ta vrarë, e dëbuan nga vendi i tij dhe bënë çdo gjë për të asgjësuar atë dhe ndjekësit e tij. Kur ai çliroi Mekën, mekasit armiqësorë ishin në ankth për të parë se çfarë do t’u bënte profeti atyre, por si një shenjë e dhembshurisë dhe mëshirës së tij, profeti i falë të gjithë ata dhe nuk u hakmor ndaj tyre.

Përveç konceptit të “durimit” dhe tolerancës, Gyleni gjithashtu përfshin dinamikën e dhembshurisë, e cila ofron si dëshirën e mirë, ashtu edhe vullnetin për të falur të tjerët. Si një shembull, për dhembshurinë Gyleni i kthehet jetës së Profetit Muhamed për t’u frymëzuar nga ajo. Në këtë mënyrë, ai përqafon dhe praktikon dashurinë pa kushte.

Në lidhje me faktin se pse falja është aq qendrore në mendimet, ndjenjat dhe veprimet e Gylenit, ai e trajton këtë çështje duke thënë, “ne besojmë se falja dhe toleranca do të shëroje shumicën e plagëve tona, vetëm nëse ky instrument hyjnor do të jetë në duart e atyre që do ta kuptojnë gjuhën e saj”. Gyleni e kupton fuqinë shëruese të faljes dhe e dallon efektin e fuqishëm transformues të saj tek individit dhe te shoqëria. Parakushti për të korrur rezultate pozitive nga falja, varet nga të kuptuarit saktë të gjuhës së faljes dhe zbatimit në mënyrë të duhur të procesit të saj.

Gyleni ka një besim të thellë në fuqinë e individit për ta transformuar shoqërinë drejt së mirës. Nevval Sevindi (2008) deklaroi se Gyleni beson në rolin qendror të individit në shoqëri, dhe citon fjalët e tij: “çdo gjë e së bukurës dhe çdo vlerë që shfaqet te individët shumëfishohet dhe reflektohet në shoqëri. Në të kundërt, çdo gjë që është e papërshtatshme, çdo pamjaftueshmëri është një skandal dhe si i tillë i bllokton rrugën shoqërisë dhe i shkakton plagë të rënda asaj”. Përdorimi i gjuhës së faljes i sjell individit dhe shoqërisë harmoni në zemër dhe mendje.

Mendimi përfundimtar mbi perspektivën e Gylenit ndaj faljes është se ajo bëhet një faktor i qëndrueshëm në jetën e dikujt. Falja gjithnjë ka qenë një seri e zakonshme në jetën e Gylenit.

3. Toleranca

“Toleranca jonë, shkruan Gyleni, duhet të jetë aq e gjerë, sa ne mund t’i mbylлим sytë tanë ndaj gabimeve të të tjerëve, të tregojmë respekt për idetë e ndryshme, dhe të falim gjithçka që është e falshme? Edhe kur shkelen të drejtat tona

të patjetërsueshme, ne duhet t'i respektojmë vlerat njerëzore dhe të përpiqemi që të vendosim drejtësinë.”

Gyleni e sheh "tolerancën", si një strehë të sigurt. Ai thekson se, duke ecur drejt së ardhmes si një komunitet i tërë, toleranca është streha më e sigurtë dhe fortesa kundër pengesave, që dalin për shkak të përçarjes, fraksioneve dhe vështirësive të natyrshme në arritjen e marrëveshjes së përbashkët; probleme këto, që rrinë duke pritur në çdo qoshe. “Ne duhet të kemi një tolerancë të tillë, që të jemi në gjendje të mbyllim sytë ndaj gabimeve të të tjerëve, të kemi respekt për idetë e ndryshme dhe të falim çdo gjë që është e falshme. Në fakt edhe kur ballafaqohemi me shkëlqen e të drejtave tona të patjetërsueshme, ne duhet të mbetemi të respektueshëm për vlerat njerëzore dhe të përpiqemi për të vendosur drejtësi. Edhe nëse gjendemi përpara mendimeve më të poshtra dhe ideve më mizore, ide të cilat neve na duket e pamundur t'i përqafojmë, me kujdesin e një Profeti dhe pa humbur durimin tonë, ne duhet të përgjigjemi me butësi. Ne, duhet të kemi aq shumë tolerancë, sa që të mund të përfitojmë nga idetë e kundërta, sepse ato na detyrojnë të mbajmë zemrën, shpirtin dhe ndërgjegjes aktive dhe të vetëdijshme edhe nëse këto ide nuk kanë asgjë për të na mësuar, direkt apo indirekt.

Nuk është e mundur të flitet për ide të përbashkëta ose për një vetëdije kolektive në komunitetet, ku individët nuk e shohin njëri-tjetrin me tolerancë, ose në vendet ku shpirti i vetëpërmbytjes nuk është plotësisht i rrënjosur.

Ai mbron idenë e dialogut mes feve dhe qytetërimeve. Kështu aktivitetet e tij në fushën e dialogut kanë hapur shumë dyer mes qytetërimeve të ndryshme në të gjithë botën. Këto dyer dhe kjo lloj marrëdhënieje me "tjetrin", u jep të dyja palëve një shans për t'u njohur me stilin e jetës, kulturën, pikëpamjet botërore dhe mendimet e njëri-tjetrit, të cilat janë shumë të rëndësishme nëse duam të jetojmë së bashku në këtë botë. Ky dialog të hap sytë për të njohur njëri-tjetrin dhe nxit ta duam njëri-tjetrin.

Një tjetër aspekt i krijimit dhe ruajtjes së dialogut, është nevoja e rritjes së interesave të përbashkëta që kemi me njerëzit e tjerë. Sot, ka nevojë më shumë se kurrë për njerëzit, që janë të virtyshëm, gjakftohtë, të matur, të sinqertë dhe të pastër, ndihet nevoja e njerëzve të zemrës, që nuk vjedhin, ose mendojnë shumë lart për veten e tyre dhe të cilët preferojnë mirëqenien e të tjerëve para asaj të tyre dhe të cilët nuk kanë ndonjë lakmi rreth kësaj bote. Nëse shoqëria mund të edukojë njerëzit me këto karakteristika, atëherë kjo do të thotë se një e ardhme më e mirë është e pashmangshme.

Në këtë deklaratë, ai e vë fort thekson në "dashurinë", e cila është një element thelbësor i paqes dhe i bashkëjetesës në botë. Sipas Gylenit, “dialogu, toleranca, dhe besimi e përforcojnë njëri-tjetrin: të zhvilluara përmes dialogut dhe tolerancës ato ndihmojnë për të pranuar të gjitha dallimet, në mënyrë që të ecet më tej drejt qëllimit më të gjerë të bashkëpunimit”. Ky qëllim më i gjerë i bashkëpunimit është paqja prosperiteti dhe respekti.

Në një botë të globalizuar, ku diversiteti kulturor dhe fetar është i dukshëm, duhet të jemi më të vetëdijshëm për ekzistimin e feve të tjera dhe pikëpamjeve e tjera jashtë

rrethit dhe shoqërisë sonë, ndaj kjo do të thotë rritje e ndërveprimit midis njerëzve të besimeve dhe prejardhjeve të ndryshme. Nevoja për njohjen e "tjetrit" në një shkallë të caktuar është thelbësore; mungesa e njohurive dhe bashkëveprimit mund të jenë të rrezikshme dhe mund të përforcojë idenë se "tjetri", është disi i huaj. Në momentin kur "tjetri" perceptohet si i huaj, apo i panjohur, ne hyjmë në rrugë të pasigurt. Si rezultat, arsimimi dhe dialogu janë bërë instrumente të fuqishme, që janë të domosdoshme për njerëzit të cilët kërkojnë paqe, duke siguruar se "tjetri" nuk është aq "i huaj". Për sa i takon "domosdoshmërsë së dialogut ndërfaqet", të njohurit e njëri-tjetrit përmes dialogut është thelbësore për krijimin e një paqeje botërore.

Gyleni në fund shpreh sigurinë e tij për të ardhmen e botës, duke thënë se, të gjitha institucionet e jetës do të riformohen dhe gjeneratat që vijnë do të jenë të pajisur me njohuri, aftësi dhe botë shpirtërore të thellë. Rrugët do të bëhen si korridoret e shkollës, burgjet (nëse do të ketë) do të transformohen në ndërtesa të arsimit dhe shtëpitë do të kthehen në pallate të parajsës. E ardhmja do të përjetojë një botë të re të ndërtuar në krahët e shpresës, besimit dhe zgjidhjes së problemeve, një botë më të përmbajtur dhe më të begatë sesa utopitë e ëndërruara në Perëndim. Askush nuk duhet të thotë se jemi larg nga një botë e tillë. Ndoshta ne mund të jemi në pragun e saj. Tërë njerëzit do të shohin, në një të ardhme të afërt, që të tjerë "diej" do të kenë lindur nga "mitra" e natës para se të dalë dita.

Sipas Gylenit, mirëkuptimi ngrihet dhe arrin përsosjen përmes natyrës njerëzore. Në këtë këndvështrim, ne mund të dëshmojmë mirëkuptimin më të madh dhe tolerancën më të paqortueshme në shembujt më të rëndësishëm të humanitetit.

“Hapja çdokujt zemrën sa mund t’ia hapësh, le të jetë si oqean! ...dhe për njeriun dashuri ndje, të mos mbetet zemër e dëshpëruar që s’u interesove për të e s’ia zgjate dorën!

Brohoriti të mirët për të mirat!..

Përgjigju të keqes me të mirë! Çdo njeri, me sjelljet e veta, me karakterin e vet reflekton. Ti zgjidh rrugën e tolerancës dhe mirëkuptimit dhe përballë atyre që s’dinë se ç’është tradita dhe edukata, tregohu bujar!

Ti duaje njeriun, mahnitu pas njerëzores!”

Këto janë principet bazë të filozofisë së Gylenit në lidhje me konceptin ndaj dashurisë njerëzore. Ai thotë se, ne duhet të kemi një tolerancë të tillë që të jemi në gjendje të mbyllim sytë para dobësive të të tjerëve, të kemi respekt për idetë e ndryshme dhe të falim çdo gjë që është e falshme. Në fakt, edhe kur përballemi me shkeljen e të drejtave tona të patjetërsueshme, ne duhet të mbetemi të respektueshëm për vlerat njerëzore.

Këtë gjë ne mund ta shohim edhe në konceptin filozofik në lidhje me natyrën njerëzore, ku përparimi ynë në njohjen e natyrës njerëzore do të na zbulojë gradualisht vështirësitë nën të cilat ne punojmë dhe jeta njerëzore do të bëhet më e mirë dhe më e lumtur.

Nga pikëpamja filozofike, në qoftë se përparimi në shkencën e natyrës njerëzore do të arrijë të zbulojë ligjet themelore, që drejtojnë shfaqjet ose manifestimet e saj, atëherë do të realizohet mijëvjeçari i ardhshëm, për të cilin fliste edhe krishterimi. Kjo ide përforcohet edhe në analogji me zhvillimin e shkencave natyrore. Në qoftë

se mendimi njerëzor arrin të kuptojë vetveten më mirë, atëherë ai do të operojë në mënyrë të re dhe të ndryshme dhe këto mënyra të reja të të vepruarit do të çojnë në probleme të reja morale, sociale dhe politike dhe kështu mijëvjeçari i ardhshëm i lumturisë do të jetë shumë i afërt.

Toleranca, një term që ne e përdorim herë pas here në vend të fjalëve respekt, mëshirë, bujari, ose vetpërmbytje, është elementi më esencial për sistemet morale, burimi më i rëndësishëm i disiplinës shpirtërore dhe një virtut me mjaft vlerë.

Ata të cilët nuk përqafojnë gjithçka për krijesat njerëzore me tolerancë dhe mirëkuptim kanë humbur vlerën e tyre për të pritur mirëkuptim dhe falje.

Në vendet ku mbizotëron korrupsioni, intoleranca dhe mungesa e mëshirës, nocione të tilla si liria e mendimit, kritika e qytetëruar, shkëmbimi i ideve në përputhje me normat e drejtësisë dhe debati i paanshëm janë të përjashtuara.

Është e pamundur të bisedosh rreth ideve të përbashkëta ose një ndjenje kolektive në komunitetet ku individët nuk i vështrojnë të tjerët me tolerancë, ose në vendet ku shpirti i vetpërmbytjes nuk është i mbrojtur plotësisht. Në këto vende, idetë do të përprijnë njëra-tjetrën në vorbullën e konflikteve. Në një vend ku nuk ka tolerancë, është e pamundur të flasësh për zhvillimin e mjeteve të komunikimit masiv, për mendimin e përparuar ose, për më tepër, për aktivitetet kulturore që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Tolerancë nuk do të thotë të jesh i ndikuar ose i lidhur me të tjerët, por t'i pranosh të tjerët siç janë dhe të dish si të ecësh përpara me ta. Askush nuk ka të drejtë të shprehë diçka rreth këtij aspekti të tolerancës, gjithsecili në këtë vend ka këndvështrimin e tij. Njerëzit me mendime dhe qëllime të ndryshme ose do të kërkojnë rrugët për të ecur përpara me synimin për harmoni, ose do të luftojnë vazhdimisht me njëri-tjetrin. Gjithmonë ka pasur njerëz që mendojnë ndryshe nga njëri-tjetri dhe kështu do të jetë përherë.

Sot, më tepër se për çdo gjë tjetër, shoqëria ka nevojë për tolerancë. Në emër të dialogut të gjithë mund të bashkohen në tokën e përbashkët dhe të shtrëngojnë duart me njëri-tjetrin.

Historia na informon se njerëzit e besimeve, racave, ngjyrave dhe gjuhëve të ndryshme, kanë jetuar së bashku në paqe. Ekziston një shpresë në rritje që grupet e ndryshme etnike do të mund të jetojnë së bashku. Prandaj, ka vetëm një mënyrë për të arritur paqen, të mësuarit për të jetuar së bashku siç thuhet në një nga rezolutat e Kombeve të Bashkuara:

Rezoluta përcakton një kulturë të paqes, që përfshin vlerat, qëndrimet dhe sjelljet që (1) refuzojnë dhunën, (2) bëjnë përpjekje për të parandaluar konfliktet, duke trajtuar shkaqet rrënjësore dhe (3) synojnë zgjidhjen e problemeve përmes dialogut dhe negociatave. Aty propozohet që të dy palët, si shtetet ashtu edhe shoqëria civile të mund të punojnë së bashku për të promovuar një kulturë të tillë, duke bërë përpjekje për të promovuar tetë parimet bazë për një kulturë të tillë. Këto janë: (1) *arsimi* (dhe veçanërisht, edukimi për zgjidhjen paqësore të konfliktit); (2) *zhvillimi i qëndrueshëm* (duke përfshirë çrrënjosjen e varfërisë, reduktimin e pabarazive, dhe mbështetja për mbrojtjen e mjedisit); (3) *të drejtat të njeriut*, (4) *barazia gjinore*; (5) *pjesëmarrja demokratike*; (6) *mirëkuptimi, toleranca dhe solidariteti* (mes popujve,

grupeve të rrezikuara, emigrantëve brenda vendit, si dhe midis kombeve); (7) *pjesëmarrja në linjat e komunikimit dhe rrjedhja e lirë e informacionit*; (8) *paqja dhe siguria ndërkombëtare*, (duke përfshirë çarmatimin dhe iniciativa të ndryshme pozitive.

Megjithatë, Gyleni është përpjekur për të arritur më shumë se kërkesat e kësaj rezolute. Me fjalë të tjera, misioni i tij për paqe ka filluar shumë më herët se shpallja e kësaj rezolute.

Botës së sotme të globalizuar i nevojitet paqja, vlerat morale, etike dhe natyrore të vetëdijes njerëzore, si dhe ndërgjegjësimi në mënyrë që njerëzit të jetojnë së bashku në harmoni.

Fethullah Gylen shpreh gjithashtu qëndrimin e tij edhe për filmin "Pasioni i Krishtit." Ai thotë se nuk është koha për një film të tillë, sepse edhe pse në pamje të parë nuk u prish punë myslimanëve, ai nxit urrejtjen dhe nuk i shërben aspak paqes në botë.

Sipas studiuesit Canan, vepra e Gylenit dhe mendimet e tij janë universale. Qëllimet e tij nuk janë lokale, rajonale apo globale, por janë universale. Për këtë arsye, në qoftë se dikush e kategorizon atë si një nacionalist, apo dikush tjetër e konsideron vetëm si pjesë e umetit (komuniteti mysliman në mbarë botën), ose një regjionalist, një kategorizim i tillë do të ishte shumë i ngushtë

Konkluzione

Sipas Gylenit njerëzit idealë janë gjithmonë në paqe me veten e tyre. Ata janë të kënaqur dhe për më tepër vendosin gjithë bagazhin e njohurive dhe të kuptuarit të tyre në shërbim të njerëzimit. Ata përdorin me guxim përkushtimin e tyre për të zhdukur botën e padrejtësisë dhe tiranisë dhe nuk tremben kur bëhet fjalë për të mbrojtur tokën dhe nderin e tyre. Dhe gjithmonë ata me tolerancë shtrijnë dorën e pajtimit mbi vëllezërit dhe motrat e tyre.

Ata gjithashtu shqyrtojnë gjithçka që ndodh pors i një shkencëtar në laborator. Ata ia kushtojnë jetën e tyre njerëzimit dhe lënë pas një botë më të mirë për brezat që vijnë.

Njerëzit idealë përpiqen që të jenë të drejtë. As pasionet e tyre fizike e as qëllimet shpirtërore nuk hedhin dyshime mbi sinqeritetin e tyre. Në zemrat e tyre ata shkrijnë çdo vulgaritet, apo ndjenja të këqija që burojnë nga të tjerët, duke treguar se si mposhtet e keqja me mirësi. Gyleni përpriqet të portretizojë një individ, apo një grup individësh, që do të ndryshojnë gjendjen e tanishme të botës, e cila aktualisht nuk është shumë pozitive në drejtim të paqes dhe prosperitetit. Këta persona përmenden me emra të ndryshëm në veprën e tij të tillë si: brez i ri, brezi i artë, të rinjtë, njeriu ideal, gjeneratat e lumtura, brezi i pritur, njerëzit e shërbimit, heronjtë e tolerancës, adhuresit e dashurisë, njerëzit e dashurisë, heronjtë e dashurisë etj.

Sipas Gylenit, njeriu i ri është një person që mendon, hulumton e beson dhe është i mbushur përplot me kënaqësitë shpirtërore. Ndërsa është në gjendje të përfitojë nga

dobia në përdorimin e plotë të mjeteve moderne, ai nuk i lë pas dore vlerat e tij tradicionale dhe shpirtërore në ndërtimin e botës së tij të brendshme.

Ai do të përdorë çdo gjë për të mirën e njerëzimit dhe për të mbjellë botën me farat e një të ardhmeje të lumtur. Ai do t'ia kushtojë tërë jetën e tij kësaj ruge të së vërtetës.

Në mënyrë që të qëndrojnë në kontakt dhe të komunikojë me mendjet, zemrat dhe ndjenjat e njerëzve, njeriu i ri do të përdorë mjetet e komunikimit masiv dhe do të përpiqet të vendosë në botë një balancë të re pushteti mbi themelet e drejtësisë, dashurisë, respektit dhe barazisë midis qenieve njerëzore. Ai do të vërë pushtetin dhe fuqinë nën komandën e drejtësisë dhe nuk do t'i diskriminojë njerëzit në bazë të ngjyrës apo racës.

Njeriun e ri do të bashkojë në karakterin e tij thellësinë shpirtërore, gjerësinë e dijeve, të menduarit të shëndoshë, temperamentin shkencor dhe aktivizmin e mençur. Asnjëherë i kënaqur me atë që ai tashmë e di, ai vazhdimisht do të rritet në shkallën e tij të njohurive.

Sipas tij, i pajisur me moralin dhe virtytet të cilat e bëjnë një person qenie të vërtetë njerëzore, njeriu i ri është një altruist, i cili përfshin të gjithë njerëzimin me dashurinë e tij.

Njeriu i ri nuk është kurrë reagues. Ai nuk rend pas ngjarjeve; në vend që të kthehet në motor të historisë, ai nis dhe formon vetë ngjarje dhe me perceptimin e drejtë për shkak të moshës dhe kushteve përreth tij, si dhe për shkak të përkushtimit ndaj vlerave esenciale, ai është në një gjendje të vazhdueshme vetë-rinovimi.

Gyleni është plot shpresë dhe i inkurajon njerëzit me fjalë të tilla si: “Bota jonë e brendshme duhet të jetë plot e përplot me dashuri dhe mëshirë për njerëzimin, nuk duhet të ketë vend në të gjithë zemrën tonë për armiqësi. Le të mos ketë asnjë dyshim se ky shekull i ri do të jetë një epokë kur dashuria dhe dialogu do të lulëzojnë. Antagonizmi do të çrrënjohet dhe frutet e dashurisë dhe tolerancës do të lindin kudo. Kjo nuk është një mundësi e largët, veçanërisht në një kohë kur bota është duke përfjetuar globalizmin.

Bibliografia

Al-Mabuk, Radhi, University i Northern Iowa, (Departmenti i Psikologjisë Edukative), “Perspektiva e Gylenit mbi Faljen”, simpozium: “Këndvështrim i diversitetit fetar, kulturor dhe shoqëror në Ballkan nga perspektiva globale; Përvoja e Fethullah Gylenit si Model dhe Harmonia Ndërfetare në Shqipëri”, Tiranë, 25-26 Mars, 2011.

Canan, Ibrahim, Fethullah Gulen'in Sunnet Anlayisi, Istanbul, Ufuk Kitap, 2007.

Çinar, Bekir, “M. Fethullah Gylen dhe kontributi i tij për Paqen Botërore”, simpozium: “Këndvështrim i diversitetit fetar, kulturor dhe shoqëror në Ballkan nga perspektiva globale; Përvoja e Fethullah Gylenit si Model dhe Harmonia Ndërfetare në Shqipëri”, Tiranë, 25-26 Mars, 2011.

- Gülen, “Veprimi dhe Mendimi”, The Fountain, Janar- Mars 1996.
- Gülen, “Yeni nesil”, Nil, Stamboll, 1995.
- Gülen, *Essays – Perspectives – Opinions*, TUGHRA Books, 2010.
- Gülen, *Key concepts in the practice of SUFISM esmerald hills of the heart*, V. 2, 2004.
- Gülen, The Fountain, Njeriu i Ri, Korrik-Shtator 1995.
- Gülerce, Huseyn. (14.10.2010). “Jam thjeshtë Fethullahu, djali i Ramizit”, gazeta *Today’s Zaman*, 2010. Marrë nga <http://www.todayszaman.com>
- Gylen, “Dialogu në Shpirtin dhe Domethënien Muhammedane”, 2006, 23 Mars 2011, nga Pearls.org: http://www.pearls.org/index2.php?option=com_content&do_pdf=1&id=27
- Gylen, “*Drejt një qytetërimi global me dashuri dhe tolerancë*”, Prizmi, Tiranë, 2004.
- Gylen, F., “Kriteret ose dritat e rrugës”, Prizmi, Tiranë, 2003.
- Gylen, F., *Yitirilmis Cennete Dogru*, Nil, Izmir, 1988, *Towards the Lost Paradise*, Kaynak, Izmir, 1988.
- <http://en.fgulen.com/about-fethullah-gulen/biography.html>
- <http://en.fgulen.com/love-and-tolerance/269-forgiveness-tolerance-and-dialogue/1797-forgiveness.html>
- <http://en.fgulen.com/love-and-tolerance/269-forgiveness-tolerance-and-dialog/1800>
- Keskin, Z., “Përdorimi Efikas i Arsimit si një Mjet për Formimin e Sjelljeve: Përvoja Australiane”, The Fountain, Mars-Prill 2011.
- Korostelina, K., “Ripërkufizimi i “Ne” dhe “Ata”: Qëndrimi i Gylenit në lidhje me transformimin e perceptimeve ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve. Islami në Epokën e Sfidave Globale, Georgetown, 2008.
- Rivera, J. d., Hyrje në J. d., Manual rreth Ndërtimit të Kulturës së Pagues, New York: Springer, 2009.
- Sinani, Prof. Dr. Gjergj, “Filozofia e historisë”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1999.
- Sinani, Prof. Dr. Gjergj, kumtesë me temë: “Një analizë e filozofisë së Gylenit nga një perspektivë humaniste”, simpozium: “Këndvështrim i diversitetit fetar, kulturor dhe shoqëror në Ballkan nga perspektiva globale; Përvoja e Fethullah Gylenit si Model dhe Harmonia Ndërfetare në Shqipëri”, Tiranë 25-26 Mars 2011.
- Sinani, Prof. Dr. Gjergji, “Dialogu ndërfetar e ndërkulturor si vlera integruese”, Prizmi, Tiranë, 2008.

SIGURIMI I CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI DUHET TË MBËSHTETET NË OPTIKËN E PLATFORMËS EVROPIANETË MODERNIZIMIT TË ARSIMIT

Gjergji Pendavinji, Robert Statoberdha

Universiteti Fan S. Noli

Përmbledhje:

Ky artikull synon të parashtojë modestisht disa tendenca të përpunimit të një vizioni bashkëkohor për sa i përket çështjes së sigurimit dhe administrimit të cilësisë së arsimit të lartë (AL) në Shqipëri lidhur ngushtë me zhvillimet e këtij procesi në kontinentin evropian.

Ai bazohet në raportin e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë Komisionit Evropian për “mbështetjen dhe modernizimin e arsimit të lartë në vendet e Bashkimit Evropian (BE)”. Ky raport finalizohet me 16 rekomandime shumë të rëndësishme për mbështetjen strategjike të zhvillimit të AL në Europë.

Nisur nga kjo optikë europiane si dhe nga problematika aktuale e zhvillimeve të brendëshme të AL në vendin tonë vëmendja është përqëndruar në disa drejtime thelbësore për thellimin e reformes në këtë sektor dhe vecanërisht në kombinimin e përpjekjeve që inicion koha për sigurimin e cilësisë dhe menaxhimin e elementeve të saj përbërës.

Synimi i autorëve është të tërheqin vëmendjen drejt një diskursi profesional për sa i takon problemeve komplekse të cilësisë, të integritetit evropian dhe modernizimit të AL në vendin tonë.

Fjalë kyç: raport i vlerësimit të AL; modernizim i AL; zhvillim i kompetencave; shpirti i bashkëveprimit dhe inovacionit; rekomandime.

Abstract:

Quality achievement of higher education in Albania ought to be supported by the European platform overview for the modernization of education.

This research paper aims at putting modestly forward some of the elaborating trends of a contemporary vision which has to do with the achievement and administration of the quality of higher education in Albania closely connected with the development of this process in the European continent.

This is based on the report of the higher level of the expert group of the European commission for "support and modernization of the higher education in the European union countries". This report is finalized on 16 recommendations for strategic support of the development of high education in Europe.

Judging from this European point of view and from the actual reality of the internal development of high education in our country, the attention is focused on some very essential directions for the realization of the reform in this sector and especially on

the efforts that the time initiates for the achievement of quality and the management of its composing elements.

The researchers' goal is to draw attention for a professional discussion in relation with the complex problems of the quality towards the European integration and modernization of higher education in our country.

Key words: Report of assessment of higher education; modernization of high education; development of competencies; cooperation and innovation spirit; recommendations.

1.Hyrje

Prezantimi i problemit

Zhvillimet reformuese të Arsimit të Lartë në Shqipëri janë frymëzuar veçanërisht nga orientimet e zhvillimet arsimore evropiane, kuptojmë këtu, reformat e thella të BE-së për një arsim të lartë të unifikuar evropian çka u finalizua në Konventën e Bolonjës. Përvoja evropiane e sistemit të arsimit të lartë ka shënuar një impakt pozitiv në veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë në mbarë hapësirën evropiane pra edhe në atë shqiptare. Por ritmet e zhvillimit kontinental e rajonal përcaktojnë drejtime të reja gjithmonë e më të efektshme reformimi. Sot, ne kemi në dorë një dokument shumë të rëndësishëm strategjik të Komisionit Evropian të hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë për mbështetjen e modernizimit të arsimit të lartë në vendet anëtare të BE-së. Ky grup ka publikuar raportin e parë mbi fuqizimin e cilësisë së arsimit dhe mësimdhënies në universitete.

Grupi i përbërë nga ekspertët më të mirë të arsimit e vë theksin tek nevoja e formimit të profesoratit në arsimin e lartë mbi bazën e zhvillimit të kompetencave që lidhen me shpirtin e bashkëveprimit dhe inovacionit tek studentët duke propozuar për këtë qëllim “krijimin e një akademie evropiane të arsimit dhe të formimit”. Vëmendja e kësaj akademie të përqëndrohet tek mënyrat e të menduarit dhe tek idetë e reja. Sipas ekspertëve të grupit konkludohet se “sistemet tona të arsimit të lartë dhe formimit përjashtojnë një arsim cilësor në aspektin e pajisjes së studentëve me një ekuilibër të mirë të kompetencave në shërbim të zhvillimit të tyre personal dhe profesional”.

Grupi i Ekspertëve të Lartë Evropianë ka konstatuar se një numër institucionesh të Arsimit të Lartë nuk këmbëngulin aspak mbi arsimin në raport me kërkimin megjithëse, të dyja janë misione kyç për arsimin e lartë. Për këtë arsye, duhet riekuilibruar ky raport dhe njëherësh t'i akordohet gjithë pesha e meritës akademike në këndin e karrierës.

Procesi i Bolonjës ka mundësuar një sërë programesh në këtë fushë. Ai u lejon studentëve të studiojnë lehtësisht jashtë vendit të tyre duke marrë njohuri në degët përkatëse në të gjitha llojet. Po kështu një sistem i ri shumëdimensional i klasifikimit të universiteteve i prezantuar me nismën e Komisionit Evropian do të lehtësojë krahasimin midis universiteteve me qëllim që studentët të jenë më të mirinformuar kur të zgjedhin universitetin e tyre.

Programi Evropian i Modernizimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, i miratuar nga ministrat e arsimit më 28 dhe 29 nëntor 2011, përcakton sektorët në të cilët vendet e BE-së duhet të bëjnë më shumë përpjekje për arritjen e objektivave dhe tregojnë se si BE-ja mund të mbështesë politikat e modernizimit. Një numër prioritetesh mbështesin cilësinë dhe zhvillojnë përshtatshmërinë e arsimit të lartë me interesat e studentëve për punësim dhe zhvillim të karrierës për të ardhmen e njëkohësisht zgjerimin e numrit të diplomave.

Programi nxit një bashkëpunim të gjerë midis universiteteve, ndërmarrjeve dhe qendrave të kërkimit. Edhe programi “Erasmus për të gjithë” i fokusuar në edukimin e formimin e rinisë do të mbështesë reformën dhe politikat në shtetet anëtare duke vënë theksin në forcimin e bazës së njohjeve të cilat mund të nisin përpunimin e politikave dhe këmbimeve të praktikave të mira.

Grupi i Nivelit të Lartë Evropian e konsideron arsimin shumë të rëndësishëm. Ai është po aq i rëndësishëm sa kërkimi. Për këtë arsye duhet vënë cilësia e arsimit dhe formimit në plan të parë.

II. Rekomandimet në themel të reformimit dhe modernizimit të arsimit të lartë në Evropë

a. Formimi pedagogjik i certifikuar i personelit mësimdhënës në institucionet e arsimit të lartë deri në vitin 2020(shih rekomandimin 4)

Formimi profesional i vazhduar në arsim duhet të bëhet një kërkesë për të gjithë mësimdhënësit në arsimin e lartë. Këtij qëllimi do t'i shërbejnë dhe kurset e hapura dhe masive të cilat mundësojnë formimin e personave të pranuar në arsimin e lartë. Partnerët e 11 vendeve kanë çelur kurset e para MOOC (Massive OpenOnline Courses) panevropiane me ndihmën e Komisionit Evropian.

Autoritetet publike përgjegjëse për AL-në duhet të mbështesin fuqishëm financimin me qëllim që të ndihmojnë institucionet e AL-së në përpjekjet për forcimin e cilësisë së arsimit dhe formimit akademik.(rekomandimi 1)

Njëkohësisht, vendimet e rekrutimit, të përparimit dhe promovimit të personelit universitar do të duhet të mbështeten në një vlerësim të kompetencave pedagogjike, paralelisht me faktorët e tjerë. (rekomandimi 5)

Grupi i ekspertëve sugjeron gjithashtu një mbështetje me bursa apo programe efikase kualifikimi për personelin mësimdhënës të arsimit të lartë i cili kontribuon në mënyrë domethënëse në fuqizimin e cilësisë së arsimit dhe të nxënësve, qoftë me anë të praktikave apo me anë të kërkimit mbi mësimdhënien dhe formimin.

b. Formimi cilësor, dialogu me aktorët e tjerë dhe tregun e punës

Konceptimi dhe realizimi i programeve të kualifikimit duhet të bëhen me anën e një dialogu dhe partneriteti midis trupës mësimdhënëse, studentëve, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë të tregut të punës ndërkohë që dhe programet të mbështeten mbi metodat e reja të mësimdhënies dhe përvetësimit të njohurive me qëllim që studentët të fitojnë kompetencat e domosdoshme për të përforcuar kapacitetin e tyre të njohjes profesionale.

Dialogu dhe partneriteti i institucioneve të arsimit të lartë dhe vendimarrësve politikë nacionalë me studentët konsiderohet rruga më efikase që duhet aplikuar për sistemin e shërbimit këshillimor, orientimin, tutoriatit me qëllim që të ndihmohen studentët veçanërisht kur ata hyjnë në arsimin e lartë por edhe më tej gjatë ecurisë së tyre deri në diplomim e më tej.

Rezultatet e studentëve në aktivitetin e tyre të përvetësimit të njohurive duhet të vlerësohen në funksion të objektivave të të nxënit të qartë, objektivat të cilat përcaktohen në bashkëveprim me njohuritë akademike të universiteteve.

c. Vlerësimi i nxënit në raport me objektivat e formimit të shpirtit inovator

Një grup rekomandimesh të rëndësishme të Grupit të Ekspertëve në raportin e modernizimit të Arsimit të Lartë Evropian kanë të bëjnë me formimin dhe përvetësimin e njohurive, me synime të përcaktuara, të mirorientuara për të ardhmen. Ky, është çelësi i menaxhimit dhe administrimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Kështu, institucionet e AL-së, duhet të kujdesen dhe të promovojnë rrugët ndërdisiplinore të arsimit, të të nxënit dhe të vlerësimit me qëllim që të ndihmohen studentët në kultivimin dhe zhvillimin e mendjes së hapur, shpirtit të tyre bashkëveprues të një mentaliteti inovator.

Rekomandimi 13 i sugjeron BE-së se ai duhet të promovojë zbatimin e strategjisë së modernizimit të AL-së duke nxitur:

- rrugët pedagogjike dhe metodat e arsimimit dhe formimit novator;
- metodat e orientimit, të këshillimit dhe të tutorialitetit për studentët;
- mbështetjen e konceptimit të programeve që bazohen tek kërkimet e fundit mbi të mësuarit human;
- profesionalizmi dhe perfeksionimin e pedagogëve, formatorëve dhe personelit;
- lëvizjen dhe këmbimin midis profesorëve universitarë për misionet e arsimimit në një kuptim të gjerë;
- mbledhjen sistematike dhe të rregullt të të dhënave mbi çështjet që kanë incidencë mbi cilësinë e arsimit dhe të nxënit;

Po kështu edhe institucionet e AL-së, me mbështetjen e administratave publike dhe të Bashkimit Evropian, duhet të ndihmojnë mësimdhënësit në zhvillimin e kompetencave të tyre në mësimdhënie, në aspektin e formave të reja që aplikohen për herë të parë si dhe të shfrytëzojnë mundësitë e ofruara nga përdorimi i teknologjive për të shfuqizuar cilësinë e formimit dhe të të nxënit.

d. Rritja e cilësisë së arsimit të lartë (AL) përmes ndërkombëtarizimit dhe globalizimit

Institucionet AL në vendet e BE-së duhet të zbatojnë strategjitë globale të ndërkombëtarizimit si pjesë integrale e misionit të tyre dhe të funksioneve të tyre të përgjithshme. Kjo, kërkon nxitjen dhe mbështetjen e lëvizjeve më të mëdha të studentëve dhe personelit akademik, theksimin e përmasës internacionale të programeve, një njohje e mjaftueshme e anglishtes dhe një gjuhë të huaj të dytë si dhe kompetenca ndërkulturore, zhvillimin e kurseve dhe diplomave ndërnacionale

dhe partneritetit ndërkombëtar. Pikërisht këto duhet të bëhen elementë të domosdoshëm të arsimit të lartë në Evropë dhe më tej.

Në këtë kuadër sugjerohet se BE-ja duhet të financojë funksionimin e një skademie evropiane të arsimit dhe formimit të drejtuar nga anëtarët pjesëmarrës dhe të frymëzuar nga praktikatat e mira që janë marrë në konsideratë nga analizat në raportin e ekspertëve.

Ndërkohë që shtetet anëtare të BE-së në kuadrin e partneritetit për “Fondet Strukturore” duhet të nxisin dhe të mbështesin nismat që çojnë në favorizimin e zhvillimit të kompetencave pedagogjike, konceptimit dhe vënies në jetë të programeve që u përgjigjen nevojave të shoqërisë dhe të tregut të punës si dhe përforcimit të partneritetit ndërmjet AL-së, ndërmarrjeve dhe sektorëve të kërkimit.

III. Sigurimi i cilësisë në AL shqiptar duhet bazuar në platformën evropiane të modernizimit

Platforma e modernizimit të arsimit në vendet e BE-së si dhe fuqizimi i cilësisë së Arsimit të Lartë në këtë proces mund dhe duhet të shërbejë si pikë orientimi për prapapunimin e ideve dhe detyrave imediate për arsimin e lartë në Shqipëri.

Rekomandimet e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë evropian për arsimin, janë një fushë e mirë reflektimi për politikatat e zhvillimit të AL-së në vendin tonë. Ato do t’ijapin një impuls më të fuqishëm administrimit të cilësive dhe njëherësh integrimin më të thellë të arsimit të lartë me prirjet dhe proceset evropiane të këtij arsimi.

Ne, mendojmë se disa fusha, disa orientime e objektiva që përmbahen në 16 rekomandime të Grupit të Ekspertëve duhet të jenë në vëmendjen e autoriteteve vendimarrëse në Shqipëri për strategjinë e zhvillimit të AL-së.

Së pari: Mbështetja më e mirë financiare e kualifikimit të personelit në shkollat e larta të vendit.

Sigurimi dhe fuqizimi i cilësisë do të thotë forcim dhe kualifikim intensiv i personelit mësimdhënës në arsimin e lartë. Aktualisht, në sistemin e AL-së në Shqipëri, janë rekrutuar një numër i madh specialistësh të rinj në procesin akademik mbasi ky i fundit ka patur emergjencë përballë zhvillimit të vrullshëm dhe galopant të numrit të studentëve në këtë sistem, zgjatjes të kohës së formimit në dy nivele, Bachelor dhe Master sipas adaptimit të sistemit evropian të Bolonjës. Mendoj se edhe aktualisht do të ketë një prurje të re mësimdhënësish në arsimin tonë të lartë. Garantimi i nivelit cilësor kërkon një kualifikim pedagogjiko-didaktik me objektiva e kompetenca të qarta në funksionet të përgatitjes dhe të nxënies tek studentët.

Së dyti: Orientimi i kualifikimit të bëhet mbi bazën e zhvillimit të kompetencave dhe formimit të shpirtit novator.

Përvoja arsimore e vendit dhe veçanërisht ajo e sistemit të Arsimit të Lartë pas viteve ‘90 ka evidentuar me forcë largimin nga disa forma të prapambetura tradicionale të formimit dhe të studiimit që bazoheshin në pranimin e një dijeje të

ngurtësuar si një produkt i gatshëm larg analizës dhe refleksionit, larg shpirtit kritik dhe krijues.

Rekomandimi evropian i fuqizimit të formimit të studentëve me zhvillimin e kompetencave dhe shpirtit novator është mjaft prioritar dhe për sistemin tonë arsimor universitar.

Realizimi i këtij objekti kërkon medoemos një nivel të lartë kualifikimi e profesionalizmi të stafëve akademike, një emancipim kulturor dhe zotërim të mjeshtërive moderne të procesit mësimor të të nxënës. Arritja e këtij objekti shënon dhe pikën e takimit të formimit akademik dhe misionit kërkimor në shkollat e larta. Si formimi i kapacitetit akademik, ashtu dhe zotërimi i kompetencave në kërkim, nuk mund të kuptohet pa kultivimin e një mendimi të gjallë, kritik, krijues dhe novator.

Çelësi i kësaj arritjeje është perfeksioni i vazhduar i stafëve akademike të Arsimit të Lartë në vendin tonë.

Së treti: Rekomandimet evropiane të grupit të ekspertëve për modernizimin e arsimit dhe të nxënës në kontinent sugjerojnë gjithashtu një kujdesje më të madhe për ndërkombëtarizimin e Arsimit të Lartë shqiptar.

Ndërkombëtarizimi duhet konsideruar jo vetëm si pjesë e strategjisë por, edhe si pjesë integrale e misionit të arsimit të lartë në Shqipëri. Kjo strategji do të ndikojë fuqishëm në lëvizjen e studentëve shqiptarë në hapësirën evropiane të Arsimit të Lartë, në përpunimin e programeve të studimit sipas dimensionit internacional, në shtimin e interesit për një njohje të mjaftueshme të anglishtes e gjuhëve të tjera të huaja dhe bashkë me to dhe kompetencën ndërkulturore. Po kështu, arsimi i lartë në Shqipëri duhet të nxisë edhe diplomat ndërnacionale në bashkëpunim me partnerët evropianë.

Futja e këtyre elementeve të domosdoshëm në arsimin tonë të lartë do të fuqizojë integrimin evropian e më tej, duke rritur mundësitë dhe shanset e të rinjve shqiptarë për t'u formuar në një hapësirë më të gjerë multikulturore dhe multinacionale.

Së katërti: Zhvillimi i cilësisë së AL-së në Shqipëri do të ndikohet shumë edhe nga dialogu që duhet të vendoset midis shkollave të larta, aktorëve të tjerë dhe tregut të punës.

Mendoj se edhe në vendin tonë ka një hapësirë shumë të gjerë diskutimi dhe refleksioni në këtë drejtim.

Rekomandimi 7 i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë Evropian për arsimin këmbëngul tek institucionalizimi i kësaj marrëdhënieje në mbarë Europën.

Në vendin tonë, universitetet duhet të konsiderojnë prioritare vendosjen e një praktike dialogu me aktorët e tjerë socialë dhe ekonomikë dhe veçanërisht me aktorët që përfshijn tregu i punës.

Ky dialog do të orientojë më mirë universitetet shqiptare në diskursin e kompetencave përgjatë formimit akademik, vizioneve të të mësuarit dhe përgatitjen profesionale jetësore të studentëve.

Nga ana tjetër, ky dialog mund të ridimensionojë edhe kërkimin shkencor në institucionet tona të arsimit të lartë duke i vendosur këto të fundit “më shumë me këmbë në tokë” në funksion të zgjidhjes së problematikave të kërkim-zhvillimit rajonal e më gjerë.

Ky dialog gjithashtu mund të institucionalizohet në Qendrat eEkselencave që janë organizuar dhe funksionojnë në përbërje të fakulteteve dhe universiteteve shqiptare.

Këto çështje që shtjelluam si një refleksion mbi rekomandimet për modernizimin e Arsimit të Lartë Evropian, mendojmë se qëndrojnë në themel të reformës për integrimin dhe evropianizimin e Arsimit të Lartë në vendin tonë dhe që mund të shërbejnë për një diskurs konstruktiv, lidhur me orientimet strategjike dhe vijimin e masave reformuese në Arsimin e Lartë (AL).

IV. Bibliografia

. Commission europeenne, Groupe d’experts de haut niveau: former les professeurs a l’enseignement, Bruxelles, le 18 juin 2013.

Pendavinji Gj. “How to deepen the knowledge in the proces of research at the stage of doctoralstudies” Semminar HERE, Exeperiences on Doctoral Studies, University “Alexander Xhuvani” Elbasan, 23 october 2011.

Pendavinji Gj. “Orientimi i FSHNH drejt fushave të kërkimit për zhvillimin rajonal” Konferencë shkencore rajonale e Universitetit “FanS. Noli” Korçë me temë: “Kërkimi shkencor në zhvillimin rajonal”, Korçë, 17. 11. 2012.

MARRËDHËNIET MES ETIKETIMIT NEGATIV TË NXËNËSVE NGA MËSUESIT DHE MOSHATARËT DHE SJELLJES DEVIJANTE TË NXËNËSVE NË KLASË

Stela Karaj

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i shkencave Sociale

Departamenti i Sociologjisë

Përmbledhje

Qëllimi i këtij studimi ishte të përcaktonte marrëdhënien që ekziston mes etiketimeve negative të bëra nga mësuesit dhe moshatarët dhe sjelljes devijante të nxënësve në klasësi dhe të përcaktonte përmasën e ndikimit të këtyre etiketimeve në sjelljen devijante të nxënësve. Kampioni i këtij studimi ishin 947 nxënës të klasave 7-12 të përzgjedhur në mënyrë rastësore në 7 rrethe të Shqipërisë. Instrumenti i përdorur ishte një pyetësor i strukturuar që përmbante një shkallë me 13 pohime për matjen e sjelljes devijante të nxënësve në klasë dhe 2 pohime për matjen e etiketimeve negative të mësuesve dhe moshatarëve. Koeficienti i besueshmërisë së shkallës për sjelljen devijante në klasë ishte 0.89.

Gjetjet e studimit evidentuan se ekzistojnë korelacione të moderuara pozitive mes etiketimeve negative dhe sjelljes devijante të nxënësve në klasë. Etiketimet negative të përdorura nga mësuesit janë një parashikues më i fortë i sjelljes devijante sesa etiketimet e bëra nga moshatarët.

Fjalët kyçe: *Etiketim negativ; etiketim informal; sjellja devijante e nxënësve në klasë*

Abstract

The purpose of this study was to determine the relationship between teacher and peer negative labeling and student classroom deviant behavior. The sample of this study was composed of 947 randomly selected students from grades 7-12. The instrument used was a structured questionnaire composed of a scale for measuring students' classroom deviant behaviour and two items for measuring teacher and peer negative labeling. The reliability coefficient of the scale composed of 13 items for measuring students' classroom deviant behaviour was 0.89.

The study findings indicated positive moderate correlations between teacher and peers negative labeling and student classroom deviant behaviour. Compared to peer negative labeling, teacher negative labeling is a stronger predictor of student classroom deviant behaviour.

Key words: *negative labeling, informal labeling; students' classroom deviant behavior*

Hyrje

Teoria e etiketimit përbën një alternativë të vecantë për shpjegimin e sjelljes devijante. Përgjatë viteve 1950 dhe 1960 idetë e Becker (1963), Lemert (1951) dhe Schur (1965) për efektet e etiketimit në sjelljen devijante mbizotëronin në literaturën kriminalogjike. Këta autorë ishin shumë popullorë në qarqet e drejtësisë kriminale dhe në qarqet sociologjike sepse ofronin një alternativë ndryshe në shpjegimin dhe trajtimin e sjelljes devijante. Ndikimi i teorisë së etiketimit u zbeh gjatë viteve 1980, por u rigjallërua gjatë dy dekadave të fundit përmes veprave të Matsueda (1992), Heimer dhe Matsueda (1994) dhe Chiricos, Barrick, Bales dhe Bontrage, (2007).

Për teorinë e etiketimit asnjë sjellje nuk është në thelbin e vet përhershmërisht devijante. Në vend të kësaj ajo e sheh sjelljen devijante të një individi në lidhje me mënyrën sesi njerëzit e tjerë përreth reagojnë ndaj kësaj sjelljeje. Nëse një individ thyen një rregull por kjo gjë nuk vihet re nga të tjerët, ose të tjerët nuk reagojnë negativisht (nuk etiketojnë si devijante) edhe kur e vënë re këtë sjellje, atëhere procesi mund të ngelet deri këtu dhe ky individ mund të mos përfshihet më tej në sjellje devijante. Por, nëse njerëzit përreth reagojnë negativisht (e etiketojnë si devijant individin që thyen rregullin), atëhere ky etiketim bën që individi të përfshihet në devijancë të metejshme. Ideja themelore e teorisë së etiketimit është se etiketimi i një individi si devijant e shtyn individin në devijancë të mëtejshme (Lemert, 1951).

Proseci i etiketimit shoqërohet me ndryshime si në nivelin e pritshmërisë dhe sjelljen e individit që etiketon, ashtu edhe në sjelljen e individit që etiketohet si devijant. Kur një grup njerëzish e etiketojnë dikë si devijant, presin që personi i etiketuar të sillet në një mënyrë të caktuar që është në përputhje me këtë etiketim. Më tej, të ndikuar nga kjo pritshmëri, njerëzit që kanë etiketuar individin si devijant, fillojnë të sillen ndryshe ndaj tij (e trajtojnë atë si devijant). Kjo bën që personi i etiketuar të përjetojë stigmë sociale (Goffman, 1963) dhe ulje të vetëvlerësimit (MacMillan, Jones, and Aloia, 1974; Ray dhe Downs, 1986). Si pasojë e gjithë këtyre, personi i etiketuar e kategorizon veten ashtu si e kanë kategorizuar të tjerët dhe vepron në përputhje me pritshmëritë e të tjerëve (Stryker, 1959). Kjo bën që personi i etiketuar të bëhet ajo që nënkupton etiketimi. Në këtë mënyrë personi i etiketuar përfshihet në një process që shpie në vetëpërmbytjen e profesisë (etiketimit) të njerëzve të tjerë. (Rubington dhe Weinberg, 2008).

Në fushën e kriminalogjisë janë kryer shumë studime lidhur me efektin e etiketimeve negative zyrtare në delinkuencën rinore. Shumica e studimeve kanë konstatuar se etiketimet kanë një efekt të moderuar ose të fortë në përfshirjen e individit në sjelljen devijante ose në krim. (Maddan dhe Marshall, 2009). Ndërkohë, studimet lidhur me efektet e etiketimeve negative të mësuesve në sjelljen devijante të nxënësve adoleshentë në shkolla janë të rralla. Në Shqipëri kjo fushë është plotësisht e pa studiuar. Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë marrëdhënin që ekziston mes etiketimeve negative të bëra nga mësuesit dhe moshatarët dhe sjelljes

devijante në klasë të nxënësve adoleshentë në Shqipëri. Po ashtu, ky studim synon të përcaktojë përmasën e ndikimit të këtyre etiketimeve në sjelljen devijante të nxënësve në klasë.

Shqyrtimi i literaturës

Në kuptimin sociologjik “etiketimi është atribuimi i një statusi një personi” (Schur, 1969, f. 15). Sipas Persuin, (1994, f. 83) etiketimi është "atashimi i një emri devijant ndaj disa veprimeve ose atributi (atributeve) të një individi”

Etiketimi mund të jetë zyrtar (formal) dhe jo zyrtar (informal)). (Whyte, 1955; Berger, 1963). Po ashtu, etiketimi mund të jetë pozitiv ose negativ (Rosenthal and Jacobson 1968). Termat etiketim negativ, pozitiv, etiketim zyrtar (formal) dhe jo zyrtar (informal) përdoren në variantin e zgjeruar të teorisë së etiketimit (Schur, 1969).

Etiketimet zyrtare bëhen nga zyrtarë të sistemit të drejtësisë kriminale për sjelljet e individëve (Triplett & Jarjoura, 1994). Këta zyrtarë kanë autoritetin që të etiketojnë zyrtarisht një individ si devijant (Bontrager, Bales, & Chiricos, 2005). Ndërkohë, etiketimet jozyrtare (informale) përkufizohen si “një përpjekje për të karakterizuar një person si një tip të caktuar (të tillë si p.sh., “një nxënës i mirë” ose një “nxënës i pasjellshëm” nga personat që nuk veprojnë si agjentë zyrtarë të agjensive zyrtare të kontrollit social, dhe në situata sociale që nuk janë “ceremoni” zyrtare të kontrollit social” (Paternoster dhe Triplett, 1988, f. 597). Prindërit janë burimi i parë i etiketimeve jozyrtare (Ray dhe Downs, 1986).

Etiketimet ka më shumë të ngjarë që të pranohen nga njerëzit e tjerë nëse etiketimin e bën një person tjetër i një rangu të lartë. Etiketimet negative pranohen më lehtë se ato positive (Rubington dhe Weinberg, 2008)

Për përkufizimin e devijancës ka dy perspektiva madhore: perspektiva normative dhe perspektiva relativiste ose situacionale. Sipas perspektivës normative devijanca është "çdo mendim, ndjenjë ose veprim që anëtarët e një grupi social e gjykojnë si dicka që ka theyr normat ose rregullat e këtij grupi" (Douglas dhe Waksler, 1982, f. 10). Maconis dhe Geber (2010) vënë në dukje se sjellja devijante ka të bëjë si me shkeljen e normave sociale të përcaktuar zyrtarisht (p.sh, në mënyrë ligjore) ashtu edhe me shkeljen e normave sociale informale (p.sh moszbatimin e zakoneve).

Sipas perspektivës relativiste ose situacionale nuk ekzistojnë veprime ose sjellje që janë në thelbin e tyre përhershëmrisht devijante. Devijanca është rezultat i ndërveprimeve mes njerëzve në shoqëri. Në këtë përkrahje, siç kemi theksuar më sipër, ka shumë rëndësi fakti sesi reagojnë njerëzit e tjerë ndaj një veprimi apo sjelljes së një individi. Sipas kësaj perspektive, një akt bëhet devijant kur emërtohet si devijant nga një grup i caktuar social. Në mënyrë mjaft të qartë e shpreh këtë gjë një nga përfaqësuesit më të fuqishëm të teorisë së etiketimit:

“Grupet sociale krijojnë devijancën duke aplikuar rregulla ndaj njerëzve të veçantë dhe duke i etiketuar ata si të huaj. Nga ky këndvështrim, devijanca nuk është një cilësi e aktit që kryen personi, por një pasojë e aplikimit nga të tjerët të rregullave dhe sanksioneve ndaj një personi që i shkel ato. Devijant është një person ndaj të

cilit është aplikuar në mënyrë të suksesshme kjo etiketë; sjellja devijante është sjellja që njerëzit e etiketojnë si devijante” (Becker, 1963, f. 9)

Dy perspektivat për përkufizimin e devijancës mund të shihen si plotësuese të njëra tjetrës .Pa ekzistencën e normave sociale nuk mund të ketë një bazë për të reaguar ndaj devijancës.Nga ana tjetër, reagimi social ndaj shkeljes së normave vë në dukje ekzistencën e normave dhe identifikon devijancën. Duke patur parasysh këtë gjë, jepet një përkufizim më i plotë që përfshin thelbin e dy perspektivave për devijancën që do të përdoret në këtë studim:

“Devijanca është shmangja nga normat që shkakton (ngjall) një mosaprovim social të tillë saqë variacione të ndryshme të tij shkaktojnë ose ka të ngjarë që të shkaktojnë, nëse pikasen, sanksione negative” (Clinard dhe Meier, 2011, f.7).

Në studime të hershme, por edhe në studime bashkëkohore (Lopes, Krohn, Lizotte, Schmidt, Vasquez, dhe Bernburg, 2012; Overall dhe Quinn, 2010; Chiricos, Barrick, Bales dhe Bontrage, 2007) është konstatuar se etiketimi zyrtar në institucionet e drejtësisë kriminale ndikon në mënyrë të rëndësishme në të ardhmen kriminale të atyre që janë etiketuar.

Studimi i Chassin, Presson, Young dhe Light (1981) lidhur me efektin e etiketimeve në konceptin për veten të adoleshentëve hapi rrugën për studimin e etiketimeve informale. Megjithatë, etiketimet informale në fushën e kriminalogjisë u studiuan në mënyrë të thellë vetëm pas vitit 1992 në studimin e Matsueda (1992) që kishte në fokus të tij lidhjet mes etiketimeve të prindërve dhe delinkuencës rinore. Në këtë studim, u arrit në përfundimin se etiketimet informale të bëra prej prindërve kanë një ndikim të fuqishëm në delinkuencën rinore (Matsueda, 1992).Studime të tjera (Triplett dhe Jarjoura, 1994; Liu, 2000) kanë evidentuar, po ashtu, se etiketimet prindërore kanë një korelacion pozitiv me devijancën e adoleshentëve.

Një sërë studimesh të kryera në institucionet e edukimit i japin mbështetje empirike teorisë së etiketimit.Sipas Rist (1977) etiketimet që i bëhen nxënësve nga mësuesit si p.sh.“ i ngadalte” “i shkëlqyer”, “ i padisiplinuar,” ose “i vështirë” përmbajnë brenda tyre një varg pritshmëriash të cilat, nëse u bëhen të ditura nxënësve, mund të shpien në një vetëpërmbushje të profecisë (nxënësit, në të fundit, veprojnë në atë mënyrë që nënkupton etiketimi i mësuesve).Sipas Schultz (1983) pritshmëritë që kanë mësuesit për nxënësit ndikojnë në mënyrën sesi mësuesit ndërveprojnë me nxënësit e tyre dhe kjo bën që sjellja e nxënësve të ndryshojë në përputhje me pritshmëritë fillestare të mësuesve.Cheung (1993) konstatoi se mes etiketimeve negative të mësuesve dhe sjelljes devijante të nxënësve në shkollë ekziston një korelacion pozitiv i vlefshëm nga pikëpamja statistikore.Lilly, Cully, dhe Ball (2007) evidentojnë se etiketimi akademik negativ i nxënësve shpie në përkeqësimin e performancës së tyre akademike (vetëpërmbushja e profecisë së mësuesve). Link & Phelan, (2001) vendos një paralele mes etiketimit negativ të nxënësve si p.sh., “të këqinj”, “të pasjellshëm” dhe etiketimit që i bëhet një personi si kriminel. Pasojat, sipas tij, janë të ngjashme sepse në të dy rastet sjellja e personave të etiketuar ndryshon në përputhje me etiketimin.

Metodologjia

Kampioni

Popullata e këtij studimi ishin nxënësit adoleshentë të klasave 7 -12 në Shqipëri. Prej kësaj popullate u përzgjedhën në mënyrë të thjeshtë rastësore 947 nxënës. 50.3% e nxënësve ishin të klasës 7-9 dhe 49.7% të klasës 10-12. Përbërja gjinore e kampionit ishte 42% meshkuj dhe 58% femra. Fillimisht, u përzgjedhën në mënyrë rastësore 7 rrethe nga lista e të gjithë rretheve të vendit. Më pas, në secilin rreth u përzgjedhën në mënyrë rastësore 12 shkolla nëntëvjeçare dhe të mesme. Më në secilën prej këtyre shkollave u përzgjedhën rastësisht 30 klasa të nivelit 7-12. Më pas, u intervistuan të gjithë nxënësit në përbërje të secilës klasë. Plotësimi i pyetësorit u bë në mjedisin e shkollës pa praninë e intervistuesve.

Duke patur parasysh faktin se është homogjen për nga karakteristikat e tij, ky kampion siguron një gabim standard prej $\pm 3\%$ (Yamane, 1967)

Instrumentat

Në planin konceptual variabli i varur që është përdorur në këtë studim (*sjellja devijante e nxënësve në klasë*) nënkupton thyerjen e rregullave të vendosura në klasë që lidhen me krijimin e mjedisit të përshtatshëm funksional për organizimin e mësimin. Për të matur sjelljen devijante të nxënësve në klasë është përdorur një instrument (shkallë) i përbërë nga 13 pohime që shprehin lloje të ndryshme të thyerjes së rregullave më tipike në klasë gjatë zhvillimit të mësimin. Nxënësve ju kërkua të vetëraportonin frekuencën e thyrjeve prej tyre të rregullave në klasë në një rend që shkonte nga 1 (asnjëherë) deri te 4 (gjithmonë). Pohimet që janë përdorur janë si më poshtë:

1. Merr gjatë mësimin në klasë gjërat që nuk të takojnë ty (që nuk janë të tua)
2. Dëmton gjërat e shkollës me qëllim
3. Zihesh me dikë tjetër (nxënësit në shkollë)
4. Përdor fjalë të rënda/flet me gjuhë të papërshtatshme në klasë
5. Harron të sjellësh me vete detyrat e shtëpisë/ librat në shkollë
6. Nuk bën një detyrë në klasë që të kë dhënë mësuesi/siç të ka udhëzuar mësuesi
7. Flet me të tjerët në kohën që mësuesi shpjegon mësimin
8. Loz me të tjerët në kohën që mësuesi shpjegon mësimin
9. Zihesh me mësuesin/nuk tregon respekt për të
10. Vjen vonë në shkollë
11. Mungon nga shkolla pa leje
12. Flet në kohën që është duke folur një nxënës tjetër
13. Përdor celularin (ose I- podin, MP3, etj) në kohën që në klasë bëhet mësim

Analiza faktoriale e kyer konfirmoi një dimensionalitetin e kësaj shkalle. Për të vlerësuar konsistencën e brendshme të shkallës u përdor koeficienti Alfa i Cronbach-ut (Cronbach, 1951). Kjo shkallë rezultoi të ketë një nivel të lartë besueshmërie ($\alpha=.89$). Siç shihetky koeficient është dukshëm më lart se niveli i pranuar i besueshmërisë. ($\geq .7$). Rezultatet e mundshme të kësaj shkalle varianonin nga 13

(Mungesë sjelljeje devijante në klasë) deri 42 (Nivel i lartë i sjelljes devijante në klasë).Sa më i lartë rezultati, aq më i lartë niveli i sjelljes devijante në klasë.

Dy variablat e pavarur në këtë studim janë etiketimi negativ i nxënësve prej mësuesve dhe etiketimi negativ i nxënësve prej moshatarëve. Këto variabla u matën me pohimet: "Në përgjithësi, çfarë mendimi kanë mësuesit për disiplinën tënde në klasë? Mendojnë se je një nxënës: 1. *Plotësisht i disiplinuar*; 2. *Me ndonjë mangësi në disiplinë*; 3. *Nuk di çtë them*; 4. *Me disa mangësi në disiplinë dhe* 5. *Me shumë mangësi në disiplinë*.Një pohim identik me këtë u përdor për të matur etiketimin e nxënësve nga moshatarët. Rezultatet e përfituara nga kjo pyetje variojnë nga 1 (mungesë e etiketimit negativ) deri në 5 (niveli maksimal i etiketimit negativ)

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat për këtë studim u mbledhën në vitin shkollor 2012-2013.Të dhënat u përpunuan me anë të SPSS. Për të përcaktuar drejtimin dhe forcën e marrëdhënies mes etiketimit negativ të mësuesve dhe moshatarëve dhe sjelljes devijante të nxënësve në klasë u përdor testi i korelacionit i Pearson-it. Përshkrimi i koeficientëve të korelacionit u bë duke u bazuar te deskriptorët e Davis (1971). Për të përcaktuar përmasën endikimit të të dy variablave të pavarur në studimi (etiketimet negative të nxënësve dhe mësuesve) në sjelljen devijante të nxënësve në klasë, u përdor regresioni linear. Analizat treguan se të dhënat i plotësonin kushtet për të përdorur regresionin (marrëdhëniet mes variablave janë lineare dhe ekzaminimi i grafikëve të rezidualeve evidenton se shpërndarja e rezidualeve është normale dhe varianca homogjene).

Në këtë studim janë raportuar vetëm gjetjet që janë brenda kufirit të vlefshmërisë statistikore ($p < 0.05$)

Rezultatet

Para kryerjes së analizaës statistikore u verifikua plotësimi i parakushtit për homogjenitetin e variancës dhe shpërndarjen normale të variablave në studim. Testet për shpërndarjen normale dhe homogjenitetin e variancës konfirmuan se të dhënat i plotësonin këto kushte dhe ishin të përshtatshme për përdorimin e testeve parametrike.

Drejtimi dhe fortësia e marrëdhënies mes etiketimeve negative të bëra nga mësuesit dhe nga moshatarët dhe sjelljes devijante të nxënësve në klasë u invetsigua duke përdorur koeficientët e korelacionit të Pearson-it. Nga të dhënat e Tabelës 1, evidentohet se ka një marrëdhënie pozitive të moderuar dhe statistikisht domethënëse mes etiketimeve negative të bëra prej mësuesve dhe sjelljes devijante të nxënësve.($r = .45$, $p < 0.01$). Po ashtu, koeficienti i korelacionit mes etiketimeve negative të bëra nga moshatarët është pozitiv,i moderuar dhe domethënës nga pikëpamja statistikore.($r = .35$, $p < 0.01$).

Tabela 1. Korelacionet e Pearson-it mes etiketimeve negative të bërë prej mësuesve dhe moshatarëve dhe sjelljes devijante të nxënësve në klasë	
Sjellja devijante e nxënësve në klasë	
Etiketimet negative prej mësuesve	.43**
Etiketimet negative prej moshatarëve	.35**
**. Korelacion është i vlefshëm statistikiht në nivelin 0.01 (2-tailed).	

Për të përcaktuar përmasën e parashikimit të sjelljes devijante të nxënësve në klasë nga variablat e pavarur (etiketimet negative nga mësuesit dhe etiketimet negative nga nxënësit) u krye analiza e regresionit të shumëfishtë standart me metodën e futjes së njëkohshme të variablave. Rezultatet tregojnë se të dy variablat e pavarur shpjegojnë në mënyrë të vlefshme nga pikëpamja statistikore variacionet në variablin e varur: etiketimet negative të bëra nga mësuesit ($\beta=.322$, $p<.001$) dhe etiketimet negative të bëra nga moshatarët ($\beta=.203$, $p<.001$). Siç shihet, etiketimet negative të bëra nga mësuesit janë një parashikues më i mirë sepse ky variabël shpjegon mbi 30% të variancës në variablin e varur (sjelljes devijante të nxënësve në klasë). (Shih Tabelën 2)

Tabela 2. Parashikimi i sjelljes problematike të nxënësve në klasë nga etiketimet negative të mësuesve dhe etiketimet negative të moshatarëve.					
R	R ²	R ² e përshtatur	Gabimi standart i vlerësimit	F	Sig.
.454 ^a	.206	.205	5.28886	10 8.0 85	.000 ^a
	Koeficientët pastandardizuar		Koeficientët e standartizuar		
	B	Gabimi standart	Beta	t	<i>Sig.(Vler a e p)</i>
(Konstant)	8.422	1.180		34. 60 7	.000

1. Etiketimet negative të bëra nga mësuesit	2.306	.031	.322	9.219	.000
2. Etiketimet negative të bëra nga moshatarët.	1.376	.237	.203	5.802	.000
a. Variabli i varur: sjellja devijante e nxënësve në klasë					

Diskutime dhe konkluzione

Ky studim konfirmoi se ekziston një korelacion i moderuar pozitiv mes etiketimeve negative të bëra nga mësuesit dhe moshatarët dhe sjelljes devijante të nxënësve në klasë. Etiketimet negative të bëra nga mësuesit rezultojnë të jenë një parashikues më i mirë i sjelljes devijante të nxënësve në klasë. Megjithatë, edhe pse në një një përmasë më të vogël, etiketimet negative të bëra nga moshatarët janë një parashikues statistikiqsiht i vlefshëm i kësaj sjelljeje. Këto gjetje i japin një mbështetje empirike premisë themelore të teorisë së etiketimit që thekson se etiketimet negative rrisin përfshirjen e individit në sjellje devijante. Këto gjetje janë në përputhe me gjetjet e studimeve të tjera të kryera në fushën e edukimit (Cheung, 1993; Rist, 1977; Link & Phelan, 2001; Lilly, Cully, dhe Ball, 2007).

Gjetjet e këtij studimi përcaktojnë nevojën e kryerjes së studimeve në lidhje me frekuencën e përdorimit, sidomos nga mësuesit, të etiketimeve negative ndaj nxënësve në klasë. Kryerja e trajnimeve me mësuesit për vetëdijësimin e tyre lidhur me efektet potenciale negative të etiketimeve në sjelljen dhe performancën akademike të nxënësve në shkollë do të ndihmonte dukshëm në minimizimin e pasojave në zhvillimin e përgjithshëm dhe mirëqënien e nxënësve.

Bibliografia

- Becker, H. (1963) *Outsiders: Studies in the Sociology of Deviance*. (New York: The Free Press)
- Berger, P.L. (1963) *Invitation to sociology*: Garden City, New York: Doubleday.
- Bontrager, S., Bales, W., & Chiricos, T. (2005). Race, Ethnicity, Threat and the Labeling of Chiricos, T., Barrick, K., Bales, W., & Bontrager, S. (2007). The Labeling of Convicted Felons. *Criminology*, 43(3), 589-622.
- Chassin, L., Presson, C. C., Young, R. D., & Light, R. (1981). Self-Concepts of Institutionalized Adolescents: A Framework for Conceptualizing Labeling Effects. *Journal of Abnormal psychology*, 90, 143-151.
- Cheung, Y.W. (1993) Predicting Adolescent Deviant behavior in Hong Kong: a Comparison of Media, Family, School, and Peer Variables. Hong Kong Institute of Asia-Pacific Studies, The Chinese University of Hong Kong.

- Chiricos, T., Barrick, K., Bales, W., & Bontrager, S. (2007). The Labeling of Convicted Felons and Its Consequences For Recidivism. *Criminology*, 45, 547-581.
- Clinard, B.M., & Meier, F.R (2011) Sociology of Deviant Behaviour, Wadsworth, Cengage Learning.
- Cronbach, L. J. (1951). Coefficient alpha and the internal structure of tests. *Psychometrics*, 16(3), 297-334.
- Davis, J. A. (1971). *Elementary survey analysis*. Englewood Cliffs, NJ: Prentice Hall.
- Douglas, J. D. and Waksler, F. C. (1982) The Sociology of Deviance. Boston: Little, Brown and Company.
- Heimer, K., & Matsueda, R. L. (1994). Role-Taking, Role Commitment, and Delinquency: A Theory of Differential Social Control. *American Sociological Review*, 59(3), 365-390.
- Lemert, E. M. 1951. Social Pathology. New York: Mcgraw-Hill
- Lilly, J., Cully, F., & Ball, R. (2007). *Context & consequences*. Sage Publications
- Link, B. & Phelan, J. (2001). Conceptualizing stigma. *Annual Review of Sociology*, 27, 368-375.
- Liu, X. (2000). The conditional effect of peer groups on the relationship between parental labeling and youth delinquency. *Sociological Perspectives*, 43, 499-514.
- Lopes, G., Krohn, M. D., Lizotte, A. J., Schmidt, N. M., Vasquez, B. E., & Bernburg, J. G. (2012). Labeling and Cumulative Disadvantage: The Impact of Formal Police Intervention on Life Chances and Crime During Emerging Adulthood. *Crime & Delinquency*, 58(3), 456-488.
- Maconis, J. J & Gerber, L. (2010). Sociology 7th Canadian Ed. Toronto, Ontario: Pearson Canada Inc.
- MacMillan, D., Jones, R., and Aloia, G. The mentally retarded label: A theoretical analysis and review of research. *American Journal of Mental Deficiency* (1974) 79
- Matsueda, R. L. (1992). Reflected Appraisals, Parental Labeling, and Delinquency: Specifying a Symbolic Interactionist Theory. *American Journal of Sociology*, 97(6), 1577-1611.
- Paternoster, R., & Triplett, R. A. (1988) Disaggregating self-reported delinquency and its implications for theory. *Criminology*, 26, 591-625
- Perusin, A. (1994). Labelling: A dilemma or solution? *B.C Journal of Special Education*, 21 (3), 81- 87
- Quinn, S. T. (2010). The Gang Member Label and Juvenile Justice Decision-Making. *Electronic Theses, Treatises, and Dissertations*, Paper 2245, 1-154.
- Whyte, W.F. (1955) *Street Corner Society*. Chicago, Illinois: The University of Chicago Press and Its Consequences For Recidivism. *Criminology*, 45, 547-581.

- Ray, M. C., & Downs, W. R. (1986). An Empirical Test of Labeling Theory Using Longitudinal Data. *Journal of Research in Crime and Delinquency*, 23, 169-194.
- Rist, R. C. (1977) "On Understanding the Processes of Schooling: The Contributions of Labeling Theory." Exploring Education 2nd Ed. Allyn & Bacon, 2001: 149-15
- Rosenthal, R. (2002). Covert communications in classrooms, clinics, courtrooms, and cubicles. *American Psychologist*, 57(11), 839-849.
- Rubington, E., Weinberg, M. (2008) Deviance. The Interactionist Perspective, Tenth Edition, Pearson
- Schultz, R. (1983). Sociopsychological climates and teacher-bias expectancy: A possible mediating mechanism. *Journal of Educational Psychology*, 76. 167-168
- Schur, E. M. (1965). *Crime Without Victims*. Neë Jersey: Prentice-Hall.
- Schur, E.M. (1969) Our Criminal Society. Englewood Cliffs, New Jersey: Prentice-Hall.
- Schur, E.M. (1969) Reactions to deviance. *American Journal of Sociology*, 75, 309-322
- Triplett, R. A., & Jarjoura, G. R. (1994). Theoretical and empirical specifications of a model of informal labeling. *Journal of Quantitative Criminology*, 10, 241-276
- Yamane, T. (1967) Statistics: An introductory analysis, 2nd Ed., New York: Harper and Row

PSIKOLOGJI,PEDAGOGJI

“REAGIMET E NËNAVE, PAS KOMUNIKIMIT TË DIAGNOZËS NGA MJEKU, PËR FËMIJËT E TYRE ME SINDROMË DAUN (DOWN)”

Dr. Artemisa SHEHU (DONO), Ma. Jonida UCAJ (PONARI)

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë

Përmbledhje

Ky studim ka dokumentuar përvojat e nënave, të fëmijve me Sindromë Daun, në Tiranë, për të parë nëse ndikon në shtimin e reagimeve negative të nënave, komunikimi i papërshtatshëm i diagnozës, nga ana e mjekve.

Për të realizuar këtë studim janë intervistuar 6 nëna që kanë fëmijë me sindromën daun. Janë përdorur pyetje të kombinuara, të hapura dhe të mbyllura, duke analizuar secilën përgjigje veçmas në mënyrë manuale.

Rezultatet treguan se të gjithë nënat të cilat kanë marrë lajmin *në mënyrë të papërshtatshme* se fëmija i tyre është i prekur nga kjo sindromë, *kanë patur shtim të reagimeve negative*.

Studimi gjithashtu tregon për fenomene që ndodhin në shoqërinë shqiptare, si “*stigmatizimi i këtyre fëmijëve*” të cilat kanë nevojë të bëhen publike që të arrihet sensibilizimi.

Konkluzionet e studimet tregojnë se nënat u drejtohen mjekëve që të përmirësojnë mënyrën se si tregohet diagnoza. Ato kanë dhënë sygjërimet e tyre në lidhje me këtë drejtim.

Fjalët çelës: reagimet e nënave, sindromi daun, diagnozë, paragjykim, komunikim efektiv.

Abstract

This study has documented the experiences of mothers of children with Down syndrome, in “*Jonathan center*” in Tirana, to see if it affects the growth of the negative reactions of mothers, inadequate communication of the diagnosis by the doctors.

To realize this study were interviewed six mothers who have children with Down syndrome. Questions are combined using, open and closed, by analyzing each separately to answer manually.

Results showed that all mothers who have improperly news that their child is affected by this syndrome had increased adverse reactions.

The study also emphasizes the phenomena that occur in Albanian society, as “*stigmatization of these children*” that need to be taken to achieve public awareness.

The conclusions of this study show that mothers suggest that doctors have to improve their communication manner of informing parents about their’s child diagnosis with Down syndrome. The study has given its suggestions regarding this.

Key words: emotional reactions, down syndrome, diagnosis, prejudice, effective communication.

Hyrje

Çështja kryesore e këtij studimi është të dokumentojë reagimet e disa prej nënave shqiptare, që kanë fëmijë me Sindromën Daun, pasi u është komunikuar diagnoza nga mjeku i lindjes.

Rëndësia akademike konsiston te zbulimi nëse ka korelacion pozitiv midis faktit se diagnoza e thënë në mënyrë të papërshtatshme nga mjeku shton reagimet negative të nënave, *reagime të cilat nga ana e tyre nuk përmirësojnë situatën ku ndodhen fëmijët e tyre*. Studimi tregon se në shoqërinë shqiptare ka një dozë të lartë paragjykimi apo stigmatizimi të fëmijve me Sindromën Daun. Ky studim është mbështetur në një literaturë të mjaftueshme, ku studime të tjera në këtë fushë kanë treguar se nënat në momentin që kanë marrë vesh diagnozën kanë reaguar shumë keq, e këto reagime janë shtuar kur mjeku ua ka komunikuar këtë të fundit me indiferencë, pa mëshirë, apo ftohtë (në 1976, studim i *Pueschel dhe Murphy*, në 1983, studim i *Murdoch*, Skoci, në 2004, studim i *Skotko and Canal*, në Spanjë). Deri më tani për sa i përket vendit tonë ka boshllëqe në literaturë, ndaj ky studim ka si qëllim t'i përmbushë ato.

Sindromi Daun është anomali kromozomale që shkaktohet në 1 foshnjë në 1000 lindje. Studimet kanë vënë re një rritje të probabilitetit për të lindur fëmijë me sindromën daun te nënat në moshën mbi 35 vjeç. Për disa arsye të paspjegueshme, gabimi në zhvillimin e qelizave rezulton me 47 kromozome, më tepër se zakonisht me 46, dhe materiali i gjenit shtesë ndërron lehtë renditjen e zhvillimit të trupit dhe trurit .

Sindroma Daun është një nga kushtet e pakta të shoqëruara me paaftësi intelektuale ku diagnoza vendoset direkt pas lindjes. Forma të tjera të njohjes se fëmija e tyre ka këtë sindromë, ndodh kur prindrit shikojnë se fëmija e tyre nuk po zhvillohet gjatë viteve të fëmijërisë.

Sindroma Daun mori emrin sipas Dr. John, i cili e përshkroi për herë të parë sindromën (Organizata Down Syndrome Kosova “*Mëso për mua*”) për prindër, institucione vendimarrëse, profesionist dhe kujdestar (Raport vjetor. Sindroma Down).

Studimet kanë vënë re se fëmijët me DS (Sindromën Daun) më shumë duken si familjarët e tyre se sa si të tjerët. Por disa nga këto karakteristika të përbashkëta janë: sy të bukur në formë bajame, që të bien në sy menjëherë, një rrudhë e vetme e pëllëmbës në njërën apo te të dy duart, tipare të vogla të fytyrës, inteligjencë sociale e veçantë, nivel të lartë të defekteve të lindura në zemër (35 deri në 50%) .

Në periudhën e shtatzënësisë çdo nënë imagjionon sesi do të jetë fëmija i saj. Ajo ëndrron për të, se si do jetë ai, dhe e pret me padurim momentin e ardhjes në jetë. Nënat e fëmijëve me Sindromën Daun kanë reagime të tjera lidhur me momentin e paslindjes, siç tregon dhe literatura. Periudha menjëherë pas lindjes së bebes është kohë e vështirë për të dhënë një lajm të tillë. Nëna nuk është e fuqishme, fizikisht ose emocionalisht, ndaj ditët e para janë më të vështirat. Shumica e prindërve

reagojnë shokueshëm kur marrin vesh se fëmija i porsalindur ka Sindromën Daun. Prindrit përdorin fjalë si “të shkatërruar”, “shkretuar”, dhe “shokuar”, për të përshkruar reagimet e tyre. Disa ndiehen sikur po humbasin mendjen, të tjerë sikur bota po i përmbysët.

Literatura tregon disa reagime më kryesore të nënave kur kanë marrë informacionin se fëmija i tyre ka këtë sindromë. Reagimet janë të ndryshme, por sidoqoftë ato kanë përvoja me emocione konfliktuale. Përjetimi më i shpeshtë është shoku emocional. Disa nënave pasi u është komunikuar diagnoza, janë si të “ngrirë”. Ekperincat e shokut ndiehen fizikisht, duke ndiere veten të djersitet, ndjenjë të vjelli ose një dëshirë të madhe për t’u larguar.

Një eksperiencë tjetër është edhe ndjenja e mosbesimit. Kur dikush konfrontohet me lajme jo pozitive, një nga mekanizmat mbrojtës që ai përdor, është *mohimi*. Kështu, prindi ndien se fëmija është normal dhe se doktori po bën një gabim.

Një tjetër simptomë është ndjenja e pikëllimit. Kur i komunikohet se fëmija e saj është prekur nga DS, nëna është pikëlluar. Nënata zakonisht shpërthejnë në lot. Ky reagim mund të jetë edhe pozitiv, pasi lejon dhembjen të gjejë hapësira për t’u shprehur.

Ndjenjat e mbrojtjes janë një tjetër reagim i nënës pas marrjes së lajmit. Edhe kjo ndjenjë është një përgjigjie instiktive. Edhe pse është një ndjenjë normale dhe e shëndetshme, kjo duhet reduktuar sepse e bën fëmijën të pazotin për të zhvilluar aftësitë që ai ka. Kjo ndikon thellë edhe në dinamikën familjare. Reagime të tjera siç tregon dhe literatura, janë edhe ndjenja e zmbropsjes, shqetësim, zemërim, apo faj.

Shumica e nënave me fëmijë me DS (Sindromën Daun) nuk e dinë diagnozën e fëmijve të tyre deri pas lindjes së fëmijës. Edhe pse tani testi prenatal lejon mjekët të bëjnë një diagnozë të caktuar më herët se java e 8-të e shtatzënisë, këto mjete nuk ofrohen te gratë nëse nuk janë mbi 35 vjeç. Ndërkohë studime të tjera tregojnë se një kategori nënash të tjera, e refuzojnë testin përçtues prenatal për arsye personale apo fetare.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës një në çdo 800 apo 1000 lindje përfshin një fëmijë me DS, të cilat 87.5 % e marrin vesh diagnozën e fëmijës pas lindjes dhe në Angli një foshnje me DS në 1000 lindje ku dhe këtu, diagnoza merret vesh pas lindjes së fëmijës.

Tre studime më të spikatura deri më tani do të paraqiten me vlerësime bazuar në të dhënat e mbi 100 nënave të fëmijve me DS.

Në 1976, Pueschel dhe Murphy analizuan përgjigjet e 414 nënave të fëmijve me DS me një pyetësorë të përbërë nga 8 pyetje. 40% e të anketuarëve u përgjigjen se e kanë marrë lajmin nga doktorët të cilët kanë diagnostikuar fëmijën e tyre me DS. në mënyrë të papërshtatshme, të papritur, e në mënyrë mospërfillëse.

Në 1983, Murdoch analizoi përgjigjet e 123 nënave të fëmijve me DS në Skoci me një sondazh prej 9 pyetjesh, ku 36% e të anketuarëve u përgjigjen se mjekët e tyre nuk bënë një punë të mirë gjatë përcjelljes së diagnozës. Pjesës më të madhe u ishte thënë diagnoza pa praninë e bashkëshortëve të tyre, dhe pak më tepër se çereku i nënave raportuan se atyre nuk i ishte dhënë mundësia për të pyetur më tepër rreth

fëmijës së tyre apo që të shprehnin ndjenjat e tyre gjatë kohës që u komunikohet diagnoza.

Në 2004, Skotko and Canal studiuar me të dhëna cilësore dhe sasiore për 467 nëna të fëmijëve me DS në Spanjë. Nën raportuan se ndieshin ankthioze, të friksuara, me faj dhe të nevrikosura e zemëruara, pasi mësuan rreth diagnozës së fëmijëve të tyre. Pjesa me e madhe e nënave fuqishëm nuk ranë dakord me idenë se doktorët e tyre i kishin informuar mjaftueshëm deri në datën e dhënies së diagnozës për DS, apo ato i kishin dhënë numra telefoni të papërshtatshëm të prindërve, të cilët kishin fëmijë në të tilla kushte ku ato ndodheshin.

Sondazhet kanë mbledhur përgjigje që nga 1972 deri më tani, por një analizë e gjatë e dhënës me rezultate të kthjellta, ka treguar se shumë pak gjërat kanë ndryshuar, duke qenë se frustracioni i nënave dhe pakënaqësia nuk kanë ndryshuar.

Materiale dhe metoda

Problemet kërkimore dhe hipotezat

1.Studimin e marrëdhënies “mes komunikimit të diagnozës në mënyrë të papërshtatshme nga mjeku direkt pas lindjes së fëmijës me Sindromën Daun dhe reagimeve negative të nënave kur marrin lajmin mbi diagnozën.

2. Gjithashtu në këtë studim kërkohet të dihet, nëse reagimet negative të nënave janë të njëjta si të nënave të tjera në studime të ngjashme, apo nënat shqiptare kanë ndonjë element tjetër për t’u shënuar.

Hipoteza 1. Komunikimi në mënyrë të papërshtatshme të diagnozës së fëmijës me Sindromë Daun nga mjeku, sjell dhe rrit reagimet negative të nënave.

Hipoteza 2. Nën e fëmijëve me Sindromë Daun kanë të gjitha reagime negative kur marrin vesh diagnozën, por nënat shqiptare kanë më të zhvilluar ndjenjën e paragjykitimit të fëmijëve të tyre.

Kampioni

Pjesëmarrës janë 6 nëna të fëmijëve me Sindromin Daun, që janë dhe popullata kryesore, në qendrën “Xhonatan” në Tiranë, qendër që diagnostikon dhe ofron terapi për këtë target grup fëmijësh.

Kampionimi është jorastësor pasi kërkimi ynë është cilësor dhe qëllimi nuk është përgjithësimi, por përshkrimi i fenomenit dhe analizimi i tij.

Regjistrimi u bë përmes mbajtjes së shënimeve, të cilat kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre.

..
Avantazhet: lidhen me faktin se gjatë kohës që shkruan përgjigjet të intervistuarat ndihen në qendër të vëmëndjes, kështu mund të shtojnë më shumë detaje.

..
Disavantazhet: nuk mund të mbahet kontakti sy më sy, ndihen vështirësi për regjistrimin e informacionit.

..
Procedurë e lodhshme që kërkon shkurtime në të shkruar.

Instrumentet

U përdorën 2 intervista, të përshtatura në shqip dhe përshtatur me ndryshimin më të vogël nga origjinali për kërkimin, i cili është cilësor. Ato janë përdorur si intervista për shkak të pyetjeve të tilla, për shkak të informacionit më në thellësi që ato sigurojnë dhe numrit të nënave ku ato do aplikohen. U përdorën 2 instrumenta, të cilat janë intervista të përdorura në studime të mëparshme në vende të tjera.

Intervista 1

Për realizimin e kësaj interviste *u mor leje përdorimi* nga drejtori ekzekutiv i “Daun Syndrome Kosova; instrument, të cilin ai e ka përdorur në një studim kombëtar për nënat e fëmijëve të prekura me këtë sindromë. Ajo është e përbërë prej pyetjesh të hapura dhe të mbyllyra, të cilat shërbyen për të marrë informacion në disa fusha të rëndësishme të studimit, që lidhen me hipotezat e ngritura.

Intervista 2

Gjithashtu, për përdorimin e intervistës nr. 2 u mor leje nga 2 bashkautorë, Victoria Dauson dhe Antonia Chitty për intervistat që kanë përdorur ato në librin “*Special Education needs*”. Pas miratimit etik për lejen e përdorimit, intervistat gjysmë të strukturuar u përkthyen dhe përshtatën në gjuhën shqipe. Këto intervista u përdorën në 6 nënat e fëmijve me Sindromë Daun në Tiranë. Këto intervista shërbyen për të marrë informacion të detajuar në lidhje me hipotezat e ngritura.

Procedura- Kërkimi u zgjodh të jetë cilësor, pasi kemi të bëjmë me eksplorimin e ekperiencave (përvojave të nënave) përmes instrumentave cilësorë si intervistat.

U përdorën intervistat gjysmë të strukturuar për dy arsye kryesore:

pasi ato ofruan informacion specifik, i cili mund të krahasohet me ato të studimeve të tjera.

u morën opinionet e pjesëmarrësve, të cilët ishin të paktë në numër, por u eksploruan në thellësi e për një kohë të gjatë.

Limitet - Besueshmëria si intervistë është e lartë, pasi është e mirëpërcaktuar në pyetje, por ajo ka dhe limitet e saj, pasi nuk mund të nxjerrim një konkluzion për gjithë popullatën, pasi vetë metoda kërkimore dhe procedura nuk e mundëson këtë gjë. *Një nga disavantazhet e përdorimit të kësaj metode ishte se* nuk mund të mbahej kontakti me sy; shpeshherë të intervistuarat jepnin informacion edhe me në gjerësi të fenomenit, por edhe dilnin jashtë çështjes.

Metoda të analizimit të të dhënave cilësore

Në fazën e analizimit të dhënave cilësore u përmbledhën në një format të caktuar më parë ku u hodhën transkriptet e të gjithë intervistave, meqenëse intervista ishte me pyetje të kombinuara, por mbizotëronin më shumë pyetjet e hapura, u listuan të gjitha përgjigjet përkatëse.

U krye një analizë krahasuese, pasi të dhënat e mbledhura nga pjesëmarrëset u krahasuan me ato të studimeve të mësipërme.

Rezultatet dhe Diskutimet

Rezultatet do tregohen duke shkëputur pikërisht ato pyetje, të cilat i shërbejnë studimit në fjalë, si më poshtë vijon:

Ndjenjat e përjetuara pas marrjes së diagnozës së fëmijës

Të gjashta nënat janë ndierë keq dhe kanë patur dhimbje të pashmangshme shpirtërore, por pikëllim (trishtim), frikë, ankth që kanë ndierë 4 prej tyre, simptoma psikosomatike kanë pasur 2 prej tyre. Në fazën pas daljes nga materniteti janë ndierë të paragjykuara nga familjarët e bashkëshortit, komshinjtë e më gjerë.




Ky rezultat tregon se dhe nënat tona kanë reaguar negativisht 100 %, ku 67 % pra, pjesa më e madhe e tyre kanë ndierë ankth, frikë, e pikëllim. Nga kjo rrjedh që dhe nënat shqiptare si ato të huaja kanë reagime të njëjta, me ndryshimin se nivelin e të paragjykuarit nga vetë familja, komuniteti e kanë më të lartë se në vendet jashtë ku janë kryer studimet.

Përshkrimi prej nënave i mënyrës së dhënies së diagnozës nga mjeku

Dy nga nënat u përgjigjën se diagnoza iu tregua *shumë ftohtë (pa ndjenja)* nga ana e mjekut.

Dy prej te cilave thanë *pa mëshirë fare*.

Njëra *në mënyrë të kujdesshme* pasi diagnozën e kishtë marrë në Itali.



Ndikimi i mënyrës së komunikimit të diagnozës


Pesë nga nënat u përgjigjën po është e vërtetë, sido të na ishte thënë diagnoza ajo periudhë ka qenë ndër më të vështirat, por sigurisht që ftohtësia e mjekëve e rëndoi edhe më tej gjendjen. Kjo pyetje bashkë me përgjigjen vërteton hipotezën se dhe mjekët shqiptarë kanë komunikim jo të mirë të diagnozës, e cila nga ana e saj ka shtuar reagimin negativ, si më poshtë tregon grafiku:



Reagimi i familjarëve të tjerë mbi diagnozën


Tre prej nënave u përgjigjën shumë keq, reaguesh shumë keq. Një prej tyre u përgjigj se familjarët i kishin thënë *sikur të të vdiste fëmija do ishte më mirë*. Dy prej të cilave u përgjigjën se familjarët reaguesh ashpër ndaj vetë nënës për lindjen e një fëmije me Sindromën Daun.

- shumë keq reagues
- sikur të të vdiste fëmija do ishte më mirë
- familjarët reagues ashpër ndaj vetë nënës për lindjen e një fëmije me sindromën daun



Sugjerimet e nënave për prindërit e tjerë

Mos lejoni t'i paragjykojnë fëmijët tuaj, mbrojeni ata me çdo mënyrë.




Ky rezultat tregon se ato ndiehen të paragjykuara nga ambienti përreth. Nga kjo përgjigje **vërtetohet** dhe hipoteza numër 2, ku nënat shqiptare e kanë më të zhvilluar ndjenjën e paragjykimit nga të tjerët për fëmijët e tyre. E për këtë duhen hartuar strategji ndërkomunitare që shoqëria jonë në këtë drejtim të sensibilizohet. Ato kërkojnë vetëdijësim nëpërmjet mediave, ku në emisione të ndryshme të flitet për fëmijët e tyre, ku këta të fundit të shihen si njerëz normal, madje të respektohen edhe më tepër.

Gadishmëria e tyre për të publikuar emrin diku

Të gjashta nënat u shprehën se donin të qëndronin anonim, kjo mund të mbështesë faktin se vetë ato kanë frikë nga të ndierit të paragjykuara.

4. A ka kishit ndryshuar po te kishit mundesi ne rrethin, lagjen e juaj ?



Nga grafiku i mësipërm kuptojmë se pjesa më e madhe e nënave, dëshirojnë të mos i paragjykojnë fëmijët e tyre.

Konkluzione dhe rekomandime

Nga i gjithë studimi i mësipërm vihet re se ka një korelacion pozitiv midis të komunikuarit në mënyrë të papërshtatshme të diagnozës (në mënyrë të ftohtë, pa mëshirë, pa kujdesin e duhur) dhe shtimit të reagimeve negative të nënave me fëmijë me Sindromë Daun. Ky fakt nga ana tjetër nuk ndihmon në përmirësimin e gjendjes së nënave menjëherë pas lindjes së fëmijës apo në zhvillimin e këtij të fundit.

Gjithashtu, një përfundim i dytë faktik tregoi se si gjithë nënat kudo në botë, edhe ato shqiptare reagojnë negativisht kur marrin lajmin e dhënë për fëmijët e tyre. Por nënat shqiptare krahas ndjenjave të tilla si *ankthi*, *frika*, *pikëllimi*, por dhe simptomave psikosomatike, gjithashtu kanë të theksuar *ndjenjën e të qenit të paragjykuara* për fëmijët e tyre, duke e ndierë këtë paragjykim që nga anëtarë të tjerë të familjes, ku përfshihen motrat apo vëllezërit e fëmijëve të tyre, por dhe persona të tjerë të fisit. Ato, gjithashtu, ndiehen të paragjykuara nga personat që i rrethojnë, në mjediset ku banojnë apo edhe nga komuniteti e më gjerë.

Një përfundim i fundit lidhet me faktin se për të marrë diagnozën nga mjeku në mënyrë sa më të përshtatshme nënat shqiptare sugjerojnë më takt në thënien e saj dhe e shikojnë të domosdoshëm praninë e një psikogu (këshilluesi) ndërkohë që marrin diagnozën, i cili mund t'ia transmetojë më shëndetshëm diagnozën.

Nga të gjitha këto konkluzione del me domosdoshmëri ngritja e strategjive të dobishme jo vetëm për të përballuar diagnozën, por dhe për t'u forcuar në ditët e

para, ku kërkesa për ndihmë është edhe më e lartë se në vijim, që më pas vetë nënat e familjarët të jenë të afta për të ndihmuar fëmijët e tyre të zhvillojnë potencialin që kanë.

Një rekomandim i dytë lidhet me faktin se ky studim duhet të aplikohet në një target grup më të gjerë për të siguruar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave të tij dhe për të rritur shkallën e përfaqësueshmërisë.

Bibliografi

- Adee, D., Adee, E., & Hunsberger, T.,** 1996 “*Lesson from Nathan and other children with special needs*”. Harvest Publication.
- Bejtullahu, E.,** 2007, “*Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimi*”, Prishtinë. Botimet “Mozaiku”.
- Buckley, S. & Bird, G.,** 2005, “Down syndrome issues & information”. A downsed publication.
- Chiriacescu, D.,** 2008, *Shifting the paradigm in social service provision: Making Quality Services Accessible for People with disabilities in South East Europe*, Disability Monitor Initiative, Handicap International.
- Down Syndrome Kosova,** 2010 “*Programi i ndwrhyrjes dhe Edukimit të Hershëm-PIEH* Doracak për përdorim për programin shkolla verore” raport i pabotuar.
- Down syndrome centar Pula-Croatia,** 2007. Edsa ured Hrvatska. International congress on down syndrom and first EDSA congress in Croatia.
- Down Syndrome Kosova,** Raport vjetor 2010. Maj 2010. (raport i pabotuar).
- Hubach., O. S.,** 2006, “*Same lake different boat*”. P&R publishing.
- Hughson, A.,** 2008 *A promising path to an inclusive life*. Alberta Association for Community Living.
- Logan, P.,** 2009, *Teaching and reading to children with down syndrome*. United States of America: Woodbine House.
- Murdoch, P.,** 1983, Counselling process with parent’s of down children, Pearson Education, Inc.
- Organizata Down Syndrome Kosova,** “*Mwso pwr mua*”. Për prindër, institucione vendimarrëse, profesionist dhe kujdestar. (Raport vjetor)
- Oelwein, R.,** 2009, *Growing up children with Down Syndrome*, Wiely, New York.
- Puesceh, L. & Murphy, G.,** 1976, *Family and family therapy with down syndrome*, Cambridge, MA: Harvard University Press.
- Selikowitz, W.,** 2008, Parent’s of diabled children and theirs emotional symptoms, nw Family psychology: the art of the science (fq 267-294), W. Pinsoff dhe J. L. Lebow, eds. New York: Oxford University Press.
- Skotko, R. & Cand, T.,** 2004, *Down Syndrome and parents reaction*, Open university Press, McGraw – Hill Education.
- Soper, K. L.,** 2007, Mothers reflects on hoë children with down syndrome enrich their lives. Segullah Group, Inc.
- Shoqata “Down Syndrome Kosova”,** 2004, “Identifikimi i Nevojave të Komunitetit me Sindromin Down drejt përfshirjes në Sistemin e Arsimit”.

INVESTIGATING GENDER ISSUES IN ENGLISH FOREIGN LANGUAGE LEARNING AMONG THE FRESHMAN STUDENTS OF ECONOMIC FACULTY “FAN S.NOLI” UNIVERSITY. A – CASE STUDY

JULIANA ÇYFEKU

University of Korca, Faculty of Education and Philology

English Language Department

Përmbledhje

Ky studim analizon ndryshimet që paraprijnë mësimin e gjuhës angleze si gjuhë e huaj nga studentët: vajza (N = 68) dhe djem (N = 37) të vitit I, në nivele të ndryshme, në kontekstin specifik të Universitetit “ Fan S.Noli”, në Fakultetin Ekonomik, Dega Financë – Kontabilitet. Fokusi kryesor është hapësira gjinore që ekzistonte midis studentëve femra dhe meshkuj. Hipotezat hulumtuese që parashtrohen, janë: 1) nëse studentët femra ose meshkuj kishin të njëjtat bindje dhe vlerësime gjuhësore përmësimin e gjuhës angleze 2) nëse të dy gjinitë mësonin anglisht ndryshe ose më mirë se njëri-tjetri. Studimi kërkimor u zhvillua përgjatë një semestri të plotë. Instrumentët shkencorë të përdorur në të janë: Testi i vendosjes (Testdiagnostikues) dhe pyetësi BALLI (Bindjet (gjuhësore) për Mësimin Krijues të Gjuhës), me anë të të cilëve u evidentuan çështjet gjinore që u hasën si faktor i rëndësishëm e dalies në mësimin e gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Gjithashtu, u analizuan lidhjet ekzistuese midis bindjeve (vlerësimeve) gjuhësore të studentëve dhe rezultateve përfundimtare për të arritur sukses në përvetësimin e gjuhës angleze në nivel akademik.

Fjalët çelës: gjinia, niveli, mësimi i gjuhës angleze si gjuhë e huaj, përfundimet, bindje (vlerësime) gjuhësore.

Abstract

The present study describes the variations that prevailed in overall English language learning by the freshman students into different levels, and by males (N=37) and females (N=68), in the specific setting of “F.S.Noli” Korca University, Economic Faculty, Finance - Accountability. The central focus was the gender gap that existed among male and female university students in EFL. It addressed the research hypothesis; 1) whether male or female students hold the same beliefs and attitudes about English language learning and 2) if both genders learned English differently or better than one another.

The research study was expanded over a full time semester. A placement test (diagnostic test) and the BALLI - survey (Beliefs About Language Learning Inventory) were employed as reliable research instruments to investigate the variations that existed within both genders and to observe the relationship that prevailed among the learners' beliefs about English language learning and their current outcomes to finally achieve success in EFL mastery at academic level.

Key words: gender, proficiency, EFL learning, outcomes, beliefs (BALLI)

1. Introduction

Learning English as a foreign, second language is a process that requires great efforts from the learner's part but even from the teachers themselves. Nowadays necessity requires commitment from all kinds of learners in the learning process. Generally speaking there exist "essential characteristics" which embody each EFL learner. Some current educational research has attempted to understand how gender and other characteristics of students and teachers (such as: age, grade, achievement, learning styles, learner's individual differences, interest, beliefs about the subject) are closely involved in foreign language learning for all students' level especially by university students.

In the field of foreign/ second language acquisition, much attention has been paid to which variable (such as age, race, social class, ethnicity, or gender among a host of others) have a great influence on English language learning. As EFL/ ESL teachers we need to find the extent to which gender differences affects our success in EL Teaching and Learning among our university students.

- This study puts forward the following hypothesis:

Hypothesis I - EFL female students are better learners than EFL male students.

Hypothesis II - Gender among other factors plays an important role in foreign language acquisition.

We are interested in discovering those factors which relate the gender differences and which may be obstacles in EFL learning and achievement. We intend to set goals for a successful language learning and achieve them despite the gender differences that exist among our students. Representing to them the most convenient language learning strategies or pointing out the ones that they already possess without being aware of them will motivate them completely in EFL learning. As Dornyei (2001:116) notes, 'teacher skills in motivating learners should be seen as central to teaching effectiveness'. Groups of people 'who come together around mutual engagement in an endeavour', when 'ways of doing things, ways of talking, beliefs, values, power relations – in short, practices – emerge' (Eckert and McConnell – Ginet, 1992:464). Various gender identities are observed in our teaching activities that are continuously argued, analyzed and contested through differentially gendered engagements. We now read frequently about gender being performed, but also constructed, accomplished, achieved, enacted and effected. Concerning gender and education studies, most have dealt with English as a native language, have focused on oral language, and have analyzed the data qualitatively rather than quantitatively. Whereas this study tried to elicit the subtle differences between males and females at university level viewing English in the process of foreign language learning and achievement.

2. Methodology

The Placement Test was conducted to the students of “F.S.Noli” Korça University, Albania (Economic Department) since the beginning of the English courses of the academic year 2010-2011. The freshman students were explained at first the scope of applying it among them. Since they came from different schools, urban or rural ones, from different areas they assessed English language skills at a range of levels. Throughout this test areas of deep comprehension were defined in terms of vocabulary, grammar and writing. It provided accurate assessments of each language skill at the appropriate level that revealed the actual participants’ level in English. There exist a wide range of placement tests designed for English learners to examine the general basic ability in English. They are designed around four essential qualities: validity, impact, reliability and practicality. They produce exact scores of the learner’s true level of language skills. The conducted Placement Test was designed from LSI (Language Studies International, Kreuzstasse 36,8008 Zurich). The test included two parts : 1) 50 multiple choice questions (each with a , b , c , d alternatives) , concerning grammar aspects and vocabulary 2) English writing test limited to 100 words writing about the students’ current language learning goals. The participants’ results reflected the current level of each English learner’s proficiency. The test included mostly English language specifications such as grammatical notions of relative time, space, possession, collocations, verb patterns and phrasal verbs. The writing section tested the way they gave information and fostered their current language goals of learning at university level. The incorporation of the Placement Test reflected the degree in which females and males scored higher in EFL learning. It provided to some extent the availability of Hypothesis I that EFL female university students at “ F.S.NOLI “ Korça University are better learners than EFL male students. To be more specific, they all came directly from high education under the same circumstances but with typical gender differences in the degree of the English language proficiency.

The survey instrument of the present study consisted of 34 items from the ‘Beliefs About Language Learning Inventory’ (BALLI) designed by Horwitz (1987). The BALLI is a widely used instrument (e.g. Horwitz,1989; Siebert, 2003; Bernat& Lloyd, 2007) available to assess learner beliefs in second/foreign language learning. Using this instrument, the present study aimed at inquiring the effects that individual learner beliefs played in foreign language learning and achievement.

The BALLI measures beliefs about five language learning areas: (1) Foreign language aptitude,(2) the difficulty of language learning,(3) the nature of language learning,(4) learning and communication strategies and (5) motivations and expectations. All items were rated on a 5-point rating scale, with 34 items ranging from strongly agree (1) to strongly disagree (5).The response options asking for the difficulty of the English language ranged from very difficult (1) to very easy (5), and the one for the item asking about how long it takes to speak English ranged from less than one year (1) to you can’t learn a language in one hour per day (5).

Research on learner beliefs has emerged out of a growing interest in individual learner characteristics in EFL with a particular focus on learner’s

affective and cognitive contributions to the language learning process .While affective contributions are central to second language learning (Schumann, 1998), learners’ metacognitive knowledge and beliefs have been found to have a pervasive influence on their academic learning, thinking, reasoning and problem solving (Kardash& Scholes,1996). Furthermore, it has been stated in various studies that one’s belief systems, social cognitions and metacognitions are a driving force for intellectual performance (Schoenfeld,1983) including acquisition of foreign languages.

3. Results and discussion

3.1. The Placement Test Findings

Research findings of the present study (see.Tb.1), indicated that significant differences existed between male and female freshman students at Economic

Group Level	Female		Male		Total		Percentage
Intermediate	35		9		44		
Region	urban	rural	urban	rural	urban	rural	42%
Number	22	13	8	1	30	14	-
Pre - Intermediate	33		28		61		-
Region	urban	rural	urban	rural	urban	rural	58%
Number	21	12	20	8	41	20	
Total	68		37		105		100%

Department, Korca University.

Table 1

Distribution of students by course level, region and gender.

The Placement Test results served as the principal basis of the students’ division into Pre-intermediate and Intermediate controlled groups. As it was overstated the Placement Test estimated each participant’s proficiency level based on Bloom’s Taxonomy of evaluation. Its implementation provided evident facts of the students’ achievements in EFL. Even though they had the same age, the test results reported diversity in English language proficiency as it can be observed from the tables below:

Table 2

Observation of students by regional education

Gender	Urban education	Rural education	Total urban	Percentage	Total rural	Percentage
Female	43	25	71	67%	34	33%
Male	28	9				

As it is observed a considerable proportion of the participants came from rural areas. Statistically 34 males and females) 33 % of the total have attended high school in rural areas, whereas 71(females and males) or 67 % in urban areas. Since they come from high education they are supposed to have the same level proficiency regardless of the region they come from. As it is seen the gap results in proficiency in terms of gender is of a considerable variation.

Moreover, both genders were expected to be at B₂ level. The placement Test reported than them to be at B₁ level, where females outperformed males in both levels, especially in Intermediate level in an advantage of 35 female students to 9 male students. Accordingly, based on the above comparisons females result to be better learners in English than males, considered so, on the first stage of the present study. Procedurally, Hypothesis I: EFL female students are better learners than EFL male students – was taken for granted to this extent of the participants' investigated proficiency level.

3.2. BALLI- survey findings (Pre-intermediate controlled group)

The aim of the present study was to investigate whether there were any gender differences in the language beliefs. The results showed that males and females generally did not hold similar beliefs about language learning in all categories of the survey instrument 'Beliefs About Language Learning Inventory, (BALLI). Concerning the first four areas of the BALLI survey, female students reported that learning English was mainly based on learning vocabulary, grammar, but mostly it was practice in authentic life which meant speaking spontaneously without paying too much attention on the mistakes. Besides, they put emphasis on the necessity of speaking with native speakers. Whereas most males, did not believe in their abilities to learn a foreign language. Besides, they were neither positive nor negative on the fact that learning English is learning how to translate from their own language or with the statement of saying it correctly. Thus, they did not have the courage to try English until they were totally sure of having the ability of using it well. On the opposite, females reported to explore the English language viewing themselves its different aspects and were conscious about their recent knowledge and their continuous progress it demanded on them all. Concerning the beliefs about the last area (Motivations and expectations) overall students reflected similar positive responses in all items.

3.3. BALLI- survey findings (Intermediate controlled group)

Results on both genders reported to be on the most part similar. They had in common 29 out of 34 items, thus differing in only 5 out of 34. Statistically, the vast majority of both males and females reported positive responses on most of the items. So, in comparison to the Pre-Intermediate controlled group results, the differences between males and females were slighter. The results of both groups indicated generally that the higher the proficiency, the lower were the differences in responses. Summing up, both groups revealed the mean score in variation beliefs in

6 out of 34 and compared to the results found by Siebert (2003), whose precious study (See bibliography) resulted that there were eight items on which responses of males and females differed. Whereas, Bernat and Lloyd (2007), in their study investigating the relationship between beliefs about language learning and gender, found that overall males and females held similar beliefs about language learning except for two items which were for the most part slightly significant.

The present study reveals that overall males and females differ in individual learner beliefs about learning English as a foreign language. The overstated comparisons found that individual factors such as proficiency, attitude, motivation and self-efficacy are found rather more important factors than gender to play a role in the differences to the language learner beliefs. Accordingly, the content of Hypothesis II is disputable when stating that –‘Gender among other factors, plays an important role in foreign language acquisition’. The identification male and female beliefs and the reflection on their potential impact on English language learning and teaching found the BALLI assessment as a good instrument and a good starting point in the present study. Males and females examined and evaluated their beliefs which arose their awareness and even adjustment of their expectations concerning English language learning. Since the present study results indicated no great gender differences in the BALLI survey, it can be concluded that the differences in the English language acquisition do not occur only by gender but are affected by such individual factors as: proficiency, attitude, motivation and self-efficacy.

4. Conclusions

Based on its results and conclusions, the present study can serve as evidence for all kind of EFL teachers (pre-service and in- service), students at all kind of proficiency level and curriculum designers to investigate the foreign language learning process with respect to gender and other related factors such as attitude, motivation, learner’s styles and achievement towards English foreign language learning. Given the great number of students that learn English as a foreign language in various school contexts all over the world, we believe that there is a need to investigate whether the same gender tendencies appear in EFL learning contexts.

Finally, it must be noted that results based on self-report questionnaires have their limitations. Specifically, they may not report what learners do, but rather, what they pretend to do. Thus one cannot report with absolute certainty that either male or female students actually engage in the language learning process and in the strategies they themselves report using in language learning. Anyway, the implications for teaching are that English foreign language teachers need to maintain and increase the learner’s self-confidence so that they gain the so-called “Learner autonomy”, a prevailing feature of academic students. What we expect at the end of our teaching process is establishing the basis of the learner’s interaction with the learning materials within the institutional context and outside its borders in the real life professional situations. The standard measures already acknowledged the existence of diversity among the students, as well as similarities. Thus, English language educators should take into account the fact that there will always be

considerable variations among different male students and among different female students. Thus further research needs to be addressed concerning such classroom learner complexities to develop new insights for a more successful language teaching and learning process.

5 Bibliografi

- BALLI (Beliefs About Language Learning Inventory) Retrieved from: <http://www.newcastle.edu.au/group/ajedp/>
- Bernat, E., Lloyd, R. (2007). Exploring the Gender Effect on EFL Learners` Beliefs about Language Learning. *Australian Journal of Educational & Developmental Psychology*. Vol 7, 2007, pp 79-9. Retrieved from <http://www.newcasle.edu.au/group/ajedp/>
- Dornyei, Z. 2001. Teaching and Researching Motivation .England: Pearson Education Limited
- Eckert, P. and McConnell-Ginet, S. 1992. Think practically and look locally: Language and gender as community-Based practice. *Annual Review of Anthropology* 21: 461-90
- Horwitz, E. K., (1987). Surveying student beliefs about language teaming. In A. L. Wenden, & J. Rubin., (Eds.), *Learner Strategies in Language Learning*, (pp. 119-132). London: Prentice Hall
- Horwitz, E. K., (1989), Recent research on second language learners: Beliefs and anxiety. D. A. Koike, & A. R. M. Simoes (Eds.), *Negotiating for meaning: Papers on foreign language teaching and testing*, 51(60). Austin: Texas Papers in Foreign Language Education
- Kardash, D. A., & Scholes, R. J. (1996). Effects of pre-existing beliefs, epistemological beliefs, and need for cognition on interpretation of controversial issues. *Journal of Educational Psychology*, 88(2), 260-271
- LSI. Placement Test. Retrieved from <http://www.sizh.ch/documents/standard%20English%20Placement%20Test.pdf>
- Schoenfeld, A. H. (1983). Beyond the purely cognitive: Belief systems, social cognitions and metacognitions as driving forces in intellectual performance. *Cognitive science*, 7, 329-363
- Schumann, J. H. (1998). *The Neurobiology of Affect in Language*. MA: Blackwell Publishers Ltd.
- Siebert, L. L. (2003), Students and teacher beliefs about language learning. *The ORTESOL Journal*, 21, 7-39

Appendix A

The BALLI measures beliefs about five language learning areas: (1) Foreign language aptitude, (2) the difficulty of language learning, (3) the nature of language learning, (4) learning and communication strategies and (5) motivations and

expectations. All items are rated on a 5-point rating scale, with 32 items ranging from *strongly agree* (1), to *strongly disagree* (5). The response options asking for the difficulty of the English language ranging from *very difficult* (1) to *very easy* (5) and the one for the item asking about how long it takes to speak English ranging from *less than one year* (1) to *you can't learn a language in one hour per day* (5).

1) Foreign language aptitude

1. It is easier for children than adults to learn a foreign language. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
2. Some people have a special ability for learning foreign languages $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
3. People from my country are good at learning foreign languages. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
4. It is easier for someone who already speaks a foreign language to learn another one. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
5. People who are good at maths or science are not good at learning foreign languages $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
6. I have a special ability for learning foreign languages $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
7. Women are better than men at learning foreign languages. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
8. People who speak more than one language are very intelligent. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
9. Everyone can learn to speak a foreign language. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$

2) The difficulty of language learning.

10. Some language are easier than others. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
11. The English language is: difficult, medium difficult, easy. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
12. If someone spent 1 hr/day learning a language, how long would it take them to speak the language very well? $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
13. It is easier to speak than to understand a foreign language. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
14. It is easier to read and write English than to speak and understand it. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$

3) The nature of language learning.

15. It is necessary to learn about English speaking cultures to speak English. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
16. It is best to learn English in an English speaking country. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
17. The most important part of learning a foreign language is learning new words. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
18. The most important part of learning a foreign language is learning grammar. $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$
19. Learning a foreign language is different than learning other academic subjects $o^1 \ o^2 \ o^3 \ o^4 \ o^5$

20. The most important part of learning English is learning how to translate from my own language. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

4) Learning and communication strategies.

21. It is important to speak English with an excellent pronunciation. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

22. You shouldn't say anything in English until you can say it correctly. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

23. I enjoy practicing English with foreign/native speakers I meet. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

24. It's OK to guess if you don't know a word in English. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

25. It is important to repeat and practice a lot. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

26. I feel shy speaking English with other people. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

27. If beginning students are allowed to make mistakes in English, it will be difficult for them to speak correctly later on. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

28. It's important to practice with cassettes/tapes or CD Rooms. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

5) Motivations and expectations

29. I believe I will learn to speak English very well. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

30. People in my country feel that it is important to speak English. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

31. I would like to learn English so that I can get to know English better. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

32. If I learn to speak English very well, I will have better job opportunities. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

33. I want to learn, to speak English very well. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

34. I would like to have English speaker friends. o¹ o² o³ o⁴ o⁵

Retrieved from: <http://www.newcastle.edu.au/group/ajedp/>

VËSHTRIM KRITIK MBI NATYRËN E MËSIMDHËNIES SË GJUHËVE TË HUAJA (MGJH) PËRMES TEKNOLOGJIVE TË INTERNETIT

Olsa Pema

Universiteti Fan S. Noli, Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Fakulteti i Edukimit e Filologjisë

Përmbledhje

Artikulli synon të analizojë MGJH-ja dhe kërkesat e saj në kontekstin e ri shoqëror-arsimor të masivizimit të internetit. Për këtë shqyrtohen teoritë më në zë të nxënës në funksion të vendit që ato i caktojnë TIK-it. Nga dy kahet e evidentuara, modeli sociolinguistik, i mbështetur në parimin se gjuha e huaj mësohet më mirë përmes ndërveprimit shoqëror, rezulton të jetë sot më i gjithëpranuari. Me zanafillë te teoria sociokulturore e Vigotsky-it dhe shtjelluar më tej në teorinë e konstruktivizmit shoqëror, ky model krijon hapësira të gjera promovuese për integrimin e mjeteve të internetit. Për një zbatim sa më të kuptimshëm e produktiv të TIK-it në klasë sipas modelit në fjalë, analizohen disa parime bazë pedagogjike, duke arritur përfundimin se rivlerësimi i rolit të TIK-it në MGJH-ja është thelbësor për arsye të potencialit të tij jo vetëm për t'iu përgjigjur këtyre parimeve, por edhe për t'i promovuar më tej ato.

Fjalë çelës: modeli sociolinguistik, konstruktivizmi shoqëror, të nxënës autonom, teknologjitë e internetit

Abstract

This article aims at analyzing the developments taking place in second language teaching (SLT) as a result of the widespread use of the internet. The analysis is grounded on an examination of the main learning theories from the viewpoint of what their basic principles have to say about ICT use. As the investigation shows, the sociolinguistic model, founded on the principle that the best way to learn a foreign language is through social interaction, remains the most widely-accepted to date. Rooted in the sociocultural theory of Vigotsky and the later developments, this model is well-adapted for fostering the integration of internet tools in SLT. The analysis of its fundamental principles serves the practical objective of maximising the effectiveness of internet tools in a foreign language class. Our many-sided approach to the question of ICT in SLT leads to the programmatic conclusion that the full exploitation of what IT has to offer to the teaching/learning process calls for no less than a paradigm shift in the way SLT is conceived and practised.

Key words: sociolinguistic model, social constructivism, learner autonomy, internet technology

1. Hyrje

Shoqëria e mijëvjeçarit të ri ka hyrë në mënyrë të pakthyeshme në rrugën e revolucionit të komunikimit njerëzor, zhvillim i cili e ka zanafillën te masivizimi i teknologjive të internetit. Edhe në fushën e mësimdhënies e të nxënësve gjithmonë e më shumë shpaloset kërkesa për zbatimin e tyre, veçanërisht në fushën e gjuhëve të huaja, ku krahas interesit të përgjithshëm për të renë janë ngjallur jo pak debate e polemika lidhur me format konkrete dhe kontekstet e veçanta të përfshirjes së tyre në procesin mësimor.

Në këtë kontekst, profesioni i MGJH-ja vazhdon të zgjerohet e të pësojë ndryshime dinamike, duke vënë gjithnjë e më shumë theksin mbi zhvillimin e shprehive për komunikimin e orientuar drejt një qëllimi, kompetencën për të menduar në mënyrë kritike dhe të mësuarit autonom gjatë gjithë jetës.

2. Teoritë e të nxënësve të gjuhëve të huaja dhe vendi që ato u caktojnë teknologjive të internetit

Diskutimet mbi teknologjitë e internetit nuk do të ishin të plota pa një vështrim të përgjithshëm mbi teoritë e të nxënësve të gjuhës së huaj, kjo për arsye se teori të ndryshme i japin jo të njëjtën rëndësi rolit të mësimdhënies praktike dhe, nënkuptohet, internetit në klasë. Qëllimi i pasqyrës së mëposhtme, pra, nuk është të sqarojmë në detaje teoritë bashkëkohore të të nxënësve të gjuhës së huaj, por të tregojmë se roli i mësimdhënies praktike, rrjedhimisht, edhe i përdorimit të TIK-it në klasë, merr vlerë jo të njëjtë në teori të ndryshme. Për më tepër, mësimdhënësve të gjuhës u nevojitet një bagazh teorik paraprak për të përcaktuar se kur një mjet mund t'i vijë në ndihmë zhvillimit gjuhësor të nxënësve.

Në literaturën bashkëkohore mbi të nxënësve të gjuhës së huaj shtjellohen dy kahe të ndryshme modelesh, jo krejt pa lidhje me njëri-tjetrin. Njëri është modeli psikolinguistik dhe tjetri modeli sociolinguistik.

Këndvështrimi psikolinguistik i ka bazat te teoria ineiste e Chomsky-t mbi natyrën e gjuhës, e cila ka revolucionarizuar fushën e gjuhësisë me postulatën e famshëm se fëmijët lindin me predispozitën për të mësuar gjuhë, duke qenë të pajisur me një mekanizëm të posaçëm mendor për përvetësimin e gjuhës (Chomsky, 1986). Duke u ekspozuar ndaj një inputi të pasur gjuhësor të karakterizuar nga përdorimi si duhet i fjalive të mirëformuara prej folësve amtarë, fëmija zhvillon gjithë strukturat e tjera specifike gjuhësore. Performanca linguistike, sipas Chomsky-t, është një veprimtari e drejtuar nga rregulla që gjenerohen nga kompetenca linguistike ose struktura e brendshme gramatikore e folësit.

Idetë çomskiane u përqaftuan nga Stephen Krashen dhe u përshtatën prej tij për të shpjeguar procesin e të nxënësve të gjuhës së huaj në formën e një modeli të ri të njohur si “*Modeli i Natyrës dhe të Nxënësve*”. Ky model hedh dritë mbi rolin e inputit të kuptueshëm si kusht i domosdoshëm për të nxënësve të gjuhës. Sipas tij inputi duhet të jetë sfidues për nxënësin (më i ndërlikuar sesa përfaqësimi mendor aktual i tij për gjuhën objekt), por të mos i tejkalojë mundësitë njohëse të tij (Krashen, 1985).

Mbështetur te koncepti i Chomsky-t mbi kompetencën e performancën, Krashen dallon qartë dy procese të ndryshme, atë të *përvetësimit* i cilësuar si proces i pandërgjegjshëm dhe të *nxënës*, proces që aktualizohet në përpjekjet e ndërgjegjshme e të qëllimshme për të nxënë format gjuhësore, duke vënë theksin mbi pamundësinë e kalimit nga të *nxënit* te *përvetësimi*. Më tej modeli plotësohet me arsyetimin se ankthet e të nxënit mund të çojnë në bllokimin e përvetësimit të gjuhës në çfarëdo rrethane, duke ngritur një filtër afektiv që nuk mundëson përdorimin e inputit të kuptueshëm.

Çfarë sjell zbatimin praktik i kësaj teorie në mjedisin e gjuhës së huaj? Sipas modelit psikolinguistik qëllimi i vërtetë i përvetësimit promovohet më së miri nga një mjedis komunikativ i pasur në input të kuptueshëm. Prania e këtij inputi, vënia e theksit te komunikimi dhe atmosfera e ngrohtë në klasë ulin filtrin afektiv dhe nxitin nxënien e gjuhës së huaj. Megjithatë, edhe pse një qasje komunikative ndaj të nxënit të gjuhës dhe me një impakt të gjerë në fushën e mësimdhënies, studiuesit mendojnë se kjo teori vendos një ngarkesë të madhe mbi mësuesin, pra, mbetet një mësimdhënie me në qendër mësuesin. Për më tepër, ekzistenca e inputit të kuptueshëm në vetvete nuk e garanton dobënë e tij në nxënien e gjuhës së huaj. Vetëm kur nxënësi arrin ta dallojë njësinë e inputit e ta ruajë në kujtesën afatshkurtër, ai brendësohet e kështu mund të shfrytëzohet për të ristrukturuar ndërgjuhën. Kjo do të thotë që nxënësi duhet të zhvillojë ndërgjegjësimin metagjuhësor për të mundësuar ndryshimin.

Kërkimet dhe zbatimet e sotme e kanë zhvendosur fokusin teorik duke sfiduar modelin natyror të Krashen-it në mbështetje të modelit sociolinguistik ndërveprues, i cili thekson në radhë të parë aspektin shoqëror të gjuhës dhe zbulimin e pengesave gjuhësore në procesin e komunikimit. Siç kuptohet edhe prej vetë termit emërtues, parimi themelor i qasjes interaksioniste është segjuha e huaj mësohet më mirë përmes ndërveprimit shoqëror (Claros, 2008). Duhet vënë në dukje, megjithatë, se ndërveprimi për nxjerrjen e kuptimit, i cili luan rol të madh në përqendrimin e vëmendjes së nxënësve në veprimtari, nuk shkakton menjëherë të nxënës të gjuhës, kjo vjen gradualisht, me kohë dhe si rezultat i një numri të madh ndërveprimesh.

Ndryshe nga "*Modeli Natyror*" i Krashen-it, këndvështrimi interaksionist mbështetet në mësimdhënien eksplicite, pra, jo të izoluar brenda veprimtarisë njohëse të individit. Kjo risi shënon një ndryshim të dukshëm në qëndrimin ndaj TIK-it në përgjithësi e internetit në veçanti, si një mjet i pazëvendësueshëm për të promovuar mësimdhënien e kësaj forme. Studimet tregojnë se individët kanë tendencë të ndërveprojnë me kompjuterin në një mënyrë thelbësisht shoqërore, njëlloj si ndërveprimet në jetën reale. Tendenca njerëzore për ta parë teknologjinë në mënyrë antropomorfike si një lloj ndihmuesi personal me të cilin bashkëpunohet për arritjen e një qëllimi, e rrit potencialin e internetit për të mbështetur procesin e të nxënit të gjuhës së huaj.

Pikëpamja interaksioniste gjen shprehje në një sërë modelesh të ndryshme bazë për shtjellimin e të cilave ka shërbyer teoria sociokulturore e Lev Vygotsky-t. Sipas modelit të Vygotsky-t zhvillimi njohës, pra, edhe të nxënit e gjuhës së huaj, e ka zanafillën në ndërveprimin shoqëror (Vygotsky, 1962). Tre postulatet bazë të kësaj teorie janë: **1)** veprimtaria shoqërore si burim i zhvillimit e mendimit njerëzor;

2)veprimtaria e ndërmjetësuar nga shenjat; 3) “Zona e Zhvillimit të Afërt”, përmes kontekstualizimit të tyre në MGJH-ja, hedhin bazat për të thelluar perceptimin tonë rreth përfshirjes së teknologjive të internetit në mësimdhënien e gjuhëve të huaja.

Për Vygotsky-n veprimtaria njohëse ka karakter unikal njerëzor, pohim ky që mbështetet në faktin se ajo vjen si rrjedhojë e të nxënësve shoqëror, e brendësimit të shenjave shoqërore, të kulturës dhe lidhjeve po shoqërore. Në thelb, pra, njohja duhet parë si produkt shoqëror realizuar përmes ndërveprimit.

Për mësuesit e gjuhës së huaj kjo do të thotë se krijimi i mundësive për ndërveprim mes nxënësve është faktori më i rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit të të menduarit të një rendi më të lartë. Ky këndvështrim teorik mund të konkretizohet në programin mësimor të gjuhës së huaj përmes zbatimit të formave të mësimdhënies së diferencuar, punës me projekte, etj., ku TIK-it luan rol jo të vogël.

Në analizën tonë vlen të ndalemi te një pikë e fortë me ndikim përcaktues mbi procesin e të nxënësve të gjuhëve, siç është postulati i “Zonës së Zhvillimit të Afërt”. Kjo përkufizohet si “*distanca midis nivelit të zhvillimit aktual përshkruar nga pavarësia në zgjidhjen e detyrës dhe nivelit të zhvillimit potencial përshkruar nga zgjidhja e detyrës me ndihmën e më të rriturve apo moshatarëve më të zotë*”. Me këtë kuptojmë që fëmija ka aftësi të kopjojë një sërë veprimesh që i tejkalojnë kapacitetet e tij, por vetëm brenda disa kufijve. Duke kopjuar, nxënësi aftësohet të nxën më mirë kur drejtohet nga të rriturit sesa kur lihet vetë. Në mësimdhënien kjo lidhet me “Zonën e të Nxënësve të Afërt” (ZNA), e cila përshkruhet si niveli i performancës për të cilën një nxënës është i aftë kur ka mbështetje nga ndërveprimi me një folës më të përparuar në gjuhë. Ky koncept lidhet shumë me të ashtuquajturën *skelë* të Bruner-it, pasi ZNA-t është praktikisht koha kur mësuesi duhet të veprojë si drejtues për të mbështetur e inkurajuar nxënësin. ZNA-t, pra, fokusohet në përdorimin aktiv nga nxënësi të mjeteve të reja për të kuptuar e kryer veprimtarinë. Nxënësi, si i tillë, nuk shihet thjesht si marrës pasiv i udhëzimeve të mësuesit, përkundrazi, të dy palët ndërveprojnë reciprokisht duke ndarë njohuri e përgjegjësi për detyrat. ZNA-t, pra, përfaqëson një ndryshim fokusi drejt mësimdhënies me në qendër nxënësin. Mendojmë se bashkëpunimi mes nxënësve në të mësuarit e gjuhës shërben si një mekanizëm i fuqishëm për zhvendosjen përpara të ZNA-t, pasi mundëson shkëmbyeshmërinë e roleve dhe akses të vazhdueshëm drejt formave strategjike të kontrollit, në përputhje me kërkesat e detyrës. Këtu krijohet hapësirë për përfshirjen e teknologjive të internetit.

Teoria e Vygotsky-it është përqafuar nga mbështetës të shumtë të qasjes sociolinguistike, siç njihet James Lantolf, i cili, duke e zgjeruar këtë teori në nxënien e gjuhës së huaj, pohon se nxënësit e gjuhës së huaj përparojnë drejt niveleve më të larta të njohurisë gjuhësore kur bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë me folës të gjuhës së huaj që e zotërojnë atë në një shkallë më të lartë(Lantolf, 2000).

Teoria sociokulturore e të nxënësve të gjuhës së huaj ka shërbyer si bazë për zhvillimin e mjaft modeleve pedagogjike, ndër të cilat, rëndësi për argumentin tonë paraqet teoria e konstruktivizmit shoqëror (gjerësisht e mbështetur nga studiuesit). Konstruktivizmi shoqëror në literaturën shkencore pedagogjike përkufizohet si një qasje bashkëkohore, një nga kahet më të komentuara e të gjithëpranuara të teorisë

konstruktiviste që e sheh nxënësin si subjekt të të nxënës. Sipas këtij modeli të nxënës rrjedh nga një aspekt social, ku nxënësi ndërvepron e dialogon me problemin, kontekstin dhe pjesëmarrësit për të zbuluar kuptimin dhe vlerat. Shoqërorja shërben si bazë përpunimit dhe organizimin e mëtejshëm njohës të informacionit brenda individit.

Sipas kësaj perspektive informacioni fillimisht ndërtohet gjatë ndërveprimit shoqëror e më pas përpunohet së brendshmi nga individ (pra, shoqërorja na kushtëzon për mënyrën si do ta përpunojmë informacionin së brendshmi). Këtu ka vend për të bërë një paralelizëm me klasën si mjedis i të nxënës të gjuhës, pasi gjuha e re sjell me vete fragmente të kulturës që nuk mund të ndahen nga informacioni.

Mësuesi, si drejtues e lehtësues i procesit, vendos me nxënësit një lidhje reciproke të pandërprerë, ku gjithsecili merr pjesë duke i shtuar komunikimit vlera dhe kuptime, vlerëson informacionin dhe e organizon atë mendërisht. Qartazi, kemi të bëjmë me një kontekst tipik të mësimdhënies me në qendër nxënësin, ku fokusi bie mbi natyrën komunikative dhe dialogun shoqëror për ndërtimin e njohurive.

3. Mësimdhënia bashkëkohore e gjuhëve të huaja dhe parimet për përfshirjen e teknologjive të internetit

Nisur nga teoritë (si dhe për një zbatim praktik sa më të kuptimshëm e produktiv të teorisë së konstruktivizmit shoqëror në klasë, si teori me mbështetje të gjerë) mund të nxirren konkluzione e të mundësohen lidhje për pedagogjinë e mësimdhënies nga ana e mësuesve, të cilët do të ngrenë mbi këtë bazë pritshmëritë e punës së tyre mbi çka mund të marrin e si ta përshtatinatë në klasë.

Sigurisht, kushdo që përpikët të mësojë një gjuhë të huaj, është i destinuar të kalojë nëpër disa faza të zhvillimit gjuhësor, të cilave nuk mund t'u shmanget dot, kushtëzim ky i pranuar edhe nga teoritë që sapo shtjelluam (Për një klasifikim të këtyre fazave shoqëruar me të dhëna të hollësishme shih: <http://www.katyisd.org/esl/documents/bilingual/bilingual-twowayimmersion-secondlangacquisition-en.pdf>). Me të drejtë, atëherë, lind pyetja, a mund të luajë mësuesi ndonjë rol për ta orientuar këtë proces, apo ndërhyrja e tij do të ishte pa vlerë? Sigurisht, mësuesit nuk mund të ndryshojnë kursin e zhvillimit gjuhësor të nxënësve që mësojnë gjuhën e huaj, por ne besojmë se ata kanë pushtet të ndikojnë në një masë të konsiderueshme në ritmin e tij, rrjedhimisht edhe në shkallën e të nxënës. Kështu, mësuesi mund të ndihmojë në përshpejtimin e procesit të nxënës, por për ta bërë të mundur këtë ai duhet të ndërtojë një perceptim të plotë individual mbi klasën si një mjedis i pasur të nxënës, të cilin më pas duhet ta aktualizojë gjatë punës me nxënësit.

Siç e kemi theksuar gjatë analizës, interneti po ndryshon gjithnjë e më shumë mënyrën si ne i adresohemi e komunikojmë me njëri-tjetrin. Bota e internetit është kaq e gjerë e komplekse, sa që përfshirja efektive e tij në klasë mund të përbëjë në vetvete një sfidë e cila duket edhe më e vështirë për arsye të ndryshimeve të pandalshme që ai pëson dita-ditës. Për gjithë këto arsye, aplikimi i teknologjisë

elektronike në MGJH-ja duhet të mbështetet në një sërë parimesh që qëndrojnë në themel të filozofisë së mësimdhënies bashkëkohore të gjuhëve.

Këto parime kanë të bëjnë më shumë me aspektet pedagogjike sesa ato teknologjike, ndaj ato mbeten udhëzues të dobishëm në çdo kohë (me gjithë ndryshimin e vazhdueshëm që pësojnë). Këto parime kryesisht lidhen me synimet e të nxënës dhe trajtat e mësimdhënies dhe planifikimit të saj. Në fund të fundit, erëndësishme është të ecet në drejtimin e duhur pavarësisht ritmit të lëvizjes. Për këtë arsye, para se të mendojmë të organizojmë krejt kursin e lëndës, apo edhe të planifikojmë një orë mësimi, duhet të përcaktojmë drejtimin që, në rastin tonë, lidhet me përcaktimin e synimeve të përgjithshme të cilat, normalisht, ndryshojnë nga klasa në klasë, por edhe midis nxënësish të ndryshëm. Më poshtë do të diskutojmë përmbledhtazi qëllimet specifike që duhet të shoqërojnë përdorimin e internetit e të plotësojnë qëllime të tjera gjuhësore ose edukative.

Të mësuarit autonom përbën një strategji që e sheh nxënësin si individ i cili merr përgjegjësitë mbi procesin e të nxënës. Kjo ndihmon nxënësit të zhvillojnë vetëdërgjegjen, botëkuptimin, praktikitetin dhe lirinë në diskutim, attribute këto që do t'i udhëheqin ata drejt një të nxënës pavarur (Little, 2002).

Për arsye se teknologjia ndryshon me ritme kaq të pandalshme, të nxënës nuk është më qëllim i një çasti të dhënë, por një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë jetës. Për këtë nxënësve nuk u kërkohet thjesht '*të nxënës*', por edhe '*të mësojnë të nxënës*', pra, të zhvillojnë strategjitë e të mësuarit autonom të nevojshme për t'iu përshtatur risive teknologjike dhe situatave të reja. Kjo shprehi do të ndihmojë studentët të arrijnë rezultate vlera e të cilave i tejkalon kufijtë kohorë të një kursi të veçantë.

Të mësuarit në bashkëpunim shihet në literaturën dhe praktikatat bashkëkohore pedagogjike si një strategji e domosdoshme për suksesin e MGJH-ja. Në klasë ai karakterizohet nga puna në grupe të vogla prej tre-katër vetësh, përqëndrimi në detyrat që duhen kryer, bashkëpunimi dhe komunikimi sistematik brenda grupit, marrja e përgjegjësisë individuale për të mësuar si dhe drejtimi i përbashkët i të nxënës si rezultat i kompaktësisë së grupit. Të nxënës bashkëpunues përmirëson të kuptuarit e përmbajtjes, përforcon shprehitë sociale aq të rëndësishme në nxënien e gjuhës së huaj, nxit aftësitë vendimmarrëse të nxënës, krijon një mjedis aktiv të nxënës, rrit vetëbesimin dhe përgjegjësinë tek nxënës, përqëndrohet në suksesin e gjithsecilit duke vlerësuar stilet e ndryshme të të nxënës. Për gjithë këto arsye ai nuk shihet më thjesht si një mjet, por, para së gjithash, si qëllim që garanton suksesin e të nxënës të gjuhës. Në epokën e internetit aftësia për të bashkëpunuar me partnerë të tjerë brenda klasës, shkollës apo jashtë saj në forume globale është e qenësishme për suksesin, ndaj nxënës nuk mund ta përdorin drejt internetin, nëse nuk kanë fituar ende shprehitë komunikuese e të punës në grup.

Të nxënës ndërkulturor. Formimi ndërkulturor në epokën që jetojmë ka marrë një domethënie të veçantë. Suksesi në shoqërinë e sotme globale – në botën akademike, të biznesit, etj. – varet në një masë të madhe nga aftësia për të komunikuar efektivisht me njerëz nga kultura të ndryshme dhe nga interpretimi i informacionit prej kontekstesh të ndryshme kulturore. Procesi i të nxënës të gjuhës së huaj, nënkupton njëkohësisht edhe përvetësimin e kulturës së vendit ku flitet gjuha, ndaj

mendojmë se ky synim duhet integruar me vetëdije të plotë në mjedisin mësimdhënës përmes teknologjisë, duke kultivuar të nxënësit tanë në të njëjtën kohë shprehitë e edukimit global.

Të nxënët kritik e krijues. Shkalla e gjerë e informacionit të disponueshëm mbi internetin do të thotë që të nxënët kritik dhe ai i bazuar në kompetenca kanë fituar një rëndësi edhe më të madhe. Më shumë se kurrë, aftësia e të lexuarit tani nënkupton leximin midis rreshtave, e kështu me radhë me shprehitë e tjera. Në zbatimin e mjeteve të internetit në klasë ne si mësues duhet t'i ndihmojmë nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike e krijuese, në një kuptim të ngushtë, duke analizuar këndvështrimin dhe piksynimet e *site*-eve individuale, etj., dhe, në një kuptim më të gjerë, duke konsideruar ndikimin e pakthyeshëm që TIK-it po ushtron në riformësimin e konteksteve të reja shoqërore, politike e ekonomike.

Synimet e sipërpërmendura cilësohen si elementë të rëndësishëm për t'u vlerësuar në çfarëdo mjedisi të nxëni në shoqërinë e sotme. Ato marrin më shumë domethënie kur në mësimdhënien e gjuhës së huaj integrohet edhe interneti. Në përputhje me këto qëllime, përfshirja e mjeteve të internetit në MGJH-ja duhet të paraprihet edhe nga një sërë parimesh që kanë të bëjnë me vetë procesin mësimor në thelb të të cilave qëndron *integrimi*. Nuk mund të flasim për përfshirje të TIK-it në MGJH-ja, aq më tepër për mësimdhënie të suksesshme, pa integrim të tij në këtë proces. Integrimi i teknologjisë në kurrikulën e gjuhës së huaj është një kusht i domosdoshëm për t'i dhënë kuptim përdorimit të saj në procesin e mësimdhënies.

Mësimdhënia përmes kompjuterit ka kaluar nëpër disa faza. E para, ajo bihejvioriste, me fillesat në vitet '70, theksonte programet praktike stërvitore për nxënien e shprehive të veçanta, e dyta, faza komunikative me fillesat në vitet '80 u fokusua në veprimtari komunikuese mbështetur në përdorimin e kompjuterit, por që mbeteshin të një modeli "*ad hoc*" me ndikim vetëm në elemente marxhinale dhe joqendrore të të nxënës të gjuhës së huaj. Kjo çoi në një etapë të tretë, atë të mësimdhënies integruese me fillimet e veta në vitet '90, ku kompjuteri filloi të përdoret natyrshëm dhe rregullisht bashkë me mjetet e tjera dhe median duke i shërbyer krijimit të një mjedisi me akses të pasur ndaj informacionit për përdorimin konstruktiv të gjuhës. Në të vërtetë, kërkimet në klasa të ndryshme kanë siguruar fakte se futja e kompjuterave ka impaktin më të madh kur ata shndërrohen në përbërës integralë të mënyrës së re të të nxënës, në vend të përdorimit periferik e sipërfaqësor të tyre.

Me fjalë të tjera, përdorimi i teknologjisë si një dukuri e izoluar, si një veprimtari e ndarë dhe e pavarur nga praktika pedagogjike e mësimdhënies së gjuhës së huaj, do të ishte jo vetëm i pakuptimtë, por edhe me pasoja tepër serioze për të. Ajo duhet parë e gërshetuar së brendshmi me detyrat mësimore si nxitëse, formësuere dhe frymëzuere e qëndrimeve tona ndaj gjuhëve brenda kuadrit pedagogjik. Në literaturën bashkëkohore flitet gjithnjë e më shumë për një lidhje simbiotike midis *mësimdhënies, të nxënës dhe të vepruarit* në kontekste sociokulturore, duke e vlerësuar të nxënës jo si një proces individual psikologjik, por si një dukuri shoqërore. Kështu, për mësuesit dhe nxënësit e gjuhës, detyra lidhet me ridimensionimin e klasës si një vend që nxit bashkëndërtimin e njohurive, të kuptuarit dhe praktikat me teknologjinë si një mjet i integruar për arritjen e këtyre

objektivave pedagogjikë. Më konkretisht, një detyrë me në qendër teknologjinë nuk ka nevojë të jetë përherë pika kulmore e një ore mësimi, teknologjia mund të përdoret gjatë çfarëdo lloj veprimtarie, edhe nëse kjo nuk është domosdoshmërisht e projektuar për ta përdorur atë.

Mësimdhënia e bazuar në projekte(MBP). Mësimdhënia e integruar kërkon mënyra të reja të organizimit të klasës. Me gjasë, më e rëndësishmja nga këto është strategjia e punës mbështetur në projekte. Kur nxënësit punojnë bashkë për projekte me një përmbajtje të caktuar, ata fitojnë përvojë në zhvillimin e qëllimeve të veta të të mësuarit e në përdorimin e internetit si burim për t'i përmbushur këto qëllime. Ata mund edhe të zgjidhin probleme e të ndërmarrin detyra të ngjashme me çka do t'u duhet të bëjnë më vonë jashtë mureve të klasës. Puna me projekte siguron që veprimtaritë me internet të shkojnë më tutje sesa një lundrim i thjeshtë në faqet e rrjetit. Konkretisht, realizimi i saj fillon me detyrat më të thjeshta për t'u e zgjeruar e thelluar gradualisht nëpërmjet veprimtarive më komplekse siç janë prezantimet me gojë, por edhe botimet *online*. Puna me projekte(shih më sipër këshillat për planifikimin e programit lëndor dhe veprimtarive ditore,f.5) vlerësohet si një mënyrë e përsosur për të realizuar gjithë qëllimet e lartpërmendura. Ajo është cilësuar si një model i veprimtarisë në klasë që zhvendoset nga praktikat e veprimtarive të shkurtra, të izoluara të mësimdhënies me qendër mësuesin drejt veprimtarive mësimore afatgjata, ndërdisiplinore (modulare), me qendër nxënësin dhe të integruara me problematikat e botës reale(QTKA, 2006). Puna me projekte mund të promovohet më tej përmes përdorimit të internetit duke u dhënë nxënësve mundësinë për të përdorur një larmi mjetesh *online* dhe akses ndaj materialeve autentike. Lidhja me internetin ndihmon nxënësit e gjuhës së huaj të njohin, p.sh., variantet e ndryshme të anglishtes ashtu siç ato përdoren në vende të ndryshme të botës. Prej kësaj nxënësi përmes një angazhimi aktiv në internet fiton mundësinë e përdorimit të një anglishteje reale, autentike dhe të kapshme për veshin. Së fundi, puna me projekte ka parparësinë e shtrirjes së kuadrit kohor të të mësuarit të gjuhës përtej një ore mësimi. Ky fakt u lejon nxënësve të përfshihen në procesin e tyre të të mësuarit, duke planifikuar, rishikuar e reflektuar si mbi procesin e të nxënës, ashtu edhe mbi produktin.

Mësimdhënia e diferencuar (MD) përbën një nga strategjitë pedagogjike bazë që përshpejton integrimin e TIK-it në mësimdhënie me vlera të paçmuara veçanërisht për mjedisin e të nxënës të gjuhës së huaj. Mësimdhënia e diferencuar ka në themel parimin se nxënësit janë të ndryshëm dhe për pasojë kanë nevojë të ndryshme. MD-ar në gjuhën e huaj ka të bëjë me atë lloj mësimdhënieje ku mësuesi planifikon variante të ndryshme për ato që nxënësit kanë nevojë të mësojnë, mënyrat se si do t'i mësojnë dhe si do t'i shprehin ato që kanë mësuar me qëllim që të plotësohen nevojat e secilit prej tyre. Pra, thelbi i MD-ar është përshtatja e përmbajtjeve, proceseve, metodave e materialeve me ritmet e nxënësve të ndryshëm, për të arritur të njëjtat synime e objektiva. Sipas të ashtuquajturave postulate të Burns-it, nevojat e MD-ar buron nga diversiteti i nxënësve: *nuk gjen dot dy nxënës identikë që të përparojnë me të njëjtën shpejtësi, të gatshëm të nxënë në të njëjtën*

kohë, që përdorin të njëjtat teknika për të studiuar gjuhën, me të njëjtin profil interesash apo të motivuar njëlloj e për të njëjtat qëllime.

Në kushtet e sotme, MD-ar është bërë e domosdoshme për arsye të heterogjenitetit të klasave, të cilat, tipikisht, përbëhen nga nxënës që vijnë prej mjediseve të ndryshme social-kulturore, pse jo, edhe me prejardhje të ndryshme etnike, me nivel njohës e gjuhësor të ndryshëm, me prirje e interesa të ndryshme. Falë MD-ar nxënësit fitojnë mundësi të barabarta për pjesëmarrje në procesin e të nxënës duke krijuar, kuptuar e interpretuar në mënyrë aktive njohuritë, duke eksploruar, eksperimentuar e zbuluar me orientimin e mësuesit universin gjuhësor e kulturor në gjuhën e huaj. Në këto kushte ne mendojmë se interneti bën të mundur krijimin e një hapësire të pafund ku gjithë nxënësit mund të përfshihen në mënyrë të barabartë në veprimtaritë për nxënien e gjuhës. E shkrirë në mënyrë sistematike me mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e bazuar në projekte, MD-ar siguron sukses të padiskutueshëm në një mjedis të nxënës të gjuhës së huaj përmes teknologjive të internetit.

Mësimdhënia me në qendër nxënësin(MQN),puna me projekte dhe mësimdhënia e diferencuar shkojnë paralel me një qasje tjetër siç është MQN-in e cila përshkohet nga parimi se nxënësi nxë më mirë duke vepruar vetë përmes bashkëpunimit në grup, në veprimtaritë e hulumtimit e gjatë teknikave të zhvillimit të të menduarit kritik e krijues,çka nënkupton që programi i kursit në përgjithësi dhe projektet e nxënësve në veçanti do të formësohen sipas nevojave e interesave të vetë atyre. Kjo aftësi për të përshtatur programin u përshtatet kërkesave të shoqërisë së re të informacionit, ku njerëzit duhet të jenë në gjendje më tepër të gjejnë e krijojnë tipa të ndryshëm njohurish sipas nevojës sesa thjesht të zbatojnë ato që mësojnë në shkollë. MQN-in nuk do të thotë që mësuesi mungon apo është pasiv në klasë, por që roli i tij zhvendoset drejt dhënies së orientimeve e ndihmës së nevojshme për organizimin e projekteve dhe përdorimin e gjuhës së përshtatshme gjatë veprimtarive. Sa më shumë punohet me TIK-it në klasë, aq më larg qendrës zhvendoset mësuesi dhe aq më në qendër të veprimtarive vjen nxënësi. TIK-it në klasë po jep mundësi të reja për MQN-in, autonominë e të nxënës e të mësuarit në zbulim. Sipas Prof.Dr.Mimoza Gjokutaj(2005) *“mësimi zbulues përbën thelbin e të mësuarit të sotëm, bazuar në parimin didaktik: të mësuarit e nxënësit në shkollë duhet të imitojë të menduarin e shkencëtarit apo hulumtuesit të ardhshëm. Tashmë pranohet fakti se në qoftë se nxënës arrijnë t’i nxjerrin vetë përfundimet prej të dhënave të siguruara më parë nga mësuesi apo nga vetë ata duke shfrytëzuar burime të ndryshme, sukcesi është i padiskutueshëm.”* Bashkëpunimi në grupe të vogla do të ishte efikas në promovimin e këtyre parimeve.

Një sërë studimesh kërkimore kanë treguar se kur mësuesit janë në gjendje ta realizojnë këtë zhvendosje, MNGJH e ndërmjetësuar prej mjeteve të internetit sjell pa diskutim rezultate pozitive.

Të nxënët e dyfishtë. Ky kuadër nënkupton që nxënësit duhet të “zhyten” njëkohësisht në nxënien e shprehive gjuhësore dhe atyre teknologjike për të arritur objektivin e tyre final të të nxënës të gjuhës së huaj (*shih: worldlanguages.jordandistrict.org/dualimmersion/*). Në këtë sipërmarrje të vështirë

mësuesi siguron strukturën e nevojshme të punës dhe mbështetje gjatë rrugës. Qasjet pedagogjike tradicionale e shohin teknologjinë si mjet për mësimdhënien e gjuhëve të huaja, por në prizmin tonë një perspektivë e tillë mbetet mjaft e kufizuar në një botë ku teknologjia ka ndryshuar thellësisht mënyrën si mund të mësohet e të përdoret gjuha në jetën e përditshme. Për të mësuar aftësi e shprehi të efektshme komunikative, studentët duhet t'i mësojnë paralelisht të dyja, edhe gjuhën e huaj, edhe mjetet e TIK-it. Ky parim reflekton ngushtësisht atë çfarë kërkohet gjatë punës në klasat ku përdoret interneti, pra, rëndësinë e zhvillimit të kompetencave të prishme të nxënësit përmes teknologjisë dhe komunikimit në mjedisin e gjuhës.

Të nxënësit e mbështetur në përmbajtje. Interneti u siguron përdoruesve, nxënësve, gjetjen e informacionit të duhur dhe mundësinë e komunikimit me një audiencë reale, çka e bën atë një mjet ideal për t'u shfrytëzuar në realizimin e projekteve me qëllim kuptimplotë. Në të tilla projekte nxënësit mund të punojnë në grupe në distanca të largëta për të trajtuar çështje të ndryshme me karakter gjithëpërfshirës (siç janë çështjet e mjedisit), mund të eksplorojnë terrenin e përbashkët të një konflikti me përmasa ndërkombëtare, të hartojnë një deklarat politike për një marrëveshje globale, të reflektojnë mbi ngjarje historike, marrëdhëniet ndërkulturore, artin, sportet, mediat, etj. Zgjedhjet, pra, janë të panumërta për nxënësit. Për më tepër, gjatë punës me një temë që lidhet ngushtësisht me botën reale, nxënësit kanë mundësinë jo vetëm të lundrojnë në rrjet, por edhe të krijojnë 'dallgë' në të, pra, të kenë impakt si pjesëmarrës aktivë në trajtimin e problematikës që merret nën shqyrtim prej projektit.

Përdorimi i gjuhës. Konteksti i ri mësimdhënës në nismat e vazhdueshme për të nxitur komunikimin bashkëpunues mes studentëve synon në thelb promovimin e aftësive gjuhësore si: të folurit, të shkruarit, të lexuarit, të dëgjuarit dhe kompetencës ndërkulturore. Ne besojmë se ky realitet bëhet plotësisht i mundur përmes aplikimit të një dimensionit të ri mjetes, siç është bota e internetit.

Njohja e nxënësve. Që TIK-it të përdoret mbi një bazë sistematike në orët e mësimit, ka rëndësi për mësuesin të njihet me shkallën e kompetencës teknologjike të nxënësve. Për këtë mund të ndërmerret një vlerësim i nevojave të nxënësve duke i identifikuar ato që në fillim të vitit. Vetëkuptohet që mësuesi nuk mund të presë prej nxënësve të nxënë gjuhën, teknologjinë dhe përmbajtjen të gjitha në të njëjtën kohë. Të nxënësit është një proces i gjatë e dinamik, ndaj zhvillimi i shprehive do të ndjekë një ritëm gradual.

Zgjedhja e materialeve. Zhvillimin më cilësor të kompetencave gjuhësore e kulturore e lehtëson vënia në dispozicion të nxënësve e materialeve autentike e krijimit të burimeve origjinale. Burimet e internetit mendojmë se përbëjnë një vlerë të pallogaritshme, por duhet të jemi të vetëdijshëm të krijojmë detyra e të zgjedhim materiale në përputhje me nivelin e të nxënës, interesat e moshës dhe shkathtësitë kompjuterike të nxënësve.

Sfidat e përdorimit të TIK-it. Vështirësitë teknike në përdorimin e TIK-it mund të kthehen në pengesa potenciale si për mësuesin, edhe për nxënësin. Për më tepër, menaxhimi i klasës gjatë punës kërkimore nëpër faqet e internetit mund të paraqesë vështirësi. Çështja e kontrollit të klasës, në këtë kontekst, është një element i

rëndësishëm që duhet marrë parasysh prej mësuesit që në fazën e planifikimit. Në mjedisin tradicional mësuesi e ka më të lehtë të menaxhojë atë që ndodh në klasë përmes një kontrolli të rreptë që ia mundëson pozicioni i tij qendror. Për pasojë, nxënësit e ambientuar vetëm me qasjen tradicionale mund të ndihen të humbur në një mjedis mësimdhënës me bazë TIK-it, i cili kërkon prej tyre një shkallë të lartë autonomie, në rast se ky nuk ndërtohet në mënyrë të mirëmenduar. Që ky problem të shmanget, pra, prej mësuesit kërkohet një planifikim sa më i thelluar që të nxitë e të përfshijë gjithkënd. Me tej, për t'u shërbyer me cilësi nxënësve dhe për të mbrojtur kuadrin e ri të mësimdhënies, mësuesi merr përgjegjësitë e '*një monitoruesi të cilësisë*' që orienton nxënësit për të shmangur *website*-t joautoritarë e të pabesueshëm, duke kultivuar te secili prej tyre qëndrimin kritik ndaj informacionit të ri.

4. Përfundime

Përmes këtij artikulli me karakter njohës e analitik u përpoqëm të shtjellojmë natyrën e mësimdhënies bashkëkohore të gjuhëve të huaja në kontekstin e një zhvendosjeje paradigmатike të kontekstit pedagogjik të të nxënës në kushtet e masivizimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe posaçërisht internetit, si ikonë e saj. Gjatë shqyrtimit të teorive më në zë të të nxënës në funksion të vendit që ato u caktojnë mjeteve të internetit në këtë proces rezulton se pikëpamja më e mbështetur dhe e gjithëpranuar në ditët tona është ajo e përfaqësuar nga teoria e konstruktivizmit shoqëror sipas së cilës gjuha e huaj mësohet më mirë përmes ndërveprimit shoqëror, dhe ku mjetet e TIK-it shihen si promotore të këtij ndërveprimi në kushtet kur këto mjete përdoren në përputhje me një sërë parimesh themelore pedagogjike që i paraprijnë filozofisë së mësimdhënies në shoqërinë e informacionit, të tilla si: integrimi i TIK-it në kurrikulën mësimore, të mësuarit autonom e në bashkëpunim, të nxënësit ndërkulturor, kritik e krijues, parimet e mësimdhënies me në qendër nxënësin, të nxënësit e dyfishtë, etj.

Në këtë kuadër, analiza që sapo realizuam na ndihmon të ngremë një argument dhe të rivlerësojmë rolin e teknologjive të internetit. Përdorimi i tyre e bën lehtësisht të zbatueshëm të nxënësit bashkëpunues në klasë dhe më gjerë, sidomos për aspekte ku hyn elementi kulturor, tipike për mjedisin e gjuhës së huaj. Kur nxënësi arrin të lidhet shpirtërisht me informacionin, kuptimi i krijuar prej tij është më i fortë dhe lidhjet me njohuritë ekzistuese e kujtesën më të shëndosha, siç ndodh zakonisht në situata të botës reale me pjesëmarrës realë. Rrjedhimisht, besojmë se prania e internetit dhe mjeteve të tjera të TIK-it në klasë e përtej saj bëjnë të mundur kapërcimin e këtyre pengesave me efektivitet.

Bibliografi

Blake R., (2008), "*Brave new digital classroom – technology and foreign language learning*", Washington, D.C., Georgetown University Press.

ChomskyN., (1986), "*Knowledge of language: its nature, origin and use*", New York, Praeger.

ClarosM., (2008), "*Psycho-linguistic and socio-cultural approaches to language learning: A never ending debate*", Retrieved 28 June 2008, from

[http://www.](http://www.scielo.org.co/scielo.php?pid=S012346412008000100008&script=scarttext)

[scielo.org.co/scielo.php?pid=S012346412008000100008&script=scarttext](http://www.scielo.org.co/scielo.php?pid=S012346412008000100008&script=scarttext).

CompennolleR., Williams L., (2009), (Re)situating the Role(s) of New Technologies in World-Language Teaching and Learning. *Second language teaching and learning in the netgeneration*. Manoa, National Foreign Language Resource Center.

Gjokutaj M., (2005), "*Mësimdhënia me në qendër nxënësin*", Tiranë, QTKA.

KrashenS., (1985), "*The input hypothesis: issues and implications*", New York, Longman.

LantolfJ., (2000), Introducing sociocultural theory. *Sociocultural theory and second language learning*. Oxford, Oxford University Press.

Little D., (2002). Learner autonomy and second/foreign language learning, Good Practice Guide. LTSN Subject Centre for Languages, Linguistics and Area Studies – On line document:
<http://www.lang.ltsn.ac.uk/resources/goodpractice.aspx?resourceid=1409>

Muka P., KarajDh., Cela L., (2006). "*Hyrjenëmësimdhënien e diferencuar*", Tiranë, QTKA.

Musai B., (2003), "*Metodologji e mësimdhënies*", Tiranë, 2003, ALBGRAF.

Nawaz A., (2012), Social-Constructivism: futuristic sphere for e-learning in HEIs. *Global Journal of Business & Management Research*. 12/8, f.21. https://globaljournals.org/GJMBR_Volume12/3-Social-Constructivism-Futuristic-Sphere.pdf

Qendra e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin, (2003), "*Të mësuarit e bazuar në projekte*". Tiranë, QTKA.

TaroneE., (2001), "*Interlanguage. Concise Encyclopaedia of Sociolinguistics*", Oxford: Elsevier Science, 475-481.

Vigotsky L., (1962), "*Thought and Language*", Cambridge, MA: MIT Press.

VigotskyL., (1978), "*Mind in society: The development of higher psychological processes*" Cambridge, Harvard University Press.

Wood D., Bruner J., Ross G., (1976), The role of tutoring in problem-solving. Retrieved 7 December 2006, from
<http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1469-7610.976.tb00381.x/pdf>
<http://www.katyisd.org/esl/documents/bilingual/bilingual-twowayimmersion-secondlangacquisition-en.pdf> Worldlanguages.jordandistrict.org/dualimmersion/

ROLI I RRJETIT SOCIAL FACEBOOK NË PROCESIN E PRODHIMIT TË FEEDBACK-UT FORMUES NË NDIHMË TË FORMIMIT DHE ZHVILLIMIT TË AFTËSIVE PËR TË SHKRUAR NË GJUHËN ANGLEZE

Pandora Teta

Departamenti i Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Qëllimi i këtij artikulli është që të paraqesë një nga mënyrat e shumta të integritit të rrjetit social Facebook në procesin e prodhimit dhe përdorimit feedback nga pedagogu dhe studenti me qëllim që ky i fundit të përvetësojë aftësitë e nevojshme për të shkruar në gjuhën angleze që për ta është një gjuhë e huaj. Përmes Facebook-ut studentët angazhohen më aktivisht dhe në mënyrë më të pavarur në nxënie ndërkohë që mjedisi i nxënies bëhet më i hapur, transparent dhe demokratik duke ndihmuar në ndërtimin dhe zhvillimin e aftësive për të kërkuar dhe prodhuar feedback. Në njërën anë Facebook-u i ndihmon punonjësit e arsimit universitar të përballojnë barrën e tejskajshme të korrigjimeve dhe prodhimit të feedback-ut dhe nga ana tjetër i jep mundësi studentit të ndërgjegjësohet për rëndësinë që ka feedback-u në nxënie. Përpos avantazheve që ka përdorimi i Facebook-ut si mjet për të prodhuar feedback, artikulli parashtrohet edhe të metat e tij duke nënvizuar faktin që Facebook-u është thjesht një mjet dhe mjedis ku studentët nxiten të prodhojnë dhe të përdorin më shumë feedback formues sesa atë përfundimtar.

Fjalët çelës: feedback, mësimdhënie, nxënie, vlerësim formues, vlerësim përfundimtar

Abstract

The aim of the article is to present readers with ways of integrating Facebook in the process of producing and utilizing feedback to help university students master the skills of writing in English as a Foreign Language. Through Facebook students become more active and autonomous learners whilst the learning environment more convenient, open, transparent and democratic contributing to the building and mastery of skills of asking for and producing feedback. On the one hand Facebook helps university teachers to cope with the immense workload of marking and giving feedback to their students and on the other it helps to raise students' awareness to the importance of feedback. Alongside of the advantages of using Facebook as a means of producing feedback, the article lists its drawbacks emphasizing the fact that Facebook is just a tool and medium where students are encouraged to produce and use formative rather than summative feedback.

Key words: feedback, teaching, learning, formative assessment, summative assessment

Teknologjia informative dhe interneti e kanë transformuar në masë të ndjeshme natyrën e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën e lartë, duke u shndërruar në mjete

të rëndësishme për nxënien, konsolidimin dhe përdorimin e dijeve. Si në shumë drejtime të tjera edhe në arsim ato i kanë dhënë përmasa dhe tipare të reja mësimdhënies dhe nxënies së gjuhëve të huaja në përgjithësi dhe gjuhës angleze në veçanti. Pavarësisht synimeve dhe qëllimeve ambicioze të politikave arsimore në Shqipëri, sistemi arsimor universitar mbetet ende larg integritetit të teknologjisë së informacionit në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Në kushtet kur universitetet tona publike, ende nuk janë në gjendje të investojnë në krijimin e mjedisit virtual të mësimdhënies përmes produkteve të tilla si: Webct, Moodle dhe Blackboard, ose programeve të veçanta në ndihmë të pedagogëve për të prodhuar feedback të shpejtë dhe cilësor, si edhe për t'i lehtësuar ata nga ngarkesa shpeshhere e papërbalueshme që shoqëron korrigjimet dhe vlerësimet masive të studentëve, pedagogu i gjuhëve të huaja, vë në përdorim Facebook-un, rrjetin social më të përhapur dhe më të përdorur në botë, veçanërisht nga të rinjtë. Me anë të Facebook-ut pedagogu jo vetëm bën njoftime dhe sqarime, por krijon kushte për angazhimin e studentëve në një dialog të drejtpërdrejtë si me të ashtu edhe me bashkënxënësit, duke i nxitur ata të prodhojnë feedback për vete dhe për të tjerët. Dy janë sfidat kryesore, me të cilat po përballlet pedagogu i gjuhës angleze në përgjithësi:

1. Kontradikta midis numrit gjithnjë në rritje të studentëve nga njëra anë dhe stafit akademik pothuajse të pandryshuar nga ana tjetër, ka bërë që presioni që ushtrohet mbi pedagogun për të prodhuar feedback formues, shpeshherë bëhet i papërbalueshëm, madje dëshpërues, pavarësisht dëshirës së madhe të çdonjërit prej tyre për t'u angazhuar më shumë në feedback formues. Është fakt se, pedagogët e gjuhëve të huaja harxhojnë energji, kohë dhe mund të tejshkallësojnë duke prodhuar feedback formues, si me shkrim ashtu edhe me gojë, me qëllim që studenti të përshpejtojë nxënien dhe arritjen e objektivave. Por, fatkeqësisht kjo veprimtari sa vjen e bëhet edhe më e mundimshme dhe për pasojë jo gjithmonë cilësore.
2. Mungesa e ndërgjegjësimit të studentëve në lidhje me rëndësinë që ka feedback-u formues i prodhuar nga pedagogu, vetë studenti dhe bashkënxënësi, ka çuar në nënvlerësim dhe indiferencë ndaj feedback-ut, si një mjet i rëndësishëm në procesin e nxënies në mënyrë të pavarur. Në sistemin e sotëm arsimor, ku studentët janë të bombarduar nga vlerësime përfundimtare (me nota dhe pikë), nuk është çudi, që ata i vlerësojnë dhe i kushtojnë më shumë vëmendje pikërisht atyre aktiviteteve, proceseve ose detyrave gjuhësore që janë të bazuara në notë ose pikë. Me këtë arsye, mund të shpjegohet mungesa tek studentët e shprehive të domosdoshme për të kërkuar, prodhuar dhe përdorur "feedback-un", si mjet për krijimin e atij sistemi të brendshëm vetërregullues, që mundëson kapërcimin e hendekut që ekziston midis asaj që dinë dhe asaj që synohet të nxënë.

Çështja e prodhimit feedback-ut, është i gjerë dhe përfshin shumë aspekte, por në këtë artikull ne do të përqëndrohemi në evidentimin e një strategjie të lirë dhe të prekshme, që mund të ndihmojë në lehtësimin e ngarkesës së pedagogut nga njëra anë, dhe shfrytëzimit dhe integritetit të feedback-ut formues në procesin e nxënies, nga vetë studenti në anën tjetër.

Ndonëse, pedagogu i shkollës së lartë, nuk e ka kohën dhe mbështetjen materiale të duhur për të prodhuar feedback, koha po tregon se interneti në përgjithësi dhe disa

mjedise dhe rrjete sociale si: Facebook-u, japin një ndihmesë të vyer, në përballimin deri diku të pritshmërive ndaj pedagogut. Kur ende është e vështirë për të përballuar financiarisht pasjen dhe mbajtjen e një faqe internet ose blog vetiak, përdorimi i Facebook-ut, jo vetëm si mjet komunikimi, por mbi të gjitha si platformë për të prodhuar dhe përdorur feedback-un nga pedagogu dhe nga studenti është optimal.

Me këtë shpjegohet vendimi për ta përdorur atë në lëndën e Gjuhës së Sotme Angleze, dhe veçanërisht në aktivitetet më shkrim. Fillimisht pedagogu krijon një grup me studentët dhe sigurohet që të gjithë t'i bashkohen atij (ka raste kur studentët ende nuk kanë llogari në Facebook dhe detyrohen të hapin një të tillë me qëllim që të postojnë detyrat). Të gjitha detyrat me shkrim postohen në murin e grupit brenda afateve të përcaktuara dhe studentët e tjerë fillojnë të bëjnë komente, shprehin mendime dhe sugjerime kur të duan (sigurisht duke iu përmbajtur kodit të etikës në komunikimin në internet). Në këto kushte është detyrë e pedagogut të ndjekë ecurinë e procesit të vlerësimit nga ana sasiore dhe cilësore. Çdo student ftohet dhe nxitet të lexojë të gjitha postimet por është i detyruar të bëjë vlerësimin e jo më pak se tri postimeve të bashkënxënësve (studentët janë bërë me dije se “like” ose “unlike” nuk përbën feedback). Përsa i përket pedagogut, vlerësimin e tij të specializuar dhe të hollësishëm ai e bën në mënyrë private duke ia dërguar studentit vërejtjet dhe mendimet në lidhje me punimin si mesazh. Kjo bëhet që studenti të ndjehet i sigurt dhe për të shmangur ndonjë ndikim që komentet dhe vlerësimet e pedagogut mund të ketë mbi vlerësimet dhe komentet e bashkënxënësve. Pasi studenti të ketë marrë feedback nga pedagogu dhe bashkënxënësit e integron atë në punim dhe e poston atë sërish duke pritur komente dhe vlerësime të reja (fig. 1) të cilat ai mund t'i reflektojë ose jo në punimin e mëtejshëm.

Fig. 1

Xheni Pashaj

A WONDERFUL DAY!

It all started as a boring day of summer! Sun-bathing, hats, the sea... and sun-shine., the reason why I hate summer, i have such a delicate skin to love it! I feel so sorry about that anyway..

As usually, my family and i, decided to go on the mountin for camping. My favorite part of holidays. Playing baseball, painting, photographing., .things wich i love doing!

It was my birthday coming up and my cousin had this crasy idea of going camping on my birthday day. Everybody agreed and so we did. On 16th day of August we started our little journey up to Tomorri.

On that day I was the princess everyone were giving me presents. It was just perfect. All my family and cousins were present, just to make my day special.

Their presence made me feel the happiest girl of the world! Meantime the present I liked the most were the four original books of Stephany Myer Twilight, New Mon, Eclipse and Breaking Down. All in Am, almost 180 pages each. Laughing, photographing and out loud music, that's how the jurney went. Presents..presents.. presents.. whatever.., it wasn't over yet.. .

By the time we got there, i started to notice something strange. Everybody were such in a hurry and i was the last one to get off the car.

I walked 3 m and then i stopped. I wasn't able to walk anymore, couldn't talk, i couldn't even move a finger. Right in front of me it was a big post of "HAPPY BIRTHDAY" ! Ballons all over the place and beside my family and cousins there were all my school friends. I got blushed and the happy birthday song made me cry. I pictured them on my mind,wich was absolutely the best memory ever! Every time i remember it i feel the same emotion. And i start smiling, always saying: I HAD NEVER BEEN SO SURPRISED IN ALL MY LIFE!

Xheni Pashaj I appreciate your opinion. can you tell me which were my mistakes?

Sunday at 11:11am Unlike 1

Blerita Hazizolli Jerry, we're talking in english, so i have to write your name in english (ha, ha, haah)! To be sincere, in the beginning i found your story not very interesting, but i changed my mind after reading till the end. i liked the figurative phrases used in your essay very much. You have some writing mistakes. That's all! Good job!

Sunday at 10:07pm Unlike 1

Sihana Qarkaxhija, Blerita Hazizolli and 2 others like this.

Sihana Qarkaxhija Xheni, even there are some grammatical mistakes, i'd rather ignore them because your story sounds really very poetic. Short nice exposures are an advantage and fluent. You have a specific style of writing.

Sunday at 11:11pm Unlike 1

Gesimiana Ibrahim A very interesting story. You have made a detailed description of that day without making it boring at all. Nice that i also appreciate the vocabulary you have used.

Sunday at 10:11am Unlike 1

Një proces i tillë vlerësimi i ndërsjellhtë përmes *Facebook-ut* ndihmon në zhvillim e shprehive të të shkruarit në gjuhën angleze dhe e përgatit studentin për një performancë të lartë në vlerësimin përfundimtar me notë ose pikë. Si sigurohet kjo përmes platformës Facebook?

Procesi i diskutimit dhe debatit është një mënyrë e efektshme për të inkurajuar dhe nxitur studentin të gjenerojë feedback formativ për vete dhe për të tjerët, por edhe ta integrojnë atë në procesin e nxënies. Nicol dhe Macfarlane-Dick (2004) janë të mendimit se :“*një mënyrë për rritjen e efikasitetit të feedback-uttë jashtëm dhe mundësisë së studentit për ta kuptuar atë, është krijimi tek studenti i perceptimit të feedback-ut si një formë dialogu dhe jo si transmetim dijesh*”, dhe ky dialog mund të realizohet më së miri përmes Facebook-ut.

Ndryshe nga punimet që kanë si qëllim të tyre vlerësimin përfundimtar, me notë dhe pikë, postimi i punimeve në *Facebook*, ka si qëllim jo vetëm vlerësimin e tyre nga pedagogu, por edhe nga ana e bashkënxënësve. Duke qenë se Facebook-u, është një mjedis i hapur, demokratik dhe miqësor, përmes feedback-ut të prodhuar nga pedagogu dhe bashkënxënësit, në këtë mjedis studenti ndjehet i respektuar dhe i

vlerësuar për punën dhe përpjekjet që ka bërë. Është në natyrën e gjithkujt, që për punën dhe mundin e bërë e djersën e derdhur të ndiejë nevojën për feedback, qoftë ky pozitiv ose jo. Me fjalë të tjera, gjithsecili ka nevojë për t'u siguruar nga të tjerët se ku po shkon dhe nëse procesi i nxënies është në rrugë të drejtë ose jo.

Meqenëse prodhimi i feedback-ut formues është larg vlerësimit me notë ose pikë, studenti ndihet i çliruar nga stresi dhe emocionet që mund të shoqëronin një proces të tillë të bazuar në notë ose pikë. Ekziston prirja tek pedagogët, që të nxisin studentët të prodhojnë feedback, dhe ta përdorin atë në funksion të nxënies, përmes aktivitete vlerësuese me notë ose pikë. Por një gjë është e provuar katërcipërisht, se në momentin që një aktivitet vlerësohet me notë ose pikë, qëllimi i atij aktiviteti pushon së qeni përshpejtimi i nxënies, por vlerësimi, matja e njohurive ose gjithçka që mendohet, se është ose nuk është nxënë.

Kriteret ose rubrikat me objektivat, synimet dhe standardet që duhen arritur nga një punim, detyrë, projekt, etj., si edhe elementet përbërëse të tyre, që qëndrojnë të postuara nga pedagogu gjatë gjithë kohës së përgatitjes së detyrës, shërbejnë si burim i vazhdueshëm reference për studentin, i cili gjatë përgatitjes është i ndërgjegjshëm për çka i kërkohet dhe se çfarë duhet të përmbushë.

Studenti e përgatit detyrën dhe menjëherë e poston atë duke i kursyer vetes mundimin, kohën dhe koston që shoqërojnë printimin e saj. Detyrat postohen brenda afatit dhe të gjithë bashkënxënësit janë në gjendje t'i lexojnë, komentojnë dhe të japin feedback, ku gjithçka është transparente.

Çdo detyrë i nënshtrohet një vlerësimi të mirëfilltë. Ashtu siç pohon edhe Sadler (1989): *“Nëse duam që studentët ta vlerësojnë feedback-un, dhe të marrin masa për ta përdorur atë, ata duhet të kenë të njëjtat shprehje dhe aftësi (për të prodhuar feedback) si mësuesi. ”* Facebook-u në këtë drejtim shërben si një platformë ku studenti stërvitet të shprehë mendimin e tij dhe të vlerësojë gjithçka që lexon. Duke i dhënë mundësi studentit të japë feedback, rreth punës së vet dhe të tjerëve, ai ndërton dhe zhvillon ato shprehje dhe kompetenca, që i duhen për të qënë aktiv, kritik madje dhe vetëkritik ndaj çdo lloji prodhimi të shkruar. Të qënurit kritik dhe vlerësues janë shprehje, që duhen ndërtuar dhe zhvilluar paralelisht me mendimin kritik që në moshë të hershme.

Materialet e postuara janë të aksesueshme në çdo kohë dhe në çdo vend ku ka internet. Pedagogu mund të kontaktohet dhe në çdo moment dhe studenti mund të konsultohet me të. Në shumë raste duke reflektuar rreth feedback-ut të marrë nga pedagogu dhe bashkënxënësit, studenti ka mundësi të rishkruajë dhe të paraqesë një punim të ri me feedback të integruar.

Komunikimi përmes facebook-ut, ka vlera të jashtëzakonshme në planin shoqëror. Përmes tij, studentët mund të lidhen dhe të njohin më mirë njëri - tjetrin, gjë që jashtë këtij mjedisi mund të jetë i kufizuar. Duke qënë një platformë interaktive, facebook-u e nxit studentin, që të përpikët të kuptojë më mirë pikëpamjet dhe opinionet e të tjerëve nga njëra anë dhe të artikulojnë dhe të mbështesin pikëpamjet dhe opinionet vetjake nga ana tjetër.

Megjithë rëndësinë që ka përdorimi i *Facebook*-ut, në përvetësimin e gjuhës angleze në nivel universitar dhe avantazhet e përmendura më sipër nuk mund të themi kurrëse se ai përbën çelësin e zgjidhjes së gjithë problemeve dhe sfidave, që shoqërojnë vlerësimin dhe prodhimin e feedback-ut formues. Duhet të jemi të vetëdijshëm se përdorimi si duhet i tij, ashtu si edhe i çdo mjeti tjetër, kërkon përgatitje, kohë, energji dhe përpjekje. Ai ende është i mbartur me disa disavantazhe:

a) Përdorimi i *Facebook*-ut, nuk e pakëson ngarkesën e pedagogut për të vlerësuar dhe prodhuar feedback-un. Pedagogu vazhdon të vlerësojë vetë dhe të prodhojë feedback, të individualizuar në lidhje me punimet dhe detyrat e studentit. Në të vërtetë Facebook-u, vetëm se e demokratizon, e sjell procesin e vlerësimit formues më pranë studentit, i cili sa vjen edhe më shumë përpunon dhe mpreh shprehitë e vlerësimit.

b) Aspekti më i rëndësishëm jofavorizues i përdorimit të Facebook-ut, është fakti që për shkak të natyrës mjaft demokratike dhe të shpenguar të këtij mjedisi, studenti nuk i kushton vëmendjen dhe kujdesin e duhur punimit. Shpeshherë ato dorëzohen të paredaktuara ose jo të kuruara siç duhet. Nga ana tjetër, edhe komentet dhe feedback-u i prodhuar nga studentët, për nga toni dhe serioziteti janë spontanë dhe jo të menduara denjësisht. Shpeshherë komentet dhe vlerësimet janë larg identifikimit të problemeve dhe parashtrimit të zgjidhjeve për të përmirësuar punimet.

c) Ende ekziston mundësia që studenti duke e parë dialogun, vlerësimin dhe dhënien e feedback-ut si fakultativ, mund të tregohet indiferent dhe për pasojë nuk angazhohet aq sa duhet. Siç duket edhe nga fig. 1, jo të gjithë studentët apo grupi, kanë shprehur mendimin e tyre rreth punimit të përzgjedhur.

d) Prodhimi i feedback-ut përmes Facebook-ut, jo gjithmonë siguron cilësinë e tij. Pavarësisht faktit, se një “like” nuk përbën feedback cilësor, shumë studentë, mund të mjaftohen me një klikim duke mos e marrë mendimin për të bërë sugjerime ose duke dhënë mendime që mund të ndihmojnë në përsheptimin e nxënies nga ana e bashkënxënësit.

Figura 1 paraqet një punim të postuar në murin e grupit dhe më poshtë janë komentet dhe vërejtjet e bëra nga bashkënxënësit. Emrat e përdorur janë ato të vetë studentëve, që paraprakisht kanë dhënë pëlqimin për t’u përdorur në kuadrin e këtij artikulli.

Siç shihet nga paraqitja e mësipërme, pavarësisht anëve jo fort të favorshme të Facebook-u, por kur ato krahasohen me avantazhet e mëdha, atëherë mund të themi me plot bindje se ai mbetet një mjedis që mund të shfrytëzohet nga pedagogu i gjuhës angleze dhe i çdo gjuhe të huaj, madje pse jo edhe i gjuhës shqipe, jo vetëm në procesin e vlerësimit të hollësishëm që u bën punimeve me shkrim, por mbi të gjitha edhe në drejtim të krijimit dhe zhvillimit të shprehive tek studentët, për të prodhuar, kërkuar dhe përdorur feedback.

Bibliografi

- Irons, A., (2008), "Enhancing learning through formative assessment and feedback", London: Routledge.
- Nicol, D., Macfarlane-Dick, D., (2006), "Formative assessment and self-regulated learning: a model and seven principles of good feedback practice", *Studies in Higher Education*, Vol. 31, No. 2.
- Sadler, R., (1989), "Formative assessment: revising and territory", *Assessment in Education*, Vol. 5, No. 1, pp. 77- 84.
- Tunstall, P., Gipps, C., (1996), "Teacher feedback to young children in formative assessment: a typology", *British Educational Research Journal* 22:4, 389 – 404.

VITI XVIII I BOTIMIT, Nr. 25, 2013

BULETINI SHKENCOR

SCIENCE BULLETIN

(seria e shkencave shoqërore)
(social science series)